

LIBËR PËR MËSUESIN

GJUHA SHQIPE 9

Për klasën e 9-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



BOTIME



Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Lindita PRELA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, Maj 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë. Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por dhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë. Korniza Kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyç nga nxënësit. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave kyç janë të domosdoshëm për një individ, me qëllim që të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo fushë të nxëni dhe lëndë synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së gjuhës shqipe, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës

PLANI MËSIMOR VJETOR 2018-2019

FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

LËNDA: GJUHË SHQIPE

KLASA: IX

35 javë x 5 orë = 175 orë

	Kompetencat e fushës		Shkathësitë që do të realizohen në komunikim përmes:	Orë
1	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshëm	8	Gjuhës së dëgjuar	8
2	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	7	Gjuhës së folur	7
3	Të lexuarit e teksteve letrare dhe Teksteve joletrare	65	Teksteve në prozë Teksteve poetike Teksteve dramatike Teksteve joletrare	30 12 7 16
4	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	20	Gjuhës së shkruar	20
5	Përdorimi i drejtë i gjuhës	60	Njohurive gramatikore Sintaksë Morfologji Leksikologji Fjalëformim Drejtshkrim	60 18 24 5 2 11
6	Provime lirim			15
	Gjithsej			175

- Shënime:**
1. Orët për testime, projekte, panair portofoli dhe përforsim njohurish janë parashikuar nga të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe provime lirim.
 2. Bisedat letrare sugjerohen të merren nga orët dyshe të kompetencës “Lexojmë”
 3. **Një pjesë** të orëve të përsëritjes për Provimet e Lirimit, mësuesi/ja mund t'i shfrytëzojë për të rimarë ose përforsuar njohuritë, në bazë të nevojave dhe specifikave të klasës.

KOMPETENCAT E FUSHËS	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR–MARS	PRILL–QERSHOR
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	3 orë	2 orë	3 orë
Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	5 orë	–	2 orë
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	29 orë	21 orë	15 orë
Të shkruarit për qëllime formale dhe funksionale	3 orë	11 orë	6 orë
Përdorimi i drejtë i gjuhës	19 orë	23 orë	18 orë
Provime lirim	1 orë provim lirim	3 orë provim lirim	11 orë provim lirim

Brenda tyre ka:

1 orë test	1 orë test	1 orë test
3 orë projekt	3 orë projekt	3 orë projekt
2 orë bisedë letrare	2 orë bisedë letrare	2 orë bisedë letrare
1 orë panair portofoli	1 orë panair portofoli	1 orë panair portofoli

<p>REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç:</p>
<p>KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; - dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime; - lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim; - shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
<p>KOMPETENCA E TË MENDUARIT Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme; - harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; - përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.
<p>KOMPETENCA E TË NXËNIT Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; - shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit; - ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
<p>KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses; - bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
<p>KOMPETENCA QYTETARE Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.
<p>KOMPETENCA DIGJITALE Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar. - analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
<p>REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to; - jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi:

- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;
- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi:

- dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;
- lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

a)

b) Tekste letrare

- dallon temën, mesazhin dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;
- dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

a)

b) Tekste joletrare

- dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.).

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi:

- përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi:

- dallon dhe përcakton theksin e fjalës dhe llojet e intonacionit në fjali;
- dallon zanoret dhe llojet e bashkëtingëlloreve (të zëshme dhe të pazëshme, të shurdhëta dhe tingullta);
- përcakton mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- dallon, përdor dhe krijon fjalë të prejardhura;
- dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve dhe krijon vetë fusha dhe familje fjalësh;
- përcakton klasat e fjalëve;
- klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- analizon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (dallon gjininë asnjansore dhe shumësin e emrave);
- dallon dhe analizon mbiemrat (të nyjshëm, të panyjshëm, gjini, numër, rasë);
- dallon llojet e përemrave dhe analizon përemrin vetor dhe trajtat e shkurtra;
- dallon dhe përcakton mënyrën dhe kohët e foljes;
- zgjedhon foljen në mënyrën dëftore.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Sugjerohet që gjatë orëve të mësimi do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *stuhi mendimi, leximi i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë*, diskutim për njohuritë paraprake, *harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, kubimi, diagrame piramidale, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit* etj.

Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.

Vlerësimi

Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, testeve, pjesëmarrja në biseda e diskutime e leximet jashtë klase, diktimet etj.

**PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NDARË NË
TREMUTORË**

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: GJUHË SHQIPE

Shkalla: IV

Klasa: IX

Viti shkollor: 2018-2019

Nr.	Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	Flasim	Elemente të komunikimit joverbal dhe rëndësia e tyre gjatë të folurit	Lojë në role: “Unë bëj gjestin, ti më thuaj kuptimin!”	<i>Pyeja sjell pyejen, të nxënit në bashkëpunim, pemë mendimi, ditari dypjesësh</i>	Vlerësim për dallimin midis komunikimit gjuhësor dhe jogjuhësor.	Inetmeti; Revista
2.	Flasim	Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde	Vargje për rëndësinë e gjuhës standarde	<i>Lëviz/ndalo/krijoj dyshe, Diskutim, Puno në dyshe</i>	Vlerësim i punës hulumtuese.	Interneti; Intervista
3.	Lexojmë	Ciklopi	Kali i Trojës	<i>Stuhi mendimi; kllaster; marrëdhënia pyetje-përgjigje</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	“Euripidi në prozë”- Janis Benekos
4	Lexojmë	Ciklopi	Fragment nga filmi “Odiseu”	<i>Diskutim; punë e pavarur; punë dyshe; punë individuale</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Interneti; Fragmente filmike
5	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit	Fjalë pa shenja pikësimit.	<i>Stuhi mendimi, INSERT, shkrim i lirë</i>	Vlerësim për përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit.	Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe
6	Lexojmë	Fjalë e grosh	Fjalë e urtë: “E mirë fuqia, por ca më mirë urtia”	<i>Bisedë e lirë; lexim zinxhir; kllaster; diskutim; punë e pavarur; punë dyshe; shkrim i lirë</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri “Përralla shqiptare”
7	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë	Punë në dyshe	<i>Punë në dyshe; Diskutim; Punë e pavarur; Punë në grupe; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe

8	Dëgjojmë	Krijimi i universit	Dokumentar	<i>Imaginatë e drejtuar; Pemë mendimi; Shkrim i lirë; Punë në dyshe</i>	Vlerësim për dallimin e elementeve të mitit	Internet; Literaturë shtesë
9	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Përdorimi i drejtë i ligjëratës së zhdrejtë	Diskutim	<i>Diskutim; Punë në dyshe; Punë e pavarur; Punë në grupe; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit; Interneti
10	Flasim	Zakonet dhe traditat tona	Histori të traditave shqiptare	<i>Diskutim; Të nxënëit në bashkëpunim; Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Folklori
11	Lexojmë	Shuarja e humorit	Kujtime me shokë të fëmijërisë	<i>Diskutim; Klaster; Lexim në role; Tabela e koncepteve</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit, Vepra e Dritëro Agollit
12	Lexojmë	Shuarja e humorit	Diskutim për vlerat e shoqërisë.	<i>Diskutim; Klaster; Punë individuale; Punë e drejtuar; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i nxënësve për shprehjen e mendimeve dhe diskutimin.	Teksti i nxënësit, Vepra e Dritëro Agollit
13	Lexojmë	Fshati mbi shtatë kodrina	Mjedisi gjeografik (relievi) i Shqipërisë	<i>Bisedë; Skeda e autorit; Klaster; Punë e drejtuar</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Novela: “Fshati mbi shtatë kodrina”
14	Lexojmë	Fshati mbi shtatë kodrina		<i>Diskutim; Punë në grup; Punë individuale; Punë dyshe; Koment</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Novela: “Fshati mbi shtatë kodrina”
15	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dy zanore	Minikonkurs	<i>Minikonkurs; Diskutim; Punë në dyshe; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe
16	Lexojmë	Lodra mbi akull	Lojërat në dimër	<i>Diskutim; Skeda e autorit; Lexim zinxhir; Ditëryt; Punë dyshe</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri “Të fala nga fshati”
17	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet ye, ua, ue.	Punë e pavarur	<i>Stuhi mendimi; Punë e pavarur; Shpjegim; Punë dyshe; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për saktësinë e përgjigjeve	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

18	Dëgjimë	Përvoja personale	Punë me tekstin	<i>Parashikim me anë të titullit; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për përdorimin e elementëve rrëfyes.	Libri “Gjuha standarde”
19	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja	Bisedë	<i>Bisedë; Diskutim; Punë dyshe; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Libri “Gjuha standarde”.
20	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Drejtshkrimi i njëjës së përparme të emrave (i, e, të, së)		<i>Punë dyshe; Shpjegim; Diskutim; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Libri “Gjuha standarde”.
21	Lexojmë	Djali me pizhame me vija	Pjesë filmike	<i>Bisedë; lexim zinxhir; diskutim; Pyetje-përgjigje</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Pjesë filmike; Teksti i nxënësit; Libri “Djali me pizhame me vija”.
22	Lexojmë	Djali me pizhame me vija	Ngjarje nga Lufta e Dytë Botërore	<i>Diskutim; Tabela e krahasimit; Punë individuale; Punë dyshe; Kllaster</i>	Vlerësim për punën kërkimore	Pjesë filmike; Teksti i nxënësit; Libri “Djali me pizhame me vija”.
23	Dëgjimë	Projekt (ora e parë) “Ne dhe traditat tona”.	“Zakonet dhe traditat tona” nëpër këngë, përralla, legjenda dhe në rrëfënja popullore	<i>Brainstorming; Pyetje-përgjigje; Analizë rasti; Mendo/puno në dyshe/shkëmbë; Mbajtja e shënimeve</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje, Vlerësim i njëri-tjetrit.	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”; Materiale të përgatitura nga mësuesi/ja dhe nxënësit; Foto nga interneti.

24	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Drejtshkrimi i njëjës së përparme të mbiemrave dhe të përemrave pronorë	Punë dyshe	<i>Punë dyshe; Shpjegim; Diskutim; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Libri "Shqipja standarde"
25	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura				
26	Flasim	Unë dhe miqësia	Komento	<i>Diskutim; Stuhi mendimi; Shkrim i lirë</i>	Vlerësimi për punën hulumtuese	Teksti i nxënësit; Folklori shqiptar
27	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras	Minikonkurs	<i>Minikonkurs; Shpjegim; Diskutim; Punë në dyshe; Punë e pavarur</i>	Vlerësimi për saktësinë e përgjigjeve	Libri "Shqipja standarde"; Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe
28	Shkruajmë	Mes miqsh	Unë dhe miqësia. Jemi të rrethuar nga shoqëria dhe miqësia. Çfarë i bën ata të veçantë për ne?	<i>Pyetje-përgjigje; punë e pavarur; mbajtja e shënimeve; diskutim; analizë rasti; diskutim; fjalët kyçe; ditari tripjesësh.</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje; Vlerësim i njëri-tjetrit; Vlerësim motivues	Teksti i nxënësit "Gjuha shqipe 9"; Materiale të përgatitura nga mësuesi/ja
29	Shkruajmë	Mes miqsh	Unë dhe miqësia. Kë konsideron "mik të vërtetë"? Ke bërë ndonjëherë diçka të veçantë për të?	<i>Rrjeti i diskutimit; Pyetje – pyetje; Organizuesi grafik; Minileksion; Punë e pavarur; Punë e drejtuar; Shkrimi i lirë.</i>	Vlerësim me notë.	Teksti i nxënësit "Gjuha shqipe 9"; Materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
30	Njohuri gjuhësore (Drejtshkrim)	Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes	Gara e fjalëve	<i>Konkurs; Diskutim; Punë në grupe; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.
31	Lexojmë	Doktor Gjëlpera	Situata politike, shoqërore e kulturore e	<i>Diskutim; Skeda e autorit; Lexim zinxhir; Pyetje-përgjigje</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit

			Shqipërisë në vitet '20						
32	Lexojmë	Doktor Gjëlpera	Situata politike, shoqërore e kulturore e Shqipërisë në vitet '20	<i>Diskutim; Punë individuale; Marrëdhënie pyetje-përgjigje; Punë në grup</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Veptra “Doktor Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurasis”			
33	Lexojmë	Vdekja e një nëpunësi	Çfarë është përulësia?	<i>Suhi Mendimi; Klaster; Pyetje-Përgjigje; Diskutim</i>	Vlerësim i nxënësve për dallimin e karakteristikave të tregimit	Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”			
34	Lexojmë	Vdekja e një nëpunësi		<i>Punë në grup; Diskutim; Punë individuale</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”			
35	Njohuri gjuhësore (Fjalëformim)	Formimi i fjalëve në gjuhën shqipe	Suhi mendimi	<i>Suhi mendimi; Punë e pavarur; Punë dyshe; Punë në grupe</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”			
36	Lexojmë	Tregu	Imazhe të ndryshme të tregjeve.	<i>Përshkrim; Skeda e romanit; Lexim zinxhir; Pyetje –Përgjigje; Punë në grup; Punë individuale; Diskutim</i>	Vlerësim për mendimin krijues dhe argumentimin.	Teksti i nxënësit; Romani “Poetët bëjnë dashuri ndryshe”			
37	Njohuri gjuhësore (Fjalëformim)	Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe	Pemë mendimi	<i>Pema e mendimit; Pyetje-përgjigje; Diskutim; Punë në dyshe; Punë në grupe</i>	Vlerësim për aktivizimin dhe dhënien e përgjigjeve të sakta gjatë orës.	Teksti i nxënësit			
38	Lexojmë	Guido dhe gjuha greke	Jeta shkollore në ditët e sotme	<i>Parashikim me terma paraparakë; Lexim zinxhir; Diskutim; Pyetje-Përgjigje</i>	Vlerësim për aktivizimin dhe dhënien e	Teksti i nxënësit			

39	Lexojmë	Guido dhe gjuha greke	Marrëdhëniet mësues-nxënës	<i>Diskutim; Punë individuale; Tabela e krahasimit; Ruaje fjalën e fundit për mua; Bisedë</i>	përgjigjeve të sakta gjatë orës. Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit
40	Njohuri gjuhësore (Leksikologji)	Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij	Stuhi mendimi	<i>Stuhi mendimi; Diskutim; Punë e drejtuar; Punë në grupe</i>	Vlerësim për aktivizimin dhe dhënien e përgjigjeve të sakta gjatë orës	Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe; Pema e gjuhëve
41	Lexojmë	Ndryshimi i Aleksit	Bisedë rreth adoleshencës	<i>Bisedë; Lexim zinxhir; Tabela e koncepteve; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri “Histori dashurie rock and roll”
42	Lexojmë	Ndryshimi i Aleksit	Puna me tekstin	<i>Diskutim; Ditari dyjesh; Punë dyshe; Tabela e krahasimit</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri “Histori dashurie rock and roll”; Teksti i nxënësit
43	Lexojmë	Holdeni te profesori	Fragment nga filmi shqiptar “Shoku ynë Tili”	<i>Bisedë; Lexim në Role; Pyetje-Përgjigje; Diagramë veni; Diskutim; Punë me tekstin; Diskutim në grupe</i>	Vlerësim për mendimin krijues dhe argumentimin	Libri “Rojë në thekërishten buzë greminës”
44	Dëgjojmë	Projekt (ora e dytë) ““Ne dhe traditat tona”	“Zakonet dhe traditat tona” Burrat shqiptarë mbanin stoli të ndryshme argjendi, sumbulla dekorative tek jelekët, unaza, pipa e kuti cigaresh, armët e brezit të stolisura.	<i>Pyetje -Përgjigje, Organizuesi grafik, Punë në grupe, Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, Punë e pavarur, Punë e drejtuar, Puno/Shkëmbe.</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje; Vlerësim i njëri-tjetrit; Vlerësim motivues	Materiale të përgatitura nga mësuesi/ja dhe nxënësit

45	Njohuri gjuhësore (Leksikologji)	Huazimet. Shmangia e tyre	Interpretojmë poezi për gjuhën shqipe.	<i>Interpretim, Punë dyshe (Të nxënësit me këmbime); Shpjegim i lidhur me diskutimin; Punë e pavarur; Koment</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit
46	Lexojmë	Purpuranti	Libri “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”; Fragment filmik.	<i>Diskutim; Lexim zinxhir; Kllaster; Pyetje-përgjigje; Punë dyshe</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje	Fragment nga filmi “Skënderbeu”
47	Lexojmë	Purpuranti		<i>Diskutim; Punë në grup; Punë individuale; Ditari dy pjesësh;</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit
48	Lexojmë	Maska e murtajës së kuqe	Punë me tekstin.	<i>Parashikim me tema paraprake; lexim i drejtuar; bisedë</i>	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Libri “Tregimet e misterit”
49	Njohuri gjuhësore (Leksikologji)	Regjistrat e gjuhës	Anës liqenit. Nata po afrohet.	<i>Diskutim, analizë rasti, pyetje-përgjigje, ditari tri pjesësh, punë me tekstin, puno/shkëmbe, rrjeti i diskutimit.</i>	Vlerësim motivues me fjalë e shprehje. Vlerësim me notë. Vetëvlerësim. Vlerësim të njëri-tjetrit	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, “Anës liqenit”; Materiale të përgatitura nga mësuesi/ja
50	Njohuri gjuhësore (Leksikologji)	Stilet e gjuhës	Planeti ynë.	<i>Pyetje -përgjigje, Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, Punë me tekstin, Ditaret e të nxënëit, Punë në grupe. Punos/shkëmbe.</i>	Vlerësim motivues me fjalë e shprehje.	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”; Materiale rreth planetit tonë të përgatitura nga mësuesi/ja.

51	Lexojmë	Një pulëbardhë e mahnitshme	Liria është jetë, jeta është liri!	<i>Stuhi mendimi; Lexim në role; Pyetje-përgjigje; Punë në grupe; Ditari dypjesësh; Diskutim</i>	Vlerësim motivues me fjalë e shprehje	Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”
52	Njohuri gjuhësore (Leksikologji)	Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe	Dispozitat Normative. NENI 85. Të drejta dhe detyra të nxënëseve.	<i>Rrjeti i diskutimit; Analizë rasti; Termat kyçe; Punë me tekstin; Grupi i ekspertëve; Teknika RAFT; Puno/ shkëmbe.</i>	Vlerësim me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimit të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve.	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”; Materiale të gatshme të sjella nga mësuesi/ja.
53	Lexojmë	Xhonasi dhe ngjyrat	Shikojmë foto me ngjyra	<i>Stuhi mendimi; Kllaster; Lexim zinxhir; Pyetje-përgjigje</i>	Vlerësim i vazhdueshëm i nxënëseve në të gjitha hapat e orës mësimore	Romani: “Dhënësi”
54	Lexojmë	Xhonasi dhe ngjyrat	Punë me tekstin	<i>Diskutim; Ditar dypjesësh; Punë në grup</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Romani: “Dhënësi”
55	Shkrualjmë	Projekt (ora e tretë) “Ne dhe traditat tona” .	“Zakonet dhe traditat tona” Vargje nga Bajroni.	<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, Pyetje – përgjigje, Punë në grupe, Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, Lojë me role, Improvizim, Prezantim</i>	Vlerësim motivues. Vetëvlerësim, vlerësim të njëri-tjetrit, Vlerësim me notë.	Materiale të përgatitura nga nxënësit, Veshje popullore, projektor.
56	Lexojmë	Shndërrimi i doktor Xhekillit	Lojë më sy të mbyllur.	<i>Lojë, Bisedë e kombinuar me argumentim, Shkrim i lirë, Pyetje-përgjigje, Minileksion, Punë me tekstin, Shënime paraprake, Diskutim i lirë, Puno dyshe.</i>	Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna.	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”; Foto nga interneti të personazheve

57	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme	Të nxënësit me këmbime	Të nxënëti me këmbime (Punë në dyshje); Organizuesi grafik; Punë e pavarur; Punë në grupe	Vlerësim i vazhdueshëm	të ndryshme fantastike.
58	Flasim	Romani grafik	Sinjalet rrugore. Shenjat e qarkullimit rrugor.	Parashikimi me terma paraprakë, pyetje-përgjigje; Minileksion; punë me tekstin; Punë individuale; Puno/ndihmo/shkëmbe. Lojë me role	Nxënësit do të motivohen me shprehje. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna.	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”; Foto dhe materiale të gatshme.
59	Lexojmë	Test për tremujorin e parë	Tremujori i parë. Nxënësit duhet të përqendrohet tek pjesa e dhënë dhe pyetjet e testit.	Stuhi mendimi, Punë me modele, Punë individuale	Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimit të ushtrimeve.	Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”; Fletët e testit.
60	Lexojmë	Panair portofoli	Reklama. Reklama është një veprim, imazh apo fjalë që tërheq vëmendjen e publikut ndaj diçkaje.	Pyetje- përgjigje; Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim; Ditarët e të nxënëti, Punë e pavarur, Analizë rasti, Lojë me role, Rrjeti i diskutimit, Turi i galerisë.	Vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje. Nxënësit do të vlerësohen me notë për punimet e dosjes.	Materiallet të gatshme të sjella nga mësuesi/ja, portofolet e nxënësave, detyrat e nxënësave.

TREMJORI I DYTË

1	Lexojmë	Gjithçka fillon nga respekti për veten	Oh sa mirë me qenë shqiptar! Jam krenar që jam shqiptar!	<i>Diskutim i lirë, pyetje- përgjigje; Fjalë kyçe; Imagjinatë e drejtuar; Minileksion; Puno dyshë/shkëmbe; Hulumtim</i>	Vlerësim motivues	Teksti i nxënësit; Libri “Persepolis”
2	Lexojmë	Gjithçka fillon nga respekti për veten	Adoleshenca	<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim; Analizë rasti, Minileksion, Gjej/zëvendëso, Pyetje-përgjigje, Prezantim, Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim me notë për përgjigjet e dhëna	Teksti i nxënësit; Libri “Persepolis; Libri “Kozeta” V. Hygo
3	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Kategoritë gramatikore të emrit	Dallojmë emrat	<i>Pune individuale; INSERT (Diskutim ne grup, Tabela përmbledhëse), Pema e mendimit</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit, Gramatika 1, Tabela e emrit
14	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Kategoritë gramatikore të emrit	Dallimi i kategorive gramatikore të emrave	<i>Pune e pavarur; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit, Gramatika 1, Tabela e emrit
5	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Emri: kategoria gramatikore e numrit	Lojë fjalësh	<i>Diskutim për njohuritë parafrase (Brainstorming); Punë e drejtuar; Punë individuale; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1; Tabela e emrit
6	Lexojmë	Sharlota	Holokausti	<i>Stuhi mendimi; Informacione shitesë; Leximi zinxhir; Karrigia e autorit; Prezantim; Punë me tekstin; Analizë teksti</i>	Vlerësim me notë	Teksti i nxënësit, Libri “Sharlota” David Foekinos
7	Lexojmë	Sharlota	Arti dhe ndjenjat	<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim; Pyetje-përgjigje; Punë e drejtuar, analizë teksti; Analizë personazhesh; Punë me tekstin, punë parafrase.</i>	Vlerësim me fjalë dhe shprehje	

8	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Emri: kategoria gramatikore e rasës	Analiza morfologjike të emrit	<i>Suhi mendimi; Punë e drejtuar; Teknika pyetje-përgjigje; Punë individuale</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Gramatika 1, 2; Teksti i nxënësit
9	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Emri: kategoria gramatikore e rasës	Analiza morfologjike të emrit	<i>Diskutim; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Gramatika 1, 2; Teksti i nxënësit
10	Lexojmë	Ejani, o kujtime!	Filasim për kujtimet më të bukura	<i>Diskutim; Të nxënësit në bashkëpunim; Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për dallimin e karakteristikave të prozës poetike	Teksti i nxënësit; Interneti
11	Shkruajmë	Prozë poetike	“Bora” Faik Konica	<i>Përvijim i të menduarit; Punë individuale; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për krijimin e prozave poetike	Proza të ndryshme; Interneti
12	Shkruajmë	Prozë poetike	Punë me tekstin	<i>Diskutim; Punë e pavarur; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit
13	Lexojmë	Martesa e Halilit	Vargje nga cikli i kreshnikëve	<i>Parashikim me anë të titullit; Minilekton; Pune dyshe; Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për krijimin e prozave poetike	Çështje të folklorit shqiptar vëllimi 2, 3
14	Lexojmë	Martesa e Halilit	Punë me tekstin	<i>Suhi mendimi; Punë dyshe; Diskutim; Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Çështje të folklorit shqiptar vëllimi 2, 3
15	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Mbiemri: kategoria gramatikore e gjinisë		<i>Suhi mendimi –kllaster; Punë e drejtuar; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1 dhe 2;
16	Lexojmë	Shpreh	Vargje nga Naimi	<i>Suhi mendimi; Diskutim, të nënësit në bashkëpunim; Vija e vlerës</i>	Vlerësim i nxënësit për analizën metrike	Teksti i nxënësit; Vëllimi poetik “Lulet e Verës” N.Frashëri

17	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Mbimi: kategoria gramatikore e numrit dhe e rasës	Kthimi në shumës dhe lakimi i grupeve emërore	<i>Punë e pavarur; Punë me fishta, Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
18	Lexojmë	Vranina	Vargje nga Gjergj Fishta	<i>Pemë mendimi; Punë dyshe</i>	Vlerësim i nxënësve për analizën letrare	Teksti i nxënësit; "Lahua e Malcis"; Interneti
19	Lexojmë	Vranina	Vargje nga Gjergj Fishta	<i>Diskutim; Të nxënëti në bashkëpunim; Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim i nxënësve për analizën letrare	Teksti i nxënësit; "Lahua e Malcis"; Interneti
20	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Mbimi: kategoria gramatikore e shkallës		<i>Punë e drejtuar; Shpjegim; Punë në dyshe; Punë e pavarur</i>	Vlerësim hap pas hapi	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
21	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Përimi: kategoria gramatikore e vetës, numrit dhe e gjinisë	Përdorimi i drejtë i përemrave	<i>Punë në grupe; Të nxënëti në bashkëpunim; Diskutim</i>	Vlerësim hap pas hapi	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
22	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Përimi: kategoria gramatikore e vetës, numrit dhe e gjinisë		<i>Diskutim; Punë individuale; minikonkurs</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
23	Lexojmë	Lamtumirë	Histori personale	<i>Parashikim me anë të titullit; Praktikë e drejtuar; Karrigia e nxehtë</i>	Vlerësim për analizën e poezisë në të gjitha rrafshet	Vëllime poetike; Teksti i nxënësit
24	Shkruajmë	Projekt (ora e parë) "Kujtime dhe krijime".	Çfarë janë kujtimet?	<i>Harta e mendimeve; Pyetje – përgjigje; Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim; Rrjeti i diskutimit; Analizë rasti; Punë e drejtuar; Punë e pavarur.</i>	Vlerësim me fjalë dhe shprehje	Ditar; Libër kujtimesh
25	Lexojmë	Kënga e natës	Thënie nga Gëte	<i>Diskutim; Punë në dyshe; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për analizën e poezisë në të gjitha rrafshet	Vepra poetike e Gëtes; Teksti i nxënësit

26	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Përemri: kategoria gramatikore e rasës		<i>Kllaster; Diskutim; Punë në grup; Punë individuale</i>	Vlerësim hap pas hapi	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
27	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Përemri: kategoria gramatikore e rasës		<i>Suhi Mendimi; Kllaster; Diskutim; Punë në grup; Punë individuale</i>	Vlerësim hap pas hapi	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
28	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Lakimi i përemrave pronorë	Lakoj përemra pronorë	<i>Mbajja e strukturuar e shënimeve në punë dyshë; Organizues grafik krahaso-dallo; Diskutim; Lojë zinxhir</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
29	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Lakimi i përemrave pronorë	Përdorimi i përemrit sipas rasave	<i>Minikonkurs; Punë e pavarur; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
30	Lexojmë	Kënga LXI	Poezia “Lirija”, Ndre Mjeda	<i>Minilekcion; Lexim dhe analizë teksti (punë në grupe); Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për analizën e poezisë në të gjitha rrafshet.	Teksti i nxënësit; Sonete nga Petrarca dhe Shekspir
31	Lexojmë	Gjuha shqipe	Vargje dhe thënie për gjuhën shqipe	<i>Diskutim; Lapsat në mes; Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për hulumtimin dhe analizën e veprës	Teksti i nxënësit; Interneti
32	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Përemri i pacaktuar	Lexim i fragmenteve që përmbajnë përemra të pacaktuar	<i>Pyetja sjell pyetjen; Përvijim i të menduarit; Punë individuale; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
33	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Foljet njëvetore dhe foljet pavetore. Foljet e parregullta	Përdorimi i foljes në fjali	<i>Suhi mendimi-kllaster; Punë individuale; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
34	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Foljet njëvetore dhe foljet pavetore. Foljet e parregullta	Përdorimi i foljes në fjali	<i>Suhi mendimi; Shpjegim; Punë e pavarur; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
35	Dëgjojmë	Në mundsh	Interpretime të ndryshme	<i>Bashkëbisedim; Shkrimi i lirë; Punë në dyshë; Konkurs recitimi</i>	Vlerësim me fjalë dhe shprehje	Interneti; CD

36	Shkruajmë	Kthejmë një poezi në prozë	Tekste në poezi	<i>Skeda e librit; Të nxënë në bashkëpunim; Grupet e ekspertëve; Turi i galerisë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim	Teksti i nxënësit “Odisea – përshtatje për fëmijë” Tregime të moçme shqiptare
37	Shkruajmë	Kthejmë një poezi në prozë	Punë me tekstin	<i>Diskutim; Punë e pavarur; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim i vazhduar	Tekste në vargje
38	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Forma veprorë e foljeve	Puna me tekstin	<i>Harta e mendjes; Të nxënë në bashkëpunim; Lojë gjuhësore</i>	Vlerësim hap pas hapi.	Teksti i nxënësit
39	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Forma veprorë e foljeve		<i>Diskutim; Punë e pavarur</i>		Teksti i nxënësit
40	Shkruajmë	Projekt (ora e dytë) “Kujtime dhe krijime”.	“Më thuaj me kërrri, të të them se kush je”	<i>Pyejtje –përgjigje; tabela; analizë rasti; rrjeti i diskutimit; puno/shkëmbe; konkurs; punë me grupe</i>		Modele me libra kujtimesh
41	Lexojmë	I sëmuri për mend	“Të kemi shëndetin” thënia e popullit	<i>Pyejtje – përgjigje; studim rasti; rrjeti i diskutimit; minilekcion; punë individuale me tekstin; lexim me role</i>	Vlerësim me fjalë dhe shprehje	“I sëmuri për mend” nga Moliëri; Teksti i nxënësit
42	Lexojmë	I sëmuri për mend	Teatri	<i>Lojë shpejtësi; Stuhi mendimi; minilekcion; Punë me tekstin; punë individuale; Puno/shkëmbe; diskutim i lire; Lojë me role</i>	Vlerësim me notë	“I sëmuri për mend” nga Moliëri; Teksti i nxënësit
43	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Forma joveprorë e foljeve		<i>Stuhi mendimi; Kllaster; Punë e drejtuar në tekst; Lojë gjuhësore</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1

44	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Forma joveprore e foljeve		<i>Suhi mendimi; Punë individuale; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
45	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Parafjalët dhe lokucionet parafjalore		<i>Punë e drejtuar; Kllaster; Punë individuale; Punë në çift; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
46	Shkruajmë	Një tekst për teatër	Krahasim i dy teksteve	<i>Vështrim krahasues, Diskutim, Interpretim, Punë individuale(Shkrim i lirë)</i>	Vlerësim; Vetëvlerësim	Tekste të ndryshme dramatike
47	Shkruajmë	Një tekst për teatër	Punë me shkrim	<i>Punë me shkrim; Turi i galerisë; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Tekste të ndryshme dramatike
48	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Dallimi i parafjalëve nga ndajfoljet dhe nga emrat me të njëjtën formë		<i>Suhi mendimi; Kllaster; Punë e drejtuar; Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
49	Provime Lirimi	Dallimi i parafjalëve nga ndajfoljet dhe nga emrat me të njëjtën formë		<i>Punë individuale; Punë në dyshë; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
50	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Dallimi i lidhëzave nga përemrat	Punë me tekstin	<i>INSERT; Punë në dyshë; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
51	Lexojmë	Trashëgimia		<i>Suhi mendimi; Lexim në role; Diskutim; Punë në grupe</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	Tekste dhe pjesë letrare
52	Lexojmë	Trashëgimia	Lojë në role	<i>Lojë në role; Punë në grupe Shkrim i lire Pyetja binare (Rrjeti i diskutimit); Diskutim</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	Tekste dhe pjesë letrare
53	Dëgjimë	Nata e dymbëdhjetë	Shfaqje teatore	<i>Suhi mendimi; Dëgjim i kujdesshëm; Diskutim</i>	Vlerësim për aktivizimin dhe interpretimin	Pjesë dramatike

54	Njohuri gjuhësore (Morfologji)	Dallimi i lidhëzave nga ndajfoljet dhe parafjalët me formë të njëjtë			<i>Të lexuarit ndërveprues; Punë dyshe; Punë individuale; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 1
55	Shkruajmë	Projekt (ora e tretë) "Kujtime dhe krijime".	Poezi		<i>Imaginatë e drejtuar; pyetje - përgjigje, punë me modele; analizë rasti; prezantim me video mesazh; lojë me role; reklamim.</i>	Vlerësim përmbledhës me notë	Libra me kujtime, autobiografi.
56	Shkruajmë	Përshkrimi i një shfaqjeje teatrale	Të ndjekim një shfaqje teatrale		<i>Ndjekja e organizuar e një shfaqjeje teatrale; Bisedë; Organizuesi grafik; Shkrim i lire; Turi i galerisë</i>	Vlerësim për aktivizimin dhe dhënien e mendimeve gjatë orës së mësimt	DVD; Shfaqje të ndryshme teatrale
57	Lexojmë	Jetë kampionësh	Ne dhe sporti		<i>Bisedë; Suhu mendimi; Lexim; Diskutim; Punë në grupe</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	Revista; gazeta
58	Shkruajmë	Nëntëvjeçarja mbaroi	Unë dhe episodet e mia më të bukura nga jeta shkollore		<i>Bisedë; Punë individuale; Turi i galerisë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	Albume fotografike
59	Lexojmë	Test për tremujorin e dytë					
60	Lexojmë	Panair Portofoli	Llojet e teksteve		<i>Bisedë e kombinuar me arsyetim; analizë rasti; minileksion; punë e drejtuar; tabela krahasuese; puno/shkëmbe</i>	Vlerësim përmbledhës për portofolin	Portofolet e nxënësve; detyrat e tremujorit të dytë

TREMJORI I TRETË

	Lexojmë	Artizanët e filigranit	Çfarë është profesioni?	Gushëkuqi rrethor; pyetje-përgjigje; punë me tekstin; minileksion; hulumtim; punim ushtrimesh; diskutim i lirë	Vlerësim me notë	Teksti i nxënësit
1	Dëgjojmë	Beteja për lumin Vjosa	Beteja për lumin Vjosa	<i>Përvijim i të menduarit; Role të specializuara në diskutime; Grupe ekspertësh; Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për punën hulumtuese	Teksti i nxënësit; Internet, gazeta, revista
2	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Kallëzuesi		<i>Punë në grup; Diskutim; Punë në dyshe</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 2
3	Lexojmë	Unë dhe Shqipëria	Intervistë me mësuesen kujdestare ose drejtoreshën e shkollës	<i>Diskutim; Procedura pyet sërish; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	Teksti i nxënësit
4	Lexojmë	Kampi i Bedenit	Intervista e at Zef Pllumit	<i>Diskutim, Stuhi mendimi; Lexim-pyeje Ruaje fjalën e fundit për mua</i>	Vlerësim për punën hulumtuese	Teksti i nxënësit; Interneti
5	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Kryefjala	Puna me tekstin	<i>Stuhi mendimi; Kllaster; Pyetja sjell pyetjen; Punë individuale</i>	Vlerësim hap pas hapi	Gramatika e gjuhës shqipe 2
6	Flasim	Demokracia dhe të rinjtë	Punë me tekstin	<i>Bashkëbisedim; Të nxënërit në bashkëpunim; Turi i Galerisë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	Përmbledhje me ese
7	Lexojmë	Hallka e munguar në zinxhirin e evolucionit	Teoria e Darvinit	<i>Stuhi mendimi; Punë dyshe, Shënime të stukturuar</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Interneti; Teksti i nxënësit
8	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Kundrinori	Punë me tekstin	<i>Punë e drejtuar; Pema e mendimit; Punë individuale; Punë dyshe</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 2

10	Lexojmë	Zogitë Akrobatë, prijës dhe anëtarë të thjeshtë: ja rregullat e një tufë	Diskutojmë së bashku	<i>Imaginatë e drejtuar; Të nxënit në bashkëpunim; Diskutim</i>	Vlerësim për punën hulumtuese	Interneti; Teksti i nxënësit
11	Shkruajmë	Si shkruhet një CV	Këshilla	<i>Sqarim termash; pyetje-përgjigje; organizuesi grafik; punë me tekstin; punë me modele; punë e pavarur; konkurs</i>	Vlerësim motivues	Teksti i nxënësit
12	Shkruajmë	Si shkruhet një CV	Cilat janë gjërat e rëndësishme në jetën tonë?	<i>Pyetje-përgjigje; bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim; KLASER; punë me tekstin; punë e drejtuar</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Interneti; Teksti i nxënësit
13	Lexojmë	Ca këshilla mbi artin e shkrimit	Thënie për Faik Konicën	<i>Lëviz /ndalo /krijo dyshe; VLM; Diskutim</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Interneti; Teksti i nxënësit
14	Lexojmë	Ca këshilla mbi artin e shkrimit	Punë me tekstin	<i>Diskutim; Punë në dyshe; Shkrim i lirë</i>	Vlerësim hap pas hapi	Interneti; Teksti i nxënësit
15	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Rrethorët	Puna me tekstin	<i>Stuhi mendimi; Kllaster; Punë e drejtuar; Punë individuale</i>	Vlerësim hap pas hapi	Gramatika e gjuhës shqipe 2
16	Dëgjojmë	Projekt (ora e parë) “Revista e shkollës”	Përkufizime: Çfarë është leksiku?	<i>Mendimi i pare; harta e mendimit; pyetje –përgjigje; KLASER; analizë rasti; punë e drejtuar; organizuesi grafik; punë në grupe</i>	Vlerësim me shprehje e notë	Botime dhe revista të ndryshme
17	Lexojmë	Zgjidh një udhërrëfyes	Udhërrëfyesi yt	<i>Parashikim me anë të titullit; Rishiko në dyshe; Vija e vlerës</i>	Vlerësim për argumentet e dhëna gjatë orës së mesimit	Teksti i nxënësit
18	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Përcaktori dhe përcaktori kallëzuesor	Dallojmë përcaktorët.	<i>Punë e drejtuar; Kllaster; Punë individuale</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 2
19	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Përcaktori dhe përcaktori kallëzuesor	Përcaktori dhe përcaktori kallëzuesor	<i>Pyetja sjell pyetjen; Kllaster; Diskutim; Punë individuale</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 2

20	Dëgjojmë	Dëgjojmë një tekst udhëzues	Lojë në role	<i>Bashkëbisedim; Punë dyshe</i>	Vlerësim për punën hulumtuese	Interneti; Teksti i nxënësit
21	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Gjymtyrët homogjene	Identifikimi i gjymtyrëve homogjene	<i>INSERT; Diskutim; Punë individuale</i>	Vlerësim për punën hulumtuese	Libri i nxënësit; Gramatika 2
22	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Gjymtyrët homogjene	Identifikimi i gjymtyrëve homogjene	<i>Punë e pavarur; Diskutim</i>	Vlerësim për punën hulumtuese	Libri i nxënësit; Gramatika 2
23	Shkruajmë	Shkruajmë një plan për një projekt	Regjimi ditor	<i>Suhi mendimi; fjalët kyçe; minileksion; punë me tekstin; punë me modele; puno/shkëmbe; konkurs</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje	Teksti i nxënësit; informacione nga Interneti
24	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Llojet e fjalive sipas kumtimit. Fjalja dëftore	Puna me tekstin	<i>Diskutim; Tabela Insert; Punë Dyshe; Punë Individuale</i>	Vlerësim hap pas hapi	Teksti i nxënësit
25	Dëgjojmë	Projekt (ora e dytë) “Revista e shkollës”	Rregullojta e klasës	<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, rrjeti i diskutimit, minileksion, studim rasti, organizuesi grafik, punë me grupe, puno/shkëmbe.</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje	Revista të botuara nga nxënësit
26	Lexojmë	Pengesat në kënaqësinë e studimit	Librat jashtëshkollorë	<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, ditari dypjesësh, punë me tekstin, organizuesi grafik, hulumtim, punë me modele</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje	Teksti i nxënësit; Informacione nga Interneti
27	Lexojmë	Pengesat në kënaqësinë e studimit	Shkolla e mesme dhe profili i zgjedhur	<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë me tekstin, rrjeti i diskutimit, pyetje-përgjigje, puno/shkëmbe</i>	Vlerësim me fjalë e shprehje	Teksti i nxënësit, informacione nga Interneti
28	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë pyetëse dhe dëshirore	Puna me tekstin	<i>INSERT; punë e drejtuar; punë individuale; punë dyshe</i>	Vlerësim hap pas hapi	Libri i nxënësit; Gramatika 2
29	Lexojmë	Zbulimi i Hektorit	“Iliada” e Homerit	<i>Mendimi i parë, bisedë e kombinuar me diskutim dhe</i>	Vlerësim me notë	Libri i nxënësit;

					<i>argumentim, mendimi zinxhir, informacion shtesë, punë me tekstin, hulumtim, ditarët e të nxëniet, puno/shkëmbe, rrjeti i diskutimit</i>				Materiale të gatshme për veprën “Iliada”
30	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë pohore dhe fjalitë mohore			<i>Dëgjim i vëmendshëm; Stuhi mendimi; INSERT; Punë individuale; Punë dyshe</i>			Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit; Gramatika 2
31	Dëgjojmë	Fjalimi i Ismail Qemalit	Fragmente nga filmi “Nëntori i dytë”		<i>Dëgjim, Lojë gjuhësore, Lexim, Diskutim, Shkrim i lirë</i>			Vlerësim me fjalë e shprehje	DVD e filmit “Nëntori i dytë” Libri i nxënësit
32	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë njëkryegjymtyrëshe dhe fjalitë dykryegjymtyrëshe			<i>Stuhi mendimi; Shpjegim-Pema e mendimit; Punë individuale</i>			Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit; Gramatika 2
33	Flasim	Rolet e ndryshme të pjesëmarrësve në një diskutim	Diskutim i improvizuar		<i>Pema e mendimit; Role të specializuara në diskutim; Diskutim</i>			Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në diskutim	“Guidë për diskutimet në klasë”
34	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore			<i>Përvijimi i të menduarit; Pema e mendimit; Diskutim; Punë individuale; Punë në dyshe</i>			Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 2
35	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje	Gjetja e fjalive njëkryegjymtyrësh e foljore në tekste të ndryshme		<i>Përvijimi i të menduarit; Pema e mendimit; Diskutim; Punë individuale; Punë në dyshe</i>			Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i nxënësit; Gramatika 2
36	Shkruajmë	Shkruajmë ese argumentuese	“Ndikimi i video lojërave tek adoleshentët”		<i>Përvijimi i të menduarit, Lexim i koduar, Shkrim i lirë</i>			Vlerësim për zbatimin e strukturës së esesë	“Si të shkruajmë ese”, Libri i nxënësit
37	Shkruajmë	Shkruajmë ese argumentuese	Punë me tekstin		<i>Pemë mendimi; Punë pavarur individuale; diskutim</i>			Vlerësimi për zbatimin e strukturës së esesë	“Si të shkruajmë ese”, Libri i nxënësit

38	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë e përbëra me nënrenditje	Punë me tekstin	<i>Pyetja sjell pyetjen; Kllaster; Diskutim; Punë e pavarur</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit, Gramatika 2
39	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë e përbëra me nënrenditje	Punë me tekstin	<i>Punë e pavarur; Punë në çift; punë në grupe.</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit, Gramatika 2
40	Provime Lirimi	Projekt (ora e tretë) “Revista e shkollës”	Kujtime.	<i>Pyetje-përgjigje, situata reale, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, fotomontazh, prezantim, turi i galerisë, konkurs</i>	Vlerësim me notë	Revista të botuara
41	Lexojmë	Liqeni i Shkodrës	Përshkrimi i një pike turistike	<i>Fjalë kyçe, shkrim me terma paraprakë, punë e drejtuar, minileksion, hulumtim, punim ushtrimesh, informacione shitesë.</i>	Vlerësim me notë	Libri i nxënësit,, materiale shitesë
42	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore		<i>Punë në grup; Diskutim; Punë individuale; Punë në çift</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit, Gramatika 2
43	Lexojmë	Banesa tiranase	Komunikimi	<i>Fotomontazh, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, organizuesi grafik, hulumtim, punë e drejtuar, punë me tekstin, puno/shkëmbe, punë individuale.</i>	Vlerësim me notë	Libri i nxënësit; Materiale shitesë
44	Njohuri gjuhësore (Sintaksë)	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore	Identifikimi i pjesës së nënrenditur përcaktore.	<i>Stuhi mendimi; Kllaster; Diskutim; Punë në grup; Punë individuale</i>	Vlerësim i vazhdueshëm	Libri i nxënësit, Gramatika 2
45	Shkruajmë	Shkruajmë ese përshkruese	Leximi i teksteve letrare	<i>Punë në grupe, Lexim, Diskutim, Punë e pavarur, Turi i galerisë</i>	Vlerësim me notë	Modele esesh, libri i nxënësit
46	Lexojmë	Test për tremujorin e tretë				
47	Lexojmë	Panair Portofoli	Përshkrimi objektiv dhe subjektiv	<i>Bisedë e kombinuar me arsyetim, gushëkuqi rrethor, minileksion, punë e drejtuar, puno/shkëmbe,</i>	Vlerësim me notë	Portofolet e nxënësve; Detyrat e tremujorit

48	Provime Lirimi								
49	Provime Lirimi								
50	Provime Lirimi								
51	Provime Lirimi								
52	Provime Lirimi								
53	Provime Lirimi								
54	Provime Lirimi								
55	Provime Lirimi								

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Elemente të komunikimit joverbal dhe rëndësia e tyre gjatë të folurit.		Situata e të nxënësve: Lojë në role: Unë bëj gjestin, ti më thuaj kuptimin! Ngrihen dy nxënës në tabelë. Në një kuti, vendosen disa fisha me situata të ndryshme dhe kuptimin e tyre. Pasi nxënësi të marrë fishën nga kutia, do të interpretojë gjestin dhe nxënësi tjetër, duhet të gjejë kuptimin e këtij gjesti. Gjesti: Ecja me duart në xhepa, shpatulla të përkulura. Kuptimi: i mërzhitur, i brengosur Gjest: Dora në faqe Kuptimi: Duke menduar Gjest: Fërkimi i syrit Kuptimi: Dyshim, mosbesim	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: -Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. -Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. -Kompetenca personale.	Fjalët kyçe: Komunikim Komunikim verbal Komunikim joverbal Të folurit Gjeste Gjuha e trupit		
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Diskuton rreth komunikimit midis njerëzve. - Liston karakteristikat e komunikimit gjuhësor. - Liston karakteristikat e komunikimit jogjuhësor. - Analizon dallimet midis komunikimit gjuhësor (verbal) dhe jogjuhësor (joverbal). - Interpreton me anë të gjesteve, kuptime të emrave, a frazave të ndryshme. 			
Burimet: https://www.wikihow.it/Leggere-il-Linguaggio-del-Corpo (material në gjuhën italiane) http://faqemeparshmeefsash-spash.fsash.al/scream/07%20loja%20me%20role.pdf “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias” https://nonverbal.ucsc.edu/facerev.html (material në gjuhën angleze)		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Anglisht, Italisht,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pyetja sjell pyetjen, të nxënësve në bashkëpunim, pemë mendimi, ditari dypjesësh</i>			
Organizimi i orës së mësimi: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Pyetja sjell pyetjen</i> a) Çfarë është komunikimi? A mund të jepni një përkufizim për të? Një përkufizim i mundshëm, do të ishte: <div style="border: 2px solid black; border-radius: 15px; padding: 10px; margin: 10px auto; width: 80%; text-align: center;"> <p>Komunikimi është aftësia për të ndarë informacion me njerëz dhe për të kuptuar se çfarë informacioni dhe ndjenjash janë, duke u përcjellë nga ne, ose nga të tjerët. Komunikimi paraqitet në shumë forma dhe secila nga këto forma, është art më vete.</p> </div> Në vitet e kaluara, kemi diskutuar për skemën e komunikimit. b) A mund të thoni se si realizohet kjo skemë gjatë komunikimit? c) Për ç’lloj komunikimi po flasim në këtë rast? Për komunikimin gjuhësor (verbal), apo komunikimin jogjuhësor (joverbal)? ç) Çfarë kuptoni me komunikim verbal? Thoni një përkufizim të shkurtër.			

Komunikim verbal:


Shkëmbimi i informacionit ndërmjet individëve, duke përdorur fjalën.

d) Çfarë kuptoni me komunikim joverbal? Thoni një përkufizim të shkurtër.


Komunikimi joverbal, mund të quhet ndryshe edhe gjuha e trupit. Pra një mënyrë të komunikuarit me anë të gjeesteve, mimikës, lëvizjeve të trupit, kontaktit me sy, etj., pa përdorur fjalën.

dh) Komentoni shprehjen: “Një foto vlen më shumë se një mijë fjalë”.

A mund të thuhet e njëjta gjë për gjestet? Nëse po, pse?



Nxënësit diskutojnë duke dhënë mendime të ndryshme rreth komunikimit joverbal e në fund, ndërtojnë një pemë mendimi për komunikimin jogjuhësor (joverbal)..



Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënësit në bashkëpunim


Mësuesja ndan klasën në grupe dhe shpërndan fishat me çështjet për diskutim:

Grupi 1. Lidhni me shigjetë. Argumentoni zgjedhjen tuaj.

a) Pozicionet e trupit	<ul style="list-style-type: none"> • Tradicionalisht, nga shmangia e kontaktit me sy, është kuptuar mungesë vetëbesimi dhe shqetësimi. Megjithatë, mesazhet e lëvizjeve të syve, janë të diskutueshme dhe ndryshojnë nga kultura në kulturë.
b) Toni i zërit	<ul style="list-style-type: none"> • Lëvizjet e syve, vetullave, buzëve dhe faqeve ndihmojnë në përcaktimin e gjendjes emocionale (i lumtur, i trishtuar, nervoz, etj.).
c) Lëvizjet e syve	<ul style="list-style-type: none"> • Janë lëvizje të duarve a të kokës për t'i komunikuar dikujt diçka, megjithëse pa fjalë.
ç) Sjellja	<ul style="list-style-type: none"> • Shfaqen komunikimin jogjuhësor, por në vetvete, është komunikim jogjuhësor. Britma, buzëqeshja, ngërdheshja etj., i shtojnë një shtresë kuptimore komunikimit.
d) Shprehjet e fytyrës	<ul style="list-style-type: none"> • Emocionet mund të shprehën edhe përmes lëvizjeve të trupit. Për shembull, gjatë një bisede për publikun e gjerë, nga qëndrimi ulur deri në fund të karrigës, duke u përkulur pak përpara dhe duke tundur kokën gjatë bisedës, duhet të kuptojmë se personi është i hapur, i qetë dhe i gatshëm për të dëgjuar, por, nëse personi ka kryqëzuar duart dhe këmbët, duhet të kuptojmë, që ai po ndihet i shkëputur nga diskutimi...
dh) Gjestet	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra si vepron njeriu në shoqëri, në shkollë etj., se si i mban marrëdhëniet me të tjerët, ose se si reagon ndaj detyrave të caktuara në rrethana të veçanta.

Grupi 2. Komentoni figurat:

Mësuesja vendos në dërrasë fotot e mëposhtme dhe nxënësit e grupit të dytë i komentojnë.



Grupi 3: Ditari dypjesësh

Komentoni

Thënia	Komenti im
<p>Sytë gjatë komunikimit shprehin 80% të mesazhit. <u>Dane Archer i Universitetit të Kalifornisë</u> e quan fytyrën “organi i emocionit”. Ajo është si një telajo dinamike, - thotë ai, - ku emocionet vizatohen gjallërisht, pastaj papritur fshihen, vetëm për t’u rivizatuar në një shprehje të re një çast më vonë.</p> <p>Sipas Archer, fytyra është ndoshta “kanali” më i fuqishëm i komunikimit joverbal.</p> <p>“Ne kodojmë mesazhe në shprehjet e fytyrave tona dhe në të njëjtën kohë çkodojmë fytyrat e njerëzve rreth nesh”.</p>	

Grupi 4 Flisni për dallimet e komunikimit joverbal në kultura të ndryshme.

Material për mësuesin

Komunikimi joverbal i gjesteve, ndryshon nga një vend në tjetrin.

- Shenja OK (fig. a) do të thotë miratim, gjithçka në rregull në kulturën e Amerikës së Veriut? Për francezët, gjesti OK do të thotë “zero” ose “e pavlefshme”, ndërsa në Japoni, nënkupton para.
- Amerikanët shpesh prekin tëmthat për të shprehur zgjuarsinë e dikujt, por ky veprim në Kinë, është me kontekst negativ. Tregon që dikush ka probleme me trurin, ose nuk është shumë i zgjuar.
- Kinezët shpesh habiten kur shohin amerikanët që bëjnë një lëvizje të ngadaltë pranë qafës, për të treguar që janë ngopur, por në Kinë, kjo shenjë shihet si një akt paralajmërues vetëvrasës.
- Në Perëndim, njerëzit përqafohen, ose puthin njëri-tjetrin në publik, një mashkull dhe një femër, por kjo gjë në Kinë ndodh vetëm mes të dashuruarve.
- Një gjest tjetër gjithashtu i njohur, është edhe ai i ngritjes së gishtit të madh të dorës në SHBA, Australi dhe në Britani, gjest i cili ka 3 kuptime: përdoret si shenjë për autostop, si shenjë për ok., gjithçka në rregull dhe gjithashtu përdoret si sharje.
- Gjithashtu, në Itali, përdorin gishtin e madh si numrin një dhe gishtin tregues si dyshin, ndërsa në SHBA dhe Britani përdorin gishtin tregues për njëshin dhe të mesmin për dyshin.
- Shenja me dy gishtat (fig. c), në Britaninë e Madhe dhe në Australi është sharje, ndërsa në Lindje, do të thotë fitore.

Burimi <http://albanian.cri.cn/821/2014/10/22/302s136017.htm>

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Udhëzohen nxënësit, që gjatë kësaj veprimtarie, do të mësojnë nëpërmjet argëtimit.

- **Pantomima**

Kjo lojë është tepër argëtuese për t'u luajtur, sepse në të mund të përfshihen të gjithë. Klasa ndahet në dy grupe. Pjesëtarët e grupeve, interpretojnë me radhë, nëpërmjet shenjave, diçka (fenomen, këngë, objekt etj.), për ta gjetur më pas grupi tjetër. Grupet më pas, ndërrojnë rolet.

- **Sharada (gjëgjëza)** është një lojë e njohur në vende të ndryshme. Ashtu si dhe për lojëra të tjera, rregullat ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Ndahet klasa në skuadra me nga katër nxënës. Detyra e secilës skuadër, është të shkruajë në një copë letër emrin e një kënge, të një libri, filmi, ose të një drame apo komedie, të palosë letrën dhe të shkruajë mbi të numrin e skuadrës. Një pjesëtar nga secila skuadër, me radhë, caktohet të tërheqë një letër. Nëse ky person tërheq letrën e skuadrës së tij, duhet ta rivendosë në vend dhe të tërheqë një tjetër. Nxënësi që tërhoqi letrën, duhet të jetë në gjendje të shprehë me mimikë, emrin që është shkruar në letër. Skuadrat e tjera, duhet të gjejnë nëpërmjet interpretimit të shokut, çfarë është shkruar në letër.

Secila skuadër ka në dispozicion 3 minuta për të interpretuar në bazë të përmbajtjes së emrit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin midis komunikimit gjuhësor dhe jogjuhësor, për komunikimin dhe interpretimin e gjuhës së trupit, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur. *Ushtrimi 3:* Zgjidhni një personazh publik dhe vëreni komunikimin e tij joverbal. Përshkruajeni atë sipas skedës së dhënë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde		Situata e të nxënët: <p>“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë të mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzoni me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim, jo vetëm me paanësi, por dhe të sillemi ashtu. Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthimet e shtypit. Ashtu qoftë!”</p> <p>Faik Konica</p> <p>“Gjuha shqipe është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar”.</p> <p>Holger Pedersen</p> <p>Diskutojmë së bashku</p>	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 	Fjalët kyçe: Gjuha standarde, Gjuha letrare, Dialekte.		
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Diskuton rreth historikut të gjuhës standarde - Analizon rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde 			
Burimet: Teksti i nxënësit Emil Lafe “Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare” Mahir Domi, “Konferenca e ortografisë”. – “Nëndori”, Tiranë, 1954, nr. 1, http://www.radiokosovaelire.com/emil-lafe-percarja-e-gjuhes-po-vjen-prej-nje-grupi-njerezish-nga-kosova		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Gjeografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lëviz / ndalo / krijo dyshe, Diskutim, Puno në dyshe</i>			

Organizimi i orës së mësimt

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Lëviz / ndalo / krijo dyshe*

Nxënësit do të përdorin këtë teknikë në fazën e parë të procesit mësimor. Ata do të dëgjojnë mendimet e njëri-tjetrit rreth gjuhës standarde, duke veçuar momentet më të kryesore të rrugës drejt standardizimit. Më pas, mendimet e tyre do të shkruhen në tabelë.

Mësuesi shpjegon informacionin më poshtë:

Themelet e gjuhës standarde u hodhën në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Në këtë kontekst, ngjarja më e rëndësishme ishte Kongresi i Manastirit (nëntor 1908), në të cilën u njëhua alfabeti i gjuhës shqipe.

Kongresi i Manastirit i finalizoi këto përpjekje duke krijuar një alfabet, i cili është alfabeti që përdorim edhe sot. Krijimi i këtij alfabeti, do të ndiqet kronologjikisht nga disa ngjarje të rëndësishme, vendimtare për procesin e konsolidimit të standardizimit të shqipes, siç janë: Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-17), Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) dhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972).


Në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, nisi një punë e organizuar dhe sistematike për standardizimin e gjuhës shqipe. Kështu, në vitet 1948-1950, 1953-1954, 1956, u hartuan njëri pas tjetrit, disa udhëzues drejtshkrimorë që e ngritën gjithnjë e më lart kulturën gjuhësore.

Pas një pune të vijueshme shumëvjeçare, u mbledh më 24 nëntor 1972 Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Pas viteve '90, u organizuan dy konferenca ndërkombëtare ("Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot" dhe "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot"), në të cilat u diskutuan disa nga problematikat drejtshkrimore të ditëve të sotme.

Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim

Emërtimi *gjuhë letrare* sot, po përdoret gjithnjë e më rrallë. Në vend të tij, po përdoret termi gjuhë standarde, e cila është modeli i përdorimit të një gjuhe. Ajo mishëron zbatimin e përpiktë të tërësisë së normave e rregullave fonetike, leksikore, gramatikore të gjuhës shqipe, që janë të detyrueshme për çdo folës të saj.

Ku përdoret gjuha standarde?



Nxënësit i ilustronë me shembuj mendimet e tyre

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë në dyshe*

Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi 1 Gjени kuptimin e fjalëve *bankina*, *karrexhata*, *korsi* në shqipen standarde.

Bankina - pjesë e rrugës e përfshirë ndërmjet kufirit të karrexhatës dhe elementit gjatësor më të afërm, trotuarit, trafikndarësit, argjinaturës, buzës së brendshme të kanalit, ose buzës së sipërme të skarpatës;

Karrexhata - pjesë e rrugës e projektuar për lëvizjen e mjeteve;

korsi - pjesë gjatësore e rrugës e kufizuar në mënyrë të përshtatshme për lejimin e kalimit të një rreshti të vetëm mjeteve;

Ushtrimi 2 Në një portal, lajmi vjen kështu:

“Punonjësit naftëtarë të Ballshit shpërthejnë dyert e Uzinës dhe kërkojnë të drejtat e tyre. Naftëtarët kanë thënë se uzina është e tyre dhe nuk ka vend këtu administratori i ri.

Ky është momenti kur naftëtarët janë konfrontuar fizikisht me administratorin e kompanisë Bylis Energy, të cilin e kanë marrë në mbrojtje forcat e sigurisë. Pas largimit të administratorit, naftëtarët kanë marshuar drejt repartëve duke u kërkuar 150 kolegeve që kanë nisur punë, që të bashkohen protestes së tyre të drejte që kërkon 1-Fillimin e punës me kontrata të rregullta, 2-Marrjen e 15 pagave të prapambetura dhe sigurimet shoqërore, 3- Zbatimin e statusit të naftëtarit

Burimi: <https://www.facebook.com/neoalb1/>

Kthejeni tekstin në shqipen standarde?

Punonjësit naftëtarë të Ballshit, shpërthejnë dyert e Uzinës dhe kërkojnë të drejtat e tyre. Naftëtarët kanë thënë se uzina është e tyre dhe nuk ka vend këtu administratori i ri.

Ky është momenti kur naftëtarët janë përballur fizikisht me administratorin e kompanisë “Bylis Energy”, të cilin e kanë marrë në mbrojtje forcat e sigurisë. Pas largimit të administratorit, naftëtarët kanë marshuar drejt repartëve duke u kërkuar 150 kolegëve që kanë nisur punë, që t’u bashkohen protestës së tyre të drejtë, e cila kërkon:

1. Fillimin e punës me kontrata të rregullta,
2. Marrjen e 15 pagave të prapambetura dhe sigurimet shoqërore,
3. Zbatimin e statusit të naftëtarit

Ushtrimi 3 Komentoni shprehjen:

Thënia	Komenti im
Në të vërtetë, ngulitja e normave të të shkruarit drejt është një proces që përbëhet nga disa hallka, ku zotërimi i rregullave përbën hallkën fillestare. Hallka të tjera që duhet të pasojnë, janë formimi i shkathësive dhe i shprehive të të shkruarit pa gabime. Vetëm kur njohuritë për normën gjuhësore kthehen në shprehje, mund të thuhet se kemi arritur të shkruajmë dhe të flasim si duhet. (R. Memushaj, Shqipja standarde, 50)	

4. Në intervistën e gjuhëtarit Et’hem Lika, ngrihen disa probleme, të cilat janë me të vërtetë shqetësuese për të ruajtur të paprekur shqipen standarde:

1) Problem janë fjalët e huaja, që kanë hyrë prej shekujsh në leksikun e shqipes dhe janë bërë tashmë një trup me fjalët shqipe, por më problem janë fjalët e huaja të cilat e kanë gjegjësen shqipe, por që shumica e njerëzve, as që marrin mundimin t’i zëvendësojnë ato gjatë bisedave, apo dhe në të shkruar.

2) Mendimi se shqipja standarde nuk është e detyrueshme, na çon në përfundimin, që në shkollat tona, duhet të bëhet një punë e madhe për zbatimin e detyrueshëm të shqipes standarde të folur e të shkruar. Mësuesit, politikanët, punonjësit e administratës shtetërore, gazetarët nuk duhet të flasin e të shkruajnë në dialekt!

3) Gjuha standarde, mësohet vetëm në shkollën 9-vjeçare deri para dy vitesh e këtu e mbyllte ciklin. Tashmë në AMU (Arsimi i Mesëm i Lartë), është futur si lëndë më vete dhe jo e integruar me lëndën e Letërsisë. Lënda “Gjuha shqipe”

Do të ishte shumë mirë, që cikli për të mësuar gjuhën standarde, të shtrihej dhe në Arsimin e Lartë, pavarësisht degës që studiohet (inxhinieri, mjekësi, farmaci, ekonomik, fizioterapi, arkitekturë, etj.).

Vlen të përmendet, që në testimet që zhvillohen për kualifikimin e mësuesve 5/10/20 vjeçar dhe testimet për liçensim të Profesioneve të Rregulluara, janë vendosur pyetje nga “Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe”.

Informacion shtesë për mësuesin:

Në tetor 1980 Komisioni i Përhershëm për Pasurimin dhe Pastrimin e Mëtejshëm të Gjuhës Letrare Shqipe (1979-1990), ngrii grupin e punës për zëvendësimin e fjalëve të huaja dhe miratoi detyrat e tij.

Grupi skedoi propozimet e bëra për zëvendësimin e fjalëve të huaja, që nga Komisioni i gjuhësisë i Institutit Shqiptar për Studime e Arte (1944) e në vijim, i krahasoi me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe i përpunoi në formë artikujsh, që nisën të botohen në revistën “Gjuha jonë” nga numri 2/1981 në rubrikën e posaçme e “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”.

Me lëndën e kësaj rubrike, më 1998 u botua vëllimi “Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor”, që përmban rreth 620 artikuj zëra (çerdhe fjalësh), ku janë trajtuar mbi 1440 fjalë.

Komisioni u vuri detyrë shkollës dhe institucioneve botuese, që të përkrahin dhe të përhapin përdorimin e fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja.

4) Mbledhja e fjalëve dhe shprehjeve popullore.

Për t'i shërbyer detyrës së pasurimit dhe pastërtisë së gjuhës, si dhe dokumentimit të leksikut popullor në tërësi, filloi më 1981, aksioni kombëtar për mbledhjen e fjalëve dhe shprehjeve popullore. Aksioni u përgatit dhe u ndoq në vijimësi nga Ministria e Arsimit dhe Instituti i Gjuhësisë, i cili hartoi një udhëzues të posaçëm metodiko-shkencor dhe mbajti lidhje me seksionet e arsimit dhe me kabinetet pedagogjike në të gjitha rrethet.

Nëpërmjet këtij aksioni në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë u grumbullua një lëndë shumë e pasur: "Fjalë e kuptime të panjohura më parë dhe shprehje frazeologjike". Në revistat "Gjuha jonë" dhe "Studime filologjike", nisi të botohet rregullisht rubrika "Fjalë dhe shprehje popullore". Aksioni shërbeu edhe si një nxitje e re për të gjallëruar traditën e mëparshme në këtë fushë. Një varg fjalorësh të botuar kohët e fundit, me fjalë e shprehje nga krahinat kanë marrë shkas edhe nga ky aksion.

5) Shqipërimi, njësimi dhe përpunimi i mëtejshëm i terminologjisë tekniko-shkencore.

Kësaj fushe, Komisioni i ka kushtuar vëmendje të veçantë vijimisht. Në periudhën e pasluftës në Shqipëri arsimit i mesëm u bë masiv, u ngrit arsimit i lartë, u organizua kërkimi shkencor dhe vendi hyri në rrugën e industrializimit. Në këto rrethana, mund të thuhet që terminologjia, u bë fusha kryesore e pasurimit të fjalorit të shqipes me fjalë e kuptime të reja. Në përpunimin dhe shqipërimin e terminologjisë, krahas terminologëve, bashkëpunuan gjuhëtarët më në zë.

Më 1984, Komisioni mori në shqyrtim studimin për shqipërimin, njësimin dhe pasurimin e terminologjisë ushtarake. Me një organizim të mirë dhe punë këmbëngulëse, në këtë fushë, u shënuan arritje të mira, duke u botuar një seri fjalorësh për armë e shërbime të veçanta, si dhe fjalorë të përgjithshëm termash ushtarakë.

6) Gjuha në shtyp dhe në radiotelevizion.

Shtypi dhe radiotelevizioni, kanë ndikim të madh për ngritjen e kulturës gjuhësore dhe përhapjen e normës letrare. Në vitin 1982, Komisioni mori në shqyrtim studimin "Mbi gjendjen dhe punën për përmirësimin e mëtejshëm të gjuhës në shtyp dhe radiotelevizion", të përgatitur nga një grup pune. Për shtypin e shkruar, studimi vinte në dukje të metat kryesore në zbatimin e drejtshkrimit dhe të normës gramatikore, përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme, përdorimin e gabuar të disa fjalëve, të meta të ndryshme stilistike e në ndërtimin e fjalive. Për radiotelevizionin, në studim vërehej, se folësit jo rrallë nuk i përmbahen tekstit të shkruar, por pasqyrojnë veçori dialektore, ose shqiptime joletrare. Organet e shtypit dhe radiotelevizionit, u porositën të merrnin masat përkatëse për mënjanimin e të metave.

Gjuha e shtypit dhe e radiotelevizionit, u mor në shqyrtim përsëri nga Komisioni më 1988.

7) Gjuha e shkruar dhe e folur në arsimin e lartë.

Më 1986, Komisioni mori në shqyrtim studimin "Ligjërimi i shkruar dhe i folur në veprimtarinë e Universitetit të Tiranës". Në këtë studim, paraqitej gjendja e zbatimit të normës letrare dhe e kulturës gjuhësore në përgjithësi në testet dhe botimet e Universitetit, më tej, gjendja e përpunimit dhe e shqipërimit të terminologjisë në lëndët mësimore, gjendja e ligjëritimit të folur në procesin e mësimdhënies.

8) Gjuha e teksteve shkollore.

Më 1987, Komisioni mori në shqyrtim një studim për gjuhën e teksteve të shkollës 8-vjeçare (klasat I-IV). Për këtë studim ishin shqyrtuar mbi 2000 faqe tekste. Shkolla 8-vjeçare, dhe veçanërisht arsimit fillor, luajnë një rol të rëndësishëm për t'i aftësuar nxënësit që të fitojnë shprehitë e zbatimit të normës letrare. Gjuha e teksteve përbën modelin gjuhësor që ndikon drejtpërdrejt në formimin gjuhësor të tyre. Në studim, vërehet se në përgjithësi tekstet e vëzhguara janë një shembull i mirë për thjeshtësinë dhe për pastërtinë e gjuhës, është punuar me pikësnyime të caktuara për të mënjauar fjalët e huaja të panevojshme dhe për të përhapur fjalën shqipe.

9) Gjuha e skenës dhe e ekranit.

Nisur nga ndikimi i gjuhës së folur në veprimtaritë artistike për kulturën gjuhësore në përgjithësi, Komisioni në dhjetor 1982, mori në shqyrtim studimin "Për gjendjen e gjuhës në skenë dhe në ekran" dhe shtroi detyra për përmirësimin e mëtejshëm të saj.

10) Gjuha e administratës shtetërore.

Komisioni mori në shqyrtim që në vitin 1982 zbatimin e normës letrare në veprimtarinë e administratës shtetërore, sidomos në pushtetin vendor dhe në institucione e ndërmarrje ekonomike. U caktuan detyra për kualifikimin gjuhësor të sekretareve, daktilografisteve, arkivisteve nëpërmjet kurseve.

11) Kualifikimi shkencor i redaktorëve dhe korrektorëve letrarë.

Me porosi të Komisionit pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, u organizua më 1982, një kurs për kualifikimin e redaktorëve e të korrektorëve letrarë, sipas një programi të posaçëm të drejtuar nga mësues të gjuhës.

Burimi: Emil Lafe, Gjuha Shqipe, Pasurimi i gjuhës shqipe.

Mahir Domi, "Konferenca e ortografisë" – Nëndori, Tiranë, 1954, nr. 1, f. 142-144.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për punën hulumtuuese, për kthimin e teksteve në shqipen standarde, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni në median vizive, 5 gabime të shqipes standarde.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Ciklopi (ora e parë)		Situata e të nxënët: Kali i Trojës	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca qytetare; 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Tregon simbolikën e kalit të Trojës - Zbulon tiparet e veprës së Euripidit - U përgjigjet pyetjeve për kuptimin e përmbajtjes së pjesës 		Fjalët kyçe: Odise Ciklop Askush Shpellë Helli Syri Profeci Satirë	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: “Euripidi në prozë” - Janis Benekos		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Mitologji, Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi; kllaster; marrëdhënia pyetje-përgjigje</i>			
Organizimi i orës së mësim: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit rikujtojnë simbolikën e kalit të Trojës, duke nxjerrë në pah zgjuarsinë dhe dinakërinë e Odisesë. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>kllaster</i> Drejtohen nxënësit në tekst për t`u njohur me informacionet e dhëna rreth fragmentit dhe autorit.			
<p><i>Krijoi karaktere, ngjarje dhe situata nga më të çuditshmet</i></p> <p><i>Tematikën e merr nga mitet duke i bërë legjendat më konkrete</i></p>			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>marrëdhënia pyetje-përgjigje</i> Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.			
-Me cilin emër i prezantohet Odiseja Ciklopit? <i>Askushi</i> -Odiseja i jep Ciklopit për të pirë verë. Si do t`ia kthejë ai këtë nder? <i>“Nderi” që do t`i bëjë Ciklopi, është që ta hajë të fundit Odisenë.</i> -Po Odiseja, çfarë plani ka? <i>Plani i Odisesë është verbimi i Ciklopit.</i> -Duke qenë se ciklopi është gjigant, përballja me të është betejë e humbur. Çfarë rruge zgjedh Odiseja për të shpëtuar prej tij? <i>Odiseja zgjedh ta mundë Ciklopin me anë të zgjuarsisë e dinakërisë dhe jo duke u përballur me të fizikisht. Pasi e deh dhe e vë në gjumë, ai vë në zbatim planin e tij duke e verbuar.</i> -Si e quan Ciklopi Odisenë në fund? <i>O i mjerë.</i> -Po Odiseja Ciklopin? <i>Bishë (që më hëngre shokët)</i> -Cilat janë dy parashikimet që përmenden në tekst.			
a) <i>“Një profeci e vjetër, më kishte thënë se do të më verboje ti, kur të ktheheshe nga Troja”.</i> b) <i>“Por edhe për ty, o i mjerë, më tha se shumë do të heqësh nëpër dete, para se të mbërrish në ishullin tënd”.</i> -Cili prej tyre u realizua? <i>Verbimi i Ciklopit nga Odiseja pas kthimit të këtij të fundit nga Troja.</i> - Cili realizohet në të ardhmen? <i>Vuajtjet e Odisesë gjatë kthimit në shtëpi (endja nëpër det 10 vjet).</i>			
Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.			
Detyra: <u>Ushtrimi 10</u> Duke u nisur nga historia e Odisesë me Ciklopin, reflektoni mbi raportin e forcës fizike me forcën mendore. Më mirë i fortë, apo i zgjuar?			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Ciklopi (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Fragment nga filmi “Odiseu” https://youtu.be/mpxPVYOVqOI	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale 			
<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Zbulon tiparet e karakterit të Odisesë bazuar në informacionin e mëparshëm dhe kryesisht në pjesën e dhënë. - Shpjegon përdorimin e pasthirmave, fjalëve përqeshëse, si dhe përdorimin e shprehjeve të figurshme. - Portretizon personazhet kryesore të pjesës. 		Fjalët kyçe: Odise; Ciklop; Askush; shpellë; helli; syri; profeci; satirë.	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: “Euripidi në prozë” - Janis Benekos		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Historia; Deklaratë e të drejtave të njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim; punë e pavarur; punë dyshe; punë individuale</i>			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi i parë: Shohim fragment nga filmi “Odiseu”			
Hapi i dytë: Punohen ushtrimet 2 - 3			
2. Duke u nisur nga personazhet dhe ndodhitë e tekstit, në çfarë kohe mendoni se zhvillohen ngjarjet? (<u>diskutim</u>) <i>Ngjarjet zhvillohen në antikitet, kohë në të cilën njerëzit besonin se fati i tyre ishte në dorë të hyjnive. Figura (mitologjike) e Ciklopit, e vërteton këtë kohë.</i>			
3. Odiseja njihet si personazh dinak dhe shumë i zgjuar. Pse ai nuk ia tregon emrin e vërtetë Ciklopit? (<u>diskutim</u>) <i>Odiseja ka frikë se Ciklopi, e di profecinë që dikush me emrin Odise do ta verbojë.</i>			
Hapi i tretë: Ushtrimi 4 (<u>diskutim</u>) Odiseja nuk pranon t’u nënshtrohet rrethanave. Ai vendos të luftojë kundër Ciklopit. Satirët kanë pranuar robërinë dhe i shërbejnë Ciklopit. Ata i thonë Odisesë: “nuk kemi oreks të hyjmë brenda e të na i bëjë turinjtë përshesh Ciklopi”. Ç’anë të karakterit tregojnë ata nëpërmjet këtyre fjalëve? Fjalët e satirëve tregojnë se ata janë frikacakë, dredharakë e të pabesë. *Pse autori i vendos satirët përballë Odisesë? <i>Satirët tregojnë një karakter të dobët e për pasojë, vënia e tyre përballë Odisesë, vë në pah tipare të karakterit të tij, si guximi dhe zgjuarsia.</i>			
Hapi i katërt: Ushtrimi 5 Pse Ciklopi i quan “hiç njerëz” Odisenë dhe shokët e tij? (<u>diskutim</u>) <i>Ciklopi i quante të tillë, sepse i konsideronte thjesht ushqim.</i>			
Hapi i pestë: (Punohen ushtrimet 6 - 9)			
6 - (<u>punë dyshe</u>) Dalloni fjalët përqeshëse që i drejton Ciklopi Askushit. - <i>A, emër i bukur! / Do të të ha të fundit! Si mendoni, cilat janë arsytet që ai flet në këtë mënyrë? “emër i bukur” nënkupton që s’je askush, siç ke dhe emrin. “do të të ha të fundit” janë fjalë tallëse dhe mjaft ironike duke i konsideruar si nder, ndërkohë që shtohet ankthi për fundin e sigurt.</i>			
9 - (<u>punë dyshe</u>)			
Dialogu me fjali të shkurtra rrit tensionin e ngjarjes. Çfarë shton përdorimi i shpeshtë i pasthirmave? <i>Pasthirrat shprehin vullte të papritura shpirtërore, në formën e entuziazmit, ngazëllimit, dëshpërimit, revoltës dhe në këtë rast, ato nxjerrin në pah gjendjen emocionale të personazheve: satirët ndiejnë frikë dhe ankthi, vetëbesimi Odiseja ndihet i sigurt në vetvete.</i>			
Nënvizojini ato në tekst. <i>o, a, oh, oh, shëëët, ah, oh, etj.</i>			

Hapi i gjashtë: Ushtrimi 7 Odiseja është ndeshur dhe ka fituar luftëra. Në këtë përballje, ai nuk përdor armët, por mendjen. Megjithatë ai u lutet perëndive: “Hefest, hyjni i Etnës! Na ndihmo të shpëtojmë nga kjo egërsirë para se të na gllabërojë të gjithëve”. Pse? (diskutim)

Në lashtësi mendohej se fati i njerëzve ishte në dorë të hyjnive dhe pikërisht Hefesti, ishte hyjnia i zjarrit, me të cilin Odiseja do të nxehte majën e bellit për të verbuar Ciklopin. Sado të zgjuar e të fortë të ishin njerëzit, ata e dinin se kishin gjithmonë nevojë për ndihmë e mbrojtje nga ana e hyjnive.

Hapi i shtatë: Ushtrimi 8 Shpjegoni kuptimin e secilës prej këtyre shprehjeve: (punë individuale)

Qielli po më vjen rrotull: *më merren mendtë*

....gëk nuk bëjnë: *nuk pipëtojnë*

...shumë do të heqësh...: *do të vuash shumë*

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Lidhni me shigjetë veçoritë dalluese në portretizimin e dy personazheve. Bëni me shkrim, analizën e portretit fizik dhe të karakterit të secilit prej tyre.


Odiseja: *dinak, njeri i zakonshëm, i guximshëm, i panënshtuar.*

Ciklopi: *gjigant, i pamëshirshëm, i mbifuqishëm, i egër*

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Tema mësimore: Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim		Situata e të nxënësve: Të lirohet jo të pushkatohet! <i>Kjo fjali mund të sjellë dykuptimshmëri në rast se do të vendoset presja gabim.</i> Të lirohet, jo të pushkatohet! Të lirohet jo, të pushkatohet! Diskutojmë së bashku.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës, sipas temës mësimore: - Dallon shenjat e pikësimit që përdoren brenda fjalisë. - Dallon shenjat e pikësimit që përdoren në fund të fjalisë. - Ndërton një tekst duke përdorur shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë. 		Fjalët kyçe: Shenja pikësimit Brenda fjalisë Në fund të fjalisë Pikë Presja Dypikëshi Pikëçuditja Pikëpyetja, etj.	
Burimet: Teksti i nxënësve, Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare:	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi, INSERT, Shkrim i lirë**Organizimi i orës së mësimi:** Stuhi mendimi*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:**Çfarë shenjash pikësimi njihni ju ?**Organizo mendimet!*

Diskutohet së bashku me nxënësit funksioni i shenjave të pikësimi.

Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT

Udhëzohen nxënësit të plotësojnë në fletoren e klasës, tabelën INSERT.

<i>V (informacioni që dihet)</i>	<i>+ (informacioni që shtohet)</i>	<i>___ (informacioni që dihet gabim)</i>	<i>(informacioni që ka nevojë për sqarim nga mësuesi)</i>

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno në dyshe

Nxënësit të ndarë në dyshe, do të punojnë ushtrimet e dhëna në tekst.

Ushtrimi 1 Vendosni thonjëzat në fjalitë e mëposhtme.

Agimi tha: “Kjo ngjarje nuk do të përsëritet më në të ardhmen”.

Ndeshja më interesante e këtij sezoni, do të zhvillohet në stadiumin “Qemal Stafu”.

Gazeta “Ekonomia”, nuk është për publikun e gjerë, por për një publik të specializuar.

Ne jemi nxënës të klasës së nëntë, në shkollën “Fan Noli”.

Ushtrimi 2 Vendosni dy pikat atje ku duhen.

Skënderbeu u përgjigj: “Lëreni të shkojë...”.

Unë vazhdoj t'i qëndroj mendimit: “Për të pasur një implementim të suksesshëm, ne duhet të kemi edhe një ofertë ekonomike intriguese”.

Ai tha: “Ky libër më pëlqen shumë”.

Kjo substancë gjendet në shumë produkte ushqimore, si: qumësht, mish, misër, arra, etj.

Fshatari pyeti: “Kur niset treni?”

Ushtrimi 3 Vendosni shenjat e pikësimi në dialogun e mëposhtëm.

-Ç' duan që vijnë në dasmat tona? - pyeti njëri nga djemtë e rinj

- Shët, se është turp!

- Çfarë turpi? - pyeti një tjetër. Guxojnë edhe të ngrihen në valle!

- Nuk mund t'i dëbonim. Kështu është zakoni i të parëve

- Ç'zakon?! Po për Nicën e shkretë, ç' thotë zakoni i të parëve?

- Shët, se mos dëgjojnë...

- Mos ki frikë, - u hodh një tjetër. Edhe sikur të dinin shqip, nuk do të kuptonin asgjë nga brenga e saj.

Ushtrimi 4 Vendosni në tabelën e mëposhtme shenjat e pikësimi që përdoret në ushtrimin 2.

Shenja pikësimi që përdoren brenda fjalisë	Shenja pikësimi që përdoren në fund të fjalisë
Dy pikat,	Pika,
Thonjëzat	Pikëpyetja, Pikëçuditja
	Trepikëshi

Ushtrimi 6 Gjenerali ku janë përdorur gabim shenjat e pikësimit. Shkruajini si duhet ato.

Harabeli nuk është shpend migrues.

Studentët kanë një skuadër me emrin e vet, Studenti.

Skënderbeu tha: “Mos i besoni armikut! Besoni vetëm te shpata dhe mendja juaj!”

Gazeta “Flamuri i Arbrit” është botuar nga De Rada.

Ushtrimi 7 Shkrim i shpejtë

Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të përdorni shenjat e pikësimit që përdoren brenda fjalisë, si dhe shenjat e pikësimit që përdoren në fund të saj.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin e shenjave të pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë, etj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalë e grosh		Situata e të nxënit: Fjala e urtë: “E mirë fuqia, por ca më mirë urtia”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: grosh; fjalë; plak; djalë; këshillë	
<ul style="list-style-type: none"> - Dallon përrallën si lloj i tekstit letrar. - Nxjerr në pah karakteristikat e përrallës nëpërmjet detajeve dhe fragmenteve në tekst. - Analizon personazhet nëpërmjet fjalëve, veprimeve dhe mendimeve të tyre. 			
Burimet: Libri “Përralla shqiptare” Libri i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Bisedë e lirë; lexim zinxhir; kllaster; diskutim; punë e pavarur; punë dyshe; shkrim i lirë</i>			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>bisedë e lirë</i>			
Nxënësve u shtrohen pyetjet: Cili është vendimi më i rëndësishëm që keni marrë deri tani? Si u siguroat që ishte i duhuri?			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>kllaster; lexim zinxhir</i>			
Paraprakisht, nëpërmjet kllasterit, nxënësve u kërkohet të zbulojnë karakteristikat e përrallës.			

- Lexohet përralla për t'u njohur me përmbajtjen dhe shpjegohen fjalët e panjohura. (lexim zinxhir)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi 1 Lexoni përrallën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. (punë e drejtuar)

Cilët njerëz lë në shtëpi djali, kur vendos të largohet? *Nënë dhe gruan.*

Çfarë synon të arrijë me largimin e tij? *Synimi i saj ishte të fitonte të ardhura.*

Sa vjet punoi djali te zotnia? *3 vjet.*

Sa grosh është pagesa që mori për punën e bërë? *3 grosh.*

Djali i shpenzon këto monedha për këshillat e një plakut të urtë. Çfarë përfiton djali nga këshillat e plakut?

Urtësi dhe pasuri.

Kë ndihmon tjetër nëpërmjet tyre? *Banorët e katundit që u kish shterur uji i pusit, si dhe familjen e tij.*

Ushtrimi 2 Plotësoni tabelën. (punë individuale)

Tri momentet kur djali vë në jetë tri këshillat:	<i>Takimi me dy gratë në fund të pusit (Robin e Zotit kurrë mos e shaj).</i>	<i>Mbërritja pranë lumit të turbulluar (Ujit turbull mos i bje).</i>	<i>Përballja me të birin që nuk e njihnte (Idhnimin e mramjes lene për në mjes).</i>
--	--	--	--

Ushtrimi 3 Dalloni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e përrallës. Vendosini çdo pjesë nga një titull.

Argumentoni përgjigjen. (punë dyshe)

Hyrja: Paragrafi i parë (nga Njeni s'kishte... deri te... në botë)

Zhvillimi: nga Kërko, kërko... deri tek... A s'po më njeh?

Mbyllja: Paragrafi i fundit (nga Plaka u ra... deri te... një mijë të mira)

Ushtrimi 4 Dalloni në fragmentin e fundit (djali mbërrin në shtëpi) pjesët rrëfyese, dialoguese dhe ato medituese.

(punë dyshe)

Rrëfyese - *Aty gjen plakën, nanën e vet, gruen e një djalë të rritshëm si nja 18 vjeç... i vje ndërmend fjala e plakut.*

-*Të nesërmen grueja e tij kishte qenë çue herët e dalë në arë, ndërsa i biri ishte ende në të shtruemë. Qatje ma vonë po e thërret plaka.*

-*Mbasi e rehatova e gjithësesi, në vend që me më gëzue, më la mbas një muaji me nusen e u nis për kurbet. Vjetët e para na pat çue pare edhe mirë, por tash ka shumë vjet që s'dij gja për te a asht gjallë a vdekë. Nusen ma ka pasë lanë shtatzanë e i ka falë Zoti këtë djalë që tash asht rritë e burrnue e ende s'e ka pa babën e vet. Lene Zot se, kur e shoh, si me pa djalin tem...*

-*Plaka u ra syve si të ishte tue u çue prej gjumit, kaq e papritun i erdh ajo fjalë. Ia gjet një shej në qafë e, tue qa, e rroku me mall. Thirri mandej nusen e nipin e jetuan bashkarisht me një mijë të mira.*

Medituese - *Idhnimin e mramjes lene për në mjes.*

-*Të bahet çka të bahet, po pres deri nesër!*

Ushtrimi 5 Përmes shembujve nga teksti, shpjegoni disa karakteristika të përrallës. (punë në grup)

	Përshkrimi i ngjarjes	Karakterizimi psikologjik i personazheve	Shkrirja e elementeve reale me ato fantastike	Mesazhi edukativ
Shembull nga përralla	<i>*Kërko, kërko e kërko, u vendos rrogëtar te një zotni. Mbas tri vjetësh lypi me u nda e priti me marrë hakun. *Aty kishte pasë qenë një plak njëqind vjeç, që rrinte buzë votrës me krye ulët pa ba za... etj.</i>	<i>*Joo, ma mirë po marr tre grosh të hallallit. *Ky flet fjalë e grosh. *Djalit i bje ndër mend fjala e plakut</i>	<i>*Aty gjetën ujë sa deti, që rridhte me furi, e ndër dy anët sheh dy sende të ndritshme si dy gra; njena krejt e bardhë e tjetra krejt e zezë.</i>	<i>*Të vjetrit dëgjoji dhe respektoji (3 këshillat e mençura të plakut)</i>
Shpjegimi	<i>Njihemi me ngjarjen hap pas hapi</i>	<i>Dalin në pah cilësitë e personazheve: -Plaku i urtë -Djali i drejtë, i mençur, i matur</i>		

Ushtrimi 6 Shpjegojini me fjalët tuaja tri këshillat e plakut: (punë në grup)

Robin e zotit kurrë mos e shaj. - *Mos paragjyko njerëzit nga pamja e jashtme / Jemi të ndryshëm, por të barabartë*

Ujit turbullt mos i bje! - *Mos hyr në ujë të turbullt*

Idhnimin e mramjes, lene për në mjes e idhnimin e mjesit lene për në mramjes.

-*Mos u nxito / Mos vepro në zemërim e sipër*

<p>Ushtrimi 7 Përshkruani me një paragraf, përjetimet e personazhit kur sheh djaloshin e panjohur 18 vjeçar që del nga shtëpia e tij. (<u>shkrim i lirë</u>)</p> <p>Ushtrimi 8 Shpjegoni kuptimin e shprehjeve të figurshme. (<u>punë e pavarur</u>) Ndau mendjen... - <i>vendosi</i> Me dalë e me qarue... - <i>të dalë për të fituar</i> Tue i blue me mend... - <i>duke i menduar</i> Bahet me lujt menç... - <i>humbet logjikën</i> I kërcet gjaku... - <i>nevrikoset</i> I shkonte dhe i vinte ftyra... - <i>shqetësohet</i></p> <p>Ushtrimi 9 - Ktheni në gjuhën standarde këto fjalë dhe shprehje. (<u>punë e pavarur</u>) nanë - <i>nënë</i> tue qenë - <i>duke qenë</i> vehet në rrugë - <i>niset për rrugë</i> katund - <i>fshat</i> votrës - <i>vatrës</i> tue lëshue - <i>duke lëshuar</i> idhnim - <i>zemërim</i> avitet - <i>afrohet</i> njena - <i>njëra</i> kishte qenë çue - <i>ishte çuar</i></p> <p>Ushtrimi 10 dhe 11 punohen në formën e diskutimit me nxënësit.</p>
<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni dhe sillni në klasë përralla të tjera, të cilat i vlerësoni për mesazhet e rëndësishme që përcjellin.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim</p>		<p>Situata e të nxënit: Punë në dyshe</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon në dialog (replikë) ligjëratën e drejtë - dallon pjesën lajmuese dhe pjesën përmendëse në ligjëratën e drejtë - përdor drejt shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë, kur pjesa lajmuese ndodhet në fillim, në mes dhe në fund - krijon fjali me ligjëratë të drejtë - kthen dialogun në ligjëratë të drejtë dhe argumenton përdorimin e shenjave të pikësimit. 		<p>Fjalët kyçe: dialog ligjëratë e drejtë pjesa lajmuese pjesa përmendëse shenja pikësimit.</p>	
<p>Burimet: teksti i nxënësit, fisha me ushtrime, fletore, shkumës me ngjyra</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi</p>	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Punë në dyshe, Diskutim, Punë e pavarur, Punë në grupe, Shkrim i lirë

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *punë në dyshe*

Orientohen nxënësit të lexojnë në dyshe dialogun e paraqitur në tekst në faqen 196. Nxënësit do të nënvizojnë fjalët që thonë personazhet, do të dallojnë llojet e fjalive dhe do të qarkojnë shenjat e pikësimit. Dëgjohen mendimet e nxënësve, duke i paraqitur ato të përmbledhura në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *diskutim*

Dy nga fjalitë e dialogut rishkruhen në tabelë, por si ligjëratë të drejtë, duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit. (*sqarohen nxënësit që çdo replikë e dialogut është një ligjëratë e drejtë*)

Me sy të picërruar Ylli më tha: "Mirë e ke bërë. Gjithçka që të shikon syri këtu në plazh, ti e ke hedhur bukur në letër. Vetëm njerëz nuk paske fare te vizatimi yt! Pa njerëzit, deti dhe rëra duken të shkretë. Hë, keq e kam?! Ç' thua?"

"Për këtë, - iu përgjigja unë, - po e vrisja mendjen e s'po e gjeja dot"

Nxënësit diskutojnë në lidhje me fjalitë.

Jepet përkufizimi për ligjëratën e drejtë dhe dy pjesët e saj: pjesa lajmuese dhe pjesa përmendëse.

Shenjat e pikësimit që përdoren në të tria rastet, kur pjesa lajmuese ndodhet në: fillim, mes dhe në fund.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Do të punohen nga nxënësit ushtrimet e fq. 197

Ushtrimi 1 (*punë e pavarur*) Nxënësit do të nënvizojnë në tekst shenjat e pikësimit, do të shpjegojnë përdorimin e tyre dhe do të dallojnë pjesën lajmuese.

Kur ishin duke u shpërndarë, xha Trifoni tha: "Ne babagjyshërve na është bërë zakon, para se të flemë, t'u tregojmë nipërve ndonjë përrallë".

"Skënderbeu ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet", - tha kryeveqilharxhi

"Populli shqiptar, - deklaroi Ismail Qemali, - na zgjodhi dhe na dërgoi ne në këtë mbledhje, që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut".

"Miqtë e mi, - u përgjigj Isa Boletini, edhe ai më këmbë e me burrni, - unë nuk ndahem nga populli".

"Ishim të rrethuar, - tha ai. - Na duhej të çanim pa bërë zhurmë".

"Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë, - tha përgjegjësi, - rritet në vendet e larta malore".

Ushtrimi 2 (*punë në grupe*)

Klasa ndahet në tri grupe. Secili grup rishkruan nga dy fjali të ushtrimit 1, duke vendosur pjesën lajmuese në dy pozicione të tjera. Tre nxënës punojnë në tabelë.

"Ne babagjyshërve na është bërë zakon, para se të flemë, t'u tregojmë nipërve ndonjë përrallë", - tha xha Trifoni kur u shpërndamë.

"Ne, - tha xha Trifoni, kur u shpërndamë, - na është bërë zakon t'u tregojmë nipërve ndonjë përrallë".

Kryeveqilharxhi tha: "Skënderbeu ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet".

"Skënderbeu, - tha kryeveqilharxhi, - ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet".

Ismail Qemali deklaroi: "Populli shqiptar na zgjodhi dhe na dërgoi në këtë mbledhje që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut".

"Populli shqiptar, - deklaroi Ismail Qemali, - na zgjodhi dhe na dërgoi në këtë mbledhje, që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut".

Isa Boletini në këmbë dhe me burrni u përgjigj: "Miqtë e mi, unë nuk ndahem nga populli".

"Miqtë e mi, unë nuk ndahem nga populli", - u përgjigj në këmbë dhe me burrni Isa Boletini.

Ai tha: "Ishim të rrethuar. Na duhej të çanim pa bërë zhurmë".

"Ishim të rrethuar, - tha ai. Na duhej të çanim pa bërë zhurmë".

Ushtrimi 3 (*shkrim i lirë*)

Paraqiten në tabelë disa nga fjalitë e krijuara nga nxënësit.

Vlerësimi: do të bazohet në pjesëmarrjen e nxënësve gjatë orës, veprimet në situatë, saktësinë në dallimin e dialogut, ligjëratës së drejtë, shenjat e pikësimit në të dhe pjesët përbërëse, kthimin e dialogut në ligjëratë të drejtë dhe qortimin që u bëjnë gabimeve të shokëve. Komunikohen vlerësimet.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, fq. 197 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Dëgjojmë Tema mësimore: Krijimi i Universit		Situata e të nxënit: Shikohet dokumentari për krijimin e universit dhe diskutohet më pas https://www.youtube.com/watch?v=DHcq_luE49U	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumton rreth krijimit të universit. 2. Diskuton rreth kuptimit të pjesës “Krijimi i universit” pas dëgjimit kritik të saj. 3. Dallon elementet kryesore të mitit si formë elementare të të rrëfyerit. 4. Përshkruan mjedisin ku zhvillohen ngjarjet duke dalluar elementet reale nga joreale 5. Argumenton shpjegimin fantastik që i jep miti ngjarjes. 		Fjalët kyçe: Mit Formë elementare e të rrëfyerit Krijimi i universit Elemente reale Elemente joreale	
Burimet: Teksti i nxënësit https://www.youtube.com/Watch?v=DHcq_luE49U http://www.standard.al/2014/02/03/si-u-krijua-universi-teorite-dhe-procesi-i-plote/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mitologjia ndër shqiptarë - Mark Tirta		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi, Mitologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Imagjinatë e drejtuar, pemë mendimi, shkrim i lirë, punë në dyshe</i>			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Imagjinatë e drejtuar Çfarë është universi? A është bosh universi? A ka fund? A është i përjetshëm, apo koha ka fund? Doli nga diçka apo nga asgjëja?			
<p>Informacion shtesë për mësuesin: Modeli Standard i Sotshëm Sipas teorisë së Big Bang-ut, universi u krijua nga shpërthimi i një pike të nxehët, të kondensuar pafundësisht. Brenda një pjese të shkurtër të një sekonde, universi filloi të zgjerohej (teoria e inflacionit). Pas kalimit të miliarda viteve, galaksitë, yjet dhe planetet, u krijuan për shkak të ftohjes së universit. Sot, 13,7 miliardë vjet pas shpërthimit të Big Bang, pranohet hipoteza, që universi akoma jo vetëm që po zgjerohet, por edhe po përshpejtohet nën ushtrimin dhe ndikimin e disa forcave tepër energjetike dhe misterioze. Nëse universi vazhdon të zgjerohet në këtë mënyrë, e ardhmja e universit duket e zezë. Yjet do të shpenzojnë energjinë e tyre, galaksitë do të shpërbëhen dhe universi do të mbetet i errët dhe pa jetë përgjithmonë. Kjo teori lë shumë pyetje dhe nuk shpjegon se si filloi Big Bang dhe se çfarë ekzistonte para shpërthimit të madh. Gjithashtu, teoria nuk shpjegon natyrën e fushës së energjisë misterioze që ndikon në rritjen e shpejtësisë së universit.</p>			

Hapi i Parë: Universi Bosh Imagjinoni dy shtresa dy-dimensionale. Shtresa e parë përmban universin tonë dhe shtresa e dytë, përmban një univers tjetër, (ose asgjë), por është i padukshëm dhe ne nuk e shohim dot, sepse është jashtë dimensioneve që mund të kuptojmë. Pas ca kohësh, trilion vite në zgjerim, i afrohem fundit ciklik kozmik ku përbërja e universit tonë është kaq e shpërndarë dhe e ulët, sa që hapësira është gati bosh. Megjithatë të dy shtresat janë akoma në lëvizje, edhe pse janë bosh, dhe forcat e tërheqjes midis tyre, i afrojnë bashkë.

Hapi i Dytë: Përplasja Energjitiqe

Gjatë afrimit të shtresave, forcat e tërheqjes i prishin sipërfaqet dhe përbërjen e të dy shtresave, duke krijuar valë derisa shtresat bashkohen në disa vende dhe në kohë të ndryshme. Prej kësaj përplasjeje të drejtpërdrejtë, çlirohet energji e madhe. Si prodhim i çlirimit të energjisë, krijohet një univers fillestar. Gjithashtu, forca e përplasjes, shkakton që të dy shtresat të shkëputen dhe të tërhiqen larg njëra-tjetrës.

Hapi i Tretë: Universi i Plotë

Shpërthimi i mësipërm dhe universi fillestar, zgjerohet dhe ftohet dhe krijohen valët e mikrovalëve, që sot janë të dukura në universin tonë. Kronologjia e ngjarjeve është e njëjtë me atë të Modelit Standard: krijohen galaksitë dhe objektet e tjera kozmike dhe universi vazhdon të zgjerohet, i cili sot është i ngjashëm me universin tonë. Këtu futet dhe Teoria e Bing Bang-ut. Nga mesi i shek. XX, Fredi Hoil e kundërshtoi teorinë e Big Bang-ut. Ky e pranoi teorinë e zgjerimit të universit, por shtoi se universi është i pafund në hapësirë dhe në kohë, duke mbështetur Teorinë Materialiste

Hapi i katërt, Universi i vjetër

Nga fundi i erës kozmike, universi është zgjeruar kaq shumë sa që galaksitë janë tepër larg me njëra-tjetrën. Mbas trilion vite, shumica e yjeve janë shuar dhe universi është bosh në përgjithësi. Por ky është vetëm fillimi. Tërheqja e shtresave kozmike është e vazhdueshme, e pafund dhe i përplas shtresat herë pas here, duke nxitur Modelin Standard të sotshëm, fillimin e vdekjes-rilindjes së universit. Tani, kjo teori, natyrisht nuk mund të provohet akoma, sepse limitet tona të kuptimit, na pengojnë të shqyrtojmë gjithësinë. Megjithatë teoria u modelua nga llogaritë matematikore shumë komplekse, gjë që i mori Prof. Steinhardt dhe Prof. Turok, gati 18 muaj për të përfunduar. Sot, teoria e tyre po shqyrtohet nga fizikantë. <http://www.standard.al/2014/02/03/si-u-krijua-universi-teorite-dhe-procesi-i-plate/>

Mitet shpjegojnë dukuritë natyrore, mangësitë kulturore, forcat e mbinatyrshme, si dhe çdo gjë tjetër që nuk mund të interpretohet në mënyrë racionale.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe, pemë mendimi

Para se të lexohet pjesa, nxënësit udhëzohen ta dëgjojnë me vëmendje atë dhe të kenë parasysh këto këshilla. Duke mbajtur në dorë laps a stilolaps, për të mbajtur shënime gjatë të dëgjuarit.


Këshilla gjatë të dëgjuarit

- **Ndani çështjet kryesore nga ato më pak të rëndësishme**
- **Përqendrohuni dhe bëni parashikime për atë që do të thuhet në vijim**
- **Mbani shënime**
- **Ngrini pyetje**
- **Vlerësoni mesazhin**

Më pas, nxënësit punojnë me të kuptuarit e tekstit duke u përgjigjur pyetjeve rreth tij, ushtrimi nr 2. Radhitini sipas rendit të zhvillimit të ngjarjeve, fjalitë përmbledhëse të mëposhtme, duke vendosur numrat 1-7.

Fjalitë jo të renditura siç duhen: Mukoli për të treguar aftësitë e tij, krijoi rrënjëzën lupunga dhe e futi thellë në tokë, në zemër të ishullit të shkretë. Nga trungu i pemës, lindi insekti dhe më pas, ai u shumua. Lindi njeriu që ia doli mbanë të ndezë zjarrin. Era e keqe Musol, acaroi erën e freskët Mukol. Fillea e botës është ndërtuar nga uji, toka dhe dy erërat: një e mirë dhe një e keqe. Zjarri ishte i rrezikshëm, por njeriu mundi ta zotërojë atë. Njerëzit u shumuan, por më pas, si pasojë e zënkave, u ndanë në fise dhe raca.

Fjalitë sipas nr 1-7
 1) Fillea e botës është ndërtuar nga uji, toka dhe dy erërat: një e mirë dhe një e keqe.
 2) Era e keqe Musol, acaroi erën e freskët Mukol
 3) Mukoli për të treguar aftësitë e tij, krijoi rrënjëzën lupunga dhe e futi thellë në tokë, në zemër të ishullit të shkretë
 4) Nga trungu i pemës, lindi insekti dhe më pas, ai u shumua.
 5) Lindi njeriu që ia doli mbanë të ndezë zjarrin.
 6) Zjarri ishte i rrezikshëm, por njeriu mundi ta zotërojë atë
 7) Njerëzit u shumuan, por më pas, si pasojë e zënkave, u ndanë në fise dhe raca.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Përshkruhet mjedisi ku zhvillohen ngjarjet e këtij miti, duke nxjerrë në pah elementet reale dhe ato joreale.

Informacion shtesë për mësuesit

Disa mite të krijimit të universit nga <http://www.tiranaobserver.al/10-mitet-e-krijimit-te-tokes/>

“Kozmologjia e Indisë, takim me Brahma-n”

Kozmologjia e Indisë, përfshin shumë mite krijimi dhe protagonistët fillestarë janë ngritur dhe kanë zbritur në rëndësi gjatë shekujve. Tekstet e vjetra Vedic, ose Rig Veda, i referohen një genieje gjigante, Purusha, e cila kishte një mijë kokë, sy dhe këmbë dhe mundej të përqafoje tokën. Kur perënditë e bënë kurban, trupi i saj prodhonte gjalpë të pastër, prej të cilit u krijuan shpendët dhe kafshët. Organet e trupit të saj, u transferuan në elementët e botës dhe te perënditë Agni, Vayu dhe Indra. Gjithashtu, nga trupi i saj, u krijuan katër kastat e shoqërisë së Indisë: priftërinjtë, luftëtarët, qytetarët dhe shërbëtorët. Më vonë në histori, treshja Brahma, (krijuesi), Vishnu (mirëmbajtësi) dhe Shiva (shkatërruesi) përfituan një post serioz në kozmologjinë e Indisë. Brahma shfaqet sipër një zambaku uji, i cili shfaqet nga kërthiza e të fjeturit Vishnu. Brahma është krijuesi i gjithësisë. Më pas, Shiva shkatërron gjithësinë dhe cikli rifillon përsëri.

Kinë, Mbretëria e Mesme

Një vezë kozmike po fluturonte në universin e pangjyrë dhe kishte fuqitë e kundërta të Yin dhe të Yang. Pas shumë shekujsh inkubacioni, qenia e parë, Pan Gu, erdhi në jetë. Copëzat e rënda të vezës (Yin) u transferuan për poshtë duke krijuar Tokën. Copëzat e lehta (Yang), u ngritën sipër dhe krijuan qiellin. Pan Gu, i frikësuar se mos copëzat e vezës do të bashkoheshin përsëri, qëndroi mbi tokë dhe mbajti qiellin me dorë. Kështu, u rrit 3 metra çdo ditë për 18,000 vjet, deri kur qielli shkoi në një distancë prej 30,000 miljesh sipër. Kur mbaroi misioni i tij, vdiq. Organet e trupit të tij, u shndërruan në pjesë të botës, disa prej tyre u shndërruan në kafshë, disa në fenomene atmosferike dhe trupa qiellorë.

Disa thonë se pleshtat të cilët qëndronin sipër tij, u transformuan në njerëz, por ekziston dhe një version tjetër. Perëndesha Nuwa ndjeu vetmi dhe kështu ajo krijoi njerëzit prej baltës që gjeti në Lumin e Verdhë. Këta njerëz të parë, fituan simpatinë e saj, por ngaqë i duhej shumë kohë për t'i krijuar ata, vendosi të shpërndajë pika balte në gjithë botën dhe çdonjëra prej tyre u shndërrua në një njeri të ri. Kështu, këta njerëz të krijuar shpejt e shpejt, u bënë njerëzit normalë, ndërsa ata të cilët u paraprinë atyre, ishin njerëzit e zgjedhur.

Çekiçi i Perëndive: Mitologjia norvegjeze

Sipas traditës norvegjeze, para se të ekzistonte Toka (Midgard) ekzistonte Musepell, një vend i përfshirë në flakë, me roje, të cilët përdorin shpata flake, me gjithësinë e pafund boshe (Ginnungagap) dhe Niflheim, që ishte një zonë e mbuluar me akull. Kur i ftohti i Niflheim preku flakët e Muspell, gjiganti Ymir dhe lopa vigane Auehumla u shfaqën nga akujt e shkriirë. Në vazhdim, lopa vigane lëpiu Perëndinë Bor dhe bashkëshorten e tij, duke i sjellë kështu ata, në jetë. Çifti solli në jetë, Buri-n, që dhe ajo me radhë bëri tre djem, Odin, Vilin dhe Venë. Tre djemtë, kur u rritën, vranë Ymir dhe nga trupi i tij krijuan: me mishin Tokën, nga kockat Malet, nga flokët pemët dhe me gjakun e tij lumenj, liqene dhe detin. Në fund, nga kafka e tij, perënditë krijuan qiellin bashkë me yjet.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin e elementeve reale, apo joreale në mitin e dhënë, për hulumtimet rreth krijimit të universit, për argumentet e dhëna gjatë diskutimit, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ritrego një mit tjetër që flet për problemet kozmologjike (krijimit të yjeve, etj.).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përdorimi i drejtë i ligjëratës së zhdrejtë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës – Drejtshkrim		Situata e të nxënësve: Diskutim	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon ndryshimet që pëson ligjëratat e drejtë kur kalon në ligjëratë të zhdrejtë - liston të gjitha llojet e ndryshimeve - përdor drejt shenjat e pikësimit gjatë kalimit të ligjëratës së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjelltas - përshkruan një situatë nga jeta e përditshme duke përdorur: ligjëratë të drejtë, të zhdrejtë dhe dialog 		Fjalët kyçe: ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë, ndryshime, shenja pikësimit	
Burimet: teksti i nxënësve, tabela, shkumës me ngjyra, fletore		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Punë në dyshe, Punë e pavarur, Punë në grupe, Shkrim i lirë</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: diskutim

Paraqitet në tabelë një ligjëratë e drejtë dhe një ligjëratë e zhdrejtë.

-“Kadareja është shkrimtari im i preferuar”- tha ajo.

Ajo tha se Kadareja ishte shkrimtari i saj i preferuar.

Nxënësit do të nënvizojnë ndryshimet që pëson ligjëratat e drejtë kur kalon në ligjëratë të zhdrejtë.

Listohen në tabelë këto ndryshime.

Rikujtohet se çështje ligjëratat e zhdrejtë

Ndërtimi i njohurive të reja: *punë në dyshe,*

Udhëzohen nxënësit që të lexojnë në dyshe shembujt e paraqitur në tekst në faqen 198-199. Nxënësit mbajnë shënime në lidhje me ndryshimet që pëson ligjëratat e drejtë kur kalon në ligjëratë të zhdrejtë. Mendimet e nxënësve, përmes punës në dyshe, paraqiten në tabelë.

Listohen ndryshimet:

- *Nuk përdoret dypikëshi dhe thonjëzat, por shtohen lidhëzat*
- *Foljet dhe përemrat vetorë e pronorë, nga veta e dytë, kthehen në vetën e tretë*
- *Ndryshon koha e foljeve*
- *Ndryshojnë përemrat dhe ndajfoljet*
- *Fjalitë pyetëse, nxitëse dhe dëshirore shoqërohen nga foljet: pyes, urdhëroj, uroj.*
- *Në fjalitë pyetëse, nuk përdoret pikëpyetja (pyetja e zhdrejtë)*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur (në grupe), shkrim i lirë.*

Ndahet klasa në tre grupe

Grupi 1: Ushtrimi 1

Nxënësit kthejnë ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë. Shpjegohen ndryshimet në çdo rast

Abdyl Frashëri ka thënë se duhet të bashkohemi në një besë të gjithë shqiptarët

Skënderbeu tha që të lajmëronin fitoren dhe të ndiznin zjarret që t'i bëhej dritë popullit.

Populli ka thënë: “Më mirë një vezë sot, se një pulë mot”.

Edlira pyeti se ku do të shkonin.

Nisur nga detyra e hapit të dytë, nxënësit dallojnë ndryshimet që ka pësuar fjalia.

Grupi 2

Katër fjalitë e para të ushtrimit 2. Ligjëratat e zhdrejtë kthehet në ligjëratë të drejtë.

Artani, më në fund më premtoi: “Do të të gjej edhe ty një libër si timin”.

Vajza iu afrua kalimtarit të rastit dhe pyeti: “Nga duhet të kaloj për të mbërritur te stacioni i autobusëve?”

Unë i thashë: “Dua të njoh nxënësit dhe punët e tyre”.

Ejona tha: “Ky libër më pëlqen shumë”.

Grupi 3. Fjalitë 5-8 të ushtrimit 2.

Besmira tha: “Edhe sikur një mijë pengesa të më dalin përpara, unë do t'i kapërcej me guxim”.

Mësuesi u kërkoi nxënësve: “Nxirrni përqindjen e normës së interesit, bazuar në të dhënat e ushtrimit”.

Përfaqësuesi i agjencisë së udhëtimit tha: “Mos lëvizni nga vendi, derisa të mbërrijnë ekskursionistët e tjerë!”

Babai i rikujtoi djalin: “Që kur je kthyer nga emigracioni, ke ndryshuar shumë”.

Tre nxënës do të punojnë në tabelë. Dëgjojnë dhe vlerësohen përgjigjet e nxënësve, duke mbledhur 2-3 fletore nga çdo grup.

Ushtrimi 3 (shkrim i lirë)

Në varësi të kohës, detyra mund të vazhdohet në shtëpi.

Vlerësimi: Do të të bazohet nisur nga pjesëmarrja gjatë orës së mësimit, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes gjatë orës së mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdohet në shtëpi puna e nisur në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Zakonet dhe traditat		Situata e të nxënësve: Gjyshja e Elenit, 80 vjeçe po i tregonte mbesës së saj për mënyrën se si ajo ishte martuar në Korçë. “Martesa ime me gjyshin tënd, u bë me mblesëri. Vinte një njeri që i njihte të dyja familjet dhe bënte bisedime që t’u mbushte mendjen të dyja palëve, që martesa midis tyre ishte e mirë. Pasi u mbushej mendja, vinin njerëzit e djalit që kërkonin dorën e vajzës. Ata nuk mund të rrinin më shumë se dy orë në shtëpinë e vajzës. Dhurata që ata binin, ishte zakonisht bukë me qiqra, çorape leshi, këmishë, etj. Vajza u dërgonte njerëzve të burrit çorape leshi, jorganë, etj. Nusja binte pajë. Në ditën e martesës, para më doli vjehrra me një pjatë më mjaltë, më leu duart, faqet dhe buzët. Më pas më hodhën oriz...”	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Hulumton rreth zakoneve dhe traditave të krahinave të tij - Përshkruan zakone dhe tradita që ruhen në familjen e tij - Diskuton për zakonet dhe traditat e jetësuar në krijimtarinë popullore - Diskuton rreth fenomenit të gjakmarrjes 		Fjalët kyçe: Zakone Tradita Krahinë Mikpritje Besë	
Burimet: teksti i nxënësit “Çështje të folklorit shqiptar 3” Visaret e Kombit, vëllimi I, Shkodër, 1937, faqe 29-30.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Folklor	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve <i>Diskutim, Të nxënësit në bashkëpunim, Rrjet diskutimi</i>			
Organizimi i orës së mësimt: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim</i> Jepni përkufizimin tuaj për fjalët <i>traditë</i> dhe <i>zakone</i> . Sipas “Fjalorit të Gjuhës Shqipe”: Traditë: Pasuri shpirtërore, virtyte, që janë formuar historikisht në jetën e një populli dhe që ruhen, trashëgohen dhe zhvillohen më tej si një thesar i çmuar nga njëri brez në tjetrin. Zakone: Mënyrë veprimi, sjelljeje, që është ndjekur dhe është përsëritur vazhdimisht nga dikush, shprehi e fituar nga përsëritja e vijueshme e një veprimi, e cila ruhet për një kohë shumë të gjatë. 2) Rregull, a normë, në mënyrën e jetesës, që është vendosur historikisht e zbatohet si ligj i pashkruar nga një popull, nga një fis, etj. dhe që trashëgohen brez pas brezi. -Nxënësit më pas, diskutojnë për shprehjen e mëposhtme duke sjellë shembuj të mikpritjes shqiptare. “Shpija para se me qenë e shqiptarit, asht e zotit dhe e mikut” Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Të nxënësit në bashkëpunim</i> Ndahet klasa në grupe dhe u shpërndahen fishat me çështjet për diskutim:			

Grupi 1) Përmendni dhe përshkruani disa nga zakonet dhe traditat që respektohen në familjen dhe krahinën tuaj.

Informacion ndihmës për mësuesin:

Tradita dhe zakone shkodrane

Shkodra, kryeqendra e Shqipërisë së Veriut. I qëndron mbi shpinë Kalaja e Rozafatit. Shkodra që laget nga dallgët e Adriatikut dhe nga ujërat e lumit Buna. Djepi i kulturës, vendlindja e Barletit, Migjenit, Gurakuqit,

Veshja e gruas myslimane karakterizohet nga dimi, këmishë e bardhë mëndafshi, jelek e xhybe e gjatë e qëndisur, me fije e shirita ari. Veshja plotësohet me pantoflat e zbukuruar me qëndisma me ngjyra. Në kokë, vihet një kësulë e zbukuruar me fije, apo monedha ari e argjendi. Pjesa më e bukur, është jeleku me këmbëzat e qëndisura.

Veshja e gruas katolike karakterizohet nga *dimi* me ngjyrë të zezë, këmishë mëndafshi të çelur e të endur me avlëmend shtëpiak, jelek, xhybe me ngjyrë vishnje të errët, blu, ose të kuqe të ndezur, për rastet ceremoniale. Kjo veshje, në kokë ka sallman, një lloj rripi i qëndisur me motive të ndryshme. Veshjet shoqëroreshin me stoli të kushtueshme.

Edhe veshjet e burrave janë interesante. Ato kanë tirk të bardhë, jelek të kuq ose të zi, me brez të gjerë. Armët kompletojnë veshjet tradicionale burrërore. Të veçanta janë sumbullat e xhamadanit, çibukët, qostekët prej ari, qeleshet, etj.

Grupi 2 Nëpër këngët dhe në rrëfenjat popullore, shpesh hasim tradita të ndryshme, të cilat lidhen me dashurinë, punën, besën, etj. Përmendni disa përralla, legjenda dhe krijime të tjera popullore. Komentojini ato, duke veçuar detajet më tipike.

-Nxënësit sjellin ndërmend “Legjendën e murosjes”, ose legjendën e ringjalljes tek “Kënga e Dhoqinës”

-Te Cikli i Kreshnikëve, te Rapsoditë “Muji mbas deket”, “Muji nën dhe”, “Halili mbas deket”: I mrekulli zoti ka ba / Prej vorrit Halili ka dalë / Edhe Mujes vorrin ia ka zbluë / kambëkryq Mujin ma ka gjetë! / Doren Mujit Halili ia ka dhanë / e prej vorrit Mujin ma ka qite / e n’gjog t’vet Mujin m’a ka hip / shnosh e mirë n’Jutbinë me te ka ra / shumë trimni bashkë prap qi i kan ba.

Grupi 3 Çdo popull ka ngjarje të rëndësishme personale, krahinore dhe kombëtare. Në çdonjërin prej tyre, respektohen zakone të caktuara (valle, këngë, lojëra, etj.). Diskutoni rreth zakoneve të familjes dhe të krahinës suaj.

Në dasma: Nxënësit tregojnë sa ditë zgjat dasma në krahinën e tyre, çfarë ritualesh ndiqen, cilat këngë këndohen, çfarë ritualesh ndiqen në familjen e vajzës dhe në atë të djalit, etj.

Në raste vdekjesh: nxënësit tregojnë çfarë dinë rreth ritualit të vdekjes.

Mësuesja mund të drejtojë disa pyetje orientuese si: - Çfarë vajtimesh bëhen?

-Sa ditë/netë qëndrojnë te shtëpia e të ndjerit njerëzit?

-Si bëhet/organizohet ndarja në burra dhe gra gjatë vajtimit?

- Çfarë ritualesh ndiqen në familjet e besimeve të ndryshme fetare

Grupi 4 Për besën kemi dëgjuar të flasin të moshuarit, kemi lexuar materiale të ndryshme informuese ose letrare, madje kemi parë edhe filma, a dokumentarë në televizor që sillen rreth saj, duke e trajtuar, interpretuar dhe paraqitur për brezat e rinj. Sillni shembuj të ndryshëm që kanë në qendër besën dhe diskutoni rreth tyre.

Përshkruani raste të respektimit të besës nga brezat e rinj. Si mendoni, është forcuar apo është dobësuar kjo traditë? Argumentoni përgjigjen.

a) Dhënia e besës nënës nga Kostandini, elementi tradicional i rëndësishëm i shqiptarëve si edhe element folklorik. “Konstandin, të ardhhtë gjëma,

Ku e ke besën që më dhe,

Besa jote nën dhe...”. Janë vargje me shumë kuptim, të ndjeshme dhe mjaft të rënda, duke patur parasysh, që thuhet nga një nënë për të birin e saj. Përmes tyre, mund të vërehet mallkimi i nënës së Kostandinit te varri i tij, duke e quajtur atë, si besëshkelës.

b) Në epikën tonë legjendare, besë i jep dhe burri gruas, që ta presë për një kohë të gjatë si te “Balada e Ago Ymerit”

c) Besa si normë jetësore, jo vetëm brenda sferës së familjes, por në marrëdhëniet me të tjerët. Muji e mban fjalën e dhënë Agë Jabanxhisë, që ta varrosë në bjeshkë dhe ta fshehë nga armiqët. Besa shfaqet dhe në marrëdhëniet me armikun. Te kënga e Ali Bajraktarit, Aliu e mban besën për t’u kthyer pas 6 ditësh, pasi i kishte dhënë besën krajlit:

“Prap n’krajlit m’duhet me dal,

pse besën e zotit krajlit ia kam dhanë”.

Burimi: “Çështje të folklorit shqiptar”

Selami Tabaku “Besa dhe mikpritja si dëshmi e lashtësisë dhe e origjinalitetit të epikës heroike legjendare”, 22 tetor 1983.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Vija e vlerës

Flisni dhe diskutoni rreth gjakmarrjes, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme ndihmëse.

Ku e ka burimin ajo? Cilat janë shkaqet, që ky zakon vazhdon të ekzistojë ende, në zona të caktuara të vendit tonë? Cilat janë pasojat e saj?

Gjatë diskutimit tuaj, sillni shembuj të ndryshëm të saj.

PO Gjakmarrja - Zgjidhje e problemit, apo zgjedhje e individit? JO

Nxënësit diskutojnë dhe japin mendimin e tyre.


Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për argumentimin dhe pjesëmarrjen në diskutime.

Detyrat dhe puna e pavarur: Bëni një ese me temë: “Besa e burrit pesha e gurit”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Shuarja e humorit (ora e parë)		Situata e të nxënësve: Kujtime me shokë të fëmijërisë.	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare - Kompetenca personale 			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexon rrjedhshëm në role tregimin. - Dallon rrëfimtarin (veçoritë e tij), vetën dhe kohën e rrëfimit. - Zbërthen brendinë e tregimit nëpërmjet pyetjeve. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Letra fëmijëri humor rrufjanë shokë</p>	
Burimet: teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bisedë e lirë; diskutim; kllaster; lexim në role; tabela e koncepteve;			
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: bisedë e lirë</p> <p>U kërkohet nxënësve të tregojnë ndonjë episod të shkurtër me ndonjë shok të fëmijërisë më të hershme, që u ka mbetur në mend.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim-kllaster, lexim në role</p> <p>Prezantohet titulli i tregimit dhe njihemi me autorin</p>			



Romani më i njohur i tij është: “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”

➤ Lexohet pjesa në role

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: tabelë konceptesh, diskutim.

Ushtrimi 10. Nëpërmjet tabelës së koncepteve nxënësit nxjerrin karakteristikat e rrëfimtari.

Në ç’vetë rrefehet ngjarja? Ngjarja rrefehet në vetën e parë.

Po letrat, në ç’vetë janë shkruar? Letrat janë shkruar në vetën e parë dhe të dytë.

Po në përrallën “Fjalë e grosh”, në ç’vetë bëhet rrëfimi? Në vetën e tretë.

Rrëfimtari

Rrëfimtari/Veta e parë	Rrëfimtari /Veta e tretë	Rrëfimtari /Veta e dytë
-është vetë pjesë e zhvillimit të ngjarjeve	-Rrëfimtari (tregimtari) më i shpeshtë, është ai i vetës së tretë	-rrëfimtari përdor vetën e dytë për t’iu referuar vetvetes
- Lexuesi i nje ngjarjet dhe marrëdhëniet mes personazheve nëpërmjet syve të tij.	-flet nga jashtë historisë	-Krijon një distancë emocionale dhe ironike
- flet nga brenda historisë: unë e di, unë pashë, unë e kuptova.	-u drejtohet personazheve duke iu referuar me “ai”, “ajo”, “atë”, ose “ato”, “ata”.	-sheh veten e tij, jetën e tij nga një distancë analizuese.
-ndryshe qubet edhe rrëfimtari i brendshëm	-rrëfimtari është një figurë e papërcaktuar dhe e papërfshirë në ngjarjet e tekstit	-është karakteristik për këngët popullore lirike
-ndihet roli subjektiv i tij.	-synon të jetë objektiv në atë që rrefen	-përdoret më shpesh në libra joletrarë
-rrëfimtari nuk mund të njëjtësohet me autorin		

Ushtrimi 1. (diskutim) Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

*Për sa letra flitet në tregim? (dy letra) Kush i dërgon ato? Hyseni dhe Zalo - shokë fëmijërie

*Çfarë i bashkon dy personazhet e tregimit, rrëfimtari dhe Zalon? Janë shokë fëmijërie.

*A takohen shpesh me njëri-tjetrin personazhet kryesore të tregimit? Jo, sepse jetojnë në qytete të ndryshme.

*Në ç’mënyrë komunikon rrëfimtari me Zalon? Komunikojnë me anë të letrave.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruajni një letër shokut tënd të fëmijërisë së hershme. Kujdes elementet e formës dhe të përmbajtjes së letrës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Shuarja e humorit (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Lidhet me diskutimin mbi vlerën që ka shoqëria.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - Zbulon tiparet e karaktereve të dy personazheve. - Interpreton elementet kryesore të stilit dhe të gjuhës së tregimit. - Dallon gjendjen emocionale të personazheve në momentin kur kanë shkruar letrat. 		Letra Fëmijëri Humor Rrufjanë Shokë	
Burimet: teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>diskutim; kllaster; punë individuale; punë e drejtuar; punë e pavarur;</i>			
Organizimi i orës së mësimi:			
Hapi i parë: Lexohen dy - tri nga letrat e nxënësve (detyra e shtëpisë)			
Hapi i dytë: Ushtrimi 2 (punë individuale). Nxënësit gjejnë në tekst fjalët me të cilat rrëfimtari:			
a) shpreh mallin për fëmijërinë (të shkuarën) <i>Dhe kur i shkruan ndonjë shokut tënd, duke radhitur gërat dhe fjalët, të del përpara gjithë fëmijëria, të kujtohen gjithë peripecitë, shkolla, mësuesit, vajzat...</i>			
b) përshkruan Zalon fëmijë... <i>të mirit të mullixhiut të fshatit tonë, atij fytyrë pikaloshit...</i>			
Hapi i tretë: Ushtrimi 3 (diskutim). Rrëfimtari rrëfen për kohën e shkuar, atë të fëmijërisë dhe kohën e tashme, kur personazhet janë të rritur dhe bëhet shkëmbimi i letrave. Për çfarë shërben një pranëvënie e tillë?			
<i>Një pranëvënie e tillë, shërben për të theksuar ndryshimin që ndodh teksa rritemi dhe për më tepër kur ndryshon edhe pozicioni ynë social. Ndoshta jo të gjithë njerëzit ndryshojnë, pasi ky ndryshim lidhet dhe me karakterin e njeriut.</i>			
Hapi i katërt: Ushtrimi 4. (kllaster) Çfarë karakteristikash të karaktereve zbulohen nga dy letrat e protagonistëve të tregimit?			
<pre> graph TD Hyseni --- H1[i thjeshtë] Hyseni --- H2[nostalgjik] Hyseni --- H3[me humor] Zaloja --- Z1[frikacak] Zaloja --- Z2[paragykues] Zaloja --- Z3[sipërfaqësor] Zaloja --- Z4[burokrat] Zaloja --- Z5[i ftohtë] </pre>			
Hapi i pestë (diskutim): Punohen ushtrimet 5, 6, 7 dhe 12.			
5. (diskutim) Përshkruani gjendjen emocionale të rrëfimtari dhe të gruas së tij, kur lexojnë letrën e Zalos. Nxënësit gjejnë fjalitë ku shprehet <i>habia</i> e bashkëshortëve.			
Si mund ta shpjegoni habinë e tyre? <i>Habia e tyre shkaktohet nga ndryshimi i Zalos.</i>			
6. Duke lexuar tekstin e letrës së Zalos, kuptoni edhe ndryshimet e karakterit të tij. Pse mendoni se kanë ndodhur këto ndryshime? <i>Për shkak të karakterit të tij të dobët, karakter që del në pah pasi ai hipën në poste drejtuese.</i>			
7. Si e kuptoni titullin “Shuarja e humorit”?			
12. Diskutoni rreth mesazhit të kësaj pjese.			
<i>Pavarësisht shkallëve që ngjisin në jetë nuk duhet të mohojmë të shkuarën dhe njerëzit që bëjnë pjesë në të.</i>			
Nxënësit diskutojnë, duke sjellë edhe shembuj nga jeta e tyre, ose e të njohurve të tyre.			

Hapi i gjashtë. Punohen ushtrimet 8-9, (punë e drejtuar).

8. Duke u nisur nga toni i letrës, konstatooni se Zalo: e kritikon ftohtë atë.

9. Shënoni me v në kolonën V, nëse pohimi është i vërtetë dhe në kolonën G, nëse është i gabuar.

Letra e rrëfimitarit	V	G
E thjeshtë	V	
Me humor	V	
Pa nënkuptime	V	
Emotive	V	
Me gjuhë teknike		G
Me nota kritike		G

Letra e Zalos	V	G
Me nota kritike	V	
Me humor		G
Me terma formalë	V	
E ftohtë	V	
Me gjuhë teknike	V	
Emotive		G

Hapi i shtatë: Ushtrimi 11 Gjenerali në letrën e dytë fjalë të stilit juridiko-administrativ. (punë e pavarur)

Shoku Hysen; letrën tuaj; më datën 14 maj të vitit në vazhdim; sektorë të ndryshëm të ekonomisë, apo të kulturës sonë popullore; letra të tilla diskriminuese në mënyrë dialektike, në zhvillim, në formë spirale.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjenerali dhe komentoni dy thënie që tregojnë vlerën e shoqërisë së vërtetë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fshati mbi shtatë kodrina (ora e parë)		Situata e të nxënësve: Mjedisi gjeografik (relievi) i Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: -Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit -Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja - Identifikon domethënien dhe karakteristikat e novelës si lloj i prozës së shkurtër. - Krahason fshatin që përshkruhet në tekst me përfytyrimin që ai vetë ka për fshatin. - U përgjigjet pyetjeve rreth të kuptuarit të tekstit.		Fjalët kyçe: fshat; kodrina; luftë; pranverë; diell; male; këngë	
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha Shqipe 9" Novela: "Fshati mbi shtatë kodrina"		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia; Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë; skeda e autorit; kllaster; punë e drejtuar</i>			
Organizimi i orës së mësimi: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>bisedë.</i> Kujtojmë nga gjeografia ç'dimë për relievin shqiptar. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>skeda e autorit, kllaster.</i> Prezantimi me titullin e pjesës dhe skeda e autorit.			
<p>Kasëm Trebeshina 8 gusht 1926 - 6 nëntor 2017 Vepra Romane => <i>Kënga shqiptare; Odin Mondvalsen; Rruga e Golgotës</i> <i>Novela:</i> => <i>Stina e stinëve; Fshati mbi shtatë kodrina</i> <i>Drama:</i> => <i>Tiranozauri; Ëndrra dhe hije</i> Botimet: <i>Iu ndalua e drejta e botimit dhe dorëshkrimet e tij, u botuan vetëm pas viteve '90.</i></p>			

Më pas bëhet leximi i pjesës nga mësuesi.

Pjesa që kemi në tekst, është shkëputur nga novela me të njëjtin titull: “Fshati mbi shtatë kodrina”

➤ Njohim karakteristikat e novelës.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e drejtuar

Ushtrimi 1. Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Në çfarë relievi është ndërtuar fshati për të cilin flet proza?	<i>Reliev kodrinor</i>
Në cilën stinë të vitit zhvillohen ngjarjet që do të rrëfohen?	<i>Në stinën e verës</i>
Çfarë përfshin brenda vetes fshati?	<i>Shtatë mëhallë; një kullë të rrëzuar; një mekam të shenjtë.</i>

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 12 Komentoni frazën: E dimë që ka vende më të bukura, më të mëdha në botë, po e dimë se ka diej edhe më të mëdhenj se dielli ynë në hapësirat e pakufishme të gjithësisë...

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fshati mbi shtatë kodrina (ora e dytë)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca personale - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja		Fshat	
<ul style="list-style-type: none"> - Dallon elementet kryesore të stilit dhe të gjuhës së autorit. - Interpreton lidhjen e autorit me vendlindjen dhe historinë e saj. - Identifikon figurat letrare dhe shpjegon përdorimin e tyre. 		Kodrina	
		Luftë	
		Pranverë	
		Diell	
		Male	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia; Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim; punë në grup; punë individuale; koment; punë dyshe;</i>			
Organizimi i orës së mësim:			
Hapi I (diskutim): Diskutohen ushtrimet 2, 3, 4, 5 dhe 9. Gjatë diskutimeve, nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre.			
2. Në çfarë vete rrëfëhet në këtë prozë? <i>Kjo prozë ka rrëfim në vetën e tretë, por herë-herë edhe në vetën e parë. Pse mendoni se natyrës së kësaj proze i përshtatet rrëfimi në këtë vetë?</i>			
<i>Rrëfimi në vetën e parë, tregon se autori identifikohet, është pjesë e mjedisit të përshkruar, kurse në vetën e tretë, autori distancohet, është thjesht vëzhgues.</i>			

3. Rrëfimi, herë duket si fantazi, (*na ishte një herë*), herë duket se është rrëfim i ngjarjeve të ndodhura vërtet (*koha ekzakte: ishte verë; pozicionimi i fshatit: mbi shtatë kodrina*). Cilat janë arsyet që e shtyjnë rrëfimtarin ta nisë sikur do të rrëfejë një përrallë e më pas një prozë realiste?

Rrëfimi si fantazi ka efekt tërheqës të lexuesi. Gërshetimi i fantazisë me realitetin, e përcjell më të plotë rrëfimin, e bën lehtësisht të lexueshëm.

4. Përshkrimi i fshatit bëhet nëpërmjet kujtimeve të autorit. Siç është normale, njeriu nuk mund t'i mbajë mend të gjitha, pasi jo gjithçka lë mbresë në nënvetëdijen e tij. Nisur nga fakti që rrëfimtari vazhdimisht thotë se ka harruar, flisni për ndryshimin mes kohës së rrëfimit dhe kohës kur mendohet se kanë ndodhur ngjarjet e rrëfyera.

Përshkrimi i fshatit nëpërmjet kujtimeve të autorit, nuk bëhet në një mënyrë tradicionale. Përkundrazi, ai të mbërthen me mënyrën origjinale të të rrëfyerit, pasi autori, kujtesën e tij e shfleton si një libër të vjetër, ku shumë fletë janë zverdhur, disa janë grisur përgjysmë e disa të tjera kanë humbur. Njësoj si në jetë, ku njeriu nuk mund t'i mbajë mend të gjitha, pasi jo gjithçka lë mbresë në nënvetëdijen e tij. Ngjarjet e rrëfyera përkrijnë me kohën kur kanë ndodhur (lufta antifashiste), koha e rrëfimit të autorit, paqartësitë e tij përkrijnë me kohën e pasluftës.

5. Pse rrëfimtari u drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë lexuesve, duke i quajtur ata miq dhe dashamirës? *Tërheq lexuesin, tregohet i afërt me të. Nxënësit diskutojnë rreth kësaj pyetjeje.*

9. Dalloni në tekst pjesët në të cilat rrëfimtari bën monolog.

- *Nuk më kujtohet viti!.. Po këtë edhe mund ta gjejmë: atë vit ishte luftë. Kjo është e sigurt: ishte luftë, se ishte luftë dhe kur ishte luftë, luftohej se ishte luftë. Ishte luftë!... Më parë se të ishte luftë, nuk ishte luftë.*

- *Zoti im! Ku e kanë gjetur këtë bukuri këto male? Po kur moti është i vrenjtur?... Po kur moti është i vrenjtur?... Hej, si duken atëherë! Marrin një pamje të zemëruar, një ngjyrë të thellë mavi dhe ngrihen të egra pikërisht përpara vështrimit tënd. Ngrihen të egra, të heshtura, të pakalueshme!... Ngrihen të gjalla, sikur të kishin një shpirt njerëzor që ka kaluar provat e gjata dhe të rënda të jetës... Të tilla janë malet e Shqipërisë!*

Çfarë tregon përdorimi i këtyre monologëve në këtë pjesë?

Autori është i paqartë dhe kërkon të zbulojë në veten e tij, kohën dhe gjithçka që ka ndodhur duke theksuar dhe një herë rëndësinë që ka fshati për të.

Hapi II (*Punë në grup*): Në këtë fazë punohen ushtrimet 6, 7.

6. Në novelën për fshatin që ngrihet mbi shtatë kodrina, rrëfimtari ndalon gjatë në përshkrimin e maleve. Pse e bën një gjë të tillë? Çfarë simbolizojnë ato për të? *Malet simbolizojnë triumf, madhësi, mosnështrim, unitet. Përshkrimi i gjatë i maleve lidhet me vlerësimin për historinë, identitetin e këtij fshati.*

Po këngët? *Simbol i gëzimit*

7. Duke pasur parasysh shprehjen “stinët e jetës” (*metaforë*), interpretoni frazën e shprehur nga teksti i mësipërm: *Jo se nuk kishte dimër në atë vend, por atë vit ishte verë, se më pas erdhi vjeshta dhe pas saj erdhi dimri...*

Stinët e jetës janë të barasvlershme me ngjyrat e jetës (gëzim, hidhërim, vuajtje, humbje, triumf, etj.). Kjo shprehje, tregon riciklimin e kohës dhe fakti që thekson stinën e verës, nënkupton se kërkon të nxjerrë në pah gëzimin, vazhdimësinë në rrjedhën normale.

Hapi III: Ushtrimi 8 (*punë dyshe/diskutim*). Nënazoni në tekst, pjesët kur rrëfimit i vishen nota humorit dhe diskutoni në klasë për këtë karakteristikë të stilit të shkrimtarit.

- *Le të themi topi i Gorricës...*

- *Ishte luftë, se ishte luftë dhe kur ishte luftë, luftohej, se ishte luftë.*

- *Më parë se të ishte luftë, nuk ishte luftë.*

Notat e humorit (nuancat kuptimore të humorit), i japin tekstit ngjyra më të thjeshta dhe më të kuptueshme. Ato i japin mundësi autorit të afrohet me lexuesin.

Hapi IV: Ushtrimi 10 dhe 12 (koment). Nxënësi përcakton figurat letrare.

10. - dielli shkëlqen madhërishtëm në kupën e qiellit - *metaforë (grup emëror)*

- pa e çarë kokën për të - *shprehje frazeologjike*

- mëhallët sikur mbaheshin dora-dorë me njëra-tjetrën – *metaforë (grup emëror)*

- dy pëllëmbë vend - *litotë*

- malet marrin një pamje të zemëruar, një ngjyrë të thellë mavi - *shkallëzim (rritës)*

- sikur të kishin një shpirt njerëzor që ka kaluar provat e gjata dhe të rënda të jetës - *similitudë*

~Litota vjen nga greqishtja litotes' - zvogëlim, thjeshtësi. Litota është e kundërta e hiperbolës dhe autori thotë më pak, duke lënë të kuptohet më shumë. Litota përdoret për modesti, për druajtje dhe rrallëherë edhe për ironi.

12. Komentoni frazën: E dimë që ka vende më të bukura më të mëdha në botë, po e dimë se ka diej edhe më të mëdhenj se dielli ynë në hapësirat e pakufishme të gjithësisë...

Autori është i vetëdijshëm për "rëndësinë" e këtij vendi, por kërkon ta dallojë për vlerën që ka te vetë ai dhe botëkuptimi i tij, pra ky vend është pjesë e identitetit të autorit. Në këtë frazë, kalohet nga konkretja tek e përgjithshmja, duke ardhur dhe si mesazh i pjesës. Përdorimi i mbiemrit në shkallën krahasore (më të bukura; më të mëdhenj), është i qëllimtë për ta dalluar ndër të tjerët.

Hapi VI: Ushtrimi 11 (punë dyshe). Në këtë tekst, vendin më të madh e zë:

përshkrimi;

rrëfimi;

dialogu;

arsyetimi.

(Autori rrëfen duke përshkruar kjo i jep mundësi të krijojë hapësira që lexuesi të mos lodhet)

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgjigjet e dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur: Bëni një ese përshkruese për vendlindjen tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dyzanore Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim		Situata e të nxënimit: Minikonkurs	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - shkruan dhe shqipton saktë fjalët në të cilat takohen zanoret: ie, oo, aa - formon fjalë të prejardhura që kanë në përbërjen e tyre këto zanore - ndërton fjali me fjalë që kanë në përbërjen e tyre këto zanore 		Fjalët kyçe: zanore, ie, je, oo zanore të njëjta rregulla përdorim i drejtë	

<p>Burimet: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, fisha me fjalë, tabelë, shkumës me ngjyra</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Minikonkurs, Diskutim, Punë në dyshe, Punë e pavarur</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Minikonkurs</i> Zhvillohet një minikonkurs me tre nxënës sipas rreshtave. Në një tavolinë, janë përmbysur fisha me fjalët: diell, e djellë, ndiej, nxierr, alkol, avijon, ndieva, përkthyer, kaisi, aksion, miljon, portier, trajner, medalie, parandjenja, e ndieshme, edukues, i vazhdueshëm, arsye, ngjyey, i anshëm, (secili nxënës ka nga 7 fisha). Nxënësit do të shkruajnë në tabelë, trajtën e saktë të fjalës, duke qortuar gabimet. Përgjigjet e sakta: diell, e diel (e djell), ndiej, nxjerr (nxierr), alkool (alkol), avion (avjon), ndjeva (ndieva), përkthyer, kaisi (kaisi), aksion, medalje (medalie), parandjenja, e ndjeshme (e ndieshme), edukues, i vazhdueshëm, arsye (arsyje), ngjyey, i anshëm. Fiton nxënësi që punon më shpejt dhe më saktë. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim, punë në grupe dyshe.</i> Në fjalët e paraqitura në tabelë, nxënësit do të nënvizojnë grupet e zanoreve. Hapet teksti në faqen 200 dhe nxënësit shqyrtojnë rastet e drejtshkrimit të fjalëve me grupet e zanoreve. Fillimisht punohet në dyshe dhe më pas, nxënës të ndryshëm paraqesin në tabelë grupe fjalësh dhe rregullin përkatës për çdo rast. Përdoren shkumësa me ngjyra të ndryshme. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë e pavarur</i> Ushtrimi 1. Nxënësit do të vendosin në vend të pikave, shkronjën që mungon. eksperiencë. Joobjektiv variant kalcium ekuivalent zooteknik arterie portier ambient joorganik përzier koalicion ekuilibër aksiomë i paarmatosur akuarium Për fjalët: eksperiencë, ekuivalent, ambient, jepet gjegjësjë në gjuhën shqipe (përvojë, mjedis, i/e njëjtë) Ushtrimi2. Nxënësit do të dallojnë fjalët nga të cilat janë formuar fjalët e prejardhura <u>arsye, thyej, muaj, hua, pyes, qiell,</u> <u>diell, mëso, harro, shkruie (geg), moho, arsye</u> Kërkesë shtesë: formohen fjalë të tjera të prejardhura, nga tri për çdo fjalë Arsye-i arsyetoj, i arsyetueshëm, i paarsyetueshëm Thyej-thyesë, i thyeshëm, thyeshmëri Muaj-mujor, hua-huazoj, i huazuar, i pahuazuar Pyes-i pyetur, i papyetur, pyetësor Qiell-qiellësi, joqiellor Diell-diellishtë, diellzim, diellzohet Mëso-mëso, mësuar, i mësuar, i pamësuar Harro-harrim, harresë, mosharrim Shkruie-shkruaj, shkrim, shkrimtar, i shkruar, i pashkruar Moho-mohim, mohues, i mohuar, i pamohuar Arsye-arsyetoj, i arsyetuar, i paarsyetuar, i arsyetueshëm Ushtrimi 3. Nxënësit formojnë mbiemra të prejardhura nga foljet dhe formojnë fjali me to. Shkruaj-i shkruar, dëgjoj-i dëgjuar, pëlqej-i pëlqyer, bluaj-i bluar, përpunoj-i përpunuar, ndiej-i ndier Dëgjohen dhe vlerësohen përgjigjet e nxënësve.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgjigjet që kanë dhënë.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni në fragmentin intervistë me gjuhëtarin Et’hem Lika, fjalë që kanë grupet e zanoreve të mësuara.</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Lodra mbi akull		Situata e të nxënimit: Lojërat në dimër	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Kompetenca personale - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare. 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikon prozën epistolare nëpërmjet elementeve strukturore të tregimit. 2. Dallon fjalët dialektore për t'i kthyer në gjuhën standarde. 3. Dallon në tekst figurën letrare të onomatopesë. 4. Diskuton mbi rëndësinë jetësore dhe të pazëvendësueshme të disa gjërave në jetën tonë. 		Fjalët kyçe: Dimër Liqen Akull Borë Fëmijë Lodra Ngjarje	
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha Shqipe 9" Libri "Të fala nga fshati"		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Edukim fizik; Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim; skeda e autorit; lexim zinxhir; ditar dypjesësh; punë dyshe;</i>			
Organizimi i orës së mësimt: <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: diskutim.</i> Nxënësve u shtrohen pyetjet: Cilat janë lojërat që luani në dimër? A paraqet rrezikshmëri ndonjë prej tyre? Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i parë: (Skeda e autorit). Në bazë të njohurive që kanë dhe të atyre që do të marrin, nxënësit ndërtojnë skedën e autorit.			
<p>Autori: Sterio Spase (1914-1989) Botimet: <i>Tregime, romane, studime pedagogjike, tekste shkollore</i> Veprat: <i>Kuror rinie, Nusja pa duvak, Pse?, Afërdita, Kryengritësit</i> Libri: <i>Të fala nga fshati</i> Titulli i tregimit: <i>Lodra në akull</i> Lloji letrar: <i>Proza epistolare</i> Karakteristikat: <i>Shkrimi në formën e letrës, ditarit, artikujve, postës elektronike.</i></p>			
Hapi i dytë: (Lexim zinxhir) Lexohet pjesa dhe shpjegohen fjalët që nxënësit i kanë të panjohura.			
Hapi i tretë: (ditar dypjesësh). Punohen ushtrimet 1, 2, 3.			
1. Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.			
Atë ditë të frohtë dimri, liqeni kishte ngrirë. A ndodhte shpesh ngrirja e liqenit në dimër?	Jo, nuk ndodhte shpesh.		
Çfarë bënë fëmijët në liqenin e ngrirë? A ishte argëtuese një gjë e tillë	Filluan të rrëbqisnin mbi liqen. Po, ishte argëtuese.		
Cila ishte ngjarja që i tronditi fëmijët në liqenin e ngrirë?	Rënia e viçit të Gjergjit në liqen dhe ngrirja brenda tij.		
Çfarë kuptojmë nga kjo pjesë? Cili është mesazhi i saj?	Lojrat janë argëtuese për fëmijët, por nuk duhet të rrezikojmë gjatë tyre.		
Teksti është ndërtuar në formën e letrës. Çfarë i shton rrëfimit të ngjarjes përdorimi i kësaj forme?	Rrëfimi bëhet më i besueshëm, autori afrohet me lexuesin.		
Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet për të cilat rrëfëhet në këtë tekst.	Në liqen, në dimër.		

Hapi i katërt: (punë individuale). Punohen ushtrimet 4 dhe 5.

4. Ngrirja e liqenit përjetohet me entuziazëm dhe frikë nga fëmijët. Gjeni në tekst ndodhitë që shkaktojnë ankth te personazhi.

...dëgjuam një“kërc” të rënduar, pastaj një “bëllduf” e po n’atë çast ulërima fëmijësh... ishte çarë akulli në një vënd dhe njëra këmbë, Vasos i qe futur brënda.

... na trembën se po çabej akulli i tërë e se do të mbyteshim.

Dhe frikën më të madhe na e futi viçi i vogël i Gjergjit ... dha një vrap në thellësi...viçi ra brenda n’ujë!

5. Gjeni në tekst përshkrimet e ndjesive të fëmijëve ditën e parë dhe ditën e dytë.

- Dita e parë: *më rrihte zemra; sa bukur që ishte; me mendje të ngritur*

- Dita e dytë: *ia patëm frikën; na erdhi shumë keq; i kemi zili ata zogj...*

Hapi i pestë: (diskutim). Punohen ushtrimet 6, 7, 8, 9, 11, 13, 14

6. Çfarë shtohet më shumë në ditën e dytë, kënaqësia apo ankthi?

Shtohet ankthi. Pse? Sepse kuptuan rrezikshmërinë e lojës së tyre.

7. Pse autori ka zgjedhur të rrëfejë një ngjarje të tillë?

- Lojëra të tilla, vërtet janë tërheqëse, por paraqesin dhe rrezikshmëri.

8. Si i kuptoni fjalët e Yllit: “Vetëm tani e kuptojmë se ç’marrëzi kemi bërë duke rrëshqitur aq fellë dje e pardje. Paskemi shpëtuar si për çudi.”

Fëmijët u ndërgjegjësuam për rrezikun pas asaj që i ndodhi viçit të Gjergjit.

A përbëjnë ato mesazhin e pjesës? Po ju, a tregoheni gjithmonë të kujdesshëm kur luani?

9. Si e interpretoni shprehjen e mëposhtme.

Ne i kemi zili këta zogj, se na duket sikur vozitin si lundra akulli mbi liqen!

Dëshira e fëmijëve ishte e madhe për të rrëshqitur mbi liqen dhe rreziku po aq i madh, ndaj i kishin zili zogjtë që e kishin këtë mundësi si pjesë e përditshmërisë së tyre. / Dëshira për të qenë “të lirë” si zogjtë.

11. Çfarë tregon përdorimi i fjalëve dialektore në tekst?

Autori ka përdorur regjistrin e shkujdesur gjuhësor, pra është i lirshëm, përdor gjuhën e gjallë...

13. Nisur nga fjalja: *Ne na erdhi shumë keq për Gjergjin që humbi viçin, të vetmin viç që kishin!* Diskutoni për kujdesin që tregojmë ndaj gjërave, rëndësia e të cilave është jetësore dhe e pazëvendësueshme për ne.

14. Fëmijët dhe nënat e tyre, kanë qëndrime të ndryshme ndaj lojës në akullin e liqenit. Po ju, a keni ndonjë qëndrim të ndryshëm nga ai i prindërve tuaj? Për çfarë?**Hapi i gjashtë:** (punë në dyshe).

Ushtrimi 10. Nënvizoni në tekst fjalët e shkruara në dialekt. Shkruajini ato në gjuhën standarde, sipas shembullit të dhënë.

Fjalët në dialekt	Fjalët në gjuhën standarde
Pyesnja	Pyesja
Shihnja	shihja
Aqë	Aq
Qërtonin	qortonin
Makar	fundja
Këthyem	kthyem
Çarkth	çark
Hapnë	hapën
Fellë	thellë

Hapi i shtatë: 12. Gjeni në tekst onomatopetë dhe shkruajini ato më poshtë.

Onomatopeja: (Nga greq. onoma – emër, poeme – bëj – krijoj). Është figurë e përsëritjes që ka bazë imitimin e zhurmave të zërave të natyrës dhe të qenieve të gjalla.

Fërshh; kërc; bëllduf; kërc-trak

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një tekst të shkurtër përshkruar, në të cilin të përdorni sa më shumë onomatope.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet ye, ua, ue		Situata e të nxënimit: Punë e pavarur	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës. Drejtshkrim			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyçe: grupe zanoresh, ye, ua, ue	
Nxënësi/ja:		raste përdorimi	
<ul style="list-style-type: none"> - shqipton dhe shkruan saktë fjalët që kanë grupet e zanoreve ye, ua, ue - përdor drejt këto zanore në fjalët e prejardhura - i përdor saktë këto fjalë në përshkrime të ndryshme 		drejtshkrim	
		drejtshqiptim	
Burimet: teksti i nxënësit, libri “Gjuha standarde”, fletore, shkumës me ngjyra		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stubi mendimi, Punë e pavarur, Shpjegim, Punë në dyshe, Shkrim i lirë.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stubi mendimi.</i>			
Shkruhet në tabelë tema e re mësimore dhe nxiten nxënësit që të shkruajnë sa më shumë fjalë me këto grupe zanoresh. Paraqiten në tabelë disa fjalë.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur</i>			
Nxënësit udhëzohen që të hapin tekstin në faqen 21. Lexohet në heshtje informacioni i dhënë.			
Shkruhen në tabelë grupet: <i>ye, ua, ue</i> dhe tre nxënës do të shkruajnë në tabelë fjalë me këto zanore. Nxënësit e tjerë do të formulojnë rregullin përkatës. Përfshihen sa më shumë nxënës në këtë veprimtari.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë në dyshe.</i> Në grupe dyshe, plotësohen ushtrimet në vijim.			
1. Nxënësit do të plotësojnë në libër ushtrimin 1. Do të këmbëjnë librat me njëri-tjetrin. Vlerësojnë punën e realizuar nga shoku/shoqja.			
Grupi ye	Grupi ua	Grupi ue	
lyej, i lyer, i palyer, thyej, pyes, fyej, i thyer, thyesë, fyell, dyer, skërfyell, përthyer, i mbërthyer, i përlyer, i fyer...	mua, luaj, duar, hua, ftua, i ftuar, i paaftuar, i aftuar, i dëgjuar, i mësuar, mbuluar, i ngujuar, bluaj, shkruaj...	dëgjueshëm, i lexueshëm, i pranueshëm, duel, tunel, mësues, i gabueshëm, i pagabueshëm...	
2. Një nxënës punon në tabelë, kurse klasa punon në fletore.			
thyerja gërryerja mësues lakues			
ftua përrua dragua grua			
langua ndërrues kërkues pastrues			
dyshues fyerja fyell arsye			
Kërkesë shtesë. Formoni fjalë të prejardhura nga fjalët: thyej, dyshues, fyej, arsye dhe më pas krijoni nga një fjali me to.			
Thyej - thyesë, i thyer, i pathyer, thyesi (shkelës kufiri)			
dyshues - i dyshuar, i padyshuar, dyshimor (që përmban dyshim), dyshimtar, dyshimtas			
fyej - fyese, i fyer, i pafyer,			
arsye - arsyejoj, arsyeitim, mosarsyeitim, arsyeshëm, i paarsyeshëm, arsyeitues, arsyeituar			
Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3. Përshkruani peizazhin e fotografisë, duke përdorur sa më shumë fjalë, në të cilat takohen dy zanore.			
*Mund të shfrytëzohen pjesë leximi nga teksti, në të cilat nxënësit do të veçojnë fjalët që kanë këto grupe zanoresh.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Përvoja personale		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat e rrëfimit - Ritregon rrëfimin në vetën e parë sikur të jetë vetë pjesëmarrës. - Tregon një përvojë personale - Krahason përvojën e tij me rrëfimin e dëgjuar. - Vlerëson rrëfimet e shokëve 		Fjalët kyçe: Rrëfim realist Përvojë personale Hyrje, zhvillim, mbyllje Hajdute e librave	
Burimet: teksti i nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Parashikim me anë të titullit, shkrim i lirë</i>			
<p>Organizimi i orës së mësimt</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Parashikim me anë të titullit</i></p> <p>Dëgjoni titullin e pjesës “Hajdutja e librave”. Çfarë mendoni se do të dëgjoni? Nxënësit bëjnë parashikimet e tyre. Në fund zgjedhin nxënësin, i cili ka bërë parashikimin më të mirë.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Shkrim i lirë</i></p> <p>Dëgjoni me vëmendje rrëfimin realist të mëposhtëm “Hajdutja e librave”. Ritregojeni këtë rrëfim në vetën e parë, sikur të jeni edhe vetë pjesëmarrës në të. Gjatë ritregimit, nxënësit kanë parasysh elementët e mposhtëm.</p>			
Varianti 1: Personazhi që rrëfen është nxënësi			
<p><i>Ditë gushti. Pasdite vonë. Po shikoja se si Lizeli po ndiqte me vëmendje hedhjen me litar të Kriatina Mylerit. Rudi kishte marrë biçikletën e vëllait dhe u qëndroi para këmbëve. Ia la biçikletën Lizelit dhe vrapoi në shtëpi të merrte të tijën. U larguan të dy me biçikletë dhe pashë nga larg se po vështronin diku... I lanë biçikletat dhe kapërcyen oborrin. U futën brenda dhe në duart e Lizelit të qullura nga djersa, qëndronte “Fjalori i plotë Duden”. I tha Rudit se kishte në duar një fjalor. Ai i dha biçikletën dhe u nisën. Lizelit i dukej se kishte një vështrim pas shpatullave të saj që po e ndiqte. Ktheu kokën nga shtëpia e kryetarit dhe dhoma e bibliotekës dhe pa gruan e kryetarit që ia bëri me dorë asaj, hajdutes së librave... Lizeli nuk hezitoi dhe ia ktheu përshëndetjen. Ndaluan te ura të dy me Rudin dhe pashë se po i hidhnin një sy librit të zi e të rëndë. Rudi tërhoqi një fletë prej tij dhe dëgjova t`i drejtohej Lizelit se në të kishte lexuar emrin e saj. Ajo u shtang e mori letrën në duar.</i></p>			

Varianti 2: Personazhi që rrëfen është Lizeli

Në një ditë në fund gusht, pasdite vonë po shihja Kristina Mylerin, që po hidhej me litar në rrugën Himel. Rudi Shtajner i qëndronte përpara me biçikletë dhe e pyeti nëse kishte kohë të merrej me të. Rudi më tha të merrja biçikletën dhe të pedalonim deri në rrugën "Grande". E pyeta se ku do të shkonim, po nuk m'u përgjigji... Pas pak, duke vështruar përtej një bredhi, pashë një dritare të mbyllur dhe një gjë që mbështetej pas një xhami.

E kisha ndarë mendjen se ia vlente të sakrifikoje për të vjedhur libra. Lashë biçikletën, vështrova dhe një herë rrugën dhe kapërceva oborrin. Duart po më dridheshin nga nervat si në atë kohë kur mora "Fërshëllyesin". Pashë një libër i cili qubej "Fjalori i plotë Duden" dhe ia tregova dhe Rudit. E mora fjalorin, po një ndjesi sikur dikush po na vëzhgonte, ishte ende te unë. Vëzhgova nga shtëpia e kryetarit. U trondita kur pashë gruan e tij, e cila po vëzhgonte çdo lëvizje timen e si për ta vërtetuar këtë, më ngriti dorën për të më përshëndetur mua, hajduten e librave. I ngrita dhe unë dorën. Nuk i thashë asgjë Rudit gjatë rrugës për në shtëpi. Kur arritëm te ura, Rudi mori një fletë nga fjalori e më tha se në të kishte lexuar emrin tim, Lizel. U çudita dhe shtanga. Mora letrën dhe nuk dija ç'të bëja me të.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Tregoni një përvojë personale për të cilën mendoni se është e ngjashme me rrëfimin e dëgjuar. Bëjini pyetje njëri-tjetrit rreth përvojës së treguar. Jepni sugjerime të mundshme për të ndryshuar mbylljen e historisë.

Vlerësoni me notë historitë e treguara nga shokët tuaj, duke u përqendruar në elementet e skedës së mëposhtme.

	5	6	7	8	9	10
Tema: interesante, e bukur, e dëgjuar më parë						
Mimika dhe pantomimika: të pëlqyeshme						
Detajet: interesante, të bukura, të gjetura						
Toni i zërit dhe pauzat: në përputhje me llojin e rrëfimit						

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin e karakteristikave të rrëfimit, për krahasimin e përvojës personale të dëgjuar me përvojën personale të tij, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani përmbledhjen e romanit tuaj të preferuar, duke e vënë veten në rolin e protagonistit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga fjalët e huaja.		Situata e të nxënimit: Bisedë	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: fjalë të huaja	
Nxënësi/ja:		Bashkëtingeloret d/,t/,l/,c/,ll	
<ul style="list-style-type: none"> - shqipton si duhet fjalët e huaja që kanë bashkëtingeloret/ d/,t/,l/,ll/,c/ - shkruan saktë fjalët e huaja që kanë këto bashkëtingelore - formon fjalë të prejardhura që kanë këto bashkëtingelore dhe formon fjali me to. 		drejtshqiptim drejtshkrim	
Burimet: teksti i nxënësit, libri "Shqipja standarde", shkumës me ngjyra, fletore, "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe"		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve: Bisedë, Diskutim, Punë në dyshe, Punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *bisedë.*

Zhvillohet një bisedë të lirë me nxënësit në lidhje me fjalët e huaja që përdoren në gjuhën shqipe. Sqarohen nxënësit që këto fjalë shqiptohen dhe shkruhen sipas disa rregullave të caktuara. Këto fjalë i përkasin kryesisht terminologjisë shkencore.

Ndërtimi i njohurive të reja: *diskutim*

Prezantohet në tabelë titulli i mësimit. Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në faqen 202.

Nxënësit do të lexojnë në heshtje informacionin e dhënë dhe më pas paraqiten fjalët me burim nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja.

Këto fjalë shkruhen me **d, t** dhe jo me **dh, th**: dekagram, diplomaci, diplomë, etnografi, aritmetikë, maratonë, termik...

Shkruhen me **d, t** edhe emrat e përveçëm: Afërdita, Demokriti, Leonida, Maratona, Tesalia, Trakia...

Shkruhen me **l** dhe jo me **ll**, fjalët nga greqishtja e vjetër: ambulancë, atlas, balonë, diplomaci, kolos, lustër, tablo, etj.

(Sqarohet që fjala atlas, pëlhurë e mëndafshhtë, me shkëlqim nga njëra anë, shkruhet me ll)

Emrat e përveçëm latinë dhe grekë: Apolonia, Atlantik, Peloponezi, Platoni...

(përjashtohen fjalët: apostull, bllok, dishepull, konsull, llogari...)

Fjalët nga latinishtja e greqishtja, që kanë bashkëtingëlloren **c** që ndiqet nga zanorja **i, e**: certifikatë, ciklamin, deficit, konciz, recension, central, cerebral... (përjashtohen: biçikletë, çiklizëm, motoçikletë...)

Flalët me burim nga anglishtja shkruhen me **l**: golf, kloun, klub...

Përdoren me **ll**: basketboll, hendboll, penallti, futboll

Shkruhen me **l** fjalët e burimit sllav: bolshevik, kolkoz, polak...

Shkruhen me **ll** fjalët: bjellorus, sllav, sllovak, Bjellorusi

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi I: *(Punë në dyshe).* Nxënësit mbyllin librin dhe shkruajnë në fletore nga 10 fjalë të burimit latin e grek.

Nxënësit kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 2. Nxënësit lexojnë me vëmendje fjalët me burim nga anglishtja dhe gjuhët sllave. Ato fjalë që nxënësit i kanë shqiptuar, apo i kanë shkruar deri tani gabim, do t'i rishkruajnë në fletore.

Hapi II: Ushtrimi 3 *(punë e pavarur)* Një nxënës punon në tabelë.

Nëvizohen fjalët e shkruara gabim dhe shkruhen saktë në fletore.

dialog, diplomë, diplomaci, olimpiadë, pedagogji, antologji, aritmetikë-aritmetikë, pathollog-patolog, patos, Herodoti, Thesalia-Tesalia, Maratona, Hietra, Iliada, dhjak, idhull, dhespot, Theodhor, Kleanth, ballonë-balonë, dialloj-dialogoj, llotari-lotari, lluks-luks, tablo-tablo, sandalle-sandale, Apollonia-Apolonia.

Fjala: despot - sundimtar me pushtet absolut, dhespot - titull fetar në kishën ortodokse, ndërmjet priftit dhe mitropolitit

Kërkesë shtesë. Me fjalët e qortuara, formoni fjalë të prejardhura dhe krijoni fjali me to. (emrat e përgjithshëm)

Diplomë - i diplomuar, i padiplomuar, dialloj-dialogues, jodialloj

Aritmetikë - aritmetikore (veprime) luks-luksoz

Patolog-patologji, patologjik

(Jo nga të gjitha fjalët formohen fjalë të prejardhura).

Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimin e rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi nr.4, sipas kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Drejtshkrimi i nyjës së përparme të emrave (i,e,të,së)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -njeh rastet e përdorimit të nyjës i, e, të, së te emrat -përdor drejt nyjën i, e, të, së te emrat në gjinore, dhanore, a rrjedhore -argumenton përdorimin e nyjës i, e, të, së te emrat		Fjalët kyçe: nyjë i, e, të, së rasë gjinore dhanore rrjedhore përdorim i drejtë	
Burimet: teksti i nxënësit, libri "Shqipja standarde", fletore, shkurtes me ngjyra, tabelë, tabakë letre		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë në dyshe, Shpjegim, Diskutim, Punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimt Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Punë në dyshe, shpjegim</i> Prezantohet në tabelë tema e mësimt dhe shkruhen disa fjali që kanë emra të nyjshëm. Oborri i shkollës gumëzhin nga zërat e nxënësve. <ul style="list-style-type: none"> - <i>Punimet e portofolit të nxënësve, janë të bukura.</i> - <i>Krijimet e një nxënësi të klasës sonë, janë të realizuara.</i> - <i>Arritjet e një nxënëseje të shkollës sonë në matematikë, janë të shkëlqyera.</i> - <i>Mbjelljet e stinës së pranverës, u realizuan në kohë.</i> - <i>Motivet e veshjeve të krahinës së Vlorës, të Mallakastrës, të Tepelenës, kanë ngjashmëri.</i> - <i>Studimi i rrjedhës së poshtme të lumit Vjosa, paraqet interes.</i> - <i>Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, organizoi në veprimtari festive me nxënësit e dalluar.</i> - <i>Rezultatet e provimeve të së motrës, i mori vesh të nesërmen.</i> - <i>Dajës së Valbonës i erdhi një letër nga një grup nxënësish të shkollës sonë.</i> Përbri tyre vendosen rregullat përkatës dhe nxënësit, në dyshe sipas bankave, do të shoqërojnë rregullin me rastin përkatës. Vendoset nga një numër bri fjalive. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim</i> Prezantohen përgjigjet e nxënësve. Diskutohet në lidhje me to dhe shpjegohen rastet, të cilat janë të paqarta për nxënësit, duke sjellë edhe shembuj të tjerë të ngjashëm. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë e pavarur</i>			
Ushtrimi 1 *Ndiqet e njëjta procedurë e ndjekur gjatë situatës së të nxënit. Nxënësit do t'u vendosin rregullave të paraqitura në libër nga një numër dhe më pas, këtij numri do t'i përkojë edhe grupi i fjalëve të ushtrimit 1.			
Ushtrimi 2 dhe 3. Vendoset nyja e përparme në vend të pikave. Një nxënës do të punojë në tabelë, kurse klasa do ta ndjekë punën në fletore. Pas vendosjes së nyjës, nxënësit do të thonë edhe rregullin përkatës. <p>recitimi i nxënësës së talentuar sipas një fjale të urtë të popullit tonë ushtrimet e lëndës së matematikës, të fizikës, të kimisë, të informatikës punimet e një nxënëseje të talentuar vlerësimi i këngës së bukur të fëmijëve</p>			
Ushtrimi 4. gomat e makinës së re ..i fjalës së rëndë nga ajo e ngrohtë ardhja e ditëlindjes së të birit dritaret e një shtëpie të vogël përpara forcës së të ardhmes fletorja e në nxënëseje të klasës.			

Vlerësimi: Vlerësohet pjesëmarrja gjatë orës, veprimet në situatë, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë.
Detyrat dhe puna e pavarur: Vendosni nyjat e përparme dhe shpjegoni përdorimin e tyre, cilësia e verës... Përmetit, përmirësimi i cilësisë... verës... Përmetit, në rendin e ditës... konferencës, vajzës së tij... dashur, vajtimi i... shkretës dhe... mjerës nënë, historia e luftës... popullit shqiptar, stina e pranverës... këtij viti, fjala e nderit... shqiptarit, kujtimet e... kaluarës, frytet e fitores... ...resë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Djali me pizhame me vija (ora e parë)		Situata e të nxënit: Sekuencë nga filmi https://www.youtube.com/watch?v=9ypMp0s5Hiw	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: pizhame me vija; ushtarë; gardh; Poloni; Gjermani;	
Nxënësi/ja			
<ul style="list-style-type: none"> - Gjykon fatin e hebrenjve gjatë luftës së dytë botërore. - Dallon fabulën, përmbajtjen dhe subjektin e fragmentit. - U përgjigjet pyetjeve për të kuptuarit e tekstit. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri “Djali me pizhame me vija”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Historia; Të drejtat e njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë; lexim zinxhir; diskutim; pyetje-përgjigje</i>			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>bisedë</i>			
Shohim në videoprojektor një sekuencë nga filmi: “Djali me pizhame me vija”			
Nxënësve u shtrohet pyetja: “Ç’dini për fatin e hebrenjve gjatë luftës së dytë botërore?”			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim zinxhir, diskutim.</i>			
Prezantohet tema dhe lexohet pjesa nga nxënësit.			
Lexohet dhe diskutohet informacioni në tekst rreth fabulës, përmbajtjes dhe subjektit të një veprë letrare.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Pyetje-përgjigje.</i>			
Ushtrimi 1. Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.			
- Duke u nisur nga informacionet që marrim në tekst, për çfarë lloj kampi mendoni se flitet? <i>Kamp nazist (përqendrimi; burgimi)</i>			
- Si visheshin njerëzit brenda gardhit të kampit? <i>Në kamp të gjithë visheshin njësoj, me të njëjtat pizhame e kapele me vija;</i>			
- Po në shtëpinë e Brunos? <i>të gjithë ata që endeshin nëpër shtëpi (përveç mamit, Gretelit dhe atij vetë) vishnin uniforma me cilësi të ndryshme dhe dekorata, kapele ose helmata, mbanin shirita kuqezi të ndritshëm.</i>			
- Kush ishte pjesëtari i vetëm i familjes që e kalonte gardhin me tela? <i>Babai</i>			
- Kush tjetër, nga ata që njihje Brunoja, kishte të drejtë të kalonte në të dyja anët e gardhit? <i>Ushtarët</i>			
- Ç’po bënte Brunoja, kur dalloj djaloshin e vogël brenda gardhit? <i>Po eksploronte</i>			
- A kishte ndonjë shenjë dalluese në rrobat e djalit? <i>Në krah kishte një shirit me një yll</i>			
- Çfarë i bëri përshtypje Brunos te Shmueli? <i>Brunoja mund të bënte be që si kishin zënë sytë kurrë më parë ndonjë djalë më të dobët dhe më të pikëlluar se ai</i>			
- Pse autori e përshkruan me detaje të hollëshme fytyrën e djalit? <i>Për të treguar se pafajësia e këtij fëmije është shndërruar nga dhembja dhe vuajtja në kamp. Imazhi fizik vjen i shpërfytyruar në nivele të larta.</i>			
- Çfarë kërkon të vërë në dukje? <i>Brenda kampit nuk bënin dallim as fëmijët.</i>			
Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Shikoni të plotë filmin “Djali me pizhame me vija” dhe shkruani një ese rreth tij.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Djali me pizhame me vija (ora e dytë)		Situata e të nxënimit: Pësimet e hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Nxënësi/ja: - Krahason tipare të fizikut dhe karakterit të djalit polak dhe atij gjerman. - Interpreton simbolikën e gardhit që ndan fëmijët dhe realitetin e secilit. - Analizon mungesën e lirisë te individi, nisur nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 		Fjalët kyçe: gardhi me gjemba; mungesa e lirisë; ndjenja; të ndryshëm; të ngjashëm	
Burimet: Libri: “Djali me pizhame me vija” Filmi: “Djali me pizhame me vija” Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Historia; Të drejtat e njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, tabela e krahasimit, punë individuale, punë dyshe, kllaster</i>			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi i parë: Lexohen dy-tri përshtypje të nxënësve rreth filmit “Djali me pizhame me vija”			
Hapi i dytë: <i>diskutim</i> . Punohen ushtrimet 2 dhe 3.			
2. Në tekst, vihet në dukje se emri Shmuel është emër shumë i përhapur, një duzinë, ndërsa ai i Brunos i përveçëm, <i>i vetmi</i> . Në kuptim të figurshëm, ç’kërkon të na tregojë rrëfimtari me këtë? <i>Kjo gjë përfaqëson filozofinë e pushtimit gjerman, mbizotërimin e racës së pastër ariane. Emri i veçantë, tregon në mënyrë simbolike, atë çka kërkonin të tregonin gjermanët: veçantinë e racës së tyre.</i>			
3. Mes dy djemve të së njëjtës moshë që jetojnë kaq pranë njëri-tjetrit, qëndron një gardh. Gjeneri në tekst sa herë përmendet fjala “gardh” (5 herë) dhe shpjegoni çfarë simbolizon ai, duke iu përgjigjur pyetjeve: <u>Nxënësit punojnë me fjalorin e gjuhës shqipe.</u> - Përse nevojitet gardhi me gjemba? <i>gardh - kuptimi i parë i kësaj fjale është ndarje fizike, territoriale kuptimi i figurshëm - ndryshim/ndarje botëkuptimi, formimi, ideologjie.</i> - Si e përjetojnë Brunoja dhe Shmueli telin që i ndan? <i>Teli me gjemba nuk ekziston për fëmijët. Naiviteti, brishtësia dhe pafajësia e fëmijëve nuk mund të jetë pjesë e ideologjisë së të rriturve.</i> - A janë ata plotësisht të ndërgjegjshëm për të? <i>Jo, nuk janë plotësisht të ndërgjegjshëm për telin (ndryshimin) mes tyre.</i>			
Hapi i tretë: Ushtrimi 4 (tabela e krahasimit) Duke u nisur nga informacionet e marra nga teksti dhe nga fotografitë që e shoqërojnë atë, bëni krahasimin mes Brunos e Shmuelit.			
a. Krahasojmë portretet fizike. Shmueli e ka lëkurën e fytyrës pothuajse ngjyrë gri... <i>Brunoja e ka lëkurën e fytyrës të bardhë e të pastër</i>			
b. Krahasojmë familjet, edukimin. Prindërit e Brunos janë gjermanë dhe babai i tij është ushtarak me uniformë... <i>Prindërit e Shmuelit janë polakë, nëna e tij ka qenë mësuese dhe babai orëndreqës.</i>			
c. Krahasojmë rrethanat në të cilat kanë lindur dhe jetojnë. Brunoja jetonte në Berlin, por u largua prej andej kur babai i tij u bë komandant i kampit... <i>Shmueli jetonte në Poloni, por u largua prej andej kur i internuan në kamp</i>			
d. Krahasojmë gjendjet e tyre shpirtërore. Brunoja ishte i pakënaqur që ishte detyruar të largohej, i vetmuar... <i>Shmueli ishte i trishtuar që ishte i detyruar të jetonte në kamp</i>			

Hapi i katërt: Ushtrimi 5 (diskutim). Si i kuptoni fjalitë: “Ku qëndronte ndryshimi? - pyeste veten. – Dhe, kush e vendosi se kush duhet të vishte pizhame me vija dhe kush duhet të vishte uniformë?” Ku qëndron dilema e djalit?

Dilema e djalit lidhet me pabarazinë mes njerëzve. Ai arrin të kuptojë, se njerëzit brenda gardhit ndryshojnë me ata matanë gardhit nga veshja, por nuk kupton ndryshimin brenda racës njerëzore. (Pa marrë parasysh ndasitë racore, apo politike që femijët me naivitetin dhe pafajësinë e tyre, nuk mund t'i kuptojnë, ai e sheh të ngjashëm me veten djalin brenda gardhit).

Hapi i pestë: Ushtrimi 6 dhe 7 (punë individuale)

6. Përshkruani përjetimin emocional të Brunos gjatë takimit me Shmuelin.

Bruno tronditet si pasojë e reflektimit të ndryshimeve që sheh mes vetes dhe djalit me pizhame.


7. Në paragrafin e parë përdoren fjalët antonime të ndryshëm/njësoj. Shpjegoni përdorimin e tyre për njerëzit në të dyja anët e gardhit. Nxënësit punojnë me fjalorin e gjuhës shqipe.

Njerëzit brenda gardhit dukeshin të gjithë njësoj dhe ata matanë gardhit të ndryshëm. E gjithë kjo tablo sështë gjë tjetër, vetëm se kontrasti i jetës mes dy grupimeve.

Hapi i gjashtë: Ushtrimi 8 (punë dyshe). Gjeni në tekst epitetet me të cilat përshkruhet gjendja e Shmuelit, në çastin kur takohet me Brunon.

Fytyrë e çuditshme; sy të pikëlluar; lëkurë gri; grije të paparë

Hapi i shtatë: 9 - Si mendoni, çfarë ndjenjash shkakton mungesa e lirisë tek individi? (klaster)



Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 10/fq. 39. Reflektoni rreth shprehjes: *Të ndryshëm, por të ngjashëm.*

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: “Zakonet dhe traditat tona” Projekt (ora e parë)		Situata e të nxënësve: Situata lidhet me temën “Zakonet dhe traditat tona” Nëpër këngë, përralla, legjenda dhe në rrëfenjat popullore, shpesh hasim tradita të ndryshme, të cilat lidhen me dashurinë, punën, besën, etj.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> -ndan detyrat qetësisht gjatë diskutimeve në klasë, në mënyrë që të zhvillojnë një projekt së bashku; -bashkëbisedon lirshëm me shokët duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij, si dhe duke respektuar edhe mendimet dhe gjykimet e të tjerëve; -shpreh mendimet dhe këndvështrimet e tij -pasuron linjën e debatit me argumente duke respektuar etikën; -bashkëpunon në grupe rreth detyrës së dhënë; -jep kontributin e tij gjatë punës në grup sipas rolit që i caktohet. 		Fjalët kyçe: Tradita Zakone Informacione Dasmë Gatime Veshje Këngë Valle Letërsi gojore	

<p>Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të përgatitura nga mësuesja dhe nxënësit, foto nga interneti.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Brainstorming, pyetje-përgjigje, analizë rasti, mendol/puno në dysbe/shkëmbe me të tjerët, mbajtja e shënimeve.</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimin Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Brainstorming, pyetje-përgjigje.</i> Mësuesi/ja hyn në klasë dhe pasi është përshëndetur me nxënësit pyet: - <i>Fjalët përshëndetëse si edhe ngritja në këmbë kur vjen dikush, janë zakone apo rregulla?</i> - <i>Cili është qëllimi i kryerjes së këtyre veprimeve?</i> - <i>Çfarë tregojnë ato?</i> - <i>Po në letërsinë gojore, a ndeshemi me tradita, apo zakone?</i> - <i>A mund të sillni ndonjë shembull nga mësimet e kaluara?</i> Nxënësit japin mendime të ndryshme duke argumentuar përgjigjet e tyre. Traditat dhe zakonet, janë sjellje të cilat kanë si qëllim rregullimin e marrëdhënieve në shoqëri. Ato ndryshojnë sipas krahinave, apo zonave. Ato përfshijnë gjithashtu edhe mënyre jetese, kulturë e veçori. Mësuesi/ja bën një përmbledhje të përgjigjeve të nxënësve dhe njeh nxënësit me temën e projektit. Shkruan në tabelë temën dhe u kërkon nxënësve që të plotësojnë me radhë në tabelë një kllaster rreth njohurive që kanë mbi traditat dhe zakonet. Nxënësit japin ide të ndryshme për të plotësuar kllasterin. Mësuesi /ja orienton dhe ndihmon nxënësit gjatë punës me kllasterin.</p> <p>Njëkohësisht me klasën zhvillohen pyetje të ndryshme si: - <i>Çfarë kuptojmë me tradita dhe zakone?</i> - <i>Ku i ndeshim ato?</i> - <i>A mund të përmendni disa nga zakonet dhe traditat që respektohen në familjen dhe krahinën tuaj?</i> Nxënësit japin idetë e tyre mbi konceptin që kanë mbi traditat dhe zakonet. Mësuesi/ja mund të sjellë materiale të gatshme nga interneti me foto e video mbi traditat dhe zakonet, por mund të jenë porositur edhe nxënësit më parë për të sjellë materiale. Diskutojnë rreth përgjigjeve të nxënësve dhe plotësojnë njëri-tjetrin me zakone dhe tradita nga zona, apo krahina.</p> <div data-bbox="446 1205 1157 1518" style="text-align: center;"> <pre> graph TD A(Traditat dhe zakonet) --> B[Mite] A --> C[Sjellje] A --> D[Stili arkitekturor] A --> E[Veshje] A --> F[Gatime] A --> G[Legjenda] A --> H[Dasma] A --> I[Këngë] A --> J[Valle] </pre> </div> <p>Nxënësit përmendin disa përralla, legjenda dhe krijime të tjera popullore duke veçuar detajet më tipike, si: fjala e dhënë, besa, nderi, ringjallja, murosja, rinjohja. Nxënësit përmendin: “Kalaja e Rozafës”, “Ymer Aga”, “Konstandini dhe Doruntina”, “Gjergj Elez Alia”, etj. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Analizë rasti</i> Diskutohet mbi ruajtjen e traditave dhe zakoneve, si dhe mbi vlerat e tyre. Ky është edhe qëllimi i projektit që do të zhvillohet. Rikthehet vëmendja te përralla “Fjalë e grosh” dhe analizohet fotoja e tekstit. Nxënësit duhet të nxjerrin elementet që u bien në sy dhe që mendojnë se janë pjesë e traditave dhe e zakoneve tona. Përmenden: punimi i qilimave me dorë, minderet, çiftelia, vatra në mes të dhomës, veshja e malësorëve, dritaret e vogla, ngjyrat e ndezura, enët e gatimit, qëndrimi në qoshe e plakut, qëndrimi i të riut, etj. Mbi këto elemente, do të ndërtohet edhe zhvillimi i projektit.</p>	

Mësuesi/ja njih nxënësit me mënyrën mbi të cilën do të punohet projekti.
 Nxënësit do të ndahen në grupe dhe do të përgatisin materiale të ndryshme rreth traditave dhe zakoneve
 Hapi I: Ndarja e grupeve
 Hapi II: Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve
 Hapi III: Ndarja e punës dhe roli i secilit nxënës.
 Mësuesi/ja ndihmon në ndarjen e grupeve dhe orienton nxënësit në përzgjedhjen e punës së secilit, sipas mundësive dhe aftësive.



Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët, mbajtja e shënimeve.*

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur duke diskutuar me njëri-tjetrin mbi rolin e secilit në grup.

Caktohen grupet e ngritura:

- 1- Grupi i këngëve popullore, 2- Grupi i valleve, 3- Grupi i gatimeve tradicionale, 4- Grupi i veshjeve popullore
 5- Grupi i letërsisë gojore.

Secili grup punon dhe shkëmben ide mes anëtarëve për mënyrën e organizimit dhe prezantimit të projektit.

Nxënësit mbajnë shënime rreth detyrave të ngarkuara si dhe për afatin e dorëzimit të tyre.

Kryetarët e grupeve ngrihen me radhë për të prezantuar grupin dhe idetë që kanë shkëmbyer mes tyre.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit dhe grupet rreth ideve të tyre dhe zgjidhjeve për probleme të ndryshme që dalin gjatë diskutimeve.

Në fund të orës, lihen porositë për orën e dytë të projektit.

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore, nxënësit do të vlerësohen me shprehje mbi njohuritë që kanë për traditat dhe zakonet, mbi mënyrën e shprehjes së ideve, bashkëpunimin me grupin dhe respektimin e bërë gjatë diskutimit në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përgatitja e materialeve për orën e dytë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Drejtshkrimi i njëjës së përparme të mbiemrave dhe të përremrave pronorë.		Situata e të nxënit: Punë në dyshe	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: njëjës e përparme, i, e, të, së, rregulla, përdorim i drejtë	
Nxënësi/ja:			
-përdor drejt njëjën e përparme të mbiemrat dhe përremrat pronorë			
-formulon rregullin përkatës, nisur nga shembulli			
-argumenton përdorimin e njëjës së përparme të mbiemrat dhe përremrat pronorë			
Burimet: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, fletore, shkurtesha me ngjyra, tabelë, tabakë letre		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë në dyshe, Shpjegim, Diskutim, Punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Punë në dyshe.

Prezantohet në tabelë titulli i mësimit. Shkruhen disa grupe fjalësh që kanë në përbërjen e tyre mbiemra dhe përemra pronorë. Në anën tjetër të tabelës, vendosen rregulla të përdorimit të nyjës të mbiemrat dhe përemrat pronorë. Nxënësit, në dyshe sipas bankave, do të shoqërojnë grupin e fjalëve me rregullin përkatës. Rregullat duhen paraqitur sa më të qartë për nxënësit. Mund të paraqiten në këtë formë:



Shembujt, nxënësve mund t'u jepen të shpërndarë, në mënyrë që ta gjejnë vetë rregullin.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim, diskutim

Diskutohen së bashku me nxënësit rastet dhe shpjegohen paqartësitë që ata mund të kenë.

Jepen edhe shembuj të tjerë nga vetë nxënësit, ose mësuesja.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur. Ushtrimi 1, 2 dhe 3.

Është e njëjta procedurë e ndjekur gjatë situatës së të nxënës. Nxënësit do t'u vendosin rregullave të paraqitura në libër, nga një numër dhe më pas, këtij numri do t'i përkojë edhe grupi i fjalëve të ushtrimit 1.

Ushtrimi 2 dhe 3. Vendoset nyja e përparme në vend të pikave. Një nxënës do të punojë në tabelë, kurse nxënësit e tjerë, do ta ndjekin punën në fletore. Pas vendosjes së nyjës, nxënësit do të thonë edhe rregullin përkatës.

Ndërtimi i një shkolle më të bukur se e para.

Çmimi i parë iu dha nxënësës më të dalluar të shkollës.

Ndërtimi i më së bukurës shkollë.

Çmimi i parë iu dha më të dalluarës nxënësës të shkollës.

Kujtimi i motrës së saj të dashur e të paharruar.

Ndihmesa e një nxënëseje të dalluar.



Vlerësimi i më së bukurës këngë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen gjatë orës, veprimet në situatë, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, sipas kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: IX
<p>Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Unë dhe miqësia</p>		<p>Situata e të nxënit: Komento</p>  <p>Kur ti të fitosh, unë me krenari do i them botës: "Ky është miku im"</p> <p>Por kur të humbasësh, unë do të jem pranë teje duke të shtrënguar dorën dhe të të them: "Unë jam miku yt"</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon fjalën "miqësi", sipas këndvështrimit të tij. - Liston cilësitë e një miku të mirë. - Diskuton rreth shprehjeve për miqësinë në kartolinat e dhëna. - Gjen fjalë të urta kushtuar miqësisë. - Krahason vlerën e miqësisë me vlera të tjera njerëzore. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Miqësi Vlerë njerëzore Besnik Tolerant I sjellshëm</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësit, Folklori shqiptar</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Stubi mendimi, Shkrim i livë</i></p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: organizues grafik</p> <p>Çfarë është miqësia për ju?</p> <p>Çfarë cilësish duhet të ketë një njeri që të bëhet miku yt?</p> <p>Plotëso organizuesin grafik</p> 			

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim

Diskutojmë së bashku

Komentoni shprehjet e dhëna në kartolinat e mëposhtme:

Nxënësit do të japin mendimet e tyre



Më pas nxënësve u kërkohet të plotësojnë pyetësorin e dhënë në tekst.

Diskutojmë rreth çështjeve të pyetësorit

Cilat janë cilësitë që vlerëson më shumë te miku yt më i mirë?

Mbi të gjitha, nuk duron që miku yt më i mirë...

Si vepron kur mes teje dhe mikut tënd më të mirë lindin keqkuptime?

A arrin të flasësh lirisht për gjithçka me mikun tënd më të mirë?

Për çfarë flet më së shumti me mikun tënd më të mirë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë**

Shkruaj një tregim të shkurtër ku të zbulosh vlerat e tjera njerëzore që janë të lidhura me miqësinë.

(besimi, solidariteti, bashkëpunimi, zemërgjerësia, respekti, dashuria, etj.).

Nxënësit punojnë dhe më pas, diskutojnë rreth shkrimit të tyre dhe të shokëve, pra vlerësojnë të tjerët dhe mësohen të vetëvlerësohen.

Puna bëhet pjesë e portofolit të tij.

Vlerësimi:**Detyrat dhe puna e pavarur: Gjej 7 fjalë të urta që flasin për miqësinë.**

Miqësia e vërtetë është si shëndeti, nuk dimë ta vlerësojmë për aq kohë sa nuk e kemi humbur.

Miku i mirë është ai që vjen kur të tjerët ikin.

Miqësia është një mendim në dy zemra.

Më mirë ta durosh mikun, sesa ta humbasësh përgjithmonë.

Ari në zjarr provohet, miku në rrezik kuptohet.

Miku i mikut tim, është edhe miku im.

Miku i mirë të nderon shtëpinë, miku i vjetër nuk hidhet poshtë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim		Situata e të nxënësve: Minikonkurs (provojmë njohuritë)	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -dallon rastet e shkrimit të fjalëve njësh dhe ndaras të fjalëve -shkruan drejt fjalët që përdoren njësh dhe ndaras		Fjalët kyçe: fjalë që shkruhen njësh, fjalë që shkruhen ndaras, fjalë të përbëra, të përngjitura, togfjalësha, parim semantik, parim morfologjik	
Burimet: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, libri “Shqipja standarde”, fisha me fjalë, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Minikonkurs, Shpjegim, Punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Minikonkurs</i> Zhvillohet një minikonkurs në klasë me tre nxënës, të cilët shprehin dëshirën që të bëhen pjesë e tij. Nxënësit, përfaqësues të tri grupeve, do të tërheqin fisha me fjalë të fshehura dhe do të shkruajnë në tabelë këto fjalë, duke i korigjuar ose jo. 1. dy vjeçar (dyvjeçar), nëndrejtor, veri perëndim (veriperëndim), vendburim, shurdh-memec (shurdhmemec) 2. farë e fis (farefis), një qind (njëqind), kush-do (kushdo), gjithsecili, tjetërkush 3.me qënë se (meqënëse), pothuajse, barblete (bar blete) bojë ari, përsëgjalli (për së gjalli) Pranohen të gjitha përgjigjet e nxënësve. Qortimi i gabimeve dhe shpallja e fituesit, do të bëhen në vazhdimin e orës së mësimit. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Shpjegim.</i> Prezantohet tema e mësimit. Sqarohen nxënësit se shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras, mbështetet në parimin semantik (kuptimi leksikor i fjalëve) dhe në parimin morfologjik			
Shkruhen bashkë ato fjalë që nga ana leksikore shënojnë një koncept të vetëm dhe nga ana gramatikore sillen si një fjalë e vetme, kurse ndaras, ato fjalë që shënojnë koncepte të ndryshme dhe nga ana gramatikore janë pjesë e një togfjalëshi.			
Tërhiqet vëmendja e nxënësve tek informacioni i paraqitur në tekst dhe diskutohen me nxënësit të gjitha rastet e shkrimit të fjalëve njësh dhe ndaras. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur</i> Ushtrimi 1. Një nxënës punon në tabelë. Të tjerët punojnë në fletoren e tyre. besëlidhje, besëmirë, besëprerë, besëplotë, besëqen bojarrë, bojargjend, bojëmjaltë, duarbosh, duarartë, duarflori, duarkryq, duarlidhur, duarmpirë, ballëbardhë, ballëçelik, ballëdalë, ballëflori, ballëfshehur bashkëbisedim, bashkëbanor, bashkëpunim, bashkëbanim kryeqytet, kryeagronom, kryeartëtar, kryeartikull, kryeartë, kryebosh ndihmësdrejtor, ndihmësmjek, ndihmësmministër, ndihmësgjyqtar parabolë, paraburgim, paracaktim, parathomë pikëbashkim, pikëçuditje, pikëderdhje, pikëgrumbullim udhëdalje, udhëheq, udhëheqës, udhëçelës (ai që çan përpara me guxim, për të zbuluar të renë) gjysmëbosht, gjysmëdrejtëz, gjysmëfinale, gjysmëdjathtas vendbanim, vendarritje, vendburim, vendnumërim Ushtrimi 2. Nxënësit qarkojnë trajtat e sakta të fjalëve. (përgjigjet e sakta) Mirë se vjen, i parakohshëm, bojëbizele, juglindje, letërnjoftim, bashkatdhetar, vendqëndrim, bashkëjetesë, rrugëdalje, jokalimtare, kryeredaktor, katër mijë.			
Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3. Kërkesë shtesë. Formoni nga një fjali me fjalët e përngjitura dhe shprehjet.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Tema mësimore: Mes miqsh (ora e parë)	Situata e të nxënit: Unë dhe miqësia Jemi të rrethuar nga shoqëria dhe miqësia. Çfarë i bën ata të veçantë për ne?
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca qytetare 	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - dallon strukturën e një tregimi: hyrjen, zhvillimin, mbylljen; - gjen në tekst fjalët kyçe me anë të të cilave mbartet kuptimi dhe mesazhi i pjesës; - shpreh qartë idetë dhe i lidh logjikisht mes tyre; - përcakton njohuritë e mëparshme rreth temës për të cilën do të shkruajë; - merr pjesë në një diskutim në grup për t'u sqaruar dhe për të ndarë ide e opinione rreth temës; - shkruan rrëfime personale duke përshkruar, ose reflektuar mbi veten, mbi përvojat personale, ngjarjet e kaluara ose çështje personale; - shkruan tregime për tema që janë interesante për moshën. 	Fjalët kyçe: <p>Miqësi Shoqëri Sjellje Dashuri Mirëkuptim Falje Besim Mbështetje</p>
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, përvoja personale të nxënësve, foto e album fotografish.	Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pyetje-përgjigje, punë e pavarur, diskutim, ditari tripjesësh.</i>	
<p>Organizimi i orës së mësimt</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Pyetje-përgjigje, punë e pavarur.</i></p> <p>Rikujtohet tema e kaluar “Unë dhe miqësia” duke nxjerrë mesazhet që u punuan dhe veçoritë e temës.</p> <p>Mësuesi/ja shkruan në tabelë një shprehje: “<i>Miqte, ata të vërtetët, na bëjnë të reflektojmë për gabimet tona dhe na ndihmojnë për të ndryshuar sjelljet negative e këndvështrimet edhe pse ndonjëherë, na vënë në pozitë të vështirë</i>”.</p> <p>Shtrohen pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- <i>A ndani të njëjtin mendim?</i> 2- <i>Çfarë është miqësia për ju?</i> 3- <i>Cilin do ta quanit “mik të vërtetë”?</i> 4- <i>Çfarë i bën ata të veçantë për ne?</i> <p>Nxënësit japin përgjigje rreth pyetjeve si: Miqësia është gjëja më e shtrenjtë në jetë; Ata që të rrinë pranë në çdo situatë; Ai që ndodhet pranë teje në momente të vështira, por edhe të lumtura; Mik i vërtetë është ai që nuk të nxjerr sekretet, nuk të bën të ndihesh keq; Të veçantë i bën fakti që nuk ka rëndësi se si janë, ata janë me ne, etj.</p> <p><i>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit, që të shkruajnë në fletore. disa cilësi të miqve e shokëve të tyre.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>A mund të përshkruani disa cilësi të tyre?</i> - <i>Si janë për ju miqtë e vërtetë?</i> <p>Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në fletoren e klasës për të përshkruar cilësi të miqve të tyre.</p> <p>Nxënësit japin disa cilësi si: të përgjegjshëm, besnikë, e mbajnë fjalën, nuk gënjejnë, të ndihmojnë, etj.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur.</i></p> <p>Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re të mësimt “Mes miqsh”. Nxënësve u kërkohet që të punojnë me shokun për të gjetur radhën e duhur të paragrafëve të tekstit.</p> <p><i>Fragment i shkëputur nga romani “Mikesha gjeniale”, Elena Ferrante.</i></p> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 15px; padding: 10px; margin-top: 10px;"> <p>Informacion rreth shkrimtares: <i>Ferrante është autore e rreth një duzine romanesh, më të njohurat prej të cilave, janë ato të tetralogjisë “Mikesha gjeniale”, rreth dy vajzave të shkathëta dhe inteligjente nga Napoli, të cilat përpiqen të krijojnë hapësirë jetësore për veten e tyre, brenda një dhune dhe kulture të zhurmshme.</i> <i>Kjo seri romanesh përbëhet nga “Mikesha Gjeniale” (2012), “Mbiemri i Ri” (2013), “Ata që ikin dhe ata që qëndrojnë” (2014), dhe “Historia e fëmijës së humbur” (2015), e cila u propozua për Çmimin Strega, njëri nga çmimet kryesore letrare në Itali.</i></p> </div>	

Nxënësit në pjesën e mëposhtme duhet të vendosin numrat nga 1-5 para çdo paragrafi, duke ndjekur rrjedhën logjike të zhvillimit të ngjarjeve.

Punohet në heshtje. Në fillim në mënyrë individuale e të pavarur secili nxënës dhe më pas, në grupe të vogla dyshe.

Nxënësi i shënon në fillim numrat sipas mendimit të tij për radhën e paragrafëve, pastaj shkëmben idetë dhe zgjidhjen e ushtrimit me shokun, shoqen e bankës.

Më pas diskutohet në klasë për saktësinë e vendosjes së numrave.

Radha e numrave sipas logjikës së paragrafëve është: 2, 1, 4, 3, 5.

Nxënësit arsyetojnë mbi përzgjedhjen e bërë, duke ilustruar me shembuj nga teksti.

Shembujt nga teksti, p.sh.:

- 1- Një të diel, e shtyrë prej një ftese që kishte ardhur...
- 2- U futa brenda. Kishte radhë karrigesh të zëna qysh herët...
- 3- Ceremonia e vogël nisi...
- 4- Teksa dilnim, ndërkohë që Karmela u bashkua gjithë mllef...
- 5- “Ndoshta nuk jam dhe aq e shëmtuar, – mendova. – Ndoshta s’arrij ta shoh vërtet veten”.

Duke dhënë shembujt me ilustrime, nxënësit rikujtojnë edhe strukturën e një tregimi dhe gjejnë sipas shembujve edhe: Hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim, ditari tripjesësh.

Nxënësve u kërkohet që të nënvizojnë në tekst, fjalët kyçe të çdo paragrafi. Lexojnë me radhë fjalët kyçe, duke plotësuar njëri-tjerin.

Disa fjalë kyçe: *vlërësonte, libër, lexuesit, ceremonia, mësues Ferraroja, bibliotekë, prindër, nxënës, shikimi, gatuante, qeshja, Çerulo, çmimi, shoh veten, etj...*

Nxënësit punojnë me ditarin tripjesësh për të vendosur sipas paragrafëve fjalët kyçe, por edhe për të përmbledhur me një fjali secilin paragraf, duke bërë kështu një përmbledhje të shkurtër të tekstit.

<i>Paragrafi</i>	Një të diel, e shtyrë prej një ftese që kishte ardhur...	U futa brenda. Kishte radhë karrigesh të zëna qysh herët...	Ceremonia e vogël nisi...	Teksa dilnim, ndërkohë që Karmela u bashkua gjithë mllef...	“Ndoshta nuk jam dhe aq e shëmtuar, – mendova. – Ndoshta s’arrij ta shoh vërtet veten”.
<i>Fjalët kyçe</i>	të diel, ftese mësues Ferraroja bibliotekë, s’me pëlqeu vetja, prindërve dhe e fëmijëve	Kishte radhë, vlerësonte me nga një libër lexuesit, ceremonia	e pesta Elena Greko, pra unë. për të qeshur, familja Çerulo, çmimin tim, lavdërime, e falënderova	dialekt, Rinon, që i tretej shikimi mbi libra, Fernando këpucarin, Nuncia që gatuante, mund të lexonin tabelat e dyqaneve:	t’ia dorëzosh? duart e mia? Marrëzi Më pëlqeu, ta shoh vërtet veten”.
<i>Përmbledhja me një fjali</i>	Përgatitja e Elenës për të shkuar në ceremoni	Atmosfera në bibliotekë dhe të pranishmit që ishin në ceremoni	Ndarjet e çmimeve për lexuesit më të zellshëm	Përshkrimi me hollësi dhe mënyra e leximit të fituesve të çmimeve	Pëlqimi i vetes dhe dyshimi se mos Elena deri tani nuk e kishte njohur mirë veten

Lexohet dhe vlerësohet ditari tripjesësh, duke i kushtuar rëndësi gjetjes saktë të paragrafëve, gjetjes së fjalëve kyçe si edhe mënyrës së përmbledhjes të tekstit në një fjali të vetme.

Diskutohet për përgjigjet e sakta dhe sqarohen përgjigjet për të gjithë nxënësit.

Bëhet përmbledhja e orës duke nxjerrë:

1- temat që u trajtuan gjatë orës mësimore,

2- mesazhet që u përcollën si gjatë temës mësimore ashtu edhe gjatë diskutimit mes nxënësve.

Nxënësit japin disa tema që u punuan gjatë orës si: miqësia, shoqëria, ndershmëria, respekti, ndihma, etj.

Japin mesazhe si: E rëndësishme është të njohësh veten, të kesh shokë të mirë, ke gjetur një thesar, etj.

Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Duke u mbështetur te temat dhe mesazhet që nxirren, jepet një ese me temë: “Shoku/shoqja ime më e mirë”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Mes miqsh (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Unë dhe shoqëria. Kë konsideron “mik të vërtetë”? Ke bërë ndonjëherë diçka të veçantë për të? Po ai për ty?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon strukturën e një tregimi: hyrjen, zhvillimin, mbylljen - përshkruan personazhet e tij të preferuara dhe argumenton pëlqimin e tij; - shpreh qartë idetë dhe i lidh logjikisht mes tyre; - përcakton qëllimin, temën dhe subjektin për punët me shkrim, - njeh dhe zbaton në proces strategjitë e të shkruarit; - përcakton njohuritë e mëparshme rreth temës për të cilën do të shkruajë; 		<ul style="list-style-type: none"> Miqësi Shoqëri Sjellje Dashuri Mirëkuptim Falje Besim Mbështetje Tregim Strukturë 	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, përvojat personale të nxënësve, foto e album fotografish.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rrjeti i diskutimit, pyetje-përgjigje, organizuesi grafik, minileksion, punë e pavarur, punë e drejtuar, shkrimi i lirë.			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Rrjeti i diskutimit, pyetje-përgjigje.			
Lexohen detyrat e shtepisë me temë: “Shoku/shoqja ime më e mirë”. Nxënësit lexojnë dhe diskutohet mbi detyrat duke vlerësuar me shprehje: realizimin e temës, ndërtimin e fjalive, gjuhën e zgjedhur për të bërë përshkrimin, argumentet e dhëna dhe strukturën e esesë.			
Nxënësit mund të kenë shkruar për shokun/shoqen e tyre më të mirë të veçuar nga shoqëria, mund të kenë shkruar edhe për një mik a mikeshë familjare, apo për prindërit e tyre.			
Shtrihen pyetjet: <i>Përse këto personazhe veçohen nga të tjerët? Cilat janë tiparet që i dallojnë dhe i bëjnë më të mirë se të tjerët?</i>			
Veçohen tipare që i bëjnë këto personazhe si “më të mirë” se të tjerët.			
Disa përgjigje të sakta do të ishin:			
<ol style="list-style-type: none"> 1- Prindërit janë miqtë më të mirë, sepse ata na gjenden pranë në çdo situatë që ndodhemi. 2- Familjarët, motrat, vëllezërit, janë miqtë më të mirë, sepse kujdesen që ne të mos na mungojë asgjë. 3- Shoqja/shoku im i bankës, është miku im më i mirë, sepse ai më kupton më mirë se të gjithë. 4- Shoku im më i mirë është... sepse sa herë që kam pasur probleme, ai më ka ndihmuar. 5- Miku im më i mirë është... sepse ai di të ruajë të gjitha sekretet dhe më mbështet vazhdimisht. 6- Shoqja ime më e mirë është... për shkak se ne ngjasojmë shumë në ide dhe pëlqejmë të njëjtat gjëra. 			

Veçohen disa nga punimet më të mira të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Organizuesi grafik, minileksion.

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një grafik të thjeshtë, i cili ka lidhje me të shkruarit e një ritregimi dhe elementët përbërës të tij. Rikujtohen njohuritë e marra mbi tregimin dhe ritregimin e një teksti.

Organizuesi grafik sqaron pyetjet se ku duhet të mbështeten nxënësit për të bërë saktë një ritregim të një teksti të dhënë, të dëgjuar, apo të lexuar.



Minileksion rreth njohurive që nxënësit duhet të kenë për tregimin.

Tregimi është një tekst letrar në prozë, në të cilin përshkruhet a tregohet zakonisht jeta e një heroi a personazhi, pa dhënë në mënyrë të hollësishme se ç'ka ndodhur më përpara a më pas. Tregimi sipas gjatësisë së tij, mund të jetë i gjatë, ose i shkurtër. Shkruhet për qëllime personale. Tregimi mund të ketë edhe elemente fantastike, sipas temës që trajton. Autori rrëfen në vetën e parë, por mund të rrëfejë edhe në vetën e tretë, kur ai nuk është pjesë e ngjarjes. Tregimi ka një strukturë të rregullt dhe veçori e tij, është mbyllja e shkurtër.

Struktura e tregimit:

- 1- Hyrja: njihen personazhet, koha, vendi, etj.
- 2- Zhvillimi: fillon me zhvillimin e ngjarjes, e cila pas disa pikash lidhjeje, arrin kulmin. Pas kulmit, situata dhe konflikti, pësojnë rënie.
- 3- Zgjidhja: jepet me përfundimin e ngjarjes. Këtu përcillet mesazhi nga autori.

Te hyrja jepen të dhëna që na njohin me: Personazhet e tregimit, vendin ku ndodh ngjarja, kohën kur ndodh ngjarja.

Gjatë zhvillimit të tregimit, njihemi me: situatat, ngjarjet, konfliktet që ka gjatë rrjedhës së ngjarjes, personazhi apo personazhet, rrethanat lehtësuese, apo që vështirësojnë realizimin e qëllimit të vënë.

Te mbyllja jepet shkurt, pa u zgatur shumë përfundimi i ngjarjes, zgjidhja e situatës, por edhe ndonjë mesazh i fshehur, apo i drejtpërdrejtë nga autori.

Veçori të tregimit: 1- ka pak personazhe (1-2 personazhe kryesore), 2- ka vetëm një ngjarje kryesore, 3- hyrje dhe mbyllje të shkurtër, (rikujtojmë njohuritë mbi përrallën), 4- ka strukturë të rregullt, 5- ka dialog.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, punë e drejtuar, shkrimi i lirë.*

Nxënësve, pasi u përsëriten njohuritë për tregimin, u bëhet lidhja me temën “Mes miqsh” dhe me pjesën e parë të mësimi.

U kërkohet nxënësve që të shkruajnë një tregim të shkurtër me temë nga jeta dhe përvojat e tyre, ku të flasin për marrëdhëniet me të afërmit, apo me shokët e shoqet e tyre.

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të shkruar tregimin, i cili u bëhet i qartë nxënësve që mund të jetë nga një situatë reale, por edhe i trilluar prej tyre.

Mësuesi/ja gjatë orës, orienton nxënësit kur punojnë mbi strukturën e tregimit, ndërtimin e fjalive, elementet e tregimit, por edhe për gabimet drejtshkrimore.

Nxënësit punojnë të pavarur deri në fund të orës së mësimi.

Në fund, mblidhen detyrat e punimet e nxënësve për të bërë vlerësimin me notë të punës me shkrim.

Vlerësimi:

Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për mënyrën e zhvillimit me shkrim të temës. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje gjatë gjithë orës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIM

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim		Situata e të nxënit: Gara e fjalëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - rendit fjalë që shkruhen me vizë në mes - dallon rastet e përdorimit të fjalëve që shkruhen me vizë në mes - shkruan saktë të gjitha fjalët që kanë vizë në mes 		Fjalët kyçe: fjalë që shkruhen me vizë në mes, rregull përkatës, drejtshkrim.	
Burimet: teksti, fletore, shkurmes me ngjyra, libri "Shqipja standarde"		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Konkurs, Diskutim, Punë në grupe, Punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësim Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Konkurs, diskutim</i> Shkruhet tema e mësimi në tabelë dhe udhëzohen nxënësit, që të paraqesin në fletore sa më shumë fjalë që shkruhen me vizë në mes. Nxënësi që mbaron i pari, ngre dorën dhe klasa lë punën. Lexohen fjalët e shkruara nga nxënësi i parë, paraqiten në tabelë dhe numërohen. Fiton nxënësi që ka numrin më të madh të fjalëve të shkruara saktë. Për fjalët e paraqitura në tabelë, nxënësit përcaktojnë klasën e tyre. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në grupe</i> Sqarohen nxënësit se fjalët e shkruara me vizë në mes, janë ato njësi që shënojnë një koncept të vetëm, por që nga pikëpamja gramatikore, janë në rrugën e njëfjalësimit (bashkimi në një fjalë të vetme). Klasa ndahet në tre grupe, secilit grup i jepet për të studiuar pesë nga rastet e shkrimit të fjalëve me vizë në mes. Nxënësit do të shkruajnë në njërën anë të fletores fjalët dhe në anën tjetër, rregullin përkatës. Përdoren ngjyra të ndryshme. Një nxënës, përfaqësues i çdo grupi, prezanton punën e realizuar në fletore. Mund të përfshihen edhe nga dy nxënës për çdo grup, nisur nga numri i nxënësve në klasë. Gjatë prezantimit të rasteve të shkrimit të fjalëve me vizë në mes, sqarohen pasaktësitë dhe paqartësitë, që mund të kenë nxënësit. Shpjegohen rastet përjashtuese. Vlerësohen dhe përgëzohen nxënësit. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur.</i> Ushtrimi 1. Nxënësit do të punojnë në fletore, kurse një nxënës punon në tabelë. Mblidhen disa fletore për t'u vlerësuar. <i>Përgjigjet:</i> 110-vjetori i Mësonjëtores, 50-vjetori i lindjes së xhaxhait, shkolla 9-vjeçare, ngjarjet e 1997, shekulli i XXI, 16-ta është katër herë më e madhe se katra. Ushtrimi 2 Para dy vjetësh mora pjesë në një konferencë rinore në Lisbonë. Ishte konferenca e 12-të ndërkombëtare. Udhëtimi me avion <u>Tiranë- Lisbonë</u> ishte mjaft i këndshëm, pasi qëndruam mbi 5 orë në Vjenë të Austrisë. Nga aeroporti në Vjenë shkua me <u>tren-ekspres</u> . Në një konferencë, u njoha me disa <u>anglosaksonë</u> dhe frankogjermanë. Erdhën përfaqësues nga OKB-ja dhe ekspertë të <u>Unicef-it</u> . Ditën e 2 -të konferencës, unë kisha <u>ditëlindjen</u> . Ishte hera e parë që unë do ta festoja larg familjes e <u>farefisit</u> tim. Kur ora po i afrohej <u>12-ës</u> , unë numëroja <u>tik-takun</u> e saj. Sapo akrepat mbuluan <u>njëri-tjetrin</u> , i pari më telefonoi babi. Edhe gjyshen <u>85-vjeçare</u> nuk e kishte zënë gjumi. U emocionova shumë dhe nuk e përmbajta dot veten. <u>Hera-herës</u> u përloja. Më uruan dhe shumë bashkëmoshatarë. Dy prej tyre ishin nga <u>La Valeta</u> , ndërsa dy të tjerë nga <u>San-Salvadori</u> . Mos më pyesni sa vjeç isha. Ju jeni një <u>grup-moshë</u> me mua. Ne atëherë ishim nxënës në klasën e 9-të. Në varësi të kohës, detyra mund të vazhdohet në shtëpi.			

<p>Detyrë shtëpie (alternativë) Shkruani si duhet fjalët që formohen nga bashkimi i temave. korean+jugor proces+verbal fletë+hyrje një+mijë lule+mos+më+prek lule+mëllagë indo+evropian vajtje+ardhje bujqësor+industrial qen+ujk vaj+recini projekt+plan teknik+shkencor makinë+shkrimi</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit nisur nga pjesëmarrja gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimin e rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Doktor Gjilpëra (ora e parë)		Situata e të nxënit: Lidhet me gjendjen politiko-shoqërore, ekonomike, kulturore, historike, gjuhësore të Shqipërisë së viteve '20.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Shqipëri;	
<ul style="list-style-type: none"> - Dallon personazhet kryesore dhe dytësore. - Identifikon karakteristikat e prozës realiste. - Zbërthen dhe kupton brendinë e pjesës, duke iu përgjigjur pyetjeve në tekst. 		Doktor	
		Komisar	
		Ilaçe	
		Pasuri	
		Korrupsion	
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha Shqipe 9"		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim; skeda e autorit; lexim zinxhir; pyetje-përgjigje;</i>			

Organizimi i orës së mësim:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Diskutim*

Nxënësit janë lajmëruar paraprakisht për të sjellë në klasë informacione dhe foto për gjendjen politiko-shoqërore, ekonomike, kulturore, historike, gjuhësore të Shqipërisë së viteve '20.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Skeda e autorit, lexim zinxhir, kllaster.*

Hapi i I: Ndërtohet skeda e autorit, duke e plotësuar atë me të dhënat kryesore.

Faik Konica: *mars 1875 (Konicë) - dhjetor 1942 (Uashington)*

Shkollimi: *Kreu studimet e larta në Harvard (për letërsi)*

Angazhimet: *Ambasador i Shqipërisë në SHBA*


Veprat: *Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit; Katër përralla nga Zullulandi; Shqipëria si m'u duk...*

Dorëshkrime: *Shqipëria - kopshti shkëmbor i Evropës juglindore*

Ishte eseist, publicist, përkthyes, poliglot, figurë politike, gjithashtu një nga krijuesit e prozës moderne shqiptare.

Hapi i II: Nxënësit lexojnë njëri pas tjetrit pjesën e dhënë në tekst dhe nënvizojnë fjalitë ku del në pah satira.

Hapi i III: Me anë të kllasterit, nxënësit nxjerrin karakteristikat e prozës realiste.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *pyetje-përgjigje*

Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- Çfarë i bën përshtypje doktorit që në momentin e parë të mbërritjes në qytet? *Durrësi – me shtëpitë e bardha, me kullat rrumbullake të mbetura nga Koha e Mesme... duket për së largu, për udhëtarin që afrohet nga deti, një qytet përralle dhe bukurie...*

- Si përshkruhen njerëzit me të cilët takohet doktori? *njerëz të zinj e të verdhë, të ngrysur, të mvrenjtur, të parrojtur, të pakrehur, njerëz të mërëzitur nga bota dhe nga vetja e tyre.*

- Çfarë e bën të çuditshëm këtë vend krahasuar me vendet e tjera ku doktori ka qenë vizitor?

Dr. Gjilpëra kish kaluar shumë kufij, po asgjëkund s'kish gjetur një tërbim kërkues aq të madh.

- Si sillet komisarari me doktorin? *Sillet vrazhdë me një armiqësi të thatë.*

- Cila është arsyeja e kthimit të doktorit në Shqipëri? *Të vizitonte vendin e tij, Shqipërinë.*

- Pse ndryshoi sjellja mes doktorit dhe komisararit? *Sepse mësoi që doktori ishte i pasur (Posa dëgjoji për pasuri, fytyra e komisararit u zbut menjëherë).*

- Çfarë i kërkoi komisarari doktorit? I kërkoi ilaçe për gruan dhe fëmijët (Zoti doktor, kam grua e fëmijë dhe s'janë mirë nga shëndeti. Kini mirësinë të më falni ca ilaçe?) Si i përgjigjet ai? *Zoti komisar, s'kam prurë ilaç me vete, se ky udhëtim i parë që po bëj në Shqipëri, është vetëm për të shikuar vendin dhe për të zënë një shtëpi.*

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 / faqe 47. Çfarë kuptoni në mbyllje të pjesës? Interpretoni idenë kyçe që shfaqet aty.

Në mbyllje të pjesës, kuptohet që komisarari nuk është i vetmi i korruptuar, por kemi të bëjmë me një sistem të tërë korruptiv. Problemi real i shoqërisë shqiptare: shoqëri e prirur drejt materializmit; antiulerave.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Doktor Gjilpëra (ora e dytë)		Situata e të nxënimit: Lidhet me gjendjen politiko-shoqërore, ekonomike, kulturore, historike, gjuhësore të Shqipërisë së viteve '20.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja		Shqipëri	
<ul style="list-style-type: none"> - Zbulon cilësitë e personazheve kryesore, nisur nga fjalët, mendimet dhe veprimet e tyre. - Analizon tiparet e gjuhës së autorit në këtë pjesë. - Krahason mendësinë e kohës kur janë zhvilluar ngjarjet me mendësinë e ditëve të sotme. 		Doktor	
		Komisar	
		Ilaçe	
		Pasuri	
		Korrupsion	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim; punë individuale; marrëdhënie pyetje-përgjigje; punë në grup;			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: diskutim, punë individuale.			
Hapi i I: (diskutim)			
Diskutohet detyra e shtëpisë.			
- Nisur nga çfarë mësuar për satirën, a mendoni se dhe vetë titulli i pjesës “Doktor Gjilpëra” ka një domethënie satirike? <i>Dr. Gjilpëra është i dërguari i fatit dhe i dijes, për të injektuar në gjak të këtij populli, kohën konkrete. Është qesharake që bashkëkombasit e kuptojnë gjuhën e tij, por s'duan as t'ia dëgjojnë kuptimin. Prandaj Konica në realitet dhe në art, është dhe bëhet injeksioni i kësaj shoqërie, që çuditërisht nuk jep shenjat e dëshirës për shërim.</i>			
Ushtrimi 3. Analizoni mënyrën e sjelljes së komisarit me doktorin.			
<i>Sjellja e komisarit, tregon qartë nivelin e ulët të formimit të tij. Përballen dy botëkuptime: padija dhe injoranca kundrejt njeriut intelektual. Ç'cilësi të këtyre personazheve dalin në pah? Sa më tepër i paditurlinjorant shfaqet komisar, aq më tepër lartësohet figura e doktorit; i cili kishte një nivel të lartë formimi/botëkuptimi (shkolluar në vende të qytetëruara).</i>			
Hapi i II (punë individuale):			
Ushtrimi 2. Nënvizoni momentet ku doktor Gjilpëra vë në lojë oficerin.			
<i>U mejtova, - vazhdoi Dr. Gjilpëra, - se po të vija në Shqipëri dhe të shisja ca hape të çuditshme që shërojnë pa-një pa-dy gjithë sëmundjet e botës, aq sa dhe njerëzve që kanë mbetur me një mëlçi u rritet mëlçia tjetër, posa gëlltitin ato hape, - mejtova se do të kem myshterinj sa të dua, do të fitoj para pamasë.</i>			
Cila figurë letrare është përdorur në këto raste? <i>b.Sarkazma.</i>			
Ndërtimi i njohurive të reja: marrëdhënie pyetje-përgjigje, diskutim,			
Hapi I. Ushtrimet 4, 5, 8 (marrëdhënie pyetje-përgjigje):			
4. Duke gjykuar nga fragmenti që lexuat, renditni dy argumente që e bëjnë “Doktor Gjilpëren” një vepër me tipare të spikatura realiste.			
<p><i>a. Dimë që rrëfimet realiste e marrin tematikën e ngjarjeve që trajtojnë nga realiteti. E njëjta gjë ndodh në fragmentin nga “Doktor Gjilpëra”, ku tema që mbizotëron, është mendësia e prapambetur e Shqipërisë së viteve '20.</i></p> <p><i>b. Tipari kryesor realist është vlera gjithëkohore që kanë këto vepra, pra janë reale në çdo kohë.</i></p> <p><i>c. Vendet dhe personazhet që janë përmendur në pjesë, janë reale (Durrës, Shqipëri, Tiranë / komisar, doktor)</i></p>			
5. Satira e Konicës, ndërtohet nga përdorimi mjeshhtëror i detajeve, të cilat e bëjnë atë moderne, origjinale e të natyrshme. Gjeneri tri të tilla dhe nënvizojini në tekst.			
<p><i>a. përdorimi i turqizmeve (Halld ettin; melun; mesh'hur)</i></p> <p><i>b. përdorimi i dialogut</i></p> <p><i>c. sarkazma e përdorur (aq sa dhe njerëzve që kanë mbetur me një mëlçi u rritet mëlçia tjetër, posa gëlltitin ato hape)</i></p>			
8. Vendosi shenjën V tek ato pohime që mendoni se përputhen me tiparet e gjuhës së kësaj pjesë. (punë individuale)			

- Gjuha e autorit përmban huazime nga turqishtja. V
- Stili i autorit është formal.
- Dialogët janë të shkurtër dhe kanë gjuhë të qartë.
- Në fragment ka batuta dhe fjalë humoristike. V

Hapi II: Ushtrimet 7 dhe 12 (diskutim).

7. Cili është përfytyrimi që krijoni për situatën e vendit në kohën e ngjarjes? Plotësojeni panoramën duke u bazuar në këtë fragment, por edhe duke marrë informacione nga burime të ndryshme për realitetin shqiptar në vitet '30. Krahasojeni atë realitet me të sotshmin (*paralelizmi me realitetin e ditëve tona*).

12. Mbani qëndrim ndaj sjelljeve të personazheve, duke i krahasuar ato. Paraqitni këndvështrimin tuaj.

Hapi III: Ushtrimet 9, 10 dhe 11 (punë në grupe): Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup, punon një nga ushtrimet 9-10-11. Në përfundim të punës, një përfaqësues i grupit lexon përgjigjet dhe nxënës të tjerë nga grupi ose klasa, mund të shtojnë, ose të plotësojnë.

9. Tregoni dallimin kuptimor mes fjalëve “ryshfet” dhe “dhuratë”.

Nxënësit punojnë me fjalorin e gjuhës shqipe për të gjetur kuptimin e fjalëve “ryshfet” dhe “dhuratë”

Ryshfet - Para ose diçka tjetër që i jepet falas nën dorë një nëpunësi, ose punonjësi në detyrë, që të bëjë një punë a një shërbim jashtë ligjit...

p.sh.: Njeri i ryshfeteve; i dha një ryshfet. Nuk merr (nuk ha) ryshfet. E dënuan për ryshfet.

Dhuratë - Send që i jepet dikujt pa asnjë shpërblim, diçka që i dhurohet a i falet dikujt.

p.sh.: Dhuratë e bukur. Dhurata të çmuara. Dhuratë simbolike. Dhuratat e Vitit të Ri. Dhuratë për ditëlindjen. Dyqani i dhuratave. Jap (marr) një dhuratë. Shpërndaj dhurata.

Cila prej të dyjave është përdorur në fragment? (*ryshfet*) A mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën? (*Jo*)

Pse? Sepse janë kuptimisht të kundërta. Ryshfeti është përfitim material, kurse dhurata “përfitim” shpirtëror.

10. Gjeneroni fjalët e huazuara dhe shpjegoni kuptimin e tyre.

melun – (turqizëm) i mallkuar, mesh'hur – (turqizëm) i mirënjohur, i famshëm halld ettin – (turqizëm) ç'na the!

Autori sjell më qartë idenë që do të përcjellë rreth injorancës dhe prapambetjes në figurën e komisarit.

11. Përjasni mendësinë e paraqitur në pjesën letrare me atë që hasni në jetën e përditshme. Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet? Sillni shembuj nga jeta juaj për të argumentuar përgjigjen.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Komentoni me shkrim këtë thënie të Konicës: “Përgjegjësia jonë ndaj vendit, është e pamohueshme: do vuajmë me vuajtjet e Shqipërisë, do gëzojmë me gëzimet e saj”. Kërkoni thënie të tjera të autorit, përzgjidhni atë që ju pëlqen më shumë dhe argumentoni pse.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Vdekja e nëpunësit (ora e parë)		Situata e të nxënësve: Përlulesia është dobësi, apo forcë karakteri?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyçe: portier; teatër	
Nxënësi/ja:		teshtimë; falje; belbëzoi; shkëlqesi; respekt; vdiq	
<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon tiparet e tregimit si lloj i shkurtër i prozës. - Diskuton për ngjarjen dhe personazhet. 			
Burimet: teksti i nxënësve “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	

<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stubi mendimi; kllaster; pyetje- përgjigje; diskutim</i></p> <p>Organizimi i orës së mësimit: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>stubi mendimi</i> Nxënësve u shtrohet pyetja: Si e kuptoni përluljen ndaj dikujt? Ndërtimi i njohurive të reja: <i>kllaster, lexim zinxhir.</i> Hapi I: Njëpërmjet kllasterit, nxënësit nxjerrin tiparet e tregimit.</p> <div style="text-align: center;"> <p><i>ngjarjet zhvillohen brenda një kohe të shkurtër</i></p> </div> <p>Hapi i II: Lexohet pjesa nga dy-tri nxënës. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>marrëdhënie pyetje përgjigje, diskutim.</i> Çfarë bëri Çervjakovi në Teatrin e Operës? <i>Teshtiu duke spërkatur kokën e Brizalovit</i> Punohen ushtrimet 2 dhe 3 (diskutim) 2. Në këtë tregim vendosen pranë dy personazhe. A ka ndonjë raport miqësor, apo pune mes tyre? <i>(Jo)</i> Ç'përfaqëson secili prej tyre? <i>Dy pozita shoqërore të ndryshme (vartës; epror)</i> 3. Ngjarjen që ndodhi në Teatrin e Operës, Çervjakovi: E mori me zell të tepruar për t'u shfajësuar.</p> <p>Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Luajeni në role këtë pjesë, duke u përpjekur të transmetoni botën e brendshme të personazheve të saj.</p>
--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Vdekja e nëpunësit (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Përlulësia është dobësi, apo forcë karakteri?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: portier; teatër; teshtimë; falje; belbëzoi; shkëlqesi; respekt; vdiq	
<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon njëpërmjet detajeve sjelljen e dy personazheve. - Interpreton lidhjen ndërmjet titullit të tregimit dhe fundit të Çervjakovit. - Analizon gjuhën e tekstit. 			
Burimet: teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë në grup; diskutim; punë individuale;</i>			

Organizimi i orës së mësim:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: punë në grup

Pasi nxënësit janë njohur me pjesën në orën e parë, ndahen në katër grupe dhe punojnë ushtrimet 4, 5, 6 dhe 7. (punë në grupe)

Grupi i parë: 4. Gjeni në tekst fjalët, të cilat e shfaqësojnë plotësisht Çervjakovin nga ajo që ndodhi.

Nuk është e ndaluar për askënd që të teshtijë. Teshtijnë fshatarët, agjentët e policisë, madje edhe gjeneralët ndonjëherë. Të gjithë teshtijnë. Çfarë tregojnë ato? Teshtima është një fenomen i natyrshëm që ndodh në mënyrë të pavullnetshme te çdo njeri.

Grupi i dytë: 5. Gjeni në tekst fjalët që tregojnë:

a. mirësjelljen e Çervjakovit; *Shkëlqesi, më falni se ju bëra pis pa dashur...*

b. përlulësinë e Çervjakovit; *Shkëlqesi... nëse kam spërkatur kokën tuaj, ka qenë në mënyrë të pavullnetshme... ju lutem të më falni... unë nuk desha...*

c. indiferencën e Brizalovit; *Po lëre tani, se e mora vesh. Më lër të dëgjoj!*

d. pompozitetin e Brizalovit. *Jashtë që këndeje! Jashtë që këtu!*

Grupi i tretë: 6. Shpesh rrëfimtari e quan Brizalovin vetëm Shkëlqesia e Tij, pa nevojën e emrit.

Pse? Për të vënë në dukje personalitetin e tij/shkallën e tij shoqërore.

Grupi i tretë: 7. Në ç'vetë kryhet rrëfimi në këtë tregim? (*në vetën e tretë*)

Ç'raport mban rrëfimtari me ngjarjet që rrëfen? Mban një raport asnjans në rolin e vëzhguesit.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Diskutim.*

Punohen në formë diskutimi, ushtrimet 8, 9, 11, 13 dhe 15.

8. Çfarë ndjenjash përjeton Çervjakovi kur sheh se kë ka spërkatur me teshtimën e tij. *I frikësuar, në ankth.*

Çfarë e shkakton shqetësimin e tij? *që ndoshta një ditë mund të ishte nën vartësinë e tij.*

9. Vdekja e Çervjakovit është: *Një fund i hiperbolizuar i njeriut të dobët.*

11. Analizoni gjuhën e Çervjakovit kur i drejtohet Brizalovit. Si janë të ndërtuara fjalitë me të cilat i kërkon vazhdimisht falje? *Fjali të shkurtra të papërfunduara. Për cilën arsye përdoren vazhdimisht reticencat ndërmjet fjalëve të tij? Tregojnë momente të nevojshme reflektimi.*

13. Çehovi njihet si një autor që e përdor shpesh komizmin për të kritikuar qëndrime apo dukuri të ndryshme. A ju bën të qeshni ky lloj komizmi? *Pse? (humor i zi, duke e bërë Çervjakovin personazh tragji-komik).*

15. Heroi i tregimit është mishërim i njeriut që është gati t'i nënshtrohet gjithkujt që gëzon një pozitë shoqërore më të lartë. Nëpërmjet tij shfaqet drama e njeriut të pasigurt në vetvete. Diskutoni rreth saj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë individuale.* Punohen në mënyrë individuale ushtrimet 10, 12 dhe 14.

10. Gjeni në këtë tekst elementet që janë karakteristike për tregimin si lloj letrar.

Një personazh kryesor (Çervjakovi)

Përshkrim i shkurtër i personazhit (...një portier jo më pak i mrekullueshëm)

Pasqyrohen anë të rëndësishme të realitetit (*i dobëti përulet para të pushtetshmit*)

ngjarjet zhvillohen brenda një kohe të shkurtër (*një mbrëmje... ditën tjetër... ditën tjetër*)

12. Dalloni në tekst monologët nga dialogët.

**Nxënësit japin shembuj konkret nga teksti.*

14. Gjeni fjalët onomatopeike në tekst: apshi hi hi; murmuriti; i pëshpëritur.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 16. Çfarë ndjenjash përjetoni ndaj Çervjakovit? Jepni shpjegimin për zgjedhjen ose jo, të secilës alternativë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX																																										
Tema mësimore: Formimi i fjalëve në gjuhën shqipe Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Fjalëformim		Situata e të nxënimit: Stuhi mendimi																																											
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 																																													
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe -dallon morfemat rrënjore dhe ndajshesore -dallon përbërësit e fjalës: tema, mbaresa, rrënja parashtesa, prapashtesa -realizon saktë analizën fjalëformuese të fjalëve -formon fjalë të prejardhura		Fjalët kyçe: fjalëformim, morfemë rrënjore, morfemë ndajshesore, rrënjë, temë, mbaresë, parashtesë, prapashtesë, prejardhje, përngjitje, konversion, përbërje, mënyra e përzier,																																											
Burimet: teksti, fletore, shkumës me ngjyra		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi																																											
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur, Punë në dyshe, Punë në grupe</i>																																													
Organizimi i orës së mësimt Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stuhi mendimi</i> U drejtohen nxënësve pyetjet: Cilat janë mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe? Ç'quajmë morfemë rrënjore dhe ndajshesore? Ç'quajmë analizë fjalëformuese? Përgjigjet e nxënësve paraqiten të përmbledhura në tabelë. Shkruhet titulli i mësimt dhe udhëzohen nxënësit të hapin tekstin në faqen 216. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë me tekstin.</i> Nxënësit do të vërejnë fjalët e nënvizuara në fragment. Si janë formuar këto fjalë? Rikujtohet me nxënësit se ç'është: rrënja, tema, mbaresa, parashtesa dhe prapashtesa.																																													
<p style="text-align: center;">Paraqitje skematike e morfemave</p> <pre> graph TD A[Morfemat] --> B[Rrënjore] A --> C[Ndajshesore] C --> D["(rrënja e fjalës)"] C --> E["trajtëformuese"] C --> F["fjalëformuese"] D --> G[mbaresa] D --> H[nyja] D --> I[parashtesa] D --> J[prapashtesa] E --> G E --> H E --> I E --> J F --> G F --> H F --> I F --> J </pre> <p>Diskutohet rreth mënyrave të formimit të fjalëve, duke dhënë shembuj për çdo rast.</p> <p>Diskutohet rreth mënyrave të formimit të fjalëve, duke dhënë shembuj për çdo rast.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë në dyshe, Punë në grupe.</i> Nxënësit punojnë dhe këmbëjnë librat me shokun/shoqen e bankës. Vlerësojnë njëri-tjetrin.</p> <p>Hapi I. Punohet në grupe dyshe ushtrimi 1 dhe 2.</p> <p>1. ndërveprimet - vepër, mjekësia-mjek, i qeshur-qesh, dal-dal, zbardh-(i)bardhë, përfundojmë-fund, pafundësi-fund, mirë-mirë, lakmi-lakm(o), lumturi-(i)lumtur, fluturimthi-flutur, trekëndësh-kënd</p> <p>2.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Fjala</th> <th>Tema</th> <th>Mbaresa</th> <th>Fjala</th> <th>Tema</th> <th>Mbaresa</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>vrapoi</td> <td>vrapo</td> <td>i</td> <td>mbishkruani</td> <td>mbishkrua(j)</td> <td>ni</td> </tr> <tr> <td>përgjithësisht</td> <td>përgjithësisht</td> <td>-</td> <td>besimin</td> <td>besim</td> <td>in</td> </tr> <tr> <td>pemët</td> <td>pemë</td> <td>t</td> <td>daljen</td> <td>dalje</td> <td>n</td> </tr> <tr> <td>motorët</td> <td>motor</td> <td>ët</td> <td>parandjenja</td> <td>parandjenj(ë)</td> <td>a</td> </tr> <tr> <td>bojë</td> <td>bojë</td> <td>-</td> <td>dëshmitarin</td> <td>dëshmitar</td> <td>in</td> </tr> <tr> <td>lulen</td> <td>lule</td> <td>-</td> <td>lulishten</td> <td>lulishte</td> <td>n</td> </tr> </tbody> </table>				Fjala	Tema	Mbaresa	Fjala	Tema	Mbaresa	vrapoi	vrapo	i	mbishkruani	mbishkrua(j)	ni	përgjithësisht	përgjithësisht	-	besimin	besim	in	pemët	pemë	t	daljen	dalje	n	motorët	motor	ët	parandjenja	parandjenj(ë)	a	bojë	bojë	-	dëshmitarin	dëshmitar	in	lulen	lule	-	lulishten	lulishte	n
Fjala	Tema	Mbaresa	Fjala	Tema	Mbaresa																																								
vrapoi	vrapo	i	mbishkruani	mbishkrua(j)	ni																																								
përgjithësisht	përgjithësisht	-	besimin	besim	in																																								
pemët	pemë	t	daljen	dalje	n																																								
motorët	motor	ët	parandjenja	parandjenj(ë)	a																																								
bojë	bojë	-	dëshmitarin	dëshmitar	in																																								
lulen	lule	-	lulishten	lulishte	n																																								

<p>Hapi II. Punë në grupe.</p> <p>Ndahet klasa në tre grupe për të punuar ushtrimin 3, 4 dhe 5.</p> <p>Grupi 1. Ushtrimi 3. Fjalë të parme: vitet, të rejat, të shkruar, gumëzhinte Fjalë jo të parme: të përbashkët, nxënësve, mësimin, gjuhësor, komunikimin</p> <p>Grupi 2. Ushtrimin 4.</p> <p>breg, bregdet-përbërë, bregdetar-prejardhje, bregore-prejardhje bukur, bukuri, bukurosh-prejardhje, bukurshkrim-përbërë drejtor, drejtori, drejtues, nëndrejtor-prejardhje arsye, arsyevoj, arsyetim, arsyetues, - prejardhje, i arsyetuar, i paarsyetuar - m e përzier famë, famëkeq, famëmadh, famëzi - përbërë, famoz - prejardhur sukses, i suksesshëm, i pasuksesshëm - m e përzier jetë, jetoj, jetesë, jetesëtar - prejardhje i jetuar, i pajetuar - m e përzier, jetëshkrim - përbërë larg larg (ndajfolje) konversion, largësi, largesë, larguar prejardhje - i larguar, i palarguar - m e përzier dje i djeshëm, i pardjeshëm - m e përzier</p> <p>Grupi 3. Ushtrimi 5</p> <p>i qetë-i qetësuar-i qetë-s(o)-uar i thatë-thatësirë-thatë-s(o)-i-rë i ëmbël-ëmbëlsirë-ëmbël-s(o)-i-rë i gjallë-gjallë-ri-në i dashur-dashur-i-a i vëshirë-vështirë-s(o)-nte i pasur-pasur-or-re i drejtë-drejtë-si-a i veçantë-veçantë-si-në i ligjshëm-ligjshmëria-ligjsh(ë)m-ëri-a</p> <p>Vlerësimi: nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë, komunikohen vlerësimet.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, sipas kërkesës.</p>
--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Tregu		Situata e të nxënësve: Foto nga tregu.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon tiparet e romanit si lloj i gjatë i prozës. - Dallon figurat letrare dhe efektin që krijojnë ato. - Zbulon gjendjen emocionale të personazhit kryesor si pasojë e ambientit që e rrethon. - Analizon elementet kryesore të gjuhës së autorit. 		Fjalët kyçe: nerva; treg; gota plastike; turma; shishe; karrocë; xhinse; skenë teatri; djersë të ftohta	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Foto nga tregje të ndryshëm.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>përshkrim; skeda e romanit; lexim zinxhir; pyetje-përgjigje; punë në grup; punë individuale; diskutim.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: diskutim, skeda e romanit.

Hapi i I: Përshkruan me detaje një treg dhe atë çfarë ndodh në të).

Hapi i II: Ndërtohet skeda e romanit për t'u njohur me tiparet e tij si lloj i prozës së gjatë.

Romani:

Përmban disa linja të zhvillimit të ngjarjeve që ndërthuren me njëra-tjetrën.

Personazhet janë në kontakt të pandërprerë dhe në bashkëveprim.

Përgjithësisht është një rrëfim i gjatë.

Shkruhet në prozë, por ekzistojnë dhe disa romanë të shkruar në vargje.

Njihen disa lloj romanësh: historikë, policorë, epistolarë, realistë, etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim zinxhir, pyetje përgjigje.*

Hapi i I: (*lexim zinxhir*) Prezantohet titulli dhe lexohet pjesa nga nxënësit.

Hapi i II: (*pyetje përgjigje*) Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. Renditni disa elemente të jetës së përditshme që dalin në këtë fragment. *Pazari i zakonshëm në dyqane, tregje; turmat e njerëzve nëpër treg; shitja ambulante;*

- Ç'ndjesi i krijojnë protagonistit detajet që sheh në tregun e qytetit? *Bezdi, lodhje, mërzi.*

- Dalloni disa nga gjendjet emocionale që provon Martini në rrjedhën e këtij fragmenti.

a. *Jam me aq shumë nerva...*

b. *Fillojnë të më rrjedhin djersë të ftohta.*

- Cila është pika kulmore e gjendjes së tij emocionale? *Nervozizmi kur kupton se Enxhi e ka sjellë pa ndonjë arsye konkrete në treg. Ku duket ajo? I qetë Mart, i qetë.*

- Sa personazhe shfaqen në këtë fragment? (*5 personazhe*) Tregoni sjelljen dhe veprimet e secilit prej tyre.

-*Personazhi kryesor është Marti, kurse personazhet e tjerë (Enxhi, shitësi i pullave, shitësi ambulant, shitësi i xhinseve) janë personazhe plotësues, që nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të tyre, ndikojnë te Marti duke na dhënë një përfytyrim më të plotë për gjendjen e tij emocionale.*

Hapi i III: (*punë në grup*).

Ushtrimi 2. Shpjegoni efektet që krijojnë në fragment krahasimet dhe përqasjet e mëposhtme. Ndahet klasa në tri grupe të mëdha dhe secili grup, punon njërin prej pikave të ushtrimit. Në përfundim, bëhet shpjegimi nga përfaqësuesit e grupit dhe nxënësit e tjerë mund të shtojnë, ose plotësojnë.

a. *me të njëjtën ngadalësi që përdorin ata që çmontojnë bomba... (Arrin të përfytyrosh monotoninë e veprimeve në kë fragment jete? - në treg)*

b. *nga një krijesë e çuditshme, gjysmë karrocë e gjysmë frigorifer... (Habia, vështirësia që ka Marti për të pranuar këtë realitet)*

c. *si hajdutët kur hyjnë në bankë... (Bezdia që ndjen Marti dhe dëshira për të shpëtuar sa më shpejt nga kjo gjendje)*

Ushtrimet **5, 6 dhe 7.** Ndahet klasa në tre grupe të mëdha dhe secili grup punon njërin prej ushtrimeve. Në përfundim, bëhet shpjegimi nga përfaqësuesit e grupit dhe nxënësit e tjerë mund të shtojnë, ose plotësojnë.

5. Shpjegoni ndikimin e ambientit në ngarkesën emocionale që shfaq Marti. *Ambjenti e lodh, e ngarkon shpirtërisht e mendërisht Martin dhe zbulon tek ai një anë tjetër, siç është padurimi, apo nervozizmi.*

6. Interpretoni shprehjen: *Problemin e kam me veten time këtu, jo me këtë vend.*

Nënkupton faktin, që Marti nuk mund të përshtatet me mentalitetin, apo botëkuptimin e këtij ambienti. Duke qenë me formim "artisti" nuk e ka të lehtë të perceptojë këtë monotoni të jetës së përditshme (tregut...pazareve).

7. Shpjegoni lidhjen midis situatave qesharake që krijohen dhe ironisë që i shoqëron ato. Ilustrojeni mendimin tuaj me shembuj.

Pranëvënia e situatave qesharake dhe përdorimi i ironisë, e bëjnë lehtësisht të kuptueshme fabulën e romanit dhe duket sikur lexuesi dhe personazhi bëhen një.

- *E sidoqoftë s'të solla kot, duhej të blija ca gota plastike. (Situatë qesharake)*

- *Si ta dush more, me gaz, pa gaz, uj amerikan, uj anglez, uj grek, uj shqiptar, uj Himare e uj Tirane, uj të bardhë e -- uj jeshil, ça të të dojë e bardha zemër. (situatë qesharake)*

- *Eh, vëllazëria ballkanike! (ironi)*

- *Akoma s'kanë ardh nesër! (ironi)*

Hapi i III (*Punë individuale*). Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe japin përgjigjet e tyre, duke veçuar dhe fragmente nga pjesa e dhënë.

3. Gjeni elementet që e bëjnë këtë fragment një rrëfim realist.

Elementet e jetës së përditshme (tregu, blerja e gotave plastike, shitësi ambulant, shitësi i xhinseve, etj), si dhe zbërthimi i botës së brendshme të personazhit nëpërmjet këtyre elementeve, e bëjnë një rrëfim realist.

4. Disa fjali në tekst, shfaqen me shkronja të pjerrëta, për t'u dalluar nga pjesa tjetër e rrëfimit. Çfarë mendoni se janë ato? Pse ndryshojnë nga pjesa tjetër e tekstit?

Këto fjali, janë të tilla për të rënë në sy e për të tërhequr vëmendjen. Ato zbulojnë ndjesitë, mendimet e Martit nga vëzhgimi i të tjerëve.

8. Gjeni sinonimet për fjalën çun dhe jepni nga një shembull përdorimi për secilin prej tyre.

Djalë; bir; voc; cull.

9. Gjeni folje nga fragmenti që tregojnë intensitetin e mendimeve të personazhit.

Komploton; bllokohem; duhet të pres;

10. Gjeni dhe shpjegoni fjalët që tregojnë ironinë në fragment.

Hapi i IV: (*diskutim*) Punohen ushtrimet 11 dhe 12 në formën e diskutimit. Nxënësit mendojnë në mënyrë kritike dhe japin përgjigjet e tyre duke i argumentuar.

11. Pse Martinit i duket tregu si skena e një teatri?

Formimi i tij prej artisti, e bën ta imagjinojë tregun si një skenë të madhe dhe çdo njeri aty, luan një rol (ky është roli i vërtetë, jeta e tyre).

Krijoni një skenë të vogël teatrale në klasë me personazhe, sende dhe lëvizje si në këtë fragment.

(Në këtë ushtrim, nxënësi duhet t'i kushtojë rëndësi tipareve fizike dhe karakterit të çdo personazhi)

12. Diskutoni rreth mesazheve, frymës dhe atmosferës që përcjell fragmenti.

A është Marti një zë juaji i brendshëm? Po i shokut tuaj? Martini e ka të vështirë të pranojë të përshtatet me një ambient, i cili nuk i ngjall asnjë lloj interesi...

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shikoni filma dhe dokumentarë që sjellin tematikat dhe problematikat e ndryshimeve të shoqërisë shqiptare pas viteve '90. Zhvilloni në klasë një tryezë debati rreth informacioneve të gjetura.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe.		Situata e të nxënësve: Nxënësit formojnë Pemën e mendimit, për mënyrat e formimit të fjalëve, nisur nga njohuritë që kanë.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Fjalëformim			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca qytetare. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: formim i fjalëve, prejardhja, përbërja, përngjitja, paranyjëzimi, konversioni, temë fjalëformuese	
Nxënësi/ja -dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe -klasifikon fjalët sipas mënyrës së formimit -tregon si janë formuar fjalët jo të parme -dallon temat fjalëformuese të fjalëve -formon fjalë të reja me mënyra të ndryshme -dallon saktë përbërësit e fjalëve			
Burimet: teksti, fletore, shkumës me ngjyra		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Pema e mendimit, Pyetje-përgjigje, Diskutim, Punë në dyshe, Punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimt. <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</i> pema e mendimit Hapi I. Nisur nga njohuritë që zotërojnë, nxënësit plotësojnë pemën e mendimit për formimin e fjalëve.			
<pre> graph TD A[Formimi i fjalëve] --- B[Prejardhja] A --- C[Përbërja] A --- D[Përngjitja] A --- E[Paranyjëzimi] A --- F[Konversioni] A --- G[Mënyra e përzier] </pre>			
Nxënësit do të japin shembuj, nga dy fjalë për secilin grup.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në grupe</i>			
Hapi I. Shkruhet tema në tabelë. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë informacionin e paraqitur në tekst, në faqen 219-220 dhe t'u përgjigjen pyetjeve, të cilat do të listohen në tabelë. Klasa ndahet në tri grupe.			
Grupi I.			
1. Çfarë është prejardhja? Cilat janë mjetet që formojnë fjalë të reja? (parashtesa, prapashtesa, parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht)			
2. Çfarë është përbërja (kompozimi)? Si formohen fjalët e reja? Sa lloje kompozitash kemi?			
Grupi II.			
1. Çfarë është përngjitja? Cilat klasa fjalësh formohen me këtë mënyrë?			
2. Çfarë është paranyjëzimi? Si formohen fjalët e reja përmes paranyjëzimit?			
Grupi III.			
1. Çfarë është konversioni? Cilat klasa fjalësh janë formime me konversion?			
2. Çfarë është mënyra e përzier? Cilat klasa fjalësh formohen me këtë mënyrë?			
Hapi II. Një nxënës, përfaqësues i çdo grupi, prezanton përgjigjet. Aktivizohen sa më shumë nxënës. Plotësimi i Pemës së mendimit, të paraqitur në fillim të orës.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë në dyshe, punë në grupe.</i>			
Hapi I. Ushtrimi 1. Nxënësit punojnë në libër dhe më pas e këmbëjnë atë me shokun/shoqen e bankës. Prezantohen përgjigjet.			

Pjesëmarrja në veprimtari që kanë synim të ndihmojnë komunitetin, apo mjedisin ku ju jetoni, quhet vullnetarizëm. Ai nuk është aspak i detyrueshëm; ju merrni pjesë dhe jepni ndihmesë me vullnetin tuaj të lirë. Kontributi dhe ndihma e secilit prej nesh, e bën shoqërinë të jetë më e mirë. (Të përngjitura: aspak, secilit. E përbërë: pjesëmarrja)

Hapi II. Punë në grupe.

Grupi 1. Ushtrimi 2.

Folje	Mbiemër	Emër	Mënyra e fjalëformimit
flas	i folur	të folurit	paranyjëzim
dal	i dalë	të dalurit	paranyjëzim
lexoj	i lexuar	të lexuarit	paranyjëzim
shkruaj	i shkruar	të shkruarit	paranyjëzim
mbjell	i mbjellë	të mbjellët	paranyjëzim
drejtoj	i drejtuar	të drejtuarit	paranyjëzim
shërbej	i shërbyer	të shërbyerit	paranyjëzim
marr	i marrë	të marrët	paranyjëzim
ujit	i ujitur	të ujiturit	paranyjëzim
organizoj	i organizuar	të organizuarit	paranyjëzim

Grupi II. Ushtrimi 3.

Parashtesim	përbrenda, padashur, papritur, përplot	Paranyjëzim	
Prapashtesim	artistikisht, hapur, barkazi, falas, rregullisht, shtruar, anglisht	Konversion	jashtë
Përbërje	paradreke	Mënyra e përzier	
Përngjitje	kurdoherë, menjëherë		

Përciptazi - me parashtesë dhe prapashtesë

Grupi III. Ushtrimi 4. (kushdo, nëpër, asnjë, meqë, përherë, farefis, kurdo, saqë, thuajse, përse, secili, shpeshherë)

Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 5, 6 në faqen 221 (sipas kërkesës).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Guido dhe gjuha greke (ora e parë)		Situata e të nxënësve: Jeta shkollore në ditët e sotme	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan marrëdhëniet mësues-nxënë, duke përdorur fjalët e dhëna. - Kupton subjektin e tregimit. 		<p>Fjalët kyçe: bankë; shokë të ngushtë; komunikim fshehurazi; regjistër; katedër; lehtësim; provime</p>	

Burimet: Teksi i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”	Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>parashikim me terma paraprakë; lexim zinxhir; diskutim; pyetje-përgjigje</i>	
<p>Organizimi i orës së mësimi: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>parashikim me terma paraprakë;</i> Nxënësit hartojnë një tekst të shkurtër (8-10 fjali) mbi bazën e fjalëve kyçe, në lidhje me situatat që krijohen në klasë në orë të ndryshme mësimore. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim zinxhir;</i> Hapi I: Pas leximit të teksteve të krijuara nga nxënësit, lexohet pjesa në tekst dhe bëhet njohja me autorin. Hapi II: Nxënësit përcaktojnë, se cili prej shkrimeve të tyre, që ata hartuan në bazë të termave, përaftron më tepër me tregimin që lexuan. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>pyetje-përgjigje</i> Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. - Cila është tema e këtij fragmenti? <i>Realiteti i jetës shkollore.</i> Po nëntemat e tij? <i>marrëdhëniet mësues- nxënës / marrëdhëniet nxënës-nxënës</i> - Kush e rrëfen ngjarjen? <i>Mario, njëri prej nxënësve</i> - Gjeni detajet që përdor rrëfimtari për pasqyrimin e jetës shkollore. <i>U ul përsëri në një bankë me mua; dy peshkopët qesharakë të klasës; mësuesja na pyeste për ekuacionet apo shifrat, që asnjëri nga ne nuk i kuptonte; në fund të klasës; lëvizte gishtin me ngadalë në regjistër; Klasa mbeti gojëhapur, etj.</i> - Dalloni personazhet kryesore (<i>Mario dhe Guido</i>) dhe dytësore, (<i>Darti</i>). - Si e shohin shokët e klasës Guidon në fillim të fragmentit? <i>E shohin si të ndryshëm dhe indiferent.</i> - A është i tillë ky perceptim deri në fund? <i>Jo, perceptimi i tyre ndryshoi duke kuptuar se ai nuk është indiferent dhe i paditur. (Klasa mbeti gojëhapur; Darti ktheu kokën dhe u bllokua pa ditur si të reagonte. Guidoja dukej shumë i përqendruar dhe i përpiktë, sikur po përthente vërtet fjalë për fjalë tekstin e greqishtes).</i></p>	
Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni epitetet, krahasimet dhe similitudat në tekst.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Guido dhe gjuha greke (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Marrëdhëniet mësues-nxënës	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca qytetare 			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan marrëdhëniet mësues-nxënës, duke përdorur fjalët e dhëna. - Reflekton mbi subjektin e tregimit. 		<p>Fjalët kyçe: bankë; shokë të ngushtë; komunikim fshehurazi; regjistër; katedër; lehtësim; provime</p>	
Burimet: Teksi i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim; punë individuale; tabela e krahasimit; Ruaje fjalën e fundit për mua; bisedë</i>			

Organizimi i orës së mësim:

Hapi i I: (*diskutim*) Nxënësit punojnë në formë diskutimi ushtrimet 2, 4, 8 dhe 9. Ky hap mund të zhvillohet edhe me anë të metodës *punë në grupe*.

2. Duke qenë se nxënësve u është kërkuar të gjejnë në tekst figurat letrare, ata shpjegojnë efektet e figurave që përshkruajnë Guidon.

Shpjegoni efektet e krahasimeve të zgjatura (*si motoslita*, në çift) në paragrafin e tretë dhe të epiteteve (*Guido i struktur*), që përshkruajnë veçanërisht Guidon. *Zbulojnë karakterin e personazhit.*

4. Si konceptohet shkolla dhe argëtimi në këtë fragment?

Shkolla shihet si një izolim, anktë (Darti) dhe argëtimi si pjesë e jetës shkollore.

8. Shpjegoni efektet e ironisë në shprehjet: *dy intelektualët më të ngathët (të prirur vetëm për të mësuar) dëgjonim dogma gramatikore dhe matematikore (për ta ishin pa interes)*

u krijua një bashkëpunim, siç ndodh në disa lloj sportesh (nxënësit u bënë një skuadër kundër të njëjtit kundërshtar) 30 viktimat të ngulura nëpër karrige (nxënësit nën presion).

9. Si e kuptoni shprehjen: *isha publiku i tij? Mario tregon raportin me Guidon: e dëgjonte, e përkrabte.*

Hapi i II: (*punë individuale*).

Ushtrimi 3. Shtjelloni nga një cilësi të botës së brendshme për secilin nga personazhet.

Guido: indiferent, rebel, guximtar / Mario: dashamirës, kurioz, frikacak

Si shfaqet kurioziteti dhe frika te Mario? *Kurioziteti për të njohur më mirë Guidon dhe frika nga të pyeturit në mësim, ecnin paralelisht. Pse çuditet klasa dhe e adhuron Guidon pas leximit? Klasa çuditet, sepse perceptimi që kishin për të ndryshon dhe Guido kthehet në heroin e klasës.*

Shpjegoni natyrën e tyre dinamike përmes ndryshimeve dhe ndërveprimit me njëri-tjetrin.

Në momentin e ngritjes së Guidos në dërrasë, nxënësit e tjerë, e ndiejnë veten “të shpëtuar” dhe vetvetiu bëhen dinamikë.

Hapi i III: (*tabela e krahasimit*)

5. Krahasoni Guidon me Marion, (*plotësojnë njëri-tjetrin edhe pse të ndryshëm, Mario është i ndrojtur dhe Guido ishte krejt ndryshe nga të tjerët*) pastaj Guidon, me një përfaqësues të brezit të sotëm.

Mario	Të përbashkëtat	Guido	Guido	Të përbashkëtat	Përfaqësues i brezit të sotëm
<i>dashamirës</i>	<i>Nxënës të një klase</i>	<i>indiferent</i>			
<i>kurioz</i>	<i>Bashkëpunues</i>	<i>rebel</i>			
<i>frikacak</i>	<i>Mbështetës të njëri-tjetrit</i>	<i>guximtar</i>			

Hapi i IV: (*Ruaje fjalën e fundit për mua*)

Interpretimi kuptimin e anijes së vjetër. *Raporti i klasës me Dartin. Guido theu “mitin” e Dartit.*

Diskutoni rreth frazës: *Ekuipezhi i saj nuk e fshihte dot kënaqësinë që ndiente nga ky ndryshim i menjëhershëm.*

Nxënësit janë ekuipezhi që ndjen kënaqësinë për prishjen e raportit të mëparshëm.

Hapi i tetë: (*bisedë*). Punohen ushtrimet 10-11.

10. Për romanin nga është shkëputur kjo pjesë, thuhet se është një himn për miqësinë e vërtetë. A dëshmohet kjo në këtë fragment? *Po*

11. Ja si shprehet një lexues për këtë roman: *Më ka dhënë forcë për të reaguar, dëshiroj të ndryshoj... Ndonjëherë i rikthehem për t'u frymëzuar. Për mua është një kryevepër. Po ju, si u ndjetë pas leximit të këtij fragmenti?*

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese argumentuese me temë: *Një mik i vërtetë na bën ta njohim më mirë veten.*

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij		Situata e të nxënimit: Stuhi mendimi.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Leksikologji			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca qytetare. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: leksik, rrugë pasurimi, shtresë vetjake, shtresë e huazuar, leksik aktiv, leksik pasiv, gjuhë standarde, familje fjalësh, huazim	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> -njeh rrugët e pasurimit të leksikut në gjuhën shqipe -dallon shtresën vetjake dhe shtresën e huazuar të leksikut -shqyrton leksikun sipas mënyrës së përdorimit -përcakton fjalë të leksikut aktiv dhe leksikut pasiv -kthen një tekst të dhënë në gjuhën standarde -shpjegon kuptimet e fjalëve -ndërton familjen e fjalëve, duke pasuruar leksikun vetjak 			
Burimet: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Pema e gjuhëve		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Tik-u	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e drejtuar, Punë në grupe</i>			
Organizimi i orës së mësimimit.			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stuhi mendimi</i>			
Shkruhen në tabelë pyetjet. Ç'quajmë leksik të një gjuhe? Cilat janë rrugët e pasurimit të leksikut? Ku bën pjesë gjuha shqipe? Nxënësit, nisur nga njohuritë që kanë, prezantojnë përgjigjet, të cilat paraqiten të përmbledhura në tabelë.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim</i>			
Shkruhet tema e mësimimit në tabelë dhe udhëzohen nxënësit që të lexojnë materialin në krye të faqes 222			
Diskutohen çështjet e paraqitura në tekst.			
1. Shtresa vetjake e leksikut (fjalët e fondit autokton)			
2. Shtresa e huazuar e leksikut (marrja e fjalëve dhe e shprehjeve nga një gjuhë tjetër)			
Rrugët e huazimit: pushtimet e ndryshme, afërsia gjeografike, marrëdhëniet kulturore, politike, ekonomike, emigrimi			
3. Rrugët e përfitimtimit të fjalëve të reja (fjalëformimi, huazimi)			
4. Shqyrtimi i leksikut sipas mënyrës së përdorimit (masës së përdorimit, marrëdhëniet me normën letrare)			
Nxiten nxënësit që të shoqërojnë mendimet me shembuj nga teksti.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë e drejtuar, punë në grupe.</i>			
Hapi III. (punë e drejtuar) 1. Nxënësit do të përpiqen që ta rishkruajnë tekstin e dhënë në gjuhën standarde.			
Ata që presin barin me drapinj dhe kosa të shkurtra, posare për livadhe me gur në bjeshkën e Cukalit, janë njerëz të heshtun (heshtur) dhe vetëm në dukje të qetë: dhimba (dhimbja) u bren kocat (kockat) natën e i kap si pika në mëngjes në muskuj e gjymtyrë, kur sjellin së pari (për herë të parë) rreptas hekurin në bar. Në parzmin (kraharorin) e leshtë, u fshehet (fshihet) frika e gjarpnit (gjarprit), që pret tue njëhë (të njohë) në ritëm afrimin e krismës së drapnit (draprit) në tërfojë (tërfill). Mbledhësit e barit flejnë (fleenë) në vapën e ditës mbështetë (mbështetur) për (në) trungun e ahut nën hije e shohin andrra (ëndrra) syçelë. Ma (Më) i riu i zgjoi njëherë e u tregoi atë që kishte gjetë (gjetur), diçka të gdhendun, (gdhendur) gungë e madhe ngjyrë ashti, (ngjyrëvjollcë) rrashtën (samarin, zhguallin) e breshkës e mbi atë gjarpnin (gjarprin) dredha-dredha, gjithçka të bamun (bërë) gurë! Mirë, - thanë ata, - na e dimë qëmoti se nëma (mallkimi) i/e Orëve ndërron në shkamb (shkëmb) çdo gja (gjë) edhe bariun me tufë përpara, po puna ashtë: si erdhi breshka deri këtu, kaq nalt (lart)?			
(Martin Camaj, "Dranja")			
<i>Ndihmohen nxënësit aty ku kanë vështirësi.</i>			

Hapi II (*Punë në grupe*) Klasa ndahet në tre grupe.

Grupi 1. Ushtrimi 1. Familja e fjalëve

emër	emëroj, emëruar, i emëruar, i paemëruar -emërim, mosemërim, emërtim, mosemërtim, emërues, joemërues, emëror, emërmadh, emërshuar, emërharuar
çel	çelur, i çelur, i paçelur, çelës,
shteg	shtegtoj, shtegtuar, shtegës, shtegti, shtegtim, shtegtar, i shtegtuar, i pashtegtuar, shtegtues

Grupi 2. Ushtrimi 2. (me ndihmën e fjalorit)

internet: sistemi i rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdor TPC/IT (Suita e Protokollit të Internetit)

celular: 1. aparat i vogël telefonik që mbahet me vete, aparat komunikimi për telefoninë e lëvizshme, i lidhur me rrjetin telefonik të tokës, nëpërmjet stacioneve të ndryshme të komunikimit.

tastiera: 1. mjet për futjen e të dhënave në kompjuter, bën pjesë në njësinë e pjesëve hyrëse të kompjuterit

2. tastiera muzikore, tërësia e tasteve të pianos, fizarmonikës

3. tërësia e tasteve në një makinë shkrimi, ose radio me tastierë

dekoder: një pajisje elektronike që konverton sinjale nga një formë në tjetrën (si për shkyçjen e një transmetimi televiziv)

korruption: (mitmarrje në shqip) sistem i bazuar te ryshfeti, dhënia e dhuratave për qëllime të caktuara, përfitim i pamërituar i diçkaje, duke shkelur ligjin.

integrim: (eci përpara, ndërftuem, në shqip) 1. pjesët a anët e diçkaje në një të tërë

2. bashkoj ose shkrij në një njësi të vetme

Grupi III. Nxënësit do të hartojnë një listë fjalësh që përdorin çdo ditë dhe që mendojnë se janë të huazuara.

Prezantimi i përgjigjeve të ushtrimeve, përmes një përfaqësuesi. Nxënësit e tjerë mund të plotësojnë, ose qortojnë gabimet e shokëve.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, sipas kërkesës në fletore. Ushtrimi 5, në fletë formati.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Ndryshimi i Aleksit (ora e parë)		Situata e të nxënit: Bisedë rreth adoleshencës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: Shpërfillës; në qiellin e shtatë; djalë mamaje; peshkop; trishtim; histori; vështrim i qeshur; dhembje	
<ul style="list-style-type: none"> - Diskuton rreth ndryshimeve të individit në periudhën e adoleshencës - Identifikon kohën dhe vendin e zhvillimit të ngjarjeve - Shpjegon ndryshimin që ndodh te personazhi nga fillimi deri në fund të tregimit. 			
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha Shqipe 9" Libri: "Xhek Frushante doli nga grupi"		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bisedë; lexim zinxhir; tabela e koncepteve; diskutim			

Organizimi i orës së mësimit:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: bisedë;

Nxënësve u shtrohen pyetjet: Ç'është adoleshenca? Ç'ndodh me ne në adoleshencë?

Adoleshenca është një fazë e zhvillimit fizik dhe mendor të njeriut, zakonisht e renditur ndërmjet fazës së *fëmijërisë* dhe pjekurisë ligjore, një person mes moshës 13 dhe 19 vjeç. Adoleshenca shihet si një tranzicion ndërmjet varësisë dhe pavarësisë, qëllimi kryesor i së cilës, është përgatitja e fëmijëve për moshën e rritur.

Ndërtimi i njohurive të reja: lexim zinxhir

Jepen njohuri të përgjithshme për përmbajtjen e librit dhe bëhet njohja me autorin nga mësuesja.

Lexohet pjesa nga nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: tabela e koncepteve; diskutim

Hapi i I (tabela e koncepteve) Lexoni tekstin dhe përgjigjuni kërkesave të mëposhtme. Plotësoni tabelën.

Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet e këtij rrefimi?	Për çfarë e përgatit lexuesin autori përmes këtij fragmenti?	Si ndihet Aleksit në hyrje të pjesës?	Gjeni disa karakteristika të Aleksit si nxënës 16-vjeçar.	Çfarë ndodh kur ai takon Adelajdën?	Si ndihet Aleksit kur Adelajda largohet?
*Bolonjë-Itali	*Problemet, mëdyshjet e jetës adoleshente.	*I trishtuar *Shpërfillës	*I kujdesshëm *I zellshëm *Korrekt	*Ndihet në qiellin e shtatë	*U zhyt në trishtim *Me dhembje në shpirt *I humbur

Hapi i II (diskutim):

- Pjesa ngjall disa ndjenja. Veçoni shembujt që ju bëjnë t'i përjetoni ato

1)... *demokracia false e këshillit shkollor dhe konformizmi, dyfityrësia e profesorëve: ata faqezinj, që me fjalë e ngrinin në qiell pavarësinë e gjykimin të fëmijëve dhe pastaj ndëshkonin tërë mlllef edhe shkëndijën më të vogël të pavarësisë...* (*indinjim*)

2) *Zoti shtronte një qiell aq të kaltër me ca re bardhoshë të tretura diku larg, sa ishte e pamundur të mos zgërdhieshe nga lumturia dhe zor se mund t'i bëje ballë tundimit që t'i thërrisje: "Rrofsh shefo, ta paçim borxh!"* (*kënaqësi / lumturi*)

3) *babë, nënë & bir, ky i fundit pesëmbëdhjetëvjeçar, simpatik, shëndetplotë e mendjehapur, shkurt fjala, një familje borgjeze e pëgërë, e mbyllur mes katër mureve, ku gjithmonë pas pune do të kishte vend për zbavitje, mjaft që kjo të ishte e shëndetshme, brenda kornizave me një fjalë...* (*xheloz*)

4) *ndërsa në qytet mbretëronte qielli i hirtë dhe kjo Adelajda kishte ikur prej disa javësh...* (*vetmi*)

5) *...gjithnjë përfundonte në çikërrima e hollësi: një takim para vitrinës së librarisë, ndonjë copëz fjalie e saj, ndonjë vështrim i qeshur e fluturak, gjithnjë i saji...* (*mall / nostalgji*)

- A kanë Aleksit dhe shokët e tij të njëjtat dëshira?

Po, i përkasin të njëjtës moshë, jetojnë me vrullin e moshës.

Si ndërveprojnë ata?

...shpëtimtari ynë shoku i tij, Oskari, qenë turrur shkallëve në krye të grupit të nxënësve somnambulë dhe kishin shtënë në dorë bankën më të fshëbur të klasës, teksa kuisnin si zagarë të rinj, të zgjuar tashmë e të ndërsyer për mrekulli.

*Ndryshimi i Aleksit merr formën: e rebelimit

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përpikuni të përdorni stilin e shpenguar të kësaj pjese, për të shkruar një faqe me ngjarje dhe përjetime nga jeta juaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Ndryshimi i Aleksit (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Puna me tekstin	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: Shpërfillës; në qiellin e shtatë; djalë mamaje; peshkop; trishtim; histori; vështrim i qeshur; dhembje	
<ul style="list-style-type: none"> - Diskuton mbi fjalorin e çlirët të personazhit dhe mosrespektimin e rregullave drejtshkrimore në tregim. - Shpjegon përdorimin e detajeve që i japin tekstit frymë lirizmi dhe natyrë përshkruese. - Krahason fragmentin “Ndryshimi i Aleksit” me fragmentin “ Guido dhe gjuha greke” për të nxjerrë ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: “Një histori dashurie me rock & roll”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësvë: diskutim; ditari dypjesësh; punë dyshe; tabela e krabasimit			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi i I: diskutim			
Ushtrimi 2. Mënyra se si është shkruar pjesa, të krijon idenë që autori flet për personazhin e tij, sikur të ishte vetë ai. Çfarë tregon kjo? <i>Autori e një mirë këtë moshë dhe problematikën e saj, prandaj vjen i njehësuar me personazhin, pasi ka kaluar vetë më parë nëpër të njëjtat “rrugë”. Është një rikthim i natyrshëm i autorit në adoleshencën e tij, pasi librin në fjalë, ai e ka shkruar pa mbushur 20 vjeç, gjë që do të thotë se e kishte mjaft të freskët atë periudhë.</i>			
Hapi i II: ditarit dypjesësh.			
Punohen ushtrimet 3 dhe 4 nëpërmjet ditarit dypjesësh.			
Para se të punohet ushtrimi 4, nxënësi njihet me figurën letrare të metonimisë, informacion që jepet nga mësuesja.			
3. Gjeni dhe shpjegoni disa detaje, si: fjalë, shprehje, elemente të natyrës, përjasje, ndjenja të forta dhe të bukura, emocione të larmishme, etj., të cilat i japin fragmentit një frymë lirizmi dhe natyrë përshkruese.			
Shprehja	Kuptimi		
<ul style="list-style-type: none"> *Aleks Plaku ndihej fort i trishtuar, disi shpërfillës *I pëlqente edhe gjithçka tjetër, perëndimi i portokalltë pas kishës, të vishte një triko të re, të ngjitej e të përshëndeste gjyshe Pinën, të hante zemrën aty dhe të hidhte e të priste breshëri fjalësh për të rejtat politike, apo televizive... *dhe kurrë s’kishte dashuruar si tani *Aleks Plakut nuk i mbetej veçse të zhytej në trishtim, gjithnjë shpërfillës, ama dhe përpiqej të sillte në mend historinë e tyre, ta bluante mbarë e prapë, ta shkruante, edhe pse gjithçka i bëhej çorbë, nuk gjente dot fjalët dhe gjithnjë përfundonte në çikërrima e hollësi... 	Lirizëm		
<ul style="list-style-type: none"> * Vjeshta e dimri u zvarritën përtacë e të mërztishëm * qyteti rrëzëllente nën qiellin pranveror *një qiell aq të kaltër me ca re bardhoshe * asfalti i lëmuar i rrugëve të gjera, ajo rruga e shtruar me gur porfiri * ky i fundit pesëmbëdhjetëvjeçar, simpatik, shëndetplotë e mendjehapur 	Përshkrim		

“Metonimia” - Metonimi vjen nga greqishtja *metonymia* - ndërrim, zëvendësim emri. Është një fjalë e figurshme, që përfshihet duke zëvendësuar një emër të një sendi, të një frymori a dukurie, me një emër tjetër, që ka lidhje më të ngjashme e përbashkët në kohë, në hapësirë, si rrjedhim, si shkak. Metafora tregon bartje të kuptimit të një fjale te një tjetër sipas disa ngjashmërive. Te metonimia, zhvendosja kuptimore bazohet në raporte të caktuara vartësie midis termit të parë dhe termit të figurshëm që i përketin së njëjtës fushë kuptimore. Te metonimia kuptimi i figurshëm fshin kuptimin e parë.

*Nëse themi “i ka hyrë lepuri në bark”, në këtë rast, është përdorur lepuri si emër konkret në vend të frikës si emër jokonkret (abstrakt).

*“Mjerimi punon, punon natë e ditë”, në këtë rast, poeti përdor gjendjen e mjeruar të asaj kohe për vetë njeriun e mjeruar.

*“Kam një javë që po lexoj Kadarenë”, në këtë rast është përdorur emri i autorit në vend të veprës.

4. Gjeni metoniminë në paragrafin e parë dhe shpjegoni efektin e saj.

Metonimia	Shpjegimi
...sikur ajo jetë-ndjesi tejet mizore	

Hapi i III: Punohen ushtrimet 5, 6, 7 dhe 8 (*diskutim*).

5. Si e përshkruan autori lumturinë në këtë fragment?

Ai e përshkruan lumturinë bazuar në njohjen-lidhjen me një vajzë (që për katër muaj, ishte ndier me të në qiellin e shtatë të lumturisë), tipike kjo për një adoleshent, lumturia e dashurisë së parë.

- A buron dinamizmi i kësaj pjese pikërisht prej saj? Po, dashuria e vuri në lëvizje, i dha një tjetër kuptim jetës së tij.

6. Interpretoni figurën e Aleksit. Shpërfillës, rebel, dinamik, i trishtuar... A është ai përfaqësues i një brezi të caktuar? Përfaqësues i adoleshencës. A ngjan ai me ju?

7. Si jepet kontradikta midis disiplinës shkollore dhe reagimeve të fëmijëve? Shkolla është institucion me një rregullore të caktuar, e cila bie ndesh me mënyrën se si fëmijët e konsiderojnë atë. Falë moshës së tyre ata kërkojnë rebelim, dëfrimin në çdo lloj mënyre brenda shkollës. Veçoni një moment të tillë dhe interpretojini atë.

...qenë turrur shkallëve në krye të grupit të nxënësve somnambulë dhe kishin shtënë në dorë bankën më të fshehur të klasës, teksa kuisnin si zagare të rinj, të zgjuar tashmë, e të ndërsyer për mrekulli.

... shkante në shkollë sa për të ngrohur bankën dhe shkruante turli ndyrësish për drejtorin në dyert e banjave

8. Çfarë ndjesish ju shkakton përdorimi i shprehjes “peshkop fare”? Po i fjalës “torollak”?

Dy perceptime me natyrë qesharake. Më këto fjalë, vihen në lojë nxënësit e zellshëm në sy të shumicës në shkollë.

Hapi i IV: Punohen ushtrimet 9, 10 dhe 11 (*punë dyshe*).

9. Paragrafi i parë është shkruar me një fjalor të çlirët. Gjeni detaje, fjalë a shprehje që vërtetojnë këtë pohim. ...shkurt, torollak.

10. Ky fragment ka një veçori: nuk janë respektuar enkas rregullat drejtshkrimore. Gjeni shembuj të tillë në tekst. *shpejt do të tretej...! dhe më e bukura është...! zelli i tij të linte gojëhapur... etj. (fjalë fillon me shkronjë të vogël)*

11. Si mendoni, çfarë ka dashur të shprehë autori përmes mosrespektimit të rregullave drejtshkrimore?

Komunikim joformal, i lirshëm karakteristik për adoleshentët, moskokëçarës për rregullat, qoftë dhe ato drejtshkrimore. (Në GRUP adoleshentët ndihen mirë, kanë të njëjtat të dhëna, një gjuhë të kodifikuar që u bën të mundur të mos përdorin atë të të rriturve...)

Hapi i V: (*tabela e krahasimit*)

12. Personazhi ynë ndryshon pasi lexon romanin “Dy nga dy”. Krahasoni dy fragmentet dhe zhvilloni një diskutim mbi ngjashmëritë dhe dallimet e pjesëve.

Guido dhe gjuha greke	Të përbashkëtat	Ndryshimi i Aleksit
Trajton marrëdhëniet mes shokëve të klasës dhe marrëdhënien mësues-nxënës.	*Personazhet janë adoleshentë *Rebelë *Sfidues	Trajton ndryshimet e menjëhershme në adoleshencë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 13. Diskutoni rreth komentit të mëposhtëm nga kritika: *Ky libër u kushtohet të gjithë adoleshentëve, që përmes lavdisë dhe çapëkëllëqeve të moshës, skalisin kohërat e shkollës së mesme, të cilat do të bëhen pjesë e pandashme e jetës së çdonjërit prej nesh...*

(Punohet me shkrim në fletoren e detyrave të shtëpisë)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Holdenit te profesori		Situata e të nxënësve: Fragment nga filmi shqiptar “Shoku ynë Tili”	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyçe: profesori; merakosej; mësim; njohuri; edukim; i lodhur; jetë	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - Diskuton mbi subjektin e tregimit. - Zbulon temën e tregimit. - Analizon rolin e shkollës në zhvillimin e natyrës krijuese te njeriu. - Zbulon gjendjen shpirtërore të personazheve nëpërmjet fjalëve dhe veprimeve të tyre. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: “Rojë në thekërishten buzë greminës”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bisedë; lexim në role; pyetje-përgjigje; diagramë Veni; diskutim; punë me tekstin; diskutim në grupe			
Organizimi i orës së mësimt:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: bisedë, lexim në role.			
Në klasë, paraqitet një fragment filmik i filmit “Shoku ynë Tili”. Zhvillohet një bisedë rreth problematikës që shfaq personazhi i Tilit. Komentohen marrëdhëniet që ka ky personazh me familjen, shokët dhe mësuesit.			
Ndërtimi i njohurive të reja: lexim në role, marrëdhënie pyetje-përgjigje.			
Njihemi me autorin, romanin “Rojë në thekërishten buzë greminës” dhe lexohet pjesa në role.			
Ushtimi 1. Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.			
- Çfarë zbuloni për Holdenin në këtë fragment? <i>Holdeni është përjashtuar nga shkolla dhe endet nëpër rrugë në kërkim të vetes. Për një natë ai shkon të strehohet në shtëpinë e një profesori.</i>			
- Renditni disa karakteristika të tij: <i>i pasigurt, i vetëm, i braktisur, i pavëmendshëm, i lodhur...</i>			
- Dalloni tensionin e profesorit, duke u përqendruar te veprimet e tij: <i>pa u ulur... u kthye... u ul...</i> Çfarë tregon ndërhyrja e tij: <i>Hej, a e ke mendjen këtu? Interesin e profesorit ndaj Holdenit, këmbënguljen e tij për ta bërë të vëmendshëm ndaj këshillave dhe mësimëve që i jepte.</i>			
- Çfarë tregojnë detajet e paragrafit të ngjyrosur? <i>Në paragraf të krijohet ideja se Holdenit e ka kuptuar mësimin e jetës nga profesori dhe tashmë ka krijuar një lloj afrimiteti duke e ndjekur pas, duke “bashkëpunuar” për të rregulluar shtratin e Holdenit, ashtu si mund të rregullonin dhe jetën e tij...</i>			
- Cili është qëllimi i citimit nga Vilhelm Shtekeli në bisedë? <i>Citimi shërben si një këshillë për rëndësinë dhe vlerën e pjekurisë te individit.</i>			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diagram Veni, diskutim			
Hapi I: diagram Veni.			
Ushtimi 2. Analizoni ndryshimet midis gjendjes shpirtërore të Holdenit dhe profesorit.			
<i>Holdeni ndihet i lodhur kurse profesori aspak. Holdenit është i painteresuar sikur e ka pranuar “fatim” e tij, kurse profesori këtë gjë e konsideron si një sfidë, ndaj këmbëngul me çdo metodë, për të kthyer Holdenin në rrugën e lënë përgjysmë (shkolla)...</i>			
Hapi II (diskutim): Punohen ushtrimet 3, 4, 5, 6 dhe 8.			
3. Pse Holdenit i vjen mirë nga kujdesi i profesorit?			
<i>Sepse profesori tregon interes dhe përkujdesje, pa asnjë lloj interesi dhe pa e gjykuar.</i>			
- Ç’kërkon të thotë profesori me shprehjen e mëposhtme? <i>Midis të tjerash, do të zbulosh se nuk je njeriu i parë që çoroditet, frikësohet, madje edhe ndien pështirosje nga sjellja e njerëzve përreth.</i>			
<i>Ai kërkon t’i bëjë të qartë Holdenit se kjo e tija, është një situatë normale që gjithkush e ka kaluar në jetë.</i>			
4. Analizoni rolin e shkollës në zhvillimin e natyrës krijuese te njeriu që del në paragrafin me shkrim të pjerrët.			
<i>Shkolla nuk ka për qëllim vetëm arsimimin, por dhe edukimin drejt vlerave e kultivimin e këtyre vlerave te njeriu.</i>			

<p>5. Pse profesori i thotë djalit se ai nuk ka kohë për të humbur? <i>Kërkon t'i mësojë se koha është e çmuar dhe Holdenin duhet ta vlerësojë atë, t'i japë rëndësinë e duhur çdo çasti. A e nxit ai Holdenin? Po.</i></p> <p>6. Në ç' pikë është biseda kur profesori thotë: <i>Do apo nuk do, ti je nxënës? Në pikën kur e kishte fituar vëmendjen e Holdenit. ("nxënës" jemi gjatë gjithë jetës...)</i></p> <p>- Për çfarë kërkon ta ndërrojë ai Holdenin? <i>Kërkon ta ndërrojë për rëndësinë e shkollës.</i></p> <p>- Përse është e rëndësishme kjo? <i>Është e rëndësishme për formimin e Holdenit.</i></p> <p>8. Cili është reagimi i pritshëm i një adoleshenti para një njeriu të urtë? <i>Shfaq interes, sepse këshillat e tij, janë një shembull i mirë.</i></p> <p>- A ndryshon ai pas kësaj? <i>Ndoshta jo menjëherë, por gradualisht po.</i></p> <p>Hapi III (punë me tekstin): Punohen ushtrimet 7 dhe 9.</p> <p>7. Si e përshkruan profesori lidhjen midis informacionit që merr njeriu dhe zemrës njerëzore që e përpunon atë? <i>Janë të shumtë ata njerëz që shpirtërisht dhe moralisht janë ndier të turbulluar si ti tani. Fatmirësisht, disa prej tyre i kanë pasur vath në vesh këto turbullime. Nëse dëshiron, edhe ti do të nxjerrësh mësimë prej tyre. Ashtu si një ditë, nëse ti ke diçka për të ofruar, të tjerët do të mësojnë prej teje. Kjo është një marrëdhënie e bukur, e ndërsjellë. Dhe nuk është edukim, është histori. Poezi.</i></p> <p>9. Shpjegoni shprehjet frazeologjike: ia kishte marrë me të katra (<i>ishte larguar me shpejtësi</i>), vath në vesh... (<i>mban mend</i>) dhe vlerësoni rolin e dialogut në këtë fragment. <i>Dialogu shërben për të njohur më mirë mendimet, idetë, qëndrimet e personazheve.</i></p> <p>Hapi IV (diskutim në grupe): Punohen ushtrimet 10-11. Ndahet klase në grupe të cilë diskutojnë mes tyre dhe në përfundim, një përfaqësues nga secili grup, jep përgjigjen përkatëse. Nxënësit e tjerë, mund të shtojnë, ose të plotësojnë.</p> <p>10. Si mendoni se nxitet, stimulohet dhe arrin rezultate të mira njeriu, referuar shembullit të Holdenit. <i>Njeriu nxitet duke u drejtuar nga shembuj konkretë. Ç'mbresa ju lë ai?</i></p> <p>11. Diskutoni rreth opinionit të mëposhtëm të një lexuesi rreth këtij libri: Unë do ta rekomandoja këtë libër për këdo, sidomos për ata që dëshirojnë të lexojnë një histori që mund të ndryshojë mënyrën se si e shohin botën.</p> <p>Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese në të cilën të përshkruani një të rritur (prind/të afërm/mësues) që ka ndikuar në këndvështrimin që keni për botën.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: "Ne dhe traditat tona". Projekt (ora e dytë)</p>		<p>Situata e të nxënës: "Zakonet dhe traditat tona" Burrat shqiptarë, mbanin stoli të ndryshme argjendi, sumbulla dekorative te jelekët, unaza, pipa e kuti cigaresh, por mbi të gjitha, armët e brezit e të krahut, që ishin gjithnjë të stolisura. Po sot, vazhdon kjo traditë?</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi dhe të shprehurit - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale 			
<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: -bashkëpunon me shokët e shoqet për të sjellë informacionet dhe materialet e duhura, -përdor saktë mjetet kompjuterike për të pasuruar informacionin, -përdor strategji të ndryshme para, gjatë dhe pas dëgjimit për të kuptuar tekstin, -mban shënime për detajet e rëndësishme, -përmbledh informacionin që prezantohet gjatë diskutimeve në klasë, -mbledh informacion për punë dhe detyra me shkrim nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, duke përdorur strategji të ndryshme -shkruan pa gabime drejtshkrimore në materialet e përzgjedhura.</p>		<p>Fjalët kyçe: Tradita Zakone Informacione Dasmë Gatime Veshje Këngë Valle Letërsi gojore</p>	

Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të përgatitura nga mësuesja dhe nxënësit, foto nga interneti.	Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK																		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve																			
<i>Pyetje-përgjigje, organizuesi grafik, punë në grupe, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë e pavarur, punë e drejtuar, puno/shkëmbe.</i>																			
Organizimi i orës së mësimi																			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje, organizuesi grafik.																			
Mësuesi/ja në fillim të orës bën lidhjen e temës me situatën rreth veshjes së sotme dhe veshjes popullore të burrave.																			
Gjatë përgatitjes për projektin dhe gjetjes së materialeve, u morën shumë informacione rreth traditave dhe zakoneve.																			
Një nga këto informacione, është edhe ndryshimi i veshjes së burrave.																			
Burrat shqiptarë mbanin stoli të ndryshme argjendi, me sumbulla dekorative te jelekët, unaza, pipa e kuti cigaresh, por mbi të gjitha, armët e brezit e të krahut, që ishin gjithnjë të stolitura.																			
<i>Po sot, vazhdon kjo traditë?</i>																			
Diskutohet rreth situatës dhe çdo nxënës jep mendimin e tij, duke argumentuar shkurt mbi përgjigjen.																			
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të listojnë disa tradita, apo zakone të zonës, apo krahinës së tyre.																			
Disa nga përgjigjet e mundshme mund të jenë:																			
<ol style="list-style-type: none"> 1- <i>gatimi i ballokumes,</i> 2- <i>pritja e nuses së re me mjaltë te dera,</i> 3- <i>kur lind djalë, qëllohet me armë,</i> 4- <i>byreku me lek,</i> 5- <i>veshja e burrave me fustanellë,</i> 6- <i>kënga polifonike me iso,</i> 7- <i>ndërtesat dykatëshe.</i> 																			
Mësuesi/ja nxit nxënësit me pyetjet:																			
<i>-Cilat janë ushqimet më të mira dhe të veçanta që gatohen në shtëpinë tuaj?</i>																			
<i>- Po zakone të veçanta të krahinës, apo zonës nga vini a ka?</i>																			
Nxënësit japin mendime personale rreth përgjigjeve duke dalluar saktë traditat dhe zakonet.																			
Radhiten disa nga gatimet e preferuara të nxënësve, si dhe disa sjellje, në të cilat përfshihet kultura e popullit.																			
Disa nga përgjigjet mund të jenë:																			
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Gatime</th> <th>Sjellje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>qumështor</td> <td>qerasja kur vjen dikush në shtëpi</td> </tr> <tr> <td>tavë dheu</td> <td>vajtimi i të vdekurit</td> </tr> <tr> <td>tavë me mish dhe oriz</td> <td>hyrja në shtëpi me këmbën e djathhtë</td> </tr> <tr> <td>Pilaf</td> <td>ngritja në këmbë kur hyn dikush më i madh</td> </tr> <tr> <td>japarak</td> <td>lyerja me mjaltë e derës</td> </tr> <tr> <td>mish në hell</td> <td>vendosja e lekëve poshtë këpucës së nuses së re</td> </tr> <tr> <td>tavë me pistil</td> <td>varja në qafë e florinjve nuses së re</td> </tr> <tr> <td>pispili</td> <td>gruaja lehonë shkon të mbushë ditët</td> </tr> </tbody> </table>	Gatime	Sjellje	qumështor	qerasja kur vjen dikush në shtëpi	tavë dheu	vajtimi i të vdekurit	tavë me mish dhe oriz	hyrja në shtëpi me këmbën e djathhtë	Pilaf	ngritja në këmbë kur hyn dikush më i madh	japarak	lyerja me mjaltë e derës	mish në hell	vendosja e lekëve poshtë këpucës së nuses së re	tavë me pistil	varja në qafë e florinjve nuses së re	pispili	gruaja lehonë shkon të mbushë ditët	
Gatime	Sjellje																		
qumështor	qerasja kur vjen dikush në shtëpi																		
tavë dheu	vajtimi i të vdekurit																		
tavë me mish dhe oriz	hyrja në shtëpi me këmbën e djathhtë																		
Pilaf	ngritja në këmbë kur hyn dikush më i madh																		
japarak	lyerja me mjaltë e derës																		
mish në hell	vendosja e lekëve poshtë këpucës së nuses së re																		
tavë me pistil	varja në qafë e florinjve nuses së re																		
pispili	gruaja lehonë shkon të mbushë ditët																		
Nxënësit japin përgjigje duke treguar grupin ku bëjnë pjesë dhe roli që kanë pasur.																			
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim.																			
Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe sipas orës së parë. Mësuesi/ja kontrollon materialet e sjella nga secili grup, duke kërkuar saktësinë e tyre. Kujdes i kushtohet drejtshkrimi të gjuhës shqipe, por edhe burimeve të informacionit.																			
Ngrihen në tabelë me radhë drejtuesit e grupeve dhe sqarojnë çështjet:																			
<ol style="list-style-type: none"> 1- Tematika që do trajtojnë në projekt 2- Vështirësitë që kanë hasur 3- Mbledhja e materialeve 4- Puna me grupin, bashkëpunimi 5- Përparësitë e grupit, pikat e forta 6- Pritshmëritë për orën e ardhshme 																			

Secili nga kryetarët e grupeve, jep informacionet e duhura për punën e bërë deri tani me grupin mbi projektin. Ata japin informacione dhe argumentojnë zgjedhjet e bëra, por edhe përzgjedhjen e materialeve.

Disa nga përgjigjet e pritshme nga nxënësit, do të ishin:

Tematika që do trajtojnë në projekt	Veshjet popullore
Vështirësitë që kanë hasur	Nuk kanë pasur vështirësi, sepse ka informacione
Mbledhja e materialeve	Janë marrë nga interneti dhe nga libra të klasave të tjera
Puna me grupin, bashkëpunimi	Çdo pjesëtar i grupit është aktivizuar dhe ka sjellë materialet e duhura
Përparësitë e grupit, pikat e forta	Të gjithë anëtarët janë të motivuar dhe u pëlqen tematika
Pritshmëritë për orën e ardhshme	Do të demonstrojnë disa veshje të krahinave të ndryshme

Një tabelë e tillë plotësohet nga të gjitha grupet.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur, punë e drejtuar, puno/shkëmbe.

Mësuesi/ja, dëgjon çdo kryetar grupi bashkë me klasën dhe më pas, u kërkon grupeve që të punojnë në mënyrë të pavarur për të rregulluar mangësitë, apo pasaktësitë e punës.

Nxënësit punojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të pavarur, por duke u orientuar edhe nga mësuesi/ja.

Mësuesi/ja ndihmon me ide mbi mënyrat e prezantimit të projektit.

Disa nga idetë:

- 1- *Fletëpalosje për qytete të ndryshme me tradita të lashta,*
- 2- *Dramatizim të sjelljeve të ndryshme,*
- 3- *Libërth me meny të disa gatimeve tradicionale,*
- 4- *Pananir gatimesh,*
- 5- *Valle të krahinës.*

Nxënësit mbajnë shënime për orën e ardhshme dhe mënyrën e prezantimit.

Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyrat e lëna për orën e ardhshme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Huazimet. Shmangia e tyre		Situata e të nxënit: Interpretojmë poezi për gjuhën shqipe.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Leksikologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca qytetare. - Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: huazim: leksikor, fjalëformues, sintaksor, fjalë e huaj, gjegjëse shqip	
Nxënësi/ja			
<ul style="list-style-type: none"> -dallon fjalët e huaja në një tekst të dhënë -njeh dukurinë e huazimit leksikor -njeh huazime nga gjuhë të ndryshme, që janë bërë pjesë e leksikut të gjuhës shqipe -dallon huazimet në fjalëformim dhe huazimet në sintaksë -ndërgjegjësohet për të ruajtur pastërtinë e gjuhës shqipe -dallon dhe zëvendëson fjalën e huaj me gjegjësen në gjuhën shqipe në tekste të ndryshme 			
Burimet: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, tekste alternative, gazeta sportive, etj.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Interpretim, Punë në dyshe (Të nxënit me këmbime), Shpjegim i lidhur me diskutimin, Punë e pavarur, Koment.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:**

Hapi I. Nxënësit recitojnë poezi të njohura për gjuhën shqipe (Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Ismail Kadare)

Hapi II. Orientohen nxënësit te fjalitë e paraqitura në krye të faqes 225. Udhëzohen, që në dyshe, të nënvizojnë ato fjalë, të cilat ata i nuk i kuptojnë. Lexohen fjalët e gjetura nga nxënësit dhe paraqiten në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Shpjegim i lidhur me diskutimin*

Bëhet e njohur tema mësimore dhe përcaktohen në tabelë çështjet që do të trajtohen:

- Dukuria e huazimit leksikor
- Huazime nga gjuhë të ndryshme
- Huazime në fjalëformim
- Huazime në sintaksë
- Shmangia e huazimeve

Nxënësit do të lexojnë në heshtje informacionin e paraqitur në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur.***Ushtrimi 1** (punohet në libër)

Fjalë e huaj	Fjalë shqip
Agresiv	I egër
Ingredient	Përbërës
Obligim	Detyrim
Dominoj	Mbizotëroj
Performancë	Paraqitje
Merkato	Treg
Kortezi	Delikatesë, mirësjellje
Ilegal	I paligjshëm, joligjor
Kreativ	Krijues

Ushtrimi 2. Një nxënës punon në tabelë, kurse klasa në fletore. Mblidhen disa fletore për t'u vlerësuar.

Fjalë të ndërtuara me:

parashtesë shqipe + fjalë të huaj: rikuperim, jolegal, pakontestueshëm

parashtesë e huaj + fjalë e huaj: destabilitet, disavantazh, dispozicion

fjalë shqipe + fjalë e huaj: bashkekzistencë, kundërofensivë,

fjalë e huaj + fjalë e huaj: low cost, play off, facebook


Komentohet thënia në lidhje me termin "huazim". Nxënësit paraqesin mendimet e tyre.

Vlerësimi: nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.

Detyra dhe punë e pavarur: Ushtrimi 5.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Purpuranti (ora e parë)		Situata e të nxënit: Fragment nga filmi “Skënderbeu”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca digjitale - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon tiparet e prozës historike. - Diskuton për periudhën e lavdishme të arbërve nën drejtimin e Skënderbeut, nisur nga të dhënat historike dhe filmi “Skënderbeu”. - Zbërthen përmbajtjen nëpërmjet pyetjeve. 		Fjalët kyçe: garda e Skënderbeut; historian; malësore; pelerinë e purpurt; pritje; mall; ushtri krenare; çerek shekulli luftë; këngë e lashtë; rrënjët e shkëmbinjve; beteja	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Informacione për periudhën pas vdekjes së Skënderbeut. Fragment nga filmi “Skënderbeu” https://youtu.be/sH9Lm9Vd3D0 Libri: “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim; lexim zinxhir; kllaster; pyetje-përgjigje; punë dyshe			
<p>Organizimi i orës së mësimit: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Hapi I (diskutim): Nxënësit shohin në videoprojektor një fragment nga filmi “Skënderbeu” dhe diskutojnë rreth tij. Hapi i II (lexim zinxhir) Bëhet njohja me autorin dhe lexohet tregimi nga nxënësit.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: kllaster Nëpërmjet kllasterit, nxënësit nxjerrin tiparet e prozës historike.</p> <div style="text-align: center;"> <p>Rrëfen ngjarje të vendosura në të kaluarën</p>  <p>Subjekti ndërtohet në bazë të një përzierjeje të ngjarjeve reale dhe imagjinare.</p> </div>			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:			
Ushtrimi 1 (pyetje-përgjigje) Pasi të lexoni pjesën, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> - Kush është historiani që po shkruan një libër për Skënderbeun? <i>Arqipeshkvi i Durrësit, Pal Engjëlli.</i> - Kë takon Stresi gjatë rrugëtimit të tij, pranë burimit? <i>Nënë e Ndre Pirolit.</i> - Stresi “<i>ndjeu një dridhje të ftohtë</i>”, kur dëgjoji emrin e Ndre Pirolit. Pse? <i>Sepse Ndre Piroli kishte vdekur.</i> - Cili është trofeu i vetëm i luftës që i kishte mbetur Stresit? <i>Pelërina e purpurt.</i> - Sa vjet kishte zgjatur lufta dhe lavdia? <i>Një çerek shekulli</i> 			
Ushtrimi 2 (punë dyshe). Renditni sipas rrjedhës së rrëfimit të ngjarjeve fjalitë e mëposhtme rreth Stresit. 4- Stresi shfaq mërzinë nëpërmjet meditimeve të tij. 2- Stresi ngushëllon dikë. 6- Stresi përballet me imazhe shpresëdhënëse të një familjeje. 7- Stresi beson tek e ardhmja. 5- Stresi tregon mosbesim për të ardhmen. 3- Stresi kërkon informacion rreth dikujt. 1- Stresi ndien mall për atë që shkoi.			

<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4. Gjeni në tekst fjalitë në të cilat rrëfimtari shpreh:</p> <p>- trishtimin e heroit për atë që la pas: <i>Një dëshirë e thellë, tërë mall e dhembshuri, e shtynte të kthente edhe një herë kokën nga deti, nga fushat, po nuk e ktheu. Në grykë iu mblodh një komb.</i></p> <p>- trishtimin për faktin që s'e pret askush: <i>Po mua kush më pret? Kujt t'i kthehem unë?... Në fshat është një rrugë që s'më shpie asgjëkund...</i></p> <p>- shpresën që jo gjithçka ka marrë fund "O babë!" <i>Kjo thirrje e jetës, ishte si një puls, që i rrihte pa pushim nëpër këto vise të larta malore, nëpër këto rrënoja vigane malesh të egra dhe Stresi mendoi se nuk kish marrë fund çdo gjë, ashtu siç i ishte dukur natën në shpellë.</i></p> <p>- besimin se e ardhmja do të jetë e bukur "Ne do të kemi Torviollë të tjerë, - mendoi, - do të kemi fillime të tjera. Ne kemi rrënjë në këtë tokë dhe nuk shkulemi kurrë".</p>
--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Purpuranti (ora e dytë)		Situata e të nxënësve:	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: garda e Skënderbeut; historian; malësore; pelerinë e purpurt; pritje; mall; ushtri krenare; çerek shekulli luftë; këngë e lashtë; rrënjët e shkëmbinjve; beteja	
<ul style="list-style-type: none"> - Dallon temën e tregimit. - Gjen dhe shpjegon figurat letrare. - Analizon gjendjen shpirtërore të Stresit gjatë gjithë udhëtimit. 			
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha Shqipe 9"		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia	
Informacione për periudhën pas vdekjes së Skënderbeut.			
Libri: "Njerëz të rinj, tokë e lashtë"			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim; punë në grup; punë individuale; ditari dypjesësh;			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi i I: (<i>diskutim</i>) Punohet ushtrimi 3, 4 dhe 5.			
3. Cila është tema kryesore e tregimit? <i>Dyzimi mes humbjes së luftës dhe shpresës për të ardhmen.</i>			
4. Nxënësit kanë zhvilluar ushtrimin 4 në shtëpi dhe tani analizojnë mënyrën se si ndryshon gjendja emocionale e protagonistit gjatë udhëtimit. <i>Fillimisht, protagonistin është i malluar, i brengosur për atë që po lë pas, ndjenja këto që ia lënë vendin trishtimit për të mbeturit i vetëm në këtë botë. Por brenga e tij më e madhe, është fati i atdheut pas vdekjes së Skënderbeut, brengë kjo, që shuhet pak nga pak, nga shpresa se e ardhmja do të jetë sërish e laudshme për të zotët e kësaj toke...</i>			
5. Gjeni elementet në bazë të të cilave "Purpuranti" klasifikohet prozë historike.			
a. Personazhe realë (Skënderbeu, Pal Engjëlli)			
b. Toponimet (Durrësi, Torviollli)			
c. Stili i rrëfimit (koha e foljes, faktet, etj.)			
9. Teksti karakterizohet nga prania e shpeshtë e monologut apo e dialogut? Si shpjegohet një gjë e tillë? <i>Zbulon gjendjen emocionale të personazhit.</i>			
Hapi II: Punohen në grup ushtrimet 6, 7, 8 (faza e parë) dhe ushtrimet 10, 11, 12 (faza e dytë). Klasa ndahet në tri grupe të mëdha dhe secili grup punon dy prej ushtrimeve. Në përfundim, secili grup zgjedh një përfaqësues për të dhënë përgjigje, ndërkohë që nxënësit e tjerë dëgjojnë, mbajnë shënime, shtojnë ose plotësojnë.			
6. Në tekst, ndeshim edhe vargjet e një kënge. Gjejini ato dhe shpjegoni kuptimin e tyre duke i lidhur me situatën. <i>"Kur të mbarohen të gjitha, atëherë do të rrëzojmë shkëmbinjët e maleve mbi kryet e armiqe dhe do të hapim ngastra toke, për vreshhta e grunore, në rrënjët e shkëmbinjve."</i>			

Melodia e këngës së lashtë, e çon prapë Stresin në kohën e shkuar, ndërsa fjalët e këngës, krijojnë vetvetiu një gjendje tjetër, një gjendje që merr frymë krejtësisht në kohën e ardhshme. Fjalët e këngës, në anën tjetër, shënojnë ndërprerjen e ngacmimeve të shumta që shkaktonte e shkuara tek Stresi. Kjo do të thotë, se kontakti me këngën e moçme shqiptare, i jep impuls tjetër jetës së Stresit.

7. Për çfarë lufte – “më e vështirë, e gjatë, e përjetshme” – flet Stresi në fund të tregimit?

Lufta e mbijetësës, e vazhdimësisë, lufta për ruajtjen e identitetit dhe trojeve të të parëve, sepse çdo e ardhme, ngrihet mbi dhembje e sakrificë.

8. Interpretoni kuptimin simbolik të këngës në tregim. Kënga është simbol i forcës, besimit, shpresës.

Po fëmija, çfarë simbolizon? Vazhdimësinë e jetës dhe shpresa për të ardhmen jepet nëpërmjet fëmijës.

10. Rrëfimtari ka ndërtuar kontraste të forta, të shprehura në tekst. Gjejini dhe shpjegojini ato.

Mbi pyllin që nxinte, hapej qielli i thellë dhe në horizontin e largët të lindjes, sipër kreshtave të maleve, sikur buronte një ndriçim i purpurt, pakëz i ftohtë.

... kish ndriçuar në mes të gjitha kombeve të zhytura në errësirën mesjetare.

... të ndriçonte një çerek shekulli në mes të errësirës...

... dhe s'levizte e s'pipëtinte asgjë... që rënkonte e psherëtinte në rrugët e largëta.

Kjo pamje e tij e ashpër, bënte kontrast me melodinë e ëmbël të fyellit të tij, ashtu siç bënte kontrast trungu i ashpër i lisit dhe shushurima e butë e erës

Dita ishte e kthjellët, me një shkëlqim të bardhë vjeshtak, po ai ndjente akoma në shpirt hijen e rëndë të natës.

11. Tregimi “Purpuranti” është i karakterizuar nga dendësia e metaforave dhe e krahasimeve. Gjeni të paktën pesë metafora dhe pesë krahasime në tekst.

Metafora: Në grykë iu mblodh një komb; ajri ishte mbushur me aromën e bimëve; Mbi pyllin që nxinte; të zhytura në errësirën mesjetare; hijen e rëndë të natës; një erë e vagët, që rënkonte e psherëtinte; një dridhje të ftohtë (epitet metaforik).

Krahasime: si engjëj (si engjëj të pikturuar në kubetë e kishave-> similitudë->krahasim i zgjeruar);si arenë; si të demit; si një copë shkëmb; sikur ishin mbështjellë me myshk.

12. Rrëfimtari ka krijuar një paralelizëm mes gjendjes shpirtërore të poetit dhe natyrës. Shpjegojeni me shembuj këtë pranëvënie.

“Po ngriset!” – mendoi përsëri dhe e dinte se këtë nuk e mendonte për muzgun, për mbrëmjen dhe për natën që po vinte pas mbrëmjes, po për një gjë tjetër...

Tani kish marrë fund çdo gjë dhe vetëm ajo ruante akoma kujtimin e gardës së hekurt, kujtimin e ushtrisë krenare, kujtimin e amshuar të një kombi, që ishte ngritur dhe kish ndriçuar në mes të gjitha kombeve të zhytura në errësirën mesjetare.

Po tani kish marrë fund çdo gjë dhe Stresi e dinte se ky komb i dashur e i shtrenjtë, që të ndriçonte një çerek shekulli në mes të errësirës, ishte djegur e përvëluar i tëri, kish shkrirë të gjitha energjitë e tij dhe për t'i vënë në vend ato energji, kushedi sa kohë do t'i duhej.

Hapi i III: Punohen individualisht ushtrimet 13 dhe 14, nëpërmjet ditarit dypjesësh.

Shprehja	Kuptimi
Ne do të kemi Torviollë të tjerë	Beteja të tjera të lavdishme
Ne kemi rrënjë në këtë tokë dhe nuk shkulemi kurrë	Komb i lashtë, autokton

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni një tregim tjetër që flet për kohën e Skënderbeut. Tregoni përmbajtjen e tij në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Maska e Murtajës së Kuqe		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja - Diskuton për kohën, vendin, ngjarjen duke dhënë detaje nga teksti. - Identifikon tiparet e tekstit të misterit. - Analizon tiparet e personazheve. - Zbërthen mesazhin e pjesës lidhur me realitetin e sotëm.		Fjalët kyçe: Murtaja e Kuqe; epidemi; princ; kërdi; popullsi; kështjellë; ballo me maska; mumje; tërbim; ra i vdekur.	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Qytetaria; Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Parashikim me tema paraprake; lexim i drejtuar; bisedë</i>			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>parashikim me tema paraprake</i> U jepen nxënësve 4-5 fjalë kyçe dhe u kërkohet të ndërtojnë një ngjarje për të parë sa do t’i afrohen përmbajtjes së pjesës në tekst.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim i drejtuar</i> Ndahet pjesa në fragmente nga mësuesi dhe lexohet me ndalesa nga nxënësit. Ndalesa e parë: Lexohet fragmenti nga “Murtaja e kuqe kishte kohë...” deri te “...s’kalonte më shumë se gjysmë ore” dhe nxënësve u drejtohen pyetjet: (Ushtrimi 2 / a-b) - Me cilin lloj letrar ju ngjan fragmenti që sapo lexuat? <i>Ky fragment ngjason me përrallën</i> - Ç’elemente hasim në fillim të këtij fragmenti, që janë karakteristike edhe për përrallën? Hyrja e paragrafit: “Murtaja e kuqe kishte kohë që shkretonte vendin”, ashtu si në përralla, ngjarjet kanë një të kaluar të hershme. <i>Vendi dhe koha të papërcaktuara ashtu si në përrallë. / Murtaja e Kuqe sëmundje që del në formën e një personazhi.</i> - Cila është pritshmëria juaj për pjesën tjetër të tekstit?			
Ndalesa e dytë: Lexohet fragmenti nga “Ama princ Prospero...” deri te “Jashtë ishte Murtaja e Kuqe” dhe nxënësve u drejtohen pyetjet: (Ushtrimi 1 / a, b, c) (Ushtrimi 4 / Ushtrimi 8) - Çfarë e bën princin Prospero dhe pasuesit e tij të futen në një manastir? <i>Epidemia e Murtajës së Kuqe.</i> - Cilat ishin simptomat e shfaqjes së Murtajës së Kuqe? <i>Të zinin dhembje therëse, marramendje të befta e më pas, shpërthim gjaku nga poret, me shpërbërje të trupit. Njollat e përskuqura mbi trup e në veçanti në fytyrën e viktimës, ishin shenjat e sëmundjes.</i> - Sa miq mori princi në manastir? <i>Një mijë shokë të gjallë e gazmorë.</i> - Si e kalonin kohën princi Prospero dhe oborrtarët e tjerë? <i>Me argëtime të ndryshme.</i> - Pse princi mendon se aty është i sigurt? <i>Sepse manastiri ish një ndërtim gjigant dhe madhështor. Një mur i fortë e i lartë e qarkonte. E ky mur dyert i kishte të hekurta.</i> - Si i kuptoni fjalitë e mëposhtme?			
Me këto masa, oborrtarët mendonin të sfidonin epideminë. Bota jashtë le të bënte ç’të donte. Ndërkohë, ishte budallallëk të dëshpëroheshe, ishte budallallëk të mendoje. Princi kishte menduar për ç’dolloj qejfi. <i>Me këto fjalë, del në pah indiferentizmi, egoizmi dhe papërgjegjshmëria e princit. Ai duhet të shqetësohej dhe kujdesej për të gjithë popullsinë, por në të vërtetë, ai tregoi se angazhimi i tij i vetëm, ishte të shpëtonte veten dhe miqtë e tij.</i> - Gjeni në tekst shprehjen që tregon arrogancën e princit Prospero ndaj pjesës tjetër të popullsisë. <i>Bota jashtë le të bënte ç’të donte.</i>			

Ndalesa e tretë: Lexohet fragmenti nga “*Andej nga fundi i muajit të pestë...*” deri tek “*Ëndrrat ngrinë aty ku i zuri*” dhe nxënësve u drejtohen pyetjet: (Ushtrimi 1 / d-e-f) (Ushtrimi 2 / c)

- Kur e organizoi princ Prosperoja ballon me maska që përshkruhet në tekst? *Andej nga fundi i muajit të pestë a të gjashtë, që kur hynë..*

- Ç’ pamje kishte figura e maskuar që u shfaq papritmas në mes të ballos me maska? *Figura që e gjatë dhe e hollë, e përcuar nga koka të këmbët me qefnin e të vdekurit. Maska që fshihte fytyrën, ishte aq e ngjashme me një fytyrë kufome dhe kishte pamjen e të vdekurit nga Murtaja e Kuqe.*

- Çfarë efekti shkaktonte sahati i ebantë te mysafirët e princit? *Kur sahati i ebantë bie, për një çast, gjithçka hesht, gjithçka rresht..*

- Në çfarë pjese të manastirit përballet princi me figurën e tmerrshme që ishte shfaqur në festë? *Në fundin e apartamentit të kadifenjtë.*


Ndalesa e katërt: Lexohet fragmenti nga “*Dhe prandaj ndoshta ndodhi...*” deri tek “*... u kthye befas dhe përballoi ndjekësin*” dhe nxënësve u shtrohen pyetjet: (Ushtrimi 3 / Ushtrimi 5 / Ushtrimi 6)

- Rendit ngjyrat e dhomave sipas radhës: *blu; e purpurt; jeshile; portokalli; e bardhë; vjollcë; e kadifenjtë*

Gjej sa ngjyra janë gjithsej. *7 ngjyra.*


- Si ishte gjendja emocionale e princit Prospero para se të futej në manastir (*ama princ Prosperoja mbetej i lumtur, sfidues dhe i mençur*) dhe gjatë pesë a gjashtë muajve brenda tij (*i sigurt*). Përshkruani ndryshimin emocional, kur në festë shfaqet prania e qenies së maskuar. (*u tmerrua, u nervozua, u turpërua*)

- Tregimet e Posë karakterizohen nga përshkrime të frikshme dhe të mistershme. Gjени në tekst elementet që e bëjnë këtë prozë të klasifikohet si tregim misteri.



Ndalesa e pestë: Lexohet fragmenti në tekst nga “*U dëgjua një britmë e mprehtë...*” deri në fund dhe nxënësit punojnë ushtrimet 7 dhe 9.

7. Lidhni me shigjetë simbolin me shpjegimin e tij.



9. Princi Prospero vdes në fund si shumë të tjerë që ishin jashtë manastirit. Mesazhi që përcjell rrëfimtari me vdekjen e këtij njeriu të pasur dhe të fuqishëm është: Me para, nuk mund të blesh gjithçka. Diskutoni rreth mesazhit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *bisedë*

10 - A ju pëlqejnë librat me mister? Çfarë efekti shkaktojnë ata te ju?

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë: “Jeta vlen më shumë se gjithçka”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Regjistrat e gjuhës		Situata e të nxënimit: Anës liqenit. Nata po afrohet. Drita e ditës tretet ngadalë e mbi tjegullat e shtëpive, mbi dërrasat e rrugëve, mbi fletët e pemëve, mbi trupat e epëta të çupave që shkojnë, një ngjyrë manushaqe - një ngjyrë gushëpëllumbi, si thonë në ca malet tona, - shtrihet e i mbështjell. Mbasandaj, pak nga pak manushaqet shfletohen. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza. Njëri mbas tjetrit, yjet shpojnë qiellin e pikëlojnë dritë. Nata u afrua. Nata erdhi.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi dhe të shprehurit - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> -dallon regjistrat e gjuhës në tekste të ndryshme; -përdor regjistrat e gjuhës për qëllime të ndryshme; -përdor regjistrin e duhur në një situatë të caktuar; -gjen elementet përbërëse të regjistrin të dhënë; -dallon të përbashkëtat e të veçantat mes regjistrin të thjeshtë e të zakonshëm; -argumenton mbi rëndësinë e përdorimit të regjistrin të lartë. 		<ul style="list-style-type: none"> Regjistri i zakonshëm Regjistri i thjeshtë Regjistri i ngritur Tipare Komunikim i folur Komunikim i shkruar 	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, “Anës liqenit”, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<i>Diskutim, analizë rasti, pyetje-përgjigje, ditari tripjesësh, punë me tekstin, puno/shkëmbe, rrjeti i diskutimit.</i>			
Organizimi i orës së mësimin			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim, analizë rasti, pyetje-përgjigje.			
Në fillin të orës bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Diskutohen me radhë duke argumentuar mbi përgjigjet e dhëna.			
Lidhja me situatën: Mësuesi/ja citon tekstin e zgjedhur për situatën dhe u kërkon nxënësve të jenë të vëmendshëm, për të gjetur elementet e tekstit si: gjuha e zgjedhur dhe lloji i tekstit.			
Nxënësit duhet të gjejnë disa epitete, metafora. Gjithashtu, nxënësit duhet të theksojnë se gjuha është e zgjedhur për të krijuar imazhe dhe kënaqësi të lexuesi. Leksiku i përdorur nga autori, është i pasur.			
Mësuesi/ja drejton pyetjet:			
<ol style="list-style-type: none"> 1- Po çfarë kuptojmë me leksik? 2- Sa fjalë përmban fjalori i gjuhës shqipe? 3- Çfarë ndodh me listën e fjalëve të një gjuhe? 4- Sa fjalë mund të përdorë një njeri gjatë jetës së përditshme? 5- Kur na nevojitet një numër më i madh fjalësh? 			
Përgjigjet e nxënësve:			
<ol style="list-style-type: none"> 1- Me leksik kuptojmë tërësinë e fjalëve dhe të shprehjeve të një gjuhe. 2- Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 përmban rreth 48.000 fjalë. 3- Lista e fjalëve dhe e shprehjeve të një gjuhe, është gjithnjë e hapur, sepse ekziston gjithnjë mundësia, që për nevoja të komunikimit, të shtohen fjalë të reja. 4- Njeriut mund t'i shërbejë një sferë e vogël e leksikut (jo më shumë se 400-800 fjalë) për komunikimin e përditshëm. 5- Në rastet e dhënies dhe të marrjes së mesazheve më të ndërlikuara, leximi i teksteve të ndryshme, nevojitet një bagazh leksikor prej 4000-5000 fjalësh. Për shkrimtarët, apo studiuesit e ndryshëm, ky numër është më i lartë. 			

Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari tripjesësh, punë me tekstin.

Teksti që citohet nga mësuesi/ja, është një prozë poetike, ku autori përdor fjalët e zgjedhura, sintaksën e fjalisë dhe figuracionin e ngjeshur për të përcjellë imazhet dhe ndjesitë e tij. Sipas situatave të ndryshme të komunikimit, në secilën prej tyre përdorim me vetëdije regjistra të ndryshëm gjuhësorë.

Përgjithësisht, këta regjistra mund të klasifikohen në tri grupe kryesore: regjistër i zakonshëm, i thjeshtë dhe i ngritur.

Mësuesi/ja ndërton në tabelë një ditar tripjesësh, në të cilin sqarohen regjistrat e gjuhës, tiparet dalluese dhe shembuj të thjeshtë. Lexohet teksti dhe dallohen llojet e komunikimit: 1- i folur; 2- i shkruar.

Regjistri	Tipare dalluese	Shembuj
Regjistri i thjeshtë	Forma mbizotëruese është dialogu. Fjalitë të shkurtra dhe të paplota, mungojnë gjymtyrë të ndryshme, madje edhe kallëzuesi. Përdoren togje të gatshme, apo dialekt. Pasthrrmat si: <i>uau, bo-bo, që thua ti, po pra, ehu</i> , etj. Shprehja e habisë, çudisë, ironisë me anë të intonacionit, etj. Gjestet dhe mimika që shoqërojnë komunikimin.	Hajt shnet! Ehu dhe ti! Varja! Ç'ia fut kot! E mban në tako. Ka marrë superxhiro. U hahet muhabeti. Çun për së mbari
Regjistri i zakonshëm	Shprehet në mënyrë të plotë funksioni komunikues i gjuhës. Forma kryesore e realizimit është dialogu. Folësit e ndërtojnë komunikimin pa përgatitje paraprake. Bëhet kujdes të respektohen normat e gjuhës letrare. Mbizotërojnë temat e jetës së përditshme. Parapëlqehen trajtat e thjeshta, fjalitë e paplota, togjet e gatshme për komunikim. Mbizotërimi i formave veprorë kundrejt atyre pësore.	Si kalon? T'u bëfsha kurban! Puna mirë? Gëzuar qofshi! Sa harxhove për pajisjet që ndërrove? Çfarë thuhet për reformën e re? Kujdes grykën e shishes! Mos i përplas buzët!
Regjistri i ngritur	Kemi të bëjmë me monolog, por nuk përjashtohen edhe format e ndryshme të dialogut. I kushtohet vëmendje e veçantë përpunimit të saj. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit. Ndërtimet emërore janë më të shpeshta se ato foljore. Përdoren gjerësisht lokucionet lidhëzore, etj. Për nga përmbajtja, i kushtohet vëmendje përpunimit të mendimit dhe shtjellimit të tij. U kushtohet vëmendje rregullave të logjikës formale.	Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014 - 2020. Këtu s'do jem, do jem larguar, në tokë i tretur si të tjerët. Në kafenenë e preferuar, nuk do më shohin më kamerierët.

Gjatë plotësimit të ditarit, jepen edhe shembuj të tjerë nga nxënësit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno/shkëmbe, rrjeti i diskutimit.

Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe dyshe me njëri-tjetrin për të plotësuar ushtrimet e tekstit.

Punohen me radhë ushtrimet dhe diskutohen zgjidhjet e tyre.

Ushtrimi 1. Në regjistrin e zakonshëm, dallojmë këto tipare:

Forma kryesore e realizimit të tij, është dialogu - Saktë

Kërkon një përgatitje të gjatë paraprake - Gabim

Nuk respektohen medoemos normat e gjuhës letrare - Saktë

Për nga përmbajtja, mbizotërojnë tema nga shkencat ekzakte - Gabim

Fjalitë janë zakonisht të paplota - Saktë

Ushtrimi 2. Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

Në regjistrin e thjeshtë, dallojmë këto tipare:

U kushtohet vëmendje e veçantë formës dhe përmbajtjes së ligjëritimit - Gabim

Përdoret kryesisht në rrethana formale dhe mes të panjohurish - Gabim

Nuk këshillohet që gjatë të folurit të përdoren gjeste dhe mimikë, apo luhatje intonacioni në fjali - Gabim

Gjejnë përdorim të dendur format dialektore - Saktë

Ushtrimi 4. Përgjigjet: kardiologu, bëra provim në lëndën e kimisë, pije ilaçin.

Diskutohet mes nxënësve për përgjigjet e sakta.

Ora e mësimit, mbyllet me theksimin e rëndësisë së përdorimit të regjistrin të lartë dhe argumentimin e përdorimit të saktë të gjuhës shqipe.

Vlerësimi:

Vlerësim motivues me fjalë e shprehje gjatë orës. Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimit të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Stilet e gjuhës		Situata e të nxënësve: Planeti ynë Toka është planeti i tretë i sistemi tonë diellor. Toka është rreth 4,57 miliardë vjet e vjetër dhe i vetmi planet në sistemin tonë diellor ku është zhvilluar jeta. Toka ka satelit natyror vetëm Hënën.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: -dallon fushat në të cilat realizohet komunikimi, -përcakton stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme, letrare dhe joletrare, -bën dallimet mes stileve të ndryshme të përdorur në tekste letrare dhe joletrare, -nxjerr veçoritë e secilit stil.		Fjalët kyçe: Regjistër gjuhësor fusha tipare stili shkencor-teknik stili juridiko-administrativ stili politiko-shoqëror stili i letërsisë artistike	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale rreth planetit tonë të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë me tekstin, ditarët e të nxënësve, punë në grupe, puno/shkëmbje.			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim. Mësuesi/ja në fillim të orës kontrollon detyrat e shtëpisë ku nxënësi duhet të krijonte dy tekste me titull: “Ndihehem qytetar i botës”, por që t’i përkisnin regjistrave të ndryshëm. Lexohen disa detyra dhe diskutohet rreth tyre duke përsëritur njohuritë e mëparshme. Nxënësve u drejtohen pyetje si: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Sipas situatave të ndryshme të komunikimit, sa regjistra gjuhësorë kemi?</i> - <i>A mund të përmendni nga një veçori të secilit regjistër?</i> - <i>“O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë”, cilin regjistër i përket?</i> Nxënësit përgjigjen duke plotësuar njëri-tjetritin e duke plotësuar me shembuj nga regjistrat e ndryshëm. Përgjigje të mundshme për regjistrat dhe veçoritë:			
<u>Regjistri i thjeshtë</u> - Përdoren togje të gatshme, apo dialekt. <i>Pasthirrmat si: uau, bo-bo, që thua ti, po pra, ehu, etj.</i> <i>Shprehja e habisë, çudisë, ironisë, me anë të intonacionit, etj.</i>			
<u>Regjistri i zakonshëm</u> - Bëhet kujdes të respektohen normat e gjuhës letrare. <i>Mbizotërojnë temat e jetës së përditshme.</i>			
<u>Regjistri i ngritur</u> - I kushtohet vëmendje e veçantë përpunimit të saj. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit			

O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë” i përket regjistrimit të ngritur.

Mësuesi bën lidhjen me situatën duke sqaruar se komunikimi realizohet sipas fushave të caktuara.

Ligjërimi strukturohet dhe përshtatet në varësi të nevojave që mbulon e gjithë veprimtaria në një fushë të caktuar dhe kështu krijohen stilet përkatëse për secilën fushë.

Mësuesi/ja lexon informacionin rreth planetit tonë dhe pyet nxënësit se cilës fushë mendojnë ata se i përket.

Planeti ynë

Toka është planeti i tretë i sistemit tonë diellor. Toka është rreth 4,57 miliardë vjet e vjetër dhe i vetmi planet në sistemin tonë diellor ku është zhvilluar jeta. Toka ka vetëm një satelit natyror, Hënën. Toka peshon 6.000 miliard tonë dhe është afër 40.000 km rreth ekuatorit.

Forma elipsoide e tokës, është marrë nga dy polet e saj Veriu dhe Jugu, sepse forca e gravitetit që e kishte zbuluar shkencëtari Njuton, ushtrohet në të dy polet, pra forca gravitacionale e veriut, kundërvepron me forcën e gravitetit të jugut, ose anasjelltas. Për këtë arsye, Toka nuk ka formë plotësisht rrethore, por elipsoide. Rrethi i ekuatorit të Tokës është pak më i madh se 40.000 km. Rrezja ekuatoriale është 6.378 km, kurse ajo polare, 6.357 km.

Nxënësit japin përgjigje dhe argumentojnë shkurt mbi to.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë me tekstin, ditarët e të nxënit.

Për të lehtësuar përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja shkruan në tabelë, fushat në të cilat realizohet komunikimi dhe stilin përkatës.

Fushat në të cilat realizohet komunikimi	Stilet përkatëse për secilën fushë
fusha e veprimtarisë shkencore e teknike	stili shkencor-teknik
fusha e veprimtarisë juridike e administrative	stili juridiko-administrativ
fusha e veprimtarisë politike e shoqërore	stili politiko-shoqëror
fusha e gjuhës dhe e krijimit artistik	stili i letërsisë artistike

Lexohet mësimi dhe nxënësit punojnë me tekstin. Jepen shembuj me tekste që përfshihen në atë stil.

Shembuj:

- 1- *Stili shkencor-teknik-artikuj, botime, studime shkencore.*
- 2- *Stili juridiko-administrativ - Kushtetuta, ligje, dokumente zyrtare.*
- 3- *Stili politiko-shoqëror - gazeta, raporte, fjalime.*
- 4- *Stili i letërsisë artistike - Veprat artistike si: “Kështjella”, “Tre Shokët”*

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe, puno/shkëmbe.

Te shembujt e dhënë në tekst, pas çdo stili ndalohet dhe diskutohet për tiparet dalluese dhe veçoritë e secilit stil.

Nxënësit punojnë në grupe dyshe me ditarët e të nxënit për të nxjerrë disa nga tiparet dalluese të stileve.

Stili	Tiparet
shkencor-teknik	Funksion informues. Informacioni është objektiv, me vërtetësi. Komunikimi është një monolog me karakter përgjithësues dhe abstrakt. Shmanget dykuptimësia dhe qëndrimet emocionale. Krijimi me vetëdije i një varianti të posaçëm, i ndryshëm nga rrjedha e zakonshme e gjuhës së përditshme. Teksti duhet të ketë organizim logjik, pa kundërthënie.
juridiko-administrativ	Funksion informues dhe parashkruar të këtij ligjërimi, jepen udhëzime. Gjithçka paraqitet në emër të ligjit dhe të shtetit. Ndjekje e një modeli të mirëmenduar dhe të paracaktuar në formë dhe përmbajtje. Gjuhë e drejtpërdrejtë, nuk lë rast rast për dykuptimësi, apo për paqartësi. Mbetet kryesisht një stil tradicional.
politiko-shoqëror	Gjuha e përdorur duhet të përmbushë funksionin informues dhe ndikues. Jo vetëm paraqiten të dhëna, mendime e qëndrime për një çështje të caktuar, por synohet të ndikohet mbi mendimet, qëndrimet dhe vlerësimet e lexuesve, ose të dëgjuesve. Jo gjithnjë informacioni është objektiv dhe në përputhje me realitetin. Qëndrimi subjektiv dhe të shprehurit emocional, janë pjesë e pandashme e këtij stili.
i letërsisë artistike	Gjuha e përdorur ka funksion estetik. Jo vetëm kumtohet diçka, por njëkohësisht, synohet të kultivohet dhe të edukohet shija estetike. Ligjërimi synon shkallën më të lartë të përpunimit artistik. Flitet për së paku dy rrafshet kuptimore, pra për mundësinë e interpretimit të shumëfishtë të një veprë letrare. Këtu fiton rol parësor, ana krijuese e autorit, organizimi individual i tekstit.

<p>Ushtrimi 1. Nxënësit punojnë në qetësi për të nxjerrë të përbashkëtat dhe të veçantat mes teksteve të dhëna.</p> <p>-E përbashkët: të katër tekstet flasin për familje.</p> <p>-E veçanta: Secili tekst e trajton familjen mbi bazën e qëllimit që ka teksti.</p> <p>-Teksti 1 = stili shkencor-teknik</p> <p>-Teksti 2 dhe 3 = Stili politiko-shoqëror</p> <p>-Teksti 4 = Stili i letërsisë artistike</p> <p>Ushtrimi 2. – Teksti i përket stilit shkencor-teknik.</p> <p>-Jo nuk mund të shkruhet në stil tjetër, sepse është tekst me funksion informues. Informacioni është objektiv, me vërtetësi. Shmanget dykuptimësia dhe qëndrimet emocionale.</p>
<p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësisht të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Një pulëbardhë e mahnitshme		Situata e të nxënësve: Liria është jetë, jeta është liri!	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: nxënës; këshilla; mjeshtër; pulëbardhë; kufij; të dëbuar; tufë; fluturim; vëllazëri; hapësirë; liri	
<ul style="list-style-type: none"> - Kupton brendinë e pjesës nëpërmjet pyetjeve në tekst. - Diskuton për kohën, vendin dhe ngjarjet duke dhënë detaje nga teksti. - Shpjegon fjalën e urtë: “Pulëbardha që fluturon më lart, sheh më larg” nisur nga simbolika e saj. - Zbulon mesazhin e pjesës lidhur me dashurinë, faljen dhe lirinë. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stubi mendimi; lexim në role; pyetje-përgjigje; punë në grupe; ditari dypjesësh; diskutim;</i>			
Organizimi i orës së mësimit:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>stubi mendimi.</i>			
Nxënësit u drejtohet pyetja: “Ç’është për ju liria?”			
<i>Liria nuk është asgjë tjetër përveçse të vepruarit pa shtrëngime sipas dëshirave, interesave, qëllimeve, si edhe aftësia e vetëvendosjes në zgjedhjet për të vepruar pa lënduar të tjerët. Liria tregon të qenurit i lirë, kushtin e njeriut që nuk është i burgosur dhe ka forcën, nuk është i kufizuar, apo i penguar. Liria në një kuptim më të gjerë, është aftësia e njeriut për të vepruar e menduar me vetëvendosje të plotë, është kushtëzimi i njeriut që mund të veprojë sipas zgjedhjeve të veta, në disa raste, falë një të veçantë të pranuar nga ligji. Mund të thuhet se kush kryen një veprim, është i lirë, kur ka mundësinë e zgjedhjes, dhe veprimi vetë është i matur; i vetvetishëm; i rastësishëm dhe jo lëndues, apo shqetësues për të tjerët.</i>			

Ndërtimi i njohurive të reja: lexim në role, pyetje-përgjigje; punë në grupe.

Hapi i I: Njihemi me autorin dhe lexohet pjesa në role.

Hapi i II:

1. Lexoni fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- Si fillon fragmenti (*fillimi i një jete të re*) dhe ç'atmosferë krijon largimi i mjeshtrit Çang? *melankoli / trishtim*

Në cilin moment të jetës së Xhonatanit jemi këtu? *Në momentin kur ka përsosur aftësitë e tij për fluturimin*

- Pse pulëbardhat dëboheshin nga jeta dhe shoqëria e tufës?

Sepse guxonin të shpallnin të vërtetën, të shpërthenin kufijtë e vet duke gjetur kuptimin e fluturimit.

- Nënvizioni këshillën e fundit të mjeshtrit Çang (*Vazhdo të mësosh për dashurinë!*) dhe tregoni si del në fragment të mësuarit zinxhir. *Xhonatani kish lindur për t'u bërë mësues; dhe të falje dashuri, për të do të thoshte t'i jepte diçka nga e vërteta e tij një pulëbardhe tjetër, që mezi ç'priste për ta rrokur njëherë e përgjithmonë këtë të vërtetë.*

Xhonatani qëndroi dhe punoi me zogjtë e rinj që vinin, të cilët ishin të shkëlqyer dhe mësonin shpejt, por malli i vjetër fanitej prapë dhe atij nuk i shqitej dot nga mendja, se poshtë në Tokë, mund të kishte ndonjë pulëbardhë që donte të përfitonte nga mësimet e tij.

- Veçoni në tekst momentet ku shfaqet dëshira e Xhonatanit për t'u kthyer në tokë.

Dhe sa më shumë i përsëriste mësimet e mirësisë dhe punonte për ta njohur karakterin e dashurisë, aq më tepër zhuritej nga dëshira për t'u kthyer në Tokë.

Pse e ka ai këtë dëshirë? *Me shpresën se në tokë do të kishte pulëbardha të tjera si ai, që ishin në kërkim të vetvetes (...atij nuk i shqitej dot nga mendja, se poshtë në Tokë, mund të kishte ndonjë pulëbardhë që donte të përfitonte nga mësimet e tij).*

- Ku ndryshojnë mendimet e Sallivanit nga ato të Xhonatanit?

Sallivani mendon se Xhonatani nuk duhet të kthehet në Tokë, pasi askush nga bota e tij e vjetër nuk do ta dëgjojë dhe aq më tepër ta besojë të vërtetën e tij rreth kuptimit të fluturimit. Ai duhet t'u përkushtohet atyre pulëbardhave që e kanë rrokur tashmë këtë të vërtetë. Xhonatani shpreson dhe ngulmon se në Tokë mund të ketë pulëbardha që janë gati për ndryshimin e madh edhe kanë nevojë për mësimet e tij.

Hapi i III: Punohen ushtrimet **2, 3 dhe 4** në grup. Klasa ndahet në tri grupe dhe secili grup punon njërin prej ushtrimeve. Në përfundim secili grup nxjerr një përfaqësues për të dhënë përgjigje, ndërkohë që nxënësit e tjerë dëgjojnë, mbajnë shënime dhe plotësojnë.

2. Përshkruani largimin e mjeshtrit Çang dhe misionin e tij përmes detajeve dhe efekteve të tyre.

Por erdhi dita që Çangu të ikte. Ai kishte folur qetësisht me të gjithë, duke i këshilluar të mos hiqnin dorë kurrë nga të mësuarit, të ushtruarit dhe përpjekjet për të kuptuar më thellë, atë parim të padukshëm e të përkryer që mban në harmoni gjithë jetën e universit.

3. Analizoni pjekurinë dhe ndërgjegjësimin e Xhonatanit përmes shqetësimeve që ai mbart dhe përmbushjes së ëndrrës së vet. *Ndihet i realizuar dhe plot vizion, por njëkohësisht kthen kokën pas në origjinën e tij dhe kërkon të jetë i dobishëm atje (në Tokë) sikur Çangu me të.*

4. Çfarë donte të thoshte Çangu me "Përpiqu të punosh për dashurinë"? *thelbi i çdo parimi në jetë, është dashuria.*

A është ky mësimi i fundit i mjeshtrit? *Po. Vlerësoni rëndësinë e tij.*

Punohen ushtrimet **5, 6 dhe 7** në grup. Klasa ndahet në tri grupe dhe secili grup punon njërin prej ushtrimeve. Në përfundim, secili grup nxjerr një përfaqësues për të dhënë përgjigje ndërkohë që nxënësit e tjerë dëgjojnë, mbajnë shënime dhe plotësojnë.

5. Krahasoni figurat e Çangut (*eksperiencia, pjekuria*), Xhonatanit (*në kërkim të vetvetes*) dhe Sallivanit (*praktik*).

6. Interpretoni këndvështrimin e Xhonatanit për miqësinë. *Miqësia e vërtetë është e gjithëkohëshme dhe nuk ka rëndësi distanca, që është thjesht fizike. Lidhja shpirtërore me mikun, ndihma përkrahja, të gjendurit pranë në çdo kohë, e bëjnë një miqësi të përjetshme.*

7. Çfarë përfaqëson fluturimi i lirë, i shpejtë, i lartë? *Realizimin e ëndrrave, dëshirave, vizionin për të ecur përpara.*

Si lidhet ai me lirinë individuale? Drejt cilave hapësira të shpie? *Drejt kërkimit të së vërtetës, realizimit të vetes.*

Punohen ushtrimet **8, 9 dhe 10** në grup. Klasa ndahet në tri grupe dhe secili grup punon njërin prej ushtrimeve. Për këto ushtrime, do të përdoret ditari dypjesësh. Në përfundim, secili grup nxjerr një përfaqësues për të dhënë përgjigje, ndërkohë që nxënësit e tjerë dëgjojnë, mbajnë shënime dhe plotësojnë.

8. Ky tekst fantastik, shoqërohet me fjalë dhe shprehje që nxjerrin në pah tiparet e tij. (*bashkëbisedimi me shpendët/pranëvënia e gjithçkaje njerëzore te shpendët*). Gjeni dhe shpjegoni disa të tilla.

Shprehja	Shpjegimi
<p>*Ai kishte nxënë gjithmonë rrufeshëm edhe nga përvojat më të thjeshta e tani, si nxënës i zgjedhur i vetë mjeshtrit, i kishte përpirë idetë e reja me shpejtësinë e një kompjuteri, një tru pupëlor elektronik.</p> <p>* Xhonatani mendonte gjithnjë e më tepër për Tokën....</p> <p>* dhe të falje dashuri, për të do të thoshte t'i jepte diçka nga e vërteta e tij një pulëbardhe tjetër.</p> <p>* Ndaloi në rërë dhe ra në mendime.</p> <p>* Sallivani kishte të drejtë.</p>	<p><i>pranëvënia e gjithçkaje njerëzore te shpendët</i></p>
<p>*Ai kishte folur qetësisht me të gjithë... dhe këto ishin të fundmet fjalë të tij...</p>	<p><i>bashkëbisedimi me shpendët</i></p>

9. Shpjegoni fjalën e urtë: Pulëbardha që fluturon më lart, sheh më larg.

Shprehja	Shpjegimi
<p>*Pulëbardha që fluturon më lart, sheh më larg.</p>	<p><i>Njeriu duhet të rrezikojë, të ketë guxim të eci përpara. Sa më shumë mëson, kërkon nga vetja, aq më largpamës bëhet.</i></p>

10. Ç' nënkuptojnë shprehjet e mëposhtme të Sallivanit?

Shprehja	Shpjegimi
<p>* Në botët e tij të vjetra...</p> <p>* Ti zog i çmendur...</p>	<p><i>Rikthim në të shkuarën</i></p> <p><i>Guximi i të riut</i></p>

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim

Diskutoni rreth mesazhit që përcjell ky fragment, duke folur për dashurinë, faljen dhe lirinë.

Raportet që njeriu vendos në jetë, kërkesat dhe pritshmëritë ndaj vetes dhe të tjerëve. Ekuilibri në jetën e tij fillimisht e më pas me të tjerët.

12 - A përputhet ndonjëra prej ideve të këtij fragmenti me mendimet tuaja? Pse?

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve, në të gjitha hapat e orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: A keni menduar ndonjëherë që mund të bëni gjëra të jashtëzakonshme? Shkruani një tregim imagjinar me temë: Lundrimi në dete të reja.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe.		Situata e të nxënësve: Dispozitat Normative. NENI 85. Të drejta dhe detyra të nxënësve 1. Nxënësi ka të drejtë: a) të kryejë veprimtaritë e tij në institucionin arsimor në kushte të qeta dhe të sigurta për jetën dhe shëndetin; b) të trajtohet me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme në institucionin arsimor, pa presione, pa padrejtësira, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi : <ul style="list-style-type: none"> -përcakton stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare -bën dallimet mes stileve të ndryshme të përdorura në tekste letrare dhe joletrare -dallon tiparet dhe mjetet gjuhësore me të cilat shprehen stilet e ndryshme në gjuhën shqipe -dallon tiparet dhe mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat e ndryshëm në gjuhën shqipe 		Fjalët kyçe: Leksikologji Komunikim Stile Regjistri Tipare Veçori	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të gatshme të sjella nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shkencat e natyrës, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<i>Rrjeti i diskutimit, analizë rasti, termat kyçe, punë me tekstin, grupi i ekspertëve, teknika RAFT, puno/shkëmbe.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Rrjeti i diskutimit, analizë rasti.</i>			
Mësimi fillon me kontrollin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit me temën “Planeti ynë”, duhet të shkruanin katër paragrafë të ndryshëm sipas katër stileve gjuhësore.			
Lexojmë disa nga detyrat dhe bëhen dallimet mes stileve të përdorura. Diskutohet me rrjetin e diskutimit pas çdo detyre për përdorimin e saktë të çdo stili duke vlerësuar njëri-tjetrin.			
Mësuesi/ja prezanton përpara nxënësve Dispozitat Normative dhe lexon nenin 85 “Të drejta dhe detyra të nxënësve”. U kërkohet nxënësve, që në këtë rast të dhënë, të dallojnë stilin e përdorur dhe veçoritë dalluese të tij.			
Teksti i përket stilit juridiko-administrativ.			
Tiparet dalluese të këtij stili janë:			
<ol style="list-style-type: none"> 1- Funksion informues dhe parashkrues i këtij ligjërimit, jepen udhëzime; 2- Gjithçka paraqitet në emër të ligjit dhe të shtetit; 3- Ndjekje e një modeli të mirëmenduar dhe të paracaktuar në formë dhe përmbajtje; 4- Gjuhë e drejtpërdrejtë, nuk lë rast rast për dykuptimësi apo për paqartësi. 			
Jepen nga mësuesi/ja dy raste të tjera.			
1- Qielli është pjesë e <u>atmosferës</u> së <u>hapësirës</u> , e cila është e dukshme nga sipërfaqja e çdo <u>objekti astronomik</u> . Është e vështirë të përcaktohet për shumë arsye. Gjatë <u>ditës</u> , qielli në <u>Tokë</u> ka pamjen e një sipërfaqeje të lëmuar me ngjyrë <u>blu</u> të errët për shkak të <u>shpërhapjes së dritës së diellit në ajër</u> . Ngjyra blu e qiellit, i atribuohet faktit se molekulat e ujit kanë si tendencë të mëtojnë valë në anën e ulët të spektrit dritor, çka i përket dritës blu. <i>(Stili shkencor- teknik).</i>			
2- Frika e fjalët mes qiellit gri nisen, bredhin udhëve të gjithësisë kuturu... <i>(Stili i letërsisë artistike)</i>			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Termt kyçe, punë me tekstin, grupi i ekspertëve.</i>			
Mësuesi/ja shënon në tabelë disa terma kyçe si: Leksikologji, Komunikim, Stile, Regjistri, Tipare, Veçori.			
Nxënësit sqarojnë njohuritë që kanë për secilën fjalë kyçe.			
<i>Degë e gjuhësisë që studion leksikun e gjuhës.</i>			
<i>Dhënia dhe marrja e mesazheve me anë të të folurit dhe të shkruarit.</i>			
<i>Stilet e gjuhës: stili shkencor-teknik; stili juridiko-administrativ; stili politiko-shoqëror; stili i letërsisë artistike.</i>			

Tre lloje: regjistër i zakonshëm, i thjeshtë dhe i ngritur.

Për fjalën: tipare dhe veçori, mësuesi/ja i drejton nxënësit nga tema e re e mësimit. Nxënësit e klasës ndahen në grupe për të punuar me grupet e ekspertëve.

Secilit grup i jepet nga një tipar për t'u trajtuar me hollësi. Nxënësit punojnë me grupe për disa minuta dhe më pas nga një përfaqësues i grupit del në tabelë për të nxjerrë tiparet dhe veçoritë e gjetura nga ekspertët e grupit përfaqësues. Anëtarët e grupit në fund mund të plotësojnë shokun e tyre për të dhënë sa më qartë e saktë informacionin.

Ekspertët e stilit shkencor-teknik

- 1- Informacioni të jepet i formuluar sa më saktë, i ngjeshur dhe pa shmangie kuptimore, shumë përkufizime, formulime apo formula për dukuri abstrakte.
- 2- Fjalitë janë të zgjeruara me grupe fjalësh dhe pjesë fjalësh që përgjithësisht janë në marrëdhënie nënrenditjeje mes tyre, mjete lidhëse më të ndërlikuara, si shprehjet lidhëzore.
- 3- Mbizotërojnë ndërtimet emërore përkundrejt atyre foljore.
- 4- Përdoren shumë folje të mënyrës dëftore, fjalë e shprehje, si: mund, ndoshta, përgjithësisht, etj.

Tiparet dhe mjetet shprehëse të stileve shkruhen në tabelë dhe në fund të ekspertëve bëhet një përmbledhje nga mësuesi/ja.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Teknika RAFT, puno/shkëmbe.*

Në formën e teknikës RAFT, u kërkohet nxënësve që të zgjedhin një profesion të preferuar dhe që kanë njohuri rreth tij. Mund të mbështeten te profesioni i prindërve. Nxënësit duhet të trajtojnë shkurt një temë që ka lidhje me atë profesion dhe të krijojnë një tekst të shkurtër.

Orientohen nxënësit duke u kujtuar profesione si: mësues, doktor, jurist, gazetar, shofer, mekanik, etj.

Për 10 minuta nxënësit punojnë të lirë për të krijuar tekstin. Lexohen disa nga punët e nxënësve duke ndaluar te tiparet gjuhësore të regjistrimit të përdorur.

Punim ushtrimesh në grupe dyshe, ku të shkëmbehen përgjigjet me njëri-tjetrin.

Ushtrimi 1

Tematika e një teksti, përcakton llojin e shkrimit - x

Ligjërimit sipas regjistrimit të ngritur është më i segmentuar se ai në regjistrin e thjeshtë - v

Ligjërimit sipas regjistrimit të zakonshëm është gjithnjë në përputhje me normën letrare - x

Një tekst pa gabime drejtshkrimore, përmbush kërkesat për tekstin e shkruar në një regjistër të ngritur - x

Në çdo rast, folësi është i lirë të përzgjedhë regjistrin gjuhësor që parapëlqen - x

Ushtrimi 2 - sipas kërkesës.

Ushtrimi 3 - teksti i përket stilit shkencor-teknik dhe nuk mund të rishkruhet në një stil tjetër, sepse është tekst informues.

Ushtrimi 4 - stili politiko-shoqëror.

Ndoshta është i pafat, sepse çdo fillim sezoni i duhet të rindërtojë skuadrat e tij fituese dhe shumë shpesh ia del, por në këtë sezon janë dëmtimet e shpeshta të lojtarëve, që po ia bëjnë jetën ferr, aq më shumë në përballjet e rëndësishme si ajo me Napolin, një javë më parë, apo akoma më shumë edhe në 90-minutëshin e shumëpritur nga të gjithë bardhezinjtë, si ky i mbrëmjes së sotme kundër Interit.

Ushtrimi 5 sipas kërkesës lexohen nga mësuesi/ja disa ligje nga kodi penal dhe civil.

Një rast: Neni 14

Faji. Askush nuk mund të dënohet për një veprim, ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është e kryer me faj. Quket me faj, personi që e kryen veprën me dashje, ose me pakujdesi.

Ushtrimi 6 plotësohet në tekst nga nxënësit dhe diskutohen përgjigjet.

Komunikimi i folur	Komunikimi i shkruar
shoferi i makinës	Drejtuesi i automjetit
doktori i zemrës	Kardiologu
dhashë provim kiminë	Bëra provim në lëndën e kimisë
pije hapen	Pije ilaçin

Vlerësimi: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Xhonasi dhe ngjyrat (ora e parë)		Situata e të nxënimit: Foto të ndryshme me ngjyra	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: ngjyra; kujtime; dhënësi; zgjedhje; perceptim	
<ul style="list-style-type: none"> - Diskuton për rëndësinë e ngjyrave në përditshmëri. - Zbulon karakterin e personazhit kryesor. - Përshkruan ndjesitë e personazhit në çastin e parë të përballjes së tij me ngjyrat. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Romani: “Dhënësi”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi; Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stubi mendimi; kllaster; lexim zinxhir; pyetje-përgjigje</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>stubi mendimi</i>			
Nxënësve u shtrihen pyetjet:			
1- <i>Cilat ngjyra ju pëlqejnë?</i>			
2- <i>A ka ndonjë domethënie ngjyra juaj e preferuar?</i>			
3- <i>A e imagjinoni dot natyrën pa ngjyra? Pse?</i>			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>kllaster; lexim zinxhir;</i>			
Njihemi me romanin “Dhënësi” dhe autoren e tij			
Lexohet pjesa nga nxënësit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>pyetje-përgjigje</i>			
Lexoni fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.			
A do të ketë Xhonasi një jetë të zakonshme, si atë të gjithë të tjerëve? Cilat ngjyra sheh ai dhe ç'emotione provon?	<i>Jo, nuk do të ketë një jetë të zakonshme. Ai sheh ngjyrën e gjelbër, portokallinë e ndezur, të kuqen dhe blunë, të cilat i japin emocionin e zbulimit të gjërave të reja.</i>		
Cila ishte detyra e Dhënësit? Në ç'mënyrë ia jepte ai informacionin e ri Xhonasit? Dallon pyetjet e tij, që e bëjnë Xhonasin të mendojë.	<i>Detyra e dhënësit ishte t'i transmetonte Xhonasit gjithë kujtesën e së shkuarës nëpërmjet prekjes së duarve. Nuk është e drejtë? Shpjegohu çfarë do të thuash?</i>		
Ç'pjesë të karakterit të Xhonasit zbulohen në këtë fragment?	<i>Kureshtar, këmbëngulës, inteligjent.</i>		
Përshkruani ndjesinë kur Xhonasi i tregon lulet Asherit: ...shihni me shumë vëmendje ato lulet atje...	<i>Xhonasi kërkon t'u përcjellë shokëve ndjeshmërinë e tij të re. Për një çast, ai beson se mund të bëjë me shokët të njëjtën gjë që marrësi bën me të. Këmbëngul me mënyrën e tij, që dhe shokët të përjetojnë emocione të njëjta.</i>		
Për ç'të drejtë flet Xhonasi? A ka kuptim ajo në botën e tij?	<i>Të drejtën për të zgjedhur. E drejtë kjo, që nuk ka kuptim në botën e tij pa ngjyra.</i>		
Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni dhe shikoni filmin e realizuar mbi subjektin e kësaj vepre. Më pas diskutoni rreth tij.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Xhonasi dhe ngjyrat (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Puna me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: ngjyra; kujtime; dhënësi; zgjedhje; perceptim	
<ul style="list-style-type: none"> - Gjen detajet që ndikojnë në përjetimet e Xhonasit. - Analizon gjendjen shpirtërore të personazhit kryesor në përballjen me gjithë njohuritë e reja të së shkuarës. - Diskuton rreth lirisë së kontrolluar në botën aktuale të personazhit, krahasuar me shembuj konkret nga historia njerëzore. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Romani: “Dhënësi”		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi; Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim; ditar dypjesësh; punë në grup			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi i I: diskutim;			
Punohen ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5.			
2. Cili është efekti i përdorimit të detajeve, kur personazhi ynë përballet me një vend tërësisht të huaj? <i>Këto detaje nxjerrin në pah një perceptim të ri, tronditës, i cili bën që Xhonasi të dëshirojë ndërprerjen e kujtimit.</i>			
3. Si e përballonte Xhonasi peshën e njohurive të reja që merrte nga Dhënësi? <i>Personalisht, e përballonte me energji dhe entuziazëm, por dhe me zemërim ndaj vetes për pamundësinë e përcjelljes të shokët të njohurive të reja dhe ndjesive që provonte.</i>			
4. Pse Dhënësi e sheh me kureshti zemërimin e Xhonasit? <i>Zemërimi është një prej ndjesive që Xhonasi përjeton gjatë marrjeve të njohurive të reja, ndjesi që e individualizon duke e shkëputur nga turma.</i> - Pse Xhonasi e quan privilegj mundësinë për të zgjedhur? <i>Zgjedhja lidhet me vendimet, përgjegjësitë që njeriu merr në jetë duke krijuar individualizmin e tij larg nga njëtrajtshmëria.</i>			
5. Analizoni tronditjen e Xhonasit në fund të fragmentit. Ç’regon gjendja e tij shpirtërore? <i>Xhonasi ndjehet i tronditur sepse has për herë të parë mizorinë, një dhe përjeton dhembjen.</i>			
Hapi i II: ditar dypjesësh			
6. Komentoni fjalinë: <i>U përpoq ta mbante mend sa më gjatë të mundte dhe njëkohësisht, t’ia përcillte atë ndjeshmëri edhe shokut.</i>			
Fjalja		Komenti	
<i>U përpoq ta mbante mend sa më gjatë të mundte dhe njëkohësisht, t’ia përcillte atë ndjeshmëri edhe shokut.</i>		<i>Xhonasi përpiqej të ruante kujtimet dhe njohuritë e reja që përcillnin ndjesi të shumëllojshme. Dëshironte t’ua trasmetonte dhe shokëve, që të përjetonin energjinë dhe entuziazmin e tij.</i>	
Hapi i III:			
7. Interpretoni dy nga mesazhet që përcjell pjesa:			
Grupi i parë: Kujtesa ka rëndësi të veçantë dhe është e pazëvendësueshme për njeriun. <i>Kujtesa ka të bëjë me përvojën njerëzore që është mjaft e rëndësishme për zhvillimin e brezave.</i>			
Grupi i dytë: Vuajtja është pjesë e pandashme e njeriut dhe nëse hiqet mundësia për ta përjetuar, hiqet edhe mundësia për të mësuar, për t’u rritur, për t’u përmirësuar. <i>Jeta është komplekse dhe harmonizimi i ndjenjave, i ngjyrave, e bën më të bukur.</i>			
Hapi i IV: diskutim;			
Punohen ushtrimet 8 dhe 9.			
8. Çfarë nënkupton trepikëshi në shembullin: <i>E di që nuk ka rëndësi se çfarë vesh. Megjithatë...</i> <i>Mendimi është lënë përgjysmë dhe nënkuptohet. Trepikëshi përforcon atë që Xhonasi tha më parë për rëndësinë e zgjedhjes.</i>			

<p>9. Çfarë shprehin fjalët me të zeza? <i>portokallia e ndezur... rrit intensitetin e ngjyrës</i> <i>copës pa ngjyrë të rrobave të veta... zbehjen e jetës</i></p> <p>10. Diskutoni rreth lirisë së kontrolluar në botën ku jeton Xhonasi. (Rikujtojmë temën “Djali me pizhame me vija” për të konkretizuar njëtrajtshmërinë si dhe sjellim shembuj nga realiteti, si p.sh., diktatura).</p>
<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjitha hapat e orës mësimore.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 11. Trego me shkrim ndjesitë dhe përjetimet e tua rreth librave fantastikë që ke lexuar.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: “Ne dhe traditat tona”. Projekt (ora e tretë)</p>		<p>Situata e të nxënit: “Zakonet dhe traditat tona” Bajroni: “<i>Më tërheqin shumë me atë ngjashmërinë e tyre me Hajlanderët e Skocisë, në veshje, në pamje dhe në mënyrën e jetesës</i>”. Si kujtim, ai mori një kostum tradicional shqiptar, i cili është i ekspozuar në Angli.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: -bashkëpunon me shokët e shoqet për të sjellë informacionet dhe materialet e duhura, -përdor saktë mjetet kompjuterike për të prezantuar informacionin, -prezanton në mënyrën e duhur një material të dhënë, -dallon se çfarë janë traditat dhe zakonet, -nxjerr vlerat dhe rëndësinë e traditave dhe zakoneve, -përmbledh informacionin që prezantohet në klasë, -sjell informacion, detyra nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, duke përdorur strategji të ndryshme, -gjen në tekste të ndryshme letrare elemente të traditave shqiptare, -luan me role pjesë të ndryshme të marra nga folklori, -shkruan pa gabime drejtshkrimore në materialet e përzgjedhura.</p>		<p>Fjalët kyçe: Tradita Zakone Informacione Dasmë Gatime Veshje Këngë Valle Letërsi gojore</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të përgatitura nga mësuesja dhe nxënësit, foto nga interneti.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, pyetje-përgjigje, punë në grupe, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, lojë me role, improvizim, prezantim.</i></p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, pyetje-përgjigje.</i> Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me situatën. Shkruan në tabelë temën e projektit, rezultatet e pritshme të projektit dhe rikujtohen njohuritë rreth orës së dytë të projektit. Informacioni: <i>Burrat shqiptarë mbanin stoli të ndryshme argjendi, sumbulla dekorative tek jelekët, unaza, pipa e kuti cigaresh, por mbi të gjitha, armët e brezit e të krahut, që ishin gjithnjë të stolisura.</i> Nxënësit rikujtojnë informacionet e marra për veshjet dhe zakonet e burrave dhe i përforcojnë me materiale të tjera të përgatitura për projektin. Diskutohet rreth veshjeve të burrave sipas zonave, krahinave dhe situatës kur dhe ku do të përdreshin.</p>			

Pyetje: Po sot, vazhdon kjo traditë? Cilat janë veshjet e sotme të burrave e grave? A është veshja kulturë për çdo njeri? Nxënësit janë të lirë të japin disa mendime pa u ndikuar nga të tjerët.

Informacione shitesë që mund të sjellin nxënësit: Tipet kryesore të veshjeve popullore shqiptare për burra, janë: kostumi me fustanellë, kostumi me këmishë të gjatë e dollamë (cibun), sipër kostumi me tirq dhe ai me poture (pantallona të shkurtra deri te gjuri). Pra, në Shqipëri, burrat kanë mbajtur, si veshjet në formën e një fundi të gjerë, ashtu edhe ato në formë pantallonash. Pjesët më të zbukuruar, ishin jelekët dhe xhamadanët e kostumit festiv. Burrat shqiptarë mbanin edhe stoli të ndryshme argjendi, si jastëkë gjoksi, sumbulla dekorative tek jelekët, unaza, pipa e kuti cigaresh, por mbi të gjitha, armët e brezit e të krahut, që ishin gjithnjë të stolisura pasurisht.

Për gra, tipet kryesore të veshjeve, ishin: kostumi me xhubletë (një fund në formë këmbane), kostumi me këmishë të gjatë e xhokë shajaku sipër, kostumi me dyfuta të vendosura mbi këmishën e gjatë, njëra përpara e tjetra prapa dhe kostumi me mbështjellëse (një fund i hapur, i mbledhur te beli me rrudha, ose pala).

Në veshje, ngjyrat e zbukurimet ndryshonin sipas moshës. Për të vegjlit e të rinjtë, kostumi krahinor, mund të ishte më i thjeshtë. Ndryshe nga popuj të tjerë të Ballkanit, në Shqipëri, vajza që kishin arritur moshën e martesës, duhej të vishej thjeshtë e pa stoli, flokët t'i mbulonte mirë me një shami dhe të mos vishte rrobë të kuqe.

Kostumi i martesës ishte varianti më i pasur i veshjes së krahinës, si për nuset edhe për dhëndurët. Për nuset, stolitë metalike ishin të pamungueshme, madje, përdorehin edhe me tepri, sepse këtu, mësa duket, kishte rëndësi jo vetëm funksioni i tyre estetik, por edhe funksioni magjik që u përvishesh. Për nuset, rëndësi të veçantë kishte zbukurimi i kokës. Disa vjet pas martesë, veshja fillonte të lehtësohej nga zbukurimet.

Kostumi më i hershëm, që përcjell një mesazh qindraveçar, është xhubleta, e cila e ka origjinën përgjatë Alpeve dhe kalon deri në malësinë e Malit të Zi. Megjithatë etnografët më të shquar të Shqipërisë kanë bërë studime nga më të ndryshmet për të, akoma nuk është arritur në një shpjegim konkret, pse kjo veshje ka qenë ekzistente vetëm në malësinë e Veriut. Ndërsa elemente të tjera të antikitetit, që përcillen nëpërmjet veshjes popullore, janë këmisha e gjatë, struka (pelerina e gjatë) dhe opingat me majë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim.

Mësuesi/ja sqaron se këto informacione për veshjet popullore të burrave, i gjejmë edhe te “Çajld Harold” të Bajronit.

-Po cili ishte Bajroni që u shpreh kështu për shqiptarët?

-Çfarë i bëri përshtypje atij te shqiptarët?

-Ne jemi shqiptarë. Po çfarë na dallon ne nga qytetarët e tjerë të botës?

-Cilat janë ato cilësi apo veçori, që tregojnë tiparet e shqiptarëve?

(Sugjerim: Hapjen e orës së mësimi dhe prezantimin e temës, apo lidhjen me temën e kaluar, mund ta bëjë edhe ndonjë nxënës. Këtu mund të përdoret edhe material i gatshëm me projektor i shoqëruar me foto të Bajronit dhe të pikturës së tij me veshje popullore).

Pak nga Bajroni: Lindi më 22 janar 1788 në Londër në një familje aristokrate të varfër. Gjatë vizitës së tij në Shqipërinë e Jugut, në Janinë në vitin 1808, Lord Bajroni mori si kujtim nga ato vise një kostum tradicional shqiptar. Piktori Tomas Filips realizoi portretin e famshëm të Lord Bajronit veshur me kostumin shqiptar. Piktura titullohet “Portrait of a Nobleman in the dress of an Albanian” dhe dallon për bukurinë dhe veçantinë e tij.

Rikujtohen veshjet popullore të burrave dhe veçoritë e tyre e sidomos armët e stolisura.

Te poema romantike “Shtegtimet e Çajld Haroldit”, për Bajronin, Shqipëria ishte një vend me bukuri natyrore të rralla; shqiptarët njerëz të pashëm, trima, krenarë, me fustanella të bardha; kurse Ali Pashë Tepelena një kapedan i egër, por jo mizor, vezir por i pavarur, figura e tretë historike pas Aleksandrit të Madh dhe pas Skënderbeut.

Autori shprehet me vargjet: “Shqipëri, lejome të kthej syt’ e mi mbi ty, o nënë e rreptë burrash t’egër”, “Ç’armiq për vdekje, po sa miq besnikë”.

- Ne njihemi në botë për luftëtarë trima.
- Skënderbeu është një figurë që na prezanton në botë të zgjuar, të bashkuar.
- Bota na njeh si mikpritës, të ndershëm, të besës e që e mbajmë fjalën e dhënë.
- Respektojmë më të rriturit dhe dëgjojmë fjalën e tyre.
- Gëzimet dhe hidhërimet i ndajmë mes njëri-tjetrit dhe mbështesim njëri-tjetrin.
- Shqiptarët njihen në botë si njerëz krenarë e të palëkundshëm.
- Gëzimet shoqërohen me këngë e valle të ndryshme, ku shprehen mendimet dhe qëndrimet e popullit.
- Veshjet popullore janë të veçanta dhe me zbukurime të shumta edhe në armët e brezit, etj.

Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve dhe vlerëson me fjalë e shprehje përgjigjet e tyre. Nxënësit mund të plotësojnë e shtojnë njëri-tjerin.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Lojë me role, improvizim, prezantim.

Në bazë të tematikës së secilit grup dhe mënyrës së prezantimit nga anëtarët e grupeve, prezantohet puna e bërë për projektin.

<p>Grupet e ngritura prezantohen me:</p> <p>1- Grupi i këngëve popullore - bën një prezantim të shkurtër të mesazheve që përcjellin këngët, llojit të këngës dhe mund të këndojnë një këngë të përzgjedhur prej tyre .</p> <p>2- Grupi i valleve - nxjerr veçori të valleve sipas krahinave të ndryshme dhe luan një valle të përzgjedhur prej tyre nga një krahinë e caktuar.</p> <p>3- Grupi i gatimeve tradicionale -krijon një libërth recetash tradicionale, por organizon edhe një panair të thjeshtë me disa nga gatimet tradicionale të zonës.</p> <p>4- Grupi i veshjeve popullore - janë të veshur gjatë gjithë projektit me veshje popullore të krahinave të ndryshme dhe prezantojnë para klasës veçoritë e këtyre veshjeve.</p> <p>5- Grupi i letërsisë – krijon fletëpalosje në formën e reklamimit të kulturës, traditave dhe zakoneve të zonave apo krahinave të ndryshme, luan me role një pjesë nga letërsia gojore, si p.sh.: “Kalaja e Rozafës”, apo “Ymer Aga”.</p> <p>Grupi i letërsisë, bën mbylljen e projektit duke nxjerrë edhe në formën e esesë argumentuese, rëndësinë e njohjes dhe ruajtjes së traditave dhe zakoneve të popullit tonë.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Shndërrimi i doktor Xhekillit.		Situata e të nxënës: Lojë me sy të mbyllur. Ngrihet një nxënës në tabelë dhe i mbyllet sytë. Ai duhet të gjejë emrin e një nxënësi tjetër sipas përshkrimit të tipareve fizike dhe karakterit.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: – dallon mënyrën e rrëfimit – dallon rrëfimitarin, vetën dhe kohën e rrëfimit – nxjerr përfundime pasi ka lexuar dhe ka kuptuar një tekst – gjen funksionin e disa elementeve të formës të tekstit – analizon personazhet duke u përqendruar te fjalët përshkruese të autorit për personazhin		Fjalët kyçe: Tekst letrar Tregim Imagjinatë Personazh i trilluar Ndryshim Pamje Bota e brendshme	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, foto nga interneti të personazheve të ndryshme fantastike.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Lojë, bisedë e kombinuar me argumentim, shkrim i lirë, pyetje-përgjigje, minileksion, punë me tekstin, shënime paraprake, diskutim i lirë, puno dyshe.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Lojë, bisedë e kombinuar me argumentim, shkrim i lirë, pyetje-përgjigje. Në fillim të orës, mësuesi/ja njofton nxënësit për organizimin e lojës dhe i njej ata me mënyrën se si do të luhet. Ngrihet një nxënës në tabelë dhe i mbyllet sytë. Nga klasa ngrihet një nxënës tjetër dhe përshkruan nga pamja e jashtme njërin nga shokët e tjerë. Nxënësi me sytë e mbyllur duhet ta njohë dhe të gjejë emrin tij. Luhet kështu për disa nxënës. Në përfundim të lojës, nxënësit diskutojnë duke radhitur arsyet e gjetjes, apo të mosgjetjes së shokëve/shoqeve që u përshkruan.			

U kërkohet nxënësve që në formën e një shkrimi të lirë të përshkruajnë veten sipas tabelës:

Unë	Isha	Jam
Pamja fizike		
Bota e brendshme		

Nxënësit punojnë për të përshkruar veten dhe lexohen disa punime duke diskutuar edhe mes shokësh për vërtetësinë e përshkrimit.

Mësuesi/ja drejton pyetje për nxënësit, në formën e rikujtimit të njohurive dhe lidhjes me temën e re:

- Çfarë lloj teksti është kur përshkruajmë shokun apo veten? (*tekst përshkrues*)
- Cilat janë format e përbëra të rrëfimit në prozë? (*romani, novela, tregimi*)
- Cilat janë veçoritë e tekstit përshkrues? (*përshkruan pamjen dhe karakteristikat e personave, kafshëve, vendeve, etj*)
- Nga dallon teksti përshkrues nga ai rrëfimtari? (*sepse te teksti rrëfimtari, tregohen/rrëfëhen ngjarje që lidhen me një, apo disa personazhe*)

Ndërtimi i njohurive të reja: minileksion, punë me tekstin, shënime paraprake.

Mësuesi/ja sqaron: Personazhet e trilluara - Janë personazhe, të cilat autori i përshkruan si personazhe në jetën reale. Me anë të imagjinatës, këto personazhe përshkruhen si krijesa fantastike, por që përfaqësojnë ide dhe ndjenja të ndryshme. Personazhi i trilluar, lë mbresa dhe është tërheqës për pamjen dhe tiparet e tij të veçanta. Një personazh i tillë, është edhe Doktor Xhekill.

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Çështja e çuditshme e Dr. Xhekillit dhe e Z. Haid". Këtu rrëfëhet për një eksperiment që Dr. Xhekilli realizon në trupin e tij. Ai merr një substancë, të cilën e kishte krijuar vetë. Kur e pi, ai pëson një shndërrim të çuditshëm, kthehet në një njeri krejt të ndryshëm, në Z. Haid.

Thuhet se ideja për shkrimin e këtij teksti, autorit i ka ardhur nga një ëndërr e tmerrshme.

Punohet me tekstin duke e lexuar me kujdes. Nxënësve u lihen disa minuta për t'iu rikthyer tekstit dhe të rilexojnë nënvizimet që kanë bërë gjatë leximit të parë të tekstit, mbi fjalët dhe veprimet e doktor Xhekill.

Lexohen shënimet mbi veprimet dhe pamjen e doktor Xhekill, mbi shndërrimin e tij dhe ritregohet shkurtimisht teksti në formën e punës zinxhir.

(Eduard Haidi ishte shumë më i vogël, më i dobët dhe më i ri se Henri... e keqja ishte shkruar gjerësisht dhe qartë në fytyrën e tjetrit. Përveç kësaj, kishte lënë mbi atë trup një gjurmë shformimi dhe kalbësire)

(Por tundimi për një zbulim aq të veçantë e të thellë, më në fund i mposhti këshillat e maturisë)

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lirë, puno dyshe.

Punohet me ushtrimet e tekstit mbi të kuptuarit e pjesës. Diskutohen me radhë ushtrimet.

Ushtrimi 1

-Cili është vendi ku zhvillohen ngjarjet dhe pse është zgjedhur pikërisht ky vend? (*në laborator*)

-A ishte e rrezikshme ajo që bëri Dr. Xhekilli? (*po, sepse nuk e dinte çfarë e priste dhe nëse mund të kthehej përsëri në gjendjen e mëparshme*)

-Cilat janë personazhet e kësaj pjesë? (*Dr.Xhekilli*)

-Kush është Eduard Haidi? Ç'lidhje ka Z. Haid me Dr. Xhekillin? (*sepse është Dr. Xhekilli pas shndërrimit*)

-Pse i duhet Dr. Xhekillit pasqyra në laborator? (*që të shihte shndërrimin*)

-Si ka qenë jeta e Dr. Xhekillit deri në momentin e eksperimentit? (*E virtytshme*)

Çfarë synonte eksperimenti i dytë i bërë nga Dr. Xhekilli? (*nëse mund të kthehej ashtu siç ishte në fillim, në veten e tij me karakterin e Henri Xhekillit*)

Ushtrimi 2 (*në ndryshime të pamjes së jashtme dhe të botës së brendshme*)

Ushtrimi 3 Shndërrimi që ndodh është rruga drejt: (*së keqes*).

A ka kthim pas shndërrimit, në drejtim të anasjellë? - *Po*

Ushtrimi 4 Në këtë pjesë, rrëfimtari: (është vetë pjesëmarrës në ngjarje).

Çfarë vlere i shton tekstit kjo mënyrë të rrëfyerit? - (*E bën ngjarjen të duket më e vërtetë*).

Ushtrimi 5 Gjeni ndryshimet mes Doktor Xhekillit dhe Zotit Haid - (*Eduard Haidi ishte shumë më i vogël, më i dobët dhe më i ri se Henri; shkëlqente e mira mbi fizionominë e njerit, e keqja ishte shkruar gjerësisht dhe qartë në fytyrën e tjetrit*)

Ushtrimi 6 Punohet në grupe dyshe duke rikujtuar njohuritë për tekstet me mister.

a- *pirja e një lëngu, ilaçi, kërcitje të kockave, shndërrim fizik e shpirtëror.*

b- *laboratori, mëngjes i errët, korridoret.*

c- *Doktor Xhekill, një njeri i moralshëm, por që shndërrohet në një njeri të keq, në Eduard Haidin.*

Tek **Ushtrimi 7** - vargonjtë e detyrimeve = *ana morale*

<p>Ushtrimi 8 - (Rrëfimi nis me folje për të treguar intensitetin e veprimeve që po përjeton autori)</p> <p>Ushtrimi 9 - e figuracionit letrar.</p> <p>Si e shpjegoni këtë shpeshiti? - (për të krijuar imazhe, për të nxitur fantazinë, përfytyrime, për ta bërë më të bukur rrëfimin si edhe për ta bërë sa më prekës)</p> <p>Ushtrimi 10 - rrëfimi;</p> <p>Ushtrimi 11 - Diskutim i lirë rreth frazës së dhënë dhe reflektimi mbi rëndësinë e njohjes së vetes.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimit të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruaj një situatë imagjinare në të cilën je i lirë dhe pa detyrime. Si do të veprojë?</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme		Situata e të nxënimit: Të nxënimit me këmbime (Punë në dyshe)	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës. - Morfologji			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: fjalë të ndryshueshme, fjalë të pandryshueshme, klasa fjalësh, fjalë kuptimplota, fjalë jokuptimplota, fjalë thirrmore	
Nxënësi/ja:			
<p>-përcakton se ç'pjesë të ligjëratës u përkasin fjalët në një tekst të dhënë</p> <p>-dallon klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe klasën e fjalëve të pandryshueshme</p> <p>-dallon fjalët e mëvetësishme dhe të pamëvetësishme</p> <p>-dallon fjalët kuptimplota, fjalët jokuptimplota dhe fjalët thirrmore</p> <p>-krijon një tekst duke përdorur fjalë të klasave të ndryshme</p>			
Burimet: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, tabela.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Të nxënimit me këmbime (Punë në dyshe), Organizuesi grafik, Punë e pavarur, Punë në grupe</i>			
Organizimi i orës së mësimimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Të nxënimit me këmbime (punë në dyshe)			
Hapi I.			
Nxënësit gjejnë në dyshe klasën e fjalëve me shkronja të zeza në fillim të mësimimit. Përgjigjet e nxënësve, paraqiten në tabelë.			
Hapi II. Bëhet e njohur tema e re mësimore, duke e paraqitur në tabelë.			
Listohen në tabelë pyetjet			
-Mbi ç'kritere i grupojmë fjalët në klasa?			
-Ç'quajmë fjalë të ndryshueshme?			
-Ç'quajmë fjalë të pandryshueshme?			
-Ç'janë fjalët e mëvetësishme dhe të pamëvetësishme?			
-Ç'farë shprehin fjalët kuptimplota, fjalët jokuptimplota dhe fjalët thirrmore?			

Nxënësit lexojnë informacionin e paraqitur në tekst dhe u përgjigjen pyetjeve të listuara në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Organizuesi grafik

Klasat e fjalëve



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur, punë në grupe

Hapi I: Ushtrimi 1. Plotësohet në tekst.

Hapi II: Punë në grupe.

Grupi 1: Ushtrimi 2.

Nxënësit do të nënvizojnë me një vijë fjalët e ndryshueshme dhe me dy vija, fjalët e pandryshueshme.

Fjalë të ndryshueshme: tringëllima, e ziles, vazhdonte, ndihej, nxënësit, derdhën, korridoreve, oborri, gumëzhiti, zgjua bletësh, djema, shkojmë, fusha, është, kohë, e bukur, mund, bëjmë, një, ndeshje, futbollli, ky, që (p.lidhor) bënte, këtë, thirrje, ishte, Altini, nxënësit, e klasës, së nëntë, disa, shokët, dëgjuan, e (trajtë e shkurtër p.vetor), bjerë, shi, kemi, të pamundur, luajmë, shtoi, ai, ke, pranoi, Erli

Fjalë të pandryshueshme: të (pjesëz e lidhores), ende, kur, u, si, nga, dhe, të, nga, e (lidhëz), jo, se, nesër, të, kështu që, do ta (e trajtë e shkurtër+pjesëz), nuk, keq.

Grupi 2: Ushtrimi 3.

Emra: tringëllima, e ziles, nxënësit, korridoreve, oborri, zgjua, bletësh, djema, fusha, ndeshje, futbollli, thirrje, Altini, e klasës, shokët, shi, Erli

Mbiemra: e bukur, futbollli, së nëntë (mbiemër marrëdhënior), të pamundur

Folje: vazhdonte, ndihej, derdhën, gumëzhiti, shkojmë, është, mund, bjerë, bëjmë, bënte, ishte, dëgjuan, kemi, luajmë, shtoi, ke, pranoi

Përemra: ky, që, disa, këtë, ai

Numëror: një

Ndajfolje: ende, nesër, keq

Parafjalë: nga

Lidhëz: kur, e, se, kështu që, dhe

Pjesëz: të, u, si, jo, do të, nuk

Pasthirrmë ---

Grupi 3: Ushtrimi 3.

a) Në derë trokitën disa vajza. (përemër i) pacaktuar

b) Një njeri i panjohur po udhëtonte me makinën tonë. (mbiemër)

c) Në breg përplaseshin dallgë deti. (emër)

ç) A doni pak ujë burimi? (pjesëz)

d) O burra, jemi vonë për provimin! (pasthirrmë)

dh) Çfarë mendimi kenë për këtë nxënëse? (përemër dëftor)

e) Çdo mëngjes shkante në shkollë me autobus. (përemër i pacaktuar)

ë) Vëlla e motër u përqaftuan me mall. (lidhëz)

Grupi 4. Ushtrimi 5.

film i ri **dokumentar** (mbiemër), **dokumentarë** (emër), **rreth** të zi (emër), **rreth** saj (parafjalë), **buzë** detit (parafjalë), I dridhej **buza** (emër), **Më** kishin (p.vetor, trajtë e shkurtër), S'foli **më** (pjesëz), tryezën **të shtruar** (mbiemër), të fliste **shtruar** (ndajfolje), ana **e majtë** (mbiemër), rruga **majtas** (ndajfolje)



Dëgjohen përgjigjet e ushtrimeve nga një përfaqësues i çdo grupi.

Vlerësimi: nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, 6 sipas kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Romani grafik		Situata e të nxënit: Sinjalet rrugore. Shenjat e qarkullimit rrugor, janë tabela në të cilat janë të vizatuara shenja ndërkombëtare të standardizuara, të cilat shërbejnë për rregullimin e trafikut rrugor.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> -dallon llojin e tekstit, -diskuton rreth këndvështrimeve të ndryshme në një tekst dhe shfaq mendimet e tij, -vlerëson idetë që përcjell teksti, -analizon gjuhën e stilit e autorit, duke argumentuar mendimin e tij, -përcakton tiparet e disa teksteve në prozë, -analizon pamjet dhe bën lidhjen me situatën. 		<ul style="list-style-type: none"> Tekst letrar Lloji Roman Figura Onomatope 	
Burimet: Teksti i nxënësit “ Gjuha shqipe 9”, foto dhe materiale të gatshme.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Parashikimi me terma paraprakë, pyetje-përgjigje, minileksion, punë me tekstin, punë individuale, puno/ndihmo/shkëmbe, lojë me role.			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Parashikimi me terma paraprakë, pyetje-përgjigje.</i>			
Mësuesi/ja në fillim të orës, shfaq përpara nxënësve disa tabela, ku janë vendosur disa sinjale rrugore. Sinjalet mund të shfaqen me projektor, por mund edhe të merren nga materiale të gatshme të Kodit Rrugor.			
			
- Vendkalim për këmbësor		- Trafik i rënduar	
<p>Me nxënësit diskutohet rreth shpjegimit që i japin nxënësit këtyre tabelave dhe ku përdoren ato.</p> <p>Mësuesi/ja shënon në tabelë termat paraprakë si: libri, loja, topi, shokë, mëngjes, zilja, provim.</p> <p>Nxënësve u kërkohet që të krijojnë një situatë të thjeshtë me këto fjalë. Punohet individualisht për të lidhur dhe përdorur fjalët në një tekst që paraqet një situatë.</p> <p>Lexohen disa nga situatat e krijuara dhe rikujtohen njohuritë për komunikimin dhe llojet e tij.</p> <p>Me anë të sinjaleve, shenjave dhe fotografive, mund të arrihet komunikim jogjuhësor.</p> <p>Komunikimi gjuhësor, arrihet me anë të gjuhës së folur dhe të shkruar.</p> <p>Nxënësve u drejtohen disa pyetje si: Cilin libër keni lexuar së fundmi? Cilat lloje ju pëlqejnë më shumë? Po figurat që shoqërojnë tregimin apo tekstin e dhënë, çfarë qëllimi kanë?</p> <p>Merren disa përgjigje rreth pyetjeve sipas mendimit personal të secilit, duke sqaruar shkurt.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Minileksion, punë me tekstin.</i></p> <p>Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e re të mësimt “Romani grafik” dhe kërkon të dijë nëse nxënësit kanë njohuri rreth temës. Diskutohet rreth ideve që hedhin nxënësit mbi llojin e romanit dhe ndërtimin e tij.</p>			

Romani grafik është lloji letrar ku kombinohen fjalët me imazhet dhe me elementet komike. Ai shpesh paraqitet me një sërë ilustrimesh drejtkëndore brenda një faqeje libri. Romani grafik, është një rrëfim imagjinar që botohet në formë libri, “ilustrime që tregojnë një histori dhe janë botuar në formë libri”.

Romanet grafike, janë vepra të botuara zakonisht në formën e një libri dhe tradicionalisht me elemente të spikatura komizmi. Ndonjëherë tregojnë një rrëfim të vetëm, të vazhdueshëm nga faqja e parë deri në fund; ndonjëherë tjetër, janë përmbledhje të tregimeve më të shkurtra.

Romanet grafike, njësoj si gjithë romanët e tjerë, kanë: subjekt, ngjarje, personazhe, konflikt, veprim.

Një nga figurat letrare që gjendet në romanet grafike, është onomatopeja.

Onomatopeja: Është figurë e përsëritjes, që ka bazë imitimim e zhurmave të zërave të natyrës dhe të qenieve të gjalla. Ky fenomen, është mjaft i përhapur në gjuhë ndërsa, kur përdoret në letërsi, merr karakter shprehës duke sjellë atmosferën me të cilën lidhet kuptimi i pjesës.

P.sh : 1 - zhurma e derës që mbyllet me forcë: Brramm! 2 - zhytja në baltë: Pllaq-plluq.

Punohet me tekstin duke lexuar informacionin e dhënë.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë individuale, puno/ndihmo/shkëmbe, lojë me role.*

Nxënësit udhëzohen të punojnë me kujdes me fotot e tekstit tek **Ushtrimi 1** në mënyrë të pavarur, duke i kushtuar rëndësi detajeve në foto.

Poshtë fotove nxënësit shkruajnë situatën që imagjinojnë gjatë shikimit të fotove.

Diskutohet rreth përgjigjeve të dhëna dhe nxënësit argumentojnë e sqarojnë përzgjedhjen e situatës.

Situata 1 - Dy shoqe që kanë një keqkuptim mes tyre. Shoqja e parë donte të kërkonte falje, por Kioko nuk e dëgjon dhe largohet duke përplasur derën.

Situata 2 - Dikush nga klasa IX, flet thashetheme për një shoqe, e cila ndodhet në infermieri.

Ushtrimi 2 punohet individualisht nga nxënësit sipas kërkesës. Fjalët e shkruara duhet të kenë lidhje me pamjet dhe rrjedhën logjike të një teksti.

Ushtrimi 3 punohet me grupe, ku nxënësit do të ndihmojnë njëri-tjetrin për të krijuar një situatë problematike mes një shoku, një grindaveci e një heroji që i vjen në ndihmë shokut.

Për të krijuar situatën, nxënësit do të mbështeten te fotot e dhëna. Teksti i krijuar në grup, dorëzohet te mësuesi/ja dhe lexohet përpara klasës, duke diskutuar për tekstin që ka bërë lidhjen dhe përshtatjen më të mirë me fotografitë e tekstit.

Grupet luajnë me role situatën e krijuar prej tyre, duke nxjerrë edhe mesazhin e tekstit.

Vlerësimi: Nxënësit do të motivohen dhe vlerësohen me shprehje gjatë gjithë orës.

Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve. Gjithashtu, nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një tekst të shkurtër, duke e shoqëruar me foto e vizatime.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Test për tremujorin e parë.		Situata e të nxënit: Tremujori i parë. Nxënësi duhet të përqendrohet te pjesa e dhënë dhe pyetjet e testit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: -lexon pjesën për të nxjerrë të dhënat që i kërkohen, -analizon personazhet, -zbërthen kuptimin e shprehjeve të dhëna, -dallon llojin e tekstit dhe dialektin që i përket, -analizon përdorimin e figurave letrare, -gjen se cilit ligjërimit dhe stil i përket një tekst, -korrigjon saktë fjalët e shkruara gabim sipas njohurive të drejtshkrimit, -dallon mënyrën e formimit të fjalëve të ndryshme, -dallon ligjëratën e drejtë dhe e kthen saktë në ligjëratë të zhdrejtë duke pasur parasysh ndryshimet që pëson.		Fjalët kyçe: Test Vlerësim Tremujor Njohuri	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, fletët e testit nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
Stuhi mendimi, punë me modele, punë individuale.			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimi. Mësuesi/ja për të hequr emocionet në fillim të orës pyet nxënësit se si ndihen dhe i qetëson ata me fjalë e shprehje të ndryshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë me modele. Mësuesi/ja shpërndan fletët e testit dhe udhëzon e sqaron shkurtimisht nxënësit për testin dhe mënyrën se si do të punojnë dhe plotësojnë ushtrime të ndryshme. Disa nxënës mund të kenë nevojë për ndihmë dhe sqarime më të hollësishme, prandaj u kërkohet nxënësve që të kenë kujdes në leximin e pyetjeve dhe të lexojnë me vëmendje tekstin.			
Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale. Mësuesi vendos qetësi në klasë dhe nxënësit punojnë në mënyrë individuale për plotësimin e testit. Në fund të orës, mblidhen fletët për të bërë vlerësimin me notë sipas përgjigjeve të dhëna nga secili.			
Vlerësimi: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimit të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive.			
Detyrat dhe puna e pavarur:			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Panair portofoli (tremujori i parë).		Situata e të nxënit: Reklama Reklama është një veprim, imazh apo fjalë që tërheq vëmendjen e publikut ndaj diçkaje.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të mësuarit për të nxënë Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -vlerëson punimet e shokut/shoqes, -bën vetëvlerësimin e punimeve të portofolit, -nxjerr dhe grupon shkurt njohuritë që ka përvetësuar, -radhit rastet kur është ndier krenar, apo është zhgënjyer për vlerësimet e marra, -prezanton përpara shokëve/shoqeve, punimet e portofolit në formën e një reklamimi, -ndërthur njohuritë gjuhësore me ato matematikore, duke bërë llogaritjen e pikëve si dhe kthimin e pikëve në notë.		Fjalët kyçe: Portofol Detyrë Saktësi Vlerësim Vetëvlerësim Njohuri Panair	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të gatshme të sjella nga mësuesi/ja, portofolet e nxënësve, detyrat e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera, ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Teknologji, TIK dhe Matematikë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, ditarët e të nxënit, punë e pavarur, analizë rasti, lojë me role, rrjeti i diskutimit, turi i galerisë.			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Reklama” dhe drejton pyetjet: Çfarë janë reklamat? Cilat janë reklamat që ju pëlqejnë më shumë? Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje gjatë shikimit të tyre? (pyetje-përgjigje) Dëgjohen përgjigjet e nxënësve dhe mësuesi/ja nxit nxënësit që të plotësojnë hartën e mendimit me idetë e tyre. Secili nxënës argumenton dhe sqaron shkurtimisht mendimin e tij (bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim).			
<pre> graph TD A[Reklama] --> B[Lloji i tekstit] A --> C[Qëllimi] A --> D[Përbërësit] B --> E[Tekst joletrar Ka elemente letrare] C --> F[Informon Paraqet Reklamon] D --> G[Imazhet Fjalët Muzika] </pre>			
Mësuesi/ja bën prezantimin e temës së mësimt duke sjellë disa informacione rreth reklamave. <i>Reklama është një veprim, imazh apo fjalë, që tërheq vëmendjen e publikut ndaj diçkaje.</i> <i>Reklamat kanë ekzistuar që në vitet 3000 para lindjes së Krishtit. 63% e njerëzve duhej ta shikonin nga 3-5 herë reklamën që të besonin tek ajo.</i>			

Në vitin 1965, daton e para gazetë që përdor reklamë në përmbajtjen e saj.

Reklama është bërë pjesë e stilit të jetës sonë dhe çdokujt.

Reklamat ndeshen edhe gjatë një panairi ku reklamohen mallra të ndryshme. Një panair i thjeshtë do të zhvillohet edhe me portofolët e nxënësve. Secili nxënës do të reklamojë punët e detyrat e tij, por do të njihet edhe me detyrat shokëve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Ditarët e të nxënët, punë e pavarur, analizë rasti.

Mësuesi/ja shpërndan portofolët e nxënësve të plotësuar me detyrat e dhëna dhe të vlerësuar me pikë sipas skemës së qortimit.

Nxënësit njihen me vlerësimet e bëra dhe pikët që kanë marrë për secilën detyrë.

Mësuesi/ja u shpërndan nga një fletë nxënësve për të bërë vetëvlerësimin dhe vlerësimin e portofolit.

Model flete vetëvlerësimi.

Nr	Vetëvlerësim	Tremujori i parë	Tremujori i dytë	Tremujori i tretë
1	Gjatë këtij tremujori kam mësuar:	<i>Nxënësi shënon njohuritë që ka përvetësuar gjatë tremujorit të parë.</i>		
2	Kam hasur vështirësi në:	<i>Nxënësi shënon temat, apo rubrikat ku ka hasur vështirësi.</i>		
3	Unë mendoj se niveli i njohurive të mia është:	<i>Nxënësi shprehet se sa i kënaqur është me nivelin e njohurive dhe vlerëson njohuritë e tij.</i>		
4	Për të rritur nivelin e njohurive duhet:	<i>Nxënësi mediton mbi nivelin e njohurive dhe jep disa ide mbi rritjen e nivelit të njohurive.</i>		
5	Njohuritë e marra janë me vlerë sepse:	<i>Nxënësi argumenton asyen se përse këto njohuri janë me vlerë si edhe ku e gjejnë përdorimin në jetën e përditshme.</i>		
6	Ajo që më ka bërë përshtypje gjatë procesit të të nxënët është:	<i>Radhiten disa elemente apo detaje, që i kanë bërë përshtypje gjatë procesit mësimor.</i>		
7	Rastet kur kam qenë krenar, apo kur jam zhgënjyer:	<i>Situata reale ku nxënësi është ndier krenar, apo anasjelltas.</i>		
8	Vlerësimi i shokut/shoqes për dosjen:	<i>Shoku vlerëson portofolin me fjalë e shprehje.</i>		
9	Vlerësimi i prindit për dosjen:	<i>Mendimi i prindërve për portofolin e nxënësit.</i>		

Nxënësi punon në mënyrë të pavarur për të bërë vetëvlerësimin e portofolit (punë e pavarur, vetëvlerësim).

Më pas, nxënësit shkëmbejnë dosjet mes tyre për të bërë vlerësimin e portofolit të shokëve (vlerësim për shokun).

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Lojë me role, rrjeti idiskutimit, turi i galerisë.

Mësuesi/ja ngre me dëshirë disa nxënës që të bëjnë prezantimin e portofolit të tyre në formën e një reklame, për të sqaruar pikët që kanë marrë, mënyrën e punimit, se si janë ndier për vlerësimin nga mësuesi/ja apo shoku, të tregojnë për vështirësitë apo njohuritë që kanë përvetësuar (rrjeti idiskutimit).

Gjithashtu nxënësit argumentojnë dhe sqarojnë hollësisht vlerësimin që u kanë bërë portofolëve të nxënësve të tjerë. Analizohen disa raste vlerësimi (analizë rasti).

Nxënësit zgjedhin një grup prej 4-5 nxënësish që të luajë rolin e jurisë për të bërë vlerësimet për prezantimin e portofolëve (lojë me role).

Juria vendoset përpara klasës në një pozicion anësor, me qëllim që të shohë të gjithë nxënësit e klasës, por edhe nxënësin që do të prezantojë punimet e tij për shokët e shoqet.

Nxënësit e klasës duhet të veçojnë nga portofoli i tyre punimin më të mirë, për ta vendosur në një kënd të caktuar si “Panairi i punimeve”.

Me anë të “Turi i galerisë”, prezantohen punimet e të gjithë nxënësve dhe në fund, juria vendos dhe zgjedh disa nga punimet e realizuara më bukur, por edhe më saktë.

Me anë të rrjetit të diskutimit, në fund diskutohet për vlerën e njohurive të marra dhe se si mund të përmirësohen e rritet niveli i tyre.

Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje nga mësuesi/ja. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit.

Nxënësit do të vlerësohen me notë për detyrat e bëra në portofol.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Gjithçka fillon nga respekti për veten (ora e parë).		Situata e të nxënit: Oh sa mirë me qenë shqiptar! Jam krenar që jam shqiptar! Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqipëtar, zemrën ti ma gatove, plot me dëshirë e me zjarr.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon llojin e tekstit sipas veçorive të tij duke përcaktuar tiparet e disa teksteve në prozë, - përshkruan dhe diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, me detaje nga teksti, - analizon pamjet e dhëna në romanin grafik dhe bën lidhjen me situatën, - tregon situata reale që lidhen me temën, - lidh njohuritë e marra me temën e re. 		<ul style="list-style-type: none"> Roman Dinjitet Mohim Respekt Krenar Integrim 	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<i>Diskutim i lirë, pyetje- përgjigje, fjalë kyçe, imagjinatë e drejtuar, minileksion, puno dysheshkëmbe, hulumtim.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>diskutim i lirë, pyetje-përgjigje.</i>			
Në fillim të orës së mësimt mësuesi/ja shtron situatën duke shkruar në tabelë shprehjen: O sa mirë me qenë shqiptar! Interpretohen nga nxënësit apo mësuesi/ja disa vargje të poezisë së Naim Frashërit: “Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqipëtar, zemrën ti ma gatove, plot me dëshirë dhe me zjarr”.			
Rikujtohen situata, ngjarje, pjesë filmash dhe këngësh që lidhen me këto shprehje.			
Diskutohet me nxënësit për emocionet që krijohen prej këtyre shprehjeve dhe vargjeve të autorit.			
Shtrohen pyetje si:			
1- Përse autori ndihet krenar që është shqiptar? (<i>Duke qenë shkrimtar i romantizmit, Naimi ngre lart tiparet e shqiptarëve dhe duke marrë si pikë referimi Skënderbeun dhe kohën e tij të lavdishme, ai është krenar që është pjesë e këtij populli</i>)			
2- Cilat janë ato veçori dhe tipare që kanë shqiptarët që e bëjnë të ndihet i tillë? (<i>Ndihet krenar që është pjesë e këtij populli trim, të ndershëm, të besës e punëtor. Popull mikpritës.</i>)			
3- Cili autor i huaj ka thurur vargje për luftëtarët shqiptarë dhe tiparet dalluese të tyre? (<i>“Shtegtimet e Çajld Haroldit” Bajroni. Shqipëria për të ishte një vend me bukuri natyrore të rralla; shqiptarët njerëz të pashëm, trima, krenarë, me fustanella të bardha; kurse Ali Pashë Tepelena, një kapedan i egër, por jo mizor, vezir por i pavarur, figura e tretë historike pas Aleksandrit të Madh dhe pas Skënderbeut. Autori shprehet me vargjet: “Shqipëri, lejomë të kthej syt’ e mi mbi ty, o nënë e rreptë burrash të egër”, “Ç’armiq për vdekje, po sa miq besnikë”.</i>)			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Fjalë kyçe, imagjinatë e drejtuar, minileksion.</i>			
Hapi i I: Në lidhje me përgjigjet e dhëna nga nxënësit, mësuesja shkruan në tabelë disa fjalë kyçe: atdhe, krenar, integrohem, respekt, dinjitet, kombësi.			
Nxënësit sqarojnë me radhë sipas mendimeve për lidhjen mes këtyre fjalëve. Dëgjohen mendimet dhe sqarohet nga mësuesi/ja, kuptimi i këtyre fjalëve në fjalor.			
<i>(Atdhe – vendi ku kemi lindur e jemi rritur, krenar - e çmon, e respekton veten, nuk e ul kokën para të tjerëve, integrohem-përfshihem në një të tërë si pjesë përbërëse, respekt-nderimi që kemi për dikë a kundrejt diçkaje, dinjitet-tërësia e vlerave morale të njeriut, kombësi-bashkësi e qëndrueshme njerëzish, të qenit pjesëtar i një kombi).</i>			

Nxënësit sjellin ngjarje dhe situata nga përvojat personale, të cilat kanë lidhje me fjalët kyçe. Këto fjalë kyçe, kanë shumë lidhje me historinë e vendit tonë dhe emigrimin e shqiptarëve në botë.

Në lidhje me shpjegimin e kuptimeve të fjalëve kyçe, mësuesi/ja njih nxënësit me temën e re “Gjithçka fillon nga respekti për veten”.

Hapi i II:

Me anën e imagjinatës së drejtuar kërkohet nga nxënësit që të imagjinojnë ngjarje dhe situata që kanë lidhje me temën e dhënë.

Dëgjohen disa përgjigje dhe nxënësit vlerësojnë e plotësojnë njëri-tjetrin për të plotësuar e saktësuar situatat e imagjinuara.

Hapi III: Punohet me tekstin duke lexuar informacionet dhe sqaruar llojin e romanit. Rikujtohen njohuritë rreth llojeve të romanit dhe tiparet e romanit grafik dhe autobiografisë.

Llojet e romanit – ndarja e romaneve bëhet kryesisht sipas temës dhe lëndës.

Sipas temës dhe lëndës që trajtojnë, ata mund të jenë: *kriminalistikë, historikë, socialë, psikologjikë*, etj.

Sipas mënyrës së qasjes së problemit, romanet mund të jenë: *humoristikë, satirikë, publicistikë*.

Një lloj i veçantë romani, është ai *grafik*.

Romani grafik, është lloji letrar ku kombinohen fjalët me imazhet dhe me elementet komike. Ai

shpesh paraqitet me një sërë ilustrimesh drejtkëndore brenda një faqeje libri. Shumë romane grafike, theksojnë dramën, aventurën, zhvillimin e karakterit e të tjera tematika të rëndësishme.

(Informacionet shtesë lexohen e sqarohen nga mësuesi/ja, por mund të jenë porositur edhe nxënësit të sjellin informacione rreth temës së kërkuar).

Autobiografia është rrëfimi i jetës personale.

Termi rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë: Të shkruash për jetën tënde.

Ngjajet në autobiografi, kanë ndodhur realisht dhe tregohen sipas një rregulli kronologjik. Në tekstin autobiografik tregohen vetëm çastet më të rëndësishme të jetës së autorit. Ngjarjet e jetës së autorit ndërthuren me ngjarjet e jetës shoqërore.

Autobiografia e Satrapit, është një histori aktuale dhe e pakohë e jetës së një vajze nën Revolucionin Islamik.

Karakterit i veçantë dhe frymëzues i një çupëline, e cila transformohet, mbi sfondin e një revolucioni islamik, disa luftërash, migrimesh dhe kthimesh, nga një vajzë në një grua të re, energjike dhe rebele.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Puno dyshelsbkëmbë, hulumtim.*

Hapi i I: Punohet rreth të kuptuarit të tekstit.

Ushtrimi 1. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe dyshe dhe të shkëmbejnë përgjigjet e sakta me njëri-tjetrin. Të udhëzuar nga mësuesi/ja, nxënësit i rikthehen tekstit dhe hulumtojnë mbi të kuptuarit e tekstit. Kjo detyrë punohet për disa minuta dhe më pas diskutohet me të gjithë klasën.

Dallonit situatën me të cilën nis pjesa.

Hapi i II: Renditni ndryshimet fizike që pëson vajza dhe karakteristikat e moshës që ndeshen te personazhi ynë. - (*Vajza është e acaruar, e inatosur, zgjatet, i ndryshojnë tiparet fizike, nuk i pëlqen vetja, mbyllet në vetvete, nuk hapet me prindërit*).

Nxirri detajet që tregojnë mospëlqimin që ka vajza për veten. Me cilën situatë sociale lidhen ato? - (*zgjatja e mjekrës, zmadhimi i hundës, nishani; kemi adoleshencën; prerja e flokut; lyerja e syve dhe veshja e çuditshme, sjellja e çuditshme me shokët dhe shoqet, por edhe me prindërit*).

Çfarë e bën të veçantë vajzën? Zbuloni momentin e rebelimit të saj. (*prerja e flokut; lyerja e syve dhe veshja e çuditshme, mohimi që i bën faktit e të qenit iraniane, kur mohon origjinën, po dukej ndryshe*).

Çfarë informacionesh marrim për jetën në Iran dhe dramacitetin e saj përmes rrëfimit të vajzës? - (*për gjendjen e keqe dhe revolucionin të Iran; bombardohet çdo ditë në Teheran*).

Sa e lidhur është vajza me familjen e saj? - (*Ata flasin në telefon dhe interesoheshin për njëri-tjetrin; ndihej fajtoje kur shihet lajmet, sepse ata bombardoheshin, kurse ajo mundohet të mos kujtonte asgjë dhe mohonte origjinën; nuk i tregon të vërtetën familjes*);

A luan ajo rolin e një dëshmitareje të realitetit? - (*luan rolin e një vajze që dëshmon për realitetin dhe gjendjen në Iran duke qenë se teksti ka elemente biografike dhe ngjarjet janë të vërteta*).

Diskutohet mbi veprimet e personazhit dhe gjendjen në të cilën ajo ndodhet. Nxënësit gjykojnë në fund të orës sjelljet e Marzhanës duke argumentuar përgjigjet e dhëna.

Vlerësimi: Vlerësimi motivues. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Informacione për Iranin.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Gjithçka fillon nga respekti për veten (ora e dytë).		Situata e të nxënit: Adoleshenca. Zhvillimi i adoleshencës, karakterizohet nga fillimi i pubertetit me një rritje të vullshme të masës trupore, të masës neuronale. Ndryshime të mëdha biologjike përfshijnë ndryshime si: lartësia, pesha, zëri, masa të muskujve, si dhe ndryshime të mëdha në strukturën e trurit dhe të organizmit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> -siguron informacione shtesë që lidhen me temën, -diskuton rreth këndvështrimeve të ndryshme në një tekst dhe shfaq mendimet e tij, -përmbledh shkurtimisht një ngjarje të lexuar, -gjykon për vlerat e një teksti duke përdorur ilustrime dhe detaje nga teksti, -analizon gjuhën e stilit e autorit, duke argumentuar mendimin e tij, -analizon veprimet e personazheve duke ilustruar me shembuj nga teksti, -lidh ngjarjet me situata reale dhe me njohuritë historike. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Roman Autobiografi Shndërrim Mohim Krenari Vetvetja Dinjitet Integrim 	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja për Iranin e për “Kozeta” të V. Hygo.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, analizë rasti, minileksion, gjej/zëvendëso, pyetje-përgjigje, prezantim, rrjeti i diskutimit.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, analizë rasti. Në fillim të orës, mësuesi/ja pyet nxënësit se cilat janë gjërat që i kanë mërzitur, apo shqetësuar në këtë ditë. Nxënësit japin përgjigje të ndryshme, të cilat mund të lidhen me familjen e tyre, shoqërinë dhe moshën e tyre. Zhvillohet një bisedë e lirë rreth njohurive që kanë mbi adoleshencën, moshën që përfshin ajo, ndryshimet që sjell te djemtë dhe te vajzat. Adoleshenca është një fazë e zhvillimit fizik dhe mendor të njeriut, zakonisht e renditur ndërmjet fazës së fëmijërisë dhe pjekurisë. Lidhim njohuritë me situatat reale dhe analizojmë disa raste të ndryshimeve të vetë nxënësve gjatë adoleshencës. Analizohen raste si: ndryshime fizike të shokëve apo shoqeve, ndryshime të karakterit, ndryshime në sjellje, marrëdhëniet që krijohen me të tjerët dhe me familjen. Nxënësit japin mendime rreth gjërave që u pëlqejnë në këtë moshë. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Minileksion, gjej/zëvendëso.</i> Hapi i I: Çdo autor ka veçantinë e tij në të shkruar, ka mënyrën e vet të përdorimit të gjuhës, krijon modelet e tij të shprehjes, pra krijon stilin e tij të veçantë. Stili ndryshon nga njëri shkrimtar te tjetri, por edhe nga një periudhë letrare në tjetrën. Gjatë procesit të të shkruarit, shkrimtari e përdor fjalën jo vetëm në kuptimin e parë, por i jep asaj edhe kuptime të dyta, të figurshme. Këto fjalë me kuptim të dytë të figurshëm, rrisin anën shprehëse të tekstit, nxisin imagjinatën dhe e bëjnë lexuesin të kënaqet e të argëtohet. Këto fjalë, quhen figura stilistike. Shprehjet e figurshme janë shprehje të cilat përdoren të ngurtësuar dhe kuptimi i tyre mund të zëvendësohet nga një fjalë e vetme.			

Hapi i II: Nxënësve u jepen disa shprehje dhe u kërkohet që t'i zëvendësojnë.

Shprehje: Iu bë zemra mal – u gëzua, e priti me zemër të hapur - e mirëpriti, u bë pikë e vrer – u hidhërua, i ka hyrë lepuri në bark – është frikësuar, shkel e shko – keq, na prishe gjakun – na shqetësove.

Romani grafik përdor edhe ilustrimet për të treguar ngjarjen, apo situatën, në të cilën ndodhen personazhet.

Romanet grafike, janë vepra të botuara zakonisht në formën e një libri dhe tradicionalisht me elemente të spikatura komizmi. Ndonjëherë ata tregojnë një rrëfim të vetëm, të vazhdueshëm nga faqja e parë deri në fund; ndonjëherë tjetër, janë përmbledhje të tregimeve më të shkurtra. Si të gjitha romanet e tjera, kanë: subjekt, ngjarje, personazhe, konflikt, veprim.

Ritregohet subjekti i pjesës “Gjithçka fillon nga respekti për vete” duke përdorur detaje nga gjuha e përdorur dhe ilustrimet që u kanë mbetur në mendje nxënësve.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Pyetje-përgjigje, prezantim, rrjeti i diskutimit.

Hapi I: pyetje përgjigje:

2. Pse ndihej e lumtur dhe në faj protagonistja kur komunikonte me prindërit? Si gërshetohen në mendimet e saj forca e dëshirës dhe e arsyes? Shpjegoni kuptimin që mbart shprehja: *Madje arrita të mohoja edhe kombësinë time*. Me çfarë është i lidhur ky qëndrim?

Analizohet ushtrimi sipas mendimit të nxënësve (*ndihet në faj për sjelljen e saj sepse ata ishin në luftë dhe po bombardoheshin, ndërsa ajo përpiqej të mohonte origjinën; e lumtur që ata ishin mirë dhe po fliste me ta. Dëshira ishte që të harronte gjithçka nga e kaluara, por arsyeja nuk e linte të qetë edhe natën në gjumë, sado që nuk e quante më veten iraniane; ky qëndrim lidhet me rebelimin ndaj situatës në Iran dhe gjendjes në të cilën ajo ndodhet*).

3. Kujtimet janë pjesë e pandarë e njeriut. Si i rrëfen vajza ato? *Sqarohet me shembuj ku kujtohen fjalët e gjyshes dhe gjatë natës i vijnë kujtimet në gjumë*.

4. Pse vajzës i bën përshtypje dhe i mbetet në mendje porosia e gjyshes? (*Shprehja i bën përshtypje, sepse në fillim, ajo nuk e kupton porosinë dhe domethënien e saj; “sillu me dinjitet dhe respekto veten” janë dy gjëra të rëndësishme për një njeri, i cili duhet të sillet sipas normave morale, të respekton veten, origjinën, gjë që Marzhana nuk po e bënte. Kuptimin dhe domethënien e shprehjes, e kupton vetëm në fund të tekstit*).

5. “Persepolis”, vepra nga është shkëputur ky fragment, është me elemente autobiografike. Analizoni rëndësinë e detajeve të tilla në këtë pjesë. (*Teksti ka elemente autobiografie si: origjina, rritja, pamja, gjendja në Teheran. Këto elemente e bëjnë të besueshme, të vërtetë ngjarjen dhe më prekës rrëfimin*).

Hapi. Për **ushkrimin 6** sillet informacion shtesë nga mësuesi/ja, ose nga vetë nxënësit, me anë të projektorit në formën e prezantimit.

(*Kozeta ishte e vetmuar, pa shoqëri, e vuajtur, viktimë e pafajshme, e pafat*)

Viktor Hygo në këtë roman, glorifikon historinë franceze të shek XIX, i merr në mbrojtje qeniet e mitura, të keqtrajtuara dhe të nëpërkëmbura. Fantina kishte një vajzë të quajtur Kozetë, vajzë ilegjitime. Për të siguruar bukën, e ëma ish marrë me prostitucion. Kozetën e çuan të punonte si shërbëtoreshë në një familje të pasur, e cila ishte pasuruar në sajë të plaçkitjeve që ishin bërë në luftën e Vaterlosë. Zhan Val Zhani e shpëton Kozetën nga kthetrat e familjes ku punonte dhe shpëton Mariusin e plagosur rëndë, i cili më vonë martohet me Kozetën.

Kozeta paraqet personazhin më të përkryer, i viktimës së pafajshme, shërbëtoreshë.

7. Interpretoni qëndrimin e vajzës, të shprehur në fjalët: *Ishte më lehtë të gënjeje, sesa ta mbaje [barrën e të qenit iraniane]*. Pse integrimi në shoqëri për të është i vështirë? (*Duke gënjer që nuk ishte iraniane, ajo nuk i jepte sqarime askujt për prejardhjen e saj, për luftën, për situatën në Teheran, për prindërit e saj dhe përse ndodhej këtu vetëm. Integrimi për të, ishte i vështirë, se vinte nga një vend me të tjera zakone dhe tradita, por shihej me sy tjetër dhe paragjykohej për origjinën e saj, pamjen dhe sjelljen*).

8. Ku qëndron origjinaliteti, apo e veçanta e kësaj pjese? (*E veçanta qëndron në mënyrën e rrëfimit që shoqërohet edhe me pamje, mënyra se si na njeht me veten e saj, me përjetimet e ngjarjeve, me ndryshimet që i ndodhin*).

9. Gjeni disa folje që tregojnë ndryshimet fizike të vajzës. (*U zgjat, u zmadhua, trefishoi, u zbukurua, preva*).

10. Me ç'qëllim përdoren nuancat e ironisë? (*Ironia përdoret për të treguar, që duke u rritur po shëmtohet dhe nuk i pëlqente fare vetja dhe flet me ironi për ndryshimet që po ndodhnin në trupin e saj*).

11. Zëvendësoni shprehjen frazeologjike me një fjalë të vetme:
më kërcëu damari - _____ (*U inatos*).

12. Merrni informacion rreth Iranit. Pyesni mësuesin e historisë, shihni dokumentarë të ndryshëm rreth tij, ose hulumtoni në internet. Diskutoni në klasë rreth këtij vendi.

(*Nxënësit, në formën e detyrës së shtëpisë, janë porositur të hulumtojnë në internet, për të sjellë disa informacione rreth Iranit në formën e detyrës së shtëpisë*).

<p>Lexohen shkurt disa informacione nga nxënësit.</p> <p>Revolucioni Iranian njihet edhe si Revolucioni Islamik. Në janar të vitit 1978, filluan protesta të mëdha të popullatës kundër Shahut. U bënë greva dhe ekonomia e vendit arriti në një krizë të madhe. Pas kësaj, Shahu në shkurt të vitit 1979, iku nga Irani dhe me ikjen e tij, Ajatollah Ruhollah Homeini vendosi të kthehet në Iran. Më 1 prill 1979, Irani, zyrtarisht u shndërrua në Republikë Islamike. Në dhjetor të vitit 1979, shteti e konfirmoi Kushtetutën Teokratike dhe si Lider Suprem, u zgjodh Ruhollah Homeini. Pas kësaj, u ndalua muzika dhe gazetat. Beni Sadr u zgjodh Kryetar i shtetit. Ky Revolucion me shpejtësinë e zhvillimit, ishte burim çuditësor për botën, mbase nuk kishte as rezistencë ushtarake, as kundërkryengritje.</p> <p>Hapi i II: diskutim</p> <p>Diskutohet me nxënësit në formën e rrjetit të diskutimit, ku nxënësit janë të lirë të shprehin saktë, qartë dhe bukur mendimin e tyre rreth çështjeve- (<i>marrëdhëniet me familjarët, mendimet e tyre për veshjet, sjelljen, këshillat e më të rriturve</i>).</p> <p>14. Zbërthehet opinioni i dhënë sipas ideve të nxënësve mbi veprën dhe mënyrën e interpretimit të ngjarjeve dhe situatave nga Satrapi në romanin grafik; vlera e përdorimit të grafikës.</p>
<p>Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësisht të ushtrimeve e për saktësinë e njohurive. Do të vlerësohet me notë arsyetimi i përgjigjeve të dhëna, informacionet shtesë që janë sjellë si edhe lidhja e njohurive me temat e tjera. Nxënësit do të bëjnë vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ese me temë: Integrimi i vërtetë, nis nga respekti për veten.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Kategoritë gramatikore të emrit (ora e parë)		Situata e të nxënit: Dallojnë emrat në fjalitë e dhëna.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <p>Përcakton kategoritë gramatikore të emrit.</p> <p>Dallon mjetet gramatikore për të përcaktuar saktë gjininë e emrit.</p> <p>Dallon emrat e dygjinishëm</p>		<p>Fjalët kyçe: emër, llojet e emrit, kategori gramatikore, gjini, numër, rasë, trajtë, gjini natyrore, gjini gramatikore, mbaresa, tingulli fundor i temës, fjalë përcaktuese, emra të dygjinishëm.</p>	
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 1, Tabela e emrit		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>	
<p align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p align="center"><i>Punë individuale, INSERT (Diskutim në grup, Tabela përmbledhëse), pema e mendimit</i></p>			
<p>Organizimi i orës së mësim</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Punë individuale</p> <p>Mësuesi njeh nxënësit me temën e re mësimore dhe i drejton ata në libër në faqen 241. Në tekstin e dhënë në krye të mësim, nxënësit, dallojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT</p>			

Duke qenë se emri dhe kategoritë gramatikore të tij, janë marrë dhe në klasat e mëparshme, mësuesi drejton nxënësit të punojnë me tabelen INSERT, ku do të klasifikojë informacionin sipas kolonave të tabelës.


□	+	-	?
---	---	---	---

- shënohet informacioni që nxënësit e dinë, ose mendojnë se e dinë;
- + shënohet informacioni, që nxënësit e kanë të ri;
- shënohet informacioni që kundërshton, ose është ndryshe nga ajo që nxënësit dinë;
- ? shënohet informacioni që është i paqartë për nxënësit.

- b) Pas leximit, nxënësit reflektojnë mbi atë që kanë lexuar dhe diskutojnë rreth pyetjeve që shtron mesuesi:
 Cilat njohuri i dinit më parë? Cili është informacioni i ri që nxoret gjatë leximit? A keni pyetje apo paqartësi për to?
- c) Nxënësit punojnë në grupe me nga 4 nxënës sipas bankave të njëpasnjëshme, duke rishikuar tabelat që kane plotësuar. Nxënësit shikojnë se ku ka pasur mosperputhje, diskutojnë për to dhe sqarojnë paqartësitë me njëri-tjetrin, por dhe me ndihmën e mësuesit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pema e mendimit

d) Në përfundim, nxënësit në grup ndërtojnë **Pemën e mendimit** të emrit.



Vlerësimi: Behet vlerësimi i nxënësve duke pasur parasysh dallimin e emrave në hapin e parë si dhe bashkëpunimin gjatë punimit të tabelës INSERT.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni kategoritë gramatikore të emrave në paragrafin e fundit të tregimit në faqen 83. Tregoni nëse janë të dygjinishëm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Kategoritë gramatikore të emrit (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Dallimi i kategorive gramatikore të emrave.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - Përcakton kategoritë gramatikore të emrit. - Dallon dhe përdor mjetet gramatikore për të përcaktuar saktë gjininë e emrit. - Dallon emrat e dygjinishëm.		Fjalët kyçe: emër, llojet e emrit, kategori gramatikore, gjini, numër, rasë, trajtë, gjini natyrore, gjini gramatikore, mbaresa, tingulli fundor i temës, fjalë përcaktuese, emra të dygjinishëm.	
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 1, Tabela e emrit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë e pavarur, diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Mësimi nis me leximin e detyrës së shtëpisë. Në paragrafin e fundit të tregimit, në faqen 83, nxënësit kane dalluar emrat dhe kanë përcaktuar gjininë e tyre. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur</i> Punohen individualisht në mënyrë të pavarur, ushtrimet në tekst, në faqet 243-244. Ushtrimi 1. a) G ; b) G; c) V; d) V; e) G; f) G. Ushtrimi 2. Lulet - emër i gjinisë femërore, shumë Lexim - emër i gjinisë mashkullore, numri njëjës Shqipëria - emër i përveçëm, gjinia femërore (prej) fjalëve-emër në rasën rrjedhore, shumë Erës - emër në rasën dhanore, numri njëjës I klasës - emër në rasën gjinore, numri njëjës Librin - emër në rasën kallëzore Ushtrimi 3. Gjinia mashkullore Hap, ari, gjest, nxënësit, plaku, e Altinit, fëmijët Gjinia femërore Duart, mësueses, pastërtinë, lëvizje, të qafës, krenari, i revistës, fletët, të pemëve, Gjinia asnjansë Të vështruarit, të nxehtë. Ushtrimi 4. Emra konkretë Emra abstrakte Shkollë (F), makinë (F), celular (M), skuadër (F), flutur (F), mollë (F), Miqësi (F), bukuri (F), studim (M), të lexuarit (A), drejtësi (F), liri (F), të mësuarit (A) kala (F), dorë (F), bukë (F), pemë (F), lepur (M) Ushtrimi 5. emision-i-t, ekran, bregdet-i, dyqan, mall-ra, projekt-i-n, variant-e, mal-e-t, vend, pyll, det-i-t, Sqarim! Sqarohen nxënësit, që të punojnë duke dalluar të gjitha mbarestat. Te fjala: emision-i-t, -i- është mbaresa e shquarsisë, ndërsa –t, është mbaresa e rasës. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>diskutim</i>			

<p>Ushtrimi 6. <u>Male</u> të larta, ata njerëz, <u>dokumente</u> të vjetra, këta libra, të gjitha <u>lajmet</u>, <u>personazhe</u> të njohura, ata emra, hapa të shpejtë, këto <u>studime</u>. Çdo ushtrim diskutohet në klasë duke përfshirë të gjithë nxënësit.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve, mund të bëhet nga mësuesi me shprehje apo notë, per çdo ushtrim.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, faqja 244.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: Emri: kategoria gramatikore e numrit Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji</p>		<p>Situata e të nxënit: Lojë fjalësh me emra që ndryshojnë rrënjën gjatë shndërrimit në numrin shumës</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përcakton kategorinë gramatikore të numrit të emrit; -dallon emrat që përdoren vetëm në shumës dhe vetëm në njëjës; -dallon emrat në numrin shumës dhe tregon mënyrat e formimit të shumësit. 		<p>Fjalët kyçe: Numri: njëjës, shumës, mbaresa-prapashtesa trajtëformuese,</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, 2;</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim për njohuritë paraprake (Brainstorming), Punë e drejtuar, Punë individuale, Diskutim</i></p>			
<p>Organizimi i orës së mësimt</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim për njohuritë paraprake (Brainstorming)</i></p> <p>Në një tabak të bardhë, apo dhe në tabelë, shkruhet fragmenti i mëposhtëm. U kërkohet nxënësve të dallojnë emrat dhe të përcaktojnë numrin e tyre.</p> <p>Me <u>kalimin e kohës</u>, njëra nga <u>pemët</u> u tha nga <u>pleqëria</u> dhe nga <u>druri</u> i kalbur, doli një <u>insekt</u>. Ishte një <u>krimb</u> i bardhë i gjatë dhe grykës, pas <u>fletëve</u> të buta të <u>bimëve</u>. Ai u shumëzua aq shumë, sa vuri në <u>rrezik jetën e bimëve</u> të tjera. Atëherë, <u>Mukoli</u>, vuri <u>dorezat</u> dhe e përzuri me të gjithë <u>pasardhësit</u> e tij. Lejoi që të mbetej vetëm një <u>krimb</u>.</p> <p>Kur emri është në numrin njëjës? Po në numrin shumës?</p> <p>-A është ndonjë nga emrat që përdoret vetëm në numrin njëjës? (pleqëria, Mukoli) Po vetëm në numrin shumës? (dorezat)</p> <p>U kërkohet nxënësve të kthejnë emrat e gjetur nga njëjësi në shumës dhe anasjelltas, me qëllim që të dallojmë mënyrën e formimit të numrit shumës, p.sh.:</p> <p>(Një) kalim - (disa) kalim-e mbaresa/prapashtesa trajtëformuese -e (një) kohë - (disa) kohë-ra - II- -II- -ra (një) pemë -(disa) pemë njësoj si njëjësi, pa mjet trajtëformues (një) rrezik - (disa) rreziq-e me ndërrim tingulli k-q dhe me mbaresë/prapashtesë trajtëformuese -e</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e drejtuar</i></p> <p>Drejtohen nxënësit në tekst në faqen 246, për t' u njohur me llojet e emrave që përdoren vetëm në numrin njëjës dhe vetëm në numrin shumës.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë individuale, Diskutim</i></p> <p>Punohen ushtrimet 1 - 5 në faqen 247. Për ushtrimet 1, 4, 5, klasa ndahet në dy grupe, duke i dhënë secilit grup për të punuar gjysmën e ushtrimit, por nxënësit punojnë individualisht.</p> <p><i>Ushtrimi 1. Dalloni emrat në numrin shumës, duke treguar mënyrën e formimit të shumësit.</i></p> <p>Këto ditë kam pasur <u>takime</u> me <u>miq</u> të rinj. Babai do të përpiqet për t' i zgjidhur ato <u>probleme</u>. <u>Shfaqjet</u> vazhduan të kishin sukses. Ngriti dorën dhe vërtiti fletën. Asnjë fëmijë nuk duhet të thotë <u>fjalë</u> që lëndojnë të tjerët. <u>Vajzat</u> dhe <u>djemtë</u> duhet të vendosin nëse do të grupohen sipas <u>projekteve</u> që kanë zgjedhur. Ai mund t' i zbatonte <u>projektet</u>, nëse do të ndihmohej nga të gjithë. Ne pamë dy <u>ndeshje</u> të bukura këtë të diel. Në ato <u>brigje</u>, vihej re një dukuri interesante. Dyshi i shumëzuar me dy jep katër.</p>			

Ushtrimi 2. Vendosni në numrin shumës emrat e gjinisë mashkullore dhe nënvizoni prapashtesat që marrin.

kapitull i ri –kapituj të rinj, ballkon me lule - ballkonë me lule, kufi me tela - kufij me tela, bishtalec i gjatë - bishtaleca të gjatë, mjeshtrë sporti - mjeshtra sporti, brez i humbur - breza të humbur, mësues karriere - mësues karriere, planet i ri - planetë të reja, telefon shtëpie - telefona shtëpie, zinxhir ari - zinxhira ari, treg perimesh - tregje perimesh, vit i kaluar - vite të kaluara

Kujdes emrat e dygjinshëm!

Ushtrimi 3. Qarkoni në vargjet e mëposhtme, emrat që përdoren vetëm në një numër dhe formoni fjali me ta.

libër, projekt, fizikë, dije, frikë, aktrim, aktor, skenarist familje, lule, argjendet, fotografi, personazh, përrallë, shtojzovallet, mal, frut, ushqim, gjizë, blerje, sëmundje, fruth, gjilpërë, antibiotiku, syzet, sy, numër, okulist, vizitë, qytet, perëndim, bregdet, plazh, shqipja, dokument, studiu, kapitull.

Ushtrimi 4. Vendosni në numrin shumës emrat dhe tregoni se çfarë kategorie gramatikore e përbashkët i bashkon. shkollë e re – shkolla të reja, fjalë e ëmbël – fjalë të ëmbla, natë vere – net vere, dardhë vjeshte – dardha vjeshte, borë e bardhë – borëra të bardha, derë hekuri – dyer hekuri, supë me perime – supëra me perime, letër falënderimi – letra falënderimi, shtëpi pushimi – shtëpi pushimi, ëndërr me sy hapur – ëndrra me sy hapur.

I bashkon kategoria gramatikore e trajtës. Të gjithë emrat janë në trajtën e pashquar, njëjës.

Ushtrimi 5. Gjeni emrat dhe përcaktoni gjininë dhe numrin e tyre, duke i vendosur në një tabelë.

Një sërë mendimesh të çuditshme u shfaqën në mendjen e saj. Pranë një pylli me pisha gjendet një fshat i madh. Dy prej nxënësve nuk u paraqitën në provim. Vendimi juaj është i rëndësishëm për mua. Një grumbull turistësh me aparate fotografike në duar zbritën nga autobusi. Bulevardi i madh “Dëshmorët e Kombit”, shkëlqente prej dritave shumëngjyreshe. Në afërsi të kësaj kalaje, kalon rruga “Egnatia”. Përreth nuk dëgjojmë asnjë zhurmë.

Emrat	Gjinia	Numri
mendimesh	femërore	Shumës
mendjen	femërore	Njëjës
pylli	mashkullore	Njëjës
pisha	femërore	Shumës
fshat	mashkullore	Njëjës
nxënësve	mashkullore	Shumës
provim	mashkullore	Njëjës
vendimi	mashkullore	Njëjës
grumbull	mashkullore	Njëjës
turistësh	mashkullore	Shumës
aparate	femërore	Shumës
duar	femërore	Shumës
autobusi	mashkullore	Njëjës
bulevardi	mashkullore	Njëjës
Dëshmorët	mashkullore	Shumës
e Kombit	mashkullore	Njëjës
dritave	femërore	Shumës
afërsi	femërore	Njëjës
kalaje	femërore	Njëjës
rruga	femërore	Njëjës
Egnatia	femërore	Njëjës
zhurmë	femërore	Njëjës

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në të gjitha fazat e orës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 247.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Sharlota. (Bisedë letrare, ora e parë)		Situata e të nxënit: Holokausti. Në disa vende të Evropës, popullsia vendase, i dorëzonte hebrenjtë në duart e nazistëve. Por pati popuj që i fshihnin, strehonin dhe i mbronin hebrenjtë. Shembulli më i njohur, janë shqiptarët. Hebrenjtë në Shqipëri kaluan mirë dhe nuk përjetuan fatin tragjik të bashkëkombasve të tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi : -dallon rrëfimtarin, vetën dhe kohën e rrëfimit, -dallon subjektin e pjesës që lexon, -nxjerr personazhet e romanit dhe disa veçori të tyre, -përshkruan, -diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti, -sjell përvoja personazhesh të tjerë të ngjashme me ato të personazheve të romanit, -dallon mënyrën e rrëfimit në roman duke i dhënë ngjarjet në rend kronologjik, ose kohor, etj.		Fjalët kyçe: Roman në vargje Hebre Luftë Sharlota Pikturë Jetë, apo teatër? Vdekje	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja, mbi Foenkinos dhe <i>Charlotte Salomon</i> , romani në vargje “Sharlota” e Foenkinos.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<i>Stubi mendimi, informacione shtesë, leximi zinxhir, karrigia e autorit, prezantim, punë me tekstin, analizë teksti.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stubi mendimi, informacione shtesë.</i>			
Mësuesi/ja njih nxënësit me fjalën: Holokaust.			
Kërkon nga nxënësit që të flasin rreth kësaj fjale dhe emocionet që përcjell kjo fjalë.			
Shtrohen pyetjet: - Çfarë është Holokausti? - Ç'dini për të? - Ku u shtri e u përhap? - Çfarë përmasash mori? Ç'janë kampet e përqendrimit? - Si u sollën nazistët me hebrenjtë? - Përse vepruan ashtu? - Cila ishte ideologjia e tyre? - Po shtetet e tjera, si u sollën me hebrenjtë refugjatë? Po në Shqipëri, si u sollën me hebrenjtë? - A keni lexuar histori e ngjarje, ku personazhet kanë qenë pjesë e terrorit nazist?			
Diskutohet me nxënësit rreth njohurive që ata kanë mbi Holokaustin dhe këto njohuri mund të plotësohen nga mësuesi/ja me anë të informacioneve shtesë.			
Holokausti është iniciativa më famëkeqe, për shfarosjen e njerëzve në historinë e botës.			
Hitleri në librin e tij “ <i>Lufta ime</i> ” shënon: “ <i>Raca gjermane është racë pasardhëse e racës ariane (popull që ka jetuar shumë vite më parë - qytetërim i zhdukur tanimë) dhe racë e pastër dhe si e tillë duhet ta sundojë botën... disa popuj duhet të zhduken nga faqja e dheut, hebrenjtë, romët dhe sllavët</i> ”.			
Hitleri, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kishte krijuar shumë burgje dhe kampe përqendrimi. Kampet kishin filluar të hapeshin që nga viti 1940. Ndër kampet më të njohura, ishin: Kampi Auschwitz-Birkenau, Kampi i Aushvicit, i Dahaut, i Mat'hauzenit, i Belsenit, i Firensburgut.			
Në këto vende, ishin vendosur njerëz nga të gjitha vendet e pushtuara nga blloku nazi-fashist. Në këto kampe, u mbytën, u torturuan dhe u bënë eksperimente të gjalla në fushën medicinale. Shumë njerëz për të mos parë skenat e tilla dhe për të mos përjetuar torturat, bënë vetëvrasje.			
Terrori ndaj njerëzve në kampet e përqendrimit kishte ndërruar formën. Vrasjet me bomba, armë zjarri, pushkatimet, mbytjet me tortura... ishin bërë të zakonshme. Nazistët donin t'i mbytnin njerëzit pa lënë gjurmë. Prandaj, filluan asgjësimin e tyre nëpërmjet helmimit masiv në dhomat me gaz në shumicën e kampeve të përqendrimit. Mbytja me gaz brenda një dite, arrinte deri në 20.000 njerëz. Trupat e pajetë të njerëzve hidheshin në furra me temperatura të larta, për të zhdukur çdo gjurmë. Shumica e këtyre njerëzve ishin hebrenj.			

Shqiptarët i mbrojtën aq shumë hebrenjtë, sa që i mbajtën edhe në familjet e tyre. Kjo ndodhi në shumë qytete të Shqipërisë, si: në Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Krutë, Shkup, Prishtinë, etj.

Në Belsen, Holandë, 15 vjeçarja me familjen e saj 4 anëtarëshe ishte e izoluar në bodrumin e një firme. Ajo kishte mbajtur ditar gjatë kohës. Ajo tregon torturat që ushtronin nazistët, rrethanat e kohës dhe mënyrën e jetesës në atë izolim. Ditari i saj u botua pas vdekjes nga i ati, i cili arriti të mbijetonte në kampin e përqendrimit: “*Ditari i Ana Frankut*”. Po për këtë temë flet edhe “Djali me pizhama”, i cili është bërë edhe film dhe nxënësit e njohin.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Leximi zinxhir, karrigia e autorit, prezantim.*

Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e orës së mësimi “Sharlota”, një lloj i veçantë romani i shkruar në vargje.

Romani në vargje është një formë e ndërmjetme mes poezisë dhe prozës.

Lexohet teksti dhe sqarimet për romanin në vargje nga nxënësit, në formë zinxhiri.

Karakteristikat kryesore të romanit në vargje në vargje janë: *prania e skenave intensive emocionale* (përqendrimi në luhatjet emocionale të personazheve), *përdorimi i formave poetike* (vargje të lira, hapësira boshe, thurje të pazakonta të vargjeve), *ndërtimi i veçantë i subjektit*.

Në formën e karriges së autorit, një nxënës pasi është përgatitur për jetën e tij dhe ka marrë informacione për krijimtarinë e Foensinos, luan rolin e të qenit vetë ai. Nxënësit e klasës zhvillojnë pyetje (në formën e intervistës) që lidhen me krijimtarinë e jetën e tij dhe nxënësi i përgatitur përgjigjet. (*Këtu mund të ndërhyrje edhe mësuesja për të plotësuar apo saktësuar nxënësin, nëse është e nevojshme*).

David Foensinos, është një nga shkrimtarët bashkëkohorë më të njohur në Francë. Ishte profesor kitare para se të bëhej një nga shkrimtarët më të njohur në Francë. Tashmë, ai është autor i dhjetëra romaneve, të përkthyer në tridhjetë gjuhë të botës. Me romanin “Delikatesa” ai u bë një nga autorët më të shitur në Francë. Në vitin 2014, me veprën “Sharlota”, Foensinos, korri shumë sukses me lexuesit dhe me kritikën, duke fituar dy çmime letrare të rëndësishme.

Library Journal shprehet: “*Teksti zhvillohet si një psalm i shenjtë, një varg fjalish të shkurtra, të gjata jo më shumë se një rresht. Ky kufizim, e detyron autorin të mbajë njëfarë serioziteti, thekson tensionin, shmang shkarjet në lotime. Ky roman magjepsës, lexohet si të ishte një rrëfenjë e kaluar gojarisht nga babai te biri, një rrëfenjë që nuk duhet harruar*”.

Në këtë roman, Foensinos i ka thurur lavde vajzës dhe gruas që mundohet të jetë vetvetja (*Mësova t'i shkelja të gjitha shtigjet dhe kështu u bëra vetvetja*). Ajo përpiqet të mbijetojë, të jetojë me pasion e delikatesë. Autori sjell një vëzhgim të imtësishëm të dhimbjeve të saj, duke na sjellë edhe realitete të kohës.

“Sharlota” u kthye në një fenomen letrar ndërkombëtar, duke fituar disa çmime letrare (Renaudot dhe Goncourt des Lycéens) dhe u bë një *bestseller*.

Edmond Tupe përkthyes dhe shkrimtar shqiptar. Ka lindur në Tiranë në vitin 1947. Studimet i kreu në vendlindje, u diplomua për gjuhë e letërsi frënge në Universitetin e Sorbonës, Paris. Fillimisht pedagog në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, pastaj mësues në qytetin e Gramshit, më vonë, përkthyes në Tiranë. Autor tekstesh universitare, vëllimesh me poezi e prozë në shqip dhe frëngjisht, leksikograf, publicist e kritik përkthimesh, laureat çmimesh kombëtare e ndërkombëtare. Ka shqipëruar vepra të shkrimtarëve francezë: Proust, Tournier, Sartre, Giono, Maurois, Delerm, Plazy, etj. Ka përkthyer në frëngjisht autorë shqiptarë si F. Kongoli, I. Kadare, D. Çomo, D. Çuli.

Si shkrimtar, ai ka botuar disa tituj: “Mos ik, o ma” dhe “Kur dhimbja premtion dashuri”.

Mësuesi/ja mund të plotësojë informacionet për Sharlotën dhe romanin në linkun: (<https://ëëë.google.com/search?q=leben+oder+theater+salomon&source>).

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë me tekstin, analizë teksti.*

Nxënësit kanë lexuar romanin dhe gjejnë momentin në të cilin përshkruhen ngjarjet e fragmentit të dhënë. Identifikojnë momentin jetësor kur Sharlota krijon veprën e saj “Jetë apo teatër”. (*ngjarja ndodh pasi një ushtar nazist e zbrit nga autobusi në Nicë dhe i shpëton jetën. Ajo shkon te doktor Moridis dhe ai e këshillon të pikturojë. Kur shkon në “La belle Aurore”, fillon të shkruajë e pikturojë gjithë jetën e saj*).

Në formë zinxhiri ritregohet subjekti i romanit në vargje.

Subjekti i romanit në vargje “Sharlota”: Ky roman i veçantë rrëfen historinë e artistes Sharlotë Salomon, e lindur në prag të Luftës së Dytë Botërore në Berlin, në një familje hebraike dhe të traumatizuar nga disa tragjedi të brendshme. Vetëvrasjet i ndiqnin pas dhe në çdo 13-vjeçar, do të kishte një vetëvrasje. Përjeton që e vogël ndarjen nga e ëma po për shkak të vetvrasjes sepse hidhet nga dritarja. Rritet nën kujdesjen e babait dhe të njerkes, por shpesh edhe nën kujdesjen e gjyshërve.

E dashuruar pas artit dhe vetë jetës, Sharlota rritet, edukohet dhe dashurohet marrëzisht në Gjermaninë e fillimit të nazizmit. Përkeqësimi i ndjeshëm i gjendjes në Gjermani, e shtyn atë drejt arratisjes pa dëshirën e saj, pa mbushur akoma moshën për pasaportë në Francë, ku në vetminë më të thellë që përjeton, sidomos pas vdekjes së gjyshes së saj, përjeton ethshëm kujtimin e dashurisë e të braktisjes dhe krijon një sërë veprash autobiografike (imazhe, fjalë dhe referenca muzikore), të cilat rrëfejnë gjithë historinë e jetës së saj.

Përndjekja e hebrenjve, mbërrin edhe në Francë me dorëzimin e Francës dhe vrasjet dhe vuajtjet filluan sërish për ta. Sharlota jetonte në heshtje, pa shqetësuar njeri, në heshtje të plotë në “La belle Aurore”, por e keqja e ndjek edhe aty, vdekja e ndjek pas. Në një moment në Francë, e ndien se po afrohet fundi dhe pikturon duke pasqyruar gjithë jetën e saj. Këto i fut në një valixhe dhe ia jep doktor G. Moridis, i cili duhej t’ia jepte zonjës Mur, bamirëses amerikane, që e ndihmoi dhe e strehoi në Francë.

Analizohet teksti i nisur nga ndërtimi i romanit - Përse autori ka zgjedhur që ta shkruajë në këtë formë? (ngjarja është tronditëse, nuk të lë të qetësohesh. Autori kishte kohë që studioje jetën e saj, që mbidhte të dhëna dhe kur ka mësuar historinë u trondit nga ngjarjet, u prek dhe këto emocione, donte t’i përcillte po kështu te lexuesi, siç i përjetoi ai vetë dhe jo thjesht një roman historik).

Autori e bën veten pjesë të romanit, luan rolin e rrëfimitarit, por edhe të personazheve që herë hyjnë e herë dalin nga romani dhe shprehet:

Nuk arrija dot të shkruaja dy fraza njëra pas tjetrës. Diçka më pengonte në çdo pikë. E pamundur të bëja përpara.

Ishte një ndjesi fizike, një ngulçim. E ndieja të nevojshme që të dilja me kryeradhë për të marrë frymë.

Gjatë studimit të tekstit, nxënësit kanë nxjerrë personazhet e romanit dhe një tipar dallues të tyre.

Personazhet kryesore të romanit: Sharlota, personazhi kryesor; Alberti, i ati i Sharlotës; Frensiska, e ëma e Sharlotës; çifti Grynvald, gjyshërit e Sharlotës nga e ëma; Paula, njerka e Sharlotës; Alfredi, i dashuri i Sharlotës; Otili Muri, bamirësja amerikane që i strehoi në Francë; doktor Moridis, mjek që ndihmoi Sharlotën në Francë; Aleksandër Nagleri, refugjat austriak, i cili martohet me Sharlotën në Francë.

Personazhe dytësore: Ludvig Bartningu, profesori që bëri të mundur futjen e saj në Akademinë e Arteve të Berlinit; Barbara, e vetmja shoqe e Sharlotës, ariane; Anxhelo Donati, politikan italian që ndihmoi hebrenjtë; prefekti Shenjo, zhduku listat administrative duke shpëtuar kështu shumë hebrenj.

Personazh negativ: Alois Bruneti, vrasësi i tmerrshëm i çifutëve, më i tmerrshmi.

Nxënësit plotësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit për të nxjerrë personazhet duke treguar për rolin e tyre në ngjarje dhe në jetën e Sharlotës.

Vlerësimi: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, për mënyrën e formulimit. të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Nxënësit do të bëjnë edhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni figura të ndryshme letrare të përdorura nga autori dhe zbrërtheni kuptimin e tyre.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Sharlota. (Bisedë letrare, ora e dytë)		Situata e të nxënit: Arti dhe ndjenjat. Arti është një burim, një urë komunikimi mes qenieve njerëzore, kulturave dhe popujve. Në art përfshihen elemente të ndryshme materiale e shpirtërore, formale, krijuese dhe mishërohet puna e njeriut me ndjenjat, emocionet e tij.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: -merr informacionet e duhura gjatë leximit të një teksti, -analizon personazhet, duke u përqendruar: te fjalët përshkruese të autorit, te fjalët, veprimet, mendimet e tij, -dallon dhe shpjegon funksionin figurave të ndryshme letrare, -shpreh pëlqimin e tij për personazhe të ndryshme, -jep opinionin e tij rreth çështjeve të caktuara dhe i mbron ato duke ilustruar nga teksti.		Fjalët kyçe: Roman në vargje Sharlota Alberti Gjyshërit Hebre Kampe Art Vdekje	

<p>Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja mbi Foenkinos dhe Charlotte Salomon, romani në vargje “Sharlota” e Foenkinos.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, pyetje-përgjigje, punë e drejtuar, analizë teksti, analizë personazhesh, punë me tekstin, punë paraprake.</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimit</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, pyetje-përgjigje.</p>	
<p>Mësuesi/ja lidh temën e mësimit me njohuritë e mëparshme duke ngritur një situatë: Arti është një mundësi e mirë për të shprehur ndjenjat.</p>	
<p>Në formën e bisedës së lirë, nxënësve u drejtohen disa pyetje: - Si mendoni ju? - A jeni dakort me këtë thënie? - Ku mbështeteni për të dhënë mendimin tuaj? - Po ju a i keni shprehur ndonjëherë ndjenjat përmes artit? - A jeni ndjerë më mirë më pas? -A është e vërtetë se arti i bën të pavdekshme ndjenjat? - Jepni ndonjë rast që e keni ndeshur këtë.</p>	
<p>Dëgjohen përgjigjet e nxënësve dhe mësuesi/ja nxit bisedën dhe ndihmon nxënësit të japin përgjigje të sakta dhe të ilustruojnë me shembuj. <i>(Ana Franku shkruajti një ditar për jetën e saj, ngjarjet historike që përjetoi).</i></p>	
<p>Nga nxënësit, përmendet gjithashtu rasti i Sharlotës, për të treguar shprehjen e ndjenjave dhe historisë përmes artit: <i>(Sharlota me anë të artit të saj, shprehu historinë e gjithë jetës së saj; dhimbjet që ajo përjetoi; mallin për prindërit, të dashurin; dëshirën për t'u kthyer në atdhe; frikën nga vdekja që e ndiqte çdo ditë; dëshirën për të jetuar jetën me pasion, etj).</i></p>	
<p>Romani në vargje “Sharlota”, përcjell te lexuesi emocione dhe ndjenja të shumta, të cilat të mbërthejnë e nuk të bëjnë të lëshosh nga dora romanin. Cilat janë disa nga ndjenjat që ju përshkuan gjatë leximit të tij? <i>(Që në momentin e parë, autori e nis veprën me thënien se Sharlota e mësoi emrin e saj mbi një pllakë varri. Kjo të përcjell një ndjesi ankthi për të parë arsyen përse. Gjatë gjithë veprës personazhi jeton me frikë për jetën dhe lexuesi e ndien dhimbjen e saj, ndien pasigurinë për të ardhmen. Lexuesi e parashikon fundin që në fillim dhe pikëllimi e shoqëron deri në faqet e fundit).</i></p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e drejtuar, analizë teksti.</i></p>	
<p>Mësuesi/ja i drejton nxënësit te romani me qëllim që të identifikojnë elementet e romanit në vargje. Ritheksohen njohuritë: Romani në vargje, është një formë e ndërmjetme mes poezisë dhe prozës.</p>	
<p>Karakteristikat kryesore të romanit në vargje janë:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1- prania e skenave intensive emocionale (Ajo nuk pikturon, por vrapon. Kjo furi në pjesën e dytë të veprës, është tronditëse. Një krijim në buzë të humnerës), 2- përdorimi i formave poetike (Kjo furi në pjesën e dytë të veprës është tronditëse. Një krijim në buzë të humnerës. E ngujuar, e dobësuar, e frikësuar, Sharlota harrohet dhe humb), 3- ndërtimi i veçantë i subjektit. (E bija më tregoi vendin ku vepra është ruajtur. Qëndrova pa lëvizur përballë kësaj të kaluarë aq të prekshme. Një mallëngjim jashtëzakonisht tronditës. Kjo është gjithë jeta ime). 	
<p>Nxënësit japin shembuj nga fragmenti i shkëputur, por mund të japin shembuj të tjerë edhe nga romani.</p>	
<p>Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>analizë personazhesh, punë me tekstin, punë paraprake.</i></p>	
<p>Hidhet për diskutim një fakt: Sharlota ishte një vajzë e re, e cila u ndoq çdo moment të jetës nga vdekja. Përse?</p>	
<p>Nxënësit japin mendimet e tyre duke u mbështetur te leximi i romanit. <i>(Që para se të vinte në jetë Sharlota, familja e saj ishte përndjekur nga vdekja, vetëvrasjet ishin të shumta. Sado që përpiqeshin e mbroheshin, ishte e pamundur t'i shpëtoje këtij fakti. Sharlotën e ndiqte frika e prindërve dhe gjyshërve se mos edhe ajo kryente vetëvrasje si e ëma, apo tezja e saj. Më pas, kjo frikë u anashkalua, sepse tani ishin nazistët ata që kërkonin vdekjen e hebrenjve).</i></p>	
<p>-Po si ishte Sharlota? <i>(Një vajzë e vogël dhe e dashur, e lidhur me të ëmën dhe nuk e kuptonte arsyen e largimit të saj. Nevojën për ngrohtësi, e shpreh te lidhja në fillim me njerikën. Adoleshenca solli rebelim në sjelljen e saj, në marrëdhëniet mes prindërve dhe shoqërisë. Ishte e mbyllur dhe nuk hapej, askush nuk e njihte në të vërtetë. Dashuron shumë sa vë në rrezik jetën për praninë e të dashurit. Rritet nga vuajtjet që i solli koha. U bë më e fortë kur mësoi të vërtetën për vetëvrasjet e familjarëve të saj. Një mbesë e dashur dhe e përkushtuar ndaj gjyshërve, një grua e një nënë fatkeqe).</i></p>	
<p>Punohet me pyetjet rreth tekstit.</p>	
<p>1. Çfarë paraqet piktura e fundit e realizuar nga Sharlota? Cilat janë fjalët e fundit që ajo shkruan mbi të? <i>(Aty e sheh duke pikturuar diku në një kodër, që ngrihet mbi detin Mesdhe. Ajo e shikon pa interes objektivin; Leben? oder Theater?).</i></p>	
<p>Fjalët e cilit shkrimtar i kujtohen rrëfimtari, teksa e imagjinon Sharlotën duke punuar mbi veprën e saj të fundit? (Gëte).</p>	
<p>Kush është në qendër të subjektit të veprës së Sharlotës? <i>(historia e jetës së saj, ka për subjekt jetën e saj).</i></p>	
<p>Në sa pako përmbledhet vepra e saj krijuese? <i>(në tri pako).</i> Pas sa kohësh u kthye Sharlota te Moridisi? Çfarë profesioni ka ai? <i>(pas dy vjetësh; doktor).</i> Kush ia tregon vendin ku ishin mbajtur dorëshkrimet e Sharlotës rrëfimtari? <i>(e bija e doktorit)</i></p>	
<p>2. Në këtë pjesë rrëfimi realizohet: <i>nga veta e parë në vetën e tretë;</i></p>	

3. Gjeni në tekst ato vargje që tregojnë:

-gjendjen e tensionuar që po kalon Sharlota: *I duhet të veprojë pa humbur kohë. Vijat e vizatimeve të saj gjallërohen. Faqe të shumta kanë vetëm tekst. I duhet të tregojë historinë e familjes së saj.*

-nxitimin e saj: *Ajo nuk pikturon, por vrapon. Kjo furi në pjesën e dytë të veprës, është tronditëse.*

-shkëputjen nga realiteti përreth: *E ngujuar, e dobësuar, e frikësuar, Sharlota harrohet dhe humb.*

-frikën se mund të mos ketë kohë të kryejë misionin: *I duhet të tregojë historinë e familjes së saj. Para se të jetë tepër vonë.*

-pasigurinë për atë që e pret: *Nëse ajo vetë do të marrë arratinë, nëse ajo vetë do të vdesë.*

4. Interpretoni shprehjen: Kryerja e këtij misioni e shkëputi përkohësisht nga mendimet e ngulmëta. Cili është ky mision dhe në çfarë mënyre e shpëton Sharlotën ky mision?

Të treguarit e jetës së saj; e shkëput nga mendimi se vdekja është shumë pranë.

5. Rrëfimtari jep disa interpretime të frazës: Kjo është jeta ime. Gjejini ato dhe shpjegoni pse janë dhënë në formë pyetjesh. Kjo është gjithë jeta ime; Kjo është gjithë jeta ime; e përsërit për të treguar rëndësinë e veprës së saj, për mos të humbur këtë gjë të shtrenjë.

6. Shpesh përdoret fraza: Jeta është një teatër i madh. Duke u nisur nga kjo thënie, si e interpretoni titullin që u vendos dorëshkrimeve të saj Sharlota: *Leben? oder Theater? (Jetë? apo Teatër?)*

Autobiografia e saj quhet e tillë, sepse edhe vetë jeta që ajo jetoi i dukej e pabesueshme, i dukej sikur ishte një aktore, por që nuk po shkëputej dot nga ky rol. A mund të quhej jetë kjo jetë që ajo po jetonte? Mos ishte më mirë të quhej teatër?

7. Duke u nisur nga vargu i parafundit: Një mallëngjim jashtëzakonisht tronditës, si mendoni se ka qenë fati i Sharlotës? Autori përjeton një ndjenjë të jashtëzakonshme kur mbërrin në vendin ku qëndroi autobiografia e Sharlotës, por ky përjetim është i dhimshëm, sepse Sharlota vdes në një dhomë me gaz helmues.

8. Cilat janë epitetet që përdoren për të karakterizuar gjendjen shpirtërore të Sharlotës gjatë kohës që realizon veprën e saj? E ngujuar, e dobësuar, e frikësuar, Sharlota...

9. Në tekst ka raste kur rrëfimtari krijon kontakt të drejtpërdrejtë me lexuesin. Gjejini ato dhe diskutoni mënyrën se si krijohet ky shkurtim distance mes rrëfimitarit dhe lexuesit.

Kjo frazë nuk të shqitet nga mendja. Të gjitha mënyrat e interpretimit të saj duken bindëse; Përballë atij ndriçimi, mendja të shkon te fjalët e fundit të Gëtes; Vjen edhe përjetimi i autorit dhe të duket sikur e ke përballë dhe po të shpreh ndjenjat e tij.

10. Në pjesën më të madhe të rasteve, rrëfimi kryhet në kohën e tashme. Çfarë efekti krijon një zgjedhje e tillë?

E bën ngjarjen të duket sikur po ndodh para teje, të freskët dhe ndjenjat vijjnë më të gjalla e prekëse.

11. Çfarë e karakterizon dialogun mes Sharlotës dhe Moridisit? Çfarë tregon ai për gjendjen shpirtërore të Sharlotës? Mungesa e fjalëve zëvendësohet nga besimi, një ndihmë e përkrahje; Ngarkesën emocionale të saj, pasigurinë për të ardhmen e saj.

12. "Sharlota" është roman në vargje. Çfarë elementesh tipike për poezinë dhe çfarë elementesh tipike për prozën, shfaq pjesa e mësipërme? Elementet e poezisë: figuracioni i ngjeshur letrar, mungesa e fjalëve dhe përcjellja e emocioneve dhe ndjenjave përmes gjuhës së zgjedhur, vargëzimi, mungesa e dialogut.

- Elementet e prozës: rrëfen një ngjarje, ka personazhe, ka strukturën e romanit.

Ushtrimi 13-14, zhvillohen në formë diskutimi mes nxënësve dhe secili prej tyre jep mendimin e tij rreth çështjeve të ngritura.

(Sharlota njohu vetveten gjatë kohës që ajo po krijonte historinë e jetës së saj. Ashtu siç e nje lexuesi kur e lexon veprën e saj ashtu dhe ajo zbuloi veten).

Paraprakisht nxënësit janë udhëzuar që gjatë leximit të romanit të punojnë për: 1- Personazhet që u pëlqejnë; 2- Personazhi që u ka përcjellë ndjesitë më negative; 3- Pjesa që u pëlqen më shumë; 4- Figura letrare, 5- Një letër për autorin.

Nxënësit japin mendime të ndryshme sipas preferencave dhe argumentojnë përgjigjet e tyre me ilustrime nga romani.

(1-Sharlota, Aleksandër Nagleri, oficeri i ri që shpëtoi Sharlotën duke e zbritur nga autobusi; 2- personazh negativ- Alois Bruneti, 3- pjesa më e bukur kur Sharlota dashurohet, kur shkon në Francë; 4- Ajo jeton në arrati si të ishte me lebër - krahasim, si arriti të besonte se kishte kohë me bollëk? - pyetje retorike, e ngujuar, e dobësuar, e frikësuar, Sharlota harrohet dhe humb - shkallëzim, tip i i njeriut që të duket sikur të mbron dhe që shumë shpejt ti duhet ta mbrosh - antitezë, ai vjell fjalë të tmerrshme - epitet, shpresat e fundit të Sharlotës po bëhen hi e pluhur - metaforë).

Në fund të orës lexohen disa letra drejtuar autorit dhe bëhet vlerësimi i romanit duke nxjerrë dhe mesazhe kundër diskriminimit racial dhe etnik.


Vlerësimi: Vlerësimi motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për të kuptuarit e romanit dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve dhe argumentet e dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë: Stop diskriminimit!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Emri: kategoria gramatikore e rasës (ora e parë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja -Përcakton saktë kategorinë gramatikore të rasës së emrave; -Lakon emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane, në trajtën e shquar dhe të pashquar, numri njëjës dhe shumës.		Fjalët kyçe: Kategoria gramatikore e rasës, funksioni në fjali, lakimi, mbaresa,	
Burimet: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, 2; tabela e lakimit të emrave		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stubi mendimi, Punë e drejtuar, Punë individuale			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stubi mendimi, U kërkohet nxënësve të vënë re fjalën ngjyrë në tekstin e mëposhtëm: Rreth nesh kudo ka ngjyra : te rrobat që veshim, te lulet, tek ylberi në qiell dhe tek ekrani i televizorit. E gjithë kjo larmi ngjyrash krijohet nga përzierja e vetëm tri ngjyrave : e kuqja, e kaltra dhe e gjelbra. Këto tri ngjyra , të quajtura ngjyra bazë, krijojnë edhe figurat që shihni në ekranin e televizorit. <ul style="list-style-type: none"> • Cilës pyetje i përgjigjet emri ngjyrë në secilin rast? Në ç'rasë është përdorur ky emër? Në cilën trajtë janë përdorur format e këtij emri? • Ç'kemi quajtur rasë? Po lakim? Theksohet se për të gjetur lakimin e emrit, mbështetemi te <i>lloji i mbaresës</i> që merr ai në rasën emërore, numri njëjës, trajta e shquar . Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar Hapi I Duke shfrytëzuar përgjigjet e nxënësve, mësuesi jep në tabelë funksionet në të cilat përdoren emrat, sipas rasave me dhe pa parafjalë.			
Emri pa parafjalë në rasën: <ul style="list-style-type: none"> → Emërore----kryefjalë; gjymtyrë e kallëzuesit emëror → Gjinore -----përcaktor → Dhanore -----kundrinor i zhdrejtë → Kallëzore---kundrinor i drejtë → Rrjedhore---përcaktor U kërkohet nxënësve të krijojnë fjali me emra me parafjalë, për të parë funksionet në të cilat ata mund të dalin.			
Hapi II. Të njëjtat fjali të krijuara nga nxënësit shfrytëzohen për të sqaruar dhe kategorinë e trajtës: të pashquar dhe të shquar. Kihet parasysh se emri në trajtën e pashquar shoqërohet zakonisht në fjali me fjalët përcaktuese: një, për nr. njëjës dhe disa/ca, për nr. shumës.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale U kërkohet nxënësve të rikujtojnë edhe një herë rrugën që përdorin për të gjetur lakimin e emrit. <i>Çohet me mend emri në rasën emërore, trajta e shquar, numri njëjës dhe në bazë të mbaresës përcaktojmë lakimin.</i>			



Drejtohen nxënësit në tekst faqja 249-250 për të vërejtur tabelat e lakimit të emrave.
Nxënësit punojnë individualisht në tekst ushtrimin 1.

	Emërore, e pashquar, njëjës	Rrjedhore, e pashquar, njëjës	Gjinore, e shquar, njëjës	Kallëzore, e shquar, njëjës
Shëndet	shëndet	(prej) shëndeti	i, e shëndetit	Shëndetin
Bark	Bark	(prej) barku	i, e barkut	Barkun
Të ftohtët	Të ftohtë	(prej) të ftohti	i, e të ftohtit	Të ftohtit
Paciente	Paciente	(prej) pacienteje	i, e pacientes	Pacienten
Ambulancë	Ambulancë	(prej) ambulance	i, e ambulancës	Ambulancën
Antibiotik	Antibiotik	(prej) antibiotiku	i, e antibiotikut	Antibiotikun
Farmacit	Farmacit	(prej) farmacie	i, e farmacisë	Farmacinë

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi duke pasur parasysh pjesëmarrjen gjatë orës mësimore dhe përgjigjet e dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur: Lakoni sipas tabelës emrat: kutia, çelësi, të menduarit.

Rasat	Trajta e pashquar		Trajta e shquar	
	Nr. njëjës	Nr. shumës	Nr. njëjës	Nr. Shumës
Emërore				
Gjinore				
Dhanore				
Kallëzore				
Rrjedhore				

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX								
Tema mësimore: Emri: kategoria gramatikore e rasës (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Analiza morfologjike të emrit.									
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji											
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale											
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: Përcakton saktë kategorinë gramatikore të rasës së emrave; -Dallon llojin e lakimit të emrave, npr mbaresës; -Analizon emrat sipas kategorive gramatikore.		Fjalët kyçe: Kategoria gramatikore e rasës, funksioni në fjali, lakimi, mbaresa, analizë morfologjike									
Burimet: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, 2; tabela e lakimit të emrave		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave									
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Punë e pavarur</i>											
Organizimi i orës së mësimt											
Hapi I. Ora mësimore nis me diskutimin e detyrës së shtëpisë. Bëhet lakimi i emrave në mënyrë zinxhir nga nxënësit.											
Hapi II. Punohen ushtrimet 1-6 në faqen 251, me punë të pavarur dhe individuale.											
Ushtrimi 2. Dalloni emrat, nënvizoni mbaresat e tyre dhe tregoni se në ç'rasë janë përdorur. Çdo vit (kallëzore) shkruhen miliona libra (k). Disa kanë fjalë (K) dhe ilustrime. (K) Disa kanë vetëm fjalë, (K) të tjerë përmbajnë kryesisht figura (K) dhe shumë pak fjalë. (K) Ne lexojmë libra (K) për të marrë informacion, (K) por për shumë njerëz (K) leximi (E) i tyre është kënaqësi (E) e madhe. Një libër (E) kinez i titulluar "Rregulla (E) të arta" është libri (E) më i vjetër i shtypur. Ai libër (E) është bërë mbi 1100 vjet (K) më parë.											
Ushtrimi 3. Emrat në kllapa vendosini në rasën e duhur dhe përcaktoni llojin e lakimit. <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë të gjitha kushtet (L.I) (kusht) e nevojshme për të jetuar. 2. Prindërit ose njerëzit (L.II) (njeri) që me ligj kujdesen për fëmijët (L.III) (fëmijë) kanë për detyrë t'u sigurojnë fëmijëve (L.III) (fëmijë) kushtet e nevojshme për të jetuar sa më mirë. Kjo bëhet sipas mundësive (L.III) (mundësi) që ata kanë. 3. Institucionet shtetërore duhet të bëjnë gjithçka që munden për të ndihmuar prindërit (L.I) (prind) ose njerëzit e tjerë që me ligj (L.I) (ligj) kujdesen për fëmijën, që të zbatohet kjo e drejtë e fëmijëve. (L.III) (fëmijë). (Konventa mbi të drejtat e fëmijës, neni 27). 											
Ushtrimi 4 Ktheni në trajtë të shquar emrat që shërbejnë si bërthamë e grupeve emërore, sipas shembullit: në një shkollë të qytetit - në shkollën e qytetit. <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%;">një shok të tyre -- shokun e tyre</td> <td style="width: 50%;">shtëpi moderne -- shtëpia moderne</td> </tr> <tr> <td>në një vend të ngrohtë -- në vendin e ngrohtë</td> <td>një libër i vjetër -- libri i vjetër</td> </tr> <tr> <td>një vajzë e klasës -- vajza e klasës</td> <td>mësime të vështira -- mësimet e vështira</td> </tr> <tr> <td>ditë të ftohta -- ditët e ftohta</td> <td>ngjyrë e lehtë -- ngjyra e lehtë</td> </tr> </table>				një shok të tyre -- shokun e tyre	shtëpi moderne -- shtëpia moderne	në një vend të ngrohtë -- në vendin e ngrohtë	një libër i vjetër -- libri i vjetër	një vajzë e klasës -- vajza e klasës	mësime të vështira -- mësimet e vështira	ditë të ftohta -- ditët e ftohta	ngjyrë e lehtë -- ngjyra e lehtë
një shok të tyre -- shokun e tyre	shtëpi moderne -- shtëpia moderne										
në një vend të ngrohtë -- në vendin e ngrohtë	një libër i vjetër -- libri i vjetër										
një vajzë e klasës -- vajza e klasës	mësime të vështira -- mësimet e vështira										
ditë të ftohta -- ditët e ftohta	ngjyrë e lehtë -- ngjyra e lehtë										
Ushtrimi 5 Ndërtoni tabelën e lakimit të emrit të mësuarit në të dyja trajtat, duke pasur si model lakimin e emrit të lexuarit. Formoni tri fjali me format e ndryshme të këtij emri. Për të punuar këtë ushtrim klasa ndahet në dy grupe. Gjysma e klasës punon tabelën në numrin njëjës dhe gjysma tjetër punon tabelën në numrin shumës. (njësoj si emri të lexuarit në librin e nxënësit)											

Numri njëjës		
Rasat	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore		
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Ushtrimi 6 Gjeneroni emrat në tekstin e mëposhtëm dhe analizoni sipas kategorive gramatikore.
 Këto unë i dëgjoja dhe mendjen e kisha të kulla ogurzezë. Nuk duhej të largohesha nga fshati pa zbuluar vetë të vërtetën. Po nga duhej t'ia nisja? Më të afërmen dhe më besniken, kisha Gëzimen. Ajo më kishte thënë shumë herë se e kishte parë fantazmën me sytë e saj. Një mëngjes e pyeta: - Nga shokët dhe shoqet e tua të fshatit, cilët janë më të guximshëm? Ajo u mendua pakëz dhe më tha se vetëm një frikacak kishin: - Trimin. - Cilin Trim? - pyeta unë. Është një djalë që e ka emrin Trim. Ai e ka parë fantazmën dhe nuk kalon më kurrë nga gërmadhat e kullës ogurzezë. Thonë se i bëhet edhe në ëndërr fantazma.

Psh. Mendjen - emër i përgjithshëm, gj. femërore, n.njëjës, t.e shquar, r.kallëzore, l.i tretë, abstrakt.
 Çdo ushtrim diskutohet në klasë.
Sugjerim: Faqja 251 mund të fotokopjohet dhe të përdoret si fletë pune për nxënësit dhe të shfrytëzohet për dosjen e nxënësit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit me shprehje mbështetëse dhe notë për të gjitha ushtrimet.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, faqja 251

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Ejani o kujtime		Situata e të nxënit: Flasim për kujtimet më të bukura	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - Hulumton rreth jetës dhe veprës së Mid' hat Frashërit. - Liston karakteristikat e prozes poetike. - Dallon vetën dhe formën e rrëfimit në prozën poetike. - Argumeton domosdoshmërinë e të kujtuarit të përjetimeve si në ditë të bukura dhe në ditë të vështira. 		<ul style="list-style-type: none"> Kujtime Prozë poetike Muzikalitet i frazës Rrëfim 	
Burimet: Teksti i nxënësit, Interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologjia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, të nxënit në bashkëpunim, Rrjet diskutimi</i>			

Organizimi i orës së mësimi*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim*

Kuriozitete. Diskutojmë rreth tyre

Ku ruben kujtimet tona ? Kërkuesit kanë gjetur me saktësi si krijohen kujtimet në trurin tonë. Sipas tyre, truri njerëzor “i kyç” kujtimet episodike në hipokampus, duke ruajtur çdo koleksion kujtimesh në paketa individuale dhe të dallueshme qelizash. Kërkuesit vlerësuan 9 pacientë me epilepsi, pasi kishin vendosur elektroda në trurin e tyre, për të monitoruar krizat. Po ashtu, u monitorua edhe aktiviteti i neuroneve, pasi pacientëve iu kërkua të mbanin mend një listë fjalësh që u shfaqën në një ekran kompjuteri. Atyre iu kërkua të identifikonin fjalët që kishin mbajtur mend. Zona e aktivizuar gjatë procesit të kujtesës së fjalëve ishte hipokampusi. Gjetja hedh dritë të mëtejshme mbi bazat nervore të kujtesës dhe mund të ndihmojë në trajtimin e sëmundjeve të reja, si Alzheimeri dhe epilepsia. Burimi : <http://shekulli.com.al/49252/>

A mund t'i rishohim kujtimet tona? Duket e pamendueshme, por në teori, teknikisht është e mundur që ta bësh, që sot. Google në fakt ka patentuar një sistem, që duke shfrytëzuar syzet e veta multimediale (Google Glass), lejon të regjistrohet gjithçka që ndodh përpara syve dhe ta transmetojnë përmes Internetit në një kujtesë virtuale (cloud). Tek kjo e fundit mund të futemi në çdo moment, për të riparë kujtimet tona në ekranin e një celulari, tableti apo kompjuteri: për të riparë një eksperiencë të caktuar, do të mjaftojë që të bëjmë në sistem pyetje si “Cilat piktura pashë? Prezantohet tema mësimi. Pjesa letrare është një prozë poetike “Ejani o kujtime” e shkruar nga Mid'hat Frashëri Çfarë dini për këtë autor?

Mid'hat Frashëri, cilësohet si figurë shumëdimensionale historike e kulturore dhe një nga intelektualët më të shquar të kohës së tij, që la gjurmë në shumë aspekte të jetës letrare e të historisë shqiptare.

Informacion shtesë:

Kontributi i tij kulturor e gjuhësor, vlerësohet në Kuvendin e Kongresit të Manastirit (1908), ku qe kryetar, ndërkaq, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, pasi u emërua Ministër i Punëve Botërore. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, emigroi si shumë personalitete të tjera të njohura, që nuk mund të përshtateshin me sistemin politik të Shqipërisë së asaj kohe.

Veprat në shqip të Mid'hat Frashërit, janë:

“Naim Be Frashëri”,

“Hi dhe shpusë”,

novela, prozë poetike e kujtime,

“Pritmi i Shqipërisë” (1915), studim mbi shqiptarët dhe të ardhmen e tyre,

“Plagët tona” (1924) ese sociopolitike e etnike.

Në frëngjisht botoi librat: “L'affaire de l'Epire” (1915), “La population de l'Epire” (1915),

“Les Albanias chez eux et a l'Etranger” (1919) dhe “Albanais et Slaves (1919).

Ka shkruar e botuar në shqip e frëngjisht vepra letrare, eseistike e kritike dhe ka përkthyer në shqip “Robinson Kruzo” të Daniel Defosë dhe “Gijom Telin” e Lamartinit. Botoi “Kalendarin kombiar” (1897-1928), botim i përsëritur, një lloj enciklopedie, fletoren “Lirija” (1908- 1910) dhe (1926-1929).

Biblioteka personale me mbi 40000 vëllime, ruhet sot në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.

“Hi dhe shpusë”, botuar në Sofje në vitin 1915, të cilën Frashëri kompozicionalisht e ndan në këto nënzhane: proza poetike, novela dhe kujtime. Të pesëmbëdhjetë prozat poetike të ciklit “Hi dhe shpusë”, funksionojnë si tekste të pavarura nga njëra-tjetra

Titujt e prozave poetike “Ejani o kujtime”, “Asaj”, “Them”, “Të mukëtit”, “Një mbrëmje mbi udhët”, “Eja motrë”, “Ah, po bie shi prapë”, “Po e sheh? Drita venitet”, “Shkretina”, “Oj, jo, nukë le gjësend”, “Tym'i cingarit”, “Pse të shoh të brengosurë”, “Mot'i ri”, “Zemrë, pusho” dhe “Afërdita e Milo-s”.

Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënësit në bashkëpunim

Lexohet proza poetike nga nxënësit të ndryshëm. Më pas klasa ndahet në grupe

Grupi 1

Njohuri për prozën poetike ju keni marrë dhe në klasat e mëparshme.

Listoni karakteristikat e prozës poetike

Proza poetike në formë kalimtare mes poezisë dhe prozës e cila ruan karakteristikat e dy zhanreve.

Të shkruarit në rreshta e përqasin me prozën, ndërsa gjuha që përdor, ritmi, rima e brendshme, i japin muzikalitet dhe e përqasin me poezinë.

Tipare të prozës poetike

- 1) Figura dhe imazhe të gjalla si në pikturë.
- 2) Muzikalitet të frazës.
- 3) Ngjyra.
- 4) Nota të një lirizmi të theksuar.
- 5) Ritëm poetik
- 6) Pasuri elementesh figurative (epitete)
- 7) Rrëfëhet në vetën e parë njëjës
- 8) Mbizotërojnë metafora dhe simboli në të

Grupi 2

- Çfarë synon nëpërmjet këtij teksti rrëfimtari? Të rrëfjë ndjenjat dhe emocionet e përjetuara në të shkruarën dhe që sot vijjnë në formë kujtimesh.

- Çfarë risjellin kujtimet në jetën e autorit?

Ato e bëjnë:

- të mërzhitet për kohën që ka shkruar. Çdo njeri mërzhitet për kohën e shkruar, se bashkë me të ikën rinia dhe çdo gjë e bukur me të.
- të gjejë energji dhe forcë;
- melankolik e të trishtuar. Padyshim, rikujtimi i gjithë gjërave të kaluara të bën melankolik dhe të trishtuar

- Kujti i drejtohet rrëfimtari me "o miqt' e mij", në fillim të tekstit dhe në fund të tij?

Autori u drejtohet miqve -lexuesve të tij

Grupi 3

Në çfarë vete rrëfëhet në tekst? Rrëfëhet në vetën e parë

Cila është forma e rrëfimit: monologu, apo dialogu? Forma e rrëfimit - Monologu epik

Kur poeti flet për kujtimet, ai u referohet ngjarjeve specifike, apo përjetimeve të tij? U referohet përjetimeve të tij

Interpretoni frazën: ...dua të trazoj këtë hi të jetës që të shoh shpuzën, ta shoh e të gëzohem, e të qesh duk'e flakurë n'erë!

Grupi 4

Në këtë prozë poetike hasim përdorimin e kohëve të ndryshme të rrëfimit:

Ejani, ejani, o kujtime...

...gjithnjë u kam dashur...

...dua të trazoj...

Si ndryshon koha e përdorur? E tashmë shpreh gjendjen reale të rrëfimtari në momentin e rrëfimit, si ndjehet ai në këtë moment - e shkruar (e kryer - kam dashur) - tregon diçka që ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë në momentet kur flitet.

Shpjegoni këtë lloj ndryshimi? Rrëfimtari rikrijon të kaluarën, duke e shpërfaqur përmes kujtimit të ndjenjës së përjetuar. Si rrjedhim, e kaluara nuk shfaqet si ngjarje, por si përjetim. Madje autori duket sikur projekton të ardhmen. Dua të trazoj këtë hi të jetës që të shoh shpuzën, ta shoh e të gëzohem, e të qesh duk'e flakurë n'erë

Pra, me një fjalë, autori e vendos veten në të tashmen, rrëfen të kaluarën dhe projekton të ardhmen.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjet diskutimi

Në pjesën e fundit të prozës poetike autori shkruan: "Po edhe në kohë të gazit dhe të shpresës, ahëre kur një e sotm' e qeshur më bën të dua gjithë kohën e shkruarë dhe të shoh t'ëmbël dhe të bukur udhën që kam përpara..."

Pse poeti u kërkon kujtimeve që t'i vijjnë jo vetëm kur ndihet i vetmuar, por edhe në kohë gëzimi e hareje?

Nxënësit diskutojnë dhe japin mendimet e tyre me argumente. Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për dallimin e karakteristikave të prozës poetike, për argumentet e dhëna gjatë diskutimit, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeneroj shkrimtarë të tjerë shqiptarë dhe të huaj që kanë shkruar proza poetike.


Lexoni ndonjë prej tyre në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Shkruajmë Tema mësimore: Prozë poetike (ora 1)		Situata e të nxënësve: Diskutojmë së bashku “Bora” Faik Konica Kthiellësia e qiellit shkoi me diellin, me lulet, me veren. Vjeshta e trishtimshëm erdhi e iku. Tani, po hyn dimëri, edhe qiellin e kanë mbuluar re të qeta e të ftohta. Edhe sot, për të parën herë, zuri të bjerë bora... Prapa qelqeve të dritares, po shikonj. Ngadalë, ngadalë, si kur ka frikë të ndegjohet, bora fluturon flokë-floqe e shtrohet mbi dhe. Bie kudo, e duket se kërkon të ndreqë e të zbukuronjë: Dy çupa të vockëla shkojnë, e, në leshërat e arta të tyre, të lëshuara mbi shpatullat, bora shkruan trëndafile të ergjenda. Djelmte qeshin, hidhen, lozin, e lëftojnë me topa. Zoqtë vërtiten rreth e rrotull prakeve: ciu, ciu, një thrimë buke! Si në verë, gjithë bota janë veshur në të bardha. Flokë-flokë, ngadalë, po bie bora...	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Dallon prozën poetike nga gjinitë e tjera letrare. - Krahason prozën poetike me poezinë dhe me prozën. - Mëson rregullat e shkrimit të një proze poetike - Shkruan një prozë poetike me një temë të zgjedhur prej tij. - Diskuton rreth prozës poetike së shkruar për të marrë vërejtjet e komentet e shokëve me qëllim përmirësimin e saj. 		Fjalët kyçe: prozë poetike formë kalimtare poezi prozë Përjetim Lirizëm Muzikalitet	
Burimet: teksti i nxënësit, https://ëëë.voal.ch/5-proza-poetike-nga-faik-konica/		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Edukim figurativ	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Përvijim i të menduarit, Punë individuale, Shkrim i lirë</i>			
Organizimi i orës së mësimin Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Çfarë dini për prozën poetike? Cila prozë poetike ju ka lënë mbresa? Listojmë tipare të prozës poetike. Rikujtojmë së bashku.		Proza poetike në formë kalimtare mes poezisë dhe prozës, e cila ruan karakteristikat e dy zhanreve. Të shkruarit në rreshta, e përqasin me prozën, ndërsa gjuha që përdor, ritmi, rima e brendshme, i japin muzikalitet dhe e përqasin me poezinë. Tipare të prozës poetike 1) Figura dhe imazhe të gjalla si në pikturë 2) Muzikalitet të frazës 3) Ngjyra 4) Nota të një lirizmi të theksuar 5) Ritëm poetik.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale Parapërgatitja për shkrimin e prozës poetike			

Parapërgatitja për shkrimin e prozës poetike



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Në këtë fazë do të japim këshilla për shkrimin e prozës poetike.

1) Përshkruani përshtypjet që ju ka lënë diçka ose dikush.

Kujdesuni që të mos rrëfeni një ngjarje apo të përshkruani një person. Në vend të përshkrimit, përpiquni të shprehni përshtypjet tuaja në lidhje me një ngjarje, apo person të caktuar. Këto përshtypje mund të jenë edhe rreth një vepre arti, vendi piktoresk, njeriu të dashur, mjeti udhëtimi, agimi a perëndimi të bukur etj.

2) Përfshini figurat letrare, si:

metaforën, simbolin, epitetin etj., në mënyrë që t'u shtoni thellësi mendimeve tuaja.

3) Shkruani në vetën e parë

Krijimet në vetën e parë janë intime, shprehin botën e brendshme shpirtërore të krijuesit dhe e lejojnë atë që ta shprehë bukur mendimin e tij edhe në rastet kur ky mendim është i ngjeshur.

4) Shkruani për veshin

Pavarësisht se proza poetike shkruhet me fjali të shtrira deri në fund të rreshtit dhe rresht pas rreshti, fjalitë që e përbëjnë atë kanë ritëm dhe rimë të brendshme. Kjo do të thotë se duhet të tregoni kujdes në zgjedhjen e fjalëve, të

5) Shmangni klishtë!

Dëgjoni herë pas here atë që keni shkruar dhe të zëvendësoni fjalët që prishin ritmin dhe muzikalitetin e tekstit. Vini re se si rrjedh çdo rresht i krijimit tuaj, se si ritmi dhe rima e brendshme e bëjnë atë të këndshëm për veshin tuaj. Shprehjet e gatshme, të përdorura shpesh, e dëmtojnë krijimin tuaj.

Shkrim i lirë

Shkruani një prozë poetike me temë: “Ditë vjeshte “Kujdes këshillat që dëgjuat për shkrimin e prozës poetike!”

Ditë vjeshte

Më në fund vjeshta trokiti...

Trokiti pa gjëmime e shkrepëtima, po me qarje shiraplotë për ikjen e së bukurës verë. U shtrua tapeti i gjetheve të arta që kërcasin lehtësisht nën këmbët e mia, kur eci mendueshëm.

E trishtë kjo vjeshtë, e trishtë pa diellin që të ngroh shpirtin e mendjen. Grija e qiellit ngacmon frymëzimin tim... Kërcitja e drurëve të thatë, kungujt, gështenjat, ftonjtë e shegët e pjekura të vëna në një treg piriq, çadra që rëndon në çantë më thonë: “Ej mik, vjeshta sapo ka ardh, ndaj mos u trisht!”
(Luiza Myrtaj Nezha)

Pas mbarimit lexohet pjesa para shokëve dhe nxënësit pranojnë reagime nga të tjerët. Leximi bëhet me qëllim për të marrë mendime dhe për ta përmirësuar atë.

Pas leximit, u lihet porosi nxënësve të rishikojnë krijimin e tyre dhe ta përpunojnë atë edhe në bazë të vërejtjeve që kanë marrë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin e prozës poetike, si një zhanër kalimtar midis poezisë dhe prozës, për shkrimin e një prozë poetike të shkurtër etj.

Detrat dhe puna e pavarur: Krijoni një prozë poetike me temë: Vetmia

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të shkruarit		Situata e të nxënësve:	
Tema mësimore: Proza poetike (ora 2)		Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - Shkruan një prozë poetike me një temë të zgjedhur prej tij duke respektuar rregullat e shkrimit të saj - Diskuton rreth prozës poetike së shkruar për të marrë vërejtjet e komentet e shokëve me qëllim përmirësimin e saj. - Vlerëson punën e shokëve dhe vetes duke argumentuar përgjigjet. 		prozë poetike formë kalimtare poezi prozë Përjetim Lirizëm Muzikalitet Aromë deti	
Burimet: Teksti i nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Gjuhë shqipe TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Punë e pavarur, Shkrim i lirë</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Diskutim*

Lexohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Nxënësit kishin për të krijuar një prozë poetike me temë “Vetmia”. Po këtë fazë të parë të orës së mësimit, mësuesi vazhdon duke nxitur nxënësit të rikujtojnë rregullat që duhen pasur parasysh gjatë shkrimit të një proze poetike. Në tabelë, ndërtohet një organizues grafik, i cili plotësohet nga nxënësit hap pas hapi gjatë punës.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e pavarur me shkrim*

Nxënësit kanë në tekstin e tyre një prozë poetike, e cila titullohet “Aroma e detit”

Aroma e detit

Aroma e detit duhet ndier. E ndien atëherë kur: në mëngjes herët shëtit bregut të detit, ranishtës, zallinës, ose: në mbrëmje rri në majë të një shkëmbi, ndërsa valëzat i lajnë e i shpëlajnë algat e gocat e shtruara nëpër rrasa...

Atëherë do ta shijosh erën e detit. Ajo vjen: nga erërat e detit, nga uji i detit, nga kripa, nga jodi, nga algat, guacat e peshqit, që valët i qesin në breg... Vjen një puih e pishave, e vreshtave, e ullishtave... Është erë e barishteve mjekuese.

Ti e thith atë erë...

Është aromë e detit.

Kraharori të mbushet, si vel i barkës.

Do të jesh i shëndoshë – si ujk i detit.

H. Ulqinaku

Aroma e detit

Buzëmburime...

Jam ulur në prehrin tënd, pas lodhjes së ditës duke u zënë me valët e tua kapriçoze.

Jam ulur të shijoj muzgperëndimin dhe aromën që vjen nga ty...

Jam ulur të marr jodin tënd në frymëthithjen time të ngadaltë...

Thonë se aroma jote zgjat jetën ...

Thonë se aroma jote zgjon dëshirën për të jetuar më shumë ...

Mbush kraharorin me aromën tënde ...

dhe pres mëngjesin të luaj me dallgët e tua.

Luiza Myrtaj Nezha

Varianti 1 *Pas leximit të saj, përpiquni dhe ju të shkruani një të ngjashme me të.*

U tërheq vëmendjen nxënësve të kenë kujdes përdorimin e vetës së parë, përdorimin e figurave letrare për t`i shtuar thellësi mendimit, rimës dhe ritmit të brendshëm dhe mospërdorimin e klisheve.

Kujdes!

Mos u largoni qëllimit që i keni venë vetes në shkrimin e kësaj proze poetike!

Frymëzohuni! Filloni të shkruani!

Nxënësit punojnë të qetë. Gjatë gjithë kohës mësuesi/ja ndjek punën e tyre duke i këshilluar në rastet kur ata kanë nevojë

Varianti 2

Shkruani një prozë poetike ku të shprehni përjetimet tuaja për një nga peizazhet e paraqitura në fotografitë e dhëna në tekst

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Diskutim*

Mësuesi/ja përpiket që puna me shkrim e nxënësve të përfundojë brenda 30 minutave. Më pas lexohen disa nga punët e nxënësve dhe diskutohet rreth tyre. Diskutimi përqëndrohet në elementet që e përafrojnë më shumë me prozën dhe ato që e përafrojnë me poezinë. Nxënësit vlerësojnë shkrimet e shokëve, jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga struktura, drejtshkrimi, etj.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për punën e tyre qoftë në përmbajtje dhe për elemente të tjera që lidhen me respektimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë shkrimit të një proze poetike, për vlerësimin që nxënësi jep për punët e shokëve të tij, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Martesa e Halilit (ora 1)		Situata e të nxënësve: Recitohen vargje nga cikli i kreshnikëve.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit . - Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Hulumton rreth këngëve të epikës legjendare Dallon tiparet e subjektit të këngës Diskuton për shqetësimin e kreshnikeve në fragment Analizon tiparet e subjektit të këngës Analizon raportet e Mujit me të vëllanë dhe me kreshnikët		Fjalët kyçe: Epikë legjendare Cikli i kreshnikëve Kreshnikë Muji Halili Tanusha Bjeshkë	
Burimet: Teksti i nxënësit Çështje të folklorit shqiptar, vëllimi 2/3		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Folklor	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Parashikim me anë të titullit, Minileksion, Punë në dyshe, shkrim i shpejtë</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Parashikim me anë të titullit</i> Duke dëgjuar titullin “Martesa e Halilit” çfarë parashikoni të lexoni në tekst? Çfarë lloj teksti do të jetë, poetik, apo rrëfimtari? Diskutojmë së bashku Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Minileksion, Punë në dyshe,</i> Hapi i I: <i>Minileksion.</i> Eposi i Kreshnikëve është pjesë e krijimtarisë popullore. Ai është i përbërë nga një cikël këngësh me frymë heroike dhe legjendare. Ndryshe, ai njihet edhe si Cikli i Këngëve të Mujit e të Halilit, duke u nisur nga emrat e dy personazheve kryesore. Secila prej këngëve trajton një ngjarje, një episod jete, po aq të rëndësishëm, madhështor e me të njëjtat personazhe: heronjtë e Jutbinës. Në të shkrihen elementet mitike, përrallore dhe fantastike. Eposi është një ndër monumentet më të rëndësishme artistike të trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve. Kënga “Martesa e Halilit” përbëhet nga 230 vargje. Kjo këngë bën pjesë në epikën legjendare. Shqetësimi kryesor i fragmentit, është se Halili nuk po martohet ende. Shqetësimi të kreshnikëve, Muji u përgjigjet duke ndarë me ta dhe shqetësimin e tij. Midis kreshnikëve janë vendosur marrëdhënie të sinqerta dhe miqësore. Ata nuk janë të nënshtruar ndaj të parit të tyre, Mujit. Ndajnë hallet e problemet së bashku, jetojnë me shqetësimet e njëri-tjerit, pasi janë pjesëtarë të një fisi. Kënga ka një subjekt ka dy tipare: <ul style="list-style-type: none"> • Që mund të tregohet fare lehtë. • Mund të tregohet dhe shkurt edhe gjatë duke qëndruar në hollësitë e ndryshme, tipare të cilat rrjedhin nga natyra e Ciklit të Kreshnikëve, sepse janë këngë që përbëjnë një repertor të gjatë, i cili këndohet netëve rreth vatrës, me një melodi monotone, këngëtari më shumë reciton se këndon. Si rrjedhim, mund të themi se në plan të parë në këtë këngë, del rrëfimi, subjekti është i tregueshëm lehtësisht dhe i kuptueshëm nga të tjerët. Një tjetër tipar i subjektit, është se ngjarjet në të rrjedhin shpejt, madje si aventurë, rapsodi nëpërmjet detajeve, të ngjall përfytyrimin duke gërshetuar fantastikën me realen. Pas leximit të pjesë nxënësit punojnë në dyshe rubrikën e kuptimit. U japin përgjigje pyetjeve të dhëna. <ul style="list-style-type: none"> - Në cilën stinë kanë dalë kreshnikët për gjueti? <i>Në stinën e dimrit: “E ka vu një barrë dru t’vogël në zjarr Treqind vetë priherë m’u nxeh...”</i> - Çfarë i bën ata të heqin dorë nga gjuetia? <i>Moti i keq: “Sa shpejt diellin ma zu reja! Shpejt ma endi një pëllburë t’gjanë e t’gjatë e ia ka veshun majat rreth e rrotull ... Askurrnji shoshojnë trimat s’p’e njohin Ngrinë trimat, u sharruen”.</i> - Cila është pyetja që i bëjnë kreshnikët Mujit në kullën e tij? <i>Pse Halili nuk po martohet? “N’vatër tande, Muje, kemi qëllue mos na ki randë për një fjalë... Qysh Halilin s’e martove?... – Janë martue krejt moca e tij...”</i> 			

Çfarë i thonë kreshnikët Mujit për kalimet e kufirit që bën Halili? *Shqetësimi se mos i ndodh ndonjë e keqe Halilit dhe turpërohen. “Shpesh e shpesh po bje n’Kotorre t’Reja Rob të gjallë djalin po e zanë / Le konakun, Muj, e po ta fikin / Ma zi fisin, Muje, po na koritin... Kujdes! Po ta fikin - shqetësimi lidhet vetëm me Mujin.*

Kush është vajza që i ka marrë zemrën dhe mendjen Halilit? *Tanusha e Krajlit. “Dheu m’ka mblue e fat s’i qita vedit po s’e mora Tanushën e Krajlit!”*

Pse Halili nuk do të martohet me vajzat e krahinës? Halili nuk pranon të martohet me asnjë nga vajzat e krahinës, sepse:

- ato i duken si motra
- ka rënë në dashuri me një vajzë të huaj

Gjeni në tekst betimin e fortë që shqipton Halili, i cili mund të shndërrohet në mallkim nëse nuk kryhet. Për cilën anë të karakterit të tij bëhet fjalë? *Betimi për martesën me Tanushën është shumë i prerë.*

Dheu m’ka mblue e fat s’i qita vedit po s’e mora Tanushën e Krajlit!

Në këto vargje tregohet trimëria e tij, por dhe fakti se ai është pak i rrëmbyer.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Shkrim i shpejtë*

Shkruaj subjektin e këngës “Martesa e Halilit”

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për argumentet e gjetura gjatë diskutimit për tipare të subjektit, për analizën e raportit të Mujit me kreshnikët dhe të vëllanë, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Mëso përmendësh 20 vargje

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Martesa e Halilit (ora 2)		Situata e të nxëniet: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> ➢ Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. ➢ Kompetenca e të menduarit. ➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. ➢ Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: Diskuton për llojin e vargut në fragment. Analizon figurat letrare dhe në veçanti krahasimin e similitudën. Analizon ndryshimet fonetike dhe leksikore në fragment në raport me gjuhën e standardizuar. Analizon qëllimin e rapsodit për pranëvënien e objekteve dhe dukurive të natyrës për përshkrimin e bukurisë së Tanushës. Argumenton përmes detajeve bukurinë e Tanushës si një bukuri jo statike, por në lëvizje dhe e gjallë.		Fjalët kyçe: Epikë legjendare Cikli i kreshnikëve Kreshnikë Muji Halili Tanusha Bjeshkë	
Burimet: teksti i nxënësit, “Çështje të folklorit shqiptar” Vëllimi 2 dhe 3		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Folklor, stilistikë, gjuhësi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë në dyshe, diskutim, rrjet diskutimi</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stubi mendimi

Çfarë dini për poezinë epike? Plotëso oraganizuesin grafik



Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të analizuar gjuhën e poezisë

- Figura e stilistikës e përdorur më shumë në këtë fragment është: 1 pikë B) **krahasimi**;

- Vargu i përdorur është 10 rrokëshi popullor

- **Gjeni figurën e hiperbolës dhe shpjegoni efektin emocional nëpërmjet shembullit të gjetur.**

Gja ma t' mirë s'sheh njeriu nën këtë diell. Halili nuk mund të mbushi mendjen e 300 kreshnikëve për bukurinë e saj dhe gjithë këtë bukuri e shpreh kështu.

- **Gjeni në tekst: epitete, krahasime, inversione (anasjella), përshkallëzime**

Kujt po i dhembë dasma për vlla t'vet? Pyetje retorike

Vetulla e saj ndrejt si fiskaja; Shtegu i ballit, si shtegu i malit-krahasime

Syni i saj, si kokrra e qershisë;

E ka qerpikun si krahi i dallëndyshës;

Fytyra e saj, si kuqet molla n'degë; Hunda ndrejt, si kalemi i Tushës;

Goja e vogël, si lulja që shpërthen

Dhambët e bardhë si gurzit e lumit, Similitudë (krahasim i zgjatur)

- Përshkrimi i pamjes fizike të Tanushës mbështetet në elemente të natyrës. Gjejini në tekst këto elemente.

Bukuria e Tanushës nuk është një bukuri statike, ajo vihet mbi natyrën. Autori mbledh shumë objekte të bukura nga natyra për më shpalosur portretin e së bukurës Tanushë.

Bukuria e Tanushës është një bukuri në lëvizje, plot jetë, në zhvillim e sipër.

Rapsodi ka nxjerrë në pah detaje (i ka theksuar) që japin përfytyrimin e lëvizjes.

Psh: qerpiku: si krahu i dallëndyshës- lëvizshmëria e qerpikut si e krahut të dallëndyshës.

· goja: si lulja që shpërthen, pra në zhvillim e sipër, në rritje, në lulëzim,

· fytyra: si molla në degë

· vetulla: si fiskaja-theksohet elasticiteti, eleganca, etj.

Rapsodi është fokusuar më shumë në portretin fizik të vajzës, sepse, për mendësinë popullore, më e rëndësishme është bukuria fizike.

Gjuha e përdorur në Ciklin e Kreshnikëve ka forma gjuhësore të shqipes së vjetër. Gjeni në fragment një ndryshim fonetik dhe një leksikor.

Shqipja e vjetër ----Shqipja e sotme

fonetik: a-hundore –ë gja-gjë, ma-më, zanë-zënë OSE ue-ua: martue-martuar

leksikor: çetinat - pishat OSE bash - tamam

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim, Rrjet diskutim

Ku duken elementet e kulturës materiale në këtë këngë?

Në mjediset familjare të shkreshnikëve në oda miqsh apo shtëpitë e zjarrit rapsodi përshkruan castet e pritjes së miqve dhe biseda familjare. Në odën e miqve diskutohet për probleme të ndryshme të gjithë flasin sipas rregullit të kuvendit të burrave njëri pas tjetrit.

PO Eposi i Kreshnikëve është ruajtur gojë më gojë, ndër shekuj.

A jeni të mendimit se do të ishte më mirë të mos ishte ruajtur? **Pse?** **JO**

Klasa ndahet në dy grupe gjatë diskutimit.

Udhëzohen nxënësit të respektojnë rregullat gjatë diskutimit.


Vlerësimi:

Detyrat dhe puna e pavarur: ndërto hartën e personazhit të Tanushës dhe Halilit

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Mbiemri: kategoria gramatikore e gjinisë		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe:	
-Dallon mbiemrat në një tekst të dhënë. Përcakton kategoritë gramatikore të mbiemrit; -Kthen në gjininë femërore mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm të gjinisë mashkullore, duke dalluar mënyrat e formimit të saj.		Mbiemri, i nyjshëm, i panyjshëm, gjini, numër, rasë.	
Burimet: Teksti i nxënësit; Gramatika1 dhe 2;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi - kllaster, Punë e drejtuar, Punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimt*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stuhi mendimi - kllaster***Hapi I.** Nxënësit pyeten se ç'dinë për mbiemrin. Përgjigjet e tyre pasqyrohen në një kllaster.**Ndërtimi i njohurive të reja: punë e drejtuar**

U shpërndahen nxënësve skeda me grupe emërore, të cilat do t'i kthejnë në gjininë femërore.

Mjek i ri - (mjeke e re) pallat i lartë - (shtëpi e lartë) shkëmb i madh - (fushë e madhe)
 oficer trim - (oficere trime) tingull acarues - (zhurmë acaruese) shteg malor - (rrugë malore) mësues gojëmbël -
 (mësuese gojëmbël).

Nëpërmjet këtyre shembujve nxënësit zbulojnë mënyrat se si formohet gjinia femërore e mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm, të cilat shkruhen në tabelë nga mësuesi.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur**

Punohen ushtrimet 1-4 në faqen 253-254.

Ushtrimi 1. Gjini mbiemrat në fjalitë e mëposhtme dhe përcaktoni gjininë e tyre.

Dielli ecte nëpërmjet pemëve, dukej e zhdukej si një fytyrë e qeshur (F) fëmije që është kureshtar (M) të shikojë se si do të përfundojë kjo garë e rrallë (F) e njeriut me kafshën... Ngjante sikur në çdo dru ndodheshin me mijëra gjinkalla dembele (F) që bënin fresk me krahët e tyre si luspa. Nga lëvorja e pishave, kullonte rrëshirë e verdhë (F) si një sumbull e trashë (F) dylli, ndërsa fletët mishtore (F) të mërsinave lëshonin një erë mjalti.

Ushtrimi 2. Formoni gjininë femërore të mbiemrave dhe i lidhni me një emër, sipas shembullit:

i bardhë	e bardhë	Letër e bardhë
i rrumbullakët	E rrumbullakët	Tokë e rrumbullakët
i ditur	E ditur	Vajzë e ditur
i pazoti	E pazonja	Specialiste e pazonja
i shkruar	E shkruar	Këngë e shkruar
i afërm	E afërme	Konferenca e afërme
i papunë	E papunë	Nënë e papunë
i pashoq	E pashoqe	Specialiste e pashoqe
i rrëmbyeshëm	E rrëmbyeshme	E folur e rrëmbyeshme
i ndershëm	E ndershme	Grua e ndershme
i sotëm	E sotme	Gazeta e sotme

Ushtrimi 3. Formoni mbiemra femërorë nga mbiemrat e panyjshëm të gjinisë mashkullore, duke treguar mënyrën e formimit të tyre.

Historik-historike, fjalëkeq-fjalë keqe, kokëmadh-kokë madhe, belhollë-belhollë, gri-gri, gjakëmbël-gjakëmbël, jeshil-jeshile, ndjellazi-ndjellazezë, grafik-grafike, plak-plakë, punëtor-punëtore, vishnjë-vishnje, dhjetëkatësh - dhjetëkatëshe, flokëgështenjë-flokëgështenjë, budalla-budallaqe

Ushtrimi 4. Në vend të vizave vini mbiemrat e mëposhtëm, duke i vendosur në formën e duhur. Përcaktoni gjininë e tyre.

Kur princin i vogël (M) e zuri gjumi, e mora në krahë dhe vijova rrugën. Isha i ngashëryer (M). Më dukej sikur mbaja në krahë një thesar të brishtë. Madje më dukej se nuk kishte gjë më të brishtë (F) mbi faqe të dheut. Nën dritën e zbehtë (F) të hënës shikoja ballin e tij të bukur (M), sytë e mbyllur (M) cullufet e flokëve që dridheshin nga era dhe me vete thosha: “Ajo që shoh është vetëm cipa. Gjëja më e rëndësishme (F) mbetet e padukshme...”

Dhe meqë buzët e tij paksa të hapura (F) kishin krijuar një nënqeshje të lehtë (F) thashë përsëri me vete: “Ajo që më prek më fort te ky princ, është besnikëria e tij për një lule, është figura e një luleje trëndafili, e cila rrëzëllen brenda tij si flaka e një feneri, qoftë edhe atëherë kur ai është në gjumë.

i brishtë	i mbyllur	i zbehtë	i bukur	i hapur
i ngashëryer	i vogël	i rëndësishëm	i zbehtë	i lehtë

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit me shprehje nxitëse dhe notë gjatë gjithë orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, faqja 254.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Shpreh		Situata e të nxënit Vargje nga Naimi - Recitime Tradhëtorët Shokë, kemi në mest tënë Shum' armik' e trathëtorë! Popo! mos u qoftë thënë! Veç që s'kanë gjë në dorë. Harruanë mëmëdhenë Dh' e lanë kombinë tënë E një tjetërë na gjenë! Popo! mos u qoftë thënë Fjalët e qiririt Në mes tuaj kam qëndruar E jam duke përvëlur, Që t'ju jap pakëz dritë, Natën t'jua bëj ditë. Do të tretëm, të kullohem, Të digjem, të përvëlohem, Që t'ju ndrit mirë e të shihni, Njëri-tjetrin të njihni.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Lexon me shprehinë dhe intonacionin e duhur poezinë - Bën analizën metrike të poezisë - Shpjegon frymën optimiste që karakterizon poezinë - Analizon mesazhin që përcjell poezia - Shpjegon rëndësinë e përdorimit të rimave foljore 		Fjalët kyçe: <i>Shpresë, Shqipëria, dritë, qytetari, fatbardhësi, dituri, mirësi</i>	
Burimet: Teksti i nxënësit, Vëllimi poetik "Lulet e Verës" N. Frashëri, materiale për jetën e autorit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stubi mendimi, diskutim, të nxënit në bashkëpunim, Vija e vlerës</i>			
Organizimi i orës së mësim: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stubi mendimi</i> Diskutojmë së bashku rreth jetës dhe veprës letrare të Naimit			

Dy fjalë për autorin:

Naim Frashëri

Naim Frashëri një ndër personalitetet më të shquara të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Ai lindi në vitin 1846, në Përmet dhe mbaroi një nga gjimnazet më të njohura të kohës, gjimnazin Zosimea. Meqenëse pati mundësi të udhëtonte shumë, ai fitoi një kulturë të gjithanshme. Vjershat e tij të para, patën ndikime të ndryshme, sidomos nga Rilindja Evropiane dhe nga rrymat letrare të kohës. Ndër të tjera, vargjet e tij janë të mbushura me humanizëm. Naimi dallohet për mbështetjen e veprës së tij në folklor. Poezia e tij përshkohet nga temat patriotike, të natyrës, sociale, të dashurisë dhe medituese. Naimi ka kontribute të jashtëzakonshme edhe në pasurimin e gjuhës shqipe, me botime të ndryshme në ndihmë të shkollës. Disa nga veprat e tij më të njohura janë: “Bagëti e Bujqësi”, “Histori e Skënderbeut” dhe “Lulet e Verës”.

Mund të ndërtojme dhe një organizues grafik ku nxënësit të hedhin idetë e tyre



Flisnin për gjendjen e Shqipërisë nën thundrën e pushtimit otoman.

Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënësit në bashkëpunim (punë në grupe).

Lexohet poezia nga nxënës të ndryshëm.

Ndaj klasën në grupe.

Grupi 1 Kuptoni poezinë

Përgjigjuni pyetjeve

Renditni disa nga problematikat e kohës që dalin në këtë poezi dhe dalloni dëshirat e poetit aty.	<i>Problematikat:</i> <i>Pushtimi i huaj,</i> <i>prapambetje ekonomike dhe shpirtërore</i> <i>asimilimit të gjuhës amtare,</i> <i>përhapja e diturisë</i>
Çfarë dëshmon ai përmes shprehjes së tyre?	<i>Dëshiron të theksojë idenë e tij se ëndrra për një Shqipëri më të mirë do të bëhet realitet vetëm përmes përhapjes së diturisë dhe mirësisë. Këtu Naimi na shfaqet si iluminist.</i>
Gjeni motivet dhe lajtmotivin e kësaj poezie.	<i>Motivi i atdhedashurisë, nota filozofike</i> <i>dhe lajtmotivi: Dëshira dhe shpresa për ndryshim.</i>
Zbuloni disa karakteristika të poezisë dhe tregoni llojin e saj.	<i>Poezia shfaq tipare që tregojnë mbështetjen e Naimit në poezinë popullore të cilat janë:</i> <i>figuracioni; (epitete, metafora, etj.).</i> <i>- gjuha e pasur, pasuria leksikore,</i> <i>- elemente të metrikës. Strofat gjashtëvargëshe.</i>
Ç’ndjenjë shpreh vargu: ditët e mira?	<i>Vargu ditë të mira shpreh shpresën e Naimit për ta parë Shqipërinë “zonjë”.</i>

Shpjegoni frymën optimiste të kësaj poezie dhe tregoni si gërshetohet ajo me emocionet e tjera poetike. Poezinë e përshkruan fryma optimiste për ardhjen e ditëve të lavdishme me shpresën e rifitimit të madhësisë së këtij kombi të lashtë

Grupi 2: Analizoni mesazhin që përcjell kjo poezi.

Do të vijë dita që Shqipëria të bëhet një shtet i lirë dhe i pavarur, i qytetëruar i barabartë mes të barabartëve.

Shpjegoni kuptimin që përftohet në vargjet: Lum kush të rronjë / ta shohë zonjë!

Ardhja e ditëve të mira për Shqipërinë është e sigurt, vetëm se duhet durim për t'i pritur ato. Lum brezat që do të vijnë!

Grupi 3: Analizoni mendimet e poetit për të ardhmen, të vërtetën, shpresën dhe përparimin. Pse autori i referohet kryesisht së ardhmes?

“Shpresa vdes e fundit”- thotë populli. Shpresa e mban gjallë një komb dhe në ditët më të këqija të tij. Dhe Naimi ishte i paduruar në realizimin e shpresës së tij: Jak e vërtetë! pse rri e qetë?

Naimi ishte shpresëplotë se Shqipëria do të çlirohej, do të ndërtohej dhe një e ardhme më e mirë, më e qytetëruar e priste këtë vend plot diell e mirësi të bekuar nga Zoti dhe këta njerëz të zgjuar e punëtorë.

Çelja e negociatave për futjen e Shqipërisë në BE mishojnë parashikimin, shpresën e ardhmërisë së Shqipërisë sipas këndvështrimit naimjan.

Gjeni dhe shpjegoni qëndrimin e poetit për dijen, gjuhën dhe njerëzit në këtë poezi.

Gjuha, vëllazërimi, bashkimi ,dituria, janë vlera të cilat e mbajnë gjallë një komb nga rrënimi i tij.

Vëllazëria

edhe bashkimi

e njerëzia

është shpëtimi

Se shqiptari

e gjuh' e tija

venë së mbari

dhe Shqipëria

Grupi 4. Poeti mbështetet në krijimtarinë popullore. Analizoni në këtë këndvështrim llojin e rimës, vargut dhe disa prej figurave letrare në poezinë “Shpreh”.

Strofa është një grup vargjesh të lidhura ndërmjet tyre me ritmin, rimën dhe intonacionin e përbashkët, që mund të qëndrojë edhe më vete. Numri i ndryshëm i vargjeve përcakton edhe llojin e strofave të ndryshme.

Strofa dyshe (distiku) është forma më e thjeshtë; përbëhet prej dy vargjeve që janë të lidhura me një mendim dhe me rimë të përputhur. Ka raste kur janë edhe pa rimë.

Strofa treshe (tercina) përbëhet prej tri vargjeve të rimuara, ose prej tri vargjeve pa rimë. Rima e saj mund të jetë e ndryshme AAA ose AAB, ose ABA, etj.

Strofa katërshe (katrena) është ndër më të përhapurat, përbëhet prej katër vargjesh të lidhura ndërmjet tyre me rimë të përputhur (AABB), të kryqëzuar (ABAB), ose të përmbysur (ABBA).

Një lloj i veçantë i **strofës me katër vargje është strofa safike**, e cila u quajt kështu sipas poeteshës greke Safo, që e lëvroi atë. Kjo strofë përbëhet prej katër vargjesh, prej të cilave tri vargjet e para janë njëmbëdhjetërrokëshe, kurse i fundit përbëhet prej pesë rrokjesh.

Strofa 6 vargëshe

Rima ABABCC

Jak e vërtetë! pse rri e qetë? Pyetja retorike

Shkojë errësira –metaforë, ligësia do të mërgohet

Grupi 5 Gjeneri disa rima foljore dhe shpjegoni rëndësinë e përdorimit të tyre.

Lum kush t'arrijë

Pa do të vijë.

Që Shqipëria

do të ndriçohet

dhe ligësia

do të mërgohet

do të burojnë,

nuk mënojnë

Efekti që krijojnë rimat e mësipërme është: efekti tingullor, muzikaliteti.

Gjeneri emrat me kuptim përmbledhës, si vëllazëria, të cilët janë mjaft të përhapur në këtë poezi.

Shpjegoni ngjyrimin kuptimor që përftohet prej tyre.

Shpjegoni formimin e fjalës: fatbardhësi (fatbardhë - tema fjalëformuese e përbërë + *si* prapashtesë)

Gjeneri fjalët kyçe të kësaj poezie.

Shprësë, Shqipëria, dritë, qytetari, fatbardhësi, dituri, mirësi

Grupi 6

Ja si janë shprehur për poezitë e Naimit dy personalitete të kulturës shqipe dhe botërore:

Mund të themi pa u drojtur se e gjithë puna e Naim Frashërit qëndron vetëm në një gjë: Atdheu. ...Atdheu qëndron mbi çdo gjë tjetër dhe ai, Apostulli i tij. Musine Kokalari

Patriotët që kanë krijuar letërsinë shqipe, janë nga mirëbërësit më të mëdhenj të kombit shqiptar si Naim Frashëri. Holger Pedersen, gjuhëtar danez

Diskutoni rreth këtyre opinionëve

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Vija e vlerës

PO

JO

A duket kjo poezi si një “projekt zhvillimi” për Shqipërinë?

Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre gjatë diskutimit. Ata vlerësojnë njëri-tjetrin në përgjigje, por edhe bëjnë vlerësimin e vetes.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për analizën metrike të poezisë, për argumentet e nxjerra gjatë diskutimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese përshkruese me temë: Shqipëria ime.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Mbiemri: kategoria gramatikore e numrit dhe rasës. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji		Situata e të nxënësve: kthimi në shumës dhe lakimi i grupeve emërore emër+mbiemër	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënësve - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> -Përcakton kategorinë e numrit e të rasës së mbiemrave -Kthen në numrin shumës grupet emërore, emër (M/F) + mbiemër, duke përcaktuar mënyrat e formimit të shumës të mbiemrave; -Lakon mbiemrin e nyjshëm e të panyjshëm, pjesë të grupit emëror, duke pasur parasysh përshtatshmërinë e tij në rasë me emrin. 		Fjalët kyçe: mbiemër i nyjshëm, mbiemër i panyjshëm, numri, rasa, nyja, mbareza.	

Burimet: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, tabela e lakimit të mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm, skeda me grupe emërore: emër+mbiemër	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë e pavarur; punë me fisha, Diskutim; Punë e pavarur.</i>	
Organizimi i orës së mësimt	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Punë e pavarur</i>	
Prezantohet tema mësimore. Për çdo nxënës ndahen fisha të parapërgatitura me grupe emërore, me të cilat duhet të punojnë sipas kërkesave, p.sh.:	
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë me fisha, diskutim.</i>	
1.Ktheji në numrin shumë grupet emërore;	
2.Lako grupin emëror të theksuar, në numrin njëjës dhe shumë:	
Libër i bukur- njeri i afërt- usta merakli- shkëmb i madh- përrua i vogël- mësues gojëmjaltë-	gazetë e sotme- vajzë e sjellshme- grua fisnike- letër e bardhë- vogëlushe syshkuar- gjshe shpirtmadhe-
Mësuesi mund t'i shkruajë në tabelë dhe të punojë në bashkëpunim me nxënësit.	
U drejtohen pyetjet nxënësve: a. Ç'ndryshime pëson mbiemri i nyjshëm kur kthehet në numrin shumë?	
b. Po mbiemri i panyjshëm? c. Dallojini me laps ndryshimet që vini re te mbiemrat.	
Bazuar te puna e bërë në skedë, nxënësit zbulojnë mënyrat e formimit të numrit shumë të mbiemrave të nyjshëm e të panyjshëm.	
E njëjta rrugë ndiqet dhe për të zbuluar përshtatshmërinë dhe ndryshimet që pësojnë mbiemrat gjatë lakimit.	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur, diskutim.</i>	
Punohen ushtrimet 1-4 në faqen 257. Çdo ushtrim diskutohet në klasë.	
<i>Ushtrimi 1. Kthejini grupet e mëposhtme në numrin shumë dhe nënvizoni një, a mbaresën e mbiemrit.</i>	
bishtalec i gjatë stoli e rrallë mësim i vështirë acid i fortë pyll i dendur dokument historik	Bishtaleca të gjatë Stoli të rralla Mësime të vështira Acide të forta të dendura Dokumente historike
zarf i mbyllur Diplomat i shquar mendim i drejtë yll i ndritshëm numër i zgjedhur thes i madh	Zarfa të mbyllura Diplomatë të shquar Mendime të drejta Yje të ndritshme Numra të zgjedhura Thasë të mëdhenj
<i>Ushtrimi 3. Lidhni secilin nga mbiemrat me emrin përkatës, duke pasur parasysh përshtatjen në rasë.</i>	
<i>Formoni fjali me pesë nga grupet e krijuara.</i>	
<i>Ushtrimi 4. Vendosni mbiemrat në kllapa në gjininë, numrin dhe rasën e duhur.</i>	
Një erë e <i>ngrohtë</i> pranverore, erë lule molle e kumbulle e <i>poraçelur</i> , erë fiku e njomë hyri në dhomë.	
Librin e ri e lexova me dëshirë të <i>madhe</i> .	
Vajzën e <i>vogël</i> e zuri gjumi herët.	
Gruas iu mbush prehri me petalet e holla e të <i>tejdukshme</i> të luleve të bajames.	
Çatitë e <i>panumërta</i> të qytetit mezi dukeshin përmes mjegullës.	
Në qytet erdhën dallëndyshet nga viset e <i>largta</i> .	
Qyteti shkëlqente nga dritat <i>shumëngjyrëshe</i> të fishekzjarrëve.	
<i>Ushtrimi 5. Gjeni mbiemrat në fjalitë e mëposhtme dhe përcaktoni gjininë, numrin dhe rasën e secilit.</i>	
Ky roman vjen te fëmijët si një ujëvarë e freskët, plot ngjarje, episode dhe aventura të habitshme, që të mbeten në mendje. Ai është ndërtuar me një stil të rrjedhshëm, me një gjuhë të gjallë jetësore, me ide dhe mendime të qarta, të shprehura mjeshtërisht bukur, që të bën të mos e lëshosh nga dora, por ta lexosh me një frymë. Romani i vendos ngjarjet në kozmos dhe duhet vlerësuar veçanërisht për informacionin e bollshëm e të saktë shkencor që jep rreth galaktikës sonë, rreth sistemit diellor, për planetët që sillen rrotull Diellit e satelitët e tyre. Janë të dhëna që nxitin interesin për shkencën dhe edukojnë pasionin për kërkimet shkencore.	
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për punën e pavarur, për përgjigjet e sakta dhe zgjidhjen e ushtrimeve.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, faqja 257.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të lexojmë Tema mësimore: Vranina (ora 1)		Situata e të nxënit: Recitojmë vargje nga Gjergj Fishta Një orë më parë mësuesi u dha porosi nxënësve të mësonin përmendësh vargje nga Gjergj Fishta. Shqyptaria <i>Edhe hana do ta dije, dhe dielli do t'ket pa, se për qark ksaj rrokullije si Shqipnija 'i vend nuk ka!</i> Lahutë e Malcis <i>Çohi, o bij të Skanderbeut, turq e t'kshenë, mos t'u dajë feja! Çohi e bini n'fushë t'bejlegut, tue gjimue ju porsì rr'feja.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Hulumton rreth jetës dhe krijimtarisë së Gjergj Fishtës. - Hulumton rreth Oso Kukës dhe trimërisë së tij - Hulumton rreth betejës së Vraninës. - Diskuton rreth strukturës së "Lahutës së Malcis". - Dallon llojet e rimave të përdorura në fragment - Analizon atmosferën e krijuar në fragment 		Fjalët kyçe: Vranina Oso Kuka Burrë trim Si dragua Luftë Krajl Armiq	
Burimet: Teksti i nxënësit https://www.youtube.com/watch?v=7sPj_1NhVrE https://www.youtube.com/watch?v=MZvqZh5FGzo		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pemë mendimi, Punë në dyshe			

Organizimi i orës së mësimi:


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Pemë mendimi

Cfarë dini për Gjergj Fishtën?

Mendimet e nxënësve i organizojmë në një pemë mendimi

Cfarë dini për Gjergj Fishtën?

Mendimet e nxënësve i organizojmë në një pemë mendimi



“Lahuta e Malcisë” është një vepër madhështore, e përbërë nga 30 këngë, me 17 mijë vargje gjithsej. Ajo është quajtur Iliada Shqiptare dhe ka strukturën e një eposi. Në të ndërthuren bukur personazhet, ngjarjet dhe rrethanat. Veçanti e saj, është edhe prania e dy llojve personazheve: historike dhe mitologjike.

Ndahet në cikle dhe hapet me atë të Oso Kukës. Aty i bëhet jehonë njëri prej betejave më të bujshme të shqiptarëve kundër serbo-malazezëve, që dokumentet historike e njohin me emrin Lufta e Vraninës. Oso Kuka është heroi i kësaj beteje.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshë

Lexohet teksti dhe shpjegohen fjalët e reja, me qëllim që të kuptohet më mirë ai. Më pas punohet me rubrikën e kuptimit të tekstit

<p>Tregoni atmosferën e këtij fragmenti dhe shpjegoni si vendosen përballë njëra-tjetrës Vranina dhe Cetina. Ç’përfaqësojnë secila prej tyre?</p>	<p><i>Atmosfera në këtë fragment është dramatike. Përballë njëra-tjetrës Vranina dhe Cetina.</i></p> <p><i>Vranina, qyteza e lashtë e shkatërruar nga pushtuesit osmanë. Syri i Liqenit apo Ishulli i Vraninës, me dy tempuj madhështorë: atë të Teutës dhe Rrasat e Yllit të Bardhë. Prej këtej dukej mjaft mirë liqeni i Shkodrës. Vranina vendi i betejës së përgjakshme më 1862.</i></p> <p><i>Cetina - vendi ku jetonte Krajli, kundërshtari i Oso Kukës dhe i shqiptarëve.</i></p> <p><i>Vranina përfaqëson historinë e lashtë të larë me gjakun e Oso Kukës dhe të gjithë shqiptarëve trima, të besës, të mençur, madhështorë, të cilët nuk nguronin të vetësakrifikoheshin për vendin e tyre.</i></p> <p><i>Cetina - vendi ku jetonte Krajli, kundërshtari i shqiptarëve dhe i Oso Kukës, i pabesë dhe dinak, ekspansionist.</i></p>
<p>Identifikoni detajet e vendit ku zhvillohen ngjarjet. A ju ngjan ky vend me një skenë dyluftimi?</p>	<p><i>Ngjarjet zhvillohen në Vraninë.</i></p> <p><i>Detajet : Vall ç’po ban mbi Shkjë, Vranina! Vall ç’po ban Vranina m’ Shkje, Rob tue zanë e gjind tue pre: Tue pre gjind, tue zan hajduka.</i></p> <p><i>Duket si një shesh dyluftimi midis Osos dhe njerëzve të Krajlit duke na kujtuar betejën e Gjergj Elez Aliaj me Bajlozin e Zi që vinte nga deti për të çnderuar viset shqiptare dhe njerëzit që jetonin në to</i></p>
<p>Cili është heroi i kësaj ngjarjeje? Cilat karakteristika të tij dalin në pah në këtë fragment?</p>	<p><i>Heroi i kësaj ngjarjeje është Oso Kuka, të cilit i vishen tiparet e një dragoi. Dragoi, i përfytyruar në kulturën shqipe si një qenie mitike me trup afërisht si të gjarprit dhe me flatra, është një krijesë që lind me aftësi mbinjerëzore... Burrë i fuqishëm e trim si zana, i besës. “Ushton mali thonë kur tflasë, dridhet fusha kah tvikasë”. Duket qartë çka synon poeti për ta përshkruar protagonistin me fuqi të mbinatyrshme...</i></p>
<p>Veçoni dy tiparet kryesore të shqiptarit që përmend autori. A jepen ato si gurë të çmuar të kurorës së vlerave kombëtare?</p>	<p><i>“Për krah besa e kah trimnija, Qi zanat i ka Shqypnija. Pse në Shqypni ka djelm si Zana.</i></p> <p><i>Qi për mbret e troje të veta</i></p> <p><i>Nuk i dhimet gjaja jeta.</i></p> <p><i>Besa dhe trimëria cilësi keto, që përfaqësojnë personalitetin etno-kulturor të shqiptarit. Cilësi që rrinë si gurë të çmuar të kurorës së vlerave kombëtare.</i></p>

2. Shpjegoni përse shërbejnë tonet e larta që shoqërojnë vargjet hyrëse të kësaj kënge.

Notat e larta në hyrje të kësaj kënge, e theksojnë akoma më shumë dramacitetin në betejën kundra Vraninës, një betejë numerikisht e pabarabartë. 1 me 300 ishte raporti midis shqiptarëve dhe njerëzve të krajlit.

3. Duke njohur faktin që Fishta mbështetet shumë në krijimtarinë popullore, gjeni dhe shpjegoni paralelizmin midis natyrës dhe veprimeve të personazhit të pjesës.

Ushton mali thonë kur tflas – kur flet ai, pesha e fjalëve drithëron malin dhe fushën.

Dridhet fusha kas t’vigasë

E kah t’dredhë t’rrebtë taga’n,

Thue se rrefta shkrepë për anë:

Kaq vringllim aj shkon tu’ i dhanë!

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe

Për rimën dhe llojet e saj është folur dhe në klasat e kaluara. Përsëritim:

Rimë quhet përputhja e tingujve në fund të dy a më shumë vargjeve. Vargjet që kanë rimë ndërmjet tyre, quhen vargje të rimuara, ose me rimë. Ajo krijon muzikalitetin në varg dhe thekson një numër të caktuar fjalësh, duke krijuar një lidhje të brendshme mes fjalëve që rimojnë.

Kemi disa lloje rimash:

- Rimë e përputhur, kur vargjet me të njëjtën rimë vijnë njëri pas tjetrit: *Skema AABB*.
- Rimë e kryqëzuar, kur me të njëjtën rimë janë vargu i parë me të tretin dhe i dyti me të katërtin: *Skema ABAB*.
- Rimë e përmbysur, kur vargu i parë rimon me të katërtin dhe vargu i dytë me të tretin: *Skema ABBA*.
- Rimë e brendshme, kur rimojnë fjalët brenda një vargu.

4. Pse rima në këtë fragment ka një rol të veçantë? *Ka një rol të veçantë, sepse krijon muzikalitet në varg.*

- Cilat lloje të saj janë përdorur? *Në fragment është përdorur rima e përputhur.*

5. Gjeni dhe analizoni figurat letrare të metaforës, përsëritjes, epitetit dhe krahasimit të zgjatur.

Vall ç'po ban mbi Shkjé, Vranina! Anaforë

Vall ç'po ban Vranina m' Shkje,

Pse tri zemra ka qillue,

E pse lika tri pupla t'arta

Përsëritja e vargjeve lidhet me: ngadalësimin e ritmit të veprimit, tipike kjo për eposet dhe me theksimin e mesazhit.

Kaleshan e **sy-përgjakun**, Epitete

Edhe e ka **nji xheverdare**,

Xheverdare **pushkë vrastare**

Ushton mali thonë, kur t'flas Metafora

Dridhet fusha kah t'vikasë;

Rob tue zanë e gjind **tue pre**:-epanastrofe

Tue pre gjind, tue zan hajduka

Qysh se duel njaj **Oso Kuka!**

Oso Kuka, 'i burrë Shkodranë

Burrë **kaprroç** e trim **si Zana** (Krahasim)


Thonë me **kmishë** e bani nana;

Edhe, **thonë**, ka le drangue, Similitudë

E kah t'dredhë t'rrebtë taga'n,

Thue se rreftja shkrepë për anë: } Hiperbolë

Kaq vringllim aj shkon tu' i dhanë!

**Kemi disa lloje rimash:**

Hiperbola është përdorur për të theksuar akoma më shumë mendimin për trimërinë e figurës së Oso Kukës.

Nxënësit diskutojnë së bashku. Vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Informacion shtesë për mësuesin:

Përse Oso Kuka është personazhi qendror i “Lahutës së Malësisë”? Poeti i madh i ka kushtuar jo vetëm një kapitull apo (këngë) të veçantë këtij trimi legjendar, po për më tepër me përshkrimin mjeshtëror të portretit të tij, i ka dhanë Oso Kukës tipologjinë e genit të racës iliro-arbërore. Fishta ka shkruar më tej duke i veshur heroit tipare të pavdekësisë, si Homeri Akilit tek “Iliada”:

“Thonë i ka një palë musteqe

Kaçurel e leqe, leqe,

Që me i mrri deri në fletë të sylahit
Të gjatë e të trashë si llana e krahut”.
Apo më poshtë:
“Edhe plumi thonë si ngulet
Në ta tagani dhe përkulet

Top me i ra shpirti si shkulet”.

Nëse “Lahuta...” evokon me të drejtë historinë e lashtë të atdheut, qytetërimin e lashtë pellazgo-ilir, Aleksandrin e Madh, Teutën, Pirron e Gjergj Kastriotin (Skënderbeun), ngjarjet historike të shkuarës së largët i kalon përciptazi, me një vështrim empirik dhe i venë ato mjeshtërisht në shërbim të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, epopenë e Oso Kukës dhe të betejave me malazetët i ka në epiqendër të poemës.

Oso Kuka lindi në vitin 1820. Ai doli në skenën historike shqiptare në vitet '50 – '60 të shek. të XIX, në kohën më kritike të kombit shqiptar. Në vitin 1830, osmanët prenë në besë dhe vranë në Manastir 500 burra të Toskërisë. Viti 1831, shënoi rënien e pashallëqeve shqiptare, atij të Janinës dhe të Bushatllinjve. Bashkë me rënien e tyre, u shua dhe ëndrra për krijimin e një fronti të përbashkët Ballkanik kundër Turqisë. Në vitin 1832, Turqia filloi “Reformat e Tanzimatit”. Kudo, në tërë hapësirën shqiptare shpërthyen kryengritjet lokale, të cilat u kthyen në lëvizje kombëtare. Veçojmë Kryengritjen e Beratit në vitin 1834, e udhëhequr nga Hamza Kazazi, të Shkodrës në vitin 1835, të Myzeqesë në vitin 1835, të Dibrës në vitin 1844, të Kosovës në vitin 1845. Kryengritjet më të mëdha, ishin ajo e Malësisë së Gjakovës, e udhëhequr nga Binak Alia dhe Sokol Rama në qershor të vitit 1845, ajo në Shqipërinë Jugore të udhëhequra nga Rrapo Hekali, Zenel Gjoleka, Tafil Buzi, Hodo Aliu në vitin 1847 dhe ajo në Shkup në të njëjtin vit – e udhëhequr nga Dervish Cara. Edhe këto kryengritje shqiptare, u shtypën me ekspedita ushtarake dhe Porta e Lartë me organizimin e ribëri ndarjen e shqiptarëve në katër vilajete, për t'i mbajtur më kollaj nën sundim. E shkatërruar, e tronditur deri në themel nga luftërat për liri e çlirim kombëtar nga Turqia, Shqipërisë i kanosej dhe një rrezik i ri. Rusia cariste, tashmë me statusin e një fuqie të madhe ushtarake dhe politike, ndihej e plotfuqishme për të ngopur oreksin e Serbisë e të Malit të Zi për të zgjeruar kufijtë e territoreve të tyre në kurriz të shqiptarëve. Ilia Garashanini, ministri i Jashtëm i Serbisë kishte shpallur “Naçertanijan” (Serbinë e Madhe). Kolet, kryeministri i Greqisë kishte shpallur Megalidhenë (Greqinë e Madhe). Knjaz Nikolla i inkurajuar nga planet e Moskës dhe premtimi i Carit për mbështetje me armatim, para e mjete logjistike thërret në Çetinjë kriminelin me damkë Vullo Serdanin e Vasoviçit dhe e urdhëron të djegë, plaçkitë e të shkretotjë viset shqiptare, në Veri të Shkodrës. Ekspeditat ndëshkimore malazeze, e kishin kthyer Vraninën e rrethinat e saj në tokë të djegur. Qindra burra ishin vranë dhe barbarisë së malazezëve, nuk u shpëtuan as fëmijët e djepit. Nga presioni i madh i popullit dhe duke qenë krejtësisht i paafte për të mbrojtur kufirin me Malin e Zi, Guvernatori i Shkodrës, Avdi Pasha, organizoi mbledhjen e autoriteteve, të parisë së qytetit dhe të popullit dhe u mundua me dredhi t'u vinte fajin shqiptarëve, duke i quajtur frikacakë e të pafe, për të mbrojtur vendin e tyre.

-S'ka më burra këtu, ju keni mbetur në vajza”, – ju drejtohet Pashai turk me ligësi e fodullëk të pranishmëve.

Trimi Oso Kuka, i cenuar në gjënë më të shtrenjtë, në nderin dhe dinjitetin kombëtar, ngrihet në këmbë si Antë, venë dorën mbi dy koburet e lara me argjend që i mbante në brez dhe i drejtohet Pashait osman:

“Avdi Pasha ma kadalë,

Mos e thuaj dy herë atë fjalë,

Se për dinë e për imanë,

T'bah si t'kjan' e zeza nanë.

T'bah si t'kjan pa exhel ty, nana,

Se n'Shqipni ka djem si zana,

K'ta më t'parët janë n'fushë t'mejdanit.

K'ta më t'rreptit janë ballë dushmanit.

Janë çelik për teh të táganit”.

Oso Kuka me një grusht djemsh të zgjedhur dhe të sprovuar në beteja me turqit dhe malazetët, mori përsipër të mbronte kullën-fortesë të Vraninës dhe viset që sulmoheshin nga Vullo Serdani e banditët e tij.

Së bashku me luftëtarët e tij, e kthen situatën brenda pak ditëve në disfavor të pushtuesit. Ai kapi dhe asgjësoi dhjetëra cuba plaçkitës, duke i rikthyer popullit qetësinë dhe shpresën për të jetuar të lirë në trojet e tyre. Demarshet diplomatike të Knjaz Nikollës në kancelaritë evropiane, me qëllimin final për të aneksuar Shkodrën dhe rrethinat e saj, ishin kthyer në një rutinë, por gjendja në terren ishte krejt tjetër.

Oso Kuka e kishte kthyer kufirin në barrikadë të pakapërcyeshme.

Kur mbreti malazet Nikollai po i mburrej për zotësitë e tij Mbretëreshës Milena, ajo duke e njohur mirë realitetin e ri, guxon e ia përplas në fytyrë me fjalët që kënga popullore i ka gdhendur mjeshtërisht:

“Nuk e njeh ti Oso Kukën,

Që me gjak ai ta lan trupin.

Hajt një herë ka Podgorica,

Me çelik t'u ka nuanë Granica”.

I alarmuar së tepërmi nga disfata në Vraninë dhe nga frika e koordinimit në një komandë të vetme të kryengritjeve që kishin filluar të shpërthenin në të gjitha trojet iliro-dardano-arbërore, Knjaz Nikolla dha urdhër të sulmohej në befasi dhe të pushtohej me çdo kusht Vranina, si një pikë strategjike nga duhej të pushtohej dhe kryeqyteti i Ilirisë, Shkodra. Ashtu si Leonidhës përballë hordhive perse të Kserksit, Oso Kukës dhe çetës së tij ju desh të luftonin 1 me 300. Në natën e asaj beteje homerike, Oso Kuka ngrihet shpejt nga sofa e bukës:

Po çka ka ai Oso Kuka

Atij sonte s'po i habet buka

Nuk han bukë veç sa me thanë

I lan durt e rrin njan t'anë"

Oso Kuka duke e njohur mirë pabesinë e malazezëve, dërgon roje katër luftëtarë trima: Met Zenelin, Vuksan Gjelin, Karrni Gilen dhe Sinanin. Luftëtarët e Osos pastrojnë pushkët, mprehin shpatat dhe shtrihen për të marrë një sy gjumë, si e kanë zakon ushtarët e regjur në beteja. Në terrin e natës 3.000 forca elitare të ushtrisë malazeze të prirë nga Mirko Gjura, mik i Osos dhe banorë i Vrakës, i afrohen në fshehtësi Vraninës. Rojet shqiptare pasi vrasin tradhtarin, fillojnë betejën e pabarabartë me pararojën malazeze.

"Lahuta..." na sjell mrekullisht madhështinë e kësaj beteje heroike

"Ah, qëndro, o Met Zeneli!

Ban gajret, o Vuksan Gjeli!

Mos e lesbo mori Zagore,

Ngul Sinan, bre re mizore,

Se me gjasë ke dridhet Suka

Asht tuj ardh bash Oso Kuka.

Dragojt shqiptarë të prirë nga Oso Kuka dolën si shqiponjat nga çerdhja e tyre dhe fluturuan drejt në "Logun e Zanave", siç e quan Fishta mejdanin e trimave:

"Aman Zot kur Osoja mbrini,

Si re breshni kresë njaj vrrini.

Me tridhjetë e disa burra

E zateti nëpër curra.

Aty qiell má nuk u pá.

Aty pushkë má nuk u dá.

Kriste ltina e dumdunja,

Porsi breshni vinte plumja".

Kush e ka pa Vaterlonë dhe i njeh përmasat e kësaj kasaphaneje përmes vargjeve të Hygoit: "Vaterlo, Vaterlo, Vaterlo – fushëvarr" është në gjendje të imagjinojë guximin e trimërinë legjendare të Oso Kukës dhe çetës së tij, të cilët luftuan si luanë për 10 orë kundër ushtrisë malazeze, derisa kryetrimi i tyre, e kthen kullën e Vraninës në një varr masiv për ushtrinë e Knjazit. Perlat e Vraninës u kthyen në ferr për agresorët. Kur e pa se ndihma ushtarake nga Shkodra nuk po i vinte dhe i kishin mbetur gjallë vetëm 7-8 luftëtarë të plagosur, Oso Kuka si luani i plagosur dhe i egërsuar, u mbyll në "Kullën e Barotit". Dhjetëra luftëtarë malazezë hipën në çatinë e kullës që nuk jepej. Ndërkaq, 800 forca të tjera e kishin futur atë në një rreth të hekurt. Kryetrimi Oso Kuka merr me të shpejtë vendimin që e bëri të pavdekshëm në histori:

"Ndigjo Nikollë, të vraftë Zoti,

Se k'tu i thonë Oso Baroti,

Se djeg veten edhe ty..."

Ai u vuri flakën fuqive të barotit për ta kthyer kullën e Vraninës, këtë çerdhe shqiponjash në varr masiv për armikun.

Kulla e Vraninës u hodh në erë, bashkë me rrethuesit dhe mbrojtësit. Oso Kuka vendosi të vetëflijohej dhe me shkrumbin e vet dhe të luftëtarëve të tij të digjte armikun. 800 malazezë u dogjën në flakët e barotit, ndërsa dhjetëra të tjerë, ishin vrarë në orët e kësaj lufte të përgjakshme.

Kështu përfundoi kjo betejë pa të dytë në histori, në qershor të vitit 1862. Ai, Oso Kuka e ktheu Vraninën në "Trojën shqiptare". Kulla e Oso Kukës në Vraninë ra, por u ngritën shqiptarët. U ngritën zërat për heroizmat dhe kërkesat e tyre. Kjo kullë u bë simbol qëndrese në mbarë trojet etnike.

Burimi : <http://www.gsh.al/2017/09/03/oso-kuka-flakadan-i-perjetshem-i-lirise>

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për përgjigjet e tyre rreth Gjergj Fishtës, hulumtimit që kanë bërë për Betejën e Vraninës dhe figursë së Oso Kukës, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruani një hero real, ose një personazh nga librat që keni lexuar, i cili ju frymëzon.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Vranina (ora 2)		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. • Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. • Kompetenca personale • Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Hulumton rreth Oso Kukës dhe trimërisë së tij - Diskuton rreth figurave stilistike të përdorura në poezi - Dallon hiperbolën dhe forcën e saj shprehëse - Shpjegon efektin e përdorimit të dypikëshit në poezi - Analizon thënien e Eqerem Çabejt “Fishta përdor njësinë e fisit për të dhënë njësinë e kombit. Te fisi dallojnë tiparet e kombit, tiparet e racës. Kjo i jep veprës së tij përmasa kombëtare” 		Fjalët kyçe: Vranina Çetina Oso Kuka Burrë trim, shkodran Si dragua Luftë Krajl Shkje-Armik	
Burimet: https://www.youtube.com/watch?v=7sPj_1NhVrE https://www.youtube.com/watch?v=MZvqZh5FGzo		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Të nxënë në bashkëpunim, Rrjet diskutimi</i>			
Organizimi i orës së mësimt: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim</i> Lexohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Diskutojmë së bashku Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Të nxënë në bashkëpunim</i> Ndahet klasa në grupe dhe diskutojmë së bashku Grupi 1. Në këtë këngë përshkruhet bukur figura e Oso Kukës dhe trimëria e treguar në betejën e Vraninës. Pse përshkrimi është i rëndësishëm në këngë të kësaj natyre? <i>Imazhi i përfutur nga përshkrimi: hero me zemër të fortë, besnik, i cili lufton në emër të nderit e besës, i ashpër me armikun, hero i ngjashëm me ata të Eposit të Kreshnikëve. Hero që përmbush përfytyrimin e popullit për trimat shqiptarë, ndaj përshkrimi është i domosdoshëm.</i> Grupi 2. Renditni fjalët kyçe të këtij fragmenti dhe kthejeni në prozë fragmentin. Grupi 3. Shpjegoni efektin e përdorimit të dypikëshit. Përdorimi i dypikëshit ka një vlerë. Ai shërben për të lajmëruar një shpjegim. Rob tue zanë e gjind tue pre } Tue pre gjind, tue zan hajduka } <i>Pra autori do t'i shpjegojë lexuesit, se njerëzit që po vret, nuk janë njerëz të pafajshëm, po hajdutë që duan t'i rrëmbejnë vatanin.</i> Ku një fjalë e paska thanë: Se për t'gjallë rodi i Shqyptarit } Shpjegimi që jepet pas dypikëshit. Oso Kuka është nga ata burra që nuk bie i S'i bjen n'dorë kurr Gospodarit. } gjallë në duar të armikut Në këtë fazë të mësimt, do të diskutojmë rreth vlerësimit që personalitete të shumtë kanë dhënë për kryeveprën e Fishtës “Lahuta e Malcis” Albanologu austriak Maksimilian Lamberg (1882-1963): <i>“...Lahuta e malcis e Gjergj Fishtës, jo vetëm se ka rëndësi në pikëpamje artistike, por edhe pse ajo, por si vena e mirë, sa ma shumë vjet që të kalojnë, aq ma vlerë merr, duke qenë se ajo është pasqyra, magazina e kopja besnike e jetës, e shpirtit, e dëshirave, e përpjekjeve, e luftës dhe vdekjes së shqiptarëve: me një fjalë, Lahuta asht shprehja më e qartë e dokeve të fshatarëve, banorëve të Maleve të Veriut. E prej se doket e lashta të fiseve malore, janë gjykue të zhduken nga tallazet e forta të civilizimit, lexuesi, letrari, folkloristi, juristi e historiani i nesërm, ka për t'ia ditë për nder më dhjetë a qindvjetët e ardhshëm Poetit, i cili në Lahutë të Malcis na la një ritrat të Shqiptarit, të përshkruar nga goja e dëshmitarëve njëkohorë, ashtu si këta e gjetën në agimin e shekullit XX, me atë ndryshim të vogël, që shqiptari pësoi ç'prej kohërave të largëta të iliro-trakëve”.</i>			

Sterjo Spasse: “Lahuta e at Fishtës shfaq ndjesitë më të thella dhe karakteristikat më të kristalizuara që i ruajti raca shqiptare përmes shekujve plot shtrëngata... Shqipëria e tërë përfaqësohet e debur nën vargjet e kësaj Lahute, e cila bëhet pronë kombëtare, mish e gjak, ndjenjë e mendim i përbashkët”.

Ernest Koliqi: “Tue lexue Lahutën e tij, përplot me teprica kangësh rapsodike të pa emën, të duket se je tu e vështrore popullin shqiptar kah i këndon vedvetit, me fjalët e Fishtës, ma të kulluetën kangë, e cila shpërthen nga një gjak misterioz, që rrjedh në zemrën e tij ilire.

Faik Konica: “Atë Fishta është marrë me secilën gjini letrare dhe në të gjitha ka qenë i suksesshëm. Mirëpo, jashtë Shqipërisë, ai është i njohur vetëm si autor i Lahutës së Malcis – një epike pastorale e kalorësiake, përkthimi gjerman i së cilës, i botuar në Lajpcig para disa vitesh, të lë një përshtypje të dobët, meqë nuk ka qenë e mundur të përkthehet muzika e ritmit të Fishtës dhe koloriti i tij verbal”.

Norbert Jokli: “Ai hyri aq thellë në shpirtin e këngëtarëve të maleve shqiptare dhe diti të karakterizojë në mënyrë të dhimbshme dhe të sigurt artin, botën ideale e gjithëmbarsisht të gjitha veglat e armët e rapsodëve që gjenden edhe ndër më të skajshmet krahina të maleve. Vetëm ai që gjendet në mes të kësaj bote mund të ndiente aq thellë zemrën e të rrahmen e diellit të këngëtarit kombëtar shqiptar, mund të kuptonte aq mirë e qartë mendimin e tij”.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjet diskutimi

Diskutojmë rreth thënies së Eqrem Çabej:

“Fishta përdor njësinë e fisit për të dhënë njësinë e kombit. Te fisi dallojnë tiparet e kombit, tiparet e racës. Kjo i jep veprës së tij përmasa kombëtare”

Nxënësit të ndarë në dy grupe, me dy qëndrime të kundërta rreth mendimit të Çabejt, japin mendimet e tyre, debatojnë me argumente.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor dhe argumentet e pasura të dhëna gjatë diskutimit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Mbiemri: kategoria gramatikore e shkallës		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - Përcakton kategorinë gramatikore të shkallës së mbiemrave - Dallon në fjali mbiemrat duke përcaktuar shkallën e tyre - Ndërton fjali me mbiemra në shkallë të ndryshme		Fjalët kyçe: mbiemër, kategoria gramatikore e shkallës, pohore, krahasore, sipërore, mjetet.	
Burimet: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, tabela e mbiemrit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e drejtuar; Shpjegim; Punë në dyshe; Punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Punë e drejtuar

Hapi i I: Punë e drejtuar

Mësuesi shkruan në tabelë fjali ku janë përdorur mbiemra të shkallëve të ndryshme. P.sh.:

Gjatë rrugës shkollorë, mund të ndeshim pengesa, fjala vjen një mësuese shumë e rreptë, që kërkon rezultate të mira, pa na dhënë zemër e nxitje në sprovat që fillimisht kërkojnë përpjekje më të mëdha.

U kërkohet nxënësve të dallojnë mbiemrat dhe të përcaktojnë kategoritë gramatikore të tyre me gojë. Kategorinë e shkallës, nxënësit e njohin nga klasat e mëparshme. Gjithsesi u tërhiqet vëmendja, se përveç gjinisë, numrit dhe rasës, mbiemrat kanë dhe kategorinë gramatikore të shkallës.



Hapi i II: shpjegim

U shpjegohen dhe qartësohen nxënësve mjetet me të cilat ndërtohet shkalla krahasore dhe sipërore e mbiemrit.

- Shkalla krahasore**
- 1- *aq, kaq* (ndajfolje sasive)... *sa, si* (lidhëza krahasore): *kaq i mirë sa*
 - 2- *më* (pjesëz)... *se, sesa, nga* (lidhëza krahasore): *më i heshtur nga* (herët e tjera)
 - 3- *më* (pjesëz) pak (Ndajfolje)... *se* (lidhëz): *më pak e zhurmshme se*

P.sh.: Apartamenti ishte kaq i mirë sa nuk e vumë në diskutim çmimin.

Qenke më i heshtur nga zakonisht!

Lagjja ku banoj tani, është më pak e zhurmshme se ajo tjetra.

Shkalla sipërore - ndajfoljet: *shumë, tepër, jashtëzakonisht, mjaft, fort, krejt, absolutisht, fare*, etj.

Por dhe emrat që në këtë rast nuk emërtojnë më sende, por një tipar të tyre: **akull, borë, mjaltë, dyllë, qumësht**. P.sh.: *Ishte bërë në fytyrë dyllë i verdhë. Para dasmës, ishte bërë në fytyrë e bardhë qumësht.*

Sugjerim: Duke qenë se nxënësit kanë njohuri nga vitet e mëparshme për shkallën e mbiemrit, pas rikujtimit apo përmbledhjes së informacionit, i duhet kushtuar vëmendje në rastet jo të zakonshme, meqë dhe në provim shpesh jepen raste të tilla.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe, punë e pavarur

Hapi i I: Punë në dyshe

Në dyshe sipas bankave, nxënësit punojnë ushtrimin 1 dhe 2.

Ushtrimi 1. Nënvizoni mbiemrat dhe përcaktoni shkallën e tyre.

Në sytë e nënës, ai donte të tregoj sa më i qetë dhe më i përmbajtur. (K)

Qe shumë i gëzuar atë ditë, sa nuk i dukej më asnjë fije nga ai hidhërim i madh. (S:P)

Ishte zhytur pa u kuptuar në një det ëndrrash e vegimesh të bardha, të mrekullueshme. (P)

Një mall i madh, gati i padurueshëm, e mbështolli krejt. (P)

Qielli u bë shumë i pastër dhe yjet nisën të shfaqeshin njëri pas tjetrit. (S)

Detyrën e shtëpisë nuk e kishin zhvilluar të gjithë nxënësit, pasi ishte më e vështirë se ajo e radhës së kaluar. (K)

Qarkoni nga lista e mëposhtme mbiemrat që e kanë kategorinë e shkallës. Me pesë prej tyre formoni fjali, duke i përdorur në shkallët krahasore dhe sipërore.

i kuq, krijues, zemërmirë, dinak, i ëmbël, i djeshëm, dyvjeçare, shumëngjyrësh, natyror, i poshtëm, shqiptar, shtetëror, i drunjti, i ditur, qortues, i thjeshtë, i papunë, trekëndësh.

Hapi i II: punë e pavarur

Ushtrimi 3. Përshtatni dhe vini në shkallën e duhur mbiemrat në kllapa.

Kjo ndërtesë është më e vjetër se ajo.

Dje qielli ishte i vrenjtur.

Për mua stina e bukur është pranvera.

Ushtrimet e këtij mësimi, janë më të lehta se të mësimin të djeshëm.

Dritaret e shtëpisë së Arbenit janë aq të larta sa dritaret e shtëpisë suaj.

Pyetjeve të bëra nga mësuesi përgjigju me fjali të shkurtra.

Mali i Korabit është më i lartë sesa mali i Dajtit.

Shfaqja ishte tepër interesante.

Ushtrimet diskutohen në klasë.

Ushtrimi 4. Nxënësit dallojnë mbiemrat në kuriozitetet e mëposhtme dhe përcaktojnë gjininë, numrin, rasën dhe shkallën e secilit.

a) Gjethet më të mëdha i ka palma rafi në brigjet e Amazonës. Gjethet e saj, janë si një pendë gjigante. Disku i gjelbër i gjethit, arrin 22 metra gjatësi dhe rreth 12 metra gjerësi, ndërsa bishti rreth 5 metra. Nën një gjeth të tillë, mund të strehohen 10 vetë.

b) Lulen më të madhe në botë e ka rraflezia, bimë në ishullin Java (Indonezi). Ajo është mishtake, pesëpetalëshe, e kuqe, me njolla. Rritet me një diametër deri në një metër e gjysmë.

Sipas kushteve të mjedisit të klasës në tabelë punojnë ushtrimin 2-3 nxënës.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit hap pas hapi gjatë gjithë orës mësimore. Vlerësohen për dallimin e mbiemrave, përshtatjen e tyre në fjali, si dhe për analizën gramatikore të tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, faqja 259.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përemri: kategoria gramatikore e vetës, numrit dhe gjinisë (ora e parë)		Situata e të nxënit: Tekste që përmbajnë përemra.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: përemri, kategoritë gramatikore, numri, veta, gjinia, përemri vetor, përemri dëftor, përemri pronor, përemri pyetës.	
<ul style="list-style-type: none"> - Përcakton kategoritë gramatikore të përemrit (kompetenca e programit). - Dallon përemrin vetor dhe identifikon veçoritë gramatikore të tij; - Dallon përemrin dëftor dhe identifikon veçoritë gramatikore të tij; - Dallon përemrin pronor dhe identifikon veçoritë gramatikore të tij; - Dallon përemrin pyetës dhe identifikon veçoritë gramatikore të tij. 			
Burimet: skeda të parapërgatitura nga mësuesi, libri i nxënësit, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Praktikë e drejtuar, Punë në grupe; Diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Praktikë e drejtuar*

Klasa ndahet në 4 grupe. Secilit grup i jepet një skedë, në të cilën është shkruar një tekst, ku janë përdorur : a) përemra vetorë; b) përemra dëftorë; c) përemra pronor; ç) përemrat pyetës.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë në grupe*

U kërkohet nxënësve të punojnë duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin për të:


- dalluar përemrat dhe të tregojnë llojin e tyre;
- identifikuar kategoritë gramatikore të përemrave.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë në grupe*

U kërkohet nxënësve të punojnë duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin për të:

- dalluar përemrat dhe të tregojnë llojin e tyre;
- identifikuar kategoritë gramatikore të përemrave.

Mali i Çikës bën pjesë në Vargun Bregdetar Jonik. Ky varg ka dy degëzime, atë perëndimor dhe atë lindor, të cilat ndahen midis tyre nga Gjiri i Vlorës dhe Fusha e Dukatit. Përgjatë këtij vargu, nga Uji i Ftohtë në Vlorë e deri në Butrint, shtrihet Riviera shqiptare.



-Dallo përemrat dhe përcakto llojin.


-Nxirr nëpërmjet kllasterit veçoritë e këtij përemri.

Kur askush nuk donte t`i tregonte se ku ishte, Rulina e mbylli

gojën. Ajo shkoi dhe u ul në dhomën e Plonit, ashtu siç

Shkonte e ulej gjithmonë. Dhe për një kohë të gjatë, i

nguli sytë pa ia ndarë karriges ku gjithmonë rrinte ulur ai. Që nga ai çast, ajo heshti një herë e përgjithmonë.



-Dallo përemrat dhe përcakto llojin.


-Nxirr nëpërmjet kllasterit veçoritë e këtij përemri.

Me motrën time vendosëm të shkonim në qytetin tonë.

Në shtëpinë tonë, tashmë jetonin njerëz të tjerë. Lagjja jonë

s`ishte më si në kujtimet tona... Gjithçka kishte ndryshuar,

megjithatë dashuria për qytetin e fëmijërisë sonë, mbetet e njëjtë.



-Dallo përemrat dhe përcakto llojin.


-Nxirr nëpërmjet kllasterit veçoritë e këtij përemri.

Sa kontinente ka planeti ynë?

Cili është kontinenti më i madh?

Cila zonë ka më shumë shtete?

E sata renditet Australia?



Pas punës në grup, përfaqësues të grupit paraqesin punën para klasës. Të gjithë nxënësit japin mendime dhe plotësojnë përgjigjet e shokëve.

Pas punës në grup, përfaqësues të grupit paraqesin punën para klasës. Të gjithë nxënësit japin mendime dhe plotësojnë përgjigjet e shokëve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Diskutim*

Mësuesi përmbledh në tabelë veçoritë gramatikore për secilin përemër.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet në lidhje me bashkëpunimin dhe saktësinë që ata tregojnë gjatë punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 1, faqja 261.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përemri: kategoria gramatikore e vetës, numrit dhe gjinisë (ora e dytë) Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji		Situata e të nxënit: Përdorimi i drejtë i përemrave	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton kategoritë gramatikore të vetës, numrit dhe gjinisë të përemri vetor, dëftor, pronor dhe pyetës. -Përdor saktë në fjali formën e duhur të përemrit pronor dhe pyetës; -Dallon përemrin dëftor në fjali dhe përcakton kategoritë gramatikore të tij. 		Fjalët kyçe: përemri, kategoritë gramatikore, numri, veta, gjinia, përemri vetor, përemri dëftor, përemri pronor, përemri pyetës.	
Burimet: skeda të parapërgatitura nga mësuesi, libri i nxënësit, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim; Punë individuale; minikonkurs</i>			
Organizimi i orës së mësimimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim</i> Diskutohet ushtrimi 1, të cilin nxënësit e kanë punuar në detyrat e shtëpisë. 1. Gjeni përemrat dhe përcaktoni se cilët prej tyre kanë kategori gramatikore. Renditni kategoritë e tyre gramatikore.			

Në studio krisi sëpata dhe në truallin prej çimentoje ranë bluashkat e arrës. Ato kërcyen ngado dhe mbushën gjithë studion. Unë u mërzhita duke dëgjuar rrahjet e sëpatës dhe vendosa ta lë mikun tim në punë të vet. Pastaj mua m'u duk sikur edhe ai dëshironte të lirohej nga barra e atyre shikimeve të mia të kota në trung të arrës, në mykën e sëpatës dhe në dorën e tij të trashë si prej druvari. Hapa derën dhe dola. Ai bile nuk më vuri re fare.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale

Nxënësit punojnë në libër **individualisht** ushtrimet 2, 3 dhe 4. Në përfundim çdo ushtrim diskutohet në klasë.

2. Lexoni fjalitë dy e nga dy. Në fjalinë e dytë në vend të vizave vendosni përemrin vector që zëvendëson emrin ose emrat e nënvizuar në fjalinë e parë.

Arbeni është një nxënës shumë i mirë i klasës së shtatë.

Me të krenohemi të gjithë.

Ajo është ulur në divan dhe po lexon një libër që i duhet për lëndën e historisë.

E lexoi atë me një frymë.

Jashtë, te portat e kështjellës, priste qysh prej mëngjesit, makina që do të dërgonte Elsën me gjyshen në kryeqytet.

Vinin apo s'vinin të tjerët, ato do të niseshin atë mbasdite.

3. Në vend të vizave, vini njërin nga përemrat në kllapa. Shpjegoni zgjedhjen e bërë.

Nga ana jonë do të marrin pjesë dy vetë.

Vajzës sime të vogël i pëlqen shumë të vizatojë.

Qyteti ynë ka pak sipërfaqe të gjelbëruara.

Këto dyshime janë pa vend.

Ne kemi mësuar nga gabimet e të parëve tanë.

Unë jam shumë e tronditur për sa i ka ndodhur vajzës suaj.

4. Zgjidhni përemrin e duhur nga dy përemrat pyetës të dhënë dhe shpjegoni zgjedhjen tuaj.

Cili është mësimi, cilat janë çështjet?

cili / kush

Nga cili e pret përgjigjen?

cili / kush

E sata ditë e javës është e diela?

i sati / sa

Cili nxënës fitoi konkursin?

cili / kush

Nuk e di se kujt t'ia jap librin.

cili, kush

Çfarë perimesh keni mbjellë sivjet?

ç' / çfarë

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: minikonkurs

Për ushtrimin 5, nxënësit punojnë fillimisht në libër për të dalluar përemrat dëftorë dhe më pas i analizojnë me shkrim në fletore. Nxiten nxënësit të konkurojnë me njëri-tjetrin.

5. Dalloni përemrat dëftorë dhe përcaktoni gjininë dhe numrin e tyre.

E çdo të fitoni ju nga tërë ky mundim e gjithë kjo rrugë e rrezikshme? - pyeti Markoja që nuk dëshironte të rrinte më vetëm.

Pas marrjes së një note të tillë, ajo filloi të mësonte shumë. Ai pranoi se për të marrë vendime të tilla të thjeshta, nuk është

kurrë vonë. Rrymat e erës i kishin kundër dhe kjo e vështirësonte së tepërmi udhëtimin. Pas asaj sëmundjeje, ajo filloi të

ushtrohej 3 orë në ditë. Ajo së cilës i jepte më shumë rëndësi, ishte komunikimi me nxënësit që për të ishin më të rëndësishmit.

Në këtë mënyrë, nisi për ata udhëtimi që zgjati, në ato toka të panjohura, plot 10 vjet. Panë disa shtëpi. U drejtua me të

birin tek ajo atje që ishte më larg dhe me ndrojtje, trokiti disa herë.

Në përfundim, ushtrimi diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve për detyrën e shtëpisë dhe për saktësinë e ushtrimeve të tjera.

Detyrat dhe puna e pavarur: Dallo përemrat dhe analizo 10 prej tyre, në tregimin "Guido dhe Gjuha greke"

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Lamtumirë		Situata e të nxënit: A keni qenë në ndonjë situatë ku duhet t'i jepnit lamtumirën diçkaje, apo dikujt që e keni pasur shumë përzemër? Na e tregoni nëse mundeni.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Diskuton rreth jetës dhe veprës letrare të Fatos Arapit - Dallon vargun e lirë nga llojet e tjera të vargjeve - Përshkruan gjendjen emocionale të poetit pas lamtumirës që i jep vendlindjes - Dallon figurat letrare në poezi. 		Fjalët kyçe: Lamtumirë Kujtim Mall Vendlindje	
Burimet: Teksti i nxënësit, poezi nga vëllimet poetike të Fatos Arapit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Parashikim me anë të titullit, Praktikë e drejtuar, Karrigia e nxehtë</i>			
Organizimi i orës së mësimt Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Parashikim me anë të titullit</i> Çfarë do të thotë për ju fjala "Lamtumirë"? Vargjet e poezisë "Lamtumirë", çfarë ndjesish përcjellin te ju?			
<p>Dy fjalë për autorin</p> <p>Fatos Arapi (1930) është një nga poetët më të spikatur të letërsisë shqipe bashkëkohore. Ka lindur në qytetin e Vlorës. U diplomua për matematikë dhe ekonomi në Universitetin e Sofjes në Bullgari. Fitues i disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në poezi. Disa nga vëllimet e tij në poezi, janë: "Shtigje poetike", "Poema dhe vjersha", "Poezi të zgjedhura", "Më vjen keq për Jagon", "Kujtohem që jam", "Antologji personale", etj.</p>			
Ndërtimi i njohurive të reja: Praktikë e drejtuar Nxënësit recitojnë poezinë "Lamtumirë vendet e mia" të Gjergj Fishtës.			
<p>Lamtumirë, vendet e mia, qe, po zhduken dalëngadalë! Gjëmon deti, ushton duhia, likundet barka valë mbi valë, Kah njai diell, që asht tue flakue, andej fill un tash do t'vete... Lamtumirë, atdhe i bekue! Lamtumirë, për sa t'jet jeta! Nesër nade kur mbi ne, rrezja e diellit ka me ra, kush e din sa ujë e dhe, mue prej teje ka me m'da</p>		<p>E por n'pyetsha ret mizore, e por n'pyetsha zogjt e detit, se për ty, moj tokë arbnore, s'ka me m'folë kush mue t'shkretit... Tjera fusha e tjera zalle kam me pa, e tjera dete; kam me ndje po tjera valle, tjera gjuhë, tjera qytete. Vendin tem s'kam me e pa, ku kam le e jam burrnue: sytë e mi kan me kja. pa u gjet kush me i ngushllue.</p>	

Lexojmë poezinë me radhë, me intonacionin e duhur duke shpjeguar fjalën konstelacion
Konstelacion – yjësi. Grup yjesh që përbëjnë një figurë të dukshme në qiell, p.sh.: yjësia e Arushës së Madhe.

Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Motivi: *Motivi i trishtimit prej ndarjes nga vendlindja*

Cili është lajtmotivi i kësaj poezie? *Dhimbja e lamtumirës*

Mësojmë: Lajtmotiv:

lajtmotiv, -i m. sh. -e(t) libr. 1. muz. motivi kryesor që përsëritet herë pas here në një vepër të madhe: lajtmotivi i operës. 2. fig. mendimi kryesor që përshkon një vepër letrare, etj., a që theksohet në të; qëllimi kryesor që udhëheq veprimtarinë e dikujt: lajtmotivi i romanit; lajtmotivi i jetës së tij.

Shkruani tri ide kyçe që shfaqen në këtë poezi.

Ndarja – lamtumira me vendlindjen

Largimi larg vendlindjes

Largim fizik, po jo shpirtëror: Vendlindja do ta shoqërojë kudo e kurdo

Renditni detajet përshkruese të kësaj poezie.

Silueta qiparisash nëpër sponde të murrme ullinjsh

Dhe blloqet e hijeve të Çikës,

mbi konstelacione yjesh Jonit përposh.

4. Kjo poezi është shkruar me varg të lirë. Ilustroni me shembuj karakteristikat e këtij vargëzimi.

Vargu i lirë shkruhet pa zbatuar rregullat e njohura për ndërtimin e strofave dhe të vargjeve, pra janë pa rimë, pa numër të njëjtë të rrokjeve në varg, etj.

5. Përshkruani gjendjen emocionale të poetit, duke plotësuar tabelën e mëposhtme.

<i>Si ndihet poeti?</i>	<i>I çlirët</i>	<i>I tensionuar</i>	<i>Indiferent</i>
<i>Pse mendoni në këtë mënyrë?</i>	<i>Autori në veprimet dhe sjelljet e tij, është i natyrshëm. Ai e kupton që është ndarja është vetëm fizike, pasi në mendimet e shpirtin e tij, vendlindja do të jetë aty.</i>	<i>Çdo lloj ndarjeje është e dhimbshme dhe e tensionon individin, jo vetëm poetin.</i>	<i>Nuk mund të jetë indiferent në momente ndarjeje.</i>

8. Gjeni figurat letrare në vargjet me shkronja të pjerrëta dhe shpjegoni funksionin e tyre.

Marr me vete djegie perëndimesh - metaforë

Muzqe të qeta - epitet metaforik

Dhe blloqet e hijeve të Çikës, që përkunden netve-metaforë – Lidhëza dhe (shtuese) krijon idenë e përmbylljes së mendimit.

Gjithçka e ka marrë me vete në kujtimet e tij, e nuk i ngelet gjë tjetër, veç mallit për vendlindjen, silueta qiparisash nëpër sponde të murrme ullinjsh. Elipsa. Përmes elipsit arrihet dendësi, thukëti dhe fuqi në shprehjen e qëndrimeve të autorit.

Mungesa e foljes të krijon një gjendjeje statike, të ngecur diku e pa forcë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Karrigia e nxehtë*

Një nxënës ulet në një karrige para klasës dhe u përgjigjet pyetjet të bëra nga shokët.

Me anë të kësaj teknike, synohet të kultivohet te nxënësi, një nga shprehitë e të menduarit, *empatia*.

9. Në rast se do të ishit në vend të poetit që po largohet nga vendi i tij, për çfarë do t'ju merrte më shumë malli?

Në karrige mund të ulen disa nxënës, të cilët kanë dëshirë të tregojnë përvojat e tyre për ndjesinë që kanë provuar kur janë larguar nga vendlindja e tyre.

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për saktësinë e përgjigjeve në nivelin kuptimor, analizën dhe interpretimin e poezisë, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: 1. Mëso poezinë përmendësh 2. Kthe poezinë në prozë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: “Kujtime dhe krijime”. Projekt (ora e parë).		Situata e të nxënit: Kujtimet. Çfarë janë kujtimet? Nuk i ndien, nuk mund t'i prekësh, nuk i shikon. Ndodh që përpiqesh t'i largosh, por ato janë akoma më të forta aty. Kanë hedhur rrënjë të thella dhe nuk i shkul dot. Kërkon të gjesh ato më të bukurat. Të ngatërrohen; janë bashkë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> -njeh e grupon llojet e teksteve sipas qëllimit, -grumbullon informacionin e duhur mbi temën e dhënë, -ritregon ngjarje me detaje dhe fjalor të bukur, -bashkëbisedon lirshëm duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij, -respekton mendimet dhe gjykimet e të tjerëve, -shpreh mendimet dhe këndvështrimet e tij, duke respektuar faktorin kohë, -pasuron linjën e debatit me argumente duke respektuar etikën, -përmbledh informacionin që prezantohet gjatë diskutimeve në klasë, në shkollë. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Tregim Ngjarje Përjetime Kujtime Tekste Ndjenja Shoqëri Shkollë Largim 	
Burimet: Modele me libra kujtimesh, pjesë të përgatitura nga mësuesi/ja për temën e mësimit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Harta e mendimeve, pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, rrjeti i diskutimit. Analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Harta e mendimeve, pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim.			
Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Kujtime” dhe kërkon nga nxënësit që të krijojnë një hartë mendimi që lidhet me këtë fjalë. Nxënësit punojnë në fletët e tyre për të hedhur disa ide rreth temës së dhënë. Punohet 2-3 minuta dhe më pas krijohet në tabelë një hartë e madhe me mendimet e përbashkëta të nxënësve.			
<div style="border: 1px solid gray; padding: 10px; width: fit-content; margin: 0 auto;"> <p>Kujtimet: na emocionojnë, na bëjnë të qeshim, ndihemi mirë, mërzitemi, trishtohemi, krahasojmë, rikujtojmë, mbajmë gjallë, gjejmë gabime, ndihmojnë të përmirësohemi, krijojnë imazhe, pamje, ndikojnë tek e ardhmja, etj.</p> </div>			
Mësuesi/ja drejton përgjigjet e nxënësve dhe një nxënës mund të plotësojë hartën në tabelë.			
Mësuesi/ja ngre situatën: Të gjitha këto që nxënësit japin si mendime, janë çfarë na bëjnë kujtimet.			
Shtrohet pyetja: Po çfarë janë kujtimet? Po e kundërta e kujtimeve, cila është? (Nuk i ndien, nuk mund t'i prekësh, nuk i shikon. Ndodh që përpiqesh t'i largosh, por ato janë akoma më të forta aty. Është aftësia e një organizmi që nëpërmjet trurit, të ruajë, të radhisë, informacionet dhe t'i kthejë ato. E kundërta është harresa. “Prona e vërtetë e njeriut, është kujtesa e tij”, Alexander Smith).			
Kërkohet nga nxënësit që të rikujtojnë ndonjë ngjarje nga jeta e tyre. Ngjarja duhet të jetë pjesë e jetës së tyre shkollore dhe personazhet duhet të jenë shokët dhe shoqet e tyre. Lihen nxënësit për disa minuta të komunikojnë me njëri-tjetrin për të kujtuar një ngjarje dhe për të zgjedhur se cili do ta tregojë.			
Nën drejtimin e mësuesit/es, ngrihen disa nxënës me radhë për të ritreguar ngjarjen e përjetuar.			

Shokët dhe shoqet presin përfundimin dhe nxënësit plotësojnë kujtimet duke dhënë detaje të hollësishme. Diskutohet mbi rëndësinë e kujtimeve si edhe bëhet një përmbledhje, duke theksuar se kujtesa nuk është e njëjtë për të gjithë. Në një situatë a ngjarje të caktuar, pjesëmarrësit, pas shumë kohe, do të sjellin variante të ndryshme dhe me detaje të ndryshme nga njëri-tjetri.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Rrjeti i diskutimit, analizë rasti.*

Mësuesja njihet nxënësit me temën e projektit: “Kujtime dhe krijime” dhe pyet nxënësit se cili është mendimi i tyre i parë pasi dëgjojnë temën. Mendimet e nxënësve vijnë në formën e një rrjeti diskutimi dhe janë të ndryshme. Ato lidhen me: *kujtime nga jeta, kujtime nga ngjarjet në shkollë, aktivitete që u kanë mbetur në kujtesë, dita e parë e shkollës, nota dhe vlerësimi që u ka bërë më shumë përshtypje, shoku dhe shoqja që i ka lënë mbresa, emocionet që kanë përjetuar para provimeve, krijime të ndryshme gjatë viteve, punë me shkrim për tema të caktuara, mësues që i kanë përkrahur, apo ndëshkuar, ambientet e preferuara të shkollës, orët që i kanë ndjekur me dëshirë apo që nuk i shtynin dot, takimet me prindër dhe fjalët që i kanë shoqëruar për ditë me radhë, ditët e pushimeve, apo ditët kur ke munguar, festat që ke festuar me shoqërinë, zënkat me shokët, apo me klasat e tjera, dënimet e marra nga mësuesilja kujdestare, etj.*

Mendimet e nxënësve dëgjohen dhe mbahen shënime nga shokët e shoqet, sepse mund t’u shërbejnë më vonë, gjatë punës individuale dhe me grupe.

Shënimet na ndihmojnë që të kujtojmë diçka. Prandaj edhe ky libër me kujtime, do të shërbejë që të mbeten të freskëta në mendje këto ngjarje e përjetime.

Për të shkruar një libër kujtimesh, duhen pasur parasysh llojet e teksteve: letrare dhe joletrare.

Te tekstet bëjnë pjesë: tregimi, poezia, novela, romani, lirikat, fjalët e urta, (shprehje të zgjuara), etj.

Te tekstet joletrare do të përmendim disa, si: reportazhi, udhëpërshkrimi, autobiografia, biografia, kujtime, ditari, intervista, lista, statistika, etj.

Këto lloje tekstesh do të përdoren gjatë krijimit të librit për projektin.

Mësuesi/ja sjell raste të teksteve të ndryshme për të nxitur nxënësit dhe për të bërë sa më të qartë punën që duhet të bëjnë.

A. Hyseni.

Me miqtë e mi u takova për herë të parë në vitin 2009, kur erdha në klasën e dytë, për disa arsye personale. Ishte një ditë e rëndësishme për mua, sepse do të takohesha me njerëz të panjohur. Sapo u futa në klasë, mësuesja më prezantoi me klasën dhe më uli në bankën e parë. Ishte një klasë e vogël dhe nxënësit po ashtu. Të gjithë më shihnin kureshtarë. U ula e vetme, sepse askush nuk dëshironte të ulej me mua. Fillova t’i shihja të gjithë me radhë. Vajza e parë me të cilën fola, ishte Fjorela, një fëmijë i imët dhe vajzë shumë e lëvizshme. Mendimi im për të, nuk ishte aspak i mirë. Nuk më pëlqente mënyra se si ajo vepronte në klasë, por... shumë shpejt u bëmë shoqe.

Ditët kaluan dhe u njoha shumë shpejt me të gjithë. Njoha Edean, një vajzë flokëverdhe që qante shpesh për notat që merrte (dukej që mësuesja kishte një simpati për të). Njoha Medinën, një bullafiqe, e cila nuk fliste po dukej që mendonte shumë. E pas tyre, njoha Serenën (ajo nuk është më në shkollën tonë), një vajzë lozonjare dhe plot teka. Shihja se çdo gjë që ajo dëshironte, plotësohej. Pasi u njoha me vajzat, fillova të eksploroja edhe djemtë, edhe pse nuk kishte ndonjë të bukur. Njoha Arjelin, Gledisin dhe Klejdin, të tre shumë të qeshur dhe të dashur. Pothuajse kisha njohur shokët me të cilët do të kaloja vitet e mia të shkollës. Ishin pikërisht ata me të cilët do të kaloja momentet më të lumtura e më të gëzuara të jetës.

Marrë nga “Libër kujtimesh”, shkolla “Kushtrimi i lirisë”, Durrës, klasa IX-C.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e drejtuar, punë e pavarur.*

Mësuesi/ja sqaron punën që do të bëjnë nxënësit për projektin në orën e parë.

Gjatë kësaj ore, pasi marrin informacionet e duhura, nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale rreth temës. Secili nxënës duhet të nxjerrë të dhëna të sakta rreth tij dhe jetës së tij shkollë.

Këtu do të përfshihen:

- 1- Emri dhe mbiemri, datëlindja, qyteti dhe shteti i lindjes, përshkrim të shkurtër të familjes, disa tipare dhe veçori të tij, aftësitë dhe zotësitë e tij, pëlqimet dhe preferencat, shokët dhe shoqet më të ngushta.
- 2- Nxënësi do të krijojë një tekst autobiografik rreth vetes, për të treguar më shumë për veten, do ta plotësojë me disa foto (nëse ka), për ta bërë më tërheqës përshkrimin. Brenda do të ketë ngjarje reale, përshkrim të shoqërisë, të ndjenjave, të përjetimeve, vlerësim të situatave.
- 3- Nxënësi do të përzgjedhë nga krijimet e tij më të bukura gjatë viteve (të ruajtura në portofolin e tij), që e identifikojnë për t’i pasqyruar në pjesën e tij të librit, ose mund të krijojë posaçërisht për këtë projekt, vargje dhe krijime artistike, që lidhen me temën e projektit.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të mbajnë shënime rreth orientimeve të dhëna për punën individuale që duhet të bëjnë.

Punimet e bëra, do të punohen në kompjuter, sepse do të bashkohen të gjitha materialet në një tekst të vetëm.

Nxënësit mbi shënimet e marra, fillojnë të punojnë në mënyrë të pavarur, për të nxjerrë të dhënat e duhura.

Gjatë punës, mund të ndihmohen nga mësuesja, për renditjen e informacioneve dhe përzgjedhjen e materialeve nga portofolët e të nxënësve.

Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Kënga e natës		Situata e të nxënësve: <i>Thënie për jetën dhe suksesin nga J. V. Gëte</i> <i>Nuk ka gjë më të frikshme se injoranca në veprim.</i> <i>Dijet që kam unë, mund t'i ketë çdo njeri, por zemra ime është vetëm e imja.</i> <i>Të jesh brilant nuk ka asnjë vlerë, nëse ti nuk respekton asgjë.</i> <i>Secili të pastrojë derën e vetë, gjithë bota do të jetë e pastër.</i> <i>Diskutojmë së bashku.</i>	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca personale. 			
<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion poezinë; - U përgjigjet pyetjeve që kanë lidhje me të kuptuarit e poezisë; - Analizon ndjesitë që përcjell poezia nëpërmjet përdorimit të figurave letrare; - Zbulon mesazhin poetik që përcjellin vargjet. 		Fjalët kyçe: Këngë Natë Jastëk i butë Ëndërrime Qiell Mëngjes Gjumi Violina	
Burimet: teksti i nxënësve http://www.gazetaexpress.com/mistere/50-thenie-frymezuese-per-jeten-dhe-suksesin-nga-gete-362896/?archive=1		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Arte TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i>			
Organizimi i orës së mësimin Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Diskutim</i> <i>Në videoprojektor paraqitet një material, i cili flet për jetën e veprën letrare të Gëtes.</i>			
<p>Dy fjalë për autorin: <i>I konsideruar nga Albert Ajnshtajni si “njeriu i fundit në botë që di çdo gjë”, emri Johan Wolfgang von Gëte i ka kaluar kufijtë e Gjermanisë. Krijimtaria letrare e Gëtes përfshin poezi, drama, tregime, novela, dorëshkrime autobiografike dhe letrare, shkrime nga shkencat e natyrës, korrespondenca, letra të ndryshme etj. Vepra që e bëri të njohur: “Vuajtjet e djaloshit Verter”</i></p> <p>Johan Wolfgang von Goethe (Johan Wolfgang von Gëte), ishte jo vetëm shkrimtar, por edhe piktor, shkencëtar, biolog, fizikant teorik, dhe dijetar. Dijetari gjerman themeloi edhe shkencën e kimisë njerëzore dhe zhvilloi një nga teoritë më të hershme të njohura të evolucionit. Ai është konsideruar si një nga figurat më të mëdha në letërsinë perëndimore. “Fausti” i tij, është quajtur një nga veprat më të mëdha dramatike të letërsisë moderne evropiane.</p> <p>Në vepër, trajtohet se si njeriu ia shet shpirtin djallit për hir të një dashurie dhe që në fakt, përbën një betejë të vështirë të gjatë ndërmjet njeriut dhe djallit. Gëte, një nga poetët më të mëdhenj në Gjermani dhe Evropë, ka ndikuar thellësisht në historinë e letërsisë dhe mendimit evropian.</p>			
Burimi : http://www.gazetaexpress.com/mistere/50-thenie-frymezuese-per-jeten-dhe-suksesin-nga-gete-362896/?archive=1			

Poezia lirike e ka marrë emrin nga instrumenti muzikor i grekëve të lashtë, lirës, me të cilën ata shoqëronin recitimin e poezisë. Në antikitet ajo nuk vlerësohej në të njëjtën mënyrë si epika dhe drama. Kjo lidhet me faktin që konsiderohej më tepër si krijim me vlera argëtuese. Për nga gjatësia, poezia lirike konsiderohet e shkurtër. Poezia lirike ka aftësinë të krijojë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me lexuesin, sepse karakterizohet nga ndjeshmëria e madhe. Poeti në poezinë lirike, shpreh unin e vet, shkruan nga pozicioni i vetvetes dhe përdor vetën e parë. Poezia lirike ka funksion shprehës. Autori sintetizon brenda saj ndjesitë, emocionet e veta. Temat e poezisë lirike janë gjithmonë të lidhura me botën e shpirtit, me subjektiven, siç ndodh te përshkrimi i natyrës, dashuria, humbja e njerëzve të dashur, ikja e rinisë, etj. Një ndarje që i bëhet poezisë lirike, është ajo sipas temës së saj: lirika e dashurisë, lirika atdhetare, lirika e peizazhit, lirika shoqërore, lirika fetare, lirika filozofike, etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë në dyshe.*

Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe pas leximit të poezisë.

1. Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- Cilit lloj i përket kjo poezi dhe cila është tema e saj? *Poezi lirike.*

Tema: Meditim në një natë të qetë, ose monolog në një natë të qetë.

- Poezia nis me detajin e jastëkut dhe mbaron po me të. A ka ndonjë funksion rimarrja e tij?

Rimarrja analizon ndjesitë që përcjell poezia. Vetëm natën, në qetësi njeriu ka privilegjin që të ëndërrojë, të përballet me nëndërgjegjen e tij, që gjatë ditës, mund t'i shmanget shumë kollaj. Vë kokën në jastëkun e ëndrrave dhe ëndërron, të pamundurën e bën të mundur, ëndrën e bën realitet.

- Identifikoni ndjesitë e njeriut që e ka natën sfond poetik dhe tregoni ku arrijnë kulmin e tyre këto ndjesi.

Ilustroni me shembuj nga vargjet.

Që nga jastëku i butë, i qëndisur

Dëgjomë pak, kur ëndërronj

Ëndërrim / Nanuritja si moment sublim

Ah, nga jastëku i butë i qëndisur:

Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kërkon

ankth e mosshijimit të ëndërrimit në qetësinë e natës

Nga zhurm' e dheut e mërzitur

Më shqit edhe më lumëron,

kënaqësi /Nata e largon nga mërzitja e ditës dhe e lumturon

- Përcaktoni llojin e strofës dhe të rimës së kësaj poezie.

Pavarësisht se në tekst poezia është organizuar në monokolonë, duken qartë stofat 4 vargëshe, të cilat rimojnë sipas skemës ABAB.

4. Analizoni se çfarë i sjell poezisë rimarrja e një vargu nga njëra strofë në tjetrën.

Kur los vjolinë e zhuritur:

Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kërkon?

Kur los vjolinë e zhuritur

Nga zhurm' e dheut e mërzitur

Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kërkon?

Nga zhurm' e dheut e mërzitur

Përsëritja artistike është rimarrja e togfjalëshve e fjalive të njëjta, që shërben për të forcuar shprehjen artistike, për të theksuar, për të vënë në pah, ose për të përcjellë veçantinë e një gjendjeje emocionale, a psikologjike.

Rimarrja thekson idenë e autorit dhe mesazhin që ai kërkon të përcjellë. Përsëritja e tyre i jep poezisë së Gëtes ritëm, muzikalitet, etj.

7. Çfarë simbolizon nata në këtë poezi? *Vetminë, errësirën shpirtërore të poetit. Po qielli? Hapësirë dhe ëndërrim pa kufij.*

8. Shpjegoni përdorimin e vetës së parë dhe të dytë në këtë poezi.
Veta e parë është përdorur për poetin, unin e tij, ndërsa veta e dytë, është përdorur për nënvetëdijën e tij.

9. Shpjegoni efektin e përdorimit të foljes “fle”. Në ç’mënyrë foljore është ajo?
Folja fle është përdorur në mënyrën urdhërore. Fli! Duket sikur i jep urdhër shpirtit të gjejë paqe.

10. Gjeni disa karakteristika të poezisë, që tregojnë lirizmin e saj.

a. *Shpreh unin e poetit - Përdorimi i vetës së parë.*
b. *Ka si qëllim të hyjë në thellësi të nënvetëdijës.*
c. *Brenda poezisë sintetizohen ndjesitë dhe emocionet e poetit.*

2. Shpjegoni si e jep autori bukurinë e natës dhe ndjesinë e veçantë njerëzore për të, përmes këtyre fjalëve: nata, jastëku, violina, gjumi.

3. Shpjegoni kuptimin që mbart figura “Tabor’ i yjve”. Gjeni dhe shpjegoni më pas, kuptimin e një pasthirrme, pyetjeje retorike dhe të një inversioni.
Tabor’ yjeve – hiperbolë. Në meditimin e tij, nuk merr pjesë vetëm një yll, por një tabor i tërë, të cilit poeti i tregon ëndrrat dhe të fshehtat që flenë deri në skutat më të errëta.
Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç’kërkon? - Pyetja retorike e përsëritur në formën e një refreni në poezi, përdoret për të tërhequr vëmendjen e lexuesit e për t’i dhënë vargut ngarkesë emocionale. Jepet qartë thirrja që poeti i bën nënvetëdijës (nënvetëdijës), që ta lerë të qetë në vetminë e natës e shoqërimin e yjeve.
Ab, nga jastëku i butë i qëndisur - Vargu që përmban pasthirrmën, është përdorur nga poeti për të treguar shqetësimin dhe ankthin e pagjumësisë së tij, e cila nuk po e lë të mbarojë ciklin e ëndërrimit, nuk po e lë të zhytet në jastëkun e butë të ëndrrave dhe pritjen e mëngjesit të çoroditur dhe ditës së zhurmshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i shpejtë.
Udhëzohen nxënësit të punojnë në fleta formati ose në fletoret e klasë me temën “Ktheni në prozë poetike këtë poezi”. Nxënësit kthejnë poezinë në prozë. Punojnë të qetë. Pas mbarimit të punës, ata i diskutojnë dhe i vlerësojnë punët e njëri-tjetrit dhe në fund, i arkivojnë në portofol.

Vlerësimi: Për analizën metrike, stilistike të vargjeve dhe zbulimin mesazheve që përcjellin vargjet.
Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni poezi lirike nga poezia shqipe dhe shpjegoni ngjashmëritë me poezinë “Kënga e natës”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përemri: kategoria gramatikore e rasës. (ora e parë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca:			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: përemri vetor, përemri dëftor, kategoria gramatikore e rasës, lakohet, trajtë e shkurtër, trajtë e shkurtër e bashkuar, rasa dhanore, kallëzore.	
<ul style="list-style-type: none"> - Përcakton kategoritë gramatikore të përemrit vetor dhe dëftor; - Lakon përemrin vetor dhe dëftor sipas rasave; - Përdor si duhet në fjali, trajtën e shkurtër të bashkuar të përemrit vetor. 			
Burimet: Libri i nxënësit; tabela e lakimit të përemrave vetorë dhe përemrave dëftorë: ky/kjo, këta/këto; ai/ajo, ata/ato; Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster; diskutim; punë në grup; punë individuale			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Kllaster, diskutim

U kërkohet nxënësve të plotësojnë kllasterin për veçoritë e përemrit vetor.




Me gojë, nxënësit rikujtojnë lakimin e përemrave vetorë. Tabela e lakimit të tyre paraqitet para klasës dhe u kërkohet nxënësve të vënë re trajtat e shkurtra të përemrit vetor në rasën dhanore dhe kallëzore.

Së bashku me nxënësit, ndërtohet tabela e formimit të trajtave të shkurtra të bashkuara, e cila paraqitet dhe në libër.

Theksohet: Trajta e shkurtrë e bashkuar, formohet nga bashkimi i dy trajtave të shkurtra. *E para është gjithmonë në rasën dhanore dhe e dyta gjithmonë në rasën kallëzore, veta e tretë, njëjës ose shumës.*

Rikujtohen njohuritë për përemrin dëftor. Punohet njësoj si për përemrin vetor. Ndërtohet kllasteri.



Në tekst, nxënësit lexojnë tabelën e lakimit të përemrave dëftorë: ky/kjo, këta/këto, ai/ajo, ata/ato.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup;

Punohet me shkrim ushtrimi 2 në faqen 267. Klasa ndahet në dy grupe.

Grupi 1 - lakon grupet emërore: libër i këtitllë, ai hap i atillë.

Grupi 2 - shtëpi e tillë, kjo lule e këtitllë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale

Punohet individualisht në libër ushtrimi 3. Nxënësit vendosin trajtën e shkurtrë që duhet

3.

Më erdhi t'i bërtisja, kaq shumë më mërziti.

E gjeta në mes të nxënësve të tjerë, duke folur për festivalin e djeshëm.

Me siguri do të vijnë të të kërkojnë mendim për këtë çështje.

Ty të kishte rrëmbyer gazi dhe nuk vije re ç'bëhej për qark.

Ata i gëzofshin shtëpitë e reja!

Na thanë se e kishin parë kur kishte dalë te porta.

Shallin që sheh mbi tavolinë, e mora në qendrën tregtare afër shtëpisë sime.

Djemve të pallatit, u kam thënë disa herë të mos bëjnë zhurmë te kati i parë.

Diskutohet plotësimi i ushtrimit në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimit, me notë dhe me shprehje nxitëse.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, faqja 267. Shkruani saktë fjalitë e këtij ushtrimi.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përemri: kategoria gramatikore e rasës (ora e dytë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës – Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton kategoritë gramatikore të përemrit vetvetor, pyetës dhe lidhor; - Përshtat sipas rasës së duhur përemrat në fjali; - Dallon në fjali përemrat vetvetorë, pyetës dhe lidhorë dhe përcakton rasën e tyre. 		Fjalët kyçe: përemri vetvetor, përemri pyetës, përemri lidhor, kategoria gramatikore e rasës, lakohet.	
Burimet: Libri i nxënësit; tabela e lakimit të përemrave vetvetorë, përemrave pyetës dhe përemrave lidhorë, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stubi mendimi; Kllaster; diskutim; punë në grup; punë individuale</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
Ora organizohet në mënyrë të ngjashme me orën e parë.			
Hapi I. Shkruhen në tabelë fjalitë: Ai u tregoi shokëve për atë histori, u tregoi se edhe <u>vetë</u> ishte pjesëmarrës në të. Ajo erdhi vetë. Ç'të bënte? Duhet ta shpëronte <u>veten</u> . Duhet të bindte <u>vetveten</u> .			
-Ç'klasë fjale janë fjalët e nënvizuara? Ç'tregojnë ato? Cilat janë veçoritë gramatikore të përemrit vetvetor?			
Përgjigjet e nxënësve përmbledhen në kllaster dhe plotësohen nga mësuesi.			
<p>Pjesë e ndryshueshme e ligjëratës tregon vetën që kryen dhe pëson një veprim</p> <pre> graph TD A[Përemri vetvetor] --> B[Pjesë e ndryshueshme e ligjëratës] A --> C[tregon vetën që kryen dhe pëson një veprim] A --> D[Lakohet si emrat e gjinisë] A --> E[përdoret me dhe pa parafjalë] </pre> <p>femërore, nr.njëjës Nuk ka formë të veçantë për të treguar numrin shumësisë apo gjininë</p>			
Hapi II. Lexohet së bashku me nxënësit tabela e lakimit të përemrit vetvetor.			
Hapi III. Kalohet te përemri pyetës. Lakimin e përemrave: kush, cili, cila, cilët, cilat, nxënësit i kanë të njohura, megjithatë, bëhet me gojë lakimi i tyre sipas rasave. Lexohet tabela e lakimit të përemrit: sa, i sati, e sata. Tërhiqet vëmendja për mënyrën e përdorimit të përemrave pyetës në fjali. P.sh.:			
-Çfarë perimesh bleve? (para emrit në r.rjedhore)			
-Kush të solli këtu? (nuk shoqërohet me emër)			
-Sa mungojnë? (r.emërore)			
-Sa njerëz ftove? (r.kallëzore)			
Hapi IV. Pyeten nxënësit se ç'dinë për përemrin lidhor. Theksohet se përemri lidhor <i>që</i> , është i pandryshueshëm, kurse <i>icili</i> , ka kategoritë gramatikore të numrit, gjinisë dhe rasës. Lakohet me gojë, ose lexohet në tabelë lakimi i përemrit <i>i cili</i> .			
Hapi V. Punohen në tekst ushtrimet 5 dhe 6, faqja 267 dhe diskutohen në klasë.			
Ushtrimi 5. <i>Në vend të vizave, vini përemrin (i këtitllë, vetvetja, ne, i tillë, kush, ato, ju, ajo), duke bërë përshtatjen e duhur.</i>			
Siç përdorim fjalët, <i>ne</i> përdorim edhe një gjuhë gjestesh për të komunikuar me të tjerët, shpesh edhe për të thënë tungjatjeta, ose mirupafshim.			

<p>Kam shëtitur botën dhe nuk kam parë diçka të tillë. Sot mund të vij mes <i>jush</i>, sepse herët e tjera punët e shumta s'më kanë lejuar. Pas marrjes së një letre të këtyllë, Elsa u mbyll në vetvete.</p> <p>Në këtë orë? <i>Kush</i> është vallë?! - pyeti djali më tepër sikur t'ia drejtonte vetvetes këtë pyetje. <i>Ajo</i> që e qetësoi mësuesin, që se fjala e tij, u ndoq me interes të madh nga të gjithë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e ministrisë. Ardita e vështroi në <i>ato</i> çaste në sy thjesht dhe pa habinë që pritej të shkaktohej.</p> <p>Ushtrimi 6. <i>Dalloni përemrat pyetës dhe përcaktoni rasën në të cilën janë përdorur.</i> Një zë burri u dëgjua pas trokitjes: - <u>Kush</u> troket? <u>Cilët</u> jeni? Nuk mbaja mend se për <u>të satën</u> herë e kisha takuar Mirën atë vit. <u>E sata</u> je në rresht? Edhe <u>sa</u> orë të duhen për të arritur te sporteli? <u>Cila</u> nxënëse ka dëshirë të ndjekë kursin për balet? Cilat pëlqejnë pikturën? <u>Kujt</u> do t'i drejtohesh me këtë letër? Nuk dinin se <u>kë</u> të pyesnin tjetër që t'u tregonte <u>kush</u> banonte më parë në atë shtëpi.</p> <p>Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimit, me notë dhe me shprehje nxitëse.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, faqja 267.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Lakimi i përemrave pronorë		Situata e të nxënësve: lakimi i përemrave pronorë.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: : Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësve Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -Lakon përemrat pronorë vetëm dhe të shoqëruar me emra; -Krahason lakimin e përemrave pronorë me atë të mbiemrave të nyjshëm e të panyjshëm, si dhe atë të emrave mashkullorë e femërorë.		Fjalët kyçe: Përemër pronor, lakimi, i shoqëruar, vetëm, emërohet.	
Burimet: libri i nxënësve, tabela e lakimit të përemrave pronorë, e mbiemrave, emrave, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Mbajtja e strukturuar e shënimeve në punë dyshe: organizues grafik krahaso-dallo; diskutim, lojë zinxhir.</i>			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Mbajtja e strukturuar e shënimeve në punë dyshe:</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshe sipas bankave. Për çdo bankë, nëse është e mundur, mësuesi vë në përdorim tri tabela: 1) lakimin e emrave, 2) lakimin e mbiemrave, 3) lakimin e përemrave pronorë. Qëllimi është, që nxënësit t'i krahasojnë tabelat e lakimit dhe të nxjerrin ngjashmëritë e mënyrës së lakimit të emrave, mbiemrave dhe përemrave pronorë, si dhe të mbajnë mend lakimin e tyre. Mbahen shënime në fletore, sipas organizuesit grafik të mëposhtëm. Në përfundim organizohen shënimet dhe nxirren përfundimet për lakimin e përemrit pronor. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>organizues grafik krahaso-dallo; diskutim</i>			
Hapi I. <u>Krahaso – dallo</u>			
Lakimi i emrit mashkullor/femëror	Lakimi i mbiemrit të nyjshëm/të panyjshëm	Lakimi i përemrave pronorë	

<p>Hapi II. Diskutohen me të gjithë nxënësit shënimet e mbajtura në tabelë.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: lojë zinxhir</p> <p>Në përfundim, bëhet përmbledhja duke pasur në qendër lakimin e përemrit pronor dhe në formë lojë zinxhir, nxënësit bëjnë me gojë lakimin e grupeve emërore të dhëna në ushtrimin 1.</p>
<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve si në bashkëpunimin në dyshe për të mbajtur shënime, ashtu edhe gjatë lakimit me gojë të grupeve emërore.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Mësoni tabelën e lakimit të përemrave pronorë.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Lakimi i përemrave pronorë (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Përdorimi i përemrit sipas rasave.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësve Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - Dallon përemrat pronorë në fjali duke përcaktuar vetën, rasën dhe numrin; -Përdor formën e duhur të përemrit pronor në fjali; -Ndërton fjali duke përdorur përemra pronorë në rase të ndryshme.		Fjalët kyçe: Përemër pronor, lako, analizo	
Burimet: libri i nxënësit, tabela e lakimit të përemrave pronorë, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Minikonkurs, Punë e pavarur; diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimin			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Nxënësit ndahen në grupe dhe prezantojnë detyrën e shtëpisë në formën e një konkursi. Pasi kanë thënë përmendësh lakimin e përemrit, ata formojnë fjali me përemra në të gjitha raset. Në grupe, sipas rreshtave, nxënësit lakojnë me shkrim: shënimet e mia, macja jote, vëllai juaj, vendi ynë, klasa juaj, ëndrrat e tyre. Nxiten që të punojnë saktë dhe shpejt.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur</i> Punohen ushtrimet në faqen 271 - 272. Për ushtrimin 2, fillimisht, nxënësit nënvizojnë në libër përemrat pronorë e më pas përcaktojnë kategoritë e tyre duke punuar me shkrim në fletore. Ushtrimi 3, 4 dhe 5, punohen në libër nga nxënësit.</p> <p>2. Dalloni përemrat pronorë dhe përcaktoni vetën, rasën dhe numrin, në të cilin janë përdorur.</p> <p><i>Edhe bisedat <u>tona</u> të mëvonshme u ngjanin bisedave telefonike.</i> <i>Në largimin e <u>tij</u>, shprehej mosbesim, ndaj nuk e ngacmuam më.</i> <i>Në bebëzat e zmadhuara të syve të <u>tij</u>, kishte vetëtimë habia.</i> <i>E vërteta, ky është i vetmi ilaç dhe e vetmja ndihmë që më ka mbetur t'i jap popullit <u>tim</u>. Po të isha unë në vendin <u>tënd</u>, do të luftoja të mbroja mendimet e <u>mia</u>, dashurinë <u>time</u>, - i tha ajo.</i> <i>Dielli po ngrihej mbi malet e <u>tyre</u> përtej dhe rrezet e <u>tij</u> po zbardhnin luginën.</i> <i>Kur të vijë <u>im</u> nip për t'u regjistruar në kursin <u>tuaj</u>?</i></p>			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim			
<p>4. Vendosni në formën e duhur përemrat pronorë dhe më pas argumentoni zgjedhjen tuaj.</p> <p><i>Ajo u përpoq të kapte sadopak vështrimin e saj të rrëshqitshëm.</i> <i>Por edhe ajo këtë herë nuk i hoqi sytë e zinj. Në bebëzat e tyre, që shkëlqenin nga një dritë e lehtë, u shfaq diçka e ngrohtë dhe e çiltër.</i></p>			

<p><i>Heshtja ishte e padurueshme për të dy. Këtë mund të vije re nga fytyrat e tyre, që papritur u bënë të ngurosurat.</i> <i>- Kështu të dua, - tha, duke u rënë me shuplakë supeve të saj. - Të jesh e sjellshme dhe e mirë.</i> <i>Ëndrrat e bukura kishin mbetur në skutat e errëta të vetëdijes së tij, së bashku me shpresat e vagëlluara.</i> <i>Rojtari plak rrinte te vendi i vet, sidomos në kohën kur binte muzgu.</i> - Çdo ushtrim diskutohet në klasë.</p>			
<p>Vlerësimi: Vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimit.</p>			
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 272.</p>			
<p>PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE</p>			<p>Data ____ . ____ . ____</p>
<p>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: IV</p>	<p>Klasa: IX</p>
<p>Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Kënga LXI</p>		<p>Situata e të nxënësve: <i>Ty të kjosha falë, o dritë, âma e mbrodhsimit,</i> <i>Ti dave terrin e egersis', e tine,</i> <i>E lakmuemja e gjith dhënavet latine,</i> <i>Ameriken e pshove prei robnimit.</i></p> <p><i>Porsi vegim u mbuze, e prei nalcimit</i> <i>E puthe token me atò rreze, e shkrine</i> <i>Akllin e vjeter qi kish mbet' e fshine</i> <i>Vaj e padije e anëmiq të lirimit.</i></p> <p><i>E ndjeu toka njetë shënd e u gëzue si fëmija</i> <i>Qi i qeshet lokes kúr ja reshë krahnorit;</i> <i>E shpirt e zëmër neper buz'i shpraze.</i></p> <p><i>Me nji te nnyeme mà të bukur, pa tallaze</i> <i>Shndriti deti njetë herë: prei katundorit</i> <i>Nder fush'e male mungulloi</i> <i>"Lirija" - Mjeda</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënësve - Kompetenca qytetare 			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës, sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumton rreth jetës dhe veprës së Petrarkës. - Analizon strukturën e sonetit. - Analizon figurat letrare në poezi. - Zbulon mesazhin që sjellin vargjet e poezisë. - Kthen poezinë në prozë. 		<p>Fjalët kyçe: Sonet Strofa katërshe Strofa treshe Dashuri Vuajtje Gëzim Grua Bekim</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësve http://zeri.info/kultura/180422/petrarka-dhe-shekspiri/</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Minileksion, Lexim dhe analizë teksti (punë në grupe), Shkrim i lirë.</i></p>			

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Minileksion.*

Jeta dhe vepra e autorit:

Françesko Petrarka (1304-1374) konsiderohet si një nga themeluesit e humanizmit dhe një ndër figurat e para dhe kryesore të Rilindjes Evropiane.

Ai fitoi famë të madhe si njeri i dijes e i kulturës, por edhe si poet i pakrahasueshëm. Petrarka është autor librash, traktatesh e vëllimesh mjaft të çmuara. Kryevepra e tij mbetet Libri i këngëve, që përmban 336 lirika (sonete) të shkruara në 40 vjet. Shumica e soneteve kanë tematikën e dashurisë, kurse disa prej tyre, trajtojnë fenë e moralin.

Françesko Petrarka, ishte një ndër figurat themelore të letërsisë italiane dhe evropiane. Në këtë sonet, ai i këndon dashurisë për Laurën, muzës që do të frymëzojë një pjesë të madhe të krijimeve të tij. Ai sjell ndërmend vendet, çastet dhe vuajtjet gjatë periudhës së njohjes me të. Ky sonet i përket pjesës së parë të përmbledhjes “Libri i këngëve”, që konsiderohet vepra më e njohur e poetit.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Lexim dhe analizë teksti (punë në grupe).*

Ndahet klasa në grupe

Grupi 1

Lexoni sonetin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- Kujt i kushtohet poezia dhe me ç’urim të poetit nis ajo? *Laurës*
- Çfarë lloj poezie është kjo? *Sonet.*
- Gjeni cilat tema gërshetohen në këto vargje, duke i ilustruar me shembuj konkretë.

Dashuria me shikim të parë, shigjeta e Kupidit godet në shenjë dhimbshëm.

Për herë të parë të takoj Dashurinë

e harku me shigjetat, që më grinë.

- Në cilin moment arrin kulmin përfshirja e poetit nga dashuria?

Kushtuar veç asaj, dhe ato rimat,

ku tjetër grua, pjesë, s’ka asnjë thërrime.

Grupi 2

2. Shpjegoni rolin e përdorimit të figurës së enumeracionit në këtë poezi. Gjeni dhe shpjegoni atmosferën që krijon enumeracioni ngjithës dhe ai zbritës.

3. Pse poeti e sheh dashurinë edhe si dritë, edhe si vuajtje? Shpjegoni këtë ndjesi, të dhënë përmes figurave letrare në vargun: Ku u lidha nga ata sy të bukur si drita.

4. Petrarka ka përdorur shpesh antiteza, të cilat kritika letrare i ka quajtur figura stilistike madhështore. Gjeni antitezën dhe shpjegoni efektin e përdorimit të saj në këtë sonet.

I bekuar qoftë i ëmbli mund, ku arrita

për herë të parë të takoj Dashurinë,

E harku me shigjetat, që më grinë,

e plagët së cilash në zemër u sfilita.

Efkti i përdorimit të saj, është theksimi i idesë, se dashuria shihet si lumturi dhe si vuajtje. Kush dashuron me forcë, nuk është gjithmonë i lumtur po ka dhe dhimbjen e dashurisë.

Grupi 3

Përcaktoni llojin e strofës, të vargjeve dhe rimën e kësaj poezie.

Dy strofa katërshe (dy katrena) dhe dy strofa treshe (dy tercina).. Renditja e rimës është: ABBA - ABBA për katrenat, kurse tercinat: CDC - CDC.

Analizoni sfondin kohor dhe vendor në funksion të ndjenjës së dashurisë.

Kjo poezi është konsideruar si një rrëfim me subjekt. Gjeni detajet që e tregojnë këtë.

Grupi 4 Shpjegoni rolin e foljes në mënyrën dëshirore në këtë poezi.

9. Dalloni dy shembuj ku kemi përmbysje të rendit të fjalëve në vargje dhe thoni çfarë emocioneesh përftohen përmes tyre. Bekuar qofshin viti, muaji, e dita,

Bekuar qoftë i ëmbli mund

Gjeni disa fjalë që japin gëzimin e dashurisë

Bekuar qofshi... sy të bukur si drita; i ëmbli mund

dhe disa të tjera që japin mundimin e saj.

E harku me shigjetat, që më grinë,

E plagët së cilash në zemër u sfilita

Grupi 5

Diskutoni rreth mesazhit që përcjell kjo poezi.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Shkrim i lirë*

Udhëzohen nxënësit të kthejnë në prozë poezinë e mësipërme.

Nxënësit punojnë të qetë dhe më pas **prezantojnë punët e tyre. Ata vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.**

Informacion shtesë

Soneti 75

Si ushqimi për jetën je ti për mua,

A si shirat e ëmbël për tokën e shuar;

Dhe për paqen tënde n'varfëri vuaj,

Si një dorështrënguar me pasurin' e pashijuar;

Shijues krenar jam një çast, por çastin tjetër,

Dyshues se koha, si kusar, vjen rrëmben thesarë;

Parajsë është t'jem me ty vetëm për vetëm,

Po Qiell m'i Epërm, kënaq'sinë po t'ma shohë bota mbarë;

Nganj'herë ngopem n'gostinë e pamjes tënde,

Por prapë pas pak uritem gjer në deje,

As zotëroj, as ndjek nga pas, jo, asnjë ëndje,

Veç asaj që vjen a vij ta marr prej teje.

Kështu lëngoj për ty e velem ditë për ditë,

Herë uritur pa ty, herë duke të t'ngrenë t'gjithë.

Shekspir

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për analizën metrike të poezisë, për zbulimin e mesazhit, për kthimin në prozë të poezisë, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni sonete të tjera nga autorë të ndryshëm dhe recitohini në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Gjuha shqipe		Situata e të nxënës: Nxënësit recitojnë vargje për gjuhën shqipe dhe thënie për gjuhën shqipe “Fjala e huaj në gjuhë, është si dhia ndër dhen” - Naim Frashëri E mjera Shqipe, ç'i punojne dhe s'ka gjuhë të ankohet” - Tajar Zavalani “Viktimat e gjuhës, janë më të shumta, se viktimat e shpatës” - Sami Frashëri “Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi, nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet” - Filip Shiroka Lasgush Poradeci - “Gjuha e zjarrtë” “O gjuhë - e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot O vetëtim' e qjellit që fërfëllon me flakë O djellë - i llaftuarur që ndrin si pikë lot... Si pikë lot e ndritur po ndrij në rreze tuaj”	

	Mitrush Kuteli - Gjuha shqipe “Të falem ty, o gjuhë e fisit tim, siç nuk i falem asnjë perëndi - se tempull i përjetshëm më je ti, dhe ti mburoje nëpër mot të zi: ti, dritë e kirtë nëpër errësi, ti, perëndi, që nuk ke perëndim”
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:	Fjalët kyçe:
<ul style="list-style-type: none"> - Hulumton rreth jetës dhe veprës letrare të Ismail Kadaresë. - Lexon poezinë për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth të kuptuarit të saj. - Bën analizën metrike të vargjeve. - Zbulon mesazhin që përcjellin vargjet e poezisë. 	Gjuhë shqipe Identitet kombëtar Pushtuesit turq Fjalë të huaja Përpjekje për zhdukje dhe asimilim
Burimet: Teksti i nxënësit http://wwwgazetadita.al/petro-nini-luarasi-martiri-i-shkolles-dhe-gjuhes-shqipe/	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Lapsat në mes, Rrjet diskutimi</i>	
Organizimi i orës së mësimt	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim</i>	
Diskutojmë së bashku	
Çfarë dini për jetën dhe veprën letrare të Ismail Kadaresë?	
Organizojmë mendimet në një organizues grafik.	
Lindi në Gjirokastrë më 1936	“Shekulli im” (1961), “Përse mendohen këto male” (1964)
2005 fitoi Man Booker International Prize	Ismail Kadare
2009 çmimin “Princi Asturias për Artet”	Kandidat për Çmimin Nobel në letërsi
“Motive me diell” (1968) “Koha” (1976) “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1963), “Kështjella” (1970), “Kronikë në gur” (1971)	2015 Çmimin “Jerusalem”
	2016 mori titullin “Komandant i Legjionit të Nderit” në Francë
	Veprat e Ismail Kadaresë, janë përkthyer e botuar në më shumë se 45 gjuhë.
	1996, Kadare u bë anëtar përjetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lapsat në mes

Lexohet në heshtje poezia. Ndahet klasa në grupe dhe shpërndahen fishat

Grupi 1

Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Cili është motivi kryesor i poezisë? *Dashuria për gjuhën shqipe si simbol i kombit dhe identitetit kombëtar.*

Cilën kohë të historisë ka veçuar poeti si më shumë të rrezikshme për zhdukjen e gjuhës shqipe? *Koha kur Shqipëria ishte nën thundrën e pushtimit shumë shekullor turk.*

Si ka arritur të mbijetojë gjuha shqipe ndër shekuj? *Falë përpjekjeve të bijve të shqipes Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Kristoforidhi, Veqilharxhi, De Rada, Naimi, Samiu e shumë të tjerë, i kushtuan një kujdes të veçantë pasurimit të gjuhës shqipe, duke e pasuruar gjuhën tonë me fjalët: jetëdhënës, ndërgjegje, dritare, gjithësi, hapësirë, fletore, mësim e shumë të tjera. Ndërsa poetët tane më në zë: Naim Frashëri, Dom Ndre Mjeda, At Gjergj Fishta e shumë të tjerë pas tyre, vargjet më të bukura ia kushtuan gjuhës shqipe, duke i thurur himn gjuhës sonë.*

Çfarë ka vënë poeti përballë poemave popullore në luftë për të ruajtur gjuhën?

Bejtes - *krijime dyvargëshe të letërsisë klasike orientale në shekullin e XVII- XVIII të quajtura dhe vargëzime të pavlera.*

Divani - Në poetikën orientale, vepër e një poeti e cila mbledh sipas një sistemi të caktuar poezitë klasike (kaside, gazel, etj.).

Çfarë ka prodhuar gjuha shqipe sipas poetit? *Megjithëse martire e përjetshme ajo diti të lindte art të përjetshëm.*

Grupi 2

Analizojmë poezinë

Për ç'loj zjarrellëku bëhet fjalë në tekst? *Lëngimit prej sëmundjes së zhdukjes si gjuhë.*

Nga cilat sëmundje mund të vuajë gjuha e një vendi? *Nga sëmundja e asimilimit.*

Nga asfiksioni prej fjalëve të huaja që futen në leksikon e saj.

3. Cilët janë akrepat që duan ta helmojnë gjuhën shqipe? Si mund ta arrijnë këtë gjë?

4. Shkrimtari ka përdorur në poezinë e tij, një shumësi figurash letrare, si: krahasime, epitete, metafora, etj.

Cila është figura letrare e përdorur më shpesh?

Figura letrare e përdorur më shpesh, është metafora.

Gjeni pesë raste të përdorimit të kësaj figure.

- 1) Kështjellat e sintaksës
- 2) Shekuj plot helm
- 3) Kufoma divanesh
- 4) Kufoma bejtesh
- 5) Vdisnin pjesëzat

Grupi 3

Zbërtheni kuptimin e figurshëm në togfjalëshat e mëposhtëm.

Gjuhë martire: Gjatë gjithë kohës i është dashur të përballlet me sfidën e asimilimit, të vuajë shumë për të qëndruar si simbol i bashkimit të shqiptarëve.

Lehonë e përjetshme

Grupi 4

Cili është lloji i strofës dhe i vargut të përdorur në poezi? *Strofa katërshe*

Po lloji i rimës? Si ndërtohet ajo?

Grupi 5

Shënoni me + (---)

Qëllimi i kësaj poezie është:

të tregojë dashurinë e madhe që ka poeti për gjuhën; +

të paraqesë vështirësitë me të cilat është përballur gjuha për të mbijetuar; +

6. Cili është poeti që përmendet në strofën e pestë?

Naim Frashëri

Gjuhë që flisnin Perënditë

“Atë flisnin Pellazgjitë

Atë kanë edhe Shqiptarët

Sikurse edhe të parët”

Çfarë simbolizon figura e tij?

Metafora është ajo fjalë a shprehje që emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi a dukurie tjetër, që i ngjan. Shpesh metafora shpjegohet edhe si krahasim i shkurtuar, si krahasim pa lidhëzën krahasuese. Në metaforë, mbartet kuptimi nga njëra fushë e jetës në një fushë tjetër, zëvendësohet kuptimi i një fjale me kuptimin e një fjale tjetër. Një lloj metafore që përdoret shpesh, është kur shpirtëzohen sendet a dukuritë, d.m.th., kur tiparet e karakteristikat e një frymori, kalohen te një jofrymor. P.sh.: pylli i shqetësuar, fusha frymon, etj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjet i diskutimit

Gjuha është pjesë e identitetit të njeriut.

Si e ruan ajo lidhjen me të kaluarën dhe si e krijon lidhjen me të ardhmen?

PO

JO

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për hulumtimin e jetës dhe veprës së Ismail Kadaresë, analizën e metrikës së vargjeve, zbulimit të mesazhit që përcjell poezia, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur:
Të gjitha gjuhët pasurohen me fjalë të reja që zakonisht krijohen nga fjalë ekzistuese. Megjithatë, ndodh edhe që pavarësisht se gjuha i ka fjalët e saj, në të ndërftuar edhe fjalë të huaja, të panevojshme. Përmendni disa prej tyre. Diskutoni në klasë rreth kësaj dukurie.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përemri i pacaktuar Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji		Situata e të nxënësve: Lexohen fragmente ku janë përdorur përemra të pacaktuar.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësve Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: -Dallon përemrat e pacaktuar të përdorur në një tekst; -Lakon përemra të pacaktuar të ndryshueshëm; -Dallon në cilat raste, e njëjta fjalë përdoret si: a) përemër i pacaktuar, apo ndajfolje; b) përemër i pacaktuar, pyetës apo lidhor.		Fjalët kyçe: përemër i pacaktuar, kuptimi, forma, përdorimi, të ndryshueshëm, të pandryshueshëm.	
Burimet: Libri i nxënësve, tabela e lakimit të përemrit të pacaktuar, Gramatika 1, tabakë letre.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Pyetja sjell pyetjen; Përvijim i të menduarit; Punë individuale; diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Hapi i I: <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stubi mendimi</i> Shkruhet në tabelë paraprakisht në një tabak letre tekstin:			
<p><i>Dikush po vjen. Se kush trokiti. Le të shkojë kushdo të shohë. Gjithkush vendos vetë. Ata kujdeseshin për njëri-tjetrin, megjithëse jetonin larg. E ndihmonin shoku-shokun. Askush nuk e pa. Asnjëri nuk e pa. Ke parë njëri këtu? Secili prej nesh do të flasë. Në secilin grup, ka disa nxënës të mirë e shumë të mirë. Çdo klasë është e veçantë.</i></p>			
U kërkohet nxënësve të dallojnë përemrin e pacaktuar.			
Hapi II. U drejtohen njëra pas tjetres pyetjet: Çfarë tregojnë këta përemra? Cili prej tyre ndryshon gjatë përdorimit? Cili përdoret i shoqëruar apo jo me emër? Çfarë kategorie gramatikore kanë ata përemra që ndryshojnë?			

Ndërtimi i njohurive të reja: Përvijim i të menduarit;

Nga përgjigjet dhe diskutimet e nxënësve, bëjmë paraqitjen e strukturuar të përemrit të pacaktuar:



Po kështu, lexohet dhe diskutohet tabela e lakimit të përemrave të pacaktuar.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim, punë individuale.

Punohen ushtrimet 1 - 5 në faqen 275. Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Ushtrimi 1 punohet nën drejtimin e mësuesit.

Dalloni përemrat dhe tregoni llojin e tyre. Plotësoni tabelën.

Dhe ai (v) uli atë (d) kokën e vet (pr) të madhe e të qethur, duke më (tr.shkurtër e p.v.) buzëqeshur fshehurazi. Filluam të loznim. Unë (v) i (tr.shk) nxora të gjitha (pacak.) lodrat e mia (pr). Prekosi sikur u magjeps nga treni i vogël që (lidhor) ecën vetë (vetvetor): nuk kishte parë kurrë diçka (pacak.) të tillë (d). I (tr.shk.) përpinte me sy vagonët e kuq e të verdhë. Unë (v) i (tr.shk) dhashë çelësin që të luante. Ai (v) u ul në gjunjë që të luante me veten (vv) dhe s'e (tr.shk) ngriti më kokën.

Kurrë nuk e (tr.shk) kisha parë aq të gëzuar. Tërë (pac) kohën thoshte: “Më fal, më fal, duke na bërë shenjë me dorë që të mos e ndalnim trenin. (4 tr.shk.) Ne (v) të gjithë(pacak.) rrinim në këmbë dhe vështronim. Vështronim atë (d) qafë të hollë, ata (d) veshë të mjerë, që (lidh) dikur i (tr.shk) kisha parë të pikonin gjak; atë (d) xhakëtë të gjatë me mëngë të përveshura nga dilnin dy krahë të hollë si prej të sëmuri, që (lidh) ishin ngritur aq herë për të mbrojtur fytyrën nga të rrahurat...

Pvetor Pvetvetor P.pronor P.lidhor P.dëftor P.pyetës Pi pacaktuar

Ushtrimet 2, 4 dhe 5 punohen individualisht nga nxënësit.

2. Dalloni cilët nga përemrat e mëposhtëm janë pyetës dhe cilët të pacaktuar. Kishte mjaft kushërinj në atë qytet.

Kush ka ngrënë mjaltin, ka mizën pas veshit.

A e dini se çfarë u tha ajo?

Pse, çfarë do të bësh?

Kush më shumë e kush më pak, të gjithë u kënaqën.

S'ka ç'i bën gomarit, i bie samarit.

Çfarë këngësh të pëlqejnë?

Nuk e kisha parë prej vitesh dhe ndieja njëfarë emocioni.

Nuk e di se kush e ka marrë.


Sa ditë kanë kaluar që atëherë?

Ç'ka barku, i nxjerr bardhaku.

Sa ftova, më erdhën.

Eja me kë të dëshirosh.

4. Ndërttoni gjashtë fjali me fjalën *kush* të përdorur si përemër pyetës, si përemër lidhor dhe si përemër të pacaktuar.

Kush 

- p.pyetës:* Kush mori pjesë në konkurs?
- p.lidhor:* Kush dëshiron, mund të vijë te koncerti i Edës.
- p.i pacaktuar:* E dëgjoi kush atë që ndodhi dje në aeroport?

5. Dalloni se në cilat raste fjalët shumë, ca, tepër, pak, janë përemra të pacaktuar.

Shumë njerëz po dukeshin nga lart. Shumë prej tyre, po vraponin, të tjerët, po ecnin ngadalë e disa po ecnin me hap të shpejtë.

Trimi i mirë me shokë shumë. (me shumë shokë)

Ngjyrat dukeshin shumë të ndezura.

Ju vijne shumë të ftuar? Vijnë shumë, por pak qëndrojnë.

Ka ca ngjarje të vërteta, që kur tregohen shumë herë, duken si të sajua për të bërë humor.

Mos jemi shumë larg prej këtej?

Ai shpenzoi shumë.

Mos po fantazojmë si tepër Pablo?

Njeriu i gjetë bën shumë gabime në jetë.

Ushtrimin 3 nxënësit e punojnë sipas rreshtave, për efekt kohe.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në të gjitha etapat e mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 275.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Foljet njëvetore dhe foljet pavetore (ora e parë)		Situata e të nxënimit: Përdorimi i foljes në fjali	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Kompetenca e të menduarit			
Kompetenca e të nxënimit			
Kompetenca personale			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon dhe përdor saktë në fjali foljet njëvetore dhe foljet pavetore (kompetenca e programit); - Dallon foljet vetore, njëvetore, pavetore; - Përdor saktë në fjali foljet njëvetore dhe pavetore; - Ndërton fjali duke përdorur folje njëvetore dhe pavetore.</p>	<p>Fjalët kyçe: folje, me kuptim të plotë, ndihmëse, gjysmëndihmëse, kategoritë gramatikore, vetore, njëvetore, pavetore,</p>
<p>Burimet: Libri i nxënësit, Gramatika 1, tekste të ndryshme, tabela e zgjedhimit të foljeve.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Stubi mendimi-klaster; Punë individuale; Diskutim.*


Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Stubi mendimi-klaster;*

Pyeten nxënësit çfarë dinë për foljet dhe përgjigjet e tyre pasqyrohen në klaster.

Ç’дини për foljet?

Pjesë e ndryshueshme e ligjëratës




Sugjerim: *Ndarja sipas vetës, të shtohet pas shpjegimit nga mësuesi.*

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë individuale*

U kërkohet nxënësve, të dallojnë foljet te fragmenti dhe të përcaktojnë cilat janë me kuptim të plotë, ndihmës dhe gjysmëndihmës.

Kompjuterat janë aparate të ndërlikuara, që mund të përpunojnë sasi të mëdha informacioni brenda një kohe shumë të shkurtër. Përdorimi i kompjuterave është bërë një mjet pune kaq i rëndësishëm, sa që sot, ata mësohen në shkollë. Ata mund të grumbullojnë të dhëna në sasi jashtëzakonisht të mëdha.



*Shpjegohen rastet kur foljet janë njëvetore dhe pavetore.

<i>Folje njëvetore</i>	{	<ul style="list-style-type: none"> - emërtojnë veprime karakteristike të kafshëve - mjaullin, kakarit, pëlllet, etj. - dukuri atmosferike, ose natyrore - fryn erë, bie shi, jehon zëri, gjelbëron fusha, etj. - foljet në f.joveprore: dihet, thuhet, ndalohej, etj. - me pjesëzën <u>s'</u> para e të tipit: s'më besohet, s'më kujtohet, s'është mirë, s'më vjen mirë, më vjen mbarë, më doli nga mendja, etj.
<i>Folje pavetore</i>	{	<ul style="list-style-type: none"> - dukuri atmosferike: bubullon, veson, gjëmon, bën ftohtë, bën vapë, etj. - Foljet gjysmëndihmëse: duhet, do. - Ka, në kuptimin ndodhet, ekziston. - Të tipit s'shkohet, s'rrihet, s'rrohet, etj.

Hapi III. Punohen individualisht ushtrimet 1, 2, 3 në faqen 278 - 279.

1. Gjeni cilat nga foljet që vijojnë janë pavetore dhe cilat njëvetore.

mësoj, kam, dal, vij, vetëtin, thuhet, nevojitet, hingëllin, gjelbëron, gurgullon, mbaroj, cicëron, bën ftohtë, gjëmon, bie shi, më vjen keq, lexohet, shkruaj, s'jetohet, dua, rri.

2. Dalloni foljet njëvetore, thoni se ç'tregojnë ato.

Drita u venit edhe më. Vajza ndezi llambën.

Mësuesi dukej pak i vrarë nga lodhja e rrugës, pinte ujë si pa dëshirë dhe heshtja e tij, shprehte një nga ato mërzitë kur gjëja më e udhës është që mikun ta ftosh në gjumë.

Në verë frynte vazhdimisht një erë e lehtë nanuritëse, në vjeshtë era lodhej e shushurinte si fllad duke sjellë ca klithma të largëta zogjsh.

Do ta fajësonte veten, asgjë më të mençur smund të bënte.

Kur arritëm në fshat, ishte natë. Njëpër re voziste hëna e ngrënë.

3. Në vend të vizave vendosni foljen e duhur. Gjeni foljet pavetore dhe përcaktoni se çfarë tregojnë ato.

(ka, të shëtitnin, kishte, rrihej, bën, duhet, frynte, mund, ndodh, s'jetohet)

Në pyllin pranë ka disa lloje kafshësh.

Kështu ndodh gjithnjë me shokun tim.

Nga jugu po vrenjtej dhe frynte një erë e lehtë shiu.

Në dimër s'jetohet pa zjarr.

Në rrugë kishte shumë njerëz. Të dielave pasdite e kishin zakon të shëtitnin te kodrat e liqenit për disa orë.

Për një përshkrim të suksesshëm duhet bërë një vëzhgim i vëmendshëm. Ne mund ta përshkruajmë historinë edhe me gojë edhe me shkrim.

Fëmijës nuk i rrihej në një vend dhe lëvizte në çdo cep të dhomës.
Është mëngjes herët dhe *bën* ftohtë. Nuk duhet nxituar.
Në përfundim, çdo ushtrim diskutohet.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në të gjitha etapat e mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, faqja 279.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Forma joveprore e foljeve (ora e dytë) Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji		Situata e të nxënit lidhet me punën në tekst.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: forma joveprore, pjesëza “u”, mbaresa, folja ndihmëse.	
-Përdor saktë në fjali folje të formës joveprore; -dallon foljet e formës joveprore në tekst; -përcakton kategoritë gramatikore të foljeve në formë veprorë dhe joveprore të përdorura në tekst.			
Burimet: libri i nxënësit, tabela e zgjedhimit joveprore të foljeve, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		-Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stubi mendimi; Punë individuale; Diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stubi mendimi</i>			
Nëpërmjet stuhisë së mendimit kontrollohen njohuritë e nxënësve për formën joveprore.			
- Ç'tregon veprimi i shprehur nga folja në formën joveprore? - Cilat janë mjetet me të cilat ndërtohet forma joveprore e foljes?			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë individuale;</i>			
Punohen në tekst ushtrimet 1 - 6 të faqes 286 - 287.			
3. Vini në vend të vizave foljet e formës joveprore dhe përcaktoni se në ç'kohë dhe vetë janë ato. Djali <u>mallëngjehet</u> gjithmonë kur sheh fotot e gjyshërve të tij. Ne nuk e dinim se autobusi për në Vlorë <i>niset</i> në orën 7.00 të mëngjesit. Arta me Verën po <i>afroheshin</i> drejt nesh me një tufë të madhe me lule. Ndonëse ata janë kushërinj të parë, <i>shihen</i> me njëri-tjetrin vetëm një herë në vit. Në shtëpinë tuaj, dritat <i>shihen</i> shumë vonë. Pasdite mamaja <i>merret</i> me punët e shtëpisë. Gjatë fundjavës, në Durrës <i>takohem</i> shpesh me disa shoqe të kursit të baletit. Anila <i>përpiqej</i> të mos mungonte asnjëherë në shkollë, që të mos mbetej prapa në mësim.			
3. Kthejini foljet e ushtrimit të mësipërm në kohën e pakryer të mënyrës dëftore sipas shembullit të dhënë. Djali <u>mallëngjehet</u> gjithmonë kur sheh fotot e gjyshërve të tij. Djali <u>mallëngjehej</u> kur shihe fotot e gjyshërve të tij. Ne nuk e dinim se autobusi për në Vlorë <i>nisej</i> në orën 7.00 të mëngjesit. Arta me Verën po <i>afroheshin</i> drejt nesh me një tufë të madhe me lule. Ndonëse ata janë kushërinj të parë, <i>shiheshin</i> me njëri-tjetrin vetëm një herë në vit. Në shtëpinë tuaj dritat <i>shuheshin</i> shumë vonë. Pasdite mamaja <i>merrej</i> me punët e shtëpisë. Gjatë fundjavës, në Durrës <i>takohet</i> shpesh me disa shoqe të kursit të baletit. Anila <i>përpiqej</i> të mos mungonte asnjëherë në shkollë, që të mos mbetej prapa në mësim.			

4. Qarkoni fjalitë ku fjalëza u shërben si pjesëz për të formuar kohën e kryer të thjeshtë të formës joveprore.

U dërgoi të gjithëve nga një kartolinë për festat.

Duhet t'u flasësh shoqeve e të mos bësh debate të kota me to.

U uroi mirëseardhjen të gjithëve dhe filloi t'i sqaronte për arsyet e takimit.

Pas pak, Drini u ngrit dhe u nis për në shtëpi, i kredhur në mendime për historinë që dëgjo.

Agimi u ul në kompjuter për t'i shkruar një letër motrës së tij.

Ua përsëriti disa herë mësimin, por ata përsëri nuk e kuptuan.

Mos u hani kot me njëri-tjetrin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim

5. Nënazoni foljet në mënyrën dëftore dhe tregoni se në ç'formë janë përdorur. Përcaktoni kohën dhe vetën e tyre.

Të gjitha ballinat e godinave ishin stolitur me flamuj të larmishëm e në ngjyra të ndezura.

Zilja për të hyrë në klasë po vononte, megjithëse nxënësit ishin rreshtuar të gjithë.

Po të mos i kishte prishur punë Arditi, tani do t'i ishin përmbushur të gjitha dëshirat.

Mësuesi filloi të shqetësohej, meqë nuk kishte mbërritur ende asnjëri nga nxënësit.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.



Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, faqja 287.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të dëgjuar Tema mësimore: Në mundsh		Situata e të nxënit: Dëgjoni interpretimin e Mirush Kabashit dhe Reshat Arbanës në linqet e dhëna https://www.youtube.com/watch?v=J_2GfLonZgc https://www.youtube.com/watch?v=16EnnDP1_sA	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. ➤ Kompetenca e të menduarit. ➤ Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. ➤ Kompetenca për jetën, sipërmbarrjen dhe mjedisin. ➤ Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Liston karakteristikat e dëgjuesit të mirë Dëgjon me vëmendje poezinë e Kiplingut në tre variantet e përkthyer në shqip nga F. Noli, V. Kokona dhe R. Shvarc. Analizon ndryshimet e dukshme në tre variantet e përkthimit. Zbulon idetë e rëndësishme që përcjellin vargjet e poezisë. Garon mes shokësh se kush do të recitojë më bukur.		Fjalët kyçe: Djalë Mundësi Qetësi Arsye, durim, Urrejtje, mendim, ëndërrim Nder Burrë	
Burimet: Teksti i nxënësit https://www.youtube.com/watch?v=J_2GfLonZgc https://www.youtube.com/watch?v=16EnnDP1_sA		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Arte TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Bashkëbisedim, Shkrimi i lirë, Punë në dyshe, Konkurs recitimi			

Organizimi i orës së mësimit



Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:

A mund të më thoni se cilat janë karakteristikat e një dëgjuesi të mirë? Listojini ato.

Dëgjues i mirë

1. Dëgjon me vëmendje dhe i përqendruar.
2. Dëgjon në heshtje.
3. Dëgjon duke selektuar materialin.
4. Kupton atë që dëgjon.
5. Dëgjon në mënyrë të qëllimshme.
6. Është aktiv gjatë të dëgjuarit.

A e keni dëgjuar më parë poezinë e Kiplingut “Në mundsh”? Si e kuptoni këtë poezi?

Nxënësit japin mendimet e tyre.

30 dhjetor 1865. Kanë kaluar mbi 150 vjet nga lindja e Rudyard Kipling, shkrimtari dhe poeti i famshëm britanik, prej të cilit, kujtojmë mes titujve më të famshëm që kanë bërë historinë e letërsisë, të paharrueshmin “Libri i xhunglës” dhe “Kapitenë guximtarë”.

Poezia e tij “Në mundsh”, na tregon sugjerimet që Kipling si baba i drejton të birit, në mënyrë që të bëhet “Burrë”. Në 1907, Kipling merr çmimin “Nobel”.

Në mundsh - Një himn i mrekullueshëm për jetën!**Në munç****Përkthyer nga Fan S. Noli**

Në munç të mbash në kokë terezinë
 Kur shokët çmendër dhe fajtor të nxijnë;
 Në munç të kesh besim, kur të dyshon
 Kushdo, dhe s'ka njeri që të beson;
 Në munç të preç, dhe pritjen s'e kursen,
 Në të gënjeshtin, ti nuk i gënjen,
 Në të urrefshin, ti s'i çan me brirë,
 Dhe s'hiqesh as m'i mënjim as m'i mirë.
 Në munç të çndërrosh e të mejtos,
 Dhe nga këto në mos u robërosh;
 Në munç të preç Triumfin dhe Hatanë,
 Dhe t'i shkëlmosh të dy si kallpazanë;
 Në munç të mbahesh, kur një drejt ta drejt
 Të drejtën dhe në lak syleshin heth,
 Kur sheh kalan' e jetës të rëzuar
 Dhe prap e ngre me veglën e çkallmuar;
 Në munç të vësh m'i grumbull çdo thesar,
 Edhe t'i loç të gjitha me një zar,
 T'i humpç edhe të nisësh përsëri
 Pa thën' asgjë për këtë batërdi;
 Në munç të kesh një zemër, trup e kokë
 Që të shërbejnë sa të bëhen trokë,
 Dhe të vazhdosh i djegur shkrimp në furrë,
 Dhe të thërret vullneti: "Mbahu, or burrë!"
 Në munç të zbreç në turm' e të mbash nderin,
 Të hash me mbretin, të pish me neferin;
 Në mos të ngaftë dot as mik as hasmë,
 N'i daç të gjithë, po asnjë për dasmë;
 Në munç për çdo minutë të përpjetë
 Të rënç tamam sekunda gjashtëdhjetë;
 Zaptove dhenë me çdo mall dhe hir,
 Dhe ca më mirë, qënke trim, or bir

Përkthyer nga Vedat Kokona

Në s'humbsh toruan kur të gjithë rreth teje
 Humbur e kanë dhe thonë se ti ke faj;
 Në paç besim tek vetja kur të tjerët s'kanë
 Tek ty edhe dyshimn' ti ua fal;
 Në pritsh edhe nga pritja të mos lodhesh;
 Në të gënjeshtin, ti mos i gënjesht;
 Në të urrefshin, ti mos i urresh;
 I urtë shumë, as shumë i mirë s'tregohesh;
 Në ëndërrosh, por zot s'ke ëndërrimin;
 Mendove dhe mendimet s'i ke si qëllim;
 Në e takofsh Triumfin dhe Rrënimin,
 Të dy mashtruesve u jep të njëjtin çmim;
 Duron kur e vërteta jote ndrydhet
 Nga horrat edhe lak bëhet për teveqelë;
 Në pafsh atë ç'ke stisur që të thyhet,
 Prap të ndërtosh me veglat bërë fërtele;
 Në bëfsh një parg me çka ti ke fituar,
 Dhe në rrezik t'i hedhësh çift a tek,
 Dhe të humbaç dhe prap duke filluar
 Gojën ta qepësh përpara kur s'ke shtet;
 Zemrën ti gur n'e bëfsh dhe nervat hekur,
 Të të shërbejn' dhe kur të thonë: Jo!
 Dhe të qëndrosh asgjë kur s'të ka mbetur
 Përveç vullnetit që të thot': "Qëndro!"
 Në flaç me turmën dhe të ruash nderin,
 Me mbret të rish, por cakun mos kalosh;
 Kur as armiq as miq s'ta duan sherrin,
 Të gjithë kur ti i do, por kurrë mos ta teprosh;
 Në e mbushç minutën që nuk të fal kurrë
 Me gjashtëdhjetë sekonda në vrapim;
 I tokës zot je, çdo gjë atje është jotja,
 Dhe sidomos Njeri do jesh, o biri im!

Të tria variantet e përkthimit, të Nolit, Vedat Kokonës dhe Robert Shvarcit

Varianti i cili është te libri i nxënësit, është variant i përkthyer nga Robert Shvarc.

Idetë që përcillen te lexuesi pas dëgjimit apo leximit të poezisë

Të ruash qetësinë kur të gjithë humbin arsyen! Besoji vetes, kur bota s'të përfill! Të presësh me durim pa u lodhur! Mos urre kur të urrejnë! Mendo, por jo pa limit! Ëndërro, por pa rënë rob ëndërrimesh! Të gjithë t'i trajtosh njëlloj me durim! Të rrezikosh, të humbasësh dhe të fillosh nga e para e askush të mos e dijë disfatën tënde! Tregohu i duruar dhe kur gjithçka të duket e kotë! Fol me maskarenj, por nderin ruaje! Mbushi minutat me vepra që peshojnë!

Gjatë dëgjimit të poezive mbani parasysh këto elemente:

lartësinë e zërit; forcën e zërit; intonacionin; ndalesat; ritmin e leximit; theksin logjik

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe

Mendoni rreth pyetjes: Sipas babait, cilat "prova" duhet të kalojë i biri për t'u bërë një njeri i pjekur dhe me dinjitet?

Para se i biri të bëhet "burrë" duhet të kalojë disa prova. Ato janë:

- Prova e kalitjes së durimit,
- Prova e përballjes me të ligjtë,
- Prova e vetëvlerësimit.

Sipas jush, përsëritja e vazhdueshme e frazës "Në mundsh", ndihmon në krijimin e një ritmi të shpejtë, apo të ngadaltë dhe monoton? Ndihmon në krijimin e një ritmi të shpejtë të zhdërvjelltë.

Ç'figurë letrare është ajo? Rimarrja ose përsëritja artistike.

Tregoni shkurtimisht poezinë që dëgjuat, duke shfrytëzuar shënime tuaja dhe duke ilustruar me detaje nga teksti.

Nxënës të ndryshëm, pas dëgjimit, fillojnë e tregojnë. Kjo do t'u shërbejë dhe për punën e tyre kur të kthejnë poezinë në prozë.

Qëllimi i poezisë që dëgjuat është të përshkruajë, të rrëfejë apo të këshillojë?

Ktheje në prozë poezinë. (Shkrimi i lirë)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Konkurs recitimi

Recitoni poezinë në cilin variant që ju të dëshironi.

Fiton më i miri.

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për argumentet e shtruar gjatë diskutimit, analizën e ideve që përcjellin vargjet, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ktheje në një dialog babë e bir poezinë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Rubrika: Shkruajmë	Situata e të nxënit:		
Tema mësimore: Kthejmë një poezi në prozë	"Odiseja - përshtatje për fëmijë", "Tregime të moçme shqiptare"		
Ora 1			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kompetenca e të menduarit. ➤ Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. ➤ Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Dallon personazhet e baladës "Kush e solli Doruntinën"		Poezi	
Dallon figurat letrare në baladë		Prozë	
Dallon fjalët e vjetra që sjellin atmosferën e kohës		Figura letrare	
Liston veprimet që kryejnë personazhet		Personazhe	
Kthen baladën në prozë			
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha shqipe 8"		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
"Odiseja - përshtatje për fëmijë"			
Tregime të moçme shqiptare, - Mitrush Kuteli			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimin**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:****Iliada dhe Odiseja janë kryevepra të Homerit. Këto janë përshtatur për fëmijë nga shtëpia botuese "Dituria"****Skeda e librit**


Titulli: Iliada, Lufta e Trojës
(përshtatje për fëmijë)
Origjinali: Iliad
Gjinia: Mitologji
Autori: Homerit
Shqipëroi: Kujtim Ymeri
Shtëpia botuese: Dituria
Viti: 2000
Fq. 96
Pesha: 0.201 kg.
ISBN: 978-99927-31-06-0

Titulli: Odiseja (përshtatje për fëmijë)
Origjinali: Odissea, Le avventure di
Ulisse
Gjinia: Prozë
Autori: Homerit
Shqipëroi: Mariana Ymeri
Shtëpia botuese: Dituria
Viti: 2005
Fq. 112
Pesha: 0.181 kg
ISBN: 978-99927-31-07-9

Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit në bashkëpunim - Grupet e ekspertëve**Ndaj klasën në grupe dhe u shpërndaj fisbat me çështjet që do të punojnë.****Grupi 1**

Cilët janë personazhet në fragment? Ndërtoni hartën e personazheve.

Nëna, Kostandini, Dhoqina

**Grupi 2**

Gjeni fjalët e vjetra në baladë. Çfarë atmosfere sjellin te lexuesi?

Ktheji në shqipen standarde

Okë -----

Stëhi _____

Pajë

Zhburrite _____

Gjëma-----

Kaptuar _____

Rrasa _____

Gjeraqinë _____

Kallogre _____

Ajodhimë _____

Grupi 3

Gjeni figurat letrare në baladë dhe emërtojini ato.

Grupi 4

Analizo veprimet që ndodhin në baladë. Listoji ato.

Grupi 5

Kthe në prozë fragmentin e mbetur të baladës

Nxënësit fillojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, shkëmbejnë mendime dhe gjatë gjithë kohës, puna e tyre vëzhgohet dhe udhëhiqet nga mësuesi.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Turi i galerisë

Nxënësit, tabakët e letrave që kanë punuar, i ngjisin në muret e klasës dhe bëjnë prezantimin e tyre. Të gjithë grupet shohin punët e njëri-tjetrit dhe bëjnë ndërhyrjet për përmirësim.

Vlerësimi:

Vlerësoj nxënësit për ndërtimin e hartave të personazheve, për listimin e veprimeve të tyre, për bashkëpunimin në grup, etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjej një poezi dhe ktheje në prozë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Forma veprorë e foljeve (ora e parë)		Situata e të nxënëtit me punën në tekst.	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore Morfologji			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënëtit Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja - Zgjedhon saktë foljet në formën veprorë në të gjitha mënyrat; - Dallon në tekst foljet e formës veprorë.		Fjalët kyçe: kategoria e diatezës, forma veprorë, mënyra dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore, urdhërore Veprimi i vërtetë, i mundshëm, i dëshirueshëm.	
Burimet: Libri i nxënësit, tabela e zgjedhimit vepror të foljeve të të tria zgjedhimeve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve Harta e mendjes; Të nxënëtit në bashkëpunim; Lojë gjuhësore			
Organizimi i orës së mësimi Hapi I. Nxënësit dinë se një nga kategoritë gramatikore të foljes është dhe diateza dhe se ajo lidhet me formën e foljes. Shpjegohet për ta npm kllasterit.			
<pre> graph TD A[Kategoria e diatezës] --> B[Shpreh gjendjen e kryefjalës e cila është vepruese ose pësuese] A --> C[E kanë vetëm foljet që i kanë të dyja format] C --> D[f.veprorë] C --> E[f.joveprorë] D --> F[veprimin e kryen kryefjala] E --> G[veprimin nuk e kryen, por e pëson kryefjala] A --> H[NUK e kanë foljet pavetore dhe shumë njëvetore] </pre>			

Hapi II. Drejtohen nxënësit në libër në faqen 280. Nëpërmjet bashkëpunimit të të gjithë aktorëve me njëri-tjetrin (nxënës-nxënës, mësues-nxënës) do të punohet për rikujtuar zgjedhimin e foljeve të të tria zgjedhimeve në formën veprorë.

a) -Në ç' mënyrë mund ta paraqesi folësi veprimin e shprehur nga folja?

veprimi	→ i vërtetë	—————	m.dëftore; m.habitore
i shprehur	→ i mundshëm	—————	m.lidhore; m.kushtore
nga folja	→ i dëshirueshëm	—————	m.dëshirore; m.urdhërore

b) Sa kohë ka mënyra dëftore? Cilat janë?

Plotësohet tabela me format gramatikore të foljes *punoj* në mënyrën dëftore.

*Këtu nga mësuesi sqarohet dhe përdorimi i dy formave gramatikore të kohës së *ardhme të së shkuarës*: do të puno-ja; dhe kohës së *ardhme të përparme të së shkuarës*: do të kisha punuar.

c) Po mënyra habitore sa kohë ka? Si shprehet veprimi në mënyrën habitore? Lexohet tabela në libër.

d) Si shprehet veprimi në mënyrën lidhore? Sa kohë ka? Plotësohet tabela.

e) Kur është i mundshëm veprimi në mënyrën kushtore? Cilat janë kohët e kësaj mënyre? Lexohet tabela.

f) Po mënyra dëshirore dhe urdhërore, çfarë formash gramatikore kanë?

Tërhiqet vëmendja për mbaresat e veçanta në të tria zgjedhimet. Lexohen tabelat.

Hapi III. Për t'u çlodhur dhe argëtuar nxënësit, zhvillohet një lojë gjuhësore. Nxënësit, zinxhir njëri pas tjetrit zgjedhjnë foljen *di* në formën veprorë në të gjitha mënyrat. Secili nga nxënësit thotë një vetë e kështu me radhë derisa përfundon zgjedhimi.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 1, faqja 282.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Forma veprorë e foljeve (ora e dytë)		Situata e të nxënësve lidhet me punën në tekst.	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësve Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -Përdor saktë në fjali foljet në formën veprorë; -Shndërron fjalitë në formën veprorë duke dalluar ndryshimet e ndodhura; -Dallon foljet e formës veprorë në fjali për të përcaktuar mënyrën, kohën, vetën e tyre.		Fjalët kyçe: kategoria e diatezës, forma veprorë, mënyra dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore, urdhërore, shndërro, përshtat, formo	
Burimet: libri i nxënësve, tabela e zgjedhimit vepror të foljeve, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim; Punë e pavarur;			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Diskutohet ushtrimi 1 që është punuar si detyrë shtëpie.

Hapi II. Punohen ushtrimet 2, 3, 4, 5 në mënyrë të pavarur.

Ushtrimi 2. Plotësohet në libër mënyra lidhore dhe kushtore e foljes *mësoj*.

Ushtrimi 3. *Shndërrojini në formën veprorë këto fjali dhe shkruajini. Çfarë vini re?*

Çelësat e thesarit të madh të gjuhës ruhen nga populli. – *Populli ruan çelësat e thesarit të madh të gjuhës.*

Sa biseda të zjarra janë bërë nga njerëzit për plazhet e bukura të Shqipërisë. – *Sa biseda të zjarra kanë bërë njerëzit për plazhet e bukura të Shqipërisë.*

Altini u prit nga shokët me duartrokitje e brohoritje. – *Shokët e pritën Altinin me duartrokitje e brohoritje.*

Ai, si gjahtar, s'mposhtej as nga lodhja, as nga etja, as nga uria. – *Lodhja, etja, uria s'e mposhtnin atë, si gjahtar.*

Astriti ishte rrëmbyer nga një dëshirë e madhe për dituri. – *Një dëshirë e madhe për dituri kishte rrëmbyer Astritin.*

*Tri ndryshime që ndodhin në fjali kur i shndërrojmë në veprorë:

1-kryefjala shndërrohet në kundrinor të drejtë;

2-folja nga forma joveprorë shndërrohet në formën veprorë;

3-kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shndërrohet në kryefjalë.

Për ushtrimin 4 rikujtohen fillimisht format e pashtjelluara e më pas nxënësit fomojnë fjalitë.

Pjesore mësuar

Paskajore për të mësuar

Përcjellore duke mësuar

Mohore pa mësuar

Të tipit me të mësuar / një të mësuar

Ushtrimi 5. *Shkruani fjalitë, pasi të keni menduar se në çmënyrë, kohë e formë vihen foljet në kllapa.*

Rrofshi! Ju bëftë dita një mijë!

Kalofshi ditë sa më të bukur sot! *Gaz paçi!*

Lëreni, - tha Artani. - *Lëreni Besën të këndojë. Kush ka qejf të këndojë* le ta provojë.

Ikni, - u thirri shokëve. - *Ikni*, se nuk lëviz dot. *Jam* i sëmurë.

Kjo linjë është e lirë, kështu që mund ta përdor si mjet transmetimi për internetin.

Herë tjetër shkruaj më me kujdes.

Dil tani, - tha mësuesi. - Gjatë rrugës nuk dua asnjë fjalë.

Të isha në vendin tënd, *do të kërkoja* të falur për çdo fjalë të thënë.

Tani fushat *mbushen* me kërcj të verdhë e të kalbur.

Përderisa *vendose* të ikësh, unë nuk *të pengoj*.

Edhe ai, po *të ishte* më i ri, do të kishte punuar pa pushim.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësime.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 283.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: “Kujtime dhe krijime”. Projekt (ora e dytë).		Situata e të nxënësve: Shoqëria. Themi shpesh; “Më thuaj me kë rri, të të them se kush je”. Po a është e vërtetë kjo thënie e mençur e popullit? A ndikon kaq shumë shoqëria tek individi? A jemi të njëjtë me ata që shoqërohemi?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca digjitale			

<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -përzgjedh grupin sipas aftësive të tij për të sjellë informacionet dhe materialet e duhura, -harton saktë një parathënie e një pasthënie, -përdor saktë mjetet kompjuterike për të pasuruar informacionin, -përdor strategji të ndryshme gjatë dhe pas dëgjimit për të kuptuar tekstin, -mban shënime për detajet e rëndësishme, -shkruan pa gabime drejtshkrimore në materialet e përzgjedhura. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Libër Kujtime Shoqëri Krijime Parathënie Pasthënie Grupe pune</p>
<p>Burimet: Modele me libra kujtimesh, pjesë të përgatitura nga mësuesi/ja për temën e mësimin.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK.</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Pyetje - përgjigje, tabela, analizë rasti, rrjeti i diskutimit, puno/shkëmbe, konkurs, punë me grupe.

Organizimi i orës së mësimin

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje - përgjigje, tabela.

Mësuesi/ja njih që në fillim të orës nxënësit me temën, sepse ata janë njoftuar që të vijnë të përgatitur me materialet e kërkuara nga ora e parë e projektit.

Pyeten nxënësit: Çfarë është shoqëria? Si e kuptoni këtë shprehje: “Më thuaj me kë rri, të të them se kush je”. Po familja çfarë roli luan? Shkolla e mësuesit, a ndikojnë te formimi i karakterit?

Merren përgjigjet e nxënësve dhe diskutohet rreth tyre. *(Si qenie sociale që jemi, shoqërimi dhe bashkëpunimi me të tjerët, është i domosdoshëm. Pas familjes, një ndikim të madh në formimin e karakterit luan shoqëria. Populli i ka nxjerrë shprehjet nga përvoja jetëgjatë e tij. Kjo vërteton thënien. Por kjo thënie është aktuale edhe në ditët e sotme sepse diçka të tërheq, të ngjit me dikë, të pëlqen që të jeni shokë.*

Mësuesi është forca shtytëse në shkollë, prindërit janë forca në familje, shokët dhe shoqet apo miqtë, janë forca në shoqëri. Të gjitha këto forca nëse do t'i konsideronim kështu janë vendimtare dhe komponentë kryesorë për formimin tërësor).

Nxënësit argumentojnë shkurt duke lidhur përgjigjet me situatat që mund të kenë dëgjuar, apo përjetuar.

Hidhet situata: Ju jeni në klasën e nëntë dhe shumë shpejt do të largoheni nga kjo shkollë. Çfarë keni pëlqyer gjatë këtyre viteve? Çfarë nuk ju ka pëlqyer dhe ju ka mërzhitur?

Dëgjohen disa mendime dhe ndërtohet një tabelë për të organizuar mendimet e nxënësve.

Ngjarjet, situatat, veprimet.	Shkaqet dhe arsytet	Çfarë do të ndyshonit?
Shkruhen nga nxënësit ato që u pëlqejnë.		
Shkruhen nga nxënësit çfarë nuk u pëlqen.		

Në fillim të orës mësuesi/ja ka përzgjedhur një nxënës (ose edhe vetë) që të bëjë disa foto të klasës. Fotot bëhen duke përfshirë të gjithë nxënësit nga kënde të ndryshme, bëhen foto të grupeve të ndryshme sipas shoqërisë. Mund të bëhen foto te këndi i klasës për nxënës që kanë afishuar aty punimet e tyre, foto te këndi i të dalluarve me nxënësit e dalluar, etj. Mund të thirret mësuesi/ja kujdestare për të bërë foto me klasën (nëse është e lirë).

Nxënësi që merret me fotot lidh aparatit me kompjuterin dhe shfaq fotot me projektor. Nxënësit përzgjedhin fotot që u pëlqejnë për t'i bërë pjesë të librit për projektin. (Procesi i daljes fotograf, mund të bëhet më i plotë edhe gjatë pushimit të madh për të qenë pjesë edhe mësuesit e tjerë që nxënësit dëshirojnë t'i përfshijnë në librin e kujtimeve).

Ndërtimi i njohurive të reja: Analizë rasti, rrjeti i diskutimit.

Përveç punimeve individuale që nxënësit do të punonin sipas udhëzimeve të orës së parë, pjesë përbërëse e librit të kujtimeve, është edhe parathënia dhe pasthënia.

Parathënia është një shkrim i shkurtër në fillimin e një veprë në të cilën jepen disa të dhëna për: jetën dhe veprën e autorit të veprës; kohën kur është shkruar vepra; vlerësime për autorin, cilësitë, apo veçoritë e tij;

Parathënia mund të shkruhet nga autori i veprës, nga ndonjë përkthyes i veprës së tij, nga një studiues i veprës dhe stilit të tij. Në të, shkruhen arsyt përse autori e ka shkruar këtë vepër; kush ka ndikuar në krijimin e saj; jepen të dhëna, data, fakte reale që lidhen me punën e bërë gjatë shkrimit të veprës; shkruhen emra që kanë mbështetur dhe përkrahur autorin për shkrimin e botimin e veprës.

Pasthënia është një shtojcë e shkurtër në fund të librit ku jepen disa shpjegime e vlerësime për veprën a për autorin e saj. Pasthënia mund të jetë një shënim i bërë autori, nga redaksia, nga përkthyesi (nëse është përkthim), etj.

Mësuesi/ja sjell në klasë disa shembuj të ndryshëm dhe i lexon para klasës.

Parathënia - *Vjen një ditë që gjithçka mbaron dhe ato që mbeten janë vetëm kujtimet.*

Pikërisht këtë kishim ndërmend gjatë ndërtimit të këtij libri: t'i ruanim këto kujtime të gjalla, plot ngjyra, ashtu siç i kemi jetuar. I krijuar nga nxënësit e klasës së IX^C si projekt lëndor në gjuhën shqipe me temë "Libër kujtimesh", ky shkrim përmbledh momente pothuajse të një dekade shkolle. Këtu do gjeni mbresa, emocione, data të shënuara, njerëz që duam t'i kujtojmë gjithmonë, histori interesante, etj.

Çdonjëri prej nesh ka lënë kujtimet e tij, të gëzueshme apo të trishta qofshin ato. Kjo për faktin se lumturia e hidhërimi kanë qenë pjesë të pandashme të këtij rrugëtimi. Ky libër nuk mund t'i kthejë këto vite pas, por arrin të prekë zemrat e çdo lexuesi e të krijojë nostalgji për të shkruarën.

Pasthënia - *Ngjarjet e shkruara në këtë libër i kemi përjetuar personalisht, me shpirt.*

Nisi thjesht si një projekt, por më vonë, hap pas hapi, me ndihmën e mësueses së lëndës së gjuhës, mësuese E. D. dhe mësueses praktikante Sh. S., e kuptuam që për ne ky nuk ishte thjesht një libër që duhej për të marrë një vlerësim, por ishte diçka më tepër dhe jo çdokush mund ta kuptonte.

9 vite duket si një periudhë e gjatë, por në të vërtetë janë shumë pak në krahasim me kujtimet që kemi kaluar. Kemi qeshur ose kemi qarë bashkë, e kemi mbështetur njëri-tjetrin në çdo kohë për të kaluar çdo pengesë që kemi hasur rrugës, i kemi shtrënguar njëri - tjetrit dorën fort për të përballuar çdo stuh, por në fund ja ku jemi. Jemi përballë njëri-tjetrit për të dhënë lamtumirën e fundit, pasi rrugët tona do të ndahen.

I urojmë të gjithë nxënësve suksese në drejtimet që do të zgjedhin!

Marrë nga "Libër kujtimesh", shkolla "Kushtrimi i lirisë" Durrës, klasa IX-C.

Pasi lexohen rastet e sjella nga mësuesi/ja në formën e rrjetit të diskutimit, nxënësit flasin për elementet e tekstit që u bënë përshtypje, stilin e përdorur dhe individualiteti. Nxirren të dhënat reale dhe elementet e parathënies e pasthënies.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno/shkëmbe, konkurs, punë me grupe.

Nxënësit udhëzohen që të mbidhen në disa grupe sipas tavolinave ku janë ulur dhe të krijojnë një parathënie dhe një pasthënie për librin që po shkruajnë "Kujtime dhe krijime".

Punohet në grup për të shkëmbyer idetë, duke u mbështetur te sqarimet e bëra nga mësuesi/ja, si dhe te modelet që u lexuan në klasë.

Pasi përfundon puna në grup mblidhen punimet e grupeve dhe lexohen përpara klasës. Gjatë leximit, bëhen vlerësime dhe komente nga mësuesi/ja dhe nxënësit e tjerë për mënyrën e hartimit dhe strukturën e shkrimit të përdorur. Në fund zgjidhen punimet më të mira e më të sakta që do të jenë parathënia dhe pasthënia e librit, por sigurisht që materialet do të rishikohen nga nxënësit përsëri deri në botimin e librit.

Në fund të orës, ndahen grupet sipas mënyrës që do të vazhdohet puna me projektin. Grupet e krijuara do të jenë:

- 1- Grupi i statistikave - Do të mbledhë të dhëna për klasën që nga viti i parë dhe deri tani për notën mesatare, përqindjen, numri i nxënësve, nxënës të larguar, nxënës të ardhur, çmimet që kanë fituar, pjesëmarrja në aktivitete, mësuesit kujdestarë në vite, etj.
- 2- Intervistat dhe opinionet - Do të intervistojë mësues e prindër të ndryshëm që kanë qenë pjesë aktive në jetën e tyre shkollore, opinione të mësuesve për nxënësit dhe të shokëve për njëri - tjetrin.
- 3- Foto dhe videomontazhet - Do të mbledhin foto të ndryshme gjatë viteve shkollore në aktivitete e festa të ndryshme si edhe do të krijojnë një videomontazh me kujtime e mbresa shkollore.
- 4- Grafika, faqosja - Do të merren me botimin e librit dhe rregullimin e materialeve personale të nxënësve.
- 5- Aktrim - Do të luajnë me role një ngjarje të shkurtër nga jeta e tyre shkollore.
- 6- Drejtshkrimi - Kontrollon në fund materialin për gabimet drejtshkrimore dhe bën korrigjimet e duhura.

Pas ndarjes së grupeve nxënësit me ndihmën e mësuesit/es përzgjedhin grupet ku do të bëjnë pjesë. Zgjidhen kryetarët e grupeve që do të grumbullojnë materialet personale të nxënësve, të cilat do të jenë pjesë e librit.

Secili grup mblidhet dhe harton një plan pune dhe veprimtarish që do të zhvillojë për të realizuar saktë detyrën e zgjedhur. Caktohen afatet e dorëzimit të materialeve te grupet e tjera të bëjnë faqosjen, drejtshkrimin e botimin e librit.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për aktivizimin dhe bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Nxënësit do të bëjnë vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje për mendimet dhe bashkëpunimin mes tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përgatitja e materialeve për orën e ardhshme të projektit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: I sëmuri për mend (ora e parë)		Situata e të nxënit: “Të kemi shëndetin” themi shpeshherë kur përballemi me probleme të vogla, a të mëdha në jetën e përditshme, se shëndeti fizik e mendor, janë ato çka e bëjnë të plotë trupin e njeriut e vet jetën.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: -dallon llojin e tekstit, letrar e joletrar, -dallon subjektin e pjesës që lexon, -nxjerr personazhet e pjesës dhe disa veçori të tyre, -sjell përvoja personazhesh të tjerë të ngjashëm me ato të personazheve të pjesës së dhënë, -merr informacionet e duhura gjatë leximit të tekstit, -analizon personazhet, duke u përqendruar: te fjalët përshkruese të autorit, te fjalët, veprimet, mendimet e tij.		Fjalët kyçe: Komedi Personazhe Doktor Sëmundje Humor Didaskali	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Pyetje - përgjigje, studim rasti, rrjeti i diskutimit, minileksion, punë individuale me tekstin, lexim me role.			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje - përgjigje, studim rasti. Mësuesi/ja në fillim të orës pyet nxënësit se si ndihen me shëndet dhe shtron pyetjet: Çfarë kuptojmë me shëndet të mirë? (<i>Shëndeti është më shumë se mungesa e sëmundjes</i>). - Çfarë ndikon që të kemi një shëndet të mirë? – A kujdeseni sa duhet për të qenë të shëndetshëm? – Sa rëndësi i kushtoni ushqimit tuaj dhe regjimit ditor? – A ka lidhje ushqimi me shëndetin? – Po sëmundjet, a kanë lidhje me shëndetin? (<i>Një faktor i rëndësishëm për të pasur shëndet të mirë, është të hash gjërat e duhura në masën e duhur. Njerëzit shpesh mendojnë që të ngrënit në mënyrë të shëndetshme, është pak i komplikuar dhe i vështirë për t'u ndjekur, por baza kryesore e ushqimit të shëndetshëm është përmbajtja. Ne të gjithë kemi nevojë për një masë të karbohidrateve, proteinave, yndyrave, fibrave, vitaminave dhe mineraleve për të qëndruar të shëndetshëm</i>). – A shqetësoheni dhe frikësoheni kur sëmureni? – A keni besim tek doktori juaj? – A bëni gjithmonë siç ju thotë doktori, apo bëni siç ju thonë njerëzit e tjerë? – Si do ta përshkruanit profesionin e doktorit? (<i>Nxënësi duhet të nxjerrë cilësi të mira të profesionit të mjekut si një njeri që ndihmon, shëron dhe është në shërbim të njerëzve, është një mision i lartë që duhet të nderohet</i>). - A njihni ndonjë vepër që flet për doktorët dhe profesionin e tyre? Cila është ajo? - Si paraqitet doktori? (<i>“Doktor Gjilpëra”; Protagonisti është mjek dhe njeri shpirtgjerë e me kulturë, i zgjuar dhe i vullnetshëm. Pas disa vitesh në mërgim, ai vendos të kthehet në atdhe për të dhënë kontributin e tij në shoqërinë shqiptare, por në Shqipëri përballlet me një realitet të vështirë</i>).			
Ndërtimi i njohurive të reja: Rrjeti i diskutimit, minileksion. Mësuesi/ja lidh situatën me temën e re të mësimi: “I sëmuri për mend” nga Moliere. Njihen nxënësit shkurtimisht me jetën e krijimtarinë e Moliere. Molier (1622-1673) është pseudonimi letrar i Jean-Baptiste Poquelin. Për pesëmbëdhjetë vjet me radhë, ai drejtoi një grup komedianësh shëtitës. Disa nga veprat e tij kryesore janë: “Shkolla e grave”, “Don Zhuan”, “Mizantropi”, “Kopraci”, “Tartufi”, “Borgjezi fisnik”. Diskutim rreth titullit: Përse mendoni që autori e titullon kështu veprën e tij? (<i>Jepen mendime nga nxënësit dhe sqarohet shkurt përse – personazhi do të ketë një sëmundje mendore, duhet të mësojë më shumë, duhet të ketë mangësi të zgjuarsisë, etj</i>). Në tekstin dramatik, autori rrëfen e tregon ngjarjen përmes personazheve vepruese e përmes lojës së aktorëve në skenë. Veçori kryesore e tekstit dramatik është dialogu, i cili mban peshën kryesore të situatave të zhvillimit të tyre e të zgjidhjes së konfliktit. Tri nënlojet e tekstit dramatik, janë: tragjedia, komedia, drama. Dy nënlojet e gjinisë dramatike, të njohura që nga antikiteti e deri më sot, janë: tragjedia dhe komedia. Në tragjedi trajtohet një konflikt i brendshëm a ngjarje tronditëse, kurse në komedi, trajtohen subjekte gazmore e qesharake.			

<p>Teksti dramatik është i përbërë nga: dialogu, monologu dhe didaskalitë. Dialogu: Janë fjalët që thonë personazhet (aktorët në skenë) gjatë bashkëbisedimit mes njëri-tjetrit. Monologu: Fjalët që thotë personazhi në bashkëbisedim me veten dhe i drejtohet publikut. Didaskalitë janë shpjegime të shkurtra për vendet, kohën dhe karakteret, të dobishme për të vënë në skenë pjesën teatrale, si dhe për të ndihmuar aktorët në lojën e tyre. Didaskalitë zëvendësojnë përshkrimet dhe detajet që nuk i thonë me fjalë personazhet. Ato i shërbejnë shumë <i>vënies në skenë</i>. Komedia është lloj i gjinisë dramatike, ku përqeshen, goditen dhe vihen në lojë veset e të metat njerëzore dhe shoqërore. Përmes ironisë dhe sarkazmës, goditen dukuritë e shëmtuara: mendjemadhësia, lakmia, etja për pushtet, paturpësia, marrëzia, etj. Ndryshe nga tragjedia, që përfundon me dhimbje, me vdekjen e personazhit, komedia zakonisht përfundon në mënyrë të gëzueshme. Komedia është më afër jetës së përditshme. Personazhet flasin gjuhën e zakonshme, mbartin po ato dobësi që vihen re në jetën e përditshme. Kur ndaj dobësive dhe të metave njerëzore flet me mirëkuptim dhe pa synuar që t'i dënojë, është fjala për <i>humor</i>. Kur komedia kritikon dukuri ose karaktere duke i përqeshur keq dhe duke i dënuar rreptë, kemi <i>satirë</i>. Në disa raste komikja dhe satira ngrihen në një nivel të tillë, ku karakteret e caktuara jepen me një formë shumë të shtrembëruar, të panatyrshme e të shëmtuar, duke bërë që komikja të qëndrojë mes humorit e seriozitetit. Në këtë rast kemi të bëjmë me <i>groteskun</i>. Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale me tekstin, lexim me role. Punohet me tekstin në mënyrë individuale për të identifikuar elementet e dhëna nga mësuesi/ja dhe teksti mbi ndërtimin e tekstit dramatik dhe gjuha e përdorur. Gjenden dhe lexohen didaskalitë e përdorura në tekst: (<i>Tuaneta del të vishet me një bluzë mjeku; Arganit; Me zë të ulët, Beraldit</i>). Gjenden në tekst fjalët e përdorura nga autori për humor: (<i>një mjek i mjekësisë, një të sëmurë kaq të dëgjuar; ky puls paska luajtur mendsh; nuk marrin erë fare nga mjekësia; nga mushkëritë, tamam, mushkëritë, mushkëritë, mushkëritë, mushkëritë ju thashë; injorantus, injoranta, injorantum; po këtë krah ç'e doni që ma mbani; po të isha në vendin tuaj, do ta kisha prerë menjëherë atë krah; po atë synë e djathtë, pse nuk e nxirrni; se ai nuk e lë të shohë mirë këtë tjetrin, nxirrreni sa më parë, se do të shihni shumë më kthjellët me syrin e majtë</i>). Ndahen rolet dhe bëhet leximi i pjesës me role. Lexohet 2-3 herë dhe mundohen nxënësit që të interpretojnë gjatë leximit.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Mësoni mirë pjesën për ta interpretuar sipas roleve.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: I sëmurë për mend (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Teatri Teatri është nocion që vjen nga greqishtja dhe nënkupton rrëfimin e një ngjarjeje të skenuar, që e realizojnë artistët, aktorët, komunikimi i të cilëve përcillet te publiku.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të mësuarit për të nxënë Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -merr informacionet e duhura gjatë leximit të pjesës për të nxjerrë subjektin, -dallon llojet e gjinisë dramatike, -nxjerr didaskalitë dhe dialogun, -analizon personazhet, duke u përqendruar te fjalët e veprimet, -dallon dhe shpjegon funksionin e gjuhës së përdorur, -shpreh pëlqimin e tij për personazhe të ndryshme, -jep opinionin e tij rreth çështjeve të caktuara duke ilustruar nga teksti.		Fjalët kyçe: Teatër Dramë Tragjedi Komedi Ironi Sarkazma Didaskali Personazhe	

Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga mësuesi/ja.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte.										
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve											
Lojë shpejtësi, stuhi mendimi, minileksion, punë me tekstin, punë individuale, puno/shkëmbe, diskutim i lirë, lojë me role.											
Organizimi i orës së mësimt											
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Lojë shpejtësie, stuhi mendimi.											
Në fillim të orës mësuesi/ja zhvillon një lojë shpejtësie me nxënësit. Lexohen disa pjesë nga dialogu i dhënë dhe nxënësit thonë emrin e personazhit: - Cili është ai mjek? – <i>Argani</i> . – Epo një mrekulli është kjo! – <i>Argani</i> . – Cili është mjeku juaj? – <i>Tuaneta e veshur si doktor</i> .											
Mësuesi/ja drejton disa pyetje:- Çfarë është teatri për ju? (<i>Teatri ose aktrimi, sipas definicioneve të kohëve më moderne mund të konstatohet se ai është një art kompleks, që në vete ngërthen elemente të të gjitha llojeve të tjera të artit: letërsisë, muzikës, pikturës, skulpturës dhe arkitekturës, si dhe artin e aktrimit, që është veçori specifike e teatrit</i>). - Cilat janë tri llojet e gjinisë dramatike? - (<i>tragjedia, komedia, drama</i>). – Nga se është i ndërtuar teksti dramatik? (<i>dialogu, monologu dhe didaskalitë</i>).											
Ndërtimi i njohurive të reja: Minileksion, punë me tekstin.											
Mësuesi/ja rikujton njohuritë mbi llojet e fjalive: Dëftore, dëftore-thirrmore, pyetëse, pyetëse - thirrmore, nxitëse, nxitëse - thirrmore, dëshirore.											
Fjalja dëftore - tregon diçka dhe në fund vendoset pikë. Dëftore - thirrmore tregon duke shprehur edhe qëndrimin e folësit dhe në fund të saj, vendoset pikëçuditja.											
Pyetëse - Shërben për të pyetur dhe në fund vendoset pikëpyetje. Fjalja pyetëse - thirrmore shoqërohet me ndjenjë të fortë dhe në fund merr pikëpyetje dhe pikëçuditëse.											
Fjalja nxitëse - shpreh vullnetin e folësit në formë lutje, këshille, propozimi dhe në fund vendoset pikë. Fjalja nxitëse - thirrmore nxit duke shprehur edhe ndjenjat e folësit.											
Fjalja dëshirore – shpreh dëshirën e folësit në formë urimi a mallkimi, dëshire dhe betimi.											
Në tekstet dramatike gjejmë shumë lloje të tilla fjalish.											
Punohet me tekstin dhe jepen disa shembuj me lloje të ndryshme fjalish. (-Cili është ai mjek? - pyetëse; - Pa thuaji të vijë moj, thuaji të vijë! - nxitëse - thirrmore; -Epo, një mrekulli është kjo! - dëftore - thirrmore; - Nëntëdhjetë vjeç?! - pyetëse - thirrmore).											
Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale, puno/shkëmbe, diskutim i lirë, lojë me role.											
Ushtrimi 1 punohet duke iu rikthyer leximit të tekstit dhe u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme. - <i>Tuaneta vishet si doktor dhe luan rolin me Arganin; - Po ai vëren lidhje sa shprehet që i duket si një mrekulli, por Tuaneta e kishte paralajmëruar që doktori i ngjante. Ai nuk shihte mirë ndonjëherë dhe mendja e tij ishte vetëm te sëmundjet. Mushkëritë; - Ai i thotë të hajë mirë dhe të kundërtat e ushqimeve të doktorëve të tjerë “Verën ju duhet ta pini pa ujë fare dhe që t’ju trashet pak gjaku, sepse e keni shumë të hollë, duhet të hani mish lope, mish derri të trashë, djathë Holande, bollgur, pilaf, gështenja, ëmbëlsira, që t’ju mpikset e t’ju trashet gjaku”; - Sepse doktori i ri i thotë që të presë krahun dhe të nxjerrë syrin me qëllim që të shërojë krahun dhe syrin tjetër.</i>											
Ushtrimi 2 - <i>Argani dhe Tuaneta; - Jo, Tuaneta luan dy role.</i>											
Ushtrimi 3 - <i>Në fillim e mirëpriti dhe i ishte mirënjohës për vizitën, por në fund as nuk u çua që ta përcillte.</i>											
Ushtrimi 4 - <i>Tuaneta shtiret sikur di latinisht se do të tallet me doktorët e tjerë dhe me vetë Arganin.</i>											
Ushtrimi 5 - gjendet në tekst momenti kur Argani frikësohet: <i>Si?; E pse?; Të nxjerr synë?; Nuk na nxiton gjë...</i>											
Ushtrimi 6 - zhvillohet në grupe dyshe dhe nxënësit shkëmbejnë mendimet me njëri - tjetrin për të plotësuar saktë tabelën me cilësi të dy personazheve.											
<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="180 1429 802 1485">Argani</th> <th data-bbox="802 1429 1425 1485">Tuaneta</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="180 1485 802 1541">Me mendje të turbullt</td> <td data-bbox="802 1485 1425 1541">Shërbëtores besnike</td> </tr> <tr> <td data-bbox="180 1541 802 1597">I sëmure nga mendja</td> <td data-bbox="802 1541 1425 1597">Në moshë të re</td> </tr> <tr> <td data-bbox="180 1597 802 1653">I pasur, i trembur, i habitur</td> <td data-bbox="802 1597 1425 1653">Me mendje të kthjellët</td> </tr> <tr> <td data-bbox="180 1653 802 1709">Në moshë të thyer</td> <td data-bbox="802 1653 1425 1709">E zgjuar, e shkathët, e zonja.</td> </tr> </tbody> </table>	Argani	Tuaneta	Me mendje të turbullt	Shërbëtores besnike	I sëmure nga mendja	Në moshë të re	I pasur, i trembur, i habitur	Me mendje të kthjellët	Në moshë të thyer	E zgjuar, e shkathët, e zonja.	
Argani	Tuaneta										
Me mendje të turbullt	Shërbëtores besnike										
I sëmure nga mendja	Në moshë të re										
I pasur, i trembur, i habitur	Me mendje të kthjellët										
Në moshë të thyer	E zgjuar, e shkathët, e zonja.										

Ushtrimi 7 - *Tuaneta, e quan zotërinë e saj “i sëmure kaq i dëgjuar dhe i famshëm” sepse ai ishte vizituar te shumë doktorë dhe të gjithë doktorët që kishin ardhur dhe e kishin vizituar ishin sharlatanë dhe merrnin pagesa të majme duke shfrytëzuar maninë e tij për shëndetin.*

Ushtrimi 8 - *Tuaneta e krijon një skenë të tillë për të vërtetuar se ai gëzon shëndet të mirë dhe mjekët janë thjesht sharlatanë; Argani fillon të dysbojë për vërtetësinë e fjalëve të mjekëve pas bisedës me Tuanetën e maskuar, sepse këshillat që i jep nuk i pëlqejnë dhe e frikësojnë.*

Ushtrimi 9 - *Një të sëmure kaq të dëgjuar; ky puls paska luajtur mendsh; nuk marrin erë fare nga mjekësia; nga mushkëritë, tamam, mushkëritë, mushkëritë, mushkëritë, mushkëritë ju thashë; injorantus, injoranta, injorantum; po këtë krah ç’e doni që ma mbani; po të isha në vendin tuaj, do ta kisha prerë menjëherë atë krah; po atë synë e djathtë pse nuk e nxirrni; se ai nuk e lë të shohë mirë këtë tjetrin, nxirrreni sa më parë, se do të shihni shumë më kthjellët me syrin e majtë.*

<p>Ushtrimi 10 - Batutat që shkëmbejnë personazhet janë të shkurtra dhe kjo tregon që ritmi i ngjarjeve është shumë i shpejtë.</p> <p>Ushtrimi 11-12 - zhvillohen në formë bashkëbisedimi me nxënësit, të cilët duhet të flasin për emocionet dhe ndjenjat ndaj Arganit. Nxjerrin mesazhin e pjesës dhe diskutojnë në lidhje me jetën reale e nëse njohin të tjerë që i ngjasojnë Arganit përsa i përket fiksimit të tij.</p> <p>Nxënësit janë njoftuar që pjesa do të luhet me role dhe duhet të kenë mësuar pjesën që do të interpretojnë dhe të krijojnë skenën dhe veshjet e duhura.</p>
<p>Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Forma joveprore e foljeve (ora e parë)		Situata e të nxënit lidhet me punën në tekst	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</p> <p>Kompetenca e të menduarit</p> <p>Kompetenca e të nxënit</p> <p>Kompetenca personale</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: forma joveprore, mjete gjuhësore, mbaresë, pjesëz, folje ndihmëse.	
<p>-identifikon mjetet me të cilat ndërtohet forma joveprore e foljes;</p> <p>-zgjedhon në të gjitha mënyrat foljet në formën joveprore;</p>			
Burimet: libri i nxënësit, tabela e zgjedhimit jovepror të foljeve, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		-Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Stuhi mendimi; kllaster; Punë e drejtuar në tekst; Lojë gjuhësore			
Organizimi i orës së mësimin			
Hapi I. Në fragmentin e dhënë, nxënësit dallojnë foljet në formën veprare.			
“Letra është më e durueshme se njerëzit” - M<u>u</u> kujtua ky proverb një ditë kur e ndjeva veten paksa të trishtuar dhe duke mbështetur kokën në duar, nuk dija ç’të bëja: të rrija në shtëpi, apo të dilja. Më në fund, nuk luajta vendit dhe u zhyta në mendime. Po letra është me të vërtetë e durueshme dhe unë nuk kam ndërmend që këtë fletore, me emrin e bujshëm “ditar” t’ia tregoj ndokujt, përveç ndonjë shoku ose shoqeje të denjë për këtë emër. Prandaj nuk më bëhet vonë, nëse ky ditar nuk do t’i interesojë askujt tjetër.			
- Në ç’formë janë foljet me të zeza?			
- Me ç’mjete ndërtohet forma joveprore?			
Hapi II			
<p>Mjetet</p> <ul style="list-style-type: none"> → Mbaresa ————— e tashme, e pakryer të m.dëftore dhe lidhore → pjesëza u ————— e kryer e thjeshtë e dëftores; e tashme e habitores, dëshirores, urdhërores → Folja ndihmëse jam — kohët e përbëra 			
Hapi III. Hap pas hapi plotësohen në tekst në faqen 284-285-286, tabelat e zgjedhimit të foljes laj në formën joveprore.			
Hapi IV. Nxënësit zhvillojnë lojën gjuhësore për zgjedhimin zinxhir të foljes flas në formën joveprore në të gjitha mënyrat.			
Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Zgjedhoni foljen pi në formën joveprore sipas mënyrave.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Forma joveprore e foljeve (ora e dytë) Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji		Situata e të nxëniet lidhet me punën në tekst	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxëniet Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -Përdor saktë në fjali folje të formës joveprore; -dallon foljet e formës joveprore në tekst; -përcakton kategoritë gramatikore të foljeve në formë veprare dhe joveprore të përdorura në tekst.		Fjalët kyçe: forma joveprore, pjesëza “u”, mbaresa, folja ndihmëse.	
Burimet: libri i nxënësit, tabela e zgjedhimit joveprore të foljeve, Gramatika 1.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi; Punë individuale; Diskutim			
Organizimi i orës së mësimet Hapi I. Njëpërmjet Stuhisë së mendimit, kontrollohen njohuritë e nxënësve për formën joveprore. -Ç'tregon veprimi i shprehur nga folja në formën joveprore? -Cilat janë mjetet me të cilat ndërtohet forma joveprore e foljes? Hapi II. Punohen në tekst ushtrimet 1-6, faqja 286-287. <i>Ushtrimi 2. Vini në vend të vizave foljet e formës joveprore dhe përcaktoni se në ç'kohë dhe vetë janë ato.</i> Djali <i>mallëngjehet</i> gjithmonë kur sheh fotot e gjyshërve të tij. Ne nuk e dinim se autobusi për në Vlorë <i>niset</i> në orën 7.00 të mëngjesit. Arta me Verën po <i>afroheshin</i> drejt nesh me një tufë të madhe me lule. Ndonëse ata janë kushërinj të parë, <i>shihen</i> me njëri-tjetrin vetëm një herë në vit. Në shtëpinë tuaj dritat <i>shuben</i> shumë vonë. Pasdite mamaja <i>merret</i> me punët e shtëpisë. Gjatë fundjavës, në Durrës <i>takohem</i> shpesh me disa shoqe të kursit të baletit. Anila <i>përpiqej</i> të mos mungonte asnjëherë në shkollë, që të mos mbetej prapa në mësimet. 3U. 3Uuu <i>Ushtrimi 3. Kthejini foljet e ushtrimit të mësipërm në kohën e pakryer të mënyrës dëftore sipas shembullit të dhënë.</i> Djali <i>mallëngjehet</i> gjithmonë kur sheh fotot e gjyshërve të tij. Djali <i>mallëngjehej</i> kur shihte fotot e gjyshërve të tij. Ne nuk e dinim se autobusi për në Vlorë <i>nisej</i> në orën 7.00 të mëngjesit. Arta me Verën po <i>afroheshin</i> drejt nesh me një tufë të madhe me lule. Ndonëse ata janë kushërinj të parë, <i>shiheshin</i> me njëri-tjetrin vetëm një herë në vit. Në shtëpinë tuaj dritat <i>shubeshin</i> shumë vonë. Pasdite mamaja <i>merrej</i> me punët e shtëpisë. Gjatë fundjavës, në Durrës <i>takohej</i> shpesh me disa shoqe të kursit të baletit. Anila <i>përpiqej</i> të mos mungonte asnjëherë në shkollë, që të mos mbetej prapa në mësimet. <i>Ushtrimi 4. Qarkoni fjalitë ku fjalëza u shërben si pjesëz për të formuar kohën e kryer të thjeshtë të formës joveprore.</i> U dërgoi të gjithëve nga një kartolinë për festat. Duhet t'u flasësh shoqeve e të mos bësh debate të kota me to. U uroi mirëseardhjen të gjithëve dhe filloi t'i sqaronte për arsyet e takimit. Pas pak, Drini <u>u</u> ngrit dhe <u>u</u> nis për në shtëpi, i kredhur në mendime për historinë që dëgjoji. Agimi <u>u</u> ul në kompjuter për t'i shkruar një letër motrës së tij. Ua përsëriti disa herë mësimin, por ata përsëri nuk e kuptuan. Mos <u>u</u> hani kot me njëri-tjetrin.			

Ushtrimi 5. Nënvizoni foljet në mënyrën dëftore dhe tregoni se në ç'formë janë përdorur. Përcaktoni kohën dhe vetën e tyre.

Të gjitha ballinat e godinave ishin stolisur me flamuj të larmishëm e në ngjyra të ndezura.

Zilja për të hyrë në klasë po vononte, megjithëse nxënësit ishin rreshtuar të gjithë.

Po të mos i kishte prishur punë Arditi, tani do t'i ishin përmbushur të gjitha dëshirat.

Mësuesi filloi të shqetësohej, meqë nuk kishte mbërritur ende asnjëri nga nxënësit.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, faqja 287.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data __. __. __

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Parafjalët dhe lokucionet parafjalore		Situata e të nxënësit lidhet me punën me tekstin.	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësit Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja		Fjalët kyçe: parafjalë, lokucion parafjalor, rasa, emërore, gjinore, kallëzore, rrjedhore.	
-Dallon parafjalët dhe lokucionet parafjalore në fjali; -Përdor parafjalën a lokucionin parafjalor të duhur në fjali; -Përcakton në fjali rastet kur e njëjta formë fjale përdoret si parafjalë a lokucion parafjalor.			
Burimet: libri i nxënësit, tekste të ndryshme, Gramatika 1		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Punë e drejtuar; Kllaster; Punë individuale; Punë në çift; Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>Hapi I. U kërkohet nxënësve të përcaktojnë klasën e fjalëve të nënvizuara në tekstin e mëposhtëm: Në Epokën e Gurit, fëmijët luanin <u>me</u> gurë zalli, <u>me</u> fara, <u>me</u> guaska, <u>me</u> pendë, etj. <u>Nga</u> Egjipti i Lashtë kanë mbijetuar kukulla, lodra e lojëra të tjera, por dihet gjithashtu, se <u>në</u> mesjetë, <u>në</u> panaire shiteshin lodra.</p> <p>Hapi II. Duke qenë se nxënësit kanë njohuri nga klasat e mëparshme për parafjalën, u kërkohet të nxjerrin karakteristikat e saj në kllaster.</p>			

P.S. Fjalët me të pjerrëta plotësohen në kllaster nga mësuesi.

Kujdes! Ka parafjalë dhe lokucione parafjalore që përdoren në më shumë se një rasë.

Pyes për vajzën --- R.kallëzore

dashuria ndaj atdheut---r.rrjedhore

Kap për (prej) dore --- r.rrjedhore

u kthye ndaj (në) të gdhirë---r.kallëzore

Në mes të natës ---r.gjinore

U ndodh në mes jush---r.rrjedhore

Hapi III. Nxënësit punojnë ushtrimet 1-5 në tekst në faqen 289-290.

Ushtrimi 1 dhe ushtrimi 4 punohen individualisht në tekst.

Formoni fjali duke lidhur me shigjetë grupin e fjalëve me emrin me parafjalë në të djathtë. Tregoni se ç'marrëdhënie shprehin.

Njerëzit ecnin	nga Gjermania.
Mendimet e tij ia kishte shprehur	për disa çaste.
Pasi u takuan, nisi ta pyesë	në klasë.
Këto fotografi do të më duhen për albumin e klasës	për javën tjetër.
Filmi do të fillojë	brenda shtëpisë.
Një fëmijë qante me të madhe diku	anës trotuareve.
Në lagjen time, rruga u përmyt	në fillim.
E paraqitën projektin që	nga uji.
U vendos qetësia	gjatë mbledhjes.
Na erdhën disa miq	për familjen e tij.

Ushtrimi 2, 3 dhe 5 punohen në çift sipas bankave.

Ushtrimi 2. Gjeni parafjalët dhe tregoni se cilës rasë i përket secila prej tyre.

a) Dritat mund të përdoren për të krijuar pamje shumë tërheqëse. Figuracionet me dritat lazer përdoren shpesh në koncertet e muzikës pop. Rrezet e lazerit, të cilat lëvizin duke krijuar figura në ajër, kontrollohen nga kompjuteri.

b) Kur drita bie mbi një sipërfaqe shumë të lëmuar, ajo reflektohet nga sipërfaqja. Në qoftë se bie në pasqyrë me njëfarë këndi, ajo rikthehet saktësisht në po atë kënd.

c) Ajri është përzierja e gazeve që ju thithni gjatë frymëmarrjes. Ju s'mund ta shihni, s'mund ta nuhatni dhe nuk mund ta shijoni ajrin, por ai ndodhet kudo rreth jush.

ç) Edhe planeti ynë, Toka, rrethohet nga shtresa ajri, të cilat formojnë atmosferën e saj. Oksigjeni është një gaz që gjendet në ajër dhe është i domosdoshëm për jetesën e gjallesave.

Ushtrimi 3. Dalloni parafjalët dhe lokucionet parafjalore. Tregoni se çfarë lidhin.

I shikoja me anën e kujtesës të gjitha imtësitë, e kisha bërë atë udhë me qindra, ndoshta me mijëra herë dhe e njihja çdo qoshe rruge, çdo gardh, çdo pemë, çdo buzë trotuari.

Evisi kishte mjaft ditë që mungonte në shkollë dhe në bazë të rregullores, rrezikonte të përjashtohet. Në anën e pasme të letrës, shoku i kishte shkruar disa rreshta në gjuhë të huaj, me disa fjalë të pakuptueshme për të, që i përktheu me anë të fjalorit.

Një brez stofi i përdorur, iu lidh rreth mesi për të mbajtur kapotën në vend.

Nuk dihet shkaku i vërtetë.

Më në fund ata u larguan me një makinë me ngjyrë të kuqe.

Për shkak të shiut të rrëmbyeshëm, nuk doli nga shtëpia atë ditë.

Në ballë të odës qëndronte më i vjetri i familjes.

Me përjashtim të Anisë, të gjitha vajzat e tjera qeshën me të madhe.

Ushtrimi 4. Në vend të vizave vendosni parafjalën a lokucionin parafjalor. Tregoni se cilat fjalë lidhin.

brenda	për	nga ana	për në	në mes	në drejtim	përveç	nga	

Në qytetin tonë, u hap një shkollë e lartë *për* mësues.

Të gjithë heshtën, *përveç* mikut tim.

Furgoni ndaloi si pa kuptuar *në mes* të autostradës.

Pas një ore, avioni niset *për në* Itali.

Stadiumi u boshatis *për* pesë minuta.

Në mes jush gjeta një atmosferë shumë të ngrohtë.

Ky aktivitet ishte organizuar *nga ana* e Drejtorisë Arsimore.

Për një pe, *për* një gjilpërë, vajti dëm një gunë e tërë.

Fëmijët shkëputen me zor *nga* kujtimet e së kaluarës.

Bëri dy hapa *në drejtim* të bashkisë.

Ushtrimi 5 Qarkoni fjalitë kur fjalët: lidhur, ngjitur, kundërshtim, krahasuar, përfshirë, përdoren si parafjalë a lokucione parafjalore.

E mbante qenin lidhur me zinxhirë.

Krahasuar me vitin e kaluar, sivjet ka pasur temperatura më të larta.

Dha urdhër në kundërshtim me vendimin e marrë para një muaji.

Gjaku, falur me pleqësi nuk do të harrohet aq lehtë.

Kundërshtimi i vendimit të arbitrit, çoi në daljen jashtë nga loja të kapitenit të skuadrës.

Në tryezën e rrumbullakët morën pjesë të gjitha partitë, përfshirë partinë më të re, të krijuar javën e fundit.

Ai diskutoi gjerë e gjatë lidhur me këtë çështje.

Ngjitur me shkollën ndodhej një kënd lojërash, ndërtuar vitin e fundit nga bashkia.

Krahasuar vazhdimisht me të kaluarën, ritmet e ekonomisë janë më të kënaqshme.

Letra ngjitur me zamkë, u lag nga shiu.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 290.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Tema mësimore: Një tekst për teatër (ora e parë)		Situata e të nxënës: Krahasojmë dy tekste	
Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Nxënësit do të krahasojnë një tekst rrëfimtar në prozë me një tekst dramatik.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit.			
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.			
Kompetenca e të menduarit.			
Kompetenca qytetare.			
Kompetenca personale			

<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <p>-krahason një tekst rrëfimtar në prozë me një tekst dramatik</p> <p>-zgjedh një tregim ose një fragment romani për ta kthyer në një pjesë për teatër</p> <p>-harton rregulla për kthimin e një tregimi në një tekst për teatër</p> <p>-harton skicën e një teksti për teatër, nisur nga një model i dhënë</p>	<p>Fjalët kyçe: tekst rrëfimtar në prozë, tekst dramatik, krahasim, rregulla shkrimi, teatër, dialogë, monologë, fjalët e autorit (didaskalitë).</p>
<p>Burimet: teksti, tregim i shkurtër, tekst dramatik, dy modele të shkruara, tabakë letre, fletore e punës me shkrim.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet-Teatri, Arti pamor, Muzika.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Vështtrim krahasues, Punë në dyshe (të nxënësve me këmbime) Diskutim, Interpretim, Punë individuale (Shkrim i lirë)</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimin</p> <p>Hapi I. Paraqiten në tabelë, në tabakë letre, dy tekste të shkruara qysh më parë: fragment i një tregimi dhe një tekst dramatik. Nxënësit, në dyshe listojnë veçori të këtyre dy teksteve. Mendimet e tyre paraqiten në tabelë.</p> <p>Hapi II. Nxënësit janë udhëzuar qysh më parë që të përzgjedhin një fragment tregimi a romani që të ketë veprim të ngjeshur dhe dialogë. Kanë nënvizuar dialogët dhe fjalët e autorit me ngjyra të dallueshme.</p> <p>Përcaktohen dhe diskutohen rregullat për kthimin e një tregimi në një tekst për teatrin e klasës. Listohen dhe prezantohen rregullat që duhen mbajtur mend</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përcaktoni personazhet pjesëmarrëse dhe atë çka përfaqëson secili prej tyre (karakteri, pamja fizike, dëshirat). 2. Fati i personazheve të parashikohet përmes fjalëve dhe fjalive të dialogut. 3. Nxirrni në pah konfliktin përmes dialogëve. 4. Didaskalitë (fjalët e autorit) të paraqesin veprimet e personazheve si dhe skenën, mjedisin ku zhvillohet ngjarja. <p>Hapi III. Nxënësit interpretojnë dy fragmentet e paraqitura në tekst, Fotografja e çuditshme. Fragmenti në prozë do të lexohet nga një nxënës, kurse fragmenti për teatër do të interpretohet para klasës nga dy nxënës.</p> <p>Hapi IV. Punë individuale. Nxënësit do të punojnë individualisht mbi një tregim që kanë zgjedhur për ta kthyer në një tekst për teatrin e klasës. Mund të këmbëjnë mendime me njëri-tjetrin, duke i lënë që të lëvizin lirshëm në klasë, pa shqetësuar shokët që punojnë.</p>	
<p>Vlerësimi: nisur nga pjesëmarrja gjatë orës, saktësia dhe lehtësia në krahasimin e dy teksteve, përcaktimi i rregullave të shkrimit, interpretimi i pjesëve, zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë dhe bashkëpunimi me të tjerët.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdohet puna me shkrim orën e dytë.</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

<p>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: IV</p>	<p>Klasa: XI</p>
<p>Tema mësimore: Një tekst për teatër (ora e dytë)</p> <p>Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Punë me shkrim</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</p> <p>Kompetenca e të menduarit.</p> <p>Kompetenca qytetare.</p> <p>Kompetenca personale</p>			

<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -përshtat një tregim ose fragment romani në një tekst për teatër -diskuton dhe vlerëson punimin e tij dhe të shokëve -realizon krijimin më të mirë si pjesë për teatrin e klasës</p>	<p>Fjalët kyçe: tekst rrëfimtari në prozë, tekst dramatik, krahasim, rregulla shkrimi, teatër, dialogë, monologë, fjalët e autorit (didaskalitë).</p>
<p>Burimet: teksti, tregim i shkurtër, fletore e punës me shkrim, tabelë.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet-Teatri, Arti pamor, Muzika.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë me shkrim, Turi i galerisë, Diskutim</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi Hapi I. Nxënësit do të vazhdojnë punën e nisur orën e parë për kthimin e një tregimi a fragmenti romani, në një tekst për teatrin e klasës. Hapi II. Turi i galerisë Prezantimi i punës së realizuar nga nxënësit. Punimet e nxënësve, do të vendosen te këndi i punimeve. (në këtë rast dytri banka mund të shërbejnë si një miniekspozitë). Nxënës, sipas dëshirës, mund të prezantojnë punën me shkrim. Hapi III. Diskutohen punimet e realizuara nga nxënësit, duke cilësuar edhe më të mirat. Punimi, ose punimet më të realizuara, do të përzgjidhen për t'u interpretuar në teatrin e klasës. Përgëzohen nxënësit për punën e realizuar. Punimet do të mblidhen për t'u vlerësuar me notë.</p>	
<p>Vlerësimi: nisur nga pjesëmarrja gjatë orës, zbatimi me saktësi i rregullave të kthimit të një tregimi në një tekst për teatër dhe zbatimi i rregullave të mirësjelles në klasë. Vlerësim, vetëvlerësim.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Puna për të realizuar dramatizimin e fragmentit të zgjedhur.</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

<p>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: IV</p>	<p>Klasa: IX</p>
<p>Tema mësimore: Dallimi i parafjalëve nga ndajfoljet dhe emrat me të njëjtën formë (ora e parë) Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji</p>		<p>Situata e të nxënësve lidhet me punën me tekstin.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësve Kompetenca personale</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -Dallon parafjalët nga emrat dhe ndajfoljet me formë të njëjtë; -dallon ndajfoljet duke i klasifikuar sipas llojit; -dallon parafjalët nga ndajfoljet me formë të njëjtë;</p>		<p>Fjalët kyçe: parafjalë, ndajfolje, emër, formë e njëjtë, dallimi,.</p>	
<p>Burimet: libri i nxënësve, Gramatika 1, tekste të ndryshme</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi; Kllaster; Punë e drejtuar; Rrjeti i diskutimit</p>			


Organizimi i orës së mësim

Hapi I. Mësuesi shkruan në tabelë fjalitë e mëposhtme dhe u kërkon nxënësve të dallojnë klasën e fjalëve me shkronja të zeza.

Lëre, mos fol **tani**. Më qëndro **afër**. Të ngriturit **herët** e gjallëron trupin. Kjo është punë e menduar **mirë**.

Ç'pjesë ligjërate janë fjalët me të zeza?

Ç'dini për ndajfoljet?



Hapi II. Drejtohen nxënësit në tekst në faqen 291. Lexohen ndajfoljet e dhëna në pikën e parë dhe vendosen në tabelë sipas llojit.

Po ashtu lexohen fjalët që dalin si ndajfolje dhe parafjalë duke theksuar që e rëndësishme është të dallohen lidhjet e tyre në fjali.

Hapi III. Nëpërmjet Rrjetit të diskutimit, diskutohet pyetja binar e mëposhtme:

po _____ A është i saktë pohimi se fjalët: para, prapa, poshtë, sipër, afër, etj., janë parafjalë kur ndiqen _____ jo

nga një emër, përemër a numëror themelor. Në qoftë se jo, atëherë janë ndajfolje? Pse?

Jep një shembull.

Shembull: Gruaja i qëndroi *afër* vajzës gjatë gjithë kohës. **Afër** qëndron pranë foljes, pas saj dhe para një emri, është parafjalë/ndajfolje???

(në këtë rast është ndajfolje e ndjekur nga një emër në rasën dhanore + trajtë të shkurtër).

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 1, faqja 292.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Dallimi i parafjalëve nga ndajfoljet dhe emrat me të njëjtën formë (ora e dytë)		Situata e të nxënësve lidhet me punën me tekstin.	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësve Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -Dallon në fjali parafjalët nga ndajfoljet me të njëjtën formë; -Dallon në fjali parafjalët nga emrat me të njëjtën formë; -Formon fjali me të njëjtën formë fjalësh, si parafjalë dhe si ndajfolje.		Fjalët kyçe: parafjalë, ndajfolje, emër, formë e njëjtë, dallimi.	

<p>Burimet: libri i nxënësit, Gramatika 1, tekste të ndryshme</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>
<p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë individuale; Punë në dyshe; Diskutim</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Hapi I. U kërkohet nxënësve të nënvizojnë parafjalët e ushtrimit 2, të cilat ngjajnë nga forma me emrat. <i>Ushtrimi 2. (Punë individuale) Gjeneri parafjalët, përcaktoni si janë formuar dhe me çpjesë të ligjëratës përkojnë nga forma. Për shkakun e sëmundjes së saj, prindërit vendosën të qëndronin në fshat. Me përjashtim të fjetjes, krejt jeta shtëpiake kishte vërshuar drejt kësaj kthine të vetme, dhomës së bukës. Çmimi vendoset në përgjithësi në bazë të kostos. Për të ardhmen, drejtorja do t'i përcaktojë detyrat në varësi të zhvillimit të ngjarjeve. Këtë herë, Meti mendonte se respekti për të do të shtohet, pasi po shkonte te miqtë në këmbë të të atit. Në dallim nga të tjerët, ai nuk pinte asnjë lloj çaji. Aktiviteti i nesërm do të kryhej në bazë shkolle, prandaj edhe kërkohet vëmendje dhe përqendrim i madh. Lola shihte se në krahasim me vitin e kaluar, kërkesat për pjesëmarrje këtë vit ishin më të shumta.</i></p> <p>Hapi II. Lexohen shembujt e dhënë në fillim të faqes 292 për parafjalët që kanë formë të njëjtë me emrat.</p> <p>Hapi III. Punohen ushtrimet 3, 4, 5.</p> <p><i>Ushtrimi 3. (punë individuale) Nënvizoni me një vijë parafjalët dhe me dy vija ndajfoljet me të njëjtën formë. Keta për një çast bie në mendime. Shikon e përhumbur larg, larg, pastaj brenda vetes. Dukej sikur ëndërronte syhapur. Jo shumë larg shtëpisë, Ademi kishte hapur një pus të thellë, nga ku nxirrte ujë për familjen e kafshët. Duhet të jenë në atë majën aty përballë dhe me siguri po na shohin me dylbi. Kur morën të përjetën e malit të Dëllinjës, zunë të dëgjojnë fare pranë zëra njerëzish. Ngjarjet që ndodhën pas, fort pak ia prekën ndërgjegjen. Që prapa banakut tundte dorën me mosbesim. Gjatë mbrëmjeve fliste gjatë, pa pushim për ngjarjet e ndodhura në fëmijërinë e tij.</i></p> <p>Ushtrimi 4. (punë në dyshe) <i>Formoni fjali, në të cilat fjalët: këtej, tutje përbri, veç, drejt të shërbejnë:</i></p> <p style="padding-left: 40px;">si parafjalë si ndajfolje</p> <p><i>Ushtrimi 5. (punë individuale) Vini në vend të vizave fjalët e mëposhtme. Çpjesë ligjërata janë dhe ç'veçori kanë. Gjestet janë shprehjet e fytyrës dhe lëvizjet e duarve ose të trupit që ju mund t'i bëni për të theksuar më shumë disa ide gjatë të folurit.</i></p> <p>Mbani kokën lart që të tjerët t'ju dëgjojnë. Flitni ngadalë, sa të jeni të kuptueshëm. Njoftimet mund të jenë me përmajtje zbavitëse. Edhe gjatë paraqitjes së tyre duhet të përfshihen detajet e nevojshme. Me anën e njoftimit duhet t'i mësojmë diçka lexuesit dhe jo të bashkëbisedojmë me të. Ashtu si njoftimi, reportazhi mbështetet në fakte të vrojtuar, por ndryshe nga njoftimi që është i përmbledhur, reportazhi i paraqet faktet nga këndvështrimi i reporterit, i cili shpreh ndjenjat e mendimet e tij. Çdo ushtrim diskutohet në klasë.</p>	
<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 293.</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Dallime i lidhëzave nga përemrat.		Situata e të nxënit lidhet me punën në tekst.	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -Dallon lidhëzat nga përemrat me formë të njëjtë; -Përcakton llojin e lidhëzave të përdorura në fjali; -Dallon përemrin lidhor dhe përemrin pyetës të përdorur në fjali.		Fjalët kyçe: lidhëz, bashkërenditëse, nënrenditëse, përemër lidhor, përemër pyetës, formë e njëjtë.	
Burimet: libri i nxënësit, tekste të ndryshme, Gramatika 1, tabela e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve INSERT; Punë në dyshë; Diskutim			
Organizimi i orës së mësimt			
Hapi I. Nxënësit punojnë me tabelën INSERT mësimin në faqen 294-295. Diskutohet me nxënësit çdo kolonë e tabelës e sidomos pyetjet dhe paqartësitë.			
Di	Di ndryshe	mësoj	Pyetje
√	-	+	?
<p>Hapi II. Punohen në dyshe ushtrimet 1 - 4 në faqen 296.</p> <p><i>Ushtrimi 1. Nënvizoni me një vijë lidhëzat bashkërenditëse dhe me dy vija lidhëzat nënrenditëse.</i></p> <p><i>Përcaktoni llojin e tyre.</i></p> <p>Zëri i tij iu duk si i njohur, <u>por</u> i largët dhe i harruar.</p> <p>Ata heshtën një copë herë, <u>ose</u> më mirë të them, heshtën nga errësira që i kllaposi.</p> <p>Donte ta harronte, <u>ndonëse</u> nuk e kuptonte mirë përse.</p> <p>Mund të vish kurdo <u>që</u> të duash.</p> <p>Ka rënë shi natën, <u>prandaj</u> dhe rrugët janë të zëna.</p> <p>Ishte mesi i prillit, <u>por</u> shenjat e pranverës nuk dukeshin gjëkund.</p> <p>Babai i kujtonte <u>sa herë që</u> duhej të bënin ndonjë hap të vështirë në jetë.</p> <p>Mëso <u>që</u> të hapësh sytë e të bëhesh i kujdesshëm!</p> <p>E kishte tërhequr telefonin fare në cep, <u>që</u> ta kishte sa më pranë veshit.</p> <p>Ana më vuri re <u>dhe</u> doli, <u>në mënyrë që</u> të kisha kohë të qetësohesha.</p> <p><i>Ushtrimi 2. Vini në vend të vizave fjalën e duhur (që, si, sa, se), duke përcaktuar se ç'pjesë ligjërata i përket secila prej tyre.</i></p> <p>Nuk e kuptoja <u>se</u> (L) ku do të dilte ai me këtë zgjidhje të ushtrimit.</p> <p>Vajza s'kishte me kë të fliste për detyrën <u>që</u> (P.I) duhet të bënte.</p> <p>Mbillet fara <u>që</u> (L) të jetë ara.</p> <p><i>Sa</i> (p.p) herë në ditë shtrohet tryeza?</p> <p>Ata <u>që</u> (P.I) kuptonin punët më thellë, heshtnin.</p> <p>S'ka gjë më të mërzitshme, <u>se</u> (L) të presësh i vetëm me orë të tëra.</p> <p>Hëna është e madhe <u>sa</u> (L) një diell korriku.</p>			

Me *se* (P.p) e shkëmben këtë libër?

Meqë dyshoi *se* (L) mos e tepronte, djali e ndërpreu befaz fjalimin.

Nuk i kujtohej *sa* (P.p) vjet kishin kaluar.

Po nxitonte *që* (L) të mos humbiste orarin e autobusit.

Ushtrimi 3. Nënvizioni lidhëzat nënrenditëse dhe tregoni llojin e tyre.

a) Bastiani kishte mbështetur kokën në pëllëmbë të dorës dhe vështronte me sy të ngulur në një pikë. “Çudi! - ia bëri me zë të lartë. - Më duket vërtet shumë çudi që (f) s’paska asnjë krijesë në Fantastikë që të jetë në gjendje t’i japë Perandoreshës-Fëmijë një emër të ri!”

b) Epo tani doli se (f) qenkam gabuar... Kisha pandehur vërtet se (f) plaku do të fillonte tani që (f) ta rrëfente historinë pa mbarim nga e para.

c) Megjithëse (L) ishte e bindur prej kohësh se (f) s’ishte ashtu, prapëseprapë u mbërthye sërishmi pas mendimit se kjo përputhje e plotë me historinë e atij vetë, mund të ishte vetëm një rastësi e çmendur...

Ushtrimi 4. Bashkoni pjesët e fjalive të përbëra, duke treguar llojin e lidhëzës nënrenditëse.

Mendohet	që të mbyllesh në shtëpi me këtë kohë kaq të bukur.
Gjithçka ndodhi aq shpejt,	sa është i nxehtë.
Fëmija ëndërronte	sa nuk u besonte as syve të vet.
Si vrau bajlozin e zi,	që të bëhej arkitekt në të ardhmen.
Është marrëzi	që ekipi të grumbullojë më shumë pikë në kampionat.
Hekuri rrihet	trimi u kthye fitimtar në shtëpi.
Ushtrimet diskutohen në klasë.	

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 296.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Tema mësimore: Trashëgimia		Situata e të nxënimit: Teksti dramatik	
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare - Teksti dramatik			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca qytetare. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja -liston tipare të tekstit dramatik -dallon personazhet pjesëmarrëse në fragment -shpjegon kuptimin e fjalëve dialektore dhe pasuron fjalorin		Fjalët kyçe: dramë, akte, skenë (dukë), dialog, fjalët e autorit (didaskalitë).	

<p>-diskuton rreth karakteristikave dhe ekzistencës së arit -analizon me detaje nga teksti, efektin që shkakton ekzistenca e arit në marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes -interpretin me intonacionin e duhur rolin e një personazhi, duke respektuar trajtën e gegërishtes</p>	
<p>Burimet: teksti, materiale shtesë, fletore, shkumësia me ngjyra</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet-Teatër, Art pamor</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Lexim në role, Diskutim, Punë në grupe</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Hapi I. Rikujtohen njohuritë që kanë marrë nxënësit në lidhje me tekstin dramatik. Paraqiten në tabelë me shkumësia me ngjyra pyetjet?</p> <p>-Ç'dini për gjininë e dramës? Në sa lloje ndahet ajo? (tragjedi, komedi, dramë) -Si zhvillohet tensioni, konflikti, në një dramë? -Ç'përfaqëson heroi i një drame? -Cilat janë veçoritë e një teksti dramatik? -Si janë shkruar dramat në lashtësi edhe sot? -Cilët dramaturgë shqiptarë dhe të huaj njihni? Ç'drama keni parë? Përgjigjet e nxënësve paraqiten të përmbledhura në tabelë.</p> <p>Hapi II. Paraqitet titulli i mësimi dhe të dhëna për autorin Martin Camaj. Bëhet një përmbledhje e subjektit të dramës. Sqarohen nxënësit që shenjat në këtë dramë emërtohen “duka”, sipas Fishtës “pamje” Leximi në role i dramës Puna me fjalët dhe shprehjet dialektore, që plotësojnë sfondin shoqëror, krahinor dhe historik të dramës dhe sjellin pasurinë leksikore të gegërishtes.</p> <p>Hapi III. Diskutim Do të punohen dhe do të diskutohen nga nxënësit pyetjet e rubrikave “Kuptojmë tekstin”, “Analizojmë tekstin”.</p> <p><u>Ushtrimi 1.</u> Renditen emrat e personazheve dhe lidhjet që ekzistojnë mes tyre. -Biseda që bëhet më shpesh në këtë familje është ari i fshehur nga kryetari i familjes, Shtjefni dhe pjesa që i takon secilit nga ky ar. -Njeriu që di se ku është fshehur ari është katundari, një farkëtar i panjohur, o që i është besuar thesari i familjes, pasi ai ka farkëtuar karrocën.</p> <p><u>Ushtrimi 2.</u> 2. Ari është pasuria e trashëguar nga të parët, mbijetesa mbas çdo lufte apo kolere. Ai është mjeti për të mbetur gjallë. Ai nuk kalbet, ka jetëgjatësi, është paja e vajzave, buka e përditshme, por është edhe rrezik për ata që e lakmojnë së tepërmi. 3. I takon Lekës që të dijë se ku është fshehur ari, pasi ai është djali i parë i familjes, trashëgimtari “i pari lemë”. Ai ka zotësinë e drejtimit dhe shpëtimit të familjes. 4. Ekzistenca e arit për pjesëtarët e familjes është edhe siguri edhe rrezik. Lakmia për të patur pasurinë e familjes vë në pikëpyetje dashurinë dhe mirëkuptimin mes tyre, por në kohën që zhvillohet ngjarja ai është edhe lakmi prej pushtetit komunist, i cili grabitjen me dhunë të pasurisë së vënë në breza, e shndërroi në diçka të ligjshme. Pranohen përgjigjet dhe argumentet që sjellin nxënësit.</p>	
<p>Vlerësimi: për pjesëmarrjen gjatë orës, përcaktimi i veçorive të tekstit dramatik, interpretimi i fragmentit me intonacion nga ana e nxënësve, argumentet për rolin e arit në marrëdhëniet mes njerëzve, fjalori i përdorur dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Interpretimi në role i dramës (Punë në grupe)</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Tema mësimore: Trashëgimia (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Lojë në role	
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare - Teksti dramatik			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca qytetare. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -interpretin në role fragmentin, duke përcjellë emocione -analizon fjalët e personazheve, duke sjellë detaje konkrete nga fragmenti -dallon krahasimet dhe shpjegon rolin e tyre -kthen fjalët dialektore në gjuhën standarde -reflektin ndaj tekstit dhe universalitetit të temës -kthen një pjesë të fragmentit në prozë, duke përdorur vetën III.		Fjalët kyçe: dramë, akte, skenë (dukë), dialog, fjalët e autorit (didaskalitë), interpretim.	
Burimet: teksti, materiale shpesh, fletore, shprehjet me ngjyra, dekor, veshje të përshtatshme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet-Teatër, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë në role, Punë në grupe, Shkrim i lirë, Pyetja binare (Rrjeti i diskutimit), Diskutim			
Organizimi i orës së mësimt			
Hapi I. Nxënësit janë ndarë në grupe pune qysh orën e parë. Kanë ndarë rolet si dhe kanë siguruar edhe veshjet, dekorin për të prezantuar pjesën. Pas prezantimit të fragmentit nga dy grupe, nxënësit japin mendimet e tyre për mënyrën se si interpretuan shokët. Cili nga aktorët interpretoi më bukur? A ishte një përvojë e bukur kjo shfaqje për ju?			
Hapi II. Do të diskutohen nga nxënësit pyetjet e rubrikave: “Interpretojmë tekstin”, “Gjuha e tekstit” 5. Shtëpia është më e rëndësishme se ari, se ekzistenca e sa lidhet me vuajtjet e të parëve për këto troje. Kjo është një vlerë që nuk humbet kurrë dhe duhet çmuar në çdo kohë. 6. Me ardhjen në pushtet të komunistëve, ari u bë i lakmueshëm, jo vetëm nga pasardhësit e një familjeje që trashëgonte një pasuri, por edhe nga strukturat e shtetit që shpalli shpronësimitin e çdo pasurie të vënë me gjak e djersë, si diçka të ligjshme në emër të së ashtuquajturës “barazi mes njerëzve” dhe luftës së pamëshirshme ndaj të pasurve dhe kundërshtarëve të regjimit. 7. Komentohen fjalët e Lekës për rolin e dyfishtë që luan ari në jetën e njerëzve. 8. Shënohen arsyet që shkaktojnë tensionin dramatik. 9. “Ata njerëzit e paemën që mjaullojnë si maca edhe natën mbi ledhe e mure, se s’kanë pikën e njerëzisë” “Si çakej thue, po mirë ky metal s’kalbet se do t’i kishin ra shpejt në erë”.			
Egërsia dhe pangopësia e komunistëve që erdhën në pushtet ishte e padëgjuar dhe e parë ndonjëherë. Përgjimi dhe përndjekja që iu bë një shtrese të popullsisë ishte e pamoralshme, jashtë çdo arsyeje e vlere njerëzore. Krahasimi i tyre me mace që qepen ngultas pas diçkaje dhe me çakej që shquhen për mizorinë ndaj presë, janë krahasime më se të goditura që tregojnë se fati i njerëzve të shënjestruar prej tyre, do të ishte ogurzi.			
Hapi III. Shkrim i lirë. Nxënësit do të gjejnë në tekst disa shprehje dialektore dhe do t’i kthejnë ato në gjuhën letrare. Dëgjohen dhe vlerësohen përgjigjet e nxënësve.			

Hapi IV. Rrjeti i diskutimit (Ushtrimi 11)		
A mendoni se brezat kanë përgjegjësi për		
Po	pasardhësit?	Jo
Hapi IV.		
Ushtrimi 12. Nxënësit do të sjellin argumente në lidhje aktualitetin e temës që trajton drama.		
Vlerësimi: për pjesëmarrjen gjatë orës, interpretimin në role të fragmentit, analiza e fjalëve që thonë personazhet, interpretimi i figurave letrare, reflektimi ndaj temës dhe kthimi i saktë i fjalëve dialektore në normën letrare.		
Detyrat dhe puna e pavarur: Ktheni pjesën e dytë të fragmentit në prozë, duke rrëfyer në vetën e tretë.		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Nata e dymbëdhjetë Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		Situata e të nxënit: Të dëgjuarit me vëmendje.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -dëgjon me vëmendje fragmentin e një komedie -mban shënime gjatë dëgjimit dhe u përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen -jep mendimet e tij në lidhje me komedinë dhe fundin e tyre -diskuton në lidhje me veprimet e personazheve		Fjalët kyçe: dëgjim, komedi, keqkuptim, të qeshura, fund gazmor, personazhe, vese, virtyte.	
Burimet: teksti, komedi të Shekspirit, fletore, mjete shkrimi DVD me fragment nga komedia “Nata e dymbëdhjetë”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet, TIK-u.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Dëgjim i kujdesshëm, Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi			
Hapi I. Njihen nxënësit me temën e re, kompetencën dhe përmbajtjen shkurt të komedisë së Shekspirit “Nata e dymbëdhjetë” Rikujtohen njohuritë që kanë nxënësit në lidhje me komedinë. Listohen në tabelë pyetjet: -Ç trajton komedia? -Cilët janë zakonisht personazhet e një komedie? -A ju pëlqejnë komeditë dhe pse? -Cilat komedi ju kanë ngelur më shumë në kujtesë?			
Hapi II. Dëgjimi i komedisë mund të realizohet ose duke prezantuar sekuenca nga komedia “Nata e dymbëdhjetë”, ose duke e lexuar vetë fragmentin. Udhëzohen nxënësit që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime në lidhje me: Për cilin problem flitet? Me çfarë rrobash është veshur Viola? Çfarë i tregon ajo Sebastianit për ta bindur se është vërtet Viola? Me kë do të martohet Olivia? Po Viola? (Këto përgjigje, nxënësit do t'i japin pas dëgjimit të fragmentit)			

<p>Hapi III. Nxënësit do të diskutojnë në lidhje me pyetjet: - Si përfundon kjo komedi? A ju duket zbatimës ky përfundim? Komedia përfundon në mënyrë gazmore. Ky përfundim, jo vetëm që shkakton të qeshura, por na tregon, që jeta duhet marrë me optimizëm në çdo rrethanë. -Çfarë ju bën për të qeshur? Kush e shkakton këtë situatë? Kjo situatë ka si shkak keqkuptimin dhe lojën që bën Viola, e cila është strumbullari i të gjitha ngatërresave dhe situatave komike që krijohen. -A ka mashtruar Viola? A duhet t'ia kthejnë shpinën për këtë veprim? Më së shumti, veprimi i Violës duhet të merret si një lojë zbatimëse, e shtyrë nga rrethanat dhe nga dashuria e saj për dukën. Nxënësit prezantojnë mendimet e tyre në lidhje me materialin e dëgjuar.</p>
<p>Vlerësimi: për dëgjimin e vëmendshëm, mbajtjen e shënimeve, përgjigjen e saktë dhe të plotë të pyetjeve, në lidhje me materialin e dëgjuar dhe komedinë në tërësi.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Të dhëna plotësuese për komedinë e Shekspirit.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: Dallimi i lidhëzave nga ndajfoljet dhe parafjalët me formë të njëjtë. Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji</p>		<p>Situata e të nxënësit lidhet me punën në tekst.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënësit Kompetenca personale</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -dallon lidhëzat nga përemrat, ndajfoljet dhe parafjalët me formë të njëjtë; -gjen tingullimitimet (onomatopetë) në fjalitë e dhëna; -formon fjali duke përdorur të njëjtën formë fjale si lidhëz dhe ndajfolje.</p>		<p>Fjalët kyçe: lidhëza, ndajfolje, parafjalë, formë të njëjtë, tingullimitime, pasthirrma.</p>	
<p>Burimet: libri i nxënësit, Gramatika 1.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Të lexuarit ndërveprues; Punë në dyshe; Punë individuale; Diskutim</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p>			
<p>Hapi I. Hapet teksti në faqen 297. Nëpërmjet Të lexuarit ndërveprues, punohet tema. Gjatë këtij procesi, kuptimi ndërtohet duke përfshirë: njohuritë fillestare dhe përvojat e nxënësve në lidhje me lidhëzat, ndajfoljet, parafjalët; bindjet e formuara më parë dhe perceptimet. Fillimisht lexohet teksti i dhënë dhe nxënësit përcaktojnë klasën e fjalëve me të zeza (ndajfolje, lidhëz, parafjalë). Lexohen dhe diskutohen shembujt kur e njëjta formë fjale del lidhëz, ndajfolje dhe parafjalë. Për çdo rast, nxënësit ngacmohen me pyetje për të shfrytëzuar njohuritë e mëparshme dhe diskutohet. Meqë nuk jepet në libër shembulli ku e njëjta formë del si lidhëz dhe përemër: Shpejtuam që të arrinim të parët në pikëtakim. (lidhëz) Pemët që ishin mbjellë para një viti, tashmë kishin bërë kurora të bukura. (përemër lidhor) Hapi II. E njëjta metodë zbatohet dhe për tingullimitimet dhe pasthirrmat. Nxënësit kanë njohuri për to, ndaj diskutohen rastet kur e njëjta formë del pasthirmë dhe tingullimitim. <i>Uuu</i> kush na erdhi! (pasthirmë, shpreh ndjenjë) <i>Uuu...</i> bënte era jashtë. (tingullimitim)</p>			

Hapi III. Punohen ushtrimet 1-5.

Ushtrimi 1. (Punë në dyshe) Dalloni se ç'pjesë ligjërata janë fjalët: nga, veç, tek, në fjalitë e mëposhtme.

Një pjesë e nxënësve u kthyen nga (nd) kishin ardhur.

Atje e kishte gjetur një ditë tek (L) rrinte mendueshëm.

Rruga nga (nd) kalonte ajo, u bë shumë e dashur.

Nga (nd) po vjen me kaq nxitim?

Gjeti ngrohtësinë tek (paraf.) ajo vajzë e panjohur.

Ai zbriti në breg tek (L) kishte qëndruar anija.

Gjithë bota vjen e vinë, veç (pjesëz) ai nuk vjen.

Po vinte nga (paraf.) shkolla bashkë me dy shoqet e saj të klasës.

Ishte njësoj si ai, veç (L) pak më i gjatë.

I shkoi mendja tek (paraf.) Andrea dhe familja e tij.

Tek (L) hetonte me bisht të syrit fytyrën e bukur të gruas, iu duk se ra dera.

Ushtrimi 2 (punë në dyshe). Emërtoni fjalët me të zeza.

Vinte gjithë ditën **rreth** (parafjalë) teatrit dhe kujtonte kohën kur ngjitej në skenat e tij.

Formuan të gjithë një **rreth** (emër) dhe në mes të tij ndezën zjarrin.

Rreth (pjesëz) dy vjet më parë kishte humbur medaljonin e nënës.

Lira erdhi **vetëm** (ndajfolje) në klasë, shumë e mërzitur, si rrallëherë.

Vetëm (pjesëz) në ka ndonjë hall që nuk vjen se ai është i pari për ekskursione.

Dhe përse u shqetësuan, **pa** (pjesëz), për diçka pa vlerë.

Pa (pjesëz) e parë mallin, mos e merr!

Në (parafjalë) majën e malit kishte borë.

Në (lidhëz) duhet të shkruash, mjafton të më thuash.

Ushtrimi 3. (punë në dyshe) Formoni 6 fjali, ku fjalët: ku, kur, si, të shërbejnë si:

a) lidhëza

b) ndajfolje lidhore

Ushtrimi 4. (Punë individuale) Në vend të vizave, vini njërën nga fjalët në, ku, kur, nga, drejt duke treguar dallimet mes tyre.

Adili u hodh që nga (parafjalë) pragu i derës.

Erdhi koha kur (ndajfolje lidhore) duhet ndarë mendja për vazhdimin apo jo të kësaj pune.

Kur (lidhëz) hyri në dhomë, ndjeu aromën e luleve të freskëta.

Kur (lidhëz) po kaloja nëpër pyll, më doli përpara një grup fshatarësh që po drejtoheshin drejt shtëpive të tyre.

Defekti është shkaktuar në (parafjalë) orët e vona të së mërkurës në (parafjalë) nënstacionin e Shkozetit.

Iu afrua karriges ku (ndajfolje) që mbështetur ajo.

Në (lidhëz) shkofsh te Margarita, bëji të fala.

Ushtrimi 5. (punë individuale) Gjeni tingullimitimet në fjalitë e mëposhtme.

- Ha-ha-ha, - qeshi Arta, këtë herë më fort.

- Hë, më të lumtë goja! Shsht! Ta dëgjojmë.

Befas një gugatje prishi heshtjen e natës. - Krah-krah-ah-kthi-kthiii... - u ndjenë mes heshtjes përsëri gugatjet e zogut të natës.

Pyetjes nëse do të shkonte atje, iu përgjigj: - Joooo.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë i nxënësve, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, faqja 299.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: “Kujtime dhe krijime”. Projekt (ora e tretë).		Situata e të nxënit: O e ardhme! Pres që ky ndikim të vijë sa më shpejt tek unë. Eja! Pa frikë! Etja ime për ndryshim po të pret! Pres që ta mposht rërën thithëse, e cila po më gllabëron dalëngadalë. Pres që thirrjet e mia të mos jenë thirrje dëshpërimi, por thirrje guximi, rebelimi... për një botë më të mirë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -dallon se llojet e teksteve joletrare dhe qëllimi i tyre, -nxjerr vlerat dhe rëndësinë e të mbajturit një libër kujtimesh, -sjell informacion, nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, duke përdorur strategji të ndryshme, -përdor saktë mjetet kompjuterike për të prezantuar informacionin, -prezanton në mënyrën e duhur një material të dhënë, -përmbledh informacionin që prezantohet në klasë, -përdor në tekste të ndryshme joletrare elementet e duhura, -luan me role pjesë të ndryshme nga ngjarje dhe përjetime, -shkruan pa gabime drejtshkrimore në materialet e përzgjedhura.		Fjalët kyçe: Kujtime Krijime Libër Emocione Shoqëri Shkolla Fotografi Ndjenja	
Burimet: Modele me libra kujtimesh nga interneti, pjesë të përgatitura nga mësuesi/ja për temën e mësimi, libri i krijuar nga nxënësit për projektin.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Teknologji dhe TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Imaginatë e drejtuar, pyetje - përgjigje, punë me modele, analizë rasti, prezantim me videomesazh, lojë me role, reklamim.			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Imaginatë e drejtuar, pyetje - përgjigje. Në fillim të orës mësuesi/ja, për të lidhur situatën, lexon disa vargje nga një poezi e krijuar nga një nxënëse për të ardhmen dhe u kërkon që të diskutojnë mbi lidhjen e kësaj poezie me temën e projektit. <i>(Poezia është për të ardhmen, shpreh ndjenjat e një adoleshenteje që po pret të hidhet në krahët e jetës pa frikë. Ajo po lë klasën e nëntë e po shkon në gjimnaz. Sjell këtë poezi si kujtim, si mesazh për bashkëmoshatarët e saj).</i> Nxënësit janë njoftuar për orën e tretë të projektit dhe kanë marrë masat paraprakisht për prezantimin e tij. Mësuesi/ja ka bërë njoftimin edhe pranë drejtorisë së shkollës me qëllim që të ketë pjesëmarrës nga drejtorja, nga mësuesit e tjerë, nxënës të shkollës apo senatit, prindër të klasës dhe mësuesi/ja kujdestare. (Prezantimi mund të bëhet nga nxënësit të aftë për të prezantuar në bazë të një skenari të parapërgatitur më parë nën drejtimin e mësuesit/es, por mund të drejtohet edhe nga vetë mësuesi/ja e lëndës që ka ndjekur hapat e projektit). Njihen pjesëmarrësit me temën e projektit: “Kujtime dhe krijime”; libër kujtimesh. Shtrohet pyetja për nxënësit: - Cili është qëllimi i këtij projekti? - Cilat janë pritshmëritë e tij? Nxënësit japin mendimet e tyre rreth qëllimit të zhvillimit të projektit pasi janë njohur që në orët e para të tij. <i>(Të dallojnë tekstet joletrare, të bashkëpunojnë në grup duke shkëmbyer ide, të krijojnë një tekst joletrar sipas udhëzimeve të dhëna, të dimë si punohet për të hartuar një libër, të mësojmë se si shkruhet një parathënie e një pasthënie, të shprehim ndjenjat për shkollën, shoqërinë, mësuesit, të tregojmë e japim informacione të sakta për veten dhe klasën; Pritshmëritë: Krijimi i librit të kujtimeve sipas udhëzimeve të dhëna, bashkëpunimi i suksesshëm mes nxënësve, përdorimi i saktë i mjeteve kompjuterike për një videomontazh për të shoqëruar librin me momente nga jeta shkollore, etj).</i> Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të tregojnë hapat që kanë ndjekur për zhvillimin e projektit, problematikat që kanë ndeshur, vështirësitë që u kanë dalë gjatë rrugës, gjërat që u kanë bërë përshtypje, por edhe ndonjë situatë gazmore që mund t’u ketë ndodhur gjatë përgatitjes së projektit.			

Drejtohen përgjigjet e nxënësve nga mësuesi/ja dhe ndalohet te disa vështirësi: mbedhja e statistikave ndër vite për klasën, vështirësi nga disa nxënës në përdorimin e saktë të mjeteve kompjuterike, gjetja e kohës jashtë procesit mësimor për të punuar në grupe.

Nga gjërat që u kanë bërë përshtypje: Tema interesante dhe të gjithë nxënësit përfshihen, argëtimi gjatë punës, rikujtimi i shumë ngjarjeve, bashkëpunimi i prindërve dhe nxënësve, etj.

Një libër kujtimesh i bën të pavdekshme ngjarjet, situatat e personat që përfshihen në të.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë me modele, analizë rasti.

Përmenden disa tekste kujtimesh nga personazhe të njohura:

- “Një jetë në shërbim të kombit shqiptar” nga Skënder Zogu, i nipi i Zogut, (dëshmi, foto, kujtime, detaje të panjohura).
- “Kujtime dhe përjetime” nga Shaban Kajtazi, (studime, kujtime, përjetime të periudhave të ndryshme).
- “Becoming” nga Michelle Obama, (detaje nga jeta e ish-zonjës së parë që nga fëmijëria e deri te Shtëpia e Bardhë).
- “Intervistë” nga Petro Marko.

Lexohet një fragment nga Petro Marko nga mësuesi/ja apo nga ndonjë nxënës.

Ç’janë kujtimet? Jeta e jetuar me emocione dhe me të gjithë armët që e mbajnë të gjallë, me të gjitha normat e kanunet që ka krijuar kuvendi i shekujve. Dikur kam shkruar tetë vargje për kujtimet: O kujtime! O jeta ime! Dilni andej nga jeni hedhur të grumbulluara me vullnetin tuaj pa asnjë shtytje e kanosje, dilni ashtu siç u regjistruat në shiritin e pafund të magnetotrrurit tim. Tani ju dua!

Përse kërkoja të dilnin kujtimet e mia, të dilnin ashtu siç u grumbulluan nga emocionet, vizionet, imazhet, skenat, dramat, tragjeditë, tragjikomeditë e jetës sime?

Sepse atëherë kur shkruajta këto vargje isha i internuar në ishullin e shkretët të Ustikës, atje, larg Sicilisë, larg Palermos. Dhe njeriu i veçuar nga vdekja, ose më mirë i vdekur, se i vdekur është ai që jeton me kujtimet, kurdis magnetotrrurin e tij dhe kalon kohën i qetë, duke numëruar hapat e këmbëve dhe të mendimit, të zemrës e të përvojës së tij.

Mësuesi/ja sqaron: Të shkruash një libër kujtimesh, është një punë që kërkon kohë dhe kërkime, fakte reale, dëshmi të ndryshme, intervista nga njerëz të ndryshëm. Nxënësit kanë punuar shumë për të krijuar dhe sjellë një libër të tillë para shokëve dhe të ftuarve.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Prezantim me videomesazh, lojë me role, reklamim.

Nxënësit fillojnë prezantimin e punës së tyre sipas një skenari dhe radhe të paracaktuar nga mësuesi/ja dhe ata vetë.

Prezantohet në fillim videomontazhi me foto nga jeta shkollore, me foto gjatë punës për projektin. Në videomesazh, mund të jenë të përfshirë edhe mësues të shkollës, mësuesit/et kujdestare me mesazhe për nxënësit si edhe nxënësit për shokët e shoqet e tyre. Këto mesazhe janë të përfshira edhe tek libri i kujtimeve në një rubrikë të caktuar. Gjithashtu, aty do të jenë të përfshira edhe fotot e përzgjedhura nga nxënësit.

Secili nxënës shfaqet me një thënie të zgjedhur dhe të thënë nga ai vetë në video. Këto thënie duhet të kenë lidhje me temën e projektit dhe kujtimet e nxënësve.

Në formë videoje do të vijnë edhe disa intervista të shkurtra me prindër, me mësues të ndryshëm të cilët japin mendime për nxënësit e klasës, për karakteret e tyre dhe pritshmëritë që kanë ata në të ardhmen prej këtyre nxënësve.

Intervista në libër do të vijë si tekst i shkruar dhe e shoqëruar me fotografi.

Më pas luhet me role një pjesë e improvizuar nga nxënësit mbi një ngjarje që ka ndodhur në klasë me nxënësit dhe mësuesit.

Nxënësit që kanë krijuar vargje për shkollën, shoqërinë, ndarjen nga shoqëria e shkolla apo mësuesit lexojnë krijimet e tyre sipas një radhe të caktuar.

Në fund prezantohen librat e botuar dhe bëhet reklamimi i tyre (numri i tyre varet nga buxheti) tek të ftuarit dhe merret një vlerësim prej tyre për punën e bërë nga nxënësit gjatë projektit.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me notë për punën e bërë gjatë tri orëve të projektit, për përgatitjen e materialit, për bashkëpunimin dhe prezantimin e bërë. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë dhe vlerësim të njëri-tjetrit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përshkrimi i një shfaqjeje teatrore Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënimit: Të ndjekim një shfaqje teatrore	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca qytetare. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -ndjek me vëmendje një shfaqje teatrore në skenë ose në DVD -realizon përshkrim e shfaqjes teatrore duke paraqitur në hyrjen e përshkrimit: titullin, autorin, regjisorin dhe aktorët e roleve të ndryshme. -përshkruan zhvillimin e ngjarjes, konfliktin, lojën e aktorëve, muzikën dekorin, skenografinë -jep vlerësimet dhe gjykimet e tij duke përcjellë një mesazh		Fjalët kyçe: shfaqje teatrore, autor, regjisor, aktorë, lojë, konflikt, dekor, muzikë, skenografi, vlerësim.	
Burimet: teksti, shfaqje teatrore, DVD, kompjuter, videoprojektor, fletoret e punëve me shkrim.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet-Teatër, Muzikë, Art pamor, TIK-u	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Ndjekja e organizuar e një shfaqjeje teatrore, Bisedë, Organizuesi grafik, Shkrim i lirë, Turi i galerisë			
Organizimi i orës së mësimi Situata e të nxënimit Hapi I. Për të realizuar këtë orë mësimi është e nevojshme, që nxënësit në mënyrë të organizuar, disa klasa së bashku, mund të shohin një shfaqje teatrore. Në pamundësi, kjo shfaqje mund të shihet në DVD. Gjithsesi kjo veprimtari, mund të realizohet jashtë orës mësimore. Udhëzohen nxënësit që gjatë ndjekjes së shfaqjes teatrore të sigurojnë të dhëna dhe të mbajnë shënime në lidhje me: titullin, autorin, regjisorin, reagimet e spektatorëve, ngjarjen dhe konfliktin. Këto shënime do t'u shërbejnë për të realizuar përshkrimin e shfaqjes. Ndërtimi i njohurive të reja Hapi II. Zhvillohet një bisedë me nxënësit në lidhje me shfaqjen dhe emocionet që ajo përcolli tek ata. Përshkrimi i shfaqjes do të realizohet sipas skemës së Organizuesit grafik			
<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto;">Përshkrimi i një shfaqjeje teatrore</div>			
Hyrja: titulli, autori, regjisorin, aktorët Zhvillimi: skenat, vendosja e ngjarjeve, konflikti, roli i aktorëve, muzika, dekorin, ndriçimi Mbyllja: vlerësim për shfaqjen, loja mesazh, ftesë, citim			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Hapi III. Nxënësit realizojnë përshkrimin e shfaqjes në fletore. Gjatë punës do t'u përmbahen elementeve të strukturës së shkrimit. Hapi IV. Prezantohen punimet përmes Turit të galerisë, ose duke i lexuar disa prej tyre, sipas dëshirës së nxënësve. Nxënësit vetëvlerësojnë punën e tyre dhe punën e realizuar nga shokët. Fletoret do të mblidhen për t'u vlerësuar.			
Vlerësimi: për vëmendjen e treguar gjatë shfaqjes, dhënia e mendimeve në lidhje me të, realizimi i saktë i përshkrimit të shfaqjes dhe vlerësimi që i bën punës së shokut/shoqes.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një minialbum me fotografi shfaqjesh dhe aktorësh të njohur shqiptarë.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përshkrimi i një shfaqjeje teatrore Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënësve: Të ndjekim një shfaqje teatrore	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca qytetare. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -ndjek me vëmendje një shfaqje teatrore në skenë ose në DVD -realizon përshkrim e shfaqjes teatrore duke paraqitur në hyrjen e përshkrimit: titullin, autorin, regjisorin dhe aktorët e roleve të ndryshme -përshkruan zhvillimin e ngjarjes, konfliktin, lojën e aktorëve, muzikën dekorin, skenografinë -jep vlerësimet dhe gjykimet e tij duke përcjellë një mesazh		Fjalët kyçe: shfaqje teatrore, autor, regjisor, aktorë, lojë, konflikt, dekor, muzikë, skenografi, vlerësim.	
Burimet: teksti, shfaqje teatrore, DVD, kompjuter, videoprojektor, fletoret e punëve me shkrim.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet-Teatër, Muzikë, Art pamor, TIK-u	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Ndjekja e organizuar e një shfaqjeje teatrore, Bisedë, Organizuesi grafik, Shkrim i lirë, Turi i galerisë.			
Organizimi i orës së mësimit Situata e të nxënësve Hapi I. Për të realizuar këtë orë mësimi, është e nevojshme ,që nxënësit në mënyrë të organizuar, disa klasa së bashku, mund të shohin një shfaqje teatrore. Në pamundësi, kjo shfaqje mund të shihet në DVD. Gjithsesi, kjo veprimtari mund të realizohet jashtë orës mësimore. Udhëzohen nxënësit që gjatë ndjekjes së shfaqjes teatrore sigurojnë të dhëna dhe të mbajnë shënime në lidhje me: titullin, autorin, regjisorin, reagimet e spektatorëve, ngjarjen dhe konfliktin. Këto shënime do t' u shërbejnë për të realizuar përshkrimin e shfaqjes. Ndërtimi i njohurive të reja Hapi II. Zhvillohet një bisedë me nxënësit në lidhje me shfaqjen dhe emocionet që ajo përcolli tek ata. Përshkrimi i shfaqjes do të realizohet sipas skemës së Organizuesit grafik.			
Përshkrimi i një shfaqjeje teatrore			
Hyrja: Zhvillimi: Mbyllja:			
titulli, autori, regjisorin, aktorët, skenat, vendosja e ngjarjeve, konflikti, vlerësim për shfaqjen, loja			
roli i aktorëve, muzika, dekori, ndriçimi mesazh, ftesë, citim			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Hapi III. Nxënësit realizojnë përshkrimin e shfaqjes në fletore. Gjatë punës do t' u përmbahen elementeve të strukturës së shkrimit. Hapi IV. Prezantohen punimet përmes Turit të galerisë, ose duke i lexuar disa prej tyre, sipas dëshirës së nxënësve. Nxënësit vetëvlerësojnë punën e tyre dhe punën e realizuar nga shokët. Fletoret do të mblidhen për t' u vlerësuar.			
Vlerësimi: për vëmendjen e treguar gjatë shfaqjes, dhënia e mendimeve në lidhje me të, realizimi i saktë i përshkrimit të shfaqjes dhe vlerësimi që i bën punës së shokut/shoqes.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një minialbum me fotografi shfaqjesh dhe aktorësh të njohur shqiptarë.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Panair portofoli (tremujori i dytë)		Situata e të nxënimit: Llojet e teksteve Teksti përshkrues është një pjesë kontekstuale që paraqet një formë përshkrimi të objekteve, frymorëve e sendeve.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: -bën vetëvlerësimin e punimeve të portofolit, -nxjerr dhe grupon shkurt njohuritë që ka përvetësuar, -radhit rastet kur është ndier krenar, apo është zhgënjyer për vlerësimet e marra, -prezanton përpara shokëve/shoqeve, punimet e portofolit në formën e një reklamimi, -vlerëson punimet e shokut/shoqes, -ndërthur njohuritë gjuhësore me ato matematikore duke bërë llogaritjen e pikëve si dhe kthimin e pikëve në notë, -bën analizën e rezultateve të arritura duke bërë krahasimin me tremujorin e parë.		Fjalët kyçe: Panair Portofol Njohuri Vlerësim Vetëvlerësim Detyra	
Burimet: Portofolët e nxënësve, detyrat e tremujorit të dytë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Matematikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Bisedë e kombinuar me arsyetim, analizë rasti, minileksion, punë e drejtuar, tabeta krahasuese, puno/shkëmbe.			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bisedë e kombinuar me arsyetim, analizë rasti. Në fillim të orës mësuesi/ja njih nxënësit me temën e orës së mësimit. U bën të ditur nxënësve hapat e organizimit të orës dhe rezultatet e pritshme. Organizohet një bisedë rreth çështjes: “Rëndësia e portofolit të nxënësit”. Secili nga nxënësit, jep mendimin e tij mbi rëndësinë që i kushton ai portofolit të të nxënimit duke argumentuar përgjigjet edhe me anë të shembujve të ndryshëm, apo detyrave të ndryshme të portofolit. Mendimet e nxënësve përmbledhen tek “harta e mendimeve”.			
Portofoli i të nxënimit			
Dëshmon, krijon, seleksionon, evidenton, përzgjedh, përcakton, dokumenton, plotëson, vlerëson, prezanton, etj.			
Në formën e një analize ngrihen disa nxënës që të diskutojnë rreth portofolit të tyre duke u mbështetur te pyetjet: -Pse? (Nxënësi duhet të sqarojë arsyen përse ka punuar kështu, përse ka zgjedhur këto detaje, përse mbi këtë temë, etj.). -Çfarë? (Nxënësi duhet të sqarojë se çfarë ka ndikuar në zgjedhjet e tij, çfarë do të tregojë me këtë detyrë, çfarë priste nga ky punim). -Kur? (Kur u zhvillua kjo detyrë apo punim si periudhë kohore, por edhe si program mësimor). -Ku? (Ku ndodhej nxënësi kur punoi me detyrën apo projektin, ku i gjeti informacionet e duhura për të realizuar detyrën). -Si? (Nxënësi tregon se si ndihet për detyrën e tij, për arritjet e tij). Diskutohet me disa nxënës në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve midis njëri-tjetrit dhe merren në shqyrtim disa detyra të zgjedhura më parë nga mësuesi/ja. Detyrat mund të jenë të cilësuar si nga më të mirat, por zgjidhen edhe detyra me anë të të cilave motivohen nxënësit për të punuar më mirë.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Minileksion, punë e drejtuar.

Gjatë prezantimit të detyrave të portofolit të të nxënit, nxënësit përdorin tekstin përshkrues. Rikujtohen shkurt llojet e tekstit përshkrues sipas qëllimit. Përshkrimi bëhet për tri arsye:

Përshkrimi informues: 1- të bëjë të njohur, të informojë, 2- jep informacione të sakta, të hollësishme e me detaje, 3- gjuha është e drejtpërdrejtë, e saktë.

Përshkrimi bindës: 1- objektin e përshkruan në mënyrë subjektive, 2- nuk ka detaje e hollësi për saktësinë e përshkrimit, 3- përpiqet të krijojë përshtypje pozitive.

Përshkrimi shprehës: 1- shpreh informacione dhe gjendje shpirtërore, përjetime, 2- paraqet përshkrim të personazheve apo mjedisit në mbështetje të temës, 3- gjuha është e zgjedhur dhe e përpunuar artistikisht.

Mësuesi/ja drejton vëmendjen e nxënësve të detyrat e tyre, të cilat kanë nevojë për përmirësim.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela krahasuese, puno/shkëmbe.

Mësuesi/ja ndërton në dërrasën e zezë një tabelë krahasuese ku nxënësit në mënyrë individuale të punojnë mbi vlerësimin duke bërë edhe vetëvlerësimin e detyrave.

Pasi punohet me tabelën krahasuese në mënyrë individuale, nxënësit punojnë në grupe dyshe, duke shkëmbyer me njëri-tjetrit detyrat e portofolit dhe fletët për të bërë vlerësimin e shokut.

Detyra Nr	Vlerësimi nga mësuesi/ja	Vetëvlerësimi	Vlerësimi i shokut
Detyra 1			
Detyra 2			
Detyra 3			
Projekti			

Mësuesi/ja ndjek punën e nxënësve dhe më pas ngre me radhë disa nxënës që të sqarojnë plotësimin e tabelës duke argumentuar mbi vlerësimin e vendosur për vete, por edhe për detyrat e shokut.

Detyrat më të bukura, më të sakta dhe të vlerësuara më mirë nga të tre komponentët, vendosen në këndin e punimeve të klasës. Mësuesi/ja vendos në këndin e klasës edhe detyra të nxënësve që kanë nevojë për motivim e stimulim.

Vlerësimi: Vlerësim motivues me fjalë e shprehje për punën e bërë.

Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Artizanët e filigranit		Situata e të nxënit: Çfarë është profesioni? Profesioni është një zanat i themeluar mbi një trajnim arsimor të specializuar, qëllimi i të cilit është furnizimi me këshilla pa interes dhe në shërbim të të tjerëve, për një kompensim të drejtpërdrejtë dhe të caktuar, tërësisht larg nga pritjet e tjera të fitimeve të biznesit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon llojin e tekstit që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare; - jep mendimin e tij pasi ka lexuar dhe ka kuptuar një tekst; - gjen figurat letrare dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst, - dallon elementet e tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja; - përdor gjuhën standarde gjatë të shkruarit dhe të folurit rreth temës; - nxjerr elementet përbërëse të një kronike; - shkruan një kronikë të shkurtër për tema të ndryshme. 		Fjalët kyçe: Reportazh Personazhe Ngjarje Elemente Artizanë Filigran	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe 9”, materiale shtesë nga mësuesi/ja rreth temës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Gushkuqi rrethor, pyetje-përgjigje, punë me tekstin, minileksion, hulumtim, punim ushtrimesh, diskutim i lirë.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Gushkuqi rrethor, pyetje- përgjigje.</i> Mësuesi/ja në fillim të orës shkruan në tabelë fjalën “profesion” dhe pyet nxënësit se çfarë kuptojnë ata me këtë fjalë. Nxënësit japin përgjigje rreth fjalës dhe sqarohet më hollësisht, me ndihmën e mësuesit/es, kuptimi i saj. <i>(Profesioni është një zanat i themeluar mbi një trajnim arsimor të specializuar, qëllimi i të cilit është furnizimi me këshilla pa interes dhe në shërbim të të tjerëve, për një kompensim të drejtpërdrejtë dhe të caktuar, tërësisht larg nga pritjet e tjera të fitimeve të biznesit).</i> Në formën e një gushkuqi rrethor zhvillohet me nxënësit një lojë, ku secili prej tyre do të shkruajë në një fletë për profesionin që dëshiron të ketë në të ardhmen. Shpërndahen fletët dhe në mënyrë të shpejtë zhvillohet loja. Mblidhen fletët dhe lexohen profesionet e zgjedhura nga nxënësit. Mësuesi/ja nxjerr profesionin që është përzgjedhur më shumë nga nxënësit. Në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve, nxënësit sqarojnë shkurtimisht çështjet: - Përse keni zgjedhur këto profesione? - A ka lidhje profesioni i zgjedhur me preferencat e prindërve? - Po me profesionin e prindërve apo trashëgiminë familjare? - Sa prej jush do të donin të kishin të njëjtin profesion si prindërit dhe përse? - A ka nga familjarët tuaj që merren me punë artizanale? Nxënësit japin mendime të ndryshme sipas dëshirave dhe pëlqimeve, pa komentuar mbi përzgjedhjet e njëri-tjetrit dhe pa ndikimin e mësuesit/es.			

U kërkohet nxënësve që të imagjinojnë veten në të ardhmen dhe të përshkruajnë në formën e një teksti përshkrues se si ndihen me profesionin e tyre.

Nxënësit lihen të lirë që të shkruajnë dhe shkrimet e tyre lexohen me radhë, duke nxjerrë elementet e tekstit përshkrues.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë me tekstin, minileksion, hulumtim.*

Rikujtohen njohuritë e marra për tekstin letrar dhe atë joletrar. Renditen disa lloje tekstesh joletrare si: ditari, udhëpërshkrimi, biografia, autobiografia, kujtime, udhëzues etj. Njihen nxënësit me temën e re “Artizanët e filigranit” si një lloj i veçantë i tekstit joletrar (reportazh).

Punohet me leximin e tekstit nga nxënësit në formë zinxhiri për të kuptuarit e temës.

Sqarohen fjalët e reja dhe të pakuptueshme nga nxënësit.

Reportazhi është lloj i tekstit rrëfimtari joletrar, në të cilin autori gërsheton faktet reale me përshypjet subjektive, duke ngritur një problem. Përshkrimi i njerëzve, i ngjarjeve ose i vendeve bëhet sipas përjetimit të rrëfimtari (reporterit).

Shfrytëzohen mjetet letrare, si përshkrimi, karakterizimi, dialogu etj., për të paraqitur një ngjarje apo një personalitet.

Autori i reportazhit zakonisht është edhe vetë pjesë e reportazhit, bëhet personazh i reportazhit, rrëfen edhe për veten, se si e ka përjetuar ai ngjarjen.

Krahas fakteve, autori përfshin edhe detajet që paraqesin gjendje emocionale, fizike apo sociale. Personazhet që marrin pjesë në reportazh janë gjithmonë reale, karakteristike, të tipizuara mirë e në përputhje me veprimet e tyre. Tema e reportazhit nuk është e kufizuar në përmbajtje. Mund të shkruhet për një person të panjohur apo për një figurë publike, po aq sa për një çështje shqetësuese, të njohur apo të panjohur për opinionin publik. Gjuha është zakonisht e qartë, me përdorim të kufizuar të figurave letrare.

Duke sqaruar elementet e tekstit joletrar, kronikës, mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të hulumtojnë mbi tekstin për të ilustruar me pjesë nga teksti elementet e reportazhit.

Nxënësit i rikthehen materialit në tekst që gjatë hulumtimit të gjejnë dhe plotësojnë organizuesin grafik.

Nr.	Lloji i tekstit sipas qëllimit	Elementet e përdorura	Përshkrime që ndeshen	Personazhet që marrin pjesë	Tematikat që trajtohen
1.	Tekst joletrar, Reportazh mbi një temë të caktuar	Ka elemente reale, por edhe përshypje e qëndrime të autorit.	Ka përshkrime të njerëzve, vendeve, ngjarjeve e përjetime të vetë autorit.	Personazhe reale që lidhen me temën, personalitete që mbështesin temën, vetë autori.	Tematika është e larmishme për çështje apo personazhe të ndryshme.
2.	<i>Trajton tematikën e profesionit të filigranit, problematikat dhe vështirësitë që</i>	<i>Ndrec Gjini, Bekim Xhemili, Kosova, 1543 Asete trashëgimie kulturore,</i>	<i>I mbledhur në një cep të dyqanit, në qytetin jugor të Prizrenit, një burrë trupvogël...</i>	<i>Ndrec Gjini, Bekim Xhemili dhe vetë autori i reportazhit.</i>	<i>Artizanët e filigranit. Filigrani-Punim argjendarie, në trajtën e një dantelle të</i>

Ndiqet dhe kontrollohet puna e nxënësve nga mësuesi/ja. Lexohen disa shembuj të dhënë nga nxënësit, duke plotësuar përgjigjet e njëri-tjetrit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punim ushtrimesh, diskutim i lirë.*

Ushtrimi 1. Cila është tema e këtij reportazhi? - *Artizanët e filigranit, problematikat dhe vështirësitë që u dalin artizanëve.*

Ushtrimi 2. Si e fillon autori reportazhin? - *Reportazhi nis me një përshkrim të personazhit dhe të punës që po kryen.*

Ushtrimi 3. Sa personazhe zënë vend në këtë reportazh? Cilët janë ata? - *Ndrec Gjini, Bekim Xhemili dhe vetë autori.*

Ushtrimi 4. A është autori një personazh i ngjarjes së rrëfyer? Pse mendoni kështu? - *Po, sepse ai është pjesë e ngjarjes dhe është prezent gjatë bisedave dhe ngjarjes.*

Ushtrimi 5. Si shprehen personazhet në lidhje me mjeshtrinë e punimit të filigranit?– *Teknika e filigranit u trashëgua që në moshë shumë të re nga prindërit e tyre, gjë që i bëri ata perfeksionistë; Arti mbetet tepër i njohur në Azi, sidomos në Indi, por edhe në Afrikën e Veriut, ndërkohë që ndeshet rrallë në Evropën moderne.*

Ushtrimi 6. Cila është problematika që ngre ky reportazh?– *Puna që bëjnë artizanët dhe vështirësitë që hasin ata. Gjithashtu theksohet edhe përpjekja që bëhet për ta mbajtur gjallë këtë traditë.*

Ushtrimi 7. Renditni faktet e përmendura në të. –*Nuk ka një datë të saktë se kur shqiptarët në Kosovë filluan të punojnë argjendin, por historianët thonë se kjo ndodhi ndoshta dikur në shekullin XVIII. Prizreni u bë qendra kryesore për argjendarët, por kishte artizanë të famshëm edhe në Pejë, Gjakovë dhe Prishtinë, ku argjendarët i përcillnin të fshhebtat nga babai te djali; Kosova ka pasur minierat e saj të argjendit në Trepçë dhe Novobërdë dhe argjendarët kishin shumë material të papërpunuar për të punuar. Por në Kosovë nuk nxirret më argjend, kështu që artizanët e mbetur duhet ta importojnë atë, mirëpo në këtë mënyrë mezi mbulojnë shpenzimet e tyre. Tregtia po vdes.*

Ushtrimi 8. Ilustroni me shembuj nga teksti detajet e dhëna në pjesët përshkruese.

– *I mbledhur në një cep të dyqanit, në qytetin jugor të Prizrenit, një burrë trupvogël... Gjini është një nga argjendarët e paktë që ka ngelur në Prizren.*

Ushtrimi 9. Nënvizoni fjalitë në të cilat autori mban qëndrim subjektiv. Dalloni dhe përcaktoni figurat letrare të përdorura.

– *Atje, në punishten e tij të vogël, në një qoshe, ai është vetëm dhe i lumtur me argjendin. Por në Kosovë nuk nxirret më argjend, kështu që artizanët e mbetur duhet ta importojnë atë, mirëpo në këtë mënyrë mezi mbulojnë shpenzimet e tyre. Tregtia po vdes.*

Epitete: *burrë trupvogël, zanat të lashtë, saktësi absolute, argjendarët e paktë, artizanët e mbetur, artizanët e famshëm, arti tepër i njohur, motivet unike; shprehje metaforike: Teknologjia moderne do t'i kishte bërë më të lehta të gjitha, mezi mbulojnë shpenzimet, tregtia po vdes.*

Ushtrimi 10- Gjeneroni në fjalor kuptimin e fjalës “artizan” – *zejtar. Plotësoni fushën leksikore të kësaj fjale. – Punishite artizanale, punë artizanale, prodhim artizanale, mjete artizanale, metoda artizanale etj.*

Ushtrimi 11- Nënvizoni në tekst citimet që ka përdorur reporterja.

“Ne punojmë me fije të përdredhura argjendi, – thotë Gjini. - Jo të gjithë mund ta mjeshtërojnë si duhet këtë art”. “Tregtia së pati origjinën në Kosovë, por kjo e fundit ishte e famshme sidomos për artizanët e saj”. “Ndërsa teknika e filigranit u trashëgua gjatë shekujve, artizanët filluan të punonin me baballarët e tyre që në moshë shumë të re, gjë që i bëri ata perfeksionistë. Kjo i bëri teknikën, stilin dhe motivet e tyre unike”.

Për **Ushtrimin 12 dhe 13** jepen përgjigje duke argumentuar shkurt rreth tyre. Cili mendoni se ka qenë lexuesi i synuar i autorit të këtij reportazhi? Pse? *Kronika është shkruar për një lexues të gjerë dhe ka si qëllim jo vetëm ta njohë me artizanët dhe punën e tyre, por edhe të trajtojë çështjen e trashëgimisë, e ruajtjes dhe traditës së këtij zanati të vjetër.*

Ushtrimi 14 - Ky reportazh përcjell idenë: “Artizanët e filigranit në Prizren mbajnë gjallë zanatin e lashtë kosovar”.

Zbërtheni kuptimin e saj. *(Është zanat i vjetër, rreth shekullit të VIII dhe këta artizanë në Prizren, edhe pse kanë vështirësi nga më të ndryshmet, po përipiqen që ta përcjellin te fëmijët e tyre, duke ruajtur kështu vazhdimësinë e zanatit të lashtë kosovar).*

Ky ushtrim do të zhvillohet në formën e një diskutimi të lirë ku çdo nxënës do të përcjellë idetë e tij.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, gjetjen e elementeve të tekstit, analizën e gjuhës së përdorur.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeneroni fotografi të ndryshme të punimeve artizanale nga krahina të ndryshme.

Grumbulloni informacione rreth tyre dhe prezantojini duke komentuar secilin rast.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Beteja për lumin Vjosa		Situata e të nxënësve: Koncerti sensibilizues i datës 18 tetor në Tiranë “MOS MA PREK VJOSËN ! https://www.youtube.com/watch?v=I2L-16BR6RY https://www.youtube.com/watch?v=BlFzY5aTihI “VJOSA, perla e egër e Europës –Lumi Vjosa në Shqipëri “Në disa zona, shtrati i lumit të Vjosës arrin më shumë se 2 km. Ajo ofron një ekosistem dinamik,	

	<p>pothuajse natyror. Ky ekosistem unik në kontinent, edhe pse i panjohur, përfaqëson një trashëgimi të vërtetë natyrore europiane. Gjarpërimet e rrjedhës së poshtme krijojnë një luginë të gjerë me habitate ligatinore që bëhet strehë për peshqit, shpendët migratorë dhe shumë specie të tjera. Rrugëtimi i saj natyror përfundon në detin Adriatik, në veri të Lagunës së Nartës. Vjosa zë një sipërfaqe totale 6700 km² në Shqipëri e në Greqi dhe shkarkon në detin Adriatik një mesatare prej 204 m³ ujë në sekondë. Flora e ekosistemit të Vjosës është mbresëlënëse. Vjosa është një ekosistem i pakrahasueshëm në Europë, një nga lumenjtë e fundit të egër në të gjithë kontinentin, ndaj është e rëndësishme ta kthejmë në një Park Kombëtar e jo të ndërtojmë diga mbi të. Nëse do të ndërtohen diga, ky lumë “vdes”. Jo vetëm shqiptarët, por edhe Europa do të humbasë këtë hapësirë të bukur dhe një nga lumenjtë e saj më të mirë. Ky lumë dallohet për vlerat e tij natyrore, sociale dhe historike. Na e kanë lënë të parët dhe ne duhet t’ua lëmë trashëgim brezave që vijnë. Lumi Vjosa është bazë të ardhurash për ekonominë e zonës; është një thesar natyror europian.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale 	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ul style="list-style-type: none"> - hulumton rreth lumit Vjosë, thesarit natyror, social dhe historik për Shqipërinë dhe Evropën; - dallon karakteristikat e reportazhit në këtë shkrim; - tregon shkurtimisht përmbajtjen e reportazhit; - përmbledh idetë kryesore të reportazhit; - argumenton qasjen apo jo të tij me fushatën “Mos ma prek Vjosën!” 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Vjosa</p> <p>Lumë</p> <p>Pasuri natyrore</p> <p>Pasuri historike</p> <p>Pasuri sociale</p> <p>Ndërtim digash</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit http://verifikimiifakteve.mk/leksion-gazetaresk-reportazhi/ https://www.youtube.com/watch?v=I2L-16BR6RY http://gazetaria.ofees.net/pdf/Reportazhi.pdf; i=parë më 07.04.2018</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjeografi, Biologji</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Përvijim i të menduarit; Role të specializuara në diskutime; Grupe ekspertësh, Shkrim i shpejtë</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimt</p> <p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Përvijim i të menduarit</i></p> <p><i>Cfarë dini ju për reportazhin?</i></p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin-top: 10px;"> <p>Fjala reportazh vjen prej frëngjishtes “reportage”: report [të tregosh diçka që ka ndodhur] + age [prapashtesë që u jep emrave masë apo kuptim abstrakt, si voujage, courage etj. Reportazhi është përshkrim i njerëzve, i ngjarjeve, i vendeve dhe i gjërave të vërteta në mënyrë letrare dhe sipas përjetimit të reporterit.</p> </div>	

Thoni disa karakteristika të tij

Janë dy anë themelore të reportazhit: reportazhi është para së gjithash informim, përshkrim letrar i ngjarjes, si dhe përjetim subjektiv i asaj ngjarjeje.

Karakteristika e dytë është prania e autorit në momentin e ngjarjes.

Autori i reportazhit zakonisht është edhe vetë pjesë e reportazhit, bëhet personazh i reportazhit, rrëfen edhe për veten, se si e ka përjetuar ngjarjen dhe atë përjetim të tij e bartë edhe në tekst.

Një karakteristikë tjetër e reportazhit është **përshkrimi i detajit**. Reportazhi pa detajin nuk ka kurrfarë vlere.

Tema e reportazhit nuk është e kufizuar në përmbajtje. Mund të shkruhet për cilëndo temë, të madhe apo të vogël,

Në aspektin strukturor të ndërtimit të tekstit dhe të idesë reportazhi është shumë më afër letërsisë se sa gazetarisë.

Autori është i lirë të zgjedhë strukturimin që ai dëshiron. Ai duhet t'u përmbahet elementeve përbërëse të reportazhit: motivit, përshkrimit, dialogut, personazhet dhe përjetimi subjektiv.

Motivi [tema, ngjarja] i reportazhit është ngjarja, personi, vendi apo gjërat për të cilat rrëfëhet në reportazh

Përshkrimi është mënyra e të rrëfyerit: autori përshkruan në pjesën më të madhe të tekstit, përveç kur përdor dialogun. Përshkrimi është faktik por në mënyrë letrare.

Gjuha mund të jetë më shumë apo më pak e figurshme, më lehtë apo më vështirë e kuptueshme, mund të jetë një gjuhë e ftohtë e fakteve [stil i ftohtë], por në të gjitha rastet duhet të jetë gjuhë letërsie.

Dialogu është një formë tjetër e formësimit të ligjërit që plotëson përshkrimin në reportazh

Personazhet e reportazhit janë pikë themelore. Reportazhi mund të jetë vetëm një peizazh apo një prozë letrare.

Personazhet janë jeta e gjallë e reportazhit dhe autori duhet të kujdeset që ata t'i karakterizojë saktë, sikurse personazhet e një romani. Personazhet duhet të jenë gjithmonë realë, të vërtetë, karakteristikë, të tipizuar mirë e në përputhje me veprimet e tyre, por edhe kur ka shpërputhje midis veprimeve dhe karakterit të personazhit autori duhet ta nxjerë në pah (evidentojë) këtë fakt. Një prej pikave kritike të reportazhit është pikërisht realizimi i mirë i personazheve: realizimi i dobët i tyre ia ul vlerën reportazhit.

Përjetimi subjektiv i ngjarjes është prezenca e autorit në reportazh.

Burimi: Dr. Bajram Kosumi / Zhanret e Gazetarisë II 2008/2009

<http://gazetaria.Ofees.net/pdf/Reportazhi.pdf?i=>

Ndërtimi i njohurive të reja: Role të specializuara në diskutime

Rolet janë:

Gjetësi i citimeve: Detyra e këtij nxënësi është të zgjedhë disa pjesë të caktuara nga teksti, të cilat grupi dëshiron t'i dëgjojë të thuhet me zë të lartë.


Hulumtuesi: Detyra e këtij nxënësi është të japë informacion paraprak për çdo temë që lidhet me tekstin.

Lidhësi: Detyra e këtij nxënësi është që të gjejë lidhjet midis tekstit dhe botës jashtë shkollës.

Personi që bën pyetjet: Detyra e këtij nxënësi është që të shkruajë pyetje para diskutimit, për të cilat do të flasë grupi, pyetje që ai/ajo dëshiron të diskutojë me të tjerët.

Gjetësi i fjalëve: detyra e këtij nxënësi është të gjejë fjalë të reja, të rëndësishme, të çuditshme për t'ia vënë në dukje grupit për të diskutuar.

Klasa ndahet në grupe ekspertësh duke i caktuar numrat nga 1-5. Secilit i jepet një nga rolet e sipërpërmendura. Të gjithë gjetësit e citimeve do të mblidhen në një grup e kështu me radhë do të veprojnë dhe rolet e tjera.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i shpejtë**Shkruaj një ese argumentuese me temë: “Mos ma prek Vjosën!”**

Nxënësit fillojnë të punojnë dhe në rast se nuk e mbarojnë punën në klasë, u lihet detyrë shtëpie dhe pjesë e portofolit.

Informacion shtesë për mësuesin/en:

Beteja për mbrojtjen e lumit Vjosë u zhvendos të premtën në gjykatë, pasi tri organizata mjedisore dhe banorët e prekur nga hidrocentrali i Poçemit iu drejtuan me një padi Gjykatës Administrative në Tiranë, ku kërkuan pavlefshmëri absolute të koncesionit të hidrocentralit të Poçemit.

Organizatat EcoAlbania nga Shqipëria, Riverwatch nga Austria dhe EuroNatur nga Gjermania, si dhe 38 banorë të zonave të prekura paditën Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe kërkuan pavlefshmëri absolute të procedurave koncensionare, si dhe konstatimin si të paligjshëm të kontratës së lidhur me shoqërinë “Kovlu Energji” për HEC-in në Poçem.

Paditësit e konsideruan ndërtimin e hidrocentralit si plan për shkatërrimin e Vjosës dhe kërkuan përmes padisë ‘pezulimin e çdo vendimi apo premtimi për këtë hidrocentral’ “Jemi të vendosur ta mbrojmë këtë kërkesë në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë. Bëhet fjalë për mbrojtjen e njëres prej zonave natyrore më me vlerë jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë Europën”, deklaroi Olsi Nika, koordinator i fushatës “Të shpëtojmë zemrën blu të Europës” nga EcoAlbania.

Burimi: <http://www.ecoalbania.org/beteja-per-lumin-vjosa/>

Mos ma prek Vjosën!” – Artistët shqiptarë kundër HEC-ve mbi lumin Vjosë

Botuar nga Amarildo Topi, Citizens Channel me 18 October 2017.

Në titullin “Mos ma prek Vjosën” artistët të njohur shqiptarë dhe të ndërkombëtarë do të performojnë mbrëmjen e së mërkurës në sheshin “Skënderbej” për të ndërgjegjësuar publikun e gjerë dhe vendimmarrësit mbi rëndësinë e mbrojtjes së lumit Vjosa nga planet për ndërtimin e hidrocentraleve. Qeveria shqiptare ka lidhur dy lidhur dy kontrata koncensionare për ndërtimin e dy hidrocentraleve mbi rrjedhën e lumit Vjosë, ai i Poçemit dhe ai i Kalivaçit. Kjo ka shkaktuar alarm dhe ka vënë në lëvizje një rrjet të gjerë shkencëtarësh ndërkombëtarë dhe shqiptarë, për të mbrojtur lumin e fundit të egër në kontinentin evropian.

Paraditen e së martës grupi i artistëve shqiptarë, përfaqësues të Riverwatch dhe EcoAlbania në një konferencë për shtyp, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së ekosistemit të Vjosës u kanë bërë thirrje qytetarëve të jenë sa më të shumtë në numër në koncert.

“Një lumë si Vjosa nuk ekziston në Europë. Vjosa është një rrjedhë jete që nuk është dëmtuar ende nga digat dhe ndërtimet. Ajo është padyshim unike në Europë dhe një digë e vetme mund të shkatërrojë të gjithë lumin. Nëse ne bllokojmë lumenjtë është njësoj si të kemi bllokuar arteriet kryesore të trupit dhe kjo do t’ju lëndojë dhe do t’ju heqë mundësinë të keni një park të egër kombëtar, të vetmin në Europë”, tha Ulrich Eichelmann, drejtues ekzekutiv i Riverwatch dhe ekspert i rrjeteve lumore në Europë.

Shqipëria ka dhënë 500 koncesione për të ndërtuar hidrocentrale në rrjetin e saj lumor. “Kjo nuk është një mënyrë për të prodhuar energji është dicka që bëhet vetëm për para dhe është vetëm korrupsion. Ju duhet të ngrini zërin tuaj sepse kjo që po ndodh është krejtësisht e gabuar”, vazhdoi më tej Eichelmann.

Koncerti sensibilizues do të zhvillohet në Sheshin Skënderbej, pranë Muzeut Historik Kombëtar më datën 18 tetor, ora 19:00 dhe artistët që do të ngjiten në skenë do të jenë Elina Duni, Eda Zari, Gent Rushi, Rob Luft, Vlashent Sata, Marsela Çibukaj, Linda Rukaj, Charles Lamouroux, Ermal Rodi, Florian Garcin, Emiljan Dhimo, Grupi Polifonik Lunxhëria, Blerat & Besfort, Këpuska dhe Dj. ODA.

“Problemi i Vjosës nuk është vetëm i banorëve të Vjosës, është i të gjithëve dhe nëse qëndrojmë indiferentë do bëjmë që ky lum të vdesë”, deklaroi këngëtarja Eda Zari

Vjosa në Konventën e Bernës *Botuar nga EcoAlbania me 22 July 2016.*

Më poshtë deklarata për mbrojtjen e Lumit Vjosë:

Lumi Vjosa është një ndër lumenjtë e fundit në gjendje natyrore në Evropë. Për më shumë se 270 km ai rrjedh i paprekur dhe i pa ndërprerë. Lumi është i karakterizuar nga kanione të bukur, në rrjedhën e sipërme dhe ka një shtrat të gjerë e madhështor në rrjedhën e mesme e të poshtme. Së bashku me degët e saj, Vjosa krijon një ekosistem dinamik, një trashëgimi të vërtetë të natyrës evropiane. Në të njëjtën kohë, Vjosa është një nga lumenjtë më pak të njohur të Evropës. Të dhënat ekologjike dhe hidro-morfologjike për të janë jashtëzakonisht të kufizuara.

Megjithatë, në pellgun ujëmbledhës të Vjosës, janë parashikuar të ndërtohen rreth 34 HEC-e, 9 prej të cilëve mbi rrjedhën kryesore të saj. Çelja e procedurave të tenderimit për HEC-in e Poçemit përbën aktualisht një ndër kërcënimet më të mëdha. Ndërhyrja e pabazuar në studime të thelluara për ndërtim hidrocentralesh edhe në degët e Vjosës (si në: Lengaricë, Bënçë, Shushicë etj.) vë gjithashtu në pikëpyetje ekzistencën e lumit të fundit të “egër” në Evropë. Ndërkohë institucionet e BE-së janë shprehur qartë në Rezolutën e Parlamentit

Evropian të vitit 2014, konkretisht në pikën 27 të saj, ku evidentohet rëndësia e veçantë që ka mbrojtja e lumit Vjosa, si një trashëgimi natyrore Evropiane.

Një kërcënim tjetër për këtë pellg ujëmbledhës është edhe Plani Grek i Menaxhimit, miratuar nga Qeveria Greke, ku parashikohet devijimi i një sasive të ujërave të lumit Vjosa drejt liqenit të Janinës. Projekte të tilla do ta shkatërrojnë këtë ekosistem lumor unik. Për më tepër, këto projekte bien ndesh me legjislacionin e BE-së si Direktiva Natura 2000 dhe Direktiva e Rrjetit të Ujërave.

OJF-të shqiptare, kundërshtojnë fuqimisht projektet që cenojnë integritetin e lumit të Vjosës. Ne duam të mbrojmë këtë thesar të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe socio-historike të rajonit.

Ne kërkojmë, që Qeveria Shqiptare të ndalojë projektet e ndërtimit të HEC-ve në gjithë luginën e Vjosës si dhe të angazhohet në shpalljen e saj Park Kombëtar. Vjosa duhet të mbrohet në të gjithë gjatësinë e saj, sepse ndërtimi i qoftë dhe një dige të vetme do ta shkatërronte përfundimisht këtë ekosistem unik dhe do t'i jepte fund vizionit të Parkut Kombëtar të parë të një lumi natyror në të gjithë Evropën.

Burimi: <https://www.mjedisot.info/index.php/ujj/1661-vjosa-ne-konventen-e-bernes>

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësoj nxënësit për materialet hulumtuese për lumin Vjosa, për dallimin e karakteristikave të reportazhit, për argumentet e dhëna për problemin që ngrihet në reportazh

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjykoni rreth vërtetësisë së tekstit duke u përqendruar te burimet, të cilave u referohet reporteri.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Kallëzuesi		Situata e të nxënësve: dallimin e kallëzuesit në tekstin e dhënë	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore-Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore: Nxënësi / ja		Fjalët kyçe: kallëzues, folje, kryefjalë, kundrinor, gjymtyrë e domosdoshme	
<ul style="list-style-type: none"> -Dallon dhe analizon kallëzuesin në fjali; -Dallon grupet e domosdoshme për foljen në fjali; -Ndryshon vendin e grupeve të fjalëve në fjalinë e dhe në. 			
Burimet: Libri i nxënësit. Gramatika 2, tabela e kallëzuesit, skeda me tekste të shkurtra.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		-- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grup; Diskutim; Punë në dyshe			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Punë në grup;			
Ndahet klasa në grupe me nga 4-5 nxë në s dhe u kërkohet që në tekstin e dhënë në skedë të dallojnë: a) kallëzuesit; b) gjymtyrë t që lidhen me kallëzuesit; c) fjalinë më të vogël (për të përcaktuar gjymtyrët e domosdoshme të fjalisë)			
Puna e secilit grup diskutohet duke i dhënë mundësinë secilit nxënë të jetë pjesëmarrës. Mësuesi bën përmbledhjen e përfundimeve të nxjerra nga puna e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim;			

Gjymtyrë kryesore e fjalisë

bërthamë organizuese e fjalisë

Kallëzuesi

i foljes → kallëzues përcakton funksionin dhe vlerën e grupeve të tjera në fjali

kundrinorë

a-folje që kërkojnë kryefjalë dhe

b-folje që kërkojnë vetë m kryefjalë

c-folje që kërkojnë kryefjalë

KD, KZHD

d-folje që s'kërkon as kryefjalë, as kundrinor

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe.**1-Nënvizoni kallëzuesit e fjalive të pjesës së mëposhtme.**

Nuk di të them sa të gjata m'u dukën këto pesë ditë. Kur i kujtoj, më duket sikur kanë zgjatur me vjet. Më kujtohet kur rrija e mbaja vesh të gjithë tingujt që mund të dëgjoheshin në shtëpi dhe që m'i zinte veshi... Pastaj gdhiehej dita prapë, vinte dreka, mbrëmja, koha kur shokët e mi loznin dhe unë rrija dhe i shikoja nga dhoma ime.

3- Gjeni kallëzuesit dhe gruponi foljet sipas ndarjes në tabelën e mëposhtme.

Ne u ngritëm menjëherë, veshëm palltot tona, morëm valixhet dhe, pa nxjerrë fjalë prej goje, dolëm nga porta e madhe në rrugën e ftohtë. Diku larg gjëmonte. Nga të dyja anët e rrugës, njerëzit na shikonin me çudi. Ne e ndjenim veten mjaft të vetmuar dhe, me sa dukej, po fillonin prapë ditët moderne, sepse heshtja po vazhdonte.

Folje që marrin (përveç rrethatorëve):

vetëm kryefjalë	kryefjalë dhe kundrinor	kryefjalë, kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë	as kryefjalë e as kundrinorë
u ngritë m	veshëm	shikonin	gjëmonte
dolëm	morëm	ndjenim	
fillonin			
vazhdonte			
dukej			

4. Në fjalitë e mëposhtme, rrethoni grupet e domosdoshme për foljen dhe nënvizoni ato që nuk janë të domosdoshme.

*Nesër do të shkoj në kinema me shokët e mi.

*Kush trokiti në derë?

*Autobusi ndaloi në të dalë të qytetit.

*Rritja e temperaturave ndikoi në përhapjen e zjarreve.

*Macja flinte e qetë mbi divan.

5. Dalloni grupet e fjalëve dhe rishkruani fjalinë duke u ndryshuar vend atyre në fjali.

*Pa i hequr sytë nga dritarja, dëgjonte mendueshëm dhe i përhumbur zhurmat e para të mëngjesit.

-Mendueshëm dhe i përhumbur, dëgjonte zhurmat e para të mëngjesit pa i hequr sytë nga dritarja.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh punën në grup, saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6-Hartoni një tekst të shkurtër me temë të lirë. Dalloni kallëzuesit dhe klasifikojini sipas numrit të gjymtyrëve që kërkojnë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të lexojmë Tema mësimore: Unë dhe Shqipëria		Situata e të nxënit: Intervistë me mësuesen kujdestare ose drejtoreshën e shkollës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - njihet me jetën dhe veprën e Robert Elsie; - dallon karakteristikat gjuhësore tipike të intervistës; - krahason intervistën e strukturuar nga ajo gjysmë e strukturuar dhe e lirë; - argumenton faktet dhe opinionet në një intervistë. 		Fjalët kyçe: Intervistë E strukturuar Gjysmë e strukturuar Me strukturë të lirë Studues Përkthyes i shqipes	
Burimet: Teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gazetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Procedura pyet sërish, Shkrim i lirë</i>			
Organizimi i orës së mësimimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim,</i> Çfarë dini për intervistën?			
<p>Me intervistë kuptojmë komunikimin mes një njeriu që konsiderohet i rëndësishëm ose interesant dhe një gazetari që ka si qëllim të informojë publikun ose të reklamojë diçka tek ai.</p>		<p>Është bashkëbisedim i planifikuar;</p>	
<p>INTERVISTA E STRUKTURUAR përbëhet nga pyetje të parapërgatitura që vendosen sipas një rendi logjik</p>		<p>Është bashkëbisedim i qëllimshëm;</p>	
<p>INTERVISTA GJYSMË E STRUKTURUAR: pyetjet e intervistuesit janë të hapura dhe qëllimi i tij është të hetojë sa më shumë që të jetë e mundur një ngjarje, një situatë, një fakt. Renditja e pyetjeve nuk është e ngurtë, si në rastin e intervistës së strukturuar, por ndjek rrjedhën e bisedës, duke iu përshtatur përgjigjeve.</p>		<p>Realizohet mes dy palësh: intervistuesit dhe të intervistuarit</p>	
<p>INTERVISTA E LIRË: Intervistuesi nuk ka pyetje të parapërgatitura por vetëm një sërë temash, te të cilat do të përqendrojë intervistën</p>		<p>Intervista përdoret, nga një anë, për grumbullimin e informacioneve autentike.</p>	
		<p>albanologji – fushë e shkencës që merret me studimin e historisë së shqiptarëve, të gjuhës shqipe dhe të letërsisë e të kulturës shqiptare</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja: Procedura pyet sërish

Dy fjalë për Robert Elsie

Robert Elsie (1950-2017) ka qenë një shkrimtar, përkthyes dhe albanolog kanadez. Ai ka studiuar për mbi 35 vjet albanologjinë, veçanërisht kulturën, letërsinë dhe historinë e shqiptarëve. Ka dhënë një kontribut të madh duke promovuar ndërkombëtarisht kulturën, gjuhën, letërsinë dhe historinë e shqiptarëve në botë. Ndër botimet e tij të shumta, përmendim disa vepra që janë edhe në gjuhën shqipe: “Mik i shqiptarëve në ditë të vështira”, “Fjalor historik i Shqipërisë”, “Fjalor historik i Kosovës”, “Letërsia shqipe: një histori e shkurtër”, “Këngë kreshnikësh” etj. Pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij është botuar në anglisht. Në këto botime përfshihen studime për letërsinë dhe historinë e Shqipërisë, përkthime të krijimtarisë popullore shqiptare, si dhe përkthime të disa prej veprave të autorëve shqiptarë, si: Gjergj Fishta, Migjeni, Fatos Kongoli, Flora Brovina etj. Është nderuar me Medaljen e Mirënjohjes në Shqipëri dhe me Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit në Kosovë. Lidhja e fortë me kulturën shqiptare shfaqet edhe në amanetin që la para se të ndahej nga jeta, që të prehej në Shqipëri.

Lexohet intervista në role. Gazetari dhe gjuhëtari

Punojmë me shpjegimin e fjalës Albanologji.

Më pas punohet me teknikën Pyet sërish.

Nxënësit ndahen në dyshe. Njëri lexon paragrafin dhe tjetri bën pyetje rreth paragrafit. Ndërrojnë më pas vendet.

Intervista e mësipërme u referohet:

a) pikëpamjeve të autorit lidhur me marrëdhënien e Shqipërisë me Kosovën;

b) vështirësive të studiuesit në përkthimin e veprave në gjuhën shqipe;

c) jetës së autorit në Shqipëri dhe perceptimit të realitetit shqiptar;

d) eksperiencës së autorit si studiues dhe përkthyes i shqipes.

2. Nënvizoni informacionet kyçe në përgjigjet e Elsie. Ritregojini ato në mënyrë të përmbledhur.

Autori gjatë gjithë jetës së tij kishte pasur si qëllim në vetvete t'i prezantojë Shqipërinë, botës. Cila ishte ajo, kush janë shqiptarët, kulturën dhe historinë e saj.

Qëllimi: Njohja e Shqipërisë si një vend i panjohur.

Problemi tjetër që shtrohet në intervistë: marrëdhënia e tij me gjuhën shqipe. Si e kishte mësuar kur ishte student në Universitetin e Bonit dhe duhej të vizitonte Shqipërinë së bashku me studentët të tjerë, pas ftesës që Aleks Buda i kishte bërë profesorit të tij në 1978. Ishte e rrallë të vizitonte Shqipërinë e asokohe.

Një problem tjetër që ngrihet në intervistë marrëdhënia e gjuhës me shqiptarët e Kosovës, pasi shqipja letrare e tij e mësuar në libra nuk e kuptonte aspak gjuhën që flitej nëpër mjediset e Kosovës.

Vështirësive të studiuesit në përkthimin e veprave në gjuhën shqipe është kushtuar vëmendje në pyetjet e intervistës.

Vështirësia për të përkthyer Fishtën, sepse nuk njihje dialektin e gegërishten.

Puna gjatë përkthimit të Migjenit ishte më e lehtë dhe ai e cilëson një shkrimtar realist.

Dhe qershia mbi tortë në këtë intervistë është përcaktimi i Ismail Kadaresë, si shqipja më e bukur.

Intervista e mësipërme është:

e strukturuar;

gjysmë e strukturuar;

me strukturë të lirë.

4. Gjeneri në intervistë

dy fakte

1) Ndërkohë shkoja çdo vit në Prishtinë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën Shqipe për të mësuar gjuhën.

2) Ishte e vështirë, pasi nuk kishte fjalorë, kishte doracakë, libra mësues. Mbaj mend që gjeta një fjalor frëngjisht-shqip dhe nga ana tjetër shqip-gjermanisht, ndërsa në anglisht nuk kishte fare.

dhe dy opinione të autorit

1) Migjeni është një poet që më ka tronditur.

2) Kjo për mua është shqipja më e bukur. Unë kënaqem kur lexoj Kadarenë thjesht nga pikëpamja e gjuhës, të lexoj se si i ndërton fjalitë, fjalët që përdor

Mendon se intervista e mësipërme bazohet më së shumti në fakte apo në opinione. Mbi bazën e fakteve.

Si i ka vlerësuar Elsie figurat e shquara të letërsisë shqipe? Nënvizoni frazat përkatëse në tekst.

Fishta: Gjuha e tij e vështirë

Migjeni: Migjeni vjen dhe tregon realitetin e vendit. Poet tronditës

Kadare: Është i veçantë dhe ka ndikuar shumë në ecurinë e gjuhës së shkruar.


Ç'figurë letrare ka përdorur autori në frazën: Nuk kam shumë dëshirë të dal në dritë...

<p>Gjeni dy fraza sinonime me të. Nuk dua të shfaqem në publik, Dua të qëndroj në hije</p> <p>8. Gjuha e kësaj interviste është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - korrekte; - formale; - e drejtpërdrejtë; - e detajuar; - e qartë. <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë Zgjidhni përgjigjen që ju pëlqen më shumë nga intervista e mësipërme. Argumentoni pse. Nxënësit punojnë e më pas lexojnë punët para shokëve. Puna arkivohet më pas në dosje.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Lexoni të plotë intervistën e Robert Elsit dhe përzgjidhni çështjet që ju bëjnë përshtypje. Shtrojini ato si temë diskutimi në klasë.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Kamp i Bedenit http://www.botasot.info/libra-sporti/658816/romani-qe-permes-rrefimeve-te-at-zef-llumit-sjell-zerin-e-perjetimeve-te-dhembjes-se-nje-kohe/</p>		<p>Situata e të nxënës: Mësuesi i ka udhëzuar nxënësit të ndjekin në <i>youtube</i> intervistën e fundit të At Zef Pllumit . Opinion - Rrëfimi i fundit i At Zef Pllumit! (29 dhjetor 2015)</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënës - Kompetenca qytetare 			
<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - hulumton rreth jetës dhe veprës letrare të At Zef Pllumit; - krahason tekstin me kujtime me tekstin autobiografik; - kthen fjalët dialektore në gjuhën standarde; - diskuton rreth vlerës së aforizmave të at Zef Pllumit; - analizon karakteristikat e tekstit rrëfimtar. 		<p>Fjalët kyçe: Kujtime Kamp të burgosurish Brigadë Roje ushtarake Lopata Kazma Dhe Sheshim i kodrinës</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësit Opinion - Rrëfimi i fundit i At Zef Pllumit! (29 dhjetor 2015) https://www.youtube.com/watch?v=XrQD0hr702c</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Stuhi mendimi, Lexim-pyetje, Ruaje fjalën e fundit për mua</i></p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënës: <i>Diskutim, Stuhi mendimi</i> Dy fjalë për librin me kujtime dhe dallimin e tij nga libri autobiografik. Librat me kujtime në thelb kanë mbledhjen dhe rrëfimin e kujtimeve të një protagonistit. Tema e një libri të tillë mund të jenë kujtimet e jetës së një individi, nëpërmjet së cilave mund të përshkruhen në mënyrë të tërthortë edhe periudha të caktuara ose ngjarje themelore në historinë e një populli. Kujtimet ngjajnë me autobiografinë, por në të vërtetë janë dy lloje tekstesh të ndryshme. Autobiografia zakonisht na ofrohet nga një figurë e shquar (historike, letrare, shkencore etj.), ndërsa kujtimet shkruhen edhe nga individë të zakonshëm, pasi ato janë dëshmia e një epoke, një mjedisi shoqëror, një periudhe historike etj</p> <p>Çfarë dini për At Zef Pllumin? Po për veprën e tij “Rrno vetëm për me tregue?”</p>			



At Zef Pllumi është simbolit të ikonës së qëndresës katolik në Shqipëri.

Me thënë gjithçka për historinë,

Është me thënë më tepër se gjithçka.

Prandaj: Rrno vetëm për me tregue!

Beso për me shpresue...

(At Zef Pllumi, fq. 7)

Në vitin 1990, Natën e Këshëndellave fillon, fillon meshtarinë tek Kisha e Shna Nout në Tiranë deri në vitin 1997.

Diskutojmë së bashku

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim-pyetje

Lexohet pjesa nga nxënës të ndryshëm. Më pas punohet më teknikën “Lexim dhe pyetje”

Teknika përdoret në këtë fazë dhe nxënësit udhëzohen se do të punojnë në dyshe. Nxënësi i parë shkruan pyetjet në skeda dhe nxënësi i dytë lexon me zë përgjigjen. Nëse janë dakord të dy me përgjigjen, ajo shkruhet në skedë. Më pas nxënësit shkëmbejnë vendet.

Nxënësit punojnë po në dyshe për të zberthyer aparatit pedagogjik.

Lexoni tekstin dhe vendosni shenjën, kur pohimet e mëposhtme lidhen me përmbajtjen e tij.

Autori përcakton me saktësi vendin e ngjarjes. JO Ditë e zezë! Kur nuk din as emnin e vendit ku jeton !

Autori rrëfen kujtimet nga jeta e tij e vështirë në një kamp të burgosurish. Po

Aty në krye rreshtoheshin: komandanti e nënkomandanti i kampit, inxhinieri, brigadier i burgosun, komandanti i kompanisë dhe xhelatët policë e të burgosur Koordinatat të dërgojshin dhjetë minuta larg Shkumbinit, aty ku ai bante një kthesë rranxë një kodre të zhuritun, dhjetë minuta larg njëj kënete punojshim nga 20m... thojshin se përkarshi, po të kalohej Shkumbini, ishin katundet Sulzotaj edhe Shna Premte

Rrëfimi i autorit përfshin fakte dhe ngjarje të vërteta nga jeta e tij. Po

Rrëfimi i autorit ndërthuret me përshkrimin. Po

Rrëfimi i autorit përmban argumente. Po

Rrëfimet në vetën e parë dhe autori është pjesëmarrës në ngjarje. PO

Shkruani dy karakteristika të tekstit rrëfimtari që dalloni në këtë rrëfim.

- Përdorimi i foljeve në kohën e shkuar.
- Rrëfimet në vetën e parë
- Ka një denduri të lartë foljesh, të cilat përdoren për të përshkruar veprimet, mendimet dhe ndjenjat.
- Përdoren fjali të shkurtra, ose të gjata, të cilat shërbejnë për ta çuar rrëfi min përpara, për të shtuar hollësi dhe për të bërë përshkrime.

Kur përshkruan vendin e rrëfimit, autori shprehet: “...ky vend me njëqind emna...”.

Gjeni detaje të tjera që përdor autori për ta paraqitur me vërtetësi atë.

Argumentoni nëse ky këndvështrim është subjektiv apo objektiv.

Vini re dialogun në tekst. Çfarë ju bën përshtypje në replikat mes punëtorëve të kampit?

Nënvizoni fjalët dialektore të përdorura në paragrafin e tretë dhe kthejini ato në gjuhën standarde. (Bëni një tabelë, ku të paraqisni punën tuaj.)

Fjalët në dialekt	Fjalët në gjuhën standard
Rranxë	Rrëzë
Ushujzat	(krimb parazitar i ujërave të ëmbla, me trup unazor shumë të zhdërvjellët, që ushqehet me gjakun e kafshëve të ndryshme
Mushkajat	Mushkonjat
Dishiri	Dëshira
Rrotë druni	Rrotë druri
Kjartë	Qartë
Janë formue	Janë formuar
Gjysë	Gjysmë
Langut ///njanin	Lëngut////njërin

Në paragrafët e tekstit, foljet janë në kohën e shkuar. Shpjegoni cili është roli i një përdorimi të tillë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Ruaje fjalën e fundit për mua*

Si i kuptoni këta aforizma të At Zef Pllumit:

“Kur njeriut t’i mungojë zemra, nuk asht ma njeri.”

“Ziliqarit mos i trego as ëndrrën që ke parë”

“Njerëzit që kafshojnë dorën e atij që i ushqen, zakonisht lëpijnë këpucët e atyre që i godasin...!”

Nxënësit komentet e tyre rreth aforizmave të At Zef Pllumit i kanë shkrujtur në copa letre. Nxënësi që komenton citimin i fundit ka të ruajtur fjalën e fundit e pas tij nuk ka më komente të tjera

Nxënësit japin argumentet e tyre në diskutim

Informacion shtesë për mësuesin

1. **Të jesh mirë, padre** -- nga *Ardian Klosi* Po të ra në dorë ky shkrim, e përfytyroj se si do shkosh prej fronit ku kalon të shumtën e ditës gjer te tryeza anë dritares, ngadalë-ngadalë, në 5-fishin e kohës që të është dashtë 15 vjet më parë, kur të kam njohur. Këmbët mezi binden, edhe shikimi ka humbë thellë brenda syve, sadoqë shkëlqimi i tyre mbetet i zi e depërtues si përherë. Ke me marrë pastaj lupën mbi tryezë e ke me ia afrue gazetës për t’i shkoqitë gërmat një për një: “Të jesh mirë, patër Zef”. Shqiptarët e vjetër e thoshin këtë fjalë për falemnderës, edhe unë s’rri dot pa ta thënë, të shumëfishuar, në dy kuptimet e saj, sepse sapo mbarova edhe një herë së lexuari tre blenjtë e kujtimeve tua “Rrno vetëm për me tregue”, që së afërmi botohen në një vëllim të vetëm.

Kur doli së pari ky libër, këtu e para 10 vjetësh, e kam pasë lexuar titullin e tij: “Rro vetëm, për me tregue”, dmth. mos u përzje me të tjerë, në qoftë se do të rrëfesh. Por presja duhet vendosur ndryshe: “Rro, vetëm për me tregue”, e kjo bëhet e qartë qysh në faqet e para: Jeta e at Zef Pllumit, një jetë e kaluar trupërisht nëpër 9 rrathët e ferrit e shpirtërisht në ajrin këndellës të Besimit, ka kuptim sot vetëm për me u tregue.

Një titull që mendoj i ka lënë larg shumë lexues të mundshëm, sidomos ç’vinë nga Shkumbin e poshtë, me njohuritë e varfra që kanë sot qytetarët tanë për variantin letrar gegënisht të shqipes.

Por kjo për patër Zefin nuk ka ndonjë rëndësi, sepse ai rrëfen jetën e vet dhe atë nuk ka si e rrëfen ndryshe përveçse me gjuhën e Bogdanit e të Mjedës, Fishtës e Gjeçovit, Gjon Shllakut, Donat Kurtit e Martin Camajt. Zef Pllumi, edhe kur çon rrallë e tek meshë ose pagëzon ndonjë fëmijë miku, nuk përdor atë liturgji të përkthyer në toskërisht pa lëng nga do priftina të rinj, por vë lupën te sytë dhe këndon nga një ruzare e vogël e vjetër gjuhën e moçme siç e njohim qyshse u zbulua i pari dokument i shqipes 1462: “unë të pagëzonj për emnit Atit, Birit e Shpertit Shenjt”.

Tani që s’dal dot nga fryma e kujtimeve tua, padre, më bëhet sikur jetët tona, aq të ndryshme së jashtmi, janë nisë me u ndeshë, me u kryqëzue e me ecë bashkë paralel. Nuk qe çudi që na ke përkrahë menjëherë në ato idetë tona të panumërta në vitet 1991-92, në Lidhjen Albania, partinë KIS, gazetën “Libertas” etj. etj. Në kohën që përktheja “Premtimi i plotësuar. Dokumentim i persekutimit të klerit katolik në Shqipëri” nga Gjon Sinishta, për ta përhapur si samizdat më 1990 ndër miq e kolegë, ti kishe filluar një dokumentim shumë më të gjerë e të plotë, nga Arkivi i madh i kujtesës tënde, diku te hauri i motrës Gjeorgjinë prapa rrugës Fortuzi. Paradoks, sepse kur linda unë mes të mirave në kryeqytetin e tiranisë, ti mbaje ndezur mes skamjes atë pak flakë të lirisë fetare në famulli të Shoshit e thellë në Dukagjin, e parrizi i fëminisë sime ishte koha kur për ty po hapeshin portat e Ferrit për herë të dytë, epoka e revolucionit kulturor. Lexova te vëllimi i tretë se si të arrestuan në Malësi të Madhe, kur po kërkoje një rrugë arratie për veten e për Dom Nikollë Mazrekun, se si të prunë në fshatin Tamarë e aty të mori gazi i degës për të të sjellë te hetuesi në Shkodër: Më hyri një dridhmë! Në atë kohë, verë ka qenë, fund i viteve ?60, edhe unë, fëmijë, vija me gazin

e degës në Tamarë nëpër luginën e Cemit. Shkoja në ndërtimin e rrugës së Malsisë së Madhe, pionier entuziast për të ndihmuar motrën në brigadat vullnetare... Stemat me "S" në kraharorin e saj, më kishin lënë përshtypje aq të thellë sa nuk rrija dot pa e marrë dhe unë një të tillë. Në Shkodër, natyrisht që u vu në dispozicion makina më e sigurt për të çuar në Tamarë djalin e shokut Filan. E ndoshta po ky Gaz nuk kthehej bosh, por merrte të lidhur me hekura at Zef Pllumin për në hetuesi të Shkodrës, ku do të fillonte kalvari i

2. 22 vjetëve të tjerë burg.

E di, padre, që këto paralele e kryqëzime janë mbase thjesht fantazi ose dëshira. Por mund të ketë edhe një grimë zilije brenda, kur shoh jetën tënde të derdhur në këta tre libra dhe gjej aq shumë kuptim në të. Aq sa nuk gjej në shumicën tonë. Ne lindëm dhe u rritëm në një botë pa besim, ose me besime të rrejshme që kaq herë u detyruam t'i përmbysnim, t'i korrigjonim, sikurse bëjmë edhe sot e gjithë kohën. Kurse ti u rrite në një besim që vinte nga shekujt e që për më tepër kishte rritur të vetmet filza të qytetërimit në Shqipëri. Fakti që këtij besimi iu vërsulën qysh më 1944-45 me zjarr e me hekur për ta shqybur krejt, e bëri atë veç më të thellë, sikurse e bëri martirizimin tuaj gurin më të rëndë e më të rëndësishëm të historisë së feve në këtë vend. Po jetojmë një kohë kur kanë vërshyer në shtypin dhe botimet tona lumenj, përrenj e gjiriza kujtimesh, shumica rrena dhe vetdilizime. Nuk kam asgjë kundër dëshirës normale të njeriut për t'i dhënë një kuptim jetës së vet të hallakatur diku nga fundi, por e kam të vështirë t'i lexoj sepse më mungojnë aty faktet dhe çastet. "Jam kloun, - thotë personazhi i njohur i Hajnrih Bëlit – dhe koleksionoj çaste". Nuk ka rrugë tjetër për të përballur sulmin e fjalëve tymtuese që po na merr frymën çdo ditë. Besoj se i këtij mendimi je edhe ti, patër Zef, që patjetër i don klounët shumë, sepse në kopertinën e librit të tretë shkruan për veten: "Thonë se asht i marrë e nuk rrin me deké rehat".

Tek ti, padre, faktet dhe çastet janë aq të shumta sa m'u desh një muaj të të rilexoj.

Po, edhe më shumë se një muaj, sepse ato çaste makthi dhe lumturie, torture fizike dhe shpirtërore kanë nevojë për pushime, për pak ajër të pastër nga e tashmja. Vetëm se s'vonon shumë dhe të tërheqin prapë mbrapsht. Libri yt patjetër që nuk i ka rreshtur diskutimet e pafundme tek ne për Luftën N-Ç, për Luftën Civile, për luftën e klasave dhe për tiranin më të madh në shekujt e Shqipërisë, Enver Hoxhën. Për shembull, mënyra se si përshkruan ti hyrjen e brigadave partizane në Shkodër më 1944 i ngjan pak një çlirim dhe shumë një pushtim. Ja disa fragmente: "29 nandori gdhini ditë e zymtë dhe e ftohtë. Në orën 10-11 nëpër rrugët kryesore të qytetit hyni brigada partizane e prime prej major Gjin Markut. ushtria partizane, e veshun me gjithnduer uniformash të hueja, paraqitej si një ushtri e parregullt, leckamane, me opinga dhe e untë... Populli i strehoi, i ushqeu dhe u mbush me parazitë. Por nuk ishin rob Zotit: këqyrshin me tinzi nëpër shpija nëse mund gjejsin ndonji "reaksonar" të mshehun. E para punë që banë qe vumja në funksionim e burgjeve, të cilat u mbushën plot e përmajë me njerëz të pafajshëm. Menjherë filluen të shpërndahen fjalë: kanë vra X-in o Y-in... Shkodra u mbush me brigada partizane dhe çuditej se nga erdhën aq shumë ushtarë sa nuk i kishin pasë as ushtritë e hueja! Partizanët thojshin se kishin ardhë për të ndjekë gjermanin deri në Berlin, por ishin pa këpucë ndër kambë. Në përgjithësi ishin njerëz me të cilët nuk mund të flitej, me sjellje të këqija: hajshin bukën e përmyshshin kupën. Shumë ushtri të hueja kishte pa Shkodra, por si këtë kurrnji jo... Flamujt e shumtë tringjyrësh jugosllavë valaviteshin në çdo rrugë, në çdo ndërtesë shtetnore e në çdo shpi... Shtoheshin kontrollet, shtoheshin të burgosunit, shtoheshin torturat, shtoheshin pushkatimet. Ndërsa pothuej për çdo natë, mbasi errej, turma të organizueme silleshin nëpër rrugë tue u çjerrë me tërbim me kangët terroriste "Hakmarrje Rini!"...Jo vetëm qyteti, por edhe katundet përreth pësuen të njajtën fatkeqsi. Vërtet: asnji pushtim i huej nuk kishte veprue kështu mbi shqiptarët."

Në kujtimet e ndonjë ish-komandanti partizan patjetër që do ta gjejmë "të vërtetën" ndryshe. Aty tregohet se si i priti me brohorima çlirimtarët populli i Shkodrës, se si vërtet u morën masa të rrepta ndaj kundërshtarëve, por këta kishin qenë të gjithë bashkëpunëtorë të pushtuesit etj. etj.

Prandaj, padre, unë mbledh çastet te ty dhe ato çaste nuk më lënë të qetë ditë e natë, derisa në këtë vend të vendoset më së fundi njëfarë drejtësie historike. Çastet kur rrije i varur te pema e pjeshkës, ajo shtyllë e Pilatit në oborr të Pjetër Çurçisë, ku ishte vendosë Sigurimi i shtetit.

Të lanë lidhur në pemë me litarin nën sjetull e këmbët që nuk preknin dot tokën për net të tëra në cikmën e dhjetorit. Shokët e tu priftërinj ose jo rrinin dhe ata varur kush nën parmakë të shkallëve e kush mbi ËC, Guljem Sumën e kishin rrasë te një raft tepër i ngushtë për trupin e tij të madh, prej dy muajsh, me fytyrë nga muri derisa vdiq. Çasti padre kur lexove te muri i ËC-së mbishkrimin "Un Dom Vlash Muçaj këtu më 22 korrik piva urinën time për mos me deké etjet". Ose çastet pa mbarim të

Frano Kirit, që më vonë do të pushkatohej, i cili kaloi dy ditë e dy net lidhur me zinxhirë me një të vdekur. Më ther mes shpatullave, mik, kur shoh atë kapterin që të bie me hu po në një vend te kurrizi derisa shkopi lagshtitet me gjak dhe mendja të turbullohet nga dhimbja.

Kur të takova para dy javësh në Kuvendin Françeskan te Arra e madhe më the se shumë gjana nuk deshe me i futë në libër a se janë të pabesueshme për njerëzit sot a se janë tepër të randa me i shkruie, si çastet kur i shponin pulpën e kambës njerit me shtizë...

Po e le këtu se është e pamundur të ritregohen çastet e jetës dhe të vetmisë tënde. Ti i shkove së keqes deri në fund, për të realizuar profecinë e fratel Gjon Pantalisë, siç e ritregon nga viti 1947: "Fra Zef, mos mendo se kjo murtajë kalon shpejt. Ti je i ri. Kleri Katolik do të shkojë "usque ad unum" (deri në fund), vetëm atëherë do të vijë liria. Ti do t'ia mbrijs asaj dite dhe ti do të tregojsh të vërtetën për të kaluemen e të sotmen. Kështu jam i bindun un".

"Rrno vetëm për me tregue" është "Arqipelagu Gulag" i Shqipërisë; vërtet nuk ka autori teknikën e lartë të mjeshtrit rus, por arqipelagu i tij shqiptar është edhe më i shtrirë në kohë, plot 45 vjet. Dhe nuk është vetëm pasuria e detajeve, fakteve, çasteve që e mban fort paralelen, por pikësëpari humanizmi i birit të Françeskut, i cili di ta zbulojë njeriun edhe te një komisar edhe te një hetues dhe di të falë.

Dëgjova këto ditë një propozim që pater Zefi të shpallet "Nder i kombit". Them se është i tillë që tani, pa ndonjë dekoratë konkrete, e në qoftë se do të ketë një të tillë, le të quhet më mirë "Nderi i kombit dhe i fesë". Nocioni abstrakt i kombit, aq më shumë i këtij kombit tonë kaq të tollovitur dhe të hapërdarë, nuk do t'i kish dhënë kurrë forcën që i dha feja e tij. Tani e di që të lodha, padre, lene thjertzën mënjane, kthehu prapë në fron. Dhe të lutem rri i marrë e mos dis rehat deri në fund, për të mirën tonë.

Përmbledhje

"Rrno vetëm për me tregue" është "Arqipelagu Gulag" i Shqipërisë; vërtet nuk ka autori teknikën e lartë të mjeshtrit rus, por arqipelagu i tij shqiptar është edhe më i shtrirë në kohë, plot 45 vjet. Dhe nuk është vetëm pasuria e detajeve, fakteve, çasteve që e mban fort paralelen, por pikësëpari humanizmi i birit të Françeskut, i cili di ta zbulojë njeriun edhe te një komisar edhe te një hetues dhe di të falë.


Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën hulumtuese mbi jetën dhe veprën e at Zef pllumit, për analizën e veçorive dhe karakteristikave të një teksti rrëfyes etj

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni dhe sillni në klasë informacion për periudhën e diktaturës në vendin tonë. Diskutoni në klasë, duke u ndalur edhe në frazat: "... për nderë të shokut Stalin të bajmë edhe një gjysë ore sulm pune!"; "Për nderë të shokut Tito, një gjysë ore sulm vullnetar

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Kryefjala		Situata e të nxënit: Puna me tekstin	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës-Sintaksë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: kryefjala; zgjerim; zvogëlim; lidhja me kallëzuesin; grupi i kryefjalës	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon kryefjalën në fjali; - zvogëlon dhe zgjeron grupin e kryefjalës në fjalitë e dhëna; - ndërton një tekst argumentues duke përdorur kryefjalë të ndryshme. 			

Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: Gramatika e gjuhës shqipe 2	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi; kllaster; pyetja sjell pyetjen; punë individuale; punë në çift</i>	
Organizimi i orës së mësimit: <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stuhi mendimi, kllaster</i>	
<p>- <u>C’ dini për kryefjalën?</u> <i>Gjendet me pyetjet kush? cili/a? cilët/ at</i></p> <p><i>është gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë</i></p> <p><i>përshtatet me kallëzuesin në numër dhe në vetë</i></p> <p><i>shprehet me emra, përemra,</i></p> <p><i>fjalë të emëruara, grup fjalësh</i></p> <p><i>është gjymtyrë kryesore në grupin emëror</i></p> <p><i>të kryefjalës</i></p> 	
<i>mund të zgjerohet me fjalë të ndryshme ka rend të lirë në fjali nuk është e domosdoshme në fjali kur është e nënkuptuar</i>	
3. Dalloni kryefjalët dhe përcaktoni me se janë shprehur.	
<p><u>Stresi</u> (emër) i kapi dorën dhe me vështirësi i gjeti pulsën. <u>Ai</u> (përemër vetor) punonte. – Thirre njërin nga gratë, – i tha <u>Stresi</u> (emër) me zë fare të ulët ndihmësit. <u>Tjetri</u> (përemër i pacaktuar) doli dhe u kthye pas pak bashkë me një grua. <u>Stresi</u> (emër) e la dorën e plakës dhe me po ata hapa të kujdesshëm iu afrua krevatit ku ishte shtrirë <u>Doruntina</u> (emër). Tani i dalloi flokët e saj të verdhë mbi nënkrejse. Në zemër ndjeu një sëmbim, por <u>ai</u> (përemër vetor) rrinte disi mënjane, i papërzier me ngjarjen që posa kishte ndodhur. Ishte një sëmbim i vjetër, <u>që</u> (përemër lidhor) kishte lidhje me dasmën e saj, tre vjet më parë, atëherë kur <u>ai</u> (përemër vetor), <u>Stresi</u>, në çastin që <u>ajo</u> (përemër vetor) po largohej hipur mbi kalin e bardhë të nusërisë, midis karvanit të krushqve, kishte ndier një pikëllim të tillë në zemër, saqë gati kishte pyetur veten me zë: po ç’kam kështu? Ishin <u>të gjithë</u> (përemër i pacaktuar) disi të pikëlluar dhe jo vetëm nëna e vëllezërit, por krejt gjindja, (grup fjalësh) sepse <u>ajo</u> (përemër vetor) ishte e para vajzë <u>që</u> (përemër lidhor) martohej kaq larg, mirëpo pikëllimi i <u>Stresit</u> (emër) ishte i një natyre të veçantë. Dhe në ato çaste që <u>ajo</u> (përemër vetor) po ikte, <u>ai</u> (përemër vetor) befasi e kishte kuptuar se <u>ajo ndjenjë</u> (grup emëror) e ëmbël, <u>që</u> e kishte pushtuar kohët e fundit për të, s’kishte qenë veçse dashuri. Por <u>ajo</u> (përemër</p>	
<p><u>vetor</u>) kishte qenë një dashuri tjetër lloj, e holluar si mjegulla mbi një hapësirë të pamatë, e padendësuar asnjëherë, e frenuar prej tij qetësisht. Ishte si vesa e mëngjesit, kishte rënë vetëm minutat e para të zgjimit dhe pastaj, në orët e tjera të ditës dhe të natës që tërhequr përgjithmonë. Dhe i vetmi çast kur <u>ajo mjegull</u> (grup emëror) kaltëroshe qe përpjekur të dendësohej e të krijonte një re, ishte çasti i ikjes së saj. Por <u>ai</u> (përemër vetor) kishte qenë çast i shkurtër, <u>që</u> (përemër lidhor) ishte harruar shpejt. Në këmbë para shtratit të saj, <u>Stresi</u> (emër) vështroi një copë herë fytyrën e Doruntinës. Ishte po aq e bukur si atëherë, në mos më tepër, me atë vijën e buzëve <u>që</u> (përemër lidhor) ia bënte ato të rënda dhe të lehta njëkohësisht. – Doruntinë, – i foli <u>ai</u> (përemër vetor) me zë fare të ulët, – <u>ti</u> (përemër vetor) ke mbërritur mbrëmë pas mesnate, apo jo? <u>Ajo</u> (përemër vetor) bëri një “po” me sy. <u>Stresi</u> (emër) deshi ta shtynte edhe pak pyetjen <u>që</u> (përemër lidhor) e mundonte, por <u>ajo</u> (përemër vetor) i doli vetvetiu: – Po <u>kush</u> (përemër pyetës) të sollti?</p>	
<p>** të gjithë, dhe jo vetëm nëna e vëllezërit, por krejt gjindja... => Një vend të veçantë midis gjymtyrëve homogjene këpujore zënë ato gjymtyrë që bashkohen me anë të lokucioneve lidhëzore të bashkëlidhura të shkallëzimit jo vetëm... por (edhe); jo vetëm po as (edhe); le...po edhe...; le...po as.</p>	
4. Zgjeroni grupin e kryefjalës me jo më pak se dy përcaktorë.	
<p>Lajmi i ri për ngjarjen u përhap me shpejtësi. Libri i vjetër me tregime ishte ende i hapur në faqen e parë. Topi i parë i ndeshjes përfundoi në rrjetë. Kjo shtëpi e vjetër stërgjyshore duhet lyer. Çdo ditë të jetës sate duhet të mësosh diçka të re.</p>	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtimi 5-fq.305	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Flasin Tema mësimore: Demokracia dhe të rinjtë		Situata e të nxënësve: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënës. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - diskuton për demokracinë, vlerat dhe sjelljet demokratike; - harton pyetje rreth fragmenteve të përzgjedhura nga esetë e nxënësve; - komenton me argumente rreth fragmenteve. 		Fjalët kyçe: Demokrati Vlera Sjellje	
Burimet: Teksti i nxënësit “Libri i esëve/ Edicioni 2008, Një mundësi më tepër” Përmbledhje e punimeve më të mira. Nga konkursi me ese për nxënësit e shkollave të mesme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Të nxënësve në bashkëpunim, Turi i Galerisë</i>			
<p>Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: bashkëbisedim</p> <p>Demokracia (gr. <i>demo</i> - popull, <i>kraci</i> - rend) është një formë qeverisjeje në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre ose drejtpërdrejtë, nëpërmjet referendumeve, ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve</p> <p>Demokracia është një proces, formë e bashkëjetesës dhe e bashkëpunimit. Është formë e evolucionit të vazhdueshëm, e jo formë statike. Nga qytetarët kërkon bashkëpunim, kompromis dhe tolerancë.</p> <p>Një aspekt tjetër i rëndësishëm i shoqërisë demokratike është roli i ligjit. Në krijimin e ligjit merren këshillat zgjedhëse legjislativë. Ligji është një mjet, me të cilin qeveriset shoqëria demokratike.</p> <p>Në shoqërinë demokratike ligji duhet të trajtojë të gjithë qytetarët si të barabartë, pa marr parasysh racën, prejardhjen apo pikëpamjet politike. Nuk mund të ketë privilegj të veçantë për personat e zgjedhëse në funksionet qeveritare, për njerëzit e pasur apo kushdo tjetër. Sepse, demokracia është proces, e jo prodhim i gatshëm, ndaj, shoqëritë demokratike bëjnë një revizion të përshtur të ligjit, që të mënjanojnë padrejtësitë dhe të garantojnë një trajtim të barabartë për të gjithë.</p> <p>Diskutojmë së bashku</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Të nxënësve në bashkëpunim</i></p> <p>Ndaj klasën në grupe</p> <p>Fragmentet e mëposhtme janë shkëputur nga përmbledhja me ese “Ç’është demokracia për mua”, në të cilën të rinjtë nga e gjithë Shqipëria kanë shprehur mendimet e tyre.</p> <p>Komentoni fragmentet duke u dhënë përgjigje pyetjeve anash.</p> <p>Shtoni nga një pyetje tjetër për secilin fragment</p>			

Grupi 1

<i>Thënia</i>	<i>Komenti im</i>
Demokracia nuk garanton barazinë e kushteve, por barazinë e mundësive. Demokraci për mua do të thotë mungesë e krimiit dhe e dhunës. Janë dy faktorë që dëmtojnë rëndë shoqërinë. Një shtet i organizuar duhet t'i kufizojë dhe t'i ketë nën kontroll këto ngjarje të padëshirueshme duke mos hapur më plagë në shoqëri. Demokraci për mua do të thotë drejtësi, ku gjithçka gjykohet sipas ligjeve demokratike, ku çdo njeri merr meritën e vet. Të studiojë aty ku do, të jetojë në vendin që pëlqen dhe ashtu siç dëshiron	

Grupi 2

<i>Thënia</i>	<i>Komenti im</i>
Demokracia është qeverisje nga populli, qeverisje e drejtë, qeverisje në të mirë të popullit, qeverisje që sjell zhvillim, qeverisje që nxit vlerat, qeverisje që i jep mundësi të barabarta çdo qytetari	

Grupi 3

<i>Thënia</i>	<i>Komenti im</i>
Nocioni demokraci ka të bëjë me këto pika: sovranitet i popullit, pushtet i shumicës, respektim i të drejtave të pakicës, barazi përpara ligjit dhe zbatim i ligjit, pluralizëm, tolerancë, bashkëpunim dhe kompromis. Çdo individ i kësaj shoqërie nuk mund të kërkojë të drejtat e tij, pa realizuar detyrat e tij, sepse çdo gjë së pari fillon nga vetja, pastaj kërkohet nga të tjerët. Në të kundërt, shteti demokratik nuk ekziston.	

Grupi 4

<i>Thënia</i>	<i>Komenti im</i>
E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur shihet çdo ditë, pasi fushata zgjedhore çuditërisht, ndoshta pa të drejtë, përfshin edhe moshën tonë. Shoh mitingjet e partive të shumta politike, fotot e retushuara të kandidatëve për deputetë që mbulojnë faqet e mureve me suva të prishura. Shikoj Kukësin të mbushur me njerëz, shoh lëvizje makinash të mbuluara me foto, shoh tabela partish të mbushura me numra	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Turi i Galerisë Punimet e grupeve ekspozohen në muret e klasës. Nxënësit i lexojnë ato dhe i diskutojnë së bashku Anëtarët e grupeve argumentojnë mendimet në komentet e bëra dhe zgjedhin grupin fitues
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për argumentet e dhëna gjatë diskutimit dhe për pjesëmarrje aktive në proces.
Detyrat dhe puna e pavarur: Bëj një ese me temë: Demokracia në vendin tim

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Hallka e munguar në zinxhirin e evolucionit		Situata e të nxënit: Çfarë dini për Darwinin <i>Një orë më parë mësuesilja u ka thënë nxënësve të hulumtojnë rreth jetës së Darwinit, Teorisë së Evolucionit</i> (Shiko informacionin shtesë për mësuesin!)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - hulumton rreth Darwinit dhe Teorisë së tij të Evolucionit; - diskuton rreth prejardhjes së njeriut; - identifikon karakteristikat e tekstit shpjegues –informues; - zbulon tiparet gjuhësore të tekstit shpjegues –informues. 		Fjalët kyçe: Tekst shpjegues –informues Shkencëtar Specie Fosile Afrika	
Burimet: Teksti i nxënësit http://www.arkivalajmeve.com/Hallka-e-munguar-ne-zinxhirin-e-evolucionit.1046846767/ ballkanweb		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, TIK	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Stuhi mendimi, Punë në dyshe, Shënime të strukturuar*

Organizimi i orës së mësimimit
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:

The diagram illustrates the connection between the 'TEKSTI SHPJEGUES - INFORMUES' (Explanatory - Informative Text) and several key aspects of the learning process:

- Paraqet informacione, data dhe lajme, duke i shpjeguar në mënyrë të qartë dhe korrekte** (Presents information, data and news, explaining them clearly and correctly) → **Çdo paragraf i tij përmban informacion** (Every paragraph contains information)
- Përdoret gjuha standarde** (Standard language is used) → **Shoqërohet me ilustrime grafike, si: fotografi, skica, harta,** (Associated with graphic illustrations, such as: photos, sketches, maps, etc.)
- Leksiku përmban fjalë teknike.** (The lexicon contains technical words.) → **Leksionet (e dëgjura), lajmet, artikujt, njoftimet, memot, broshurat, fletëpalosjet, CV-të, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, relacionet, letrat zyrtare, njoftimet, ftesat, shpalljet, telegramet, etiketat,** (Lessons (heard), news, articles, notices, memos, brochures, leaflets, CVs, verifications, requests, reports, minutes, relations, official letters, notices, invitations, announcements, telegrams, labels, etc.)
- Nuk përdoret gjuha figurative** (Figurative language is not used)
- Rendi i gjymtyrëve në fjali është kryesisht ai i zakonshmi** (The order of parts in the sentence is mainly the common one)
- Koha e foljeve: e tashme dhe e shkruar** (Verb tense: present and written)
- Informacioni jepet në formë të folur ose të shkruar** (Information is given in spoken or written form)

Ndërtimi i njohurive të reja:

Në këtë fazë të orës së mësimimit nxënësit do të lexojnë zinxhir pjesën dhe më pas do të punojnë me zbërthimin e aparatit pedagogjik që është në tekst.

Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Çfarë zbuluan shkencëtarët? Një specie paraardhëse e njeriut

Ç'rëndësi kishte ky zbulim për njerëzimin? Zbulimi ishte një hallkë e munguar në zinxhirin e evolucionit njerëzor

Ku dhe kur u prezantua specia e zbuluar? “Në “Burimin e Njerëzimit” në Maropeng, rreth 40 kilometra larg Johannesburgut.

Çfarë kishte të veçantë ajo? Specia e porsazbuluar, e quajtur Australopithecus Sediba, ecte duke e mbajtur trupin drejt.

Çfarë tha profesor Bergeri lidhur me zbulimin? Për të ishte një zbulim i papritur, tronditës.

Sa vite më parë mendohet të kenë jetuar homonidët e zbuluar? 1.9 milion vjet më parë

Si ishte gjendja e fosileve të gjetura? Fosilet ishin në gjendje shumë të mirë.

Si dubet të ketë qenë pamja fizike e species së zbuluar? Me krahë të gjatë si majmun, duar të shkurtra të fuqishme, një legen tepër të zhvilluar e këmbë të gjata në gjendje të ecnin apo të vraponin si njeri.

Ç'rëndësi kishte ky zbulim për kontinentin afrikan sipas presidentit Motlanthe? Afrika, pas këtij lajmi, sipas presidentit, do të ishte vendi ku ishin shfaqur për herë të parë fillesat e racës njerëzore, pra vendi i zanafillës së racës njerëzore

Cili prej informacioneve të mëposhtme është kyç, lidhur me kuptimin e pjesës.

a. Këta homonidë, të cilët kanë jetuar 1,9 milionë vjet më parë.

b. Ata përfaqësojnë një specie deri më sot të panjohur të paraardhësve të njeriut.

c. Specia e porsazbuluar, e quajtur Australopithecus Sediba, ecte duke e mbajtur trupin drejt.

d....ky zbulim ishte një ndër provat e shumta që tregojnë se raca njerëzore e ka zanafillën në kontinentin afrikan

Vendosni frazën: “i përbërë nga më se 60 shkencëtarë” në njërin prej kutive që shihni në tekst. Tregoni kujdes për ta përshtatur nga ana kuptimore në fjalinë e duhur.

Kreu i ekipit kërkimor, të përbërë nga më se 60 shkencëtarë, profesor Li Berger tha se ky ishte një zbulim me të vërtetë tronditës.

Cili mendoni se është kuptimi i fjalës me shkronja të zeza në këtë fjali:

“Këta homonidë, të cilët kanë jetuar 1,9 milionë vjet më parë, janë në gjendje jashtëzakonisht të mirë.”

Plotësoni pohimet e dhëna për tiparet gjuhësore të tekstit:

Leksiku i këtij teksti përmban fjalë të fushës së biologjisë: specie, zinxhir i evolucionit njerëzor, fosile etj.

Fjalitë e këtij teksti janë të përbëra nënrenditëse filluese...

Foljet janë përdorur kryesisht në kohën e shkuar...


Gjuha është standarde, korrekte dhe objektive...

Citohen fjalët dhe thëniet e personave të rëndësishëm...

Detajet përshkruese kanë si funksion informimin...

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shënime të strukturuar

Plotësoni hartën kuptimore të këtij teksti, duke shtuar informacione të tjera rreth temës dhe duke nxjerrë konkluzione rreth



Nxënësit shtojnë dhe informacione të tjera në këtë hartë. Ata diskutojnë pas mbarimit të punës duke vlerësuar saktësinë e punës së tyre dhe të shokëve.

Informacion shtesë për mësuesin

Charles Robert Darwin Charles R. Darwin Angli më 12 shkurt të vitit 1809. Ai ishte fëmija i pestë nga gjashtë fëmijët e doktorit dhe financierit të pasur Robert Darwin dhe Susannah Darwin. Studioi në Universitetin e Edinburgut. Ai asistoi kërkimet shkencore të Robert Edmunt Grant mbi anatominë dhe ciklin e jetës së gjallesave jovvertebrore detare në Firth of Fort. Në mars të 1827 ai paraqiti përpara Plinian Society zbulimin e tij mbi mënyrën e riprodhimit të shushunjave.

Mungesa e disiplinës së Charles Darwin në shkollë, bëri që babai i tij ta dërgonte në Kolegjin e Krishtit në Kembrixh për diplomim në Bachelor of Arts.

Aty filloi të i kushtohej botanikës. Më 27 dhjetor, 1831 filloi udhëtimi i Beagle. Udhëtimi zgjati plot pesë vjet. Ishte natyralist anglez, pjesëtar i Royal Society, që themeloi Teorinë e Evolucionit sipas së cilës të gjitha krijesat zhvillohen me kalimin e kohës.

Sipas tij zhvillimi i krijesave të gjalla që ndanin midis tyre të njëjtin paraardhës, ishte rrjedhojë e një procesi të quajtur Seleksionimi natyror (përzgjedhja natyrore). Evolucioni dhe seleksionimi natyror ishin një ide shumë përparimtare për kohën dhe pavarësisht nga kritikata dhe debatet e shumta mbi të, shumë shkencëtarë dhe njerëz të thjeshtë të kohës e pranuan atë si fakt.

Megjithatë vetëm me themelimin e Sintezës Moderne Evolucioniste nga vitet 1930 deri më 1950, u pranua se selektimi natyror ishte mekanizimi bazë i evolucionit.

E thënë ndryshe zbulimi shkencor i Darvinit është teoria bashkuese e shkencës natyrore duke shpjeguar diversitetin (larminë) e gjallesave.

Libri i tij publikuar në 1859 “Mbi origjinën e llojeve” (origjinali: “On the Origin of Species”) themeloi evolucionin si shpjegimi më i saktë shkencor mbi diversitetin në natyrë të jetës. Ai ekzaminoi evolucionin njerëzor dhe selektimin/përzgjedhjen seksual/e në librin e tij “Mbi prejardhjen e njeriut dhe selektimi në lidhje me seksin” (origjinali: “The Descent of Man, dhe Selection in Relation to Sex), libër i ndjekur nga libri tjetër “Shprehja e emocioneve tek njerëzit dhe kafshët.” (origjinali: The Expression of the Emotions in Man and Animals”).

Kërkimet e tij të mëtejshme mbi bimët u publikua në një seri librash të ndryshëm, ndërsa libri i tij i fundit bënte fjalë për krimbat e tokës dhe efektet e tyre mbi tokën bujqësore.

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për dallimin e karakteristikave të tekstit shpjegues –informues, diskutimin për prejardhjen e njeriut etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Kërkoni në internet, revista apo enciklopedi për zbulime shkencore të rëndësishme, të cilat kanë luajtur rol qendror në historinë e vendeve dhe atë të njerëzimit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Kundrinori		Situata e të nxënësve: Puna me tekstin	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore-Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: kundrinor i drejtë, i zhdrejtë; trajtë e shkurtër; parafjalë; fjalë drejtuese	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon kundrinorin në fjali; - përcakton llojin e kundrinorëve të përdorur në fjali; - ndërton fjali duke përdorur lloje të ndryshme kundrinorësh. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: Gramatika e gjuhës shqipe 2		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e drejtuar; pema e mendimit; punë individuale; punë dyshje</i>			


Organizimi i orës së mësimi:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: punë e drejtuar;

Mësuesja shkruan një tekst në dërrasë dhe nxënësit dallojnë kundrinorët.

Ai ngriti dorën e djathtë për t'u bërë të ditur se nuk donte të dëgjonte më gjë prej gjëje. Me zemër të ngrirë si rrallë herë, ata dëgjuan vendimin që ai ua tha atyre me fjalë të thata dhe fare ftohtë. Piramida do të bëhej. Më e larta e të gjithave. Më madhështorja.

Ndërtimi i njohurive të reja: pema e mendimit



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale; punë dyshe

Punohen ushtrimet 1, 3 dhe 4 në mënyrë individuale.

1. Dalloni pohimin e saktë nga pohimi i gabuar.

*Kundrinori i drejtë mund të shoqërohet me parafjalë. X

*Kundrinori i zhdrejtë shoqërohet gjithnjë me trajta të shkurtra përemërore. X

*Të gjitha foljet kërkojnë një kundrinor. X

3. Ndërtoni fjali me foljet e mëposhtme dhe thoni sa kundrinorë mund të marrin ato.

*eci me vëllain (k.zh.m.p)

*i (k.zh.p.p) pranoj ftesën (k.i drejtë)

*u (k.zh.p.p) dërgoj letër (k.i drejtë)

*bubullin ----

*udhëtoj me tren (k.zh.m.p)

*pyes shokët (k.i drejtë) për rezultatit (k.zh.m.p)

4. Vendosni trajtat e shkurtra përemërore aty ku duhet. (punë individuale)

*Fëmijës *i* flihej.

*Nuk *e* di përse ajo nuk *i* flet më shoqes së vet.

**Më* hahet.

**U* tha të gjithëve të vërtetën pa *iu* dridhur qerpiku.

*Ç' *i* the babait kur u ktheve?

*Nuk *ia* dal mbanë dot me gjithë këto punë.

**E* lexove librin?

2- Dalloni kundrinorët dhe përcaktoni llojin e tyre. (punë dyshe)

Që nga veranda ku kishte dalë për të marrë ajër (kundrinor i drejtë) të freskët, atij i (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë) vinin zhurmat e lehta të shtëpisë. Po sistemonin dhomat. (kundrinor i drejtë) Nga kuzhina vinte një tringëllimë enësh. Ai solli ndër mend sytë (kundrinor i drejtë) e kapituri të mysafirit, pastaj xhyben (kundrinor i drejtë) e pluhurosur, në xhepat e brendshëm të së cilës kushedi ç'dokumente sekrete fshiheshin. Një grimë mbajti hapat (kundrinor i drejtë) si në përgjim.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5-fq. 307

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Zogjtë. Akrobatë, prijës dhe anëtarë të thjeshtë: ja rregullat e një tufe		Situata e të nxënësve: A flenë zogjtë gjatë fluturimit? Diskutojmë së bashku. (Shiko informacionin shtesë për mësuesin)	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - hulumton rreth jetës së zogjve; - diskuton për tufat e zogjve të cilët lëvizin në formë V-je; - dallon faktet që paraqiten në secilin paragraf (1-5); - nënvizon të gjitha fjalët apo frazat e gjuhës formale në shkrimin e dhënë; - analizon faktet që ngjallin interesa kërkimore në studimin e parë, të dytë e të tretë; - shkruan një tekst shpjegues-informues rreth një eksperimenti shkencor që e ka kryer në shkollë. 		Fjalët kyçe: Zogj Studiues Etologë Fizikanë Fluturime në tufa të mëdha Formacione Formë kaleidoskopike Luzma mizash	
Burimet: Teksti i nxënësit http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/01/17/fluturimi-zogjve-zbulohet-misteri-formacionit-v/ http://www.oranews.tv/article/fotot-e-mrekullueshme-te-fluturimit-te-zogjve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar, Të nxënësve në bashkëpunim, Diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimi: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Kur dëgjoni titullin e pjesës që do të lexoni “Zogjtë akrobatë prijës dhe anëtarë të thjeshtë: ja rregullat e një tufe, çfarë mendoni se do të lexoni?” <i>Në këtë fazë të parë gjithashtu diskutoj me nxënësit se çfarë shohin e çfarë u bën përshtypje në foton e dhënë?</i> <i>A dinë raste të tjera të ruajtjes së këtij rregulli, hierarkie, por jo vetëm të shpendët</i> Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Të nxënësve në bashkëpunim –Lapsat në mes</i>			
<p style="text-align: center;">Fjalët e reja</p> <p>etolog – studiues që merret me studimin e sjelljeve të kafshëve. dinamikë – lëvizjet e trupave. hierarki – këtu: rendi i përgjegjësive, nga më të ulëtat deri në më të lartat.</p>		<p style="text-align: center;">Fjalët e reja</p> <p>formacion – këtu: mënyra e vendosjes. kaleidoskopike – këtu: që të befason me pamjen. unison – në mënyrë të njëjtë; të centralizuar; të përqendruar. luzma – tufa.</p>	
<i>Ndaj klasën në grupe dhe analizojmë tekstin, pasi lexohet nga nxënësit.</i> Grupi 1. Plotëso hartën kuptimore			

Studimi 1
Universiteti i
Budapestit

Studimi 2
Fizikanët e Universitetit
La Sapienza

Studimi 3
Fizikanë në Romë

Citimi 1
“E megjithatë, hierarkitë janë të ndryshueshme dhe roli i çdo zogu të veçantë mund të ndryshojë pareshtur”,
“Ky sistem i ndër-këmbësish prijësish dhe vartësish në të cilin dhe hierarkitë më të ulëta kanë peshën e tyre dhe mund të japin ndihmesë, përbën një sistem shumë efikas për të marrë vendime

Citimi 2
“Në tufat shumë të mëdha, që grupojnë deri në dhjetë mijë individë, prishet çdo lloj sistemi udhëheqjeje”,
“Çdo tufë, merr si referim një grup të vogël individësh të tjerë, përgjithësisht gjashtë ose shtatë, jo domosdoshmërisht pranë tij. I mjafton të lëvizë në unison me ta për t’u bërë pjesë e një grupi unik. Krijohet kështu një sistem kontrolli i shpërndarë, ku mjafton të ndjekësh rregulla të thjeshta për të arritur një lëvizje kolektive shumë komplekse

Citimi 3
“Por këtë herë s’do të merremi me zogjtë, do të ndjekim mizat e vogla “

Paragrafi 1	<i>Studiuesit e Budapestit hetuan dinamikat e një tufe pëllumbash në fluturim, duke iu lidhur në shpinë një GPS të vogël 16 gramë dhe duke mbajtur shënim ndryshimet e kursit të fluturimit plot 5 herë në sekondë.</i>
Paragrafi 2	<i>Studimi hungarez botohet sot nga revista shkencore “Nature”.</i>
Paragrafi 3	<i>“Çdo mbrëmje, plot tre dimra rresht u ngjitem në çatinë e muzeut të Pallatit Massimo dhe fotografuam formacionet e tufave të zogjve”, – shpjegon Andrea Kavanja fizikani i Institutit të Sistemeve Komplekse të Këshillit Kombëtar të Studimeve dhe anëtar i projektit european “Superflag”.</i>
Paragrafi 4	<i>Studimi i tyre rreth formës kaleidoskopike të fluturimit të zogjve romanë është botuar në vitin 2008, në gazetën zyrtare të Akademisë Kombëtare të Shkencave të ShBA-së.</i>
Paragrafi 5	<i>Një grup fizikanësh në Romë ka marrë financim nga Instituti Italian i Teknologjisë në Gjenovë, por këtë herë do të ndjekin jo zogjtë, po tufat e mizave.</i>

Grupi 3 Nënvizoni të gjitha fjalët apo frazat e gjuhës formale në shkrimin e mësipërm:

P.sh.: merr si referim..., duke marrë shkas nga... ka nisur të hetojë, mund të gjendet zgjidhja më frytdhënëse formacion unison, të heqësh një paralele, ka marrë një financim


Grupi 4 A mbyllet pjesa me një konkluzion të qartë nga ana e shkencëtarëve? Argumentoni përgjigjen tuaj

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Në këtë fazë të orës së mësimin u kërkohet nxënësve të heqin në diskutimet e tyre me argument paralele midis botës së shpendëve dhe botës njerëzore.

Si e kuptoni frazën: “Të heqësh një paralele midis shoqërisë së njerëzve dhe tufave të zogjve është një objektiv që shkon përtej synimeve të kërkuesve.”

Nxënësit ndjekin rregullat gjatë diskutimit dhe japin mendimet e tyre të argumentuara. Ata vlerësojnë përgjigjet e shokëve dhe vetëvlerësohen njëkohësisht



Fotografi Shaun Kardinal ka fotografuar fluturimin e zogjve në koloni. Fotot e mahnitshme të qiellit tregojnë se si këta zogj bëjnë “rrugëtimin” e tyre së bashku dhe me një rregull habitës.

Burimi:

<http://www.oranews.tv/article/fotot-e-mrekullueshme-te-fluturimit-te-zogjve>

Informacion shtesë për mësuesin

Misteri se pse kaq shumë zogj fluturojnë në formacionin V, mund të jetë zgjidhur, thonë shkencëtarët. Ekspertët nga Britania e Madhe pajisën disa tufa zogjsh të rrallë, të cilët po stërviteshin për emigrim me pajisje të gjurmimit të vendndodhjes. Kjo zbuloi se zogjtë fluturonin në pozicion optimal – duke fituar lartësi nga zogu në ballë dhe duke qëndruar pranë majës së krahut të tij. Studimi i publikuar në revistën “Nature”, zbuloi gjithashtu se zogjtë koordinonin rrahjet e tyre të krahëve. Një eksperiment më i hershëm me pelikanë ishte i pari që zbuloi të dhëna mbi faktin se formacioni V mund t’u shërbente zogjve për kursimin e energjisë. Ai zbuloi se ritmi i rrahjes së zemrës së zogjve pakësohej kur ata fluturonin bashkërisht në formacionin V. Por ky studim i fundit gjurmoi dhe monitoroi fluturimin e çdo zogu në tufë, – duke regjistruar pozicionin, shpejtësinë, drejtimin, si dhe çdo rrahje krahësh. Kjo u bë e mundur nga një projekt unik konservimi i zbatuar në Austri, ku qenë mbarështuar një tufë zogjsh të species Geronticus Eremita, të cilët ishin stërvitur të migronin përmes një loje me drita. Qëllimi i këtij projekti të pazakontë ishte rikthimi i kësaj speciejë në kontinentin europian; zogjtë qenë shfarosur nga gjuetia, kështu që skuadra po i ritrajnonte zogjtë për të udhëtuar në shtegun e migrimit që sakaq është humbur. Duke i pajisur këta zogj me një mjet që transmeton të dhëna, këto specie në rrezik të madh zhdukjeje treguan se zogjtë shpesh ndryshonin pozicion dhe alternonin kohën e rrahjes së krahëve për të përfutur avantazh aerodinamik. Udhëheqësi i kërkimit, dr. Steven Portugal, shpjegoi: “Ata duket se janë shumë të vetëdijshëm, për faktin se ku gjenden zogjtë e tjerë në tufë dhe e vendosin veten në pozicionin më të mirë të mundshëm. Kjo bëhet duke shfrytëzuar ajrin shtytës për lart, të gjeneruar nga zogu në ballë. Kjo e ashtuquajtura “shtytje për lart” krijohet ndërsa zogjtë fluturojnë përpara; pavarësisht nëse po rrëshqasin apo po rrahin krahët, pozicioni shtyn ajrin poshtë krahëve të zogut. Shtytja për poshtë” është e keqe, shpjegoi dr. Portugal. “Zogjtë nuk duan të jenë në pikën kur zogu para tyre po rreh krahët për poshtë, sepse kjo gjë i shtyn edhe ato për poshtë. Por ndërsa ajri ngjishet përreth pjesës së jashtme të krahëve, ai krijon një shtytje për lart në majat e krahëve.” Kjo skemë jep një farë udhëtimi falas për zogun e radhës në formacion”, thotë dr. Portugal. “Kështu zogjtë e tjerë duan të vendosen pikërisht pranë majës së krahëve të zogut që gjendet para tyre për të përfutur.” Zbulimi tjetër me të vërtetë surprizues, thanë shkencëtarët, ishte që zogjtë e koordinonin rrahjen e krahëve në perfeksion për të përfutur maksimalisht nga ajri i lëvizur nga zogu përpara”. “Çdo zog mbante krahun e tij në lëvizjen sipër në ciklin e rrahjeve”, shpjegon dr. Portugal.

Fenomen natyror

Njësoj si zogjtë që kursejnë energji duke fituar lartësi nga flukset e ajrit të lëvizur nga zogjtë e tjerë, edhe shumë kompani që po zhvillojnë avionë apo helikopterë pa pilotë po shikojnë mundësinë e kopjimit të formacionit V, që kursen energji. “Zbulimi i më shumë të dhënave për këtë mekanizëm, në një farë mase mund të ndihmojë kompanitë të kuptojnë se si të mund ta kopjojnë atë në formacionet e tyre të mjeteve të fluturimit për të kursyer energji”, thotë dr. Portugal. Por për shkencëtarët, kjo njohuri mbi një fenomen mbresëlënës natyror është shumë interesant. “Formacionet V janë kaq të bukur”, thotë Adrian Thomas, profesor i biomekanikës në Universitetin e Oksfordit. “Ne i shohim ato gjatë të gjithë kohës dhe me të vërtetë duam të kuptojmë dhe të shpjegojmë se çfarë ndodh dhe kjo skuadër kërkuesish ka bërë shumë hapa përpara në këtë drejtim.” Dr. Portugal shtoi: “Ajo që këta zogj janë në gjendje të bëjnë është e mrekullueshme. Ata janë në gjendje të ndiejnë se çfarë po ndodh me zogun para tyre, ku ka ajër të mirë dhe nga po vjen ky ajër dhe të pozicionojnë veten në mënyrë perfekte. Nga pikëpamja e faktit se si e ndiejnë këtë gjë, është me të vërtetë diçka e pabesueshme.”

<p>A flenë zogjtë gjatë fluturimit? Disa zogj, si dallëndyshet, mund të fluturojnë pa u çlodhur për disa muaj dhe për mijëra kilometra. Dyshohej se ata flinin gjatë fluturimit, njësojë si delfinët kur notojnë, por kjo sjellje ende nuk ishte konstatuar. Tashmë, studimi i publikuar në revistën “Nature Communications” tregon se zogjtë jo vetëm që janë të aftë të flenë gjatë fluturimit, por dinë të ruajnë aftësinë për t’u orientuar në gjendjen REM. (Faza REM, është kur truri ynë përpunon të gjitha informacionet e ditës së kaluar. Ne e përjetojmë këtë fazë disa herë gjatë një nate (cikli i gjumit). Nëse ne zgjohemi gjatë fazës REM, mund të kemi pasqyrën më të qartë të ëndrrës që kemi pasur).</p>
<p>Mbështetur në fakte- Niels Rattenborg i institutit të ornitologjisë “Max Planck”, me disa kolegë të Universitetit të Zyrihut, ka projektuar një pajisje që është në gjendje të monitorojë aktivitetin elektrik të trurit të zogjve (me EEG), gjatë fluturimit. Ajo është aplikuar tek disa ekzemplarë, kryesisht tek zogjtë e ishujve Galapagos, që kalojnë shumë ditë në fluturim mbi oqean, në kërkim të ushqimit. Grupi i shpendëve fluturon për rreth 3000 km rrugë, pa u ulur kurrë në tokë. Kontrolli perfekt- Gjatë ditës zogjtë kanë qëndruar zgjuar, por me perëndimin e diellit, kur ata ndodhen në lartësi shumë të madhe, u konstatuase zogjtë bënë disa seanca gjumi, që zgjasnin vetëm pak minuta. Por edhe në këto momente, zogjtë arrinin të ruanin kontrollin aerodinamik.</p>
<p>me doza të vogla- Në disa raste, zogjtë futeshin në gjendje REM: në një fazë ku njeriu humbet kontrollin e tonit muskolor, por që në rastin e tyre nuk është e rrezikshme. Gjumi REM, zgjat vetëm pak sekonda edhe pse humbja e tonit të muskujve nuk “bie”, mbi kokën e zogjve. Kjo bën që ata të mos bien nga lartësia. Është e mundur që edhe tek zogjtë e tjerë, me rekorde fluturimit, zogjtë të mjaftohen me pak minuta gjumë. Ata mund të flenë 42 minuta.</p>
<p>Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për hulumtimin e bërë për mënyrën se si jetojnë zogjtë, për dallimin e fateve fakteve në paragrafët e dhënë, për dallimin e gjuhës formale të përdorur etj.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: Si shkruhet një CV(ora e parë).</p>		<p>Situata e të nxënit: Rekomandoj - Jap mendim të mirë me shkrim për dikë për cilësitë morale dhe aftësitë e dikujt. - Jap mendim të mirë për dikë tek dikush që ta marrë në punë a ta bëjë pjesë të diçkaje.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Të mësuarit për të nxënë</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon llojin e tekstit joletrar; - nxjerr karakteristikat dhe veçoritë e CV; - shkruan një tekst për qëllimin e kërkuar; - plotëson saktë me të dhënat e duhura një formular; - harton saktë një CV sipas modelit të dhënë; - shkruan një CV, duke ndjekur strukturën e shkrimit të një teksti të tillë. 		<p>Fjalët kyçe: Informacione Dokument Të dhëna Kandidat Strukturë Model</p>	

<p>Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Teknologji dhe TIK.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Sqarim termash, pyetje- përgjigje, organizuesi grafik, punë me tekstin, punë me modele, punë e pavarur, konkurs.</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>sqarim termash, pyetje-përgjigje.</i></p> <p>Mësuesi/ja shtron situatën: Duhet të rekomandoni një shok a shoqe për një punë a pjesëmarrje në një konkurs. Po çfarë kuptoni me fjalën “rekomandoj”? (<i>Jap mendim të mirë me shkrim për dikë për cilësitë morale dhe aftësitë e dikujt; Jap mendim të mirë për dikë tek dikush që ta marrë në punë a ta bëjë pjesë të diçkaje</i>).</p> <p>-Cilin do të rekomandoni? -Ku do të mbështeteshit për të bërë këtë rekomandim?</p> <p>Jepen disa përgjigje nga nxënësit dhe nxënësit e plotësojnë më me detaje situatën.</p> <p>Mësuesi/ja hedh çështjen: Po a e njih mirë shokun apo shoqen tënde të ngushtë ?!</p> <p>Çështja plotësohet e sqarohet me pyetje të tjera që kërkojnë përgjigje të ndryshme nga nxënësit:</p> <p>-Cili është shoku apo shoqja jote më e mirë dhe përse?</p> <p>-Përshkruaje shokun apo shoqen sipas tipareve fizike dhe karakterit. A ka diçka të veçantë që e dallon nga të tjerët?</p> <p>-Si e mendoni atë në të ardhmen? Çfarë mund të bëhet apo si mund të jetë fizikisht?</p> <p>Nxënësit japin mendime të ndryshme dhe janë të lirë të përgjigjen sipas ideve që kanë për shokët e shoqet e tyre.</p> <p>Përgjigjet për të ardhmen e shokëve duhet të argumentohen dhe të lidhen me aftësitë e tyre.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Organizuesi grafik, punë me tekstin.</i></p> <p>Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e mësimit: Si shkruhet një CV.</p> <p>CV-ja është një dokument që do të na duhet jo vetëm në të ardhmen kur duam të kërkojmë punë, por edhe kur duam të jemi pjesë e një konkursi apo duam të pranohemi në një shkollë.</p> <p><i>Curriculum vitae</i> ose CV, rrjedh nga gjuha latine dhe ka kuptimin “rrjedha e jetës”.</p> <p>Ndërtohen njohuritë për CV-në me anë të tabelës.</p>	
<p>Karakteristikat</p> <p>CV-ja zakonisht hartohet kur kërkon një punë.</p> <p>CV-ja është burimi i parë informues, kur punëdhënësi vendos nëse do ta shqyrtojë një kandidat për ta punësuar.</p> <p>CV-ja mund të jetë e shtypur në letër ose në format elektronik.</p> <p>Duhet hartuar me kujdes, në mënyrë që të jetë e thjeshtë dhe të konsultohet shpejt.</p> <p>Të dhënat të jenë të sakta.</p>	<p>Struktura</p> <p>Një CV e hartuar në formë të shkruar përmban informacione të ndryshme</p> <p>Disa janë të detyrueshme, kurse disa të tjera janë me dëshirë.</p> <p>Të dhëna të detyrueshme janë: të dhënat personale, adresa, numri i telefonit, arsimimi, përvoja në punë, niveli i njohjes së gjuhëve, niveli i njohjes së programeve të ndryshmeve kompjuterike.</p>
<p>Lexohet informacioni i dhënë për CV-në në tekstin e nxënësit dhe analizohet rasti i dhënë.</p> <p>Diskutohen rastet kur të dhënat jepen me dëshirë dhe shqyrtohen modelet e dhëna.</p> <p>Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë me modele, punë e pavarur, konkurs.</i></p> <p>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në mënyrë të pavarur me modelet e dhëna në tekst. Duke u mbështetur te struktura e dhënë, te modelet, nxënësit do të hartojnë nga një CV.</p> <p>Situata e krijuar për plotësimin e CV-së: Keni shumë dëshirë që të pranoheni në një shkollë të caktuar. Numri i nxënësve që do të pranohet është i ulët dhe konkurrentë ka shumë. Duhet të dorëzoni një CV pranë sekretarisë së shkollës. Ato çfarë do të shkruani janë informacione të detyrueshme, por ju jeni të lirë të plotësoni CV-në tuaj me të dhëna të tjera, sipas dëshirës të cilat ju mendoni se do t’ju shërbejnë që të pranoheni në shkollë.</p>	

<p>Mësuesi/ja orienton nxënësit se cilat mund të jenë të dhëna të shtuara me dëshirë: - aftësi në komunikim, menaxhimi i situatave, aftësi drejtuese të punës në grup, aftësi për sporte të ndryshme, zotësi dhe njohuri në degë të ndryshme të shkencës, pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kulturore e artistike etj.</p> <p>Nxënësit punojnë të lirë sipas udhëzimeve të dhëna nga mësuesi/ja. Ndërkohë mësuesi/ja krijon një grup me tre nxënës si juri e cila do të vlerësojë CV-të e nxënësve që do të konkurrojnë për t'u pranuar në shkollën e dhënë tek situata e mësipërme.</p> <p>Në formën e konkursit CV-të e nxënësve mblidhen dhe i dorëzohen jurisë. Juria bashkë me mësuesin/en vlerëson punimet e nxënësve dhe bën përzgjedhjen e nxënësit fitues. Nga juria argumentohen shkurt arsyet e përzgjedhjes së nxënësit fitues të konkursit.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimi. Nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Fotografi personale për CV-në.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Si shkruhet një CV (ora e dytë).		Situata e të nxënit: Gjërat më të rëndësishme. Në jetën tonë ka shumë gjëra që i quajmë të rëndësishme. A janë blerjet që bëjmë të rëndësishme? Kur në vendosim të blejmë një produkt, çfarë shohim? Çfarë na bën që të vendosim për ta blerë?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi dhe të shprehurit - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - nxjerr karakteristikat dhe veçoritë e CV; - shkruan një CV për qëllimin e kërkuar; - plotëson saktë me të dhënat e duhura një formular; - harton saktë një CV sipas modelit të dhënë; - dallon e krijon një CV në formë videoje. 		CV Dokument Informacione të sakta Strukturë Të dhëna të detyrueshme	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Teknologji dhe TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, KLASËR, punë me tekstin, punë e drejtuar.			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim.			
Mësuesi/ja në fillim tërheq vëmendjen e nxënësve duke i thënë se do t'u tregojë diçka të rëndësishme.			
Shtrohet çështje për diskutim: Po cilat janë gjërat e rëndësishme në jetën tonë?			
Në shkollë ne marrim shumë njohuri që na kthehen në shkollën tonë, por sa rëndësi ka shkollimi ynë?			
Mësuesi/ja pyet nxënësit: A ka rëndësi pamja e jashtme për ju? Kur i japin më shumë rëndësi pamjes së jashtme? Në cilat raste pamja e jashtme luan një rol të madh? Kur kërkojmë një punë dhe plotësojmë një CV a kërkohet foto?			
Përse mendoni duhet të jetë CV-ja e shoqëruar me foto? Kur duam të blejmë diçka çfarë shohim që të bindemi për ta blerë? A ka rëndësi pamja e jashtme e produktit apo paketimi? A ka rëndësi pamja e shitësit që ne të vendosim për të blerë diçka? Po mënyra e prezantimit të mallit a ndikon që ne ta zgjedhim atë për ta blerë?			

Nxënësit japin përgjigjet e tyre sipas mendimit që kanë dhe duhet ta mbrojnë me argumente të thjeshta duke dhënë edhe raste apo situata reale nga përvojat e tyre jetësore.


Mësuesi/ja përmbledh përgjigjet e nxënësve duke ndaluar në gjërat e rëndësishme që dalin gjatë diskutimit: jeta, shëndeti, miqësia, shkollimi, pamja e jashtme, shpirti i bukur, pasuria, njohuritë, gjuha e huaj etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: KLASTER, punë me tekstin.

Mësuesi/ja thekson gjërat e rëndësishme në jetën e nxënësve dhe një prej tyre është edhe gjuha e huaj.

Krijon në tabelë një KLASTER për gjuhën e huaj dhe nxënësit e plotësojnë sipas mendimit dhe vlerësimit që i bëjnë ata përdorimit dhe njohjes së gjuhëve të huaja.

Mësimi i shumë gjuhëve, përveçse pasuron njohuritë e njeriut, është edhe mundësi praktike për komunikimin e tij jashtë vendit. Disa e mësojnë për kënaqësi, disa për kulturë disa për shkak të nevojave për shkollim e disa për shkak se kjo ua lehtëson gjetjen e vendeve të punës.



Plotësohet KLASTER dhe nxirret nga vetë nxënësit rëndësia e njohjes dhe përvetësimit të gjuhëve të huaja.

Me anë të njohjes së gjuhës së huaj ne mund të kërkojmë të punësohemi brenda BE.

CV-ja evropiane është një format standard për hartimin e CV-së. Qëllimi i krijimit të këtij formati është favorizimi i lëvizjes së punonjësve brenda Bashkimit Evropian. Ky model CV-je është mjaft i përdorur dhe i përhapur në Evropë, si edhe në vendin tonë. Ai ka një strukturë, sipas së cilës të dhënat ndahen në: të dhëna personale; përvoja profesionale; arsimimi; aftësi të ndryshme personale (p.sh: gjuhët e huaja); botime të ndryshme; shtojca.

E rëndësishme është edhe njohja dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike dhe internetit.

Një lloj i veçantë CV-je është edhe CV-ja në formë videoje e cila zakonisht krijohet në formën e një video-prezantimi, duke përshkruar aftësitë kryesore të kandidatit.

Punohet me tekstin për të sqaruar veçoritë e CV-së në formë videoje. (mund të jenë porositur nxënës të ndryshëm që zotërojnë mirë njohuritë kompjuterike që të sjellin CV të tillë për t'u prezantuar përpara klasës).

Demonstrimi i rezultateve të arritura: punë me modele, punë e drejtuar.

Mësuesi/ja drejton nxënësit tek modeli i dhënë në tekst mbi një CV evropiane. Sqarohet struktura e CV-së dhe elementet përbërëse të saj.

Modeli i dhënë do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit që të krijojnë një CV evropiane.

Ushtrimi 1. Ndërtohet situata: Imagjinoni veten pas 15 vitesh. Doni të punësoheni diku dhe duhet të plotësoni një CV.

Nxënësit punojnë duke u orientuar nga mësuesi/ja për përmbushjen e detyrës së kërkuar. Lexohen disa punime të nxënësve dhe bëhen vlerësime për mënyrën e plotësimit të CV-së.

Vlerësimi: Vlerësim motivues gjatë gjithë orës. Vlerësim me notë për plotësimin në mënyrën e duhur të plotësimit të CV-së.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 2 (mund të bëhet edhe si video)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Te lexuarit Tema mësimore: Ca këshilla mbi artin e shkrimit		Situata e të nxënit: Fan Noli: “Ky njeri me kulturë të lartë”, G. Apolinieri: “Enciklopedi shëtitëse”. Diskutojmë rreth vlerësimeve që i kanë bërë personalitete si Fan Noli apo Apolinieri figurës së Konicës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - hulumton mbi jetën dhe veprën letare të Faik Konicës; - diskuton për vlerësimin që Noli apo Apolinieri ka dhënë për Konicën; - identifikon tekstin udhëzues; - dallon veçoritë e tij; - dallon llojet e ndryshme të tekstit udhëzues nëpërmjet funksionit të tyre; - analizon veçoritë gjuhësore të tekstit udhëzues. 		Fjalët kyçe: Tekst udhëzues Arti i shkrimit Këshilla Strukturë Hyrje Zhvillim Mbyllje	
Burimet: Teksti i nxënësit. http://www.tiranaobserver.al/faik-konica-ca-keshilla-mbi-artin-e-shkrimit/		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gazetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Lëviz /ndalo /krijo dyshe, VLMD, Diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Lëviz /ndalo /krijo dyshe</i> Udhëzohen nxënësit të punojnë në këtë fazë të parë të orës së mësimimit me teknikën “Lëviz/Ndalo/Krijo dyshe”. Në këto dyshe ata do të shkëmbejnë me njëri-tjetrin mendime për karakteristikat e tekstit udhëzues dhe do të hartojnë një listë me to.			
<p>Teksti udhëzues</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Udhëzohet lexuesin hap pas hapi në lidhje me një veprimtari të caktuar. 2. Shoqërohet me ilustrime ndihmëse ose me simbole që u referohen, për shembull, pikave të një rregulloreje. 3. Tregon rregulla që duhet t'i përmbahemi për të kryer një veprimtari. Në këto lloj tekstesh përfshihen: nenet e ligjeve, manualët mësimore, recetat e gatimit, rregulloret e ndryshme etj. 4. Gjuha e përdorur në to është formale, me fjalë dhe terma teknikë. 5. Foljet përdoren në mënyrën urdhërore, lidhore, si dhe në dëftore. Ato janë në kohën e tashme, të formës veprorë ose joveprorë. 6. Renditje kohore veprimesh 			
Varianti B Në këtë fazë të parë të orës së mësimimit mund të diskutojmë së bashku për jetën dhe veprimtarinë letrare të Faik Konicës			

Vëllimi me përralla të përkthyer "Nën hijen e hurmave"(1924).
 "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit"
 Kater përralla nga Zullulandi
 Ai la në dorëshkrim anglisht veprën "Shqipëria - kopshti shkëmbor i Evropës juglindore" dhe ese të tjera, e cila u botua pas vdekjes (1957
 Publicist ,Kritik letrar ,prozator "Një liqen", "Anës liqenit", "Bora", "Malli i mëmëdheut" etj.
 ,poet Gjuha jonë", "Flamuri", "Kushtrimi ose Marsejeza e shqiptarëve".
 Eiseist "Jeta dhe librat" Shqipëria- kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore"

Ndërtimi i njohurive të reja: VLMD

Mësuesi/ja lexon dy paragrafët e parë dhe nxënësit dëgjojnë. Më pas ai/a jo u bën pyetje rreth të kuptuarit e tyre.

Cili është kriteri i parë i domosdoshëm që një shkrim të jetë i realizuar?

Çfarë roli ka hyrja në një shkrim?

Çfarë kuptoni me shprehjen "Se po të jetë hyrja si një gërmadhë, shpejt-shpejt këndonjëtori kthen fletën "

Nxënësit japin mendimet e tyre.

Mësuesja fillon e lexon paragrafin e tretë e pas dëgjimit bën pyetjet.

Si duhet të shfaqet mendimi gjatë zhvillimit të shkrimit dhe pse?

Shpjegoni shprehjen: "Se po të hidhni pa vijë një copë mendim atje, do të bëhet një çorbë, ku këndonjëtori s'ka për të kuptuar tjetër gjë, përveçse shkronjëtori nuk di të japë kuptim.

Lexohet paragrafi IV dhe pyetja rreth tij është: Po mbyllja, si duhet të formulohet?

Nxënësit dëgjojnë në mënyrë kritike që të jenë të aftë t' u përgjigjen pyetjeve rreth tekstit pas leximit.

Lexohet paragrafi V

A sugjerohet përdorimi i frazave të gjata në shprehjen e mendimeve gjatë të shkruarit?

Në paragrafin e VI: A udhëzohet shkruesi të rilexojë krijimin e tij? Pse?

Nxënësit japin mendimet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Dalloni paragrafin në të cilin autori:

- përdor humor;

- shpjegon: *Prapoja, duhet, me një mënyrë të ngjeshur e të fortë, të përsërit në fare pak fjalë gjithë mendimet e mësipërme dhe të nxjerrë një fund i cili është qëllimi i shkronjës"*

Kritikon. *Mësoni dhe mirë rregullat e gjuhës shqipe: mos thoni për tregim: "Fshati që u linda"; kjo mënyrë përdorje e fjalës që është turqisht dhe mjaft për të qeshur, në shqipe duhet thënë: "Fshati ku u linda" a "Fshati në të cilin u linda "*

Nxënësit japin lirshëm mendimet e tyre

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën hulumtuese rreth figurës shumëplanshe të Faik Konicës, rreth të kuptuarit e tekstit etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Interpretoni rolin e paragrafit mbyllës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të lexuarit		Situata e të nxënit:	
Tëma mësimore: Ca këshilla mbi artin e shkrimit –F. Konica		Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca qytetare 			

<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon paragrafët në të cilët autori shpjegon e kritikon; - kthen fjalët dialektore në gjuhën standarde; - përmbledh secilin nga paragrafët e tekstit udhëzues me nga një fjali; - krijon një mbyllje tjetër ndryshe nga ajo e autorit. 	<p>Fjalët kyçe: Tekst udhëzues Arti i shkrimit Këshilla Struktura e shkrimit Hyrje Zhvillim Mbyllje</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit. http://www.tiranaobserver.al/faik-konica-ca-keshilla-mbi-artin-e-shkrimit/</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe / Gazetari</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimin Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Diskutim</i> Lexohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Dalloni paragrafin që tregon çfarë do të thotë autori, paragrafët të cilët tregojnë stilin, organizimin dhe fundin në një shkrim</p> <p>1. Çfarë do të thotë autori Kur qëlloni të shkruani gjësendi, qoftë një biblh (libër) e madhe a një artikull pesë-gjashtëradhësh, e para nevojë është të dini mirë ç'doni të dëfteni. Se shumë herë këndojmë të shkruara, të cilat s'kanë as mendim, as qëllim dhe si, mbarohen, një pyetje na vjen në buzë: "Mirë, po ç'dolli nga kjo?" Para që të zini të shkruani, pra, thuani vetes tua: "Dale të mendohem mirë ç'dua për të shkruar...."</p>	
<p>2. Stili Si të vendosni shëndoshë në mend, ç'keni për të thënë, kërkoni mënyrën qysh do ta thoni. Duhet në krye ca fjalë, hyrje të shkurtëra dhe për të pëlqyer, që të kuptonjë atë hop këndonjëtori "ku fle lepurit" si thonë toskët, dhe që të ëmbëltohet e t'i ketë ënda të këndojë më poshtë. Se po të jetë hyrja si një gërmadhë, shpejt- shpejt këndonjëtori ktheh fletën</p> <p>3. Organizimi Pas hyrjes, zini të shfaqni mendimin tuaj, nuk përnjëherë, po dalngadalë, thela- thela, që të gëlltitet më lehtë, që të kuptohet më thellë. Togjtë fjalësh (a frazat) të mos jenë kurrë të veçantë, të jenë të lidhur njëri me tjetrin; një togfjalësh duhet të pjellë një tjetër më poshtë që të hipë këndonjëtori si në një shkallë dhe kur t'i afronjë majës të jetë gati për të kuptuar prapone (konklurimi). Se po të hidhni pa vijë një copë mendim këtu, një copë mendim atje, do të bëhet çorbë, ku këndonjëtori s'ka për të kuptuar tjetër gjë, përveçse shkronjëtori nuk di t'i japë kuptim.</p> <p>4. Fundi Prapoja, duhet, me një mënyrë të ngjeshur e të fortë, të përsëritnjë në fare pak fjalë gjithë mendimet e mësipërme edhe të nxjerrë një fund, i cili është qëllimi i shkronjës. Burimi: http://www.tiranaobserver.al/faik-konica-ca-keshilla-mbi-artin-e-shkrimit/</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në dyshe</i> Udhëzoj nxënësit të punojnë në dyshe. Si është i organizuar ky tekst? Shëno me Po ose Jo Në të tregohet se si dhe pse ndodh një dukuri. <i>Jo</i> Ndërtohet me paragrafë të veçantë, që paraqesin hapa të ndryshëm të dukurisë. <i>Jo</i> Udhëzon hap pas hapi lexuesin rreth një teme. <i>Po</i> Jep këshilla hap pas hapi rreth funksionimit të një pajisjeje. <i>Jo</i> Në cilin dialekt shkruan Konica? <i>Toskërisht</i> Nga e kuptoni këtë? "Ku fle lepurit si i thonë toskët", <i>Duket se nuk kemi asnjë fjale në dialektin gegërisht që të ketë ndryshime fonetike apo leksikore</i> Nënvizoni fjalët dialektore në paragrafin e tretë, zëvendësojini ato dhe tregoni efektin që sjell ky ndryshim për lexuesit. <i>thela-thela-copa –copal, të pjellë –të lindë /një tjetër- një tjetër / të hipnjë-të hipël, një çorbë-një supë, përveçse – përveçse / shkronjëtori-shkrimtari /prapo-mbyllje</i> Çfarë ju bën përshtypje në ndërtimin sintaksor të kësaj fjalie? Para se të zini të shkruani, pra, thuani vetes tua: "Dale të mendohem mirë ç'dua për të shkruar...". Nëse do të ishte në ndërtimin sintaksor të një ligjtare të drejtë ku të dallohej qartë pjesë përmendëse dhe pjesa lajmëruese fjalia do të kishte këtë ndërtim</p>	


<p><i>Thuaj vetes: “Mendohu mirë për atë që do të shkruash!”</i></p> <p>Pjesa e nënrenditur “Para se të zini të shkruani “e prish ndërtimin sintaksor të ligjëratës së drejtë</p> <p>Rishpreheni fjalinë e mësipërme, duke ruajtur idenë e autorit dhe duke e shndërruar atë në ligjëratë të zhdrejtë.</p> <p><i>Para se të shkruaj i them vetës se duhet të mendohem mirë se ç’do të shkruaj</i></p> <p>Përmbledhni secilin prej paragrafëve udhëzues në një fjali të vetme, e cila duhet të përmbajë idenë kyçe.</p> <p>1.Mendohuni mirë, para se të filloni të shkruani!</p> <p>2.Një hyrje e mirë grish lexuesin për të vazhduar leximin e shkrimit.</p> <p>3.Mendimi në shkrim duhet të ketë koherencë dhe kobezion për ta kuptuar atë.</p> <p>4.Mbyllja në mënyrë koncize i sqaron lexuesit qëllimin e shkrimit</p> <p>5.Gjuha duhet të jetë e pastër larg përdorimit të fjalëve të huaja dhe ndërtimi sintaksor i fjalive duhet t’u përmbahet rregullave të shqipes.</p> <p>6.Rishikimi është element i domosdoshëm i procesit të të shkruarit.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë</p> <p>Sipas jush, çfarë e bën një shkrim eseistik të arritur? Formuloni pesë këshilla për të arritur këtë qëllim</p> <p>1.Struktura e esesë të jetë lehtësisht e dallueshme.</p> <p>2.Të jetë e qartë problematika që shtroni.</p> <p>3._____</p> <p>4._____</p> <p>5._____</p> <p>Nxënësit shkruajnë këshillat dhe i diskutojnë me shokët e klasës.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë, përmbledhjen e paragrafëve në një fjali etj.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ndërtoni një mbyllje tjetër nga ajo e autorit.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Rrethanorët		Situata e të nxënit: Puna me tekstin	
Kompetenca: Njohuri gjuhësore-Sintaksë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore, Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon rrethanorët në fjali; - zgjeron grupin foljor me rrethanorë të ndryshëm; - përcakton përdorimin e së njëjtës fjalë me funksione të ndryshme sintaksore. 		rrethanorë vendi, kohe, shkak, qëllimi, mënyre, sasi, kushti, lejimi; lidhje sintaksore; fjalë drejtuese	
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9” Libri: Gramatika e gjuhës shqipe 2		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi; kllaster; punë e drejtuar; punë individuale</i>			
Organizimi i orës së mësimimit: <i>stuhi mendimi; kllaster</i>			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/les: Ç’dini për rrethanorët? (stuhi mendimi +kllaster) Plotësohet kllasteri nga nxënësit dhe mësuesja plotëson me njohuri të reja.			

nuk është gjymtyrë e domosdoshme në fjali



Ndërtimi i njohurive të reja: punë e drejtuar

1. Dalloni rrethanorët dhe përcaktoni llojin e tyre.

Megjithëse u përpoq të zbriste shkallët pa u mbajtur (rr. mënyre) nga parmacët (rr. vendi), dy-tri herë (rr. sasië) i preku ata. I porsaardhuri qëndronte në këmbë (rr. mënyre) në sallonin e madh (rr. vendi). Beqir Aliu e ndjeu në çast (rr. kobe) se përvoja e gjatë nuk e ndihmoi këtë herë (rr. kobe) të kapte aty për aty (rr. kobe) rangun e vërtetë të zyrtarit që kishte përpara (rr. vendi). - Vij drejt e nga kryeqyteti (rr. vendi) me një mision të veçantë, - tha ai.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale

2. Dalloni pohimin e saktë nga pohimi i gabuar.

- *Rrethanorët kanë si fjalë drejtuese kryefjalën. X
- *Rrethanorët kanë rend të lirë në fjali. V
- *Si fjalë drejtuese për një rrethanor mund të shërbejë edhe mbiemri. V
- *Rrethanorët rimerren me anë të trajtave të shkurtra përemërore. X

3- Përcaktoni funksionin e fjalës det në fjalitë e mëposhtme.

- *E kaloi jetën deteve (rrethanor vendi) si marinar.
- *Deti (kryefjalë) ishte pasioni i tij më i madh.
- *Sa herë shoh detin (kundrinor i drejtë), më vjen të këndoj.
- *Dallgët e detit (përcaktor) përplaseshin mbi shkëmb.

4- Zgjeroni fjalitë e mëposhtme me rrethanorë të ndryshëm.

- *Më flihej => Atë çast (rr. kobe) më flihej shumë (rr. sasië) nga lodhja e ditëve të fundit (rr. shkaku).
- *Dëgjonim muzikë => Në shtëpi (rr. vendi) dëgjonim muzikë çdo pasdite (rr. kobe).
- *Gjëmonte => Në dimër (rr. kobe) gjëmonte shpesh (rr. mënyre) në ato anë (rr. vendi).

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5-fq. 309

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: "Revista e shkollës", (projekt, ora e parë).		Situata e të nxënësve: Fusha leksikore Tërësia e fjalëve të një gjuhe quhet leksik. Leksiku është një sistem gjuhësor ku çdo fjalë ka vendin e vet dhe gjithmonë në lidhje me fjalët e tjera. Fusha leksikore është një bashkësi fjalësh që lidhen sipas kuptimit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -bashkëbisedon lirshëm me shokët duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij, - respekton mendimet dhe gjykimet e të tjerëve duke i dëgjuar me kujdes deri në fund, - ndan detyrat qetësisht gjatë diskutimeve në klasë, në mënyrë që të zhvillojnë një projekt së bashku, - pasuron linjën e debatit me argumente duke respektuar etikën, -bashkëpunon në grupe rreth detyrës së dhënë, - jep kontributin e tij gjatë punës në grup sipas rolit që i caktohet. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Revistë Shkrime Kronikë Intervistë Informacione Njoftime Lojëra Arti Kultura</p>
<p>Burimet: Materiale të gatshme nga botime të ndryshme revistash, revista të botuara nga nxënësit.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Arte, Teknologji dhe TIK.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Mendimi i parë, harta e mendimit, pyetje -përgjigje, kllaster analizë rasti, punë e drejtuar, organizuesi grafik, punë në grupe.</i></p>	

Organizimi i orës së mësimin

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: mendimi i parë, harta e mendimit, pyetje-përgjigje,

Në fillim të orës mësuesi/ja orienton nxënësit që të shkruajnë në fletore mendimet e para që u vijnë ndërmend kur përmendet fjala: shkollë. Kjo teknikë zhvillohet për rreth tri minuta sepse nxënësit duhet që të shkruajnë thjesht dhe mendimet e tyre duhet të jenë të papërpunuara.

Krijohet një hartë e përbashkët në dërrasën e zezë me mendimet e para të nxënësve për shkollën.


Lexohen nga një nxënës fjalët që përbëjnë hartën e mendimit dhe diskutojnë duke rikujtuar njohuritë e marra:

- Çfarë është leksikologjia? Çfarë quajmë leksik? Po fusha leksikore çfarë është? - (leksikologjia është një degë e veçantë e gjuhësisë që studion fjalët e një gjuhe dhe kuptimet e tyre. Leksiku është tërësia e fjalëve të një gjuhe, është një sistem gjuhësor ku çdo fjalë ka vendin e vet dhe gjithmonë në lidhje me fjalët e tjera. Fusha leksikore është një bashkësi fjalësh që lidhen sipas kuptimit).

Të gjitha fjalët që nxënësit përdorin kur flasin dhe kur shkruajnë janë pjesë e leksikut të gjuhës shqipe.

Me anë të leksikut që përdorin nxënësit lidhin mendimet për të sqaruar hartën e mendimeve rreth shkollës.


Harta e mendimeve



Ndërtimi i njohurive të reja: KLASËTER, analizë rasti.

Mësuesi/ja e njëh nxënësit me temën e projektit “Gazeta e shkollës” dhe u kërkon që të krijojnë një KLASËTER me fjalën: Revista.

Nxënësit mendohen për 2 -3 minuta rreth detyrës dhe shkruajnë në fletore disa elemente përbërëse të revistës. Një nxënës del përpara klasës që të dëgjojë përgjigjet e nxënësve të tjerë dhe të plotësojë kllasterin e përbashkët.



Diskutohet në lidhje me informacionet që kanë nxënësit rreth revistës dhe llojeve të saj. Revista e shkollës është një botim periodik që mund të dalë një herë në vit nga nxënësit e klasave të nënta, në formën e një projekti lëndor apo ndërëndor.

Mësuesi/ja sjell në klasë disa modele revistash dhe ua tregon nxënësve. Modelet e revistave mund të jenë të punuara nga klasat e mëparshme ose modele revistash të botuara nga shtypi i shkruar.

Modelet e revistave mund të jenë: sociale e kulturore, sportive, shkencore, të fushës së mjekësisë etj.

Analizohen disa raste mbi tematikat e punuara dhe mënyrën e paraqitjes së informacioneve; përdorimi i fotografive dhe madhësia e tyre; ngjyrat e përdorura dhe përshtatja e titullit me përmbajtjen.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e drejtuar, organizuesi grafik, punë në grupe.

Mësuesi/ja drejton nxënësit që të mendojnë rreth revistës, por edhe rreth aftësive e pëlqimeve të tyre. Nxënësit duhet të mendojnë për rolin e tyre në revistë dhe se ku e ndiejnë ata veten më të zotë për të kontribuar gjatë punës me projektin. Për të ndihmuar nxënësit mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë një tabelë organizuese mbi krijimin e grupeve të punës.

Fusha	Mjedisi dhe shoqëria	Gjuha dhe komunikimi	Sporti	Arti dhe kultura	TIK	Redaktimi
Çështjet	Higjiena, sëmundjet, ushqimet, mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit.	Tregime, përshkrime, poezi, intervista, kronika, njoftime, rregullore.	Informacione sportive, Rezultate ndeshjesh, Skuadrat e preferuara.	Krijime të nxënësve, botime librash, foto nga aktivitete.	Përpunimi dhe hedhja e materialeve në kompjuter, faqosja e revistës.	Redaktimi nga ana gjuhësore i revistës.
Emrat e nxënësve						

Diskutohet mbi çështjet që do të trajtohen dhe secili nxënës vendos emrin tek grupet që dëshiron të marrë pjesë sipas zotësisë dhe pëlqimit. Nxënësi është i lirë të vendosë emrin në dy-tri grupe. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit në përzgjedhjen e grupit të duhur.

Pasi shkruhen në tabelë emrat e të gjithë nxënësve, nxënësit krijojnë grupe të vogla ekspertësh, zgjedhin kryetarët e grupeve dhe diskutojnë e shkëmbejnë ide për informacionet që mund të mbledhin, tematikat dhe mënyrat e paraqitjes së tyre.

Në fund nxënësit kanë mbajtur shënime idetë e shkëmbyera dhe rolin që do të kenë në realizimin e projektit.

Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e projektit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Mbledhja dhe përgatitja e materialeve për projektin.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Lexojmë Tema mësimore: Zgjidh një udhërrëfyes		Situata e të nxënit: Cili nga prindërit, të afërmit e tu, dhe jo vetëm, kanë shërbyer për ty si një udhërrëfyes? Jepni shembuj Diskutojmë së bashku	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Diskuton për karakteristikat e tekstit udhëzues Shpjegon kuptimin e fjalës “udhërrëfyes” Analizon gjuhën e tekstit të dhënë. Argumenton zgjedhjet e tij për udhërrëfyesin e tij ideal		Fjalët kyçe: Teksti udhëzues Udhërrëfyes Sugjerim Këshilla Veta e dytë	

Burimet: teksti i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Parashikim me anë të titullit, Rishiko në dyshe, Vija e vlerës</i>	
<p>Organizimi i orës së mësimt Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Parashikim me anë të titullit.</i> <i>Teksti që do të lexoni sot titullohet “Zgjidh një udhërrëfyes”</i> <i>Çfarë mendoni se do të lexoni në të ?</i> <i>Jepni kuptimin leksikor të fjalës “Udhërrëfyes”</i> <u><i>Më pas mësuesja bën shpjegimin e fjalës “udhërrëfyes” sipas “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”</i></u></p> <p>udhërrëfyes,-i m. sh. -(IT) 1. Ai që i tregon rrugën a drejtimin dikujt nga të kalojë: shkojnë pas udhërrëfyesit; shenjë udhërrëfyes; / udhëheqës 2. Libër që përshkruan një vend, një shtet, një krahinë, veçoritë dhe bukuritë natyrore të tij flet për historinë e tij, dhe që përmban dhe të dhëna të tjera të dobishme për ata që e vizitojnë këtë vend: udhërrëfyes për turistët (për të huajt) 3. fig. Diçka që tregon rrugën nga duhet kaluar ose zgjidhjen e drejtë për të arritur një synim: dikush ose diçka që na hap rrugën drejt një qëllimi ose drejt së ardhmes: udhërrëfyes në punë; e ka udhërrëfyes etj. Shpjegoni fjalëformimin e saj.(udhë+rrëfyes) A mund të jepni fjalë të tjera sinonime me të? udhëprijës, udhëheqës</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rishiko në dyshe</i> Lexohet teksti udhëzues dhe më pas diskutojmë së bashku rreth rubrikave të dhëna në tekst Shënoni me Po ose JO pohimet e mëposhtme. Teksti i mësipërm i udhëzon lexuesit që të ndjekin një udhërrëfyes. PO Teksti i mësipërm i këshillon lexuesit që të ndjekin një drejtim në karrierë. JO Pyetjet e autorit përgjatë tekstit presin përgjigjet e lexuesve. JO Teksti udhëzon lexuesit se si t’u përgjigjen pyetjeve të drejtuara. JO Teksti u sugjeron lexuesve disa pyetje ndihmëse. PO Teksti i mësipërm udhëzon lexuesit për të zgjedhur modelin udhëheqës dhe frymëzues në jetë. PO</p> <p>Analizojmë tekstin 2. Plotësoni: Në hyrje, autori u sugjeron lexuesve të përqendrohen në tri modele konkrete udhërrëfyes. Gjatë zhvillimit autori u sugjeron lexuesve rrugët që duhen ndjekur për të arritur të komunikojmë me udhërrëfyesin, duke filluar nga caktimi i një takimi, të folurit në telefon, të shkruarit e një letre, një e-maili autori u sugjeron lexuesve disa pyetje ndihmëse. Në mbyllje, autori udhëzon lexuesin si ta bëjë udhërrëfyesin pjesë të jetës së tij/saj</p> <p>Shëno me + (mund të zgjedhësh më shumë se një pohim). Ky tekst udhëzues është organizuar: si një ndërthurje e këshillave dhe e udhëzimeve; + si një ndërthurje e sugjerimeve dhe e pyetjeve; si një renditje e rregullave për zgjedhjen e një udhërrëfyesi; + në bazë të skicave dhe imazheve udhëzuese. Në cilën vetë është shkruar teksti i mësipërm? <i>Veta e dytë njëjës</i> Provoni ta ktheni atë në numrin shumës. <i>Shkruani emrat e tre njerëzve që i admironi dhe që mendoni se mund të jenë udhërrëfyes të përshtatshëm për ju. Zgjidhni persona që i njihni ose që keni mundësi t’i njihni. Gjatë katër javëve në vazhdim, caktoni një takim për të intervistuar secilin prej tyre.</i></p>	

Cfarë efekti do t'i sillte ky ndryshim rrëfimit?
Në cilën kohë dhe mënyrë janë përdorur kryesisht foljet e këtij teksti?
Shtoni pesë pyetje të tjera në listën e pyetjeve të tekstit, të cilat doni t'ia drejtoni dikujt që e konsideroni si model për veten tuaj.
Gjatë gjithë kohës mësuesi përpiqet të përfshijë një numër sa më të madh nxënësish në dhënien e përgjigjeve

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Vija e vlerës

A do të ishte një udhërrëfyes ideal për ju: mamaja, babai, mësuesja/i apo një person jashtë rrethit tuaj familjar?

PO Argumentoni përgjigjen. JO

Nxënësit diskutojnë duke dhënë argumente bindëse.

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për argumentet e dhëna gjatë diskutimit etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani dhjetë këshilla drejtuar bashkëmoshatarëve, me temë: “Drejt suksesit!”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përcaktori dhe përcaktori kallëzuesor (ora e parë)		Situata e të nxënit lidhet me dallimin e përcaktorëve në fragmentin e shkëputur nga “Fshati mbi shtatë kodrina”	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: përcaktor, fjalë drejtuese, emër, përemër, me përshtatje, me drejtim, me bashkim.	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon përcaktorët në fjali; - ndërton fjali më lloje të ndryshme përcaktorësh; 			
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda të ndryshme, tabela e përcaktorit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e drejtuar; Kllaster; Punë individuale			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Punë e drejtuar;			
Mësuesi u kërkon nxënësve të dallojnë përcaktorët në fragmentin e shkruar në një tabak letre.			
“...Të shtatë kodrinat përbënin të shtatë mëhallët dhe qendra kishte vetëm një kullë të rrëzuar dhe një mekam të shenjtë. Kjo qendër dukej e çuditshme dhe sikur nuk ishte qendër. Mëhallët sikur mbaheshin dora-dore me njëra-tjetrën dhe quheshin...Dreq e gjysmë!...Si mund të kujtoj emrat e mëhallëve kur nuk më kujtohet as emri i fshatit? Njeriu kur harrokërka, i harrokërka të gjitha! Të gjitha!...”			
Ndërtimi i njohurive të reja: Kllaster			

<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale</p> <p><i>Ushtrimi 1- Plotësoni pohimet e mëposhtme.</i></p> <p>*Përcaktori është me përshtatje kur fjala drejtuese drejton në gjini, numër dhe rasë.</p> <p>*Përcaktori është me drejtim kur fjala drejtuese drejton në rasë.</p> <p>*Përcaktori është me bashkim kur fjala drejtuese nuk e kushtëzon formën e fjalës së varur (fjalës përcaktuese).</p> <p>*Përcaktori mund të ketë si fjalë drejtuese emrin dhe përemrin.</p> <p>*Përcaktori nuk mund të ketë si fjalë drejtuese foljen.</p> <p><i>Ushtrimi 2- Gjeni përcaktorin dhe thoni llojin e tij.</i></p> <p>*Shtëpia e vogël -- p.me përshtatje</p> <p>*Shtëpia në kodër –p.me drejtim</p> <p>*Shtëpia përballë –p.me bashkim</p> <p>*Shtëpi guri –p.me drejtim</p> <p>*Shtëpia e fqinjët –me drejtim</p> <p>*Shtëpi përdhese –me përshtatje</p> <p>Ushtrimet diskutohen në klasë.</p>
<p>Vlerësimi: Vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3, faqja 312.</p> <p>- Ndërtoni nga një fjali ku mbiemri i mirë të jetë përkatësisht:</p> <p>a) Përcaktor:</p> <p>i kryefjalës: Gjyshja ime e mirë më rrëfen ço natë histori të bukura.</p> <p>i kundrinorit të drejtë: Sapo e mora lajmin e mirë, vrapova drejt prindërve.</p> <p>i kundrinorit të zhdrejtë: Gjithçka ia kushtonte familjes së mirë që kishte pasur.</p> <p>i një rrethanori: Burri buzëqeshte i kënaqur për shkak të gjahut të mirë të asaj nate.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Përcaktori dhe përcaktori kallëzuesor (ora e dytë)		Situata e të nxënësve lidhet me dallimin e përcaktorit kallëzuesor në fjali.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: përcaktor kallëzuesor, i kryefjalës, i kundrinorit të drejtë, lidhje/marrëdhënie dyfishe	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon përcaktorët kallëzuesorë në fjali; - dallon përcaktorin kallëzuesor të kryefjalës, duke shpjeguar lidhjen e tij me kryefjalën dhe kallëzuesin; - dallon përcaktorin kallëzuesor të kundrinorit duke shpjeguar lidhjen me kallëzuesin dhe kundrinorin e drejtë; - ndërton fjali me përcaktor kallëzuesor. 			
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda fjalish me përcaktor kallëzuesor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetja sjell pyetjen; Kllaster; Diskutim; Punë individuale			
Organizimi i orës së mësimimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Pyetja sjell pyetjen;			
Rikujtohen njohuritë për përcaktorin kallëzuesor. U drejtohen nxënësve pyetjet:			

Ç'gjymtyrë është përcaktori kallëzuesor? Në cilin grup funksional të fjalisë bën pjesë? Cila është karakteristika kryesore e përcaktorit kallëzuesor që e dallon nga gjithë gjymtyrët e tjera? Si dallohet nga përcaktori i thjeshtë? Sa lloj përcaktorësh kallëzuesorë ka? Me se shprehen ata?

Ndërtimi i njohurive të reja: Kllaster;

Përgjigjet e nxënësve pasqyrohen në mënyrë skematike në kllaster



Punohen nga mësuesi në bashkëpunimi me nxënësit fjalitë dhe theksohet përshtatja e PK me gjymtyrën emërore në gjini, numër dhe rasë:

Zëri vinte i zbehtë -----Zërat vinin të zbehtë.

Ky qen dukej si ujë.

Këta i kemi tanët.

Të riun e merrnin për të huaj.

U bë për t'u fshirë prapë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale; Diskutim;

Punohen individualisht nga nxënësit pika b, tek ushtrimi 3 dhe ushtrimi 4. Pas përfundimit secili ushtrim diskutohet në klasë.

Ushtrimi 3. Ndërtoni nga një fjali ku mbiemri i mirë të jetë përkatësisht:

b) përcaktor kallëzuesor:

* i kryefjalës: Malli i sapoardhur duket i mirë dhe cilësor.

* i kundrinorit: Nëna i kishte bërë të mira petullat.

c) gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror: Vëllaçkoja im është i mirë, i bukur dhe i mençur.

Ushtrimi 4. Dalloni përcaktorët dhe thoni llojin e tyre. Rishkruani fjalitë duke kthyer disa prej përcaktorëve në përcaktorë kallëzuesorë.

Pas lajmeve të para, të turbullta e të rrëmujshme, erdhën të dytat, të qeta e të sakta. Hetuesit kishin gjetur të shkallmuara jo vetëm hyrjet e fshehta të piramidave, por edhe sarkofagët. Kishin një plan të tërë për t'i vjedhur mumiet, për t'i nxjerrë fshehtazi jashtë Egjiptit e për t'i çuar në vende të huaja, të largëta, në ca qytete të reja barbare e me emra të frikshëm.

Vlerësimi: Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi, gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e paruar: Ushtrimi 5, faqja 312.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Dëgjojmë Tema mësimore: Dëgjojmë një tekst udhëzues		Situata e të nxënit: Lojë në role. Udhëzo një shok apo shoqe për rrezikun që sjell pirja e ujit shumë të ftohtë, pas një ore të Edukimit fizik, kur trupi është shumë i nxehtë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			

<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon tekstin udhëzues; - krahason tekste udhëzuese mes tyre; - analizon karakteristikat e tekstit udhëzues. 	<p>Fjalët kyçe: Tekst udhëzues Receta gatimi Karakteristika Lloje tekstesh udhëzuese</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit Siguria e Fëmijëve në Internet “ -Udhëzues për fëmijë: fq 21-23 Botuar nga: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP http://www.living.al/kuzhina/orakulli-i-kuzhines/receta-te-shpejta/keku-me-i-lehte-dhe-i-shpejte-i-pranveres-me-kos-dhe-luleshtrydhe</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Gjuhë shqipe, TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Punë në dyshe</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimt</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i></p>	
<p>Diskutojmë së bashku</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në dyshe</i></p>	
<p>Më pas dëgjojmë dhe disa tekste të tjera udhëzuese dhe bëjmë dallimin midis tyre</p>	
<p>5 sekretet si të vishni rrobat e gjera "oversize" kur je trupvogël ose e shkurtër</p> <p>Femrave shtatshkurtër u duhet të kthejnë xhinset, të palosin pulovrat dhe të mos veshin gjëra shumë të mëdha pasi të krijojnë idenë sikur i ka përpirë veshja. Të paktën kështu është besuar deri më tani, pasi me sekretet që Living do të ndajë më poshtë, çdo vajzë e shkurtër apo e imët do të mundet të vishet me rroba <i>maxisize</i> dhe të mos e humbasë feminitetin.</p> <p>Balanconi veshjet</p> <p>Sekreti qëndron tek harmonia dhe balanca e copëzave ! Nëse ju vishni një pulovër “oversive”, duhet të siguroheni që pantallonat të jenë të ngushta! E njëjta gjë vlen edhe për fustanet e leshta, duhet të kombinohen me çizme të gjata dhe pas këmbëve.</p> <p>Pulovra të gjera të leshta, fustane XL kur masa e trupit tuaj është XS! Rripi i lidhur rreth belit do të bëjë që ju mos të dukeni të zhytyra si në një “thes”.</p> <p>Ruani detajet femërore</p> <p>Çdo veshje <i>maxisize</i> mund të duket pak mashkullore, ndaj gjëja më e mirë që mund të bëni është që outfitit juaj të ketë të paktën një detaj femëror.</p> <p>Pantallonat me bel të lartë dhe pulovrat e gjera përbëjnë një kombinim ideal për vajzat shtatshkurtër. Palosni pulovrat e gjera dhe mos lejoni që bluza t’ju varet lirshëm, pasi do t’ju mbulojë duke ju bërë të dukeni edhe më të shkurtra</p>	
<p>Lojërat online</p>	
<p>Të luani lojëra në kompjuterin tuaj është shumë e këndshme dhe argëtuese, mirëpo lojërat kanë edhe rreziqe. Ju mund të luani me kompjuter, telefona mobil, në rrjete sociale (p.sh. Facebook) apo me pajisje të vogla elektronike siç janë <i>PlayStation</i> dhe <i>Nintendo</i>. Ju gjithashtu mund të luani vetëm, me fëmijë të tjerë në dhomë apo luani <i>online</i> me njerëz të tjerë nga e gjithë bota, si janë shoqëria juaj apo edhe persona që nuk i njihni. Mirëpo, nëse luani lojëra në internet, duhet ta keni parasysh se jeni të ekspozuar ndaj disa rreziqeve në vijim: Ju mund të shkarkoni (download) gjëra të këqija së bashku me instalimin e lojërave.</p> <p>Është dukuri e shpeshtë që kur ofrohen lojëra për t’u instaluar gjatë bisedave <i>chat</i> me shokët e juaj apo gjatë shkëmbimit të <i>e-mail</i>-eve, ato ofrohen edhe me ndonjë virus i cili mund të ketë <i>spam</i> apo <i>malicious software</i>.</p> <p>Ndonjëherë lojërat që janë falas (free) mund të pyesin për informata shpesh përveç atyre që i keni në profilin tuaj dhe ata që lançojnë virusin mund të keqpërdorin të dhënat tua personale.</p> <p>Ajo çfarë ju duhet të bëni është që të mos mbani sekrete me prindërit tuaj për gjërat që ju dyshoni se ka diçka shqetësuese në to. Ju duhet të bisedoni shtruar me prindërit dhe ta rrisni komunikimin për gjithçka që ju bëni në internet. Rekomandohet që fëmijët të luajnë me prindërit e tyre në mënyrë që edhe ata të vlerësojnë lojën që ju bëni dhe të vlerësojnë se kur kyçeni në loja <i>online</i>, ju luani të sigurt.</p> <p>Gjithashtu rekomandohet që fëmijët të luajnë lojëra që kanë reputacion (rating) të mirë, sepse këto lojëra janë më të sigurta, rreziku për viruse gjatë instalimit është më i vogël.</p>	

Pajiseni kompjuterin tuaj me antivirus dhe asnjëherë mos e ndalni (fikni) “firewall”-in në kompjuterin tuaj. Ju nuk duhet të lejoni veten të bëheni të varur pas lojërave në internet, sepse kjo mund të ju kushtoj shumë në shëndet, mësim dhe financiarisht.

Burimi: “Siguria e Fëmijëve në Internet” – Udhëzues për fëmijë: fq. 21-23

Botuar nga: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe

Diskutojmë për veçoritë e teksteve udhëzuese që dëgjuat

1. Teksti udhëzues informon për rregullat
2. Renditja e informacionit bëhet sipas radhës së veprimeve që duhen kryer për të realizuar një qëllim të caktuar
3. Shoqërohen me imazhe konkrete të cilat bëjnë që të kuptohet më mirë teksti udhëzues
4. Gjuha standarde, e thjeshtë dhe e qartë
5. Ndërtohet nga pjesë që janë lehtësisht të dukshme

Nxënësit japin mendimet e tyre. Vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për identifikimin e dallimin e veçorive të teksteve udhëzuese, për pjesëmarrjen aktive të tyre në orën e mësimin etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Sillni në klasë tekste udhëzuese

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Gjymtyrët homogjene (ora e parë)		Situata e të nxënimit: lidhet me identifikimin e gjymtyrëve homogjene në fjali.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënimit 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: gjymtyrë homogjene, kushte, funksion sintaksor, bashkërenditje, e njëjta gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët.	
Nxënësi /ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - dallon gjymtyrët homogjene në fjali; - rendit kushtet që duhet të plotësojnë dy gjymtyrë homogjene. 			
Burimet: Libri i nxënësit, Gramatika 2, skeda fjalish me gjymtyrë homogjene		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: INSERT; Diskutim; Punë individuale			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: INSERT			
U prezantohet nxënësve tema e re mësimore dhe u kërkohet që të punojnë me tabelën INSERT, fillimisht duke bërë shënimet në libër e më pas duke plotësuar tabelën.			
DI ✓	DUA TË DI ?	MËSOJ +	DI NDRYSHE -
Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim			
Diskutohet plotësimi i tabelës INSERT, e cila plotësohet gjatë këtij diskutimi nga mësuesi në tabelën e zezë. Sqarohen pyetjet apo paqartësitë e nxënësve dhe theksohet informacioni i ri.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale			
Nxënësit, individualisht, punojnë ushtrimin 1.			
Ushtrimi 1. Dalloni pohimin e saktë dhe të gabuar.			
*Dy a më shumë gjymtyrë janë homogjene: vetëm nëse lidhen me lidhëzën dhe; X			
*kur varen nga gjymtyrë të ndryshme; kur i përgjigjen së njëjtës pyetje; X			
*kur kryejnë të njëjtin funksion sintaksor, varen nga e njëjta gjymtyrë dhe bashkërenditen mes tyre; V			
*kur fjalët që varen nga gjymtyrë homogjene, janë po ashtu homogjene. X			
Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni gjymtyrët homogjene te pjesa "Purpuranti".			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Gjymtyrët homogjene (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: lidhet me dallimin e gjymtyrëve homogjene në fjali.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënësve 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: gjymtyrë homogjene, kushte, funksion sintaksor, bashkërenditje, e njëjta gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët.	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - dallon gjymtyrët homogjene në fjali; - dallon fjalitë e thjeshta me kallëzues homogjen nga fjalitë e përbëra; - ndërton fjali me gjymtyrë homogjene. 			
Burimet: Libri i nxënësve, Gramatika 2, skeda fjalish me gjymtyrë homogjene		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur; Diskutim			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I. Nxënësit punojnë të pavarur ushtrim 2-6. Pas përfundimit çdo ushtrim diskutohet në klasë.			
Ushtrimi 2- Dalloni fjalitë e thjeshta me kallëzues homogjen nga fjalitë e përbëra.			
Binte shi dhe frynte erë. -P- U përkul dhe i përshëndeti të gjithë. -P- Ai jepte e merrte më kot për ta bindur mësuesin.			
-TH- Njeriu duhet të mendohet e të reflektojë(H) mirë para se të flasë. -P- Parkoi makinën dhe hyri në ashensor. -P- Të lëvizësh, të ecësh, të vraposh (H) ndihmon dhe përmirëson (H) shëndetin. P			

<p>3- Ndërtoni katër fjalë me kryefjalë homogjene. Shtoni nga një përcaktor për secilën. <u>Zemra dhe mendja e tij</u> punonin vetëm për atdheun. <u>Vajzat dhe djemtë e grupit</u> vendosën të bashkëpunonin për të arritur fitoren. U çuditëm kur pamë se <u>këlyshi i vogël dhe macja bardhoshe</u> ishin miqësuar me njëri-tjetrin. <u>Qetësia dhe lumturia e atyre njerëzve</u> tani ishte qëllimi i jetës së saj.</p> <p>4- <u>Plotësoni fjalitë e mëposhtme me kundrinorë homogjenë.</u> *Ata e donin <u>teatrin dhe kinemanë</u> më shumë se çdo gjë. *Gjente kohë për të mësuar <u>violinën dhe pianon</u> njëkohësisht. *Pavarësisht qortimeve të të tjerëve iu kthye sërish <u>pasionit dhe ëndrrës së tij</u>. *Ftesën ua dërgoi vetëm <u>shokëve dhe shoqeve të klasës</u>. *Fiku <u>televizorin, dritën dhe doli</u>. <u>Ushtrimi 5- Gjeneri rrethorët homogjenë.</u> Erdhi nga fillimi i muajit, një të hënë. <u>Sot, nesër dhe pasnesër</u> është pushim. Punonte <u>në heshtje, pa u ankuar</u>. Bën vapë e madhe <u>si jashtë, si brenda</u>. Rrugës, në të dalë të fshatit, takuam një të njohur. Ecte <u>duke gjuajtur gurët me këmbë dhe duke fishkëllyer</u>. Pritëm më kot një orë e gjysmë. Aty për aty nuk e kuptova në u tund llamba <u>nga era apo nga ndonjë tërmet</u>. <u>Ushtrimi 6. Dalloni dhe nënvizoni përcaktorët homogjenë.</u> Në kokën e tij <u>të vogël e të rrumbullakët</u>, bluante lloj-lloj mendimesh. Malet e larta, fushat e gjera dhe kodrinat e pafundme ia shtonin gëzimin njeriut. Mendimi <u>për të lënë gjithçka e për t' u kthyer në vendlindje</u> nuk po e linte të qetë. Shtëpi <u>me mure dhe çati</u> prej guri, veç atje kishte. Porositi një gotë me ujë të ftohtë.</p>
<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një tekst përshkruar ku të përdorësh gjymtyrë homogjene. Nënvizojini ato.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
<p>Tema mësimore: Si të shkruajmë një plan për një projekt.</p>		<p>Situata e të nxënës: Regjimi ditor Regjimi ditor është shumë i rëndësishëm për shëndetin e një fëmije. Fëmijët, sidomos në moshën e para-adoleshencës, duhet të mësohen nga prindërit me regjim ditor si në të ushqyer edhe në aktivitetet fizike dhe argëtuese.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh fjalët dhe terminologjinë e duhur për të arritur qëllimin e tij; - përmbledh idetë kryesore, pasi ka lexuar një tekst; - rilexon një tekst për të ngulitur në mendje detajet më të rëndësishme; - studion modelet e dhëna për të shkruarit; - zbaton njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - përdor gjuhën standarde gjatë të shkruarit. 		<p>Fjalët kyçe: projekt, qëllim, objektiva, koha, përgjegjës, burime, plan.</p>	

Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga nxënësit apo mësuesi/ja.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, fjalët kyçe, minileksion, punë me tekstin, punë me modele, punolshkëmbje, konkurs.</i>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi, fjalët kyçe.</i></p> <p>Në fillim të orës së mësimit mësuesi/ja pyet nxënësit për regjimin e tyre ditor. Nxënësit ngrihen me radhë dhe tregojnë për regjimin e tyre të përditshëm ditor.</p> <p>Shtrohet pyetja: - Si është një ditë normale e nxënësit të klasës së nëntë?– A ka raste kur ky regjim priset? Si vepron kur jeni shumë të ngarkuar me detyra dhe mendoni se ju duhet kohë? Kush ju ndihmon në këto raste? Ku i gjeni informacionet për të kryer sa më mirë dhe shpejt një detyrë të ngarkuar? (<i>Jepen përgjigje të ndryshme sipas aktiviteteve të secilit nxënës</i>).</p> <p>Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa fjalë kyçe si:Projekt, qëllim, objektiva, koha, përgjegjës, burime, plan.</p> <p>Nxënësit japin ide të ndryshme rreth lidhjes së fjalëve në një kontekst të caktuar. Sqarohen me radhë se çfarë kuptimi ka secila fjalë.</p> <p>Nxënësit jo vetëm janë njohur me termin “projekt”, por edhe kanë punuar me projekte, prandaj nga mësuesi/ja shtohet pyetja : Cilat janë hapat e zhvillimit të një projekti sipas njohurisë që keni? Cilat janë hapat që keni ndjekur ju për të zhvilluar një projekt? (<i>Titulli i projektit, objektivat e projektit, temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit, partnerët (nëse ka, si: prindër, OJF), numri i orëve gjithsej të projektit dhe i ndarë në mes të mësuesve nëse është ndërlëndor, numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave, përshkrimi i shkurtër i veprimtarive kryesore të projektit; përshkrimi i shkurtër i produktit të projektit; mënyra e prezantimit përfundimtar të projektit dhe prezantimi i projektit</i>).</p> <p>Mësuesi/ja jep një shembull nga letërsia artistike ku hartohet një plan, për një qëllim të caktuar, nga disa fëmijë. “Fantazma dhe plani 3+4” nga Petro Marko.</p> <p>Ky roman tregon për aventurat e një djali, Besimit dhe disa miqve të tij në fshatin ku kishte lindur babai i Besimit. Djalin e tërheq shumë gërmadha e errët e kështjellës ogurzezë ku thuhet nëpër fshat se banonte një fantazmë. Kjo fantazmë u del përpara vetëm vajzave dhe grave, kurse burrave dhe djemve jo. Besimi takoi disa shokë dhe filloi të mbledhte një grup për të kapur fantazmën. Ai filloi të mbante edhe shënime gjithashtu. Ata vendosën dhe bënë një plan që ia vunë emrin 3+4 sepse ishin 3 vajza dhe 4 djem. Filloi zbatimi për planin 3+4. Në të vërtetë fantazma nuk ishte... , por fëmijët u ndjenë të gëzuar që zbuluan “fantazmën”.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Minileksion, punë me tekstin, punë me modele.</i></p> <p>Mësuesi/ja njeht nxënësit me temën e mësimit “Shkruajmë një plan për një projekt”.</p> <p>Jepen sqarime: Projekti do të konsiderohet si një model të shkruari, përmes të cilit nxënësit do të parashtrajnë idetë dhe synimet e tyre për një punë që pritet të bëhet.</p> <p>Projekti do të konsiderohet edhe si një mënyrë e të përshkuarit të aktiviteteve ose të punëve që kryhen përmes një planifikimi.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Identifikoni në fillim qëllimin e planit të punës. Planet e punës shkruhen për arsye të ndryshme. 2- Përcaktoni objektivat tuaj që i keni vënë këtij projekti. Objektivat janë specifike dhe të matshëm. 3- Përcaktoni saktësisht veprimtarinë, llojin e saj e cila do të kryhet për të arritur objektivat. 4- Përcaktoni kohën kur do të kryhet veprimtaria për përmbushjen e objektiveve. 5- Renditni burimet tuaja. Përfshini çdo gjë që do të jetë e nevojshme që mund t’ju ndihmojë nëse keni pyetje apo nevojë për ndihmë. <p>Punohet me njohuritë e dhëna në tekst dhe nxirren hapat që duhet të ndiqen për planin e projektit.</p> <p>Mësuesi/ja ndërton një model plani për projektin në tabelë.</p> <p>Konventa për të Drejtat e Fëmijës përshkruan: Neni 2, “E drejta për të mos u diskriminuar”. “Asnjë fëmijë nuk duhet të diskriminohet për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit, vendit të origjinës, varfërisë ose pasurisë, paaftësisë ose përkatësisë në një pakicë etnike”.</p> <p>Të bazuar mbi këtë nen,por edhe mbi sjelljet sociale të nxënësve të shkollës, Senati i shkollës harton një plan pune.</p> <p>Qëllimi: Eliminimi i sjelljeve dhe i mendimeve raciste në shkollë.</p>	

Qëllimi	Veprimtaria	Afati	Personat përgjegjës	Burimet	Komente
Objektivi 1. – Të ndërgjegjësohemi për ekzistencën e racizmit në shkollën tonë.	1-Pyetësor me nxënës të klasave të ndryshme dhe prindër të ndryshëm të shkollës.	Nëntor-shkurt	Senatorët e klasave VIII dhe IX.	Konventa e të drejtave të njeriut, Kryqi i Kuq, interneti.	Intervista do të zhvillohet me prindër, mësues e nxënës të ndryshëm të shkollës.
Objektivi 2. – Të “luftojmë” sjelljet raciste në shoqërinë tonë.	1-Takim me psikologun e shkollës dhe nxënës të klasave të ndryshme. 2-Takim me nxënës që shfaqin sjellje raciste dhe prindërit e tyre.	Mars - qershor	Senatorët e klasave të IX-ta, Psikologu i shkollës.	Rregullorja e shkollës, Konventa e të drejtave të njeriut, interneti.	Psikologu i shkollës sqaron nxënësit e prindërit mbi sjelljet e gabuara raciste.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punolshkëmbje, konkurs.*

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 vetë sipas tavolinave ku janë ulur. Udhëzohen të punojnë me ushtrimin e tekstit për të krijuar një plan vjetor të punës së Senatit të shkollës, sipas skemës së dhënë në libër.

Nxënësit punojnë për disa minuta duke dhënë ide dhe duke shkëmbyer mendimet me njëri – tjetrin.

Në fund të orës do të lexohen disa plane që kanë hartuar nxënësit për detyrën e dhënë.

Diskutohet me nxënësit e senatorin e klasës në formën e një konkursi të thjeshtë, për të zgjedhur planin më të saktë sipas njohurive të marra dhe udhëzimeve të bëra nga mësuesi/ja.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Llojet e fjalive sipas kumtimit		Situata e të nxënët: Puna me tekstin	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Sintaksë			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe:			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: fjali dëftore, grupe fjalësh; rregulla gramatikore, gjymtyrë fjalie.	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalitë dëftore dhe i përdor drejt ato; - identifikon gabimet në fjalitë e ndërtuara gabim duke bërë rregullimet e duhura; - rishkruan fjalitë duke ndryshuar rendin e grupeve të fjalëve. 			
Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha Shqipe 9”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim; tabela insert; punë dyshe; punë individuale

Organizimi i orës së mësimi:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: diskutim

Mësuesi shkruan në tabelë disa fjali dhe u kërkon nxënësve të diskutojnë rreth respektimit dhe mosrespektimit të rregullave gramatikore në ndërtimin e fjalive si dhe anës kuptimore të tyre: (diskutim)

A. *Mua nuk pëlqen këtë këngë.* B. *Mua nuk më pëlqen kjo këngë.* C. *Molla hëngri njeriun.* D. *Njeriu hëngri mollën.*

Ndërtimi i njohurive të reja: tabela insert; punë dyshe

Mësuesi drejton nxënësit në fq.316 në tekst dhe ata lexojnë në heshtje mësimin për disa minuta.

Ndërtohet tabela INSERT nga mësuesi dhe nxënësit e plotësojnë sipas kolonave përkatëse.

DI (V)	DUA TË DI (?)	MËSOVA (+)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale

1. Lexoni shembujt e mëposhtëm dhe dalloni ndërtimet e pasakta. Argumentoni përgjigjen tuaj.

*Dimër. V

*Gjatë dimrit, ne. X (*mungon grupi i kallëzuesit*)

*Dimri mbajti e ftohtë. X (*nyja e mbiemrit duhet në gjininë mashkullore i ftohtë*)

*Dimri mernte ilaçe për ftohje të rëndë. X (*rasa e gabuar e emrit dimri*)

*Dimër nga mbulohen bora në malet. X (*rend i gabuar i fjalëve në fjali*)

*Dimri është koha e duhur që njerëzit që e duan të ftohtët dhe borën që mbulon malet që shtrihen në lindje të qytetit që është i rënduar nga smogu që shkaktohet nga makinat e shumta që tejmbushin rrugët tona që janë si qorrsokakë që nuk u gjendet filli, të gjejnë prehje në pistat e skive. V

2. Rishkruani si duhet fjalitë e mëposhtme pasi të keni analizuar gabimet për secilën

Nuk m'pihet më ujë. => Nuk më pihet më ujë (*përdorim i gabuar i apostrofit*)

A e di emrin atij? => A ia di emrin atij? (*trajtë e shkurtër e përdorur gabime-ia / fjalët janë shkruar ngjitur si një fjalë e vetme*)

Unë mendoj që unë të shkoj. => Unë mendoj që të shkoj. (*Nuk është e nevojshme përsëritja e kryefjalës, ajo nënkuptohet*)

Të gjithë ishin të gëzuar. => Të gjitha ishin të gëzuara. (*gjini e gabuar e mbiemrit të gëzuar-të gëzuara / fjalët janë shkruar ngjitur si një fjalë e vetme*)

Nesër vendosim ç'duhet bërë dje. => Nesër vendosim ç' duhet bërë nesër. (*është përdorur ndajfolja e gabuar*)

3. Dalloni pohimin e saktë dhe të gabuar. *Çdo fjali ka kryefjalë dhe kallëzues. X

*Kryefjala qëndron gjithnjë në krye të fjalisë. X

*Fjalja mund të ndërtohet edhe me një fjalë të vetme. V

*Rendi i çdo fjale të fjalisë është i lirë. X

*Folësi mund të ndërtojë fjali të sakta, pa i njohur rregullat e gramatikës. V

4. Dalloni dhe analizoni gabimet në fjalitë e mëposhtme.

Vajza, e cila (*të cilën => përshtatja në rasë e përemrit lidhor*) takuam dje, do të vijë në festën tonë. Kur shkoni (*shkojmë => folja në kohë të gabuar*) me pushime, marrim gjithnjë shumë gjëra me vete. Nëse nuk pushon shiu, as sot nuk (*mungesa e pjesëzës mohuese "nuk"*) shkohet atje. Me të perënduar diellin (*dielli=>emri në rasë të gabuar*), dolëm.

Kush (*Cili =>përdorim i gabuar i përemrit pyetës "kush" në shoqërinë e emrit*) fëmijë po qan? Si sot kanë ardhur gjërat kështu? (*Si kanë ardhur gjërat kështu sot?=> rend i gabuar i fjalëve në fjali*)

5. Dalloni grupet e fjalëve dhe rishkruani fjalinë e mëposhtme duke ndryshuar rendin e tyre.

Sot, shumica e nxënësve, si rrallëherë kishin ardhur në shkollë pa e lexuar librin e sugjeruar javë më parë nga mësuesi i letërsisë.

Sot si rrallëherë / shumica e nxënësve / kishin ardhur në shkollë pa e lexuar librin e sugjeruar javë më parë nga mësuesi i letërsisë.

Shumica e nxënësve kishin ardhur në shkollë, sot si rrallëherë, pa e lexuar librin e sugjeruar javë më parë nga mësuesi i letërsisë.

Shumica e nxënësve / kishin ardhur në shkollë pa e lexuar librin e sugjeruar javë më parë nga mësuesi i letërsisë, rrallëherë si sot.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6- fq. 318

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: "Revista e shkollës" (projekt, ora e dytë)		Situata e të nxënimit: Tekstet joletrare. Rregullorja e klasës: - Të mos bëjë mungesa të paarsyeshme. - Të vijë në shkollë me uniformë. - Të jetë i vëmendshëm në orën e mësimit. - Të respektojë mësuesit dhe shokët e klasës. - Të përdorë fjalor të zgjedhur në komunikim me të tjerët.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënimit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - bashkëpunon me shokët e shoqet për të sjellë informacionet dhe materialet e duhura; - përshtat gjuhën me llojin e detyrës me shkrim, me qëllimin dhe me lexuesin; - mban shënime për detajet e rëndësishme; - mbledh informacion për punë dhe detyra me shkrim nga burime të ndryshme duke përdorur strategji të ndryshme; - dallon dhe përdor njohuritë rreth elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet, - përmbledh informacionin që prezantohet gjatë diskutimeve në klasë; - shkruan pa gabime drejtshkrimore në materialet e përzgjedhura.		Fjalët kyçe: tekste joletrare, revistë, kronikë, intervistë, informacione, njoftime, lojëra, arti, kultura.	
Burimet: Materiale të gatshme nga botime të ndryshme revistash, revista të botuara nga nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Arte, Teknologji dhe TIK, Matematikë, Edukim fizik, sporte dhe shëndet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, rrjeti i diskutimit, minileksion, studim rasti, organizuesi grafik, punë me grupe, puno/shkëmbe.			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, rrjeti i diskutimit. Në fillim të orës së mësimit mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën: E ardhmja! Kërkohet nga nxënësit që të diskutojnë rreth ideve dhe ndjenjave që u lindin kur mësuesja shkruan temën. Nxënësit japin mendime të ndryshme të cilat lidhen me: shkollën, punën dhe profesionin që do të bëjnë, me shoqërinë dhe miqësinë, pasurinë, hallet si të rritur, familjet e tyre etj. Nxënësit argumentojnë përgjigjet duke i vendosur si përparësi për të ardhmen e tyre këto çështje. Mësuesi/ja shtron pyetjen: - Cili faktor apo personazh mendoni ju se ka rëndësi të madhe në të ardhmen tuaj? (<i>faktorë të rëndësishëm mund të jenë: shëndeti i plotë, shkollimi i duhur, ndihma nga familja, gjendja e mirë ekonomike e familjes, shoqëria, fati</i>). - Çfarë mund të bëjmë ne për të ardhmen tonë? (<i>të shkollohemi sa më mirë, të kujdesemi për mjedisin ku jetojmë, të jemi të drejtë, të zbatojmë ligjet dhe të kërkojmë zbatimin e tyre, të mos tolerojmë padrejtësitë, të kujdesemi për shëndetin, të ngremë zërin ndaj padrejtësive etj</i>). Nxënësit në formën e rrjetit të diskutimit hedhin idetë e tyre të cilat shtjellohen nga vetë ata, por plotësohen edhe nga mendimet e shokëve dhe shoqeve.			

Ndërtimi i njohurive të reja: *minileksion, studim rasti.*

Mësuesi/ja njih nxënësit më temën e orës së mësimi: Revista e shkollës (ora e dytë).

Revista është një mjet në të cilin mund të përdorim zërin tonë për çështje e tematika që na shqetësojnë dhe të ndikojmë tek të tjerët.

Për të bërë një punë sa më të saktë rikujtohen njohuritë e marra për tekstet joletrare, llojet e tyre dhe disa nga tiparet dalluese.

Teksti joletrar na shërben për të marrë informacion, për t'u ndjerë pjesëtarë të shoqërisë. Këtu mund të futen gazetat dhe revistat.

Tek një gazetë apo revistë mund të gjejmë lloje të ndryshme shkrimesh.

Udhëpërshkrimi: *Ndërthur shkrimin publicistik me atë letrar. Autori sjell fakte, të dhëna konkrete, të sakta, por përdor një gjuhë të zgjedhur për të tërhequr vëmendjen e lexuesit.*

Kronika: *Shtjellon ngjarje duke e dhënë rrjedhën kohore sipas rendit që ka ndodhur, por duke sjellë fakte mbi ngjarjen e duke sqaruar detajet rreth saj.*

Reportazhi: *Shkrim letrar- publicistik. Autori ngre një problem dhe e trajton me ndërthurjen e elementeve letrare me ato reale duke përcjellë edhe mesazhin përmes sugjerimeve të veta.*

Kujtime: *Autori njih lexuesin me kujtime nga jeta e tij dhe i bën publike për lexuesin përvojat dhe problemet e hasura gjatë jetës së tij. Këto kujtime shërbejnë si fakte për të dhënë hollësi mbi një ngjarje, si dëshmi historike.*

Intervista: *Shkrim publicistik. Ndërtohet nëpërmjet pyetjeve që i drejtohen nga gazetari një personazhi të njohur dhe interesant për lexuesit dhe përgjigjeve të dhëna.*

Gjatë kohës që sqarohet leksioni dhe rikujtohen njohuritë, nxënësit dëgjojnë mësuesin/en dhe mbajnë shënime.

Nga materialet e gatshme mësuesi/ja përzgjedh një tekst joletrar dhe e prezanton para nxënësve duke analizuar elementet e tekstit.

Model i një teksti joletrar, intervistë.

Intervistë me kryetaren e Bordit të shkollës.

Përshëndetje!

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të 50-vjetorit të kësaj shkolle. Ne duam të dimë më shumë për organet drejtuese që janë risi ndër vite, prandaj zgjedhëm t'ju intervistojmë juve si Kryetare e Bordit të Prindërve.

Si u zgjodhët dhe prej sa kohësh qëndroni në krye të kësaj detyre?

- Jam zgjedhur prej tre vitesh në krye të këtij posti nga mbledhja e parë, e cila u zhvillua me rastin e fillimit të vitit shkollor dhe me pjesëmarrjen e prindërve e këshillit të prindërve.

Cili është funksioni i Bordit të prindërve?

- Disa nga detyrat mund të veçoj: Të miratojë planin afatmesëm dhe vjetor të institucionit, të miratojë planin e shpenzimeve, të marrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit nga detyra të drejtorit ose mësuesve, të shqyrtojë rregulloren e brendshme të institucionit.

Nga cilët përbëhet ky organ drejtues?

- Bordi përbëhet nga shtatë anëtarë: 1 mësues, 2 prindër, 2 nxënës, 1 pjesëtar nga komuniteti dhe 1 përfaqësues i qeverisjes lokale.

Sa të kënaqur jeni me bashkëpunimin dhe kontributin e prindërve në shkollën tonë?

- Jam shumë e kënaqur, sepse në mbledhjet që zhvillojmë gjithmonë mundohemi të biem dakord.

Ju jeni prind i dy nxënësve që studiojnë këtu, pse zgjodhët pikërisht këtë shkollë për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve tuaj?

- Kjo është një pyetje shumë e drejtë. Unë zgjodha shkollën tuaj, sepse në radhë të parë më pëlqyen ambientet e kësaj shkolle, pastërtia, rregulli dhe qetësia. Kisha dëgjuar fjalë të mira edhe për mësuesit, të cilët janë të shkëlqyer, të sjellshëm dhe të dashur në komunikimin me fëmijët.

Cilat janë gjërat që ju do të donit t'i ndryshonit apo përmirësonit duke i parë me syrin e prindërve?

- Siç jua thashë edhe më parë, jam shumë e kënaqur në kuptimin e plotë të fjalës nga stafi pedagogjik, nga drejtoresha, e cila gjithmonë i ka këshilluar fëmijët dhe ka qenë e pranishme në çdo problem që ata hasnin.

Faleminderit për intervistën.

Ju urojmë suksese në punën tuaj.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Organizuesi grafik, punë me grupe, puno/shkëmbe.*

Nxënësit kanë sjellë materialet e duhura të cilat i kanë përgatitur për orën e dytë të projektit sipas grupit të ekspertëve që bëjnë pjesë (të përzgjedhur që në orën e parë të projektit).

Mësuesja ndërton një tabelë organizative për të shpërndarë ekspertët në grupe të tjera.

Ndarja e grupeve	Mjedisi dhe shoqëria	Gjuha dhe komunikimi	Sporti	Arti dhe kultura	TIK	Redaktimi	Mjedisi e shoqëria
Emrat e nxënësve Revista 1.	Shënohen emrat nga grupi i ekspertëve të kësaj fushe që do të jenë tek revista 1.	Shënohen emrat që do të jenë tek revista 1.	Vendosen emrat nga grupi i ekspertëve që do të jenë tek revista 1.	Emrat nga grupi i ekspertëve të kësaj fushe.	Emrat e ekspertëve të TIK që do të merren me revistën 1.	Përzgjidhen emrat që do të bëjnë redaktimin tek revista 1.	Shënohen emrat nga grupi i ekspertëve të kësaj fushe.
Revista 2							
Revista 3							

Në bazë të numrit të nxënësve mësuesi/ja vendos se sa grupe për botimin e revistës do të krijojë. Pasi janë mbledhur materialet nga grupet e ekspertëve, rikrijohen grupet e reja të punës tashmë për hartimin e revistës.

Nxënësit mblidhen në grupe sipas revistës së caktuar ku bëjnë pjesë dhe shkëmbejnë me njëri -tjetrin ide dhe mendime rreth mënyrës së duhur të botimit.

Mbahen shënime mbi mënyrën e përzgjedhjes së materialeve, datës së dorëzimit të grupi, tematikave të dhëna etj.

Vlerësimi: Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet mënyra e aktivizimit dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Pengesat në kënaqësinë e leximit		Situata e të nxënit: Librat jashtëshkollorë. Çdo libër është një aventurë e re, një mësim i ri. Çdo libër përcjell një mesazh të lexuesi, aftëson të menduarit, zgjeron kufijtë e fantazisë dhe i jep ndjenjën e të qenit me një mik të mirë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - rilexon tekstin për të ngulitur në mendje detajet më të rëndësishme të tekstit; - dallon llojin e tekstit joletrar sipas qëllimit të tij; - nxjerr tezën dhe argumentet e tekstit të dhënë; - jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij; - përdor organizuesin grafik për të shënuar faktet dhe idetë e rëndësishme që gjen; - zberthen kuptimin e frazave të përdorura nga autori.		Fjalët kyçe: pengesa, lexim, kënaqësi, bindje, argument, tezë, kundërshtim.	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, ditari dypjesësh, punë me tekstin, organizuesi grafik, hulumtim, punë me modele.*

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, ditari dypjesësh.*

Mësuesi/ja në fillim të orës zhvillon një bisedë me nxënësit rreth librave që ata kanë lexuar sipas pyetjeve: - Cilët kanë qenë librat që keni lexuar së fundmi? A e mbani mend autorin e tij? - Cila ishte tematika që trajtonte libri? - A ju pëlqeu? - Cili jua rekomandoi atë libër? - Po ju a do t'ua rekomandonit shokëve tuaj? - Sa libra keni në shtëpi? - Sa lekë harxhoni për të blerë libra? - Nëse mësuesi/ja nuk do t'ju kërkonte të lexonit, a do të lexonit libra me dëshirën tuaj? - Çfarë librash do të lexonit? - A lexoni tekste të tjera përveç librave shkollorë? - Sa orë i kushtoni leximit? - Po internetit dhe lojërave sa kohë i kushtoni?

(Nxënësit japin përgjigje të shkurtra dhe mësuesi/ja ndalon shpesh për të marrë më shumë detaje e hollësi nga përgjigjet e nxënësve kur ato lidhen me temën e re të mësimit).

Në dërrasën e zezë mësuesi/ja ndërton një tabelë me dy pjesë “Libri dhe interneti” dhe ndan gjithashtu edhe klasën në dy grupe.

Njëri grup do të mbrojë tezën në të cilën libri është më i vlefshëm se interneti, dhe grupi tjetër do të mbrojë të kundërtën.

Nxënësit lihen të lirë të diskutojnë pa zhurmë me njëri – tjetrin për të gjetur argumentet që duhet të përdorin.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të sqarojnë shkurtimisht mbi përzgjedhjen e argumenteve që duken më të sakta dhe me vlerë rreth temës. Sqarohet termi “Argument”.

Argument - Arsyetim që përdoret për të vërtetuar ose për të kundërshtuar, provë që sillet për të mbrojtur ose hedhur poshtë diçka.

Libri është më i mirë sepse	Interneti
<p>Nga përdorimi i internetit mund të shkaktohet: dëmtimi i syve (duke shtuar përqindjen e personave që përdorin syze), dhimbje koke (kjo shkaktohet nga drita e fortë e kompjuterave dhe telefonave), përdorimi i një fjalori jo të mirëfilltë, rritjen e personave që vuajnë nga dembelizmi (duke qenë se ata luajnë nëpërmjet kompjuterave dhe lexojnë libra në mënyrë elektronike). Fëmijët që e përdorin me orë të tëra lënë edhe mësimet pas dore.</p> <p>Libri s'ka nevojë as për bateri e as për antenë.</p> <p>Libri të fal një ndjesi, të cilën ti nuk do ta përjetosh kurrë në internet.</p>	<p>Në internet mund të gesh shumë kollaj dhe pa lodhje materiale.</p> <p>Ti mund të argëtohesh me lojëra të ndryshme.</p> <p>Mund të komunikosh me të tjerët që janë larg.</p> <p>Mund të bësh pazare on – line.</p> <p>Mund të shohësh një film të ri.</p> <p>Mund të dëgjosh muzikën që të pëlqen.</p> <p>Aty mund të gesh çdo lloj informacioni që nga recetat e gatimit etj.</p>

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë me tekstin, organizuesi grafik.*

Njihen nxënësit me temën e mësimit “Pengesat në kënaqësinë e leximit”, i cili është një tekst joletrar, argumentues. Nxënësit nxjerrin bashkë me mësuesin/en njohuritë që kanë rreth tekstit argumentues si: tekst joletrar, ka qëllim të bindë lexuesit për një çështje të caktuar në të cilën autori vetë është i bindur, ka elemente letrare për ta bërë sa më tërheqës për dëgjuesin apo lexuesin.

Punohet me tekstin duke e lexuar me radhë, në formë zinxhiri, për të kuptuar llojin e tekstit dhe qëllimin.

Duke u mbështetur në të dhënat e tekstit të nxënësit, sqarohen me një organizues grafik elementet përbërëse të tekstit argumentues.

Qëllimi i tekstit argumentues	Struktura	Llojet e teksteve	Gjuha e argumentit
Të bindë lexuesin për një çështje të caktuar nëpërmjet argumenteve apo arsytetimeve, të cilat janë fakte, shembuj, prova apo gjykime praktike të autorit.	Struktura e tekstit argumentues përbëhet nga: hyrja, në të cilën prezantohet çështja; teza në të cilën shprehet pohimi kyç i tekstit, vërtetësia e të cilit duhet argumentuar; argumentet në mbështetje të tezës; jo domosdoshmërisht kundërteza, e cila kundërshton tezën; mbyllja, e cila është një konkluzion nëpërmjet të cilit konfirmohet teza.	Llojet e teksteve argumentuese janë të shumta, ato më të përdorshmet janë: fjalime, letra të hapura, artikuj gazete, ese argumentuese, reklama promovionale etj.	Gjuha e argumentimit dallon për përdorimin e fjalëve apo frazave, të tilla si: <i>kështu, në këtë mënyrë, si rezultat, mendoj se, sipas opinionit tim, jam kundër mendimit se, etj.</i> Vërtetësia e argumentimit ndërtohet nëpërmjet përdorimit të referencave, citimeve nga autoritete dhe burime të ndryshme informuese. Foljet përdoren kryesisht në kohën e tashme.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Hulumtim, punë me modele.*

Nxënësit udhëzohen të hulumtojnë me tekstin për të nënvizuar në të elementet e tekstit të vendosura në tabelë.

Punohet në mënyrë individuale mbi tekstin dhe mbahen shënime në fletore. Mësuesi/ja ndjek punën e nxënësve duke bërë sqarime dhe udhëzime për plotësimin e saktë të detajeve të kërkuara.

Lexohen me radhë ilustrimet e gjetura në tekst mbi elementet e tekstit argumentues.

Punë individuale me ushtrimin 1: Në tekstin e mësipërm autori: *argumenton qëndrimin e tij ndaj një dukurie.*

Mësuesi/ja lexon disa argumente për punën me modele:

1. Stimulon imagjinatën. Të gjithëve na pëlqen të shikojmë televizorin dhe filmat, por njëra nga arsyet më të mira të leximit të librit është se ju përdorni imagjinatën tuaj për të përshkruar karakteret dhe gjërat që i rrethojnë. Është gjithnjë e rëndësishme të kesh imagjinatë aktive dhe leximi i ndonjë libri interesant është rrugë e sigurt për të stimuluar mendjen tuaj!
2. Nëse je duke kaluar në situatë të vështirë, ke një ditë të keqe apo ndihesh depresiv, të humbësh mendjen në një libër është një mënyrë e mirë.
3. Informative. Informacioni do mbetet më gjatë në mendjen tënde nëse lexon një libër.
4. Pasuron fjalorin. Ata që lexojnë rregullisht, zakonisht kanë fjalor më të pasur se sa ata që rrallë lexojnë dhe kjo gjë do t'u shërbejë shumë edhe në të ardhmen, në debate, prezantime etj.
5. Librat shpesh janë më të mirë se sa filmat që bëhen bazuar në to. Kjo për shkak se filmi ka 2 ose më së shumti 3 orë për të treguar tërë ngjarjen, ndërsa libri është shumë më i gjatë dhe ka mundësi të përshkruajë shumë më shumë detaje të zhvillimit të situatave dhe karaktereve.
6. Ti mund të lexosh gati në çdo vend pa penguar dikë tjetër rreth teje. Leximi është mënyrë e mirë e kalimit të kohës pa e penguar dikë tjetër.

7. Inkurajon të tjerët. Nëse ju shohin që po lexoni, kjo do t'i inkurajojë ata që ta bëjnë të njëjtën gjë. Leximi ka aftësi të hapë shumë rrugë dhe sot shumë fëmijë të vegjël dhe të rritur nuk inkurajohen aq sa duhet për të lexuar për kënaqësi dhe mendojnë se leximi është thjesht për detyrë shtëpie dhe diçka që kërkohet detyrimisht nga ta. Nxënësit duhet të gjejnë tek modelet e dhëna: llojin e tekstit (*joletrar, argumentues*), tezën e hedhur nga autori (*arsyet përse duhet të lexojmë*), gjuha e përdorur (*e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë*), kujt i drejtohet (*të gjithëve, të rinjve, fëmijëve*).

Vlerësimi: Vlerësim motivues me fjalë e shprehje për përgjigjet e dhëna dhe njohuritë rreth tekstit argumentues dhe elementeve përbërëse të tij. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxjerrja e detajeve përshkruese në tekst.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Pengesat në kënaqësinë e leximit		Situata e të nxëniet: Shkolla e mesme dhe profili i zgjedhur. Suksesi në shkollën e detyruar është shumë i rëndësishëm për mundësitë e më vonshme. Pas mbarimit të shkollës së detyruar, të rinjtë kanë shumë rrugë të hapura, për të gjetur një zgjidhje në jetën profesionale. Pa një arsimim të mëtejshëm, është vështirë për të gjetur një vend të mirë pune.	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - nxjerr tezën dhe argumentet e tekstit të dhënë; - jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij; - dallon paragrafët dhe zbërthen kuptimin e tyre; - analizon nga ana gjuhësore tekstin argumentues; - përdor organizuesin grafik për të shënuar faktet dhe idetë e rëndësishme që gjen; - zbërthen kuptimin e frazave të përdorur nga autori.		Fjalët kyçe: argument, pengesa, lexim, kënaqësi, vuajtje, teza, kundërteza.	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe” 9, materiale shtesë nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë me tekstin, rrjeti i diskutimit, pyetje- përgjigje, punolshkëmbe.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë me tekstin, rrjeti i diskutimit.</i> Mësuesja shtron pyetjen në formën e bisedës: - Kur të mbaroni arsimin e detyrueshëm ku mendoni të shkoni për të vazhduar studimet tuaja? - Vendosni vetë për shkollimin tuaj apo vendosin prindërit? – Si do të vepronit për të bindur prindërit që t’ju lënë të shkoni në një shkollë që ju dëshironi? (<i>nxënësit japin mendime rreth pyetjeve duke u mbështetur edhe te përvojat e tyre nga situatat e krijuara në familjet e tyre</i>). Duke u mbështetur tek përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja shkruan një tezë në tabelë: Dua të vazhdoj studimet e ciklit të mesëm të ulët në një shkollë private. Shkruani disa argumente pro tezës dhe disa argumente kundra tezës. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të gjetur argumentet e kërkuara dhe puna e tyre ndiqet dhe kontrollohet nga mësuesi/ja. Shkruhen në tabelën e zezë disa argumente të nxjerra nga nxënësit.			
Teza	Shkollimi më i mirë arrihet në një shkollë private.		
Argumentet pro tezës	Sepse ka më pak nxënës nëpër klasa dhe për rrjedhojë duhet të ketë më shumë kërkesë llogarie dhe të pyetesh më shpesh. E zgjedh vetë shkollën që më pëlqen. Disa nga shokët e mi do të shkojnë atje. Atje ka më shumë kushte, notën mund ta marrësh më kollaj etj.		
Argumentet kundër tezës	Atje kushton më shumë se sa shkolla në një gjimnaz shtetëror, duke pasur më pak nxënës ti nuk do të kesh konkurrencë dhe nuk do të mësosh, nota që mund ta marrësh kollaj nuk tregon njohuritë e tua, nuk të vlen nota pa njohuritë etj.		

Ndërtimi i njohurive të reja: *Termtat kyçe, shembuj paraprakë.*

Mësuesi/ja shkruan në tabelë termtat kyçe: paragrafë, rrëfim subjektiv, folje ndihmëse.

Rikujtohen me nxënësit njohuritë e marra rreth këtyre termave.

- Paragrafi i mirë duhet të ketë një mendim, një qëllim. Nëse gjatë shkrimit idetë tuaja do të ndryshojnë, atëherë edhe paragrafët duhet të ndryshojnë.

Paragrafi të jetë i qartë dhe i renditur në mënyrë logjike, pra të kuptohet qysh me leximin e parë. Në paragraf, të gjitha fjalitë janë të lidhura me njëra – tjetrën. Paragrafi duhet të jetë i kuptueshëm. Në aspektin pamor, rreshti i parë i paragrafit është më i zhvendosur, me fjalitë që vijnë më pas në paragraf. Paragrafi përbëhet nga fjalitë që trajtojnë të njëjtën temë.

-Rrëfimi subjektive tregon dhe e përshkruan dukurinë, sendin a frymorin nga këndvështrimi i tij,shpreh qëndrime e opinionone,do të përcjellë emocione që i ka përjetuar dhe vetë.

- Foljet ndihmëse janë folje që tregojnë: fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e veprimit në kallëzuesit e përbërë: filloj të luaj, vazhdonte të luante, mbaroi së luajturi; foljet gjysmëndihmëse tregojnë: mundësi, domosdoshmëri e detyrim dhe janë pjesë e kallëzuesit foljor të përbërë: mund të luaj, duhet të luaja, do luajtur.

Mbi njohuritë e përsëritura nxënësit japin disa shembuj paraprakë.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Pyetje- përgjigje, puno/shkëmbe.*

Punohet me tekstin në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve.

- Çfarë argumenton autori në këtë tekst? - *Mbi zbulimin e kënaqësisë së leximit.*

- Për cilin zbulim e ka fjalën autori kur u referohet të rinjve? - *Ndërgjegjësimin, vetëdijësimin për mundësitë e tyre të mëdha e të pamata.*

- Kujt i drejtohet autori gjatë rrëfimit në vetën e dytë? - *Lexuesit të tekstit që janë nxënësit, i drejtohet një fëmije në moshë shkollore.*

- Cili është sipas autorit, kushti për të ndier kënaqësinë e përpjekjeve? - *Nëse rezultatet janë pozitive, notat janë të mira, ndiejmë kënaqësi.*

- Si përshkruhet rruga e shkollimit dhe realiteti me të cilin përballlet individi?- *Rruga përshkruhet me shumë pengesa, me sprova që kërkojnë përpjekje të mëdha.*

- Cilat janë pasojat e vështirësive të hasura në botën e shkollimit? - *Reagime zemërake, ankthi, pakënaqësia që bëhet shkak i grindjeve me familjarët, heqja dorë nga lojërat .*

- A është i njëjtë qëndrimi i autorit në fillim dhe në fund të pjesës? - *Qëndrimi është i njëjtë dhe autori nxjerr një konkluzion mbi tezën.*

Ushtrimi 2. Cila është tema e këtij shkrimi?- *Pengesat në kënaqësinë e leximit.* Po teza e tij?- *Teza e hedhur nga autori është: “Studimi e leximi nuk sjell kënaqësi”. Argumentoni ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra (tema na njeh me çfarë do të flasë autori, ndërsa teza na njeh me bindjen dhe opinionet që ka autori rreth temës).*

Ushtrimi 3. Punohet sipas kërkesës në mënyrë individuale duke u mbështetur te sqarimet e bëra mbi paragrafët.

Lexohen disa dhe diskutohet rreth tyre.

Ushtrimi 4. Që në hyrje të pjesës autori shpreh qëndrimin e vet se studimi është i lodhshëm dhe aspak zbatimës. – *Po.*

Në hyrje të pjesës duket sikur autori njëjtësohet me kundërshtarët e tezës.– *Po.*

Teza paraqitet e qartë që në hyrje të pjesës.– *Po.*

Episodet nga jeta e autorit përdoren në funksion të argumentimit. – *Po.*

Autori rrëfen në vetën e parë.– *Po.*

Në këtë tekst, argumentimi gërshetohet me rrëfimin dhe përshkrimin.– *Po.*

Rrëfimi në vetën e dytë njëjës e bën tekstin më të gjallë dhe emocionues. – *Po.*

Argumentet që jepen nëpërmjet rrëfimit janë të detajuara. – *Po.*

Ushtrimi 5. Si mund të mposhten pengesat në kënaqësinë e studimit? - *Duke u ndërgjegjësuar për mundësitë e së ardhmes.*

Ushtrimi 6. Punohet në grupe dyshe duke shkëmbyer përgjigjet e sakta dhe duke diskutuar me njëri-tjetrin. - A është gjuha e këtij teksti subjektive dhe e figurshme? – *Po; studimi është i lodhshëm, i mërzitshëm, dhe aspak i pakënaqshëm-epitet;përvoja ishte e mbushur me frikë- metaforë; ke harruar kënaqësinë- metaforë; mësuese e rreptë- epitet, pa na dhënë zemër e nxitje- shprehje e figurshme, na vënë në lojë- shprehje frazeologjike, etj.*

- A përdoren folje ndihmëse? - *Po; mund të thuash, mund të ndiesh, mund të mësojë, mund të ndeshim, mund të hasim.*

- A përdoren fjalët lidhëse për të lidhur idetë?- *Po; sepse, nëse, dhe, por edhe, por, që, dhe.*

- A mbizotërojnë foljet e përdorura në kohën e t ashme? - *Po; zbulohet të provojnë, të angazhohen, ndien, është, ndiej, vënë, fshehim, lindin, bëhen, ndeshim, arrijmë.*

- A janë përdorur kryesisht folje në mënyrën joveprore? – *Po; të ndiesh, zbulohet, dukem, bëhem.*

- A është gjuha e përdorur e thjeshtë dhe kuptueshme për të gjitha nivelet e lexuesve? Në ç’përfundim arrini?

- Arrihet në përfundimin se autori i drejtohet një mase të gjerë lexuesish dhe e bën sa më të qartë dhe të kuptueshme tezën për të gjithë.

Ushtrimi 7. Rrethanat që të shtyjnë lehtësisht në rrugë të gabuar.

Ushtrimi 8. Studiojmë me dëshirë kur kemi parasysh kënaqësitë në arritjen e një objektivi të rëndësishëm.

Dy ushtrimet e fundit zhvillohet në formë diskutimi i lirë, por argumentohen shkurtimisht përzgjedhjet e bëra duke dhënë argumente dhe ilustrime nga teksti.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Do të vlerësohet me notë për dallimin e tezës dhe argumenteve pro dhe kundër, për zbërthimin e analizën e gjuhës së përdorur.

Detyrat dhe puna e pavarur: A mendoni se përparimi i teknologjisë po e sfidon leximin e librave? Argumentoni duke ndërtuar edhe një antitezë, të cilën më pas do ta rrëzoni nëpërmjet fakteve dhe provave të dhëna në mbështetje të tezës suaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë pyetëse dhe dëshirore		Situata e të nxënimit: Puna me tekstin	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës- Sintaksë			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: fjali pyetëse, fjali dëshirore.	
<ul style="list-style-type: none"> - përcakton fjalitë pyetëse dhe dëshirore dhe i përdor drejt ato; - kthen fjalitë pyetëse të drejta në të zhdrejta dhe anasjelltas; - ndërton fjali pyetëse dhe dëshirore. 			
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha Shqipe 9" Libri: Gramatika e gjuhës shqipe 2		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: insert; punë e drejtuar; punë individuale; punë dyshe			
Organizimi i orës së mësimit:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: insert			
Mësuesi i njeh nxënësit me temën e re mësimore dhe i drejton ata në libër në faqen 319 për të lexuar në heshtje informacionin në tekst.			
Duke qenë se fjalitë pyetëse dhe dëshirore janë marrë dhe në klasat e mëparshme, mësuesi drejton nxënësit të punojnë me tabelën INSERT, ku do të klasifikojë informacionin sipas kolonave të tabelës.			
DI (V)	DUA TË DI (?)	MËSOVA (+)	
Ndërtimi i njohurive të reja: punë e drejtuar			
1. Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.			
*Çdo fjali pyetëse duhet të fillojë me një përemër pyetës. X			
* Në fund të çdo fjali pyetëse vendoset pikëpyetje. V			
*Me anë të intonacionit, një fjali dëftore mund të kthehet në fjali pyetëse. V			
*Rendi i fjalëve nuk luan rol në ndërtimin e fjalive pyetëse. X			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale.			
2. Ktheni fjalitë pyetëse të drejta në fjali pyetëse të zhdrejta dhe anasjelltas.			
* A të pëlqen të studiosh? Po të pyes nëse të pëlqen të studiosh.			
*Do të doja të di kur fillojnë regjistrimet për në shkollë. Kur fillojnë regjistrimet për në shkollë?			

*Nuk e di nëse të pëlqejnë ëmbëlsirat. *A të pëlqejnë ëmbëlsirat?*

*Sa ditë do të qëndrosh me ne? *Më thuaj se sa ditë do të qëndrosh me ne.*

3. Nënvizoni fjalinë pyetëse të zhdrejtë, qarkoni pjesën tjetër të fjalisë.

*Nëse vepruam mirë apo keq, këtë nuk di ta them.

* Pyes veten se si do të bëja pa ndihmën e tyre.

*Se si zuri fill kjo punë, askush s'e mban mend.

* Tani shtrohej pyetja se kush të nisej i pari.

4- Jepni nga një shembull fjalie dëshirore që shpreh:

*urim: *Ju këndofte zemra!*

*mallkim: *E marrtë djalli, e marrtë!*

*përsëndetje: *Natën e mirë!*

*betim: *Pasha sytë e ballit!*

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5- Fq.321

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Zbulimi i Hektorit.		Situata e të nxënësve: "Iliada" e Homerit Iliada ka kuptimin e "Këngës së Ilionit", pasi emri i vjetër i Trojës ishte Ilion. Iliada përbëhet nga 24 këngë me gjithsej 15,693 rreshta. Konsiderohet si tragjedia e parë për shkak se ngjarja ka karakter tragjik.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: tekst joletrar, argument, zbulim, dyshim, Akili, Hektori, i pashëm shqiptarët.	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh fjalët dhe terminologjinë e duhur për të arritur qëllimin e tij; - shpreh ndjenjë dhe emocion gjatë të treguarit; - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit, - nxjerr të dhënat e tekstit; - dallon llojin e tekstit dhe veçoritë e tij, - analizon tiparet e personazheve. 			
Burimet: Teksti i nxënësit "Gjuha shqipe 9", materiale të gatshme për veprën "Iliada" nga mësuesi/ja apo nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Edukim fizik, sporte dhe shëndet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Mendimi i parë, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, mendimi zinxhir, informacion shtesë, punë me tekstin, hulumtim, ditarët e të nxënësve, puno/shkëmbe, rrjeti i diskutimit.</i>			

Organizimi i orës së mësimt

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Mendimi i parë, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, mendimi zinxhir.*

Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa fjalë për të ndërtuar rubrikën e mendimit të parë. Fjalët mund të jenë: zbulim, dyshim, Akili, Hektori, rivalë, i pashëm, shqiptarët.

Nxënësit lidhin fjalët në një tekst përmbledhës sipas mendimit të parë që u vjen ndër mend.

Lexojmë disa mendime dhe nxënësit sqarojnë lidhjen mes fjalëve të dhëna duke diskutuar dhe argumentuar arsyen e lidhjes që kanë zgjedhur.

(duke qenë se nxënësit e njohin historinë e luftës së Trojës do të krijojnë rreth kësaj ngjarje. E veçanta e krijimit duhet të jetë në lidhjen me fjalën “shqiptarët”)

Për të sqaruar më tej rikujtohen njohuritë për “Iliada” e Homerit.

Në formën e mendimit zinxhir nxënësit ritregojnë subjektin e poemës duke nxjerrë personazhet dhe disa nga veçoritë e tyre dalluese.

Iliada –Paridi, i magjepsur nga premtimi i perëndisë Afërditë, rrëmben Helenën dhe shënon fillimin e Luftës së Trojës. Të udhëbequr nga Agamemnoni, Mbreti i Mikenës dhe vëllai i Menelaut (burrit të Helenës) mbreti i Spartës e me luftëtarë të fortë si : Akili , Ajaksi, Odiseu, Diomedi, bëjnë përpjekje të vazhdueshme rreth 10 vjet për të rrëzuar Trojën.

Personazhet: Akili -Heroi kryesor i poemës. Akili ishte djali i Peleut dhe nimfës Teti. Ishte një luftëtar i pamposhtur, i egër, trim, i pavdekshëm përveç se në thembër, ku ishte i pambrojtur.

Agamemnoni - Agamemnoni ishte më i tmerrshmi i mbretërve të Greqisë, por ishte i pangopur për pushtet. Ai përfiton nga shkakut e vëllait të vet Menelaut që donte t'i hapte luftë Trojës për Helenën.

Ajaksi – Ishte i pajisur me një forcë të mahnitshme fizike por jo prej perëndive. Megjithatë fundi i tij nuk ishte i laudishëm: vrau veten.

Hektori - Një kalorës dhe luftëtar i frikshëm. Udhëhoqi ushtrinë trojane, duke i bërë rezistencë ushtrisë greke. Biri i Priamit, mbretit të Trojës dhe vëllai i Paridit.

Bëhet lidhja e situatës me njohuritë e mëparshme duke rikujtuar llojet e teksteve dhe përmenden disa tipare dalluese të tyre.

Llojet e teksteve që përmenden janë :1- letrare, 2- joletrare.

Tekst joletrar: Në këtë lloj shkrimi, përfshihen: intervistat, autobiografitë, biografitë, kujtimet, udhëpërshkrimet, mbresat, reportazhet, ditarët, kronikat etj.

Teksti shpjgues-informues është një tekst që paraqet informacione, data dhe lajme, duke i shpjguar në mënyrë të qartë dhe korrekte.

Reportazhi është një lloj i tekstit rrëfimtari joletrar, në të cilin autori gërsheton faktet reale me përshtypjet subjektive, duke ngritur një problem. Përshkrimi i njerëzve, i ngjarjeve ose i vendeve bëhet sipas përjetimit të rrëfimtari.

Me intervistë kuptojmë komunikimin mes një njeriu që konsiderohet i rëndësishëm ose interesant dhe një gazetari që ka si qëllim të informojë publikun ose të reklamojë diçka tek ai.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Informacion shtesë, punë me tekstin, hulumtim, ditarët e të nxënës.*

Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e re pa sqaruar llojin e tekstit. Jepen informacione shtesë nga mësuesi, por mund të jepen informacione për Kadarenë edhe nga nxënësit sepse është i njohur për nxënësit.

Ismail Kadare është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe, por jo vetëm. Ai njihet si një shkrimtar i letërsisë botërore bashkëkohore. Veprat e tij kanë shënuar një numër rekord të përkthimeve (në mbi 45 gjuhë të huaja). Me anë të veprave të tij e ka bërë të njohur Shqipërinë në botë, me historinë dhe kulturën e saj shekullore.

Ndër veprat më të njohura të Kadaresë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar janë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, novela “Kush e solli Doruntinën”, “Prilli i thyer”, “Kështjella” etj.

Punohet me tekstin duke e lexuar dhe sqarohet fjalori i dhënë. Me metodën e hulumtimit mësuesja i lë nxënësit që të punojnë në mënyrë të pavarur mbi tekstin për të dalluar llojin e tij dhe veçoritë e personazheve.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punolshkëmbje, rrjeti i diskutimit.*

Nxënësit pasi kanë punuar individualisht me tekstin bashkëpunojnë me shokun/shoqen duke shkëmbyer zgjidhjet dhe mendimet.

Ushtrimi 1

Hektori sheh për herë të parë Akilin. - x

Hektori gjithnjë e ka ditur se Akili është i shëmtuar. - x

Akili mendon se fytyra e Hektorit është ashtu si shpirti i tij, e pahijshme. - x

Legjenda rrëfen se Akili ka pamje të hijshme. - v

Hektori rendit shkaqet e shëmtisë së Akilit. - x

Homeri e thekson që Hektori është shumë i pashëm. - v

Hektori vërteton dyshimet e tij për pamjen e Akilit në momentet e fundit të jetës. - v

Dhunimi dhe prekja e trupit të viktimës ndalohet në kodin zakonor të popujve të Ballkanit. -v

<p>Ushtrimi 2 Nëpërmjet pyetjeve: S'ka qenë asnjëherë aq i hijshëm sa ç'e bënin? Apo ka qenë i tillë, por një shkak i papritur, puçrra, ekzemë, paralizë e pjesshme e ka shëmtuar, dhe tani, ashtu si aktorët që nuk duan më t'i zhgënjejnë adhuruesit, edhe ai i mënjanohet publikut, kërkon shkaqe për t'u mbyllur në çadër, për të ikur fare nga fushata?</p> <p>Ushtrimi 3 Teza e këtij teksti është: Akili është i shëmtuar Argumenti 1: kur Hektori zbulon ashtu siç dyshonte ("bindja s'më ka mashtruar") se fytyra e tjetrit, ashtu si shpirti i tij, është mizore, pra e pahijshme. Argumenti 2: Na kujtohet vetmimi i Akilit, fyerja e shpejtë, nervozizmi, sidomos mënjanimi i tij. S'ka qenë asnjëherë aq i hijshëm sa ç'e bënin? Apo ka qenë i tillë, por një shkak i papritur, puçrra, ekzemë, paralizë e pjesshme e ka shëmtuar, dhe tani, ashtu si aktorët që nuk duan më t'i zhgënjejnë adhurimtarët, edhe ai i mënjanohet publikut.</p> <p>Ushtrimi 4 Sinonimi - Të menduarit mirë, thellë, rrahja mirë me mend për të gjetur zgjidhjen.</p> <p>Ushtrimi 5 Sa për zbulimin, është me interes të veçantë, së pari, ka pasur një bindje, është fjala pikërisht për një zbulim, për herë të parë dhe të fundit.</p> <p>Ushtrimi 6 Nxënësi jep ide dhe mbështetet te: -Dhe vendos ta shëmtojë atë bukuri të urryer, ta fëlliqë nëpër baltë... Me Ushtrimin 7 punohet me rrjetin e diskutimit për idetë e ndryshme të nxënësve.</p> <p>Ushtrimi 8 Autori përgjithëson dukurinë e trajtuar në pjesë. - Me qindra janë këngët e baladave ku këndohen hijeshia e personazheve, dhunimet, masakrimet, lutjet për të mos u shëmtuar fytyrat, sytë etj. Që nga Homeri e këtej ky motiv s'ka reshtur kurrë në popujt e gadishullit, gjersa, shqiptarët...</p> <p>Vlerësimi: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësisimit të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruaj personazhet.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë pohore dhe mohore		Situata e të nxënësve: lidhet me situata të ndryshme komunikimi, në të cilat pohohet dhe mohohet.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës- Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: fjali pohore, mohore, pohim i sigurt, i pasigurt, mohim i përgjithshëm, i pjesshëm.	
Nxënësi /ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - përcakton fjalitë mohore dhe fjalitë pohore dhe i përdor drejt ato; - dallon mohimin e përgjithshëm nga ai i pjesshëm ë në fjalitë e dhëna; - dallon pohimin e sigurt nga ai i pasigurt në fjalitë e dhëna. 			
Burimet: Libri i nxënësit, Gramatika 2, tabela e fjalive sipas nuancës kuptimore, magnetofon, CD		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		-Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Dëgjim i vëmendshëm; Stubi mendimi; INSERT; Punë individuale; Punë dyshe			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit. Dëgjim i vëmendshëm; Stubi mendimi			
Hapi I: Në klasë vendoset për t'u dëgjuar nga magnetofoni një dialog ndërmjet dy personazheve të cilët shprehin në bisedën e tyre pohim, miratim apo dhe mohim. Mësuesi mund të improvizojë dhe një dialog ndërmjet dy nxënësve të klasës.			
Hapi II: U drejtohet nxënësve pyetja: Si i klasifikojmë fjalitë e dialogut për nga nuanca kuptimore që përcjellin? Cilat janë fjalët që përdorim për të pohuar dhe mohuar?			
Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT			
Pas përgjigjeve të tyre nxënësit drejtohen në libër në faqen 322, për të punuar me tabelën INSERT.			
DI	MËSOJ	DUA TË DI	DI NDRYSHE
√	+	?	-

Pas plotësimit të tabelës zhvillohet diskutimi i saj në klasë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale; Punë dyshe

Punohen ushtrimet 1-4.

Ushtrimi 1 (Punë individuale) Gruponi në tabelën e mëposhtme pjesëzat: *po, ndoshta, mbase, gjoja, mirë, posi, me siguri, si jo, natyrisht, patjetër, vallë.*

pohim	
i sigurt	i pasigurt
<i>po; mirë; posi; si jo; natyrisht; patjetër; me siguri</i>	<i>ndoshta; mbase; gjoja; vallë</i>

Ushtrimi 2 (Punë dyshe) - Klasifikoni fjalitë e mëposhtme sipas tabelës së dhënë.

1. Ai që s'linte rast pa udhëtuar, kishte ardhur në shtëpinë time me dhjetëra herë, madje pa e ftuar kush. 2. Kurse e ëma s'kishte dalë kurrë nga shtëpia e vet.

-3. Sigurisht që s'është tek unë.

- Je e sigurt?

- 4. Rino, të lutem, të thashë që nuk është.

- Po ku të ketë shkuar vallë? - 5. Nisi të qante dhe unë e ndiqja pa ndërhyrë.

6. Kur mbaroi i thashë: - 7. Të lutem, mos e kërko.

- Ç'thua kështu?

- 8. Atë që thashë. 9. Kot e ke.

pohim		mohim	
i sigurt	i pasigurt	i përgjithshëm	i pjesshëm
6,8,9		2,3,4,7	1,5

Ushtrimi 3 (punë individuale) - Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme me anë të një pohimi të pasigurt. Nënvizoni mjetet që e shprehin atë.

*Kur do të nisesh? Ndoshta nesër.

*A të pëlqen të luash tenis? Për pak hoqa dorë nga futbollit për të.

*E njeh historinë e Shqipërisë? Pothuaj di gjithçka.

*Çfarë profesioni të pëlqen më shumë? A nuk zgjedh vetë më mirë?

Ushtrimi 4 (punë individuale) - Dalloni mohimin e përgjithshëm nga ai i pjesshëm.

*Nata ishte pa hënë. (i pjesshëm)

*Nata nuk ishte me hënë. (i përgjithshëm)

*Jo, nuk e njoh. (i përgjithshëm)

*Jo më kot të pyeta. (ka kuptim pohor)

*As ti nuk do të shkosh. (i përgjithshëm)

*As mos e ço ndër mend. (i përgjithshëm)

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, faqja 324.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalimi i Ismail Qemalit		Situata e të nxënës: Fragmente nga filmi "Nëntori i dytë".	
Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënës - Kompetenca qytetare 			

<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon me vëmendje një fjalim historik dhe mban shënime të rëndësishme në lidhje me të; - dallon qëllimin e fjalimet dhe argumentet e përdorura; - nënvizon informacionet faktike të paraqitura në tekst; - dallon tiparet e një fjalimi -shkruan një fjalim përshëndetës për ceremoninë e mbylljes së vitit mësimit.</p>	<p>Fjalët kyçe: fjalim historik, Ismail Qemali, qëllim, argumente, informacione faktike.</p>
<p>Burimet: Teksti, DVD e filmit “Nëntori i dytë”, video-projektor, fletore</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Dëgjim, Lojë gjuhësore, Lexim, Diskutim, Shkrim i lirë</i></p>	
<p>Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Dëgjim, Lojë gjuhësore,</i> Hapi I. Shfaqen sekuenca nga filmi “Nëntori i dytë”, fjalimi i Ismail Qemalit. Pas dëgjimit të këtij fjalimi, nxënësit kujtojnë ngjarjen historike, së cilës i referohet ky film. Hapi II. Lojë gjuhësore. Shkruhen në tabelë emrat fjalë dhe fjalim. Nxënësit do të krijojnë familjen e emrit fjalë, ndërsa emrin fjalim do ta shoqërojnë me mbiemrat: i rëndësishëm, historik, politik, i hapjes ,i mbylljes, përshëndetës. fjalë-fjalos, fjalosur, i fjalosur, i pafjalosur, fjalim, fjalëformim, fjalëformues, jofjalëformues, fjalëbutë, fjalëgjatë, fjalëkotë, Nxënësit do të renditin tiparet që duhet të ketë një fjalim, duke vendosur shenjën + në pohimet e paraqitura në tekst. (pohimi 1.3) Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim</i> Dëgjohet, përmes leximit fragmenti i tekstit. Gjatë dëgjimit të tij, nxënësit udhëzohen që të mbajnë shënime në lidhje me informacionet dhe faktet që paraqiten në këtë fjalim. Fjalimi mund të prezantohet nga mësuesja ose nga ndonjë nxënës që lexon bukur. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Diskutim, Shkrim i lirë</i> Hapi I. Diskutohet me nxënësit materiali i dëgjuar. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve. 1. Qëllimi i fjalimit ka të bëjë me njoftimin e shpalljes së aktit të pavarësisë, nga delegatët e trevave mbarëshqiptare të mbledhur në Vlorë. Gjithashtu ky fjalim shpreh edhe gëzimin dhe lumturinë për arritjen e kësaj dite të shumëpritur për popullin tonë, falë luftërave dhe përpjekjeve shekullore.</p>	
<p>2. Argumenti që tregon shkakun e këtij gëzimi është përfundimi i mbledhjes historike dhe sihariqi i madh i shpalljes së Pavarësisë.3. Informacionet faktike kanë të bëjnë me gjendjen reale të Shqipërisë në fillim të shekullit të XX-të, robërinë e gjatë turke, rolin e shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut, për të mbajtur larg Evropës pushtuesit turq. Në arritjen e kësaj dite kontribuoi edhe gjaku i dëshmorëve dhe puna e vlefshme e të gjithë patriotëve dhe pjesëtarëve të mbledhjes. 4. Arsyet që populli shqiptar përmbushi qëllimin e tij, janë historia e lavdishme që nga koha e Skënderbeut, trimëria e pashoqe e bijve të shqipes dhe lufta e pandërprerë e patriotëve. 5. Funksioni dhe roli i Ismail Qemalit ishte të kryesonte Qeverinë e Përkohshme të Shqipërisë së lirë, si nismëtari i kësaj mbledhjeje dhe më plaku(më i vjetri) ndër delegatët. Ai e ka për nder të jetë dëshmorë më i parë i atdheut ,ashtu siç pati nderin të puthë i pari flamurin e lirisë. 6. Gjuha e këtij fjalimi është dialekti toskë. 7. Fjalimi mbyllet me urimet për flamurin dhe Shqipërinë,përmes fjalive dëshirore. Këto fjali ngrenë lart optimizmin dhe frymën e hareshë që përcjell kjo ditë. Hapi II. Plotësohet me fjalën e duhur paragrafi i paraqitur në tekst, duke shfrytëzuar fjalë nga fjalimi. Nxënësit prezantojnë përgjigjet e tyre.</p>	
<p>Vlerësimi: për pjesëmarrjen gjatë orës,përcaktimi i qëllimit të fjalimit dhe tiparet e tij, dëgjimin e vëmendshëm, ndërtimin e saktë të familjes së fjalës, dallimin e argumenteve dhe fakteve, si dhe përcaktimin e rolit të Ismail Qemalit në këtë ngjarje historike.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një fjalim përshëndetës për ceremoninë e mbylljes së vitit mësimit.</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe		Situata e të nxënit lidhet me dallimin e gjymtyrë ve kryesore në fjali.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi /ja: - përcakton llojin e fjalive sipas gjymtyrë ve kryesore dhe i përdor drejt ato; - dallon fjalitë një kryegjymtyrë she emërore dhe i përdor drejt ato; - ndërton fjali emërore përshkruese, treguese dhe emërtuese.		Fjalët kyçe: fjali dykryegjymtyrëshe, njëkryegjymtyrëshe, kallëzues, kryefjalë, fjali emërore, përshkruese, treguese, emërtuese.	
Burimet: Libri i nxënësit, Gramatika 2, tabela e fjalive sipas përdorimit të gjymtyrëve kryesore		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi; Shpjegim-Pema e mendimit; Punë individuale</i>			
Organizimi i orës së mësim:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stuhi mendimi</i> U kërkohet nxënësve të dallojnë gjymtyrët kryesore në fjalitë e mëposhtme. <i>Pranverë. Zogjtë e parë kanë filluar të rindërtojnë foletë e tyre. Aromë lulesh. E ndiej kudo gëzimin e kë saj stine.</i> Cilat janë gjymtyrët kryesore? Si quhen fjalitë që i kanë të dyja kë to gjymtyrë? Po ato që s' i kanë?			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Shpjegim-Pema e mendimit</i> Përgjigjet e nxënësve përmbledhen në një kllaster, në të cilin shtohet dhe informacioni që do të shpjegojë mësuesi nëpërmjet shembujve.			
<pre> graph TD A[Fjalitë] --> B[Dykryegjymtyrëshe] A --> C[një kryegjymtyrëshe] C --> D[emërore] C --> E[foljore] D --> F[Përshkruese] D --> G[treguese] D --> H[emërtuese] </pre>			

Shënim: Kjo skemë do të plotësohet në temën pasardhëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale.

Punohen individualisht ushtrimet 1,2,3 faqja 326.

1-Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

*Çdo folje kërkon një kryefjalë dhe një kundrinor. X

*Kryefjala përcakton vendin e kallëzuesit në fjali. X

*Kryefjala dhe kallëzuesi përshtaten në numër dhe në vetë. V

*Fjalja pa kryefjalë nuk qëndron. X

*Fjalja pa kallëzues nuk qëndron. X

2-Gruponi fjalitë e mëposhtme në emërore dhe joemërore. Përcaktoni kriterin dallues.

Dimër. Në dimër. Sot. Heshtje varri. Treg ushqimor. Afër tregut ushqimor. Në kinema. Kinema Agimi. Menjëherë. Qetësi.

Fjali	
emërore	joemërore
Dimër. Heshtje varri. Treg ushqimor. Kinema Agimi.	
Qetësi.	

3- Ndërtoni nga dy shembuj fjalish sipas tabelës së mëposhtme.

Fjali emërore		
përshkruese	treguese	emërtuese
Dëbora e parë.	Ja deti Jon.	Ekipi i futbollit "Partizani".
Kohë të lavdishme.	Ja mësuesja kujdestare.	Shkolla 9-vjeçare "Hasan Prishtina"

Vlerësimi: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4. Shkruani një tekst me temë "Ditë vjeshte" në të cilin të përdorni fjali emërore të të tria llojeve, si dhe fjali pa kryefjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Rolet e ndryshme të pjesëmarrësve në një diskutim		Situata e të nxënit: Improvizoni një diskutim me 2 shokë a më shumë shokë dhe zhvillojeni atë. Si reagoni ju dhe shokët gjatë diskutimit?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - diskuton rreth karakteristikave të diskutimit; - ndaj rolet e pjesëmarrësve në diskutim; - diskuton për çështje të ndryshme duke respektuar rregullat gjatë diskutimit; - koordinon lloje të ndryshme diskutimi në varësi të temës së zgjedhur. 		Fjalët kyçe: diskutim, rol, kryetar, koordinator, mbajtësi i kohës, sekretari, aftësi e analizës, kontroll i emocioneve.	

Burimet: teksti i nxënësit, “Guidë për diskutimet në klasë”. https://1e534t15m04h2znqeo4blk1d-Wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetari
--	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pema e mendimit, Role të specializuara në diskutim, Diskutim

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:



Pjesëmarrësit kanë këto qëllime gjatë diskutimit:

- të marrin vendime (p.sh., të vendosin se kush do të marrë pjesë në një projekt dhe të caktojnë detyrat);
- të japin ose të shkëmbejnë mendime rreth një teme të caktuar (diskutimi këtu mund të bëhet në formë debati, ku palët kanë ide të kundërta, p.sh.: Sa i rëndësishëm është garimi në procesin e të mësuarit?);
- të krijojnë diçka (p.sh., planifikohet dhe bëhet një poster për mbrojtjen e mjedisit);
- të zgjidhin një problem (p.sh., planifikohet dhe vendoset se si do të rimodelohen ambientet sportive të shkollës).

Diskutoj për rolet që mund të marrin pjesëmarrësit e një grupi gjatë një diskutimi

Kryetari

- Harton strategjinë e punës në grup dhe të komunikimit.
- Ndan detyrat dhe verifikon nëse secili e ka kryer si duhet punën e tij.
- Ndhmon në zgjidhjen e problemeve që mund të ketë grupi.

Koordinatori

- Mbledh mjetet e nevojshme për çdo veprimtari, si për shembull: vizore, fletë të bardha, postera, projektor etj.
- I ofron mjetet e duhura secilit anëtar të grupit për të përmbushur detyrën e tij.

Mbajtësi i kohës

Vendos se sa kohë duhet për secilën nga detyrat e dhëna.

- Sigurohet që grupi t'i kryejë në kohë të gjitha detyrat e dhëna nga mësuesi.
- Ndhmon anëtarët e grupit që të përmbyllin argumentimin e tyre në kohën e duhur.

Sekretari

- Verifikon përfundimin e detyrave të dhëna.
- Mban shënim pjesëmarrjen dhe përpikërinë e anëtarëve të grupit gjatë takimeve të kryera.
- Mban shënim arritjet pozitive të grupit (të konfirmuara nga mësuesi/ja).

Pjesëmarrësit në diskutim duhet të kenë këto aftësi bazë:

Aftësinë e analizës

Aftësinë e bindjes


Aftësinë e kontrollit të emocioneve

Ndërtimi i njohurive të reja: Role të specializuara në diskutim

Në këtë fazë të mësimit u cakton nxënësve një rol specifik gjatë diskutimit nxënësve.

Ndaj klasën në grupe të vogla dhe diskutimi do të zhvillohet me to.

Secili grup merr fishën që përmban temën e diskutimit.



Ndahen rolet brenda grupit

Nxënësitvënë në zbatim këshillat për të zbatuar rregullat gjatë diskutimit


Nxënësit vënë në zbatim aftësitë e analizës, bindjes dhe kontrollit të vetes

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Në këtë fazë fillon diskutimi i grupeve të vogla. Udhëzohen nxënësit që secili grup të mos jetë i pavëmendshëm gjatë diskutimit, por të japë idetë e tij për çështjen në fjalë, të vlerësojë argumentet e shokut dhe të vlerësojë veten.

Informacion shtesë për mësuesin

Më poshtë po japim disa skema se si mund të organizohen nxënësit në klasë.



Mjetet ndihmëse në diskutim:

Shënjes me ngjyrë për të shkruar në tabakë të bardhë

Letra shënimesh me ngjitëse

Bllok shënimesh që ka shënimet e nxjerra për diskutim

Kunja ngjitëse të tabakëve të shënimit

Stilolapsa

Ëmbëlsira që shërbejnë si vetëvlerësim kur grupi realizon një diskutim të mirë

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për ndarjen e roleve gjatë diskutimit, për dhënien e argumenteve për diskutim etj.

Detyrat dhe puna e pavarur:-----

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës- Sintaksë		Situata e të nxëniet lidhet me përcaktimin e llojeve të fjalive njëkryegjymtyrëshe foljore në tekste të ndryshme.	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton llojin e fjalive sipas gjymtyrës kryesore dhe i përdor drejt ato; - dallon fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore dhe i përdor drejt ato; - formon fjali njëkryegjymtyrëshe foljore me vetë të përcaktuar, të papërcaktuar, të përgjithësuar dhe fjali pavetore. 		Fjalët kyçe: njëkryegjymtyrëshe foljore, me vetë të përcaktuar, të papërcaktuar, të përgjithësuar, fjali pavetore	
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, tabela e fjalive sipas përdorimit të gjymtyrëve kryesore		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Përvijimi i të menduarit; Pema e mendimit; Diskutim; Punë individuale; Punë në dyshje</i>			
Organizimi i orës së mësimet:			
<p>Hapi I. Në këtë hap nxënësit ndahen në grupe me 5-6 veta dhe u jepet detyra. Kërkesa është e përbashkët për të gjitha grupet. <i>- Dalloni gjymtyrën kryesore dhe tregoni me se është shprehur. Cila është veta e tyre? Çfarë tregon kjo vetë? Proveni nëse pranon kryefjalë.</i></p> <p>Grupi 1, 2, 3 – Si quheni? Merreni, ju lutem. Mos më vononi. Po nisemi për rrugë të gjatë. <ul style="list-style-type: none"> - Ç'të mbjellësh, do të korrësh. - Thonë se Skënderbeu rrinte i fshehur në kodrat rrotull. Jashtë gjëmonte. </p> <p>Grupi 4, 5, 6 – Atje ngritën një përmendore. Më thanë se ti po kërkoje me ngulm atë kolonel të zi. <ul style="list-style-type: none"> - Shkoni përpara. Qofsh i lumtur në jetë, bir! - Duart mund t'ia lidhësh njeriut, mendjen jo. </p> <p>Nxënësit mbajnë shënim duke iu përgjigjur secilës pyetje.</p> <p>Hapi II. Nën drejtimin e mësuesit plotësohet <i>Pema e mendimit</i>, nisur orën e kaluar. (Degëzimi me të zeza)</p>			
<pre> graph TD Fjalitë --> Dykryegjymtyrëshe Fjalitë --> njëkryegjymtyrëshe njëkryegjymtyrëshe --> Emërore njëkryegjymtyrëshe --> foljore foljore --> Përshkruese foljore --> treguese foljore --> emërtuese njëkryegjymtyrëshe --> vetore njëkryegjymtyrëshe --> pavetore vetore --> Me_vetë_të_përcaktuar[Me vetë të përcaktuar] vetore --> Me_vetë_të_papërcaktuar[Me vetë të papërcaktuar] pavetore --> me_vetë_të_përgjithësuar[me vetë të përgjithësuar] </pre>			

Hapi III. Hapet libri në faqen 327 dhe nxënësit lexojnë në heshtje informacionin. Pas përfundimit diskutohet tabela për fjalitë pavetore.

Hapi IV. Punohen ushtrimet në faqen 329. Ushtrimi 1 dhe 2 punohen individualisht. Ushtrimi 3 punohet në dyshe sipas bankave.

1-Dalloni fjalitë pa kryefjalë dhe shtojeni atë ku është e mundur. Shpjegoni mundësinë dhe pamundësinë e shprehjes së saj.

Nisu për në shkollë. S'më shkohet. Heshtje. Jashtë veton e bubullin. S'di ç'të bësh më parë, të përgatisësh mësimet, apo t'u përgjigjesh mesazheve të shumta. S'di ç'të bëjë njeriu i shkretë. Vazhdonte të binte shi e të frynte një erë e ftohtë veriu. Këtu s'shtyhet. Kush do të vijë me mua? Askush. Më vjen keq.

2- Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

* Kryefjala shprehet në fjali sa herë ka një kallëzues. X

*Nuk ka fjali pa kryefjalë. X

* Kryefjala mund të gjejë shprehje edhe me anë të mbaresave foljore. V

*Kryefjala mund të shprehet në fjali me folje me vetë të përcaktuar. V

*Kryefjala nuk mund të shprehet në fjali me vetë të papërcaktuar. V

3- Jepni nga dy shembuj fjalish sipas tabelës së mëposhtme.

Fjali vetore me vetë:			Fjali pavetore
të përcaktuar	të papërcaktuar	të përgjithësuar	

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, faqja 329.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: XI
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje		Situata e të nxënësve:	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës-Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, kallëzues, bashkërenditje, lidhëza, këpujore/shtuese, krahasimore - kundërshtuese, veçuese, përmbyllëse, skema.	
-Dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë; -Përcakton llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe i përdor drejt ato;			
Burimet: libri i nxënësit, Gramatika 2, skeda		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim, punë në grup, punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit:*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim***1. Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. Argumentoni përgjigjen.**

- | | |
|---|------------------|
| e thjeshtë | e përbëre |
| *Për të pasur shëndet të mirë, duhet të ushqehesh mirë. | √ |
| *Ushqehu mirë dhe ke për të pasur shëndet të mirë. | √ |
| *Që të kesh shëndet të mirë, duhet të ushqehesh mirë. | √ |
| *Mund të ushqehesh mirë, por mund të mos gëzosh shëndet të plotë. | √ |
| *Për të pasur shëndet të plotë nuk mjafton vetëm të ushqyerit mirë. | √ |

*Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup,***Lidhni fjalitë e mëposhtme me lidhëza bashkërenditëse dhe përcaktoni llojin e marrëdhënies që vendoset mes tyre.**

Shtëpia ishte e braktisur dhe lulet në oborr ishin tharë. (këpujore/shtuese)

*Bie shumë shi, por do të shkoj në kinema. (krahasimore-kundërshtuese)

*Të dielën do të shkoj në stadium ose do ta shoh ndeshjen në shtëpi. (veçuese)


*Ishte mesi i gushtit, ndaj në oborrin e shkollës dëgjohej vetëm kënga e gjinkallave. (përmbyllëse)

*Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur***3. Dalloni fjalitë me bashkërenditje dhe mjetet që lidhin pjesët mes tyre.**


Fillimisht vrapova drejt saj /dhe e ndihmoval të ngrihej,/ por pastaj u ktheva për të parël ç'bënte Lila. Kishte zbritur nga trotuari /dhe po shkonte te Melina duke kaluar rrugën,/ por pa ua vënë veshin kamionëve /që kalonin njëri pas tjetrit. I shqova në sjellje, më tepër se në fytyrë, diçka /që më turbulloi/ e që sot e kësaj dite e kam të vështirë/ ta përcaktoj, / pasi,/ edhe pse shkonte përmes rrugës, e vogël e zezë, nervoze,/ edhe pse e bënte me vendosmërinë e saj të zakonshme,/ gjithsesi kishte ngecur si e ngrirë.

4. Ndërtoni skemën e fjalive të mëposhtme.


*Dikush trokiti në derë/, por askush nuk u përgjigj.



*Frynte erë/, binte shi/, gjëmonte/ e vetonte/, por në rrugë kishte ende shumë lëvizje.



*Këtë fundjavë do të shkoj me prindërit në mal, /ose do të takohemi me shokët



Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.**Detyrat dhe puna e pavarur:** Ushtrimi 5-fq. 332**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të shkruajmë (ora 1) Tema mësimore: Shkruajmë ese argumentuese		Situata e të nxënësve: “Ndikimi i video-lojërave tek adoleshentët”. Diskutojmë së bashku	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			

<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasifikon tema për lloje të ndryshme eseash argumentuese - Analizon strukturën e esesë argumentuese - Analizon esenë argumentuese nga ana gjuhësore - Shpjegon ndërtimin e një eseje argumentuese 	<p>Fjalët kyçe: Ese argumentuese Tema Hyrja Teza Argument Kundër-argumente Mbyllja</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit “Si të shkruajmë ese” CDE</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, TIK</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Përvijim i të menduarit, Lexim i koduar, Shkrim i lirë*

Organizimi i orës së mësimi


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Përvijim i të menduarit*

Keni dëgjuar për esenë argumentuese.

Cila është struktura e kësaj eseje?

Në sa paragrafë organizohet eseja argumentuese ?

Nxënësit japin



Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i koduar **Varianti 1**

Ashtu si dashuria, libri nuk vdes kurrë
 Ditë më parë, duke kaluar hutueshëm nga njëri kanal i televizorit në tjetrin, ndesha në një kanal ku po transmetohej njëfarë spoti i gjatë, apo lajmërimi për një program të ri. (Nuk e mbaj mend se cili televizion ishte saktësisht, dhe kjo pohon se sa i pambrojtur ideologjikisht është telespektatori krahasuar me lexuesin e gazetave, i cili e di me saktësi se kush po i flet.) Po u bënin reklamë mrekullive të CD-ROM-ve, disqeve që mund të na ofrojnë të njëjlershmen e një enciklopedie të tërë, me ngjyra, tinguj dhe mundësisht me lidhje të menjëhershme nga argumenti në argument. Meqenëse po krijoj njëfarë përvojë në këtë fushë, e pra e njoh argumentin, nuk po i kushtoja vëmendje të madhe. Derisa, në njëfarë pike, dëgjova emrin tim: po thuhej se unë paskështa pohuar që këto disqe do të zëvendësojnë përfundimisht librat. Askush, veç në qoftë paranojak, s'mund të mëtojë që të tjerët të lexojnë gjithçka që ai shkruan, por të paktën mund të shprehësh që mos t'i vënë në gojë pikërisht të kundërtën, sidomos nëse po e përdorin, në mënyrë të paligjshme, për t'i bërë reklamë diçkaje. Në të vërtetë, po e përsëris fort e më fort se CD-ROM-i nuk mund ta zëvendësojë kurrë librin. Ka dy lloje librash, ata për t'u konsultuar dhe ata për t'u lexuar. Të parët (prototip është lista telefonike, por mund të shkohet deri te fjalorët dhe enciklopeditë) zënë shumë vend në shtëpi, janë të vështirë për t'u manovruar dhe janë të kushtueshëm. Këta mund të zëvendësohen nga disqet multimediale, kështu lirohet hapësirë në shtëpi dhe në biblioteka publike. Ndërsa librat për t'u lexuar (që shkojnë nga "Komedia Hyjnore" te romani i verdhë më i vonë) nuk mund të zëvendësohen nga asnjë gjësend elektronik. Janë bërë për t'u mbajtur në dorë, edhe në shtrat, edhe në barkë, edhe atje ku nuk ka spina elektrike, edhe atje ku e kur çfarëdolloj baterie shkarkohet,

Në esenë argumentuese, autori mban një qëndrim për një çështje të cilën e mbështet me argumente. Qëndrimi i autorit shprehet nëpërmjet tezës, e cila nga ana gjuhësore shprehet me një fjali dëftore. Nga pikëpamja logjike, ndaj këtij qëndrimi të autorit, ka pikëpamje të ndryshme, që edhe mund të jenë në kundërshtim me të. Një mënyrë e mirë për të shndërruar idetë në tezë, është t'u përgjigjeni pyetjeve rreth çështjes nëpërmjet tezës.

Mësuesi udhëzon nxënësit në leximin e vëmendshëm të esesë duke koduar ato pjesë të tekstit që kanë të bëjnë me elementet përbërëse të përmbajtjes së esesë argumentuese.

Kujdes! Më poshtë janë kodet që nxënësit do të vendosin gjatë leximit të tekstit

Hyrja – Autori tërheq vëmendjen lexuesit duke tërhequr situatën

Teza: CD-ROM-et nuk mund të zëvendësojnë librin.

Argumente:

Kundër-argumente

Mbyllja:

Varianti2

Mësuesi/ja mund të përdorë një model eseje argumentuese që nuk është në tekst

Reklamat

Specialistët tregojnë se një ekonomi e shëndetshme varet nga një qarkullim i shëndetshëm i mallrave dhe i shërbimeve. Kur njerëzit ndalojnë së bleri dhe së shituri, ekonomia fillon të bjerë. Njerëzit varfërohen dhe jeta kthehet në një luftë për mbijetesë. Kushdo që dëshiron të shesë diçka, duhet t'u bëjë të ditur njerëzve se çfarë është ajo që kërkon të shesë dhe sa kushton. Një shitës duhet të tregojë mallra dhe t'i bindë njerëzit se ata kanë nevojë për to. Me fjalë të tjera, një shitës duhet të reklamojë. Kohët e fundit është bërë e modës që reklamat të kritikohen me idenë se ato zhvatin konsumatorin dhe ndotin zona të tëra me grumbuj hedhurinash. Një pjesë e reklamave shumëngjyrëshe në revista të shkëlqyera, si dhe disa programe zbavitëse në televizion përçmohen jo vetëm se fyejnë inteligjencën e të rriturve, por edhe se dëmtojnë mendjet e fëmijëve dhe të rinjve (dhe kjo është më e keqja). Megjithatë, televizionet dhe revistat do të falimentonin pa reklamat, pasi ato kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre. Një tjetër përgjegjësi që i ngarkohet industrisë së reklamave, është se reklamimi i nxit njerëzit të blejnë gjëra që realisht nuk u duhen. Një pohim ky, paksa, i pazakontë për një demokraci liberale që mbështetet në parimet e zgjedhjes së lirë. Kjo përgjegjësi krijon vizionin e një qytetari të pafuqishëm, që ndodhet në mes të një mekanizmi të "shpëlarjes" së trurit. Kërkoni po të doni, por kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklamat, të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur. Le t'i lëmë blerësit t'i hapin vetë sytë, por mos iu shmangni periudhës kur çmimet bien ndjeshëm vetëm se disa njerëz kanë mendime negative. Disa kritikë mendojnë se reklamat kontribuojnë në shtimin e ndotjes dhe po përshpejtojnë zhdukjen e materialeve të rralla nga planeti. Deri diku, kjo mund të jetë e vërtetë, por në këtë çështje ndikojnë edhe faktorë të tjerë, si: konsumatorët që i dëshirojnë këto mallra, prodhuesit që përfitojnë nga produktet e tyre, qeveria që ka nevojë për taksat që vijnë nga ekonomia e kështu me radhë. Shqyrtojeni me kujdes këtë listë dhe shikoni se ku ndodheni ju vetë. Herën tjetër, kur të dëgjoni dikë të thotë se reklama ka një ndikim të pafavorshëm në ekonomi, risillni në mendje se ajo është katalizator në procesin e shitjes dhe të blerjes.

Teza: Reklama është katalizatori në procesin e shitjes dhe të blerjes.

Argumenti 1. Pa reklamat televizionet dhe revistat do të falimentonin pa reklamat, pasi ato kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre

Argumenti2 Kërkoni po të doni, por kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklamat, të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur.

Kundërteza: Reklamat të kritikohen me idenë se ato zhvatin konsumatorin dhe ndotin zona të tëra me grumbuj hedhurinash
Teknikat që përdor autori për të përfshirë lexuesin në problemin që trajton

Teknikat: përdorimi i vetës II shumë, duke iu drejtuar drejtpërdrejt lexuesit/dëgjuesit;

- mbyllja mbetet e hapur, fton lexuesin të shtojë gjykimin e tij;
- përdorimi herë pas here i një leksiku të shkujdesur, bisedor;
- toni sugjerues
- Karakteristikat e esesë argumentuese:
- Hyrja është e shkurtër, prezantohet çështja;
- Fillon me kundërtezen dhe argumentet mbështetëse të saj (këndvështrimi I);
- Më pas ka argumente në mbështetje të tezës;
- Çdo argument kundra tezës shoqërohet me një argument pro asaj;
- Në paragrafin përmbyllës shfaqet qëndrimi i autorit, por njëkohësisht diskutimi lihet i hapur;
- Koherenca dhe kohezioni sigurohen përmes përshtatjes morfologjike të fjalëve, përmes përdorimit të një
- gjuhe të saktë, përmes mjeteve lidhëse (lidhëza, përemra lidhorë, ndajfolje etj.).

Burimi: AKP, Matura shtetërore 2015, Shkolla Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me shkrim

Udhëzohen nxënësit të punojnë për hartimin e një eseje argumentuese me temë: “Një vend kaq i afërt nga fëmijëria e largët”.

Kujdes !

Strukturën e esesë.

Në argumentet bindëse që sjellin.

Në pasurinë e detajeve.

Në organizimin e paragrafëve

Në gabimet drejtskrimore dhe gramatikore

Në përdorimin saktë të shenjave të pikësimit që përdoren brenda dhe në fund të fjalisë.

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për analizën e strukturës së esesë argumentuese, për gjetjen e tezës kundratezës, argumenteve dhe kundër-argumenteve etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Jeta ime pa teknologji


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Rubrika: Të shkruajmë Tema mësimore: Shkruajmë ese argumentuese Ora 2		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - klasifikon tema për lloje të ndryshme esesh argumentuese; - analizon strukturën e esesë argumentuese; - analizon esenë argumentuese nga ana gjuhësore; - shpjegon ndërtimin e një eseje argumentuese. 		Fjalët kyçe: Ese argumentuese Tema Hyrja Teza Argument Kundër-argumente Mbyllja	
Burimet: Teksti i nxënësit, “Si të shkruajmë ese”, CDE		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, TIK	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *pemë mendimi, punë pavarur individuale, diskutim.*

Organizimi i orës së mësimit



<p>Lexohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Diskutojmë së bashku.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Punë pavarur individuale</p> <p>Udhëzohen nxënësit që të shkruajnë një ese argumentuese.</p> <p>Pavarësisht se klasa është ndarë në grupe për temën e esesë, puna është individuale për secilin nga anëtarët e grupit</p> <p>Grupi 1 Kur lexoj një libër, mbyll një portë dhe ngre një perandori.</p> <p>Grupi 2 Libri prej letre është i lehtë, por forca e tij është aq e jashtëzakonshme, sa e ngre njeriun në majat e universit.</p> <p>Grupi 3 Libri apo filmi?</p> <p>Kujdes! Udhëzohen nxënësit për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturën e esesë. - Në argumentet bindëse që sjellin. - Në pasurinë e detajeve. - Në organizimin e paragrafëve - Në gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore - Në përdorimin saktë të shenjave të pikësimit që përdoren brenda dhe në fund të fjalisë. <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim</p> <p>Mësuesi/ja përpiket që puna me shkrim e nxënësve të përfundojë brenda 30 minutave. Më pas lexohen disa nga punët e nxënësve dhe diskutohet rreth tyre.</p> <p>Diskutimi përqendrohet në elementet përbërëse të esesë argumentuese teza, argumentet, kundërteza kundër-argumentet etj.</p> <p>Nxënësit vlerësojnë shkrimet e shokëve jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga struktura, drejtshkrimi etj.</p> <p>Mësuesi/ja mbledh fletoret e punës me shkrim për t'i vlerësuar me notë.</p> <p>Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për strukturën e esesë, për analizën e elementeve të strukturës dhe të përmbajtjes</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p>
--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje (ora e parë)		Situata e të nxënësve lidhet me dallimin në tekste të ndryshme të fjalive të përbëra me nënrenditje, si dhe me përcaktimin e skemës së tyre.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës--Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: fjali e përbërë me nënrenditje, marrëdhënie varësie, pjesë e varur ffilluese, rrethana, përcaktore, skema e fjalisë	
-Dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje dhe i përdor drejt ato; -identifikon skemën e fjalive të përbëra;			
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda me fjali nënrenditëse		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetja sjell pyetjen; Kllaster; Diskutim; Punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Pyetja sjell pyetjen, Kllaster;

Hapi I. U drejtohen pyetjet nxënësve: Si është marrëdhënia ndërmjet pjesëve në fjalinë e përbërë me nënrenditje? Cilat janë llojet e FPN (fjali e përbërë me nënrenditje)? Si paraqitet skematikisht FPN?

Hapi II. Përgjigjet e nxënësve përmbledhen te kllasteri




Hapi III. Përqendrohet vëmendja te FPN ftilluese. Rikujtohet informacioni i marrë në klasë të tetë.

Cilat janë mjetet lidhëse që shërbejnë për të lidhur pjesët e FPN ftilluese? Si është lidhja midis pjesës kryesore dhe pjesës së varur në këto fjali? Në varësi të rolit që luan pjesa e nënrenditur në lidhje me kallëzuesin e pjesës kryesore, si i klasifikojmë FPN ftilluese? Cili është rendi i pjesëve të kësaj fjalie?

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim;

Paraqiten në skemë përgjigjet e nxënësve



Shpjegohen modelet e skemave nga mësuesi duke bashkëpunuar me nxënësit në analizën e fjalive.

-Rikujtohen hapat që ndiqen për ndërtimin e skemës së fjalisë së përbërë;

1-Nënvizohen kallëzuesit;

2-vendosen numrat mbi secilin kallëzues, që do të përgjigjet numrit të pjesës përkatëse;


3-qarkohen mjetet lidhëse;

4-ndahen pjesët(përcaktohen gjymtyrët që lidhen me secilin kallëzues)


5-ndërtohet skema;

6-emërtohen pjesët.


Nuk e dinim1 /që ishte i huaj2 /dhe /që jetonte vetëm 3. Çfarë nuk dinim? Që ishte i huaj dhe që jetonte vetëm.



Jo vetëm që nuk e dinim1/,por as nuk na e merrte mendja2/ që ishte i huaj.3 Çfarë nuk dinim dhe nuk na e




Jo vetëm që nuk e dinim1/,por as nuk na e merrte mendja2/që ishte i huaj3/ dhe/ që jetonte vetëm.4



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

Nxënësit, sipas hapave, punojnë një fjali nga skedat e përgatitura.p.sh.:

Toni nuk arriti1/ të rikthehej në majë2/,**kurse** unë pata mundësi3/ të luaja më tepër.4



Vlerësimi: vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi, gjatë gjithë etapave të orës mësimore, duke pasur parasysh pjesëmarrjen, saktësinë e njohurive të mëparshme dhe përdorimin e tyre për temën e re.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjej 5 fjali të përbëra nënrenditëse në faqen 141 dhe shkruaji në skeda.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje (ora e dytë) Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës - Sintaksë		Situata e të nxënësve lidhet me dallimin në tekste të ndryshme të fjalive të përbëra me nënrenditje, si dhe me përcaktimin e skemës së tyre.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje ffilluese dhe i përdor drejt ato; - identifikon skemën e fjalive të përbëra; - ndërton fjali sipas skemave të dhëna. 		Fjalët kyçe: fjali e përbërë me nënrenditje, marrëdhënie varësie, pjesë e varur ffilluese, rrethore, përcaktore, skema e fjalisë	
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda me fjali nënrenditëse		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë e pavarur; Punë në çift; punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimi: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Punë e pavarur;</i> Nxënësit punojnë ushtrimet në faqen 335. 1. Dalloni fjalitë e përbëra me pjesë të varur ffilluese dhe mjetet lidhëse që vendosen mes tyre. Qysh atëherë seç kishte diçka/ që s'më linte/ ta braktisja. Turbull ndiejta/ se, po t'ia mbathja bashkë me të tjerat,/ do t'i lija diçka timen! që s'do të ma kthente më. Në fillim rrija fshehur pas një cepi, dhe nxirrja kokën për të parë/ nëse po vinte. Pastaj/ kur e shihja/ që s'levizte, detyrohesh/ t'i shkoja pranë, i jepja gurët/ e i vërtitja edhe unë!, por e bëja pa qenë e bindur tamam. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në çift;</i> 2. Dalloni pjesët e varura ffilluese dhe pjesët e varura përcaktore, thoni llojin e tyre dhe të mjeteve lidhëse përkatëse. Nëpunësit e të gjithë sektorëve pa përjashtim, por sidomos ata/ që(p.l) merreshin me Seleksionimin(P), dridheshin nga fjala "verifikim". U kishin treguar/ se(l.n.f) qëllonte shpesh(F-Kundr) / që(l.n.f.) ëndërrparësi, <i>me të dëgjuar ndonjë ngjarje reale, dërgonte letër në Tabir Saraj, duke pretenduar profetizimin e ngjarjes me anë të ëndrrës së tij.</i> (F-Kundr) Atëherë kërkohej ëndrra, /gjendej me anë të numrit të regjistrimit të saj në Recepton,/ nxirrej nga Arkivi/ dhe,/ në qoftë se ajo ishte vërtet ashtu,/ kërkohejshin fajtorët/ që ajo s'që marrë parasysh. Fajtorë mund të ishin interpretuesit,/ që(p.l) nuk e kishin zbrëthyer drejt kuptimin e sinjalit(P), por mund të ishin seleksionuesit,/ që (p.l) e kishin nxjerrë ëndërrën të pavlefshme(P) /dhe në këtë rast faji i tyre quhej edhe më i rëndë,/ sepse gabimi i interpretuesit,/ që(p.l) nuk arriti(P) ta shpjegonte drejt sinjalit,(F-Kundr)/ ishte më i falshëm në krahasim me gabimin e seleksionuesit,/ që(p.l) nuk gjeti në ëndërr asnjë sinjal.(P) Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë në grupe.</i> 3. Ndërtoni tri fjali sipas modelit të dhënë. * [pj. drejtuese] [(pj. e varur ffilluese) + (pj. e varur ffilluese)]-- Mendohet/ se Skënderbeu strehohej në këtë shpellë/ dhe/ se pak njerëz dinin për të. * [pj. drejtuese + pj. drejtuese] [(pj. e varur ffilluese)]—As e dinte më parë dhe as e mendonte fare,se ajo do të largohej drejt ShBA-ve. * [pj. drejtuese + pj. drejtuese] [(pj. e varur ffilluese) + (pj. e varur ffilluese)]--As e dinte më parë dhe as e mendonte fare, se ajo do të largohej drejt ShBA-së dhe s'do të kthehej më. Çdo ushtrim diskutohet në klasë.			
Vlerësimi: Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi për të gjitha ushtrimet.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4,faqja 335.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: “Revista e shkollës” (projekt, ora e tretë)		Situata e të nxënësve: Kujtime. Kujtimet janë të rëndësishme për të ardhmen. Njeriu përpiqet që të mbajë mend sa më shumë gjëra. Po a mundet vallë?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Prezantim	
- përdor saktë mjetet kompjuterike për të prezantuar informacionin;		Revistë	
- prezanton në mënyrën e duhur një material të dhënë;		Informacion	
- dallon lloje të ndryshme tekstesh në një revistë;		Materiale	
- sjell informacion, detyra nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, duke përdorur strategji të ndryshme;		Intervista	
- bashkëpunon me shokët e shoqet për të sjellë informacionet dhe materialet e duhura;		Kujtime	
- shkruan pa gabime drejtshkrimore në materialet e përzgjedhura.			
Burimet: Materialet kompjuterike për projektin, revistat e botuara për projektin.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Arte, Teknologji dhe TIK, Matematikë, Edukim fizik, sporte dhe shëndet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Pyetje-përgjigje, situata reale, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, fotomontazh, prezantim, turi i galerisë, konkurs.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Pyetje-përgjigje, situata reale.</i>			
Në fillim të orës mësuesi/ja ka përgatitur klasën për projektin me qëllim që të ketë gati materialet e duhura. Klasa duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të kenë të gjithë nxënësit pamje nga projektori. Për këtë orë mësimore janë të ftuar edhe mësues të tjerë nga shkolla, drejtorja e shkollës, nxënës nga senati dhe prindër të nxënësve.			
Prezantimi mund të bëhet nga nxënës të përgatitur me një skenar të veçantë.			
Lidhja me situatën nis me çështjen: Ju jeni nxënës në klasën e nëntë dhe shumë shpejt do të largoheni nga kjo shkollë.			
- Cilat janë gjërat që do të mbani mend? (shokët, shoqet, mësuesin/en kujdestare, rojën e shkollës etj).			
- Për çfarë do t’ju vijë më shumë keq? (për aktivitetet, shakatë në orët e mësimi)			
- A do të donit të riktheheshit pas në kohë? (Po që të ishim më të vegjël e të mos na ngarkonin me kaq shumë detyra)			
- Çfarë do të ndryshonit apo do ta bënit ndryshe nëse do të kishit mundësi? (Do ta vazhdonim shkollën këtu, do të mësonim më shumë)			
- Cilin apo çfarë do të donit ta merrnit me vete kur të largoheshit dhe përse? (shokun, shoqen, bankën e fundit ku rrija rehat, mësuesin/en kujdestare etj)			
Diskutohet me radhë mbi përgjigjet e çiltra e të sinqerta të nxënësve dhe tregohen shkurtimisht dy situata që nxënësit duan të rikujtojnë nga koha e tyre shkollore.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, fotomontazh.</i>			
Mësuesi/ja shtron pyetjet:			
- Ç’janë kujtimet? (<i>Kujtimet janë ngjarjet dhe situatat apo personat që kanë qenë pjesë e jetës sonë dhe mbeten në kujtesën tonë, në mendimet tona</i>).			
- Përse shërbejnë ato? (<i>Kujtimet na ndihmojnë që të zhvillojmë jetën normalisht sepse në kujtime dhe kujtesë ruhet shumë informacion për jetën tonë, që nga personat që na rrethojnë deri tek ngjarjet që na ndodhin gjatë gjithë jetës</i>).			
- Çfarë do të donit të mos harronit asnjëherë? (<i>Kujtimet që dua të ruaj janë ato me familjen time, kujtimet e bukura me shoqërinë, kujtimet që lidhen me formimin tim si njeri</i>).			

-Cilat janë gjërat që na ndihmojnë të mbajmë mend dhe të kujtojmë? (*Kujtimet ruhen në mendjen tonë, por rritja jonë, koha që kalon bën që ne të harrojmë shumë gjëra, për të kujtuar më mirë na ndihmojnë fotografitë, tekstet e shkruara, video etj.*)

Diskutojmë me nxënësit rreth përgjigjeve të dhëna.

Për të vërtetuar këtë nxënësit kanë përgatitur një fotomontazh nga shkolla e tyre.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Prezantim, turi i galerisë, konkurs.*

Për të kujtuar çaste nga jeta na ndihmon edhe media e shkruar. Pikërisht për të dokumentuar pjesë nga jeta shkollë, për të treguar ngjarje nga shkolla, mënyrën e arsimimit, aktivitete të ndryshme dhe vlerësimet e marra për të reklamuar punën e bërë në shkollë është zhvilluar edhe projekti për revistën e shkollës.

Grupet e punës kanë sjellë botimet dhe bëjnë prezantimin e revistës së tyre.

Secili grup ka krijuar edhe faqen on-line të revistës e cila është hedhur në faqen e shkollës.

Në faqen e shkollës janë bërë pëlqime për revistën nga nxënësit e tjerë të shkollës.

Secili grup reklamon revistën dhe sqaron disa çështje si: vendosjen e titullit, lloji i revistës, tematikat që kanë zgjedhur, grupin e punës sipas rolit dhe kontributit të secilit nxënës, burimi i materialeve, ndihma nga të tjerët, redaktori, faqesja dhe kryetari i grupit.

Kryetari i secilit grup bën një përmbledhje të shkurtër të punës dhe nga një vlerësim për punën e bashkëpunimit e secilit nxënës.

Prezantimi shoqërohet me pamje gjatë zhvillimit të punës së projektit si edhe me pamje të revistës.

Pasi mbarojnë me prezantimin secili kryetar u shpërndan të ftuarve nga një kopje të revistës dhe kopjen tjetër e vendos tek këndi i caktuar për turin e galerisë.

Nxënësit zhvillojnë turin e galerisë për të parë botimet e njëri-tjetrit dhe japin mendime e vlerësime për punën e grupeve apo për punën e gazetarëve të vegjël.

Në fund të orës, në formën e një konkursi të thjeshtë, shpallet revista më e mirë nga votimet *online* sipas pëlqimeve të nxënësve, por edhe nga juria e të ftuarve në klasë ndahen çmimet sipas mënyrës që kanë punuar.

Juria vendos duke parë: Tematikat e përzgjedhura që trajtohen, drejtshkrimi i gjuhës në tekste, faqesjen dhe ilustrimet që shoqërojnë e sqarojnë materialin, mënyrën e reklamimit, faktet reale dhe informacionet e sakta, përfshirjen e të gjithë anëtarëve dhe shoqërimin apo jo me suplemente në gjuhë të huaj apo për një çështje të caktuar.

Nxënësit përgëzohen për punën e bërë dukë u bërë të ditur se me këtë projekt kanë bërë të përhershme shumë kujtime nga jeta shkollë.

Vlerësimi: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen për përzgjedhjen e materialeve, bashkëpunimin, saktësinë, mënyrën e reklamimit, dorëzimin në kohë të materialeve. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Liqeni i Shkodrës		Situata e të nxënësve: Pikë turistike Shkodra ndodhet 99 kilometra nga kryeqyteti i vendit Tirana, 37 kilometra nga pika e kalimit kufitar të Hanit të Hotit (me Malin e Zi) dhe 16 kilometra nga pika e kalimit kufitar të Muriqanit (me Malin e Zi). Ajo ndodhet pranë Liqenit të Shkodrës, më i madhi në Ballkan, pranë lumenjve Drin, Buna dhe Kir.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi dhe të shprehurit - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Kompetenca qytetare 			

<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërton një tekst mbi fjalë kyçe; - dallon e sqaron fjalët e reja të tekstit; - lexon paraprakisht informacionin, në mënyrë që të mos ketë vështirësi për të kuptuar; - lidh informacionin që merr me përvojat e tij; - rilexon tekstin për të ngulitur në mendje detajet më të rëndësishme; - bashkëpunon me grupin për të zbërthyer tekstin sipas ndërtimit gjuhësor; - dallon elemente të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Liçen Breg Plazh Sipërfaqe Fundi Peshq</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të gatshme për liçenin e Shkodrës.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Fjalë kyçe, shkrim me terma paraprakë, punë e drejtuar, minileksion, hulumtim, punim ushtrimesh, informacione shtesë.</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimt</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Fjalë kyçe, shkrim me terma paraprakë.</i></p> <p>Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Pikë turistike” dhe nxënësit japin emra vendesh në Shqipëri që janë vende turistike. Kërkohe nga nxënësit që të sqarojnë shkurtimisht se cila është sipas tyre arsyeja që disa vende quhen pika turistike, çfarë i veçon dhe i dallon këto vende. <i>(Të veçanta i bën lashtësia, stili kulturor, natyra, bregdeti, gastronomia, stili arkitekturor, flora dhe fauna e tyre, traditat dhe zakonet etj).</i></p> <p>Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa fjalë kyçe si: Liçen, breg, plazh, sipërfaqe, fundi, peshq, Evropë, Shqipëri. Në formën e mendimit të lirë nxënësit shkruajnë një tekst ku duhet të përdorin fjalët e dhëna. Mësuesi/ja vendos kriterin për tekstin që duhet të krijojnë. Teksti duhet të jetë një tekst përshkruar.</p> <p>Nxënësit punojnë me udhëzimet e dhëna për të lidhur fjalët në një tekst përshkruar. Punimet e nxënësve dëgjohen dhe diskutohen para klasës duke nxjerrë elementet e përshkrimit.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e drejtuar, minileksion.</i></p> <p>Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e mësimt “Liçeni i Shkodrës” dhe drejton nxënësit të lexojnë në heshtje tekstin. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale mbi të kuptuarit e tekstit dhe fjalët e reja të fjalorit.</p> <p>Pas leximit të drejtuar mësuesi/ja ngre nxënësit për të sqaruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- llojin e tekstit <i>(jo letrar);</i> 2- për çfarë flet teksti <i>(jep informacione për Liçenin e Shkodrës);</i> 3- qëllimi i tekstit <i>(të sjellë informacione);</i> 4- mënyra që përdor autori për të përcjellë informacionin <i>(teksti përshkruar).</i> <p>Sqarohet teksti përshkruar: <i>Teksti përshkruar ka si qëllim të përshkruajë duke paraqitur me detaje tiparet e një objekti, të një personi, të një kafshë, të një mjedisi, apo të një dukurie.</i></p> <p>Përshkrimi mund të jetë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Objektiv (në enciklopedi, në tekste shkencore, dokumente zyrtare etj). 2 - Subjektiv (në ditarët, në letrat personale dhe në tekstet letrare). <p>Përshkrimi mbështetet në perceptimin shqisor: të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit. Në të jepen detaje dhe informacione të hollësishme të objekteve që përshkruhen.</p> <p>Në tekstin përshkruar mbizotëron përdorimi i mbiemrave dhe fjalëve përshkruuese. Në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, parafjalë, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet. Foljet e përdorura janë në kohën e tashme dhe të pakryer.</p> <p>Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Hulumtim, punim ushtrimesh, informacione shtesë.</i></p> <p>Nxënësit udhëzohen të hulumtojnë mbi tekstin duke iu rikthyer leximit për të dalluar elementet e përshkrimit. Duke lexuar e hulumtuar nxënësit mbajnë shënim të dhënat që marrin nga teksti mbi liçenin e Shkodrës. Hulumtohet për disa minuta dhe lexohen shënimet. <i>(Në tekst jepen tri elemente të rëndësishme të liçenit: pozicioni gjeografik, thellësia, fauna).</i></p>	

Punohet me radhë me ushtrimet e tekstit në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Ushtrimi 1 – (Gjenden paragrafët; Ritregohet shkurtimisht përmbajtja e paragrafit të parë mbi fjalët kyçe; thyerjen; fauna është e shumëllojshme, 45 lloje peshqish e 270 lloje zogjsh. Këta shpendë zënë 87% të gjithë ornitofaunës së Shqipërisë. Një perlë është pelikani. Gjendet: krap, qefulli, ngjala, blini; Në këtë paragraf jepen të dhëna për thellësinë e liqenit, si është i përbërë dhe origjina e prejardhjes së liqenit).

Ushtrimi 2 - *Liqeni i Shkodrës.*

Ushtrimi 3 - *Të përshkruajë duke informuar lexuesin.*

Ushtrimi 4 - *Duke përzgjedhur disa elemente si më të rëndësishmet dhe domethënëset.*

Ushtrimi 5 - *Cila kohë foljore mbizotëron në këtë tekst? - E tashmja.*

Ushtrimi 6 - *Pasqyra e tij ujore- Nivel i tij; buron- fillon, nis rrjedhën; ndarë- shkëputur, shndërruar- kthyer.*

Ushtrimi 7- *Kriptodepresion, ornitofauna, vorbullla sublakustrike; fusha leksikore: liqen.*

Ushtrimi 8- *Gropa ujëmbajtëse e liqenit; pellg a rezervuar i hapur për të grumbulluar ujë a lëngje të tjera. Basen uji. Basen prej betoni; Baseni i përroit; Pjesa e thelluar e detit afër portit ku qëndrojnë anijet.*

Ushtrimi 9 – *Studiuesit e gjeografisë, tekst shkollor; enciklopedi sepse jepen të dhëna dhe fakte shkencore.*

Në lidhje me **Ushtrimin 10**, mësuesi/ja jep disa informacione shtesë për liqenin e Shkodrës.

Gjatë dekadave të fundit ka pasur një rënie të dukshme të gjuetisë së peshkut, si në sasi ashtu edhe në strukturën e llojeve të këtyre specieve. Rezervat e peshkimit në liqen janë zvogëluar nga shfrytëzimi pa kriter, përdorimi i metodave të paligjshme ose të paqëndrueshme, konkurrenca nga specie ekzotike dhe degradimi i habitateve nga ndotja dhe shkatërrimet e bregut të liqenit.

Rezervat e peshkimit të llojeve shtegtare në liqen, gjithashtu janë prekur nga peshkimi i paligjshëm dhe praktikata e paqëndrueshme në lumin Buna. Gjatë dy dekadave të fundit, gjuetia e paligjshme ka qenë një kërcënim i vazhdueshëm për shpendët ujorë, çka, e kombinuar edhe me ndikime të tjera, si ndryshimet në rezervat ushqimore, cilësia e ujit, klima dhe shqetësimet nga aktivitetet njerëzore, ka zvogëluar numrin e llojeve dhe numrin total të shpendëve në liqen. Zvogëlimi i popullsisë së shpendëve të ujit ka ardhur edhe si pasojë e gjuetisë së pakontrolluar dhe të paqëndrueshme në zonat në afërsi, veçanërisht në Velipojë dhe në grykëderdhjen e lumit Buna. Blini (*Acipenser sturio*) nuk është regjistruar prej më shumë se 2- vitesh në Liqenin e Shkodrës

Liqeni ushqen rreth 50 lloje peshqish, 37 nga të cilët janë autoktonë, duke përfshirë edhe një numër llojesh endemikë të cilat mund të gjenden vetëm në liqen ose në zona të tjera ujore të Gadishullit të Ballkanit. Rreth 280 lloje shpendësh janë regjistruar deri tani në Liqenin e Shkodrës, duke përfshirë shumë lloje të rralla dhe të rrezikuara, të tilla si dallëndyshja faqebardhë e detit, pelikani kaçurrel, dhe çafka e verdhë.

Dëgjohet informacioni dhe mund të plotësohet nga nxënësit me fakte apo të dhëna nga njohuritë dhe përvojat e tyre. Nxënësit punojnë një shkrim të lirë me pasojat negative që sjell peshkimi i paligjshëm i peshkut.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve dhe nxirret si mesazh ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit.

Vlerësimi: Vlerësim motivues gjatë orës. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruani liqenin e Shkodrës në mënyrë subjektive duke u mbështetur te perceptimi shqisor.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Banesa tiranase		Situata e të nxënësve: Komunikimi Qëllimet që ne komunikojmë janë të ndryshme dhe të shumta. Komunikimi është nevojë e përditshme, por është edhe element argëtimi, element që forcon miqësitë, bashkëpunimet dhe lehtëson veprimtaritë e jetës sonë të përditshme.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon tekstin letrar nga ai joletrar; - nxjerr veçoritë e tekstit përshkrues; - nxjerr përfundime pasi ka lexuar dhe ka kuptuar tekstin; - mban shënime gjatë të lexuarit për të bërë ilustrime; - jep argumente që mbështesin interpretimin e tij; - dallon elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet.		Fjalët kyçe: Tekst informues Banesë tiranase Përshkrim Sali Shijaku	
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe 9”, materiale për piktorin Sali Shijaku, fotomontazh rreth banesave tiranase.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Fotomontazh, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, organizuesi grafik, hulumtim, punë e drejtuar, punë me tekstin, puno/shkëmbje, punë individuale.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: fotomontazh, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, organizuesi grafik. Mësuesi/ja prezanton përpara nxënësve disa fotografi të ndërtesave të vjetra të qyteteve të ndryshme të vendit tonë. Gjatë shikimit të fotove, nxënësve u sqarohet qyteti dhe diskutohet mbi disa tipare që i dallojnë apo afrojnë nga njëra-tjetra. Mësuesi/ja lidh situatën me temën duke sqaruar se edhe me anë të fotografisë mund të komunikosh, por komunikimi me i plotë është ai përmes gjuhës së folur dhe të shkruar. Rikujtohen njohuritë me anë të pyetjeve: 1- Çfarë kuptojmë me komunikim? (Komunikimi është nevojë e përditshme, por është edhe element argëtimi, element që forcon miqësitë, bashkëpunimet dhe lehtëson veprimtaritë e jetës sonë të përditshme). 2- Sa llojesh është ai? (gjuhësor dhe jogjuhësor). 3- Po komunikimi gjuhësor si ndahet? (Komunikim me anë të gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar). 4- Cili komunikim është më i saktë? (gjuhësor sepse me anë të gjuhës së folur e të shkruar mund të përcillen më mirë informacionet, mesazhet, mund të përshkruhen ndjenjat etj.). Komunikimin e përdorim për qëllime të ndryshme dhe tekstet e krijuara për qëllime të ndryshme kanë dhe veçori të ndryshme. Mësuesi/ja ndërton në tabelë një skicë për të nxjerrë disa lloje tekstesh.			
Teksti	Veçoritë	Shembuj	
Rrëfimtar	Rrëfen, tregon ngjarje, ka personazhe, ka një histori të trilluar a të vërtetë	Tregim, roman, përrallë	
Argumentues	Jep një opinion dhe e mbron me fakte bindëse.	Ligjërata, fjalime	
Përshkrues	Përshkruan pamjen e personave, objekteve dhe vendeve.	Tekste artistike, guida, manuale.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim, punë e drejtuar. Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e re, me tekstin përshkrues: “Banesa tiranase”. Lexohet pjesa dhe sqarohen fjalët e fjalorit.			

U kërkohet nxënësve që të hulumtojnë mbi pjesën e dhënë për të gjetur elementet e tekstit përshkrues të cilat i kanë marrë më parë. Rikujtohen njohuritë për ta pasur nxënësit më të thjeshtë.

Punohet disa minuta në heshtje për të studiuar tekstin dhe më pas ngrihen nxënësit me radhë për të gjetur detajet e tekstit përshkrues.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve duke i drejtuar për të gjetur elementet e tekstit përshkrues.

- 1- Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë duke paraqitur me detaje tiparet e një objekti, të një personi, të një kafshe, të një mjedisi, apo të një dukurie (*E ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XIX, ajo paraqet fazën më të zhvilluar të kësaj banese. Ajo ka planimetri katërkëndëshe të rregullt me dy kate*).
- 2- Përshkrimi mbështetet në perceptimin shqisor: të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit. (*Dhoma e zjarrit, ambientet e ndenjjes dhe anekset e shërbimit*).
- 3- Në të jepen detaje dhe informacione të hollësishme të objekteve që përshkruhen (*nëpërmjet portave të mëdha dykanatëshe që janë pothuaj gjithmonë të mbuluara me çati të thjeshtë*).
- 4- Në tekstin përshkrues mbizotëron përdorimi i mbiemrave dhe fjalëve përshkruese. Por, në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, parafralë, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet (*katërkëndëshe, më të lashta, të mëdha, të mbuluara, gjithmonë*).
- 5- Foljet e përdorura janë në kohën e tashme dhe të pakryer (*janë, është*).

Jepen disa detaje dhe informacione shkurt për piktorin Sali Shijaku. Një nga piktorët më të rëndësishëm në Shqipëri në shekullin XX. Lindi në Tiranë. Në Galerinë e Arteve ruhen rreth 92 vepra në pikturë, qeramikë e vizatime.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë me tekstin, puno/shkëmbje, punë individuale.*

Punohet me ushtrimet për të zërthyer të kuptuarit e tekstit.

Ushtrimi 1 - Banesa e Shijakasve daton në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë - x

Planimetria e saj është katërkëndëshe e rregullt me dy kate -v

Bërthama e mjediseve përçark saj është dhoma e zjarrit - v

Banesat me vatër zjarri kryesisht gjenden në zonën e Tiranës dhe në fshatrat përreth saj - x

Në katin e parë janë ambientet e ndenjjes dhe anekset e shërbimit - x

Në fillim të shekullit të njëzetë është bërë një rikonstrukcion i mjediseve, si dhe mbyllja e çardakut – v

Këto lloj banesash hasen edhe në qytete të tjera të Shqipërisë - x

Banesa e Shijakasve është shpallur monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1973 - v

Banesat shqiptare dallohen për tipologjitë e tyre të larmishme e të pasura - v

Ushtrimi 2 - Dhënësi – teksti; marrësi – lexuesi; kodi – gjuha shqipe; referenti – gjuha shqipe; kanali –shkrimi; Mesazhi - informacioni për ndërtesën tiranase dhe lashtësinë e saj.

Ushtrimi 3 - Objekti i përshkrimit - banesa tiranase; detajet – dy kate, katërkëndëshe, shkallë prej druri, mure qerpiçi, porta dykanatëshe; Shqisat – të shikuarit; Mënyra e organizimit të ideve – përshkrim në rend kohor.

Ushtrimi 4 - Do të punohet në grupe dyshe dhe nxënësit ndihmojnë njëri –tjetrin në saktësinë e ushtrimit;

Fazën më të zhvilluar: mbiemër i nyjshëm, femërore, njëjës, kallëzore, shkalla pohore.

Planimetri katërkëndëshe: mbiemër i panyjshëm, femërore, njëjës, kallëzore, shkalla pohore.

Ambientet ndihmëse: mbiemër i panyjshëm, femërore, shumës, emërore, pohore.

Llojet më të lashta: mbiemër i nyjshëm, femërore, shumës, emërore, krabasore.

Ushtrimi 5 - Shekullin- emër që tregon kohë; katërkëndëshe- mbiemër që tregon hapësirë; gjithmonë – ndajfolje që tregon kohë; fazën – emër, tregues kohor; përçark – parafralë, tregues hapësinor.

Ushtrimi 6 - Do të zhvillohet në mënyrë individuale dhe nxënësit do të përdorin stilin e individualitetin e tyre gjatë kthimit të tekstit në tekst përshkrues subjektiv. Mësuesi/ja ndjek dhe orienton nxënësit gjatë punës.

Ushtrimi 7 - (*Po sepse është një tekst joletrar dhe qëllimi i tij është të sjellë një pamje të qartë të banesës tiranase, të sjellë informacion të saktë pa përfshirë opinionet dhe qëndrimet e autorit*).

Ushtrimi 8 - Do të zhvillohet në formën e një diskutimi të lirë duke qenë se nxënësit kanë njohuri për arkitekturën si pjesë e folklorit shqiptar.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna për tekstin përshkrues, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, saktësinë e njohurive gramatikore dhe gjuhësore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Informacione për arkitekturën e qytetit në formën e një teksti përshkrues.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore		Situata e të nxënit lidhet me dallimin e pjesës së nënrenditur rrethore në fjali.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: FPN rrethore, kohore, vendore, shkakore, qëllimore, mënyrore, krahasore, kushtore, lejore, rrjedhimore	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - përcakton FPN rrethore dhe e përdor drejt atë; - dallon llojin e pjesës së nënrenditur rrethore, mbështetur dhe në mjetet lidhëse; - ndërton skemën e fjalive të përbëra me nënrenditje rrethore. 			
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika2, skeda me fjali të përbëra.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë në grup; Diskutim; Punë individuale; Punë në çift</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
Model skede			
Ndërto skemën e fjalive, duke punuar sipas hapave.			
<ul style="list-style-type: none"> - Kur dielli ra pas malit, bariu i vogël drejtoi bagëtinë drejt fshatit. - U ul të shkruante në kompjuter, ndonëse ishte i lodhur nga puna. 			
Hapi I. Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 nxënës. Secilit grup i jepet një skedë me 2 fjali të përbëra që kanë pjesë të nënrenditura rrethore. U kërkohet nxënësve të punojnë për t'i paraqitur skematikisht këto fjali, duke punuar sipas hapave të mësuara.			
Hapi II. Secili grup prezanton punën e bërë. Diskutohet për secilin rast të PN rrethore. Skemat e këtyre fjalive paraqiten edhe në tabelë. Nëse ndonjë nga skemat nuk është ndërtuar saktë, mësuesi ndërhyr për ta sqaruar e për ta ndërtuar saktë dhe në të njëjtën kohë mësuesi ngacmon kujtesën e nxënësve në lidhje me njohuritë për FPN rrethore.			
Hapi III. Nxënësit drejtohen në tekst për të punuar ushtrimet 1-4 në faqen 338.			
<i>Ushtrimi 1-Punë individuale-Dalloni fjalitë e përbëra me pjesë të varur rrethore dhe mjetet e tyre lidhëse.</i>			
Kur vrulli i zemërimit i ra, / e frenoi prapë veten. Orari zyrtar s'po mbaronte që s'po mbaronte. Megjithëse i dhembnin sytë, / Ebu Qerimi tërhoqi disa fletë nga dosja e ëndrrave të papërpunuara/ dhe i vuri përpara. Kishte përshtypjen / se lodhej më shumë duke bërë / sikur lexonte, / sesa po të lexonte vërtet. Zgjodhi ato fletë / që i kishin tekstet më të shkurtra/ dhe , pa e parë fare adresuesin, lexoi njëzën prej tyre.			
<i>Ushtrimi 2-Punë individuale- Përcaktoni llojin e fjalive të mëposhtme dhe nënvizoni mjetet lidhëse.</i>			
* Nëse bie shi, / do të rri në shtëpi. (FPN kushtore)			
* Kur bie shi, / rri në shtëpi. (FPN kohore)			
* Rri në shtëpi/ sepse po bie shi. (FPN shkakore)			
* Ndonëse bie shi, / nuk rri në shtëpi. (FPN lejore)			
* Po bie shi, / ndaj rrimë në shtëpi. (FPB përmblyllëse) ??????			
<i>Ushtrimi 3-Punë në çift- Shtoni nga dy pjesë të varura në pjesët e mëposhtme dhe përcaktoni llojin e tyre.</i>			
* Nuk më kujtohet/ se kush ma dhuroi librin (kryefjalore/ që kisha mbi tavolinë (përcaktore).			
* Askush nuk foli /që të mos mërzitej babai (qëllimore), sepse ishte lodhur shumë gjatë ditës. (shkakore)			
* Ne i dërguam/ se ata nuk kishin qenë asnjëherë në fshat, (shkakore)/ ndonëse e dashuronin natyrën. (Lejore)			
* Jashtë frynte erë /sa herë që nxihej andej (kohore) / nga dukej maja e Dajtit. (vendi)			
Ushtrimi 4- Punë në çift-Ndërtoni skemën për secilën nga fjalitë e ndërtuara në ushtrimin 3.			
Ushtrimet diskutohen me të gjithë nxënësit.			
Vlerësimi: Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi që në etapën e parë te puna në grup e deri në punimin e ushtrimeve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, faqja 338.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore		Situata e të nxënit: Identifikimi i pjesës së nënrenditur përcaktore.	
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe: FPN, përcaktorë, përemrat lidhorë, ndajfolje lidhore, vendi i PN, skema e FPN përcaktore	
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - përcakton FPN përcaktore dhe e përdor drejt atë; - identifikon funksionin e fjalës <i>që</i> në fjali të ndryshme; - Ndërton fjali të përbë ra me pjesë të nënrenditur përcaktore. 			
Burimet: Teksti i nxënësit, Gramatika 2,skeda me fjali të përbëra me nënrenditje		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Kllaster, Diskutim, Punë në grup; Punë individuale</i>			
Organizimi i orës së mësimi:			
Hapi I. Rikujtohen njohuritë për FPN përcaktore, të marra në klasën e tetë.			
<ul style="list-style-type: none"> - Ç'dini për FPN përcaktore? Çfarë tregon PN përcaktore? Ku është vendi i kësaj PN në raport me PK? Cilat janë mjetet me të cilat lidhen pjesët e FPN përcaktore? 			
Hapi II. Konkretizohen përgjigjet me punimin e fjalisë: <i>Dielli2/ i cili dukej si një disk i zjarrtë në kupë të qiellit,1/digjite atë fillim gushti2.</i>			
Hapi III.			
Hapi III. <u>Mjetet lidhë se</u>			
<ul style="list-style-type: none"> -P. lidhor: <i>që</i>, i cili - Nd. lidhor: <i>ku</i>, nga 			
Hapi IV. Punohen fjalitë për t'u njohur me skemat e FPN përcaktore.			
A <u>vjen</u> nga Durrësi <u>treni</u> 1/ <u>që</u> <u>ndaloj</u> në <u>stacionin</u> 2/ <u>që</u> <u>u</u> <u>hap</u> së fundi3			
Hante gjithçka1/ <u>që</u> <u>ishte</u> e <u>shijshme</u> 2/ dhe/ që <u>tretej</u> lehtë 3.			

Hapi V. Punohen ushtrimet 1-5 në faqen 341. Klasa ndahet në dy grupe. Grupi i parë punon ushtrimin 1; grupi i dytë punon ushtrimin 5. Ushtrimet 2, 3, 4 punohen individualisht.

Ushtrimi 1- Dalloni fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore dhe mjetet e tyre lidhëse.

Gjithë udhës/ **nga** iktel, dukeshin gjurmët e hënës së plagosur. Ja kjo ishte vërtet një ëndërr/ **që** ia vlente barra qiranë/ të merreshë me të. Ishte vërtet një ëndërr serioze./ **me të cilën** kishe qejf/ të merreshë. Ebu Qerimi mendoi/ se, sidoqoftë, puna e interpretuesve, /pavarësisht se ishte tepër e vështirë dhe delikate,/ ishte e këndshme, /sidomos kur kishe/ të bëje me ëndrra të tilla. Atij vetë, megjithëse i lodhur, i lindi dëshira të interpretonte ëndrrën. Madje kjo gjë s'iu duk aspak e zorshme,/ pasi kuptohej /që macja e zezë ishte një forcë armiqësore/ **që** vepronte kundër tyre. Një ëndërr e tillë i ka të gjitha shanset për t' u shpallur kryeëndërr,/ mendoi Ebu Qerimi.

Ushtrimi 2. Ndërtoni nga një fjali të përbërë përcaktore duke përdorur si mjete lidhëse:

*që

*prej të cilës

*me të cilin

*ku e cila

Ushtrimi 3- Për secilën nga fjalitë e mësipërme, ndërtoni skemën përkatëse.

Ushtrimi 4- Në secilën nga fjalitë e mëposhtme, përcaktoni funksionin e fjalës që dhe llojin e fjalisë në të cilën përdoret.

*Më lëndoi kjo fjalë/ **që** the. (P) që -p. lidhor

* Dihet /**që** këtu ka shumë vështirësi. (Ftilluese-kryefjalore) që - l.n. ftilluese

*Nuk është dëgjuar më parë /**që** një robot të marrë shtetësinë e një vendi. (Ftilluese-kryefjalore) që -l.n. ftilluese

*Duhet të punosh shumë /**që** t'ia dalësh mbanë. (rrethano-re-qëllimore) që - l. n. qëllimore

*Erdhën **që** të dy me vonesë. që -pjesë z

Ushtrimi 5- Dalloni dhe analizoni fjalitë e përbëra si dhe mjetet e tyre lidhëse.

Që në orën dy të natës më zgjonte një mërmërimë e mbytur,/ si të dilte nga rropullitë e dheut. Ishin njerëzit/ që zinin radhë poshtë, në dyqanin e qumështit. Ata flisnin,/ diskutonin,/ grindeshin, /sidomos kur mbërrinte shitësja e qumështit. Ky që çasti kulmor i grindjeve për të mos lejuar prishjen e radhës nga hileqarët. Këtyre u ishte treguar vendi/ sepse njerëzit shtrengoheshin pas njëri-tjetrit,/ secili kishte të drejtë/ të merrte dy litra/ dhe,/ nëse arrinte/ t'i merrte,/ largohej i kënaqur për të ardhur të nesërmen.

Ushtrimet diskutohen në klasë.

Vlerësimi: Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi, gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6,faqja 341

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Data ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: I X
Tema mësimore: Shkruajmë një ese përshkruese Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Lexojmë dhe japim mendime për një tekst joletrar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca qytetare. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - rikujton njohuritë në lidhje me esenë dhe llojet e saj; - dallon fjalitë përshkruese dhe mbiemrat në një tekst të dhënë; - krahason dy përshkrime objektive dhe subjektive; - shkruan një ese përshkruese, duke respektuar formën dhe përmbajtjen e saj; - shkruan pa gabime drejtshkrimore - vetëvlerëson krijimin e tij dhe punën e realizuar nga shokët.		Fjalët kyçe: ese, ese përshkruese, përmbajtje, strukturë, paragraf, ide, detaje përshkruese	
Burimet: teksti, modele esesh, fletore, tabakë letre, libri “Të shkruajmë ese”, lapustila shkumësa me ngjyra		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë në grupe, Lexim, Diskutim, Punë e pavarur, Turi i galerisë</i>			
Organizimi i orës së mësimt Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Punë në grupe,</i> U shpërndahen nxënësve disa modele të shkurtra esesh. Nxënësit, të ndarë në grupe, do të përcaktojnë llojin e esesë, qëllimin dhe tiparet e saj. Më pas, një përfaqësues i çdo grupi do të prezantojë punimin në tabelë. Vlerësohet puna e realizuar nga grupet. (modele esesh argumentuese, krahasim kontrasti dhe ese përshkruese) Do të veçohet eseja përshkruese dhe nxënësit do të plotësojnë veçoritë e saj, duke shfrytëzuar edhe informacionin e paraqitur në faqen.189 Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim, Diskutim</i> Prezantohet tema e mësimt dhe lexohet teksti përshkrues: Buzë liqenit të Janinës. Gjatë leximit të pjesës udhëzohen nxënësit që të nënvizojnë mbiemrat. Mund të përcaktojnë edhe epitetet si figurë e përdorura. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit. Perceptimi shqisor i të parit. Detaje që realizohen përmes mbiemrave të shumtë që janë përdorur, <i>Gjashhtë remtarë të nxirë nga dielli.....lopatat pezull.</i> <i>Para barkës lundronte...të ndiqte turmën</i> <i>Nga ai krah ishulli...të pasanikëve të Janinës.</i> Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur, Turi i galerisë</i> 3.Përshkrimi i liqenit të Shkodrës është një përshkrim objektiv që mbështetet në fakte dhe të dhëna reale gjeografike, kurse përshkrimi i liqenit të Janinës është subjektiv, i parë nën këndvështrimin e një personazhi kaq madhështor si Ali Pasha. Gjuha në rastin e parë është asnjansë, me kuptim të drejtpërdrejtë, kurse në rastin e dytë ajo është e figurshme. Hapi I. <i>Punë e pavarur:</i> Nxënësit do të zgjedhin njërin nga temat e tekstit, për të hartuar një ese përshkruese, duke plotësuar më parë Organizuesin grafik, i cili do t'i orientojë për të realizuar sa më mirë punimin. Hapi II. <i>Turi i galerisë:</i> Prezantimi i punimeve të realizuara nga nxënësit. Nxënësit do të vlerësojnë punën e realizuar nga ata vetë dhe nga shoku/shoqja. Gjatë vlerësimit do të kihet parasysh se sa janë zbatuar nga nxënësit rregullat e shkrimit të esesë përshkruese.			
Vlerësimi: nisur nga pjesëmarrja gjatë orës, puna në grup, përcaktimi i tipareve të esesë, krahasimi i dy përshkrimeve, shkrimi i esesë sipas rregullave të hartimit të saj dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes gjatë orës së mësimt.			
Detyrat dhe puna e pavarur:			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: IX
Tema mësimore: Panair portofoli (tremujori i tretë)		Situata e të nxënit: Përshkrimi objektiv dhe subjektiv. Të dy tekstet përshkruajnë, por ndryshojnë nga njëri-tjetri. Njëri është thjesht informues dhe tjetri, përveçse informon, ngjall emocione tek lexuesi.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Komunikimi dhe të shprehurit Të menduarit Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: -nxjerr dhe grupon shkurt njohuritë që ka përvetësuar, -radhit rastet kur është ndier krenar apo është zhgënjyer për vlerësimet e marra, -prezanton përpara shokëve\shoqeve punimet e portofolit në formën e një reklamimi, -bën vetëvlerësimin e punimeve të portofolit, -vlerëson punimet e shokut\shoqes, -ndërthur njohuritë gjuhësore me ato matematikore duke bërë llogaritjen e pikëve si dhe kthimin e pikëve në notë, -bën analizën e rezultateve të arritura duke bërë krahasimin e tremujorëve.		Fjalët kyçe: Panair Portofol Detyra Projekt Njohuri Vlerësim Vetëvlerësim Talent Prirje	
Burimet: Portofolat e nxënësve, detyrat e tremujorit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Arte, Matematikë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë e kombinuar me arsyetim, gushkuqi rrethor, minileksion, punë e drejtuar, puno/shkëmbje, organizuesi grafik, panair detyrash.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bisedë e kombinuar me arsyetim, gushkuqi rrethor. Njihen nxënësit me temën e orës mësimore dhe mënyrën e organizimit të saj. Gjatë kësaj ore do të ketë të ftuar nga nxënës të klasave të tjera, mësues të tjerë dhe prindër. Në fillim prezantohen të ftuarit të cilët do të jenë edhe pjesë e jurisë në fund të orës për vlerësimin e portofolëve më të mirë. Në formën e bisedës së kombinuar nis ora mësimore dhe diskutohet mbi rëndësinë e punës me portofol. Nxënësit japin mendime për rolin e portofolit. Portofoli i nxënësit: Dëshmon për aftësitë e tij, krijon me anë të imagjinatës, seleksionon detyrat më të mira, evidenton arritjet e tij, përzgjedh temën ku ndien siguri dhe kënaqësi, përcakton nivelin e njohurive të tij, dokumenton njohuritë, plotëson informacionin e marrë, vlerëson punën e shokut dhe vetëvlerëson detyrat e tij, prezanton punën e bërë etj. Me metodën e gushkuqit rrethor mësuesi/ja shpërndan një fletë ku nxënësit do të shkruajnë temën e trajtuar apo detyrën që u ka pëlqyer më shumë. Më pas po me këtë metodë kërkohet që të shkruajnë për detyrën apo temën që i ka lodhur më shumë. Në fund mblidhen fletët dhe nga përgjigjet e nxënësve dalin dy tema fituese: Njëra si tema më e bukur dhe tjetra si tema më e vështirë. Nxënësit sqarojnë shkurt disa nga përgjigjet e dhëna. Lexojmë disa nga detyrat e nxënësve nga temat e përzgjedhura si më të bukurat dhe disa detyra të përzgjedhura si më të vështirat. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Minileksion, punë e drejtuar.</i> Për të bërë prezantimin e portofolit është e rëndësishme që të bësh një përshkrim të saktë dhe të bukur të tij. Përshkrimet janë dy lloje: Përshkrimi objektiv dhe subjektiv. Të dy tekstet përshkruajnë, por ndryshojnë nga njëri- tjetri.			

Teksti përshkrues objektiv:

- 1- jep informacione dhe të dhëna për një send a person në mënyrë të saktë;
- 2- autori nuk mban qëndrim apo të shprehë opinione vetjake;
- 3- ka qëllim vetëm të informojë;

Teksti përshkrues subjektiv:

- 1- autori përshkruan një send a një frymor sipas këndvështrimit të tij;
- 2- shpreh përshtypje dhe mban qëndrime personale,
- 3- përveçse sjell informacion, argëton, ngjall emocione.

Për të realizuar të dy llojet e përshkrimeve mësuesi/ja ngre në tabelë disa nxënës me radhë dhe i drejton ata që të prezantojnë në të dy mënyrat portofolat e tyre. Nxënësit e klasës dëgjojnë prezantimet e shokëve e shoqeve dhe japin pëlqimet e tyre pas përshkrimeve.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Puno/shkëmbje, organizuesi grafik, panair detyrash.*

Orientohen nxënësit që të punojnë në grupe dyshe me portofolat e tyre. Shikohen detyrat dhe vlerësimet e bëra nga mësuesi/ja.

Mësuesi/ja u lë nxënësve kohë për rishikim dhe përmirësim të një detyre që ata dëshirojnë të shtojnë diçka, të bëjnë një korrigjim duke ndihmuar njëri-tjetrit.

Në dërrasën e zezë mësuesi/ja harton një tabelë mendimesh dhe nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e saj.

Unë jam shumë i kënaqur.	Shënohet detyra e përzgjedhur nga nxënësi.	Plotësohet nga nxënësi me arsyet përse është i kënaqur.
Jam pjesërisht i kënaqur.	Shënohet detyra e përzgjedhur nga nxënësi, që ka nevojë për përmirësim.	Nxënësi/ja e plotëson sipas mendimit të tij/saj arsyen përse nuk ka arritur maksimumin të kjo detyrë.
Nuk jam i kënaqur.	Shënohet detyra në të cilën nxënësi/ja nuk është i/e kënaqur me punën e tij/saj.	Shënohet arsyeja e pakënaqësisë nga kjo detyrë.

Pasi nxënësit kanë zgjedhur detyrën ku ndihen të kënaqur, e vendosin atë tek këndi i caktuar për të organizuar një panair me detyrat e portofolit. Juria e caktuar që në fillim të orës e përbërë nga të ftuarit, vendos dhe përzgjedh disa nga detyrat më të bukura e më të sakta. Juria motivon të gjithë nxënësit për punën e bërë me portofolat e të nxënësve. Nxënësit përgëzohen për përmirësimet e bëra nga njëri-tjetri.

Vlerësimi: Vlerësim motivues me fjalë e shprehje për punën e bërë.

Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

